

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

JETA SHOQËRORE E SHQIPTARËVE
NË SHKUP DHE RRETHINË
NDËRMJET DY LUFTËRAVE
BOTËRORE

(Konferencë shkencore, 14–15 tetor 2015 – Shkup)

- 12 -



Shkup, 2015

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE –
SHKUP

Vëllimi 12 – 2015

Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Sevdail Demiri

Këshilli redaktues:
Dr. Zeqirija Ibrahim
Dr. Skender Asani
Dr. Sevdail Demiri
Mr. Ardian Limani
Mr. Muharrem Jahja
Mr. Murtezan Idrizi

Sekretaria:
Dr. Hidajete Azizi, Mr. Ardian Limani,
Elham Bislimi, Arife Kovaçi

Redaktor teknik: *Naser Fera*

Copyright© ITSHKSH, 2015
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN 978–608–4653–32–5

www.itsh.edu.mk

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI – 12

***JETA SHOQËRORE E SHQIPTARËVE NË
SHKUP DHE RRETHINË NDËRMJET DY
LUFTËRAVE BOTËRORE***

(Konferencë shkencore, 14–15 Tetor 2015 – Shkup)

***ОПШТЕСТВЕНИОТ ЖИВОТ НА
АЛБАНЦИТЕ ВО СКОПЈЕ И ОКОЛИНА
ПОМЕЃУ ДВЕТЕ СВЕТСКИ ВОЈНИ***

(Научна конференција, 14-15 Октомври 2015, Скопје)

***THE SOCIAL LIFE OF ALBANIANS IN SKOPJE
AND SURROUNDINGS BETWEEN THE
TWO WORLD WARS***

(A scientific conference, 14–15 October – Skopje)

SCUPI

Shkup, 2015

TRYEZA E LËNDËS:

HYRJE.....	9
NEBI DERVISHI: KONTRIBUTI I FAMILJES DRAGA NË LËVIZJEN SHQIPTARE, NGA GJYSMA E DYTË E SHEK. XIX, DERI NË VITET 30 TË SHEK. XX.....	11
MARENGLLEN VERLI: SHKUPI NË FOKUSIN E NJË PIONIERI TË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE.....	24
DAUT BISLIMI: HISTORIOGRAFIA PSEUDOSHKENCORE SERBE PËR SHQIPTARËT NDËRMJET DY LUFTRAVE BOTËRORE.....	33
AVZI MUSTAFA: EDUKIMI DHE ARSIMI I SHQIPTARËVE NË SHKUP E RRETHINË NË MES TË DY LUFTËRAVE BOTËRORE.....	41
QERIM LITA: DIPLOMACIA SHQIPTARE NË SHKUP (1935 – 1941)	55
SHINAZI MEMETI: ROLI I BASHKËSISË FETARE ISLAME DHE MYFTINISË SË SHKUPIT NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE.....	71
ADNAN ISMAILI: ZHBËRJA E IDENTITETIT ISLAM NË SHKUP – 90 – VJETORI I RRËNIMIT TË XHAMISË BURMALI –.....	92
NAIM HALIMI: REFORMA AGRARE – KOLONIZUESE NË QARKUN E SHKUPIT, NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE.....	101
SKENDER LUTFIU: REFORMA AGRARE DHE KOLONIZIMI NË FERIZAJ ME RRETHINË, NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE.....	109

DON VIKTOR SOPI: VEPRIMTARIA DIPLOMATIKE E LAZËR MJEDËS, KARSHI TRYSNIVE FETARE DHE POLITIKE NDAJ SHQIPTARËVE	123
ALBERT RAMAJ: GJENDJA E ARGJIPESHKVISË SË SHKUPIT DHE VEPRIMTARIA E ARGJIPESHKVIT LAZËR MJEDA	138
METIN IZETI: TEQETË E SHKUPIT MIDIS DY LUFTËRAVE BOTËRORE DHE NDIKIMI I TYRE NË NGRITJEN INTELLEKTUALE DHE FETARE TË POPULLSISË SHQIPTARE. 209	
SKENDER ASANI & MEHMET PRISHTINA: SHKUPI – QENDËR E RËNDËSISHME E ORGANIZATËS POLITIKE XHEMIJETI... 224	
NURIDIN AHMETI: DËMTIMI SISTEMATIK I PRONAVE PRIVATE DHE VAKËFEVE NË SHKUP, SIPAS NJË SHKRESE ZYRTARE TË FERHAT DRAGËS TË VITIT 1935.....	233
QEMAL MURATI: POPULLSIA SHQIPTARE E SHKUPIT NË DRITËN E GJUHËS DHE TOPONIMISË SË SAJ NË DISA PUBLIKIME SERBE	248
MIXHAIT POLLOZHANI: SHQIPTARËT DHE TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE MIDIS DY LUFTËRAVE BOTËRORE NË SHKUP.....	266
ZEQIRIJA IBRAHIMI: KUJTESA HISTORIKE E SHKUPIT PËRMES PLANEVE URBANISTIKE (1914–2014)	280
GABRIELA TOPUZOVSKA & LIDIJA GJUROVSKA: MORBIDITETI DHE MORTALITETI NË SHKUP DHE RRETHINËN E TIJ MES DY LUFTËRAVE BOTËRORE.....	289
ISAMEDIN AZIZI & AGRON SALIHI: LËVIZJET DEMOGRAFIKE TË SHQIPTARËVE NË SHKUP ME RRETHINË MIDIS DY LUFTËRAVE	306
BESNIK RAMETI: NDARJA ADMINISTRATIVE– TERRITORIALE CIVILE NË SHKUP DHE RRETHINË.....	323
NATASHA DIDENKO & ALBERT HANI: LËVIZJET KULTURORE NË SHKUP, MES DY LUFTËRAVE BOTËRORE (1918–1928).....	332
IZAIM MURTEZANI: SHKUPI NË RAPSODINË POPULLORE, NËDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE	357

SEVDAIL DEMIRI: ÇËSHTJA SHQIPTARE NË SHTYPIN E KOHËS QË BOTOHEJ NË SHKUP (<i>SHEMBUJ NGA “PRIVREDNI GLASNIK” GJATË VITIT 1921</i>).....	368
NASER RAMADANI: FUNKSIONIMI I MEDRESEVE TË SHKUPIT NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE.....	377
TAXHEDIN BISLIMI: KONTRIBUTI I MEXHLISI ULEMASË SË SHKUPIT NË NGRITJEN E VETËDIJES DHE ARSIMIT TE POPULLATA SHQIPTARE	394
MURTEZAN IDRIZI: ROLI EDUKATIVO – ARSIMOR DHE KULTUROR I MEDRESEVE NË SHKUP	425
ISLAM ISLAMI & MUHAMED ALI: MEDRESEJA MEDDAH DHE NDIKIMI I SAJ NE SHOQËRINË SHKUPJANE NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE	435
AFET JASHARI: POROSITË E ATULLAH EF. KURTISHIT (1874–1946), PËR SHQIPTARËT E SHKUPIT	443
FJALA E PËRMBYLLËSE	453

HYRJE

Periudha ndërmjet dy luftërave botërore, është një nga fazat më të errëta dhe më të rënda për shqiptarët e mbetur nën Mbretërinë Serbo–Kroato–Sllovene, përkatësisht Jugosllave. Shkupi, si një qendër e rëndësishme historike e zhvillimeve gjeopolitike e këtij rajoni të Ballkanit, ishte qendër edhe e realizimit të projekteve antishqiptare që dirigjoheshin nga Beogradi.

Nisur nga nevoja e hulumtimit dhe zbardhjes së të vërtetave historike për Shkupin dhe rrethinën e saj gjatë asaj periudhe, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITSHKSH) në Shkup, ngriti iniciativën për organizimin e një konference shkencore, për të cilën që në fillim u tregua një interesim i madh i të gjitha qarqeve shkencore, jo vetëm se në Shkup e Maqedoni, por edhe në Kosovë, Shqipëri e diasporë. U formua Këshilli Organizues, dhe për pjesëmarrje në konferencë u paraqitën mbi 30 studiues të njohur me tema të ndryshme.

Kështu, më 14 dhe 15 tetor 2015, në Shkup i zhvilloi me sukses punimet konferenca shkencore me temë “Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore”, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë.

Në këtë edicion të revistës periodike “SCUPI”, janë përfshirë kumtesat e studiuesve që morën pjesë në punimet e konfe–

rencës së lartpërmendur. Kuntetat e zgjeruara që botohen në këtë edicion, janë me aparaturë të nevojshme shkencore, dhe paraqesin një lëndë të mirëfilltë për shkrimin e historisë së shqiptarëve të Shkupit dhe më gjerë, në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore.

Botimin e këtij edicioni të “Scupi”-t, e mundësoi Qendra Kulturore Turke “Junus Enre” nga Shkupi, të cilën e falënderojmë për ndihmën dhe bashkëpunimin.

*Këshilli redaktues,
11.12.2015, Shkup*

NEBI DERVISHI

Universiteti Shtetëror i Tetovës

KONTRIBUTI I FAMILJES DRAGA NË LËVIZJEN SHQIPTARE, NGA GJYSMA E DYTË E SHEK. XIX, DERI NË VITET 30 TË SHEK. XX

Familja Draga – është degë e fisit Kelmendi, një nga fiset e njohura në historinë e re shqiptare. Nga kjo familje dolën personalitete në tri breza, si pinjollë të oxhakut.

Ali Pashë Draga – ishte i biri i Ali Ferhat bej Dragës – Kelmendit i cili shërben si imam në një xhami të Pazarit të Ri. Ai të birin të quajtur me emrin Ali i dha shkollim në drejtim shoqëror dhe ushtarak. Ali Kelmendi do të bëhet i njohur veçanërisht në kohën e Luftës Ruso-Turke të vitit 1876–1877. Familja Draga kishte prona të mëdha në Sanxhakun e Pazarit të Ri, dhe që herët kishin hapur një fabrikë për përpunimin e durit pranë lumit Ibër¹, dhe do të merrë pjesë në ndërtimin e hekurudhës në relacionin Shkup – Mitrovicë në vitin 1874.

Ali pashë Ali Ferhat bej Draga – Kelmendi mori pjesë aktive në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe me sukses i bashkoi elementet etnike shqiptare dhe boshnjake në veriperëndim të Vilajetit të Kosovës, e mbrojti kufirin etnik dhe historik të Shqipërisë në viset e Shalës së Bajgorës, të Kollashinit dhe të Sanxhakut të Tregut të Ri (Jeni Pazar, Novi Pazar). Së këndejmi, i doli zot, së fundi edhe çiflikut prej 500 hektarë që ia kishte ndarë Sulltani në Mojstir për sukseset në luftën e Plemës.

¹ Shukri Rrahimi, Vilajeti I Kosovës, Prishtinë, 1969, f.37;

Ali pashë Draga ishte anëtar i komitetit Qendror të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit² dhe mori pjesë aktive në Lidhjen Shqiptare të Pejës 1899³ duke bashkëpunuar dendur me Haxhi Zekën dhe atdhetarët e tjerë të Lëvizjes Kombëtare. Ai pati katër djem: Nexhipin, Hajdinin, Xhaferrin dhe Ferhatin, të cilët gjithashtu dhanë kontributin e tyre për çështjen kombëtare, dhe një pjesë të veprimtarisë e kryen pikërisht këtu në Shkup, në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës, kjo dëshmohet me një dokument⁴ që mbanë datën 19 prill 1929, avokati Velibor Gjiniqi, i drejtohet me një kërkesë gjykatës Komunale në Shkup që të lëshoi një vërtetim që Kompania “Ali Pashë Draga” – e themeluar rreth vitit 1880 në Mitrovicë të Kosovës, ka punuar me këtë emër deri rreth vitit 1896, dhe se antar të Kompanisë kanë qenë edhe dy djemtë e tij, Ajdini dhe Nexhipi në periudhën 1896–1905. Kompania (Ndërmarrja për përpunimin e drurit) “Ali Pashë Draga” nga viti 1905 e në vitet në vazhdim do të emërohet “DRAGA ZADELER” (Djemtë Draga), “DRAGA FILLS” dhe se anëtarët e kompanisë kanë qenë tre djemtë e Ali Pashë Dragës, Nexhipi, Ajdini dhe Ferhati. Në dokument (kërkesa ka për bazë garancionin e dy dëshmitarëve) theksohet se “Kompania DRAGA ZADELER – “Djemtë Draga” – “Draga Fills”⁵ – pjesën më të madhe të transaksioneve tregëtare nga përpunimi i drurit materialeve ndërtimore i ka pasur këtu në Shkup.

1. **Nexhip bej Draga**, si pinjoll oxhaku i familje Draga – Kelmendi që i kishin dhënë kombit shqiptar në tri breza, dhe si bir pas-hai, u rrit në gjirin e familjes me një traditë të formuar intelektuale, ushtarake dhe politike⁶. Ai gjatë veprimtarisë së tij fillimisht karrierën e nisi në administratën perandorake dhe qe diplomat, deputet në

² Fjalori Enciklopedik Shqiptar Tiranë, 2008, f. 508;

³ Kristaq Prifti, Lidhja e Pejës, Tiranë, 1986, f. 179;

⁴ Државен Архив на Р. Македонија, Архив на град Скопје, фонд. „Гредско Поглаварство,, 19.IV.1929 год.

⁵ Po aty.

⁶ Shukri Rrahimi, Lufta e shqiptarëve për autonomi (1896 – 1912), Prishtinë, 1979, f. 124

parlamentin xhonturk, udhëheqës politik e kombëtar së bashku me Hasan bej Prishtinën në Kryengritjen e Përgjithshme të 1912, veprimtar për çlirimin e bashkimit të viseve shqiptare të mbëtura jashtë kufirit shtetëror,⁷ mbështetës e veprimtarë në hapjen e shkollave dhe Alfabetit të Manastirit, dhe senator në Parlamentin e Mbretërisë Serbo – Kroate – Sllovene në Beograd në 1920–1921.⁸

Nexhip bej Draga kishte mundësi materiale të shkollohet në shkollat më me emër të Perandorisë Osmane, ku krijoheshin kuadro për administratë dhe nënpunës të lartë.

Lindi në vitin 1868 në Mitrovicë dhe ishte i biri më i madh i Ali Pashë Dragës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Pasi e mbaroi idadinë (gjimnazin) në Quperli (Veles) dhe Shkollën e lartë mbretërore të profesioneve ekonomike Mulkiye – I – Sehadane”, për shumë vite specializoi dhe mësoi gjuhën frënge në Paris, ku u lidh me qarqet revolucionare të Turqve të Rinj. Fliste dhe shkruante frengjisht, turqisht, serbisht dhe bullgarisht.

Nga fundi i shek. XIX, Nexhip bej Dragën e shohim kajmakam (1896–1902) në Kratovë, Pazarin e Ri, e Veles, kursë në prag të Lidhjes shqiptare të Pejës “Besa – Besë” të Haxhi Zekës, e shohim në Mitrovicë, ku iu kushtua jetës politike dhe administrimit të ekonomisë familjare në Mitrovicë dhe Shkup. Meqë pronat e familjes Draga ishin në viset kufitare me Serbinë, të bijtë Ali Pashë–Dragës të hedhur në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe veçmas Nexhipi, si veprimtar i shquar i Lëvizjes Demokratike Xhonturke, kultivoi marrëdhënie fqinjësore të mira me Serbinë dhe me sërëbët në viset e Mitrovicës. Këtë fakt e vërtetoi “Afera e Shkurtit” të 1899 me komitet serbë në Mitrovicë.

⁷ Ramiz Abdyli, Fjalori i Historisë, Shkup, 2008, f. 319.

⁸ Po aty.

Në zgjedhjet e para për Parlamentin e Turqisë, në dhjetor të vitit 1908, Nexhip bej Draga u zgjedh deputet (përfaqësues) i popullit për Sanxhakun e Shkupit të Vilajetit të Kosovës. Gazeta shqiptare “Besa” e Stambollit, e dt. 26 janar 1909, duke folur për zgjedhjen e përfaqësuesve të katër vilajeteve të Shqipërisë, Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës, Shahin Kolonjës, Nexhip Dragës e të tjerëve për përfaqësues të popullit, ata i quan “Lule të atdheut që ka dërguar këtu (Stamboll) Shqipëria”, të cilët “do të përpiqen për atdheun tonë”⁹.

Si një ndër veprimtarët më të shquar të Klubit Shqiptar “Bashkit” të Shkupit¹⁰ me ndikim të vazhdueshëm në qarqet xhontuke – ushtarake – politike dhe administrative në Vilajetin e Kosovës, qysh para vitit 1908, Nexhipi tashti, në kushtet të Kushtetutshmërisë xhonturke – “Hyrjetit” (Lirisë), u bë shtyllë e fortë e shkollës dhe alfabetit shqip në Vilajetin e Kosovës dhe më gjërë në trojet shqiptare, ndjekësi dhe mbështetësi më besnik, më i devotshëm i Hasan Prishtinës në këto fusha të kulturës, të jetës dhe të ardhmërisë shqiptare.

Në luftën kombëtare për sendërtimin e programit dhe të rezolutës së Kongresit të Alfabetit në Manastir (14–22 Nëntori 1908) Nexhip bej Draga kurrë nuk u luhat dhe i qëndroi besnik parimit të tij luftarak: “Me alfabetin latin i hapim dyert e Kalasë Evropiane, të bijtë e së cilës jemi”. Me mençuri, guxim dhe autoritet, së bashku me Dervish Himën e të tjerët, e minuan plotësisht, Kongresin Xhonturk të Dibrës (23–28 korrik 1909), i cili kishte për qëllim të nxirrte dhe të flakte nga përdorimi alfabetin shqip latin për gjuhën shqipe.¹¹ Atë botë, krahas Hasan Bej Prishtinës dhe Shahin bej Kolonjës ishte krahu më i fortë i Ismail Qemalit rreth partisë liberale opozitare “Ahrar” dhe kontriboi në veprimtarinë kulturore e

⁹ Gazeta “Besa”, Stamboll, dt. 26 janar 1909.

¹⁰ Nebi Dervishi, Klubet kombëtare shqiptare në Vilajetin e Kosovës dhe Manastir, në Revistën “Kërkime historike”, Shkup, 2011.

¹¹ Po aty.

kombëtare – arsimore të Klubit Qendror “Bashkimi” të Stambollit, i cili kishte rolin e një ministrie shqiptare të arsimit dhe të kulturës në kushte të shtetit shqiptar në lindje e sipër. Propaganda e huaja bënë që edhe deputetët shqiptarë në Parlament në Stamboll të ndaheshin në dy tabore, në të ashtuquajturë nga të huajt: “Latinash” dhe “Arabistë”. Në grupin e parë ishin 10 përkatësisht 11 deputet, kurse në grupin e dytë ishin 14 përkatësisht 13 deputetë. Midis “Latinashëve” ndër më aktivët u dëshmuan Hasan Bej Prishtina dhe Nexhip bej Draga.

Pas shumë përpjekjeve të Hasan be Prishtinës dhe Nexhip Bej Dragës gjuha shqipe u fut në “DARUL MUALIM” (Shkolla Normale) të Shkupit, në “Idadinë” (gjimnazin) dhe në Shkollën Edukative “Meçteb – I – Edeb” të Shkupit¹². Në këto shkolla shqipen e ligjëronin dy rilindasit, publicistët e shquar dhe flamurtarët e Vlorës në nëntor të 1912, Bedri bej Pejani dhe Sali Gjukë Dukagjini.

“Në Shkup u vendos me msue gjuhën shqype me Shkrola t’veta” do të konstatojë “Bashkimi” i Shkodrës, më 6 shkurt 1910¹³. Ministri i Arsimit të Turqisë, i provokuar dhe i nxitur nga propaganda e huaja dhe nga një pjesë e ulemasë dhe krerëve islam fanatikë, më 23 janar 1910, lëshuar urdhëresën që “gjuha shqipe në të gjitha shkollat në brendi të vilajetit të jepët vetëm me shkronja arabe. “Kjo urdhëresë u dha akoma fuqi qarqeve reaksionare antishqiptare në shumë vise të Vilajetit të Kosovës. Më 28 janar 1910 në Kaçanik u organizua një miting kundër alfabetit latin dhe kundër Nexhip Dragës. Në miting u kërkua të mbyllën shkollat shqipe ku mësohej e shkruhej me Alfabet latin.

Në janar të 1912, në Perandorinë Osmane u mbajtën zgjedhjet parlamentare, ku në mes të tjerëve Nexhip bej Draga ishte kandidat për deputet nga Vilajeti i Kosovës. Në një raport të Hainrotit, dt.

¹² Ramiz Abdyli, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, V. II (1911-1912), Prishtinë, 2005

¹³ Gazeta “Bashkimi”, Shkodër, dt.6.02.1910.

27.I.1912, në mes tjerash thuhet: “Ata kërkojnë të arrihet në një marrëveshje me shqiptarët, kandidatët e të cilëve sikur deri tash janë Nexhip Draga dhe Hasan Beu, dhe në këtë mënyrë të bëjnë që të sprovohen kandidatët e tyre, Rexhep beu – drejtor i shkollës së Arteve të Bukura në Shkup dhe Sahit Hoxha – deputet i deritashëm xhonturk”.

Në janar të 1912¹⁴, Nexhip bej Draga mbledhet me deputetët e tjerë shqiptarë që bënin pjesë në opozitë, përkundrejt politikave të Turqve të Rinj për Osmalillëkun e Vilajeteve Shqiptare. Duke vënë re se fjala e deputetëve shqiptarë për të drejtat kombëtare të cilat Turqit e Rinj u kishte valvitur flamurin për të ardhur në pushtet, Nexhip beu bashkë, me Ismail Qemalin, Surija Beun, Hasan Prishtinën, Myfit bej Libohovën, etj., takohen në fillim pranë hotel “Pena Palace” dhe më pas më 12 janar në shtëpinë e Syrija beut, në lagjen Taksim, që u pagëzua “Komploti i Taksimit”.¹⁵

Nexhip bej Draga së bashku me Hasan bej Prishtinën ishin drejtuesit kryesor të Kryengritjes së Përgjithshme në vitin 1912.¹⁶

Pas Luftës së Parë Ballkanike, policia serbe me qëllim që populli shqiptar në Vilajetin e Kosovës të mbetej pa udhëheqës politik dhe kombëtar¹⁷, në fillim të nëntorit të vitit 1912, i zuri dhe i internoi në Kalemegdan (Beograd) prijësit shqiptarë. Me këtë rast u interesuan: Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Hoxhë Sejdi Idrizi, Idriz Seferi, etj. Udhëheqësit politik shqiptar në burgun e Kalemekdanit në Beograd të internuar ngelën deri në përfundimin e punimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër në 1913.

¹⁴ Prishtina H. Bej, Një shkurtim kujtimesh mbi Kryengritjen Shqiptare të vjetit 1912, Shtypshkronja Franciskane, Shkodër 1912.

¹⁵ Historia e Popullit Shqiptar II, Tiranë, 2002, faqe179;

¹⁶ Zekrija Cana, Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare (1903 – 1913, Prishtinë, 2006.

¹⁷ Faton Mehmetaj, Veprimtaria kriminale e “Dorës së Zezë “serbe në trojet shqiptare”, Prishtinë, 2004, f.76-77.

Pas Luftës së Parë Botërore dhe krijimit të Mbretërisë Serbo – Kroate – Sllovene (1.XII.1918), Nexhip Bej Draga do të formojë një parti politike me emrin Xhemijet. Mbledhja themeluese do të mbahet në Shkup më 17 dhjetor 1919. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1920, Nexhip Draga do të zgjidhet deputet – senator në Parlamentin e Mbretërisë S.K.S.¹⁸

Në fillim të vitit 1921 Nexhip bej Draga sëmurët rëndë. Tani tu – moret malinje iu paraqiten në fyt dhe ia vështirësuan frymëmarrjen. Meqë nuk i lejohej shërimi urgjent, për pak kohë Nexhipi u bë shumë keq. Pas një vonese prej 25 ditësh nga dita kur kërkoi leje të shkonte në Vjenë për shënim, qeveria e Nikolla Pashiqit i mundësoi daljen nga shteti, por tashti ishte shumë vonë. Operacioni në një spital të Vjenës nuk ia përmirësoi gjendjen.

Kështu, me mallin për lirinë e atdheut të robëruar, me 18 maj 1921, vdiq i rrethuar nga studentët shqiptarë që studjonin në Universitetet e Austrisë. U përcollë me nderime të mëdha për varrim në varret e vendlindjes në Mitrovicë.

2. HAJDIN DRAGA (1870–14 qershor 1914) – Edhe Hajdin Bej Draga ishte i biri i Ali Pashë Dragës, vëllau i Nexhip beut dhe Ferhat Bej Dragës, i cili u rrit në gjirin e familjes tanimë me tradita të formuara politike, ushtarake dhe intelektuale. Lindi në Mitrovicë në vitin 1870, në një familje të shquar për kontributin në mbrojtje të trojeve shqiptare dhe kryengritjet antiosmane në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shekullit XX¹⁹.

Emri i Hajdin Dragës bëhet i njohur si një nga personalitetet e shquara shqiptare qysh në Lidhjen shqiptare “Besa – Besë” të Pejës, 1899 – 1900, krahas, Haxhi Zekës, Bajram Currit dhe atdhetarëve të tjerë. Midis Krerëve që organizonin kuvende në Vilajetin e Kosovës dhe

¹⁸ Gazeta “Hak”, 11 Prill 1920, faqe 1;

¹⁹ Bardhul Gaçe, Ata që shpallën pavarësinë shqiptare”, Tiranë, 2012, f. 68-71.

në Shkup “për bashkimin e Shqiptarëve pa dallim feje e krahine”, siç shkruan në relacionin e tij kosulli Siniç, ishte edhe Hajdin Draga.

Hajdin Draga ishte anëtar i Kompanisë (ndërmartjes) Ali Pashë Draga që veprimtarinë prodhuese të përpunimit të drurit e zhvillonte në Shkup²⁰. Për këtë arsye ai disa herë u autorizua dhe u dërgua në Shkup me misionin për të biseduar me Krerët e atjeshëm, “të cilët u bindën të mbajnë Kuvendin e tyre në Pejë”.

Në janar të vitit 1899, Hajdin Draga ishte njëri ndër anëtarët aktiv në këtë Lidhje (Lidhja Besa – Besë), që hyri në bisedime me atdhetarët e Stambollit dhe pati korespondencë me ideologunë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Sami Frashërin. Më 23 – 29 janar 1899, mori pjesë si delegate i Vilajetit të Shkupit në Kuvendin e Pejës, si dhe në hartimin e Karnanamesë së këtij kuvendi historik.

Në vitin 1908, emri i tij shënon si anëtar i Pleqësisë së Klubit Shqiptar “Bashkimi” të Shkupit me detyrën e Këshillanjesit. Ai ndihmoi edhe në çeljen e Klubit Shqiptar të Kumanovës.²¹

Ajdin Draga dha një kontribut të çmuar në organizimin e kryengritjeve antiosmane të viteve 1908–1912 dhe bashkëpunoi dendur me krerët e tjerë shqiptar si: Hasan Prishtinën, vëllain e tij Nexhip Dragën, Isa Boletinin, Sali Gjukën, Bedri Pejanin, Zuhdi bej Ohrin, Hamdi Bej Ohrin dhe të tjerë.

Në nëntor të 1912, Hajdin Draga së bashku me Sali Gjukën u zgjodhën delegatë për në Kuvendin historik të Vlorës. Sipas dokumenteve arkivore, Mehmet Pash Deralla, Sali Gjuka, Hajdin Draga shkuan në Dibër, ku u takuan me delegatët e tjerë kosovarë.²²

²⁰ Државен Архив на Р. Македонија, Архив на гр. Скопје, фонд. Градско Поглаварство.

²¹ Nebi Dervishi, Klubet kombëtare në Vilajetin e Manastirit dhe Kosovës, në gazetën “Lajm”, nëntor 2011

²² Bardhul Gaçe, Ata që shpallën pavarësinë shqiptare, Tiranë, 2012, f. 68-71.

Si në mbledhjen e Kuvendit (28 Nëntor 1912) ashtu edhe në detyrat e ngarkuara nga qeveria e Vlorës dhe Ismail Qemalit ai u tregua energjik dhe një atdhetar i flaktë për strukturimin e kësaj qeverie dhe organizimin e ushtrisë sepse ishte me profesion officer ushtarak. Në qershor të 1913, së bashku me Isa Boletinin dhe Mehmet Pashë Derallën, protestuan pranë Fuqive të mëdha në mbrotje të kufinjve toksor të Shqipërisë, kundër synimeve të shteteve basllkanike. Gjatë vitit 1913, Ismail Qemali dhe Qeveria e përkohëshme e Vlorës e ngarkuan Hajdin Dragën me detyrën për të ndihmuar në krahinën e Shkodrës në vendosjen e rendit, qetësisë dhe shtrirjen e administratës së kësaj qeverie.

Hajdin Draga gjatë gjysmës së parë të vitit 1914 u rreshtua në radhët e forcave të udhëhequra nga Bajram Curri e Isa Boletini në luftimet kundër kryengritësve antiesadistë, ku ra në fushë të nderit në luftimet e Rroshbullit më 14 qeshor 1914.²³

3. FERAT BEJ DRAGA (1873 – 2 DHJETOR 1944)

Ferat be Draga ishte vëllau i tretë nga katër djemtë të Ali pashë Dragës, nga fisi Kelmend i Pështerrit. Ferat beu ishte më shumë se krahu i djathtë i të vëllait, Nexhip beut, në përpjekjet për shkollën shqipe dhe për alfabetin latin për gjuhën shqipe në fillim të shekullit XX, mandej në fushën e politikës dhe të diplomacisë deri në Luftën e Parë Botërore.²⁴

Lindi në vitin 1873 në fshatin Dragë të Komunës së Tutinit. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa studimet i përfundoi në Stamboll. Zotëronte gjashtë gjuhë të huaja.

Krimtarinë politike e filloi në moshë të re. ishte bashkëpuntor i të vëllait, Nexhip Bej Dragës, në përpjekjet për shkollën shqipe dhe alfabetin latin. Mori pjesë në Kongresin e Firencës në 1– 4 mars

²³ Po aty.

²⁴ Ramiz Abdyli, Fjalori i Historisë, Shkup, 2008. F. 123.

1913²⁵. Më 1915 ndihmoi Hasan Prishtinën në ngritjen e zatës legale kulturore e arsimore “Bashkimi” në Mitrovicë dhe brenda saj “Komitetin e Kosovës”, e cila ishte organizatë politike ushtarake ilegale për çlirimin e tokave shqiptare nga pushtuesit austro – hungarezë e bullgarë dhe ribashkimin e Shqipërisë Etnike nën flamurin e ngritur në Vlorë, më 28 Nëntor 1912.²⁶

Në vitin 1919 Ferat Bej Draga ndihmoi Nexhipin në ngritjen e organizatës politike legale “Xhemijet” (Bashkimi), e cila ishte organizatë politike kombëtare shqiptare e veshur me petkun fetar islam, mundësi e vetme për organizimin politik shqiptar legal, jashtë partive politike serbe. Nga ana tjetër, mbante lidhje veprimi ilegal me Komitetin “Mbrotja Kombëtare e Kosovës”, e vendosur në Shkodër, si dhe më 1920 përfaqësoi “Xhemijetin” në kontakt me qeverinë e Pashiqit, në Beograd. Mbledhja themeluese e “Xhemijetit”, si organizatë politike e myslimanëve për të ashtuquajturën “Serbi Jugore” u mbajt më 17 dhjetor të vitit 1919 në sallën e filmit afër Urës së Gurit, këtu në Shkup²⁷. Në themelimin e saj, përpos Nexhip Be Draga rol të madh pati shqiptari zemërluan Ferhat Be Draga. Realisht ky ishte aktivist dhe veprimtari më i shquar i “Xhemijetit”, e në një farë dore ishte organizatori dhe drejtuesi i Kuvendit themelues, pasi i vëllai, Nexhipi, me shëndet të ligë, nuk i kishte aftësi dhe forcë fizike të përballonte punë të rënda organizative. Nexhip Draga ishte për nga natyra urtak dhe diplomat i mençur, ndërkaq Ferhati, ishte trim dhe plotë energji për të urdhëhequr organizatën politike të porsaformuar “Xhemjet” shtigjeve plotë rrezeqe.²⁸

Pas vdekjes së Nexhip Bej Dragës më 18 maj 1921, në Vjenë, Ferhati u bë kryetar i “Xhemietit”. Si përfaqësues i tij në parlamentin

²⁵ Zekirija Cana, Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare (1903 – 1913), Prishtinë, 2006, f. 340.

²⁶ Portali I Sanxhakut Tregu I Ri;

²⁷ Muhedin Fijuljanim, Sanxhaçki Boshnjaci, 2010.

²⁸ Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2008, f. 508.

jugosllav, në gjysmën e parë të viteve 1920 të shek. XX, Ferat Draga denoncoi politikën shtetërore antishqiptare. “Xhemijeti” – kryesuar nga Ferat Bej Draga u vu në mbrojtje të drejtave të shqiptarëve në mbretërinë S.K.S. dhe luftoi sidomos kundër zbatimit të reformës agrare dhe të kolonizimit, përmes të cilave synohej dëbimi i shqiptarëve nga trojet e tyre dhe ndryshimi përfundimisht i pamjeve etnike të viseve Kosovë, Sanxhak e Maqedoni.²⁹ Në zgjedhjet Parlamentare të vitit 1920 kjo parti fitoi 8 (tetë) deputetë për Kuvendin e Mbretërisë së S.K.S.–së, ndërsa në zgjedhjet e dyta parlamentare të 1923, “Xhemijeti” fitoi 14 deputetë. Ferat Draga krijoi aleancë me partitë nacionaliste kroate, sllovene e hungareze për t’iu kundërvua synimeve shoveniste sërbbomëdha.³⁰

Në ato vite (vitet 20 të shek. XX) në regjimi serb në Maqedoni, Sanxhak, Kosovë, etj., kishte ndërmarrë aksione masovike për pastimin etnik dhe terror të hapur daj popullsisë shqiptare³¹, turke e boshnjake. Duke reaguar ndaj sjelljeve të tilla shtazarake të regjimit, deputetët e Xhemijetit, në shkurtin e vitit 1921 i dërguan letër protestuese Kryesisë së Kuvendit Kushtetues të Mbretërisë S.K.S., me Konstatimin se “Kohëve të fundit rajonet dhe nahitë e Kosovës, Prizrenit, Sanxhakut, Shkupit, Ohrit, etj., për çdo ditë vriten qindra gra e fëmijë”. Në reagimin qartas theksohet se “Zullumi ndaj banorëve muslimanë nga ana e pushtetit civil tejkalon çdo masë dhe se kjo nuk ka lidhje me ndjenjat njerëzore dhe humanitare”. Të njëjtën vlerësim e jep edhe gazeta “Hak³²” – organ i Partisë (Organizatës “Xhemijet” pas reaktionit të djegies së Xhamisë Burmalit, më 18 Nëntor 1924. Pushteti serbomadhi ndaloi dhe mandej paralajmëroi luftë të rreptë politike me Ferat Bej Dragën dhe partinë e

²⁹ Akif Bajrami, Politika shfarosëse të shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1995), fejtton në gazetën “Flaka”, dt. 22.V. – 25.V.1995

³⁰ Ramiz Abdyli, Fjalori historik, Shkup, 2008, f. 123.

³¹ Shaban Braha, Gjenocidi serbomadhi (1844-1990), Tiranë, 1991, f. 215

³² Gazeta “Hak, 18.XI.1924.

tij, e cila pasoi edhe në zgjedhjet e reja parlamentare për Kuvendin e Mbretërisë S.K.S., në shkurt të vitit 1925.

Respektin e madhë që kishte në mesin e shtresave popullore dhe ndryshimet në orientimin e partisë “Xhemijet” nga ana e Ferhat Bej Dragës, te partitë e tjera politike kundërshtarë serbe u trajtua si rrezikim i pozicioneve politike të tyre. Për këtë arsye më 31 janar 1925, në Shkup u organizua edhe arrestimi i tij. Shpejt pas saj, Partia e “Xhemijetit” u shpall si antishtetërore dhe puna (veprimtaria) e saj u ndalua. Me qëllim që të sigurohet fitorja, në zgjedhjet parlamentare me 8 shkurt 1925, pushteti para dhe gjatë ditës së votimit për deputetët të parlamentit, ndërmorën akcione të papara friksinimi dhe terror të hapur ngaj popullsisë muslimane dhe popullsisë joserbe, të cilat masa do t’ua japin edhe fitoren radikalëve serbë.

Ferat bej Draga në këto zgjedhje me gjithë presionet, shantazhet dhe terrorin e paparë, arriti të fitoi në qarkun e Zveçanit dhe të fitojë mandatin e deputetit, e cila iu muar në mënyrë jo ligjore dhe iu anulua. Me vendim të administratës së atëhershme, Ferat bej Draga dënohet me 101 vjet burgë të rëndë me punë të detyrueshme, dënimin më pas iu ul në 25 vjet dhe në fund dënimin iu ndërpre me aktin e faljes nga Mbreti Aleksandër Karagjorgjeviqi.³³

Ferat bej Dragën në pragë të zgjedhjeve 1925 e 1927 u përpoqën ta likujdonin dhe e burgosën. Në fillim të viteve ‘30 të shek. XX, në Mbretërinë Jugosllave u vendos jeta e partive politike, Ferat bej Draga ishte aktiv në gjirin e Komunitetit fetar Musliman për Serbinë Jugore dhe ushtroi ndikim mbi deputetët shqiptarë të çdo orientimi politik. Më 1935 dhe 1938, Ferat Bej Draga përmes disa përkujtesave kërkoi liri politike dhe kulturore për shqiptarët dhe anulimin e shpronsimit agrar e të shpërnguljes së tyre në Turqi³⁴.

³³ Akif Bajrami, Politika shfarosëse të shqiptarëve, punim I cituar...,

³⁴ Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2008, f. 508.

Pas vitit 1939 dhe veçanërisht pas shpërbërjes së Mbretërisë Jugosllave, në prill të vitit 1941, Ferat Bej Draga bashkëpunoi me pushtuesit italianë, me synim bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një njësi politike të vetme. Gjatë pushtimit gjerman (8 shtator 1943– nëntor 1944) u menjanua nga strukturat politike si italoofil. Bashkëpunoi me krerët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Atdhetari i pakursyeshëm Ferat Bej Draga nuk pranoi asnjë ditë të pushtetit komunist Jugosllav. Në moshën 71 vjeçare e zëvendësoi lapsin me pushkën dhe, duke shkelë mbi fërkemat e Ibrahim Lutfiut, nga Mitrovica kaloi në Llapushë, për t’u bashkuar çetës së profesor Imer Berishës e Ukë Sadikut.

Më 2 dhjetor të vitit 1944, vritet në rrethana të paqarta në Kralan të Gjakovës, me nëmën e fundit në gojë: “Komunistat (...) në qafë e paçin Kosovën e Shqipërinë...”! Bashkëluftëtarët pas vrasjes e nxjerrin në lindje të Drinit të Bardhë dhe e varrosin në arealin e Valjakës, pranë një lisi.³⁵

Partizanët jugosllavë – shqiptarë, nuk i besuan informatës që “rrodhi” për vdekjen e Ferat bej Dragës. i shkuan te murana, ia zbulojnë varrin dhe ia plaçkisin dhëmbët e arit për trofe!

Vdekja misterioze burrërore, krahas veprës, Ferat bej Dragën e ngriti në Shenjt i Kombit.

³⁵ Po aty.

MARENGLEN VERLI

Instituti i Historisë – Tiranë

SHKUPI NË FOKUSIN E NJË PIONIERI TË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Mirënjohja është një nga virtytet më të larta të njeriut. Gjithkush e njeh fabulën e përrallës së pjatës prej druri që fëmija e vogël po e gdhendte për prindërit e parespekt për gjyshin e tij... Ata e morën mesazhin dhe ndërruan qëndrim...

Mund të kemi vlerësime të ndryshme për punën e paraardhësve tanë, por gjithsesi ajo duhet respektuar dhe kriteri real për ta çmuar është kur shikohet jo çfarë nuk bënë sipas parametrave bashkëkohorë të brezit të ri, por çfarë bënë më tepër se ata që jetuan para tyre.

Hamit Kokalari sot nuk është një emër fort i njohur, por në vitet 40 libri i tij “Kosova – djepi i shqiptarizmit”³⁶ bëri bujë dhe ishte një studim i mirëfilltë shkencor. Madje varianti i zgjeruar në gjuhën frënge³⁷, i botuar disa muaj më vonë pas një pune intensive, u përgatit posaçërisht për publikun e huaj, çka duhet të na shërbejë si shembull sot e kësaj dite e të na kujtojë se është luks që për tema të rëndësishme të realizuara me parametra të lartë shkencorë, të bëjmë publikime vetëm në gjuhën shqipe, që do të thotë vetëm për publikun shqiptar.

Kam patur fatin ta njoh nga afër Hamit Kokalarin në vitet 80-të, kur ky intelektual i kalibrit jo të zakonshëm, dikur diplomat i vyer e studiues i thellë, edhe pse në moshë të thyer, rrezatonte vlera të

³⁶ Hamit Kokalari, *Kosova – djepi i shqiptarizmit*, Tiranë: Maragjerit Shqiptare, 1943.

³⁷ Hamit Kokalari, *Kosovo berceau du peuple albanais et foyer de sa renaissance nationale*, Tirana 1943.

mirëfillta intelektuale e njerëzore. Fare thjeshtë erdhi një ditë në Institutin e Historisë, shumë i kënaqur që aty disa studiues po angazhoheshin për studimin e historisë së Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare. Komunikonte shtruar dhe me modesti na dhuroi një hartë etnike të përgatitur nga profesor Ahmet Gashi, që e kishte ruajtur në shtëpinë e tij.

Për të shuar kureshtjen tuaj për këtë pionier të studimeve shqiptare dua të përmend fare shkurtimisht disa të dhëna biografike. U lind në Gjirokastrë në vitin 1909 ku edhe filloi të arsimohej. Përfundoi me rezultate të shkëlqyera arsimin fillor e të mesëm në shkollë prestigjioze të Shqipërisë së asaj kohe, pikërisht në Liceun e Gjirokastrës dhe atë të Korçës. Kishte qenë nxënësi më i mirë në të njëjtën klasë me Enver Hoxhën, që ishte një vit më i madh në moshë e njëherësh kushëriri i tij. Këtë e ka përmendur edhe vetë E.Hoxha në kujtimet e tij të botuara në fillim të viteve 80-të. Njëherësh ishte vëlla i intelektualës së njohur Musine Kokalari, që u persekutua nga regjimi komunist, si edhe i dy vëllezërve të pushkatuar pas Luftës.

Pas diplomimit në Tuluzë të Francës për drejtësi me rezultate shumë të mira, ku studioi në vitet 1930–1934, Hamit Kokalari u kthye në Shqipëri dhe që punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Aty, punoi gjatë viteve 1936–1951, ndonëse vitet e fundit jo si diplomat por si përkthyes. Gjatë këtij harku kohor në periudhat 1938–1939 dhe 1941–1943, për shkak të aftësive të spikatura dhe arsimit të kompletuar, shërbeu përkatësisht në legatën e Shqipërisë në Romë dhe mandej në konsullatën shqiptare në Shkup. Ky qytet ndërkohë, pas shkatërrimit të Mbretërisë Jugosllave së bashku me shumë treva të tjera shqiptare ishte aneksuar nga Bullgaria.

Intelektual dhe atdhetar i mirëfilltë, H.Kokalari qysh në vitin 1942 skicoi studimin e tij prej disa dhjetra faqesh me titull “Shkupi –

qendër shqiptare me rëndësi”³⁸. Më pas mbi faqet e daktilografuara titullin e korrigjoi me shkrim dore duke e quajtur “Shkupi – qendër kryesore e Shqipërisë Verilindore”.

Në faqen e parë, nën titull, shënoi se ky studim ishte një “studim etnografik”, ndërkohë që ai ishte më tepër se kaq. Aty, përveç konsideratave etnografike e demografike, gjenden informacione historike e administrative, gjeografike e rreth komuniteteve fetare, vlerësime politike, ekonomike e kulturore etj. Në studimin në fjalë prej më shumë se 50 faqesh, paraqiten pasqyra statistikore me informacione shumë të detajuara.

Realizimi i këtij studimi për Shkupin nuk qe një punë e lehtë dhe nuk e dimë nëse H.Kokalari ka qenë udhëzuar apo me nismën e tij personale e ndërmori këtë studim. Gjithsesi ajo që dimë me siguri është se vetëm një vit më vonë, madje jo në variantin shqip të librit (“Kosova djepi i shqiptarizmit”, 128 faqe), ai u botua si pjesë në librin e publikuar në gjuhën frënge (285 faqe)³⁹. Në këtë botim studimi për Shkupin përfshinte rreth 60 faqe, përkatësisht afro 1/3 e librit. Në këtë botim të librit në gjuhën frënge Hamit Kokalari figuron qysh në kopertinë, e mandej në frontespis, si anëtar korrespondent i Institutit Shqiptar të Shkencave dhe Arteve⁴⁰, çka tregon vlerësimin që iu bë punës së tij për trojet e copëtuara nga shteti shqiptar më 1913, të botuar fillimisht në gjuhën shqipe me titullin “Kosova – djepi i shqiptarizmit”, sikurse e përmendëm qysh në krye të kësaj kumtese.

³⁸ *Arkivi i Institutit të Historisë – Tiranë (AIH)*, Dosja E I – 15, nr. Inventari 1726.

³⁹ Të dy librat u publikuan në vitin 1943.

⁴⁰ “*Instituti i Studimeve Shqiptare*”, u ngrit më 12 prill 1940. Në fillim quhej “*Instituti i Studimeve Shqiptare i Fondates “Skënderbej”*”. Në të u përfshinë studiues shqiptarë dhe italianë të gjuhës, të letërsisë, të historisë dhe të artit shqiptar. Në vitin 1942 u quajt “*Instituti Mbretnuer Shqiptar*” dhe u vu nën drejtimin e Kryeministrit. Në vitin 1943 u emërtua “*Instituti shqiptar i shkencave dhe arteve të bukura*”. Në prill 1944 u riorganizua. U zgjeruan fushat e interesimeve shkencore dhe numri i studiuesve, të cilët tani ishin vetëm shqiptarë. Kryetar i parë i Institutit ishte Ernest Koliqi.

H.Kokalari kishte hulumtuar për Shkupin dhe regjionin e tij gjithçka mund të sigurohej aso kohe nga burimet osmane, ballkanase dhe evropiane. Në bibliografinë fillestare, që shoqëronte studimin e vitit 1942, shënohen statistikat jugosllave të regjistrimit të popullsisë të vitit 1921 (*Résultats prééliminaires du recensement de la population dans le Royaume des Serbes, Croates et Slovènes du 21 Janvier 1921*, Sarajevo 1924, et. cartes annexes), studimi i Lumo Skëndos (Mithat Frashërit) “Shqiptarët dhe sllavët”, i vitit 1919, (Lumo Skendo: Albanais et Slaves, Lausanne 1919), dokumentet zyrtare shqiptare që u paraqitën më 1919 në Konferencën e Paqes (*Shqipëria përpara Konferencës së Paqes*, Romë 1919), statistikat e Komunitetit mysliman në Jugosllavi⁴¹, disa publikime të Salih Beut, Prof. Kettlerit, E.Durhamit, A.Baldaçit, P.F.Kordinjanos, Gj.Kërsitiqit, I.Haxhi Vasiljeviqit etj.⁴²

Në botimin shqip e frëngjisht, që pasoi studimin fillestar për Shkupin, i cili u gjet në Arkivin e Institutit të Historisë, bibliografia ishte pasuruar shumë më tepër se sa përmenda më sipër.

I ndodhur në Shkup, me detyrën e diplomatit, H.Kokalari kishte verifikuar në terren me pasionin dhe përvojën e vet, atë që kishte hulumtuar në literaturën e publikuar prej të tjerëve dhe, kështu, në studimin që realizoi në vitin 1942, dhe që mandej të plotësuar e publikoi në gjuhën frënge më 1943, i bëri një shërbim të madh jo vetëm kombit të tij, por edhe shkencave humane ballkanikë e më gjerë. Pa dyshim ofroi një studim konçiz me informacione të sakta e të padiskutueshëm, i cili prandaj edhe i qëndroi kohës.⁴³

⁴¹ *Isveštaj o Rady yulema mexhlisa u Skoplje y 1938 i 1939*, Sarajevo 1941.

⁴² Salih Bey, *Uskubin Tarihi*, Skopje 1932; Prof. dr. J.Kettler, *Volkerkarte der Balkanhalbinsel*, Berlin 1919.

⁴³ Edith Durham: *Venti anni di groviglio balcanico*, tradotto da Stefania Pelli – Bossi, Firenze 1923, Antonio Baldacci, *L'Albania*, Roma 1929; P. Fulvio Cordignano S.I.: *L'Albania*, Roma 1934; G. Krstić, *Kolonizacija na Južnoj Srbiji*, Sarajevo 1928, Leonhard Sehultze Jena, *Makedonien*, Jena 1927, Dr. Ivo Haxhivasiljević, *Karta linguistic districta Preševo*.

Përkatësia etnike e Shkupit në periudha të ndryshme historike u studiua me vëmendje të madhe nga H. Kokalari dhe rezultoi se për shekuj me radhë Shkupi kishte qenë një qendër e madhe urbane, kryeqendër e një njësie të madhe administrative, gjatë çdo qeverisjeje nga mbretëritë apo perandoritë që kishin dominuar historikisht në rajon dhe çdo herë kishte patur prani masive të banorëve shqiptarë.

Në rrafshin e studimeve etnokulturore e historike, veçanërisht qasja e H. Kokalarit, sikurse edhe të tjerëve para tij, ka synuar evidencimin e gjendjes në dy shekujt e fundit, kur edhe ndodhi procesi i rilindjes nacionale dhe i shtetformimit në Ballkan. Në këtë periudhë, deri në vitin 1912, sipas H. Kokalarit, Shkupi banohej për rreth 55–60% prej shqiptarëve.⁴⁴ Kjo do të thotë se ata e kishin dominuar popullsinë e qytetit dhe rrethinave të tij, deri në vitin 1912. Por, sikurse konstatonte studiuesi i vyer, edhe pasi ra sundimi osman dhe Shkupi kaloi në disa duar, për të mbetur më 1918 pjesë e Mbretërisë Serbo–Kroato–Sllovene, ose Jugosllave, deri në vitin 1941, qyteti mbeti një qendër e rëndësishme e botës shqiptare. Kolonët serbë, të llogaritur në rreth 30–40 mijë vetë, të cilët u vendosën aty në vitet 1912–1941 nuk e zbritën në vend të dytë popullsinë shqiptare, veçse për pak kohë. Duke cituar, statistikën e Komunitetit mysliman të Shkupit – botuar në Kalendarin e vitit 1941 në Sarajevë (f. 24), H. Kokalari e vlerëson në 57.791, ose në *43 për qind* të popullsisë, numrin e banorëve *myslimanë në distriktin e Shkupit*. Pas largimit të tyre kolonëve serbë dhe të një pakice maqedonësh, që kishin bashkëpunuar me ta, shqiptarët u bënë përsëri popullsia e parë në Shkup duke arritur të kenë rreth 65 për qind të popullsisë së qytetit.

Duke analizuar të dhëna të shumëllojshme të pasvitit 1941, të zonës së aneksuar nga Bullgaria, që flasin jo vetëm për qytetin e Shkupit

⁴⁴ H. Kokalari citon Gabriel Louis Jaray-n, *L'Albanie inconnue*, Paris 1913, XXI, sipas të cilit Shkupi nga 45.000 banorë, 25.000 i kishte myslimanë, shumica shqiptarë, pra 55,5 % të popullsisë.

(për këtë kohë 29.000 shqiptarë ose 55 për qind), por edhe për qarkun e Shkupit (45 000 shqiptarë ose 75 për qind), edhe për zonën shqiptare të qarkut të Kumanovës (22.000 shqiptarë ose 60 për qind), dhe duke përjashtuar qytetin e Kumanovës (90 për qind shqiptarë), edhe për zonën shqiptare të qarkut të Preshevës (24.000 shqiptarë ose 90 për qind), edhe të zonës së Moravës (16.000 shqiptarë ose 80 për qind), edhe për qarkun e Kaçanikut (së bashku me katundet që më parë vareshin nga qarku i Ferizajt 20.000 shqiptarë ose 98 për qind), si edhe katundet shqiptare në qarkun e Velesit (5.000 banorë shqiptarë), H. Kokalari arrin në përfundim se brenda rajonit në fjalë, të aneksuar në këtë kohë nga Bullgaria, banonin 161.000 shqiptarë. Janë shifra në dukje befasuese, por në fakt reale. Politika e spastrimit etnik të ndjekur nga qarqet drejtuese të Beogradit deri në vitin 1941 nuk kishin mundur ta shkatërronte grupimin etnik shqiptar në trojet e veta etnike në rajonin në fjalë.

Informacione e konsiderata të vyera H. Kokalari sjell edhe për problemet ekonomike, për historinë, për vendndodhjen gjeografike etj., dhe rëndësinë e tyre. Këto japin mundësinë të kuptohet pse shqiptarët ende ishin masivisht të pranishëm në këtë trevë.

“Shkupi sundon gjithë krahinat e afërme e të largme që e rrethojnë ..., shkruante H. Kokalari, të gjithë popujt ballkanikë janë përpjekur ta pushtojnë për shkak të pozitës së tij të vlerëshme”, “Ky qytet “tërheq tregtinë e Kosovës, të krahinave të Tetovës e Gostivarit dhe të Dibrës, të fushave të Shkupit e Kumanovës, të Vardarit dhe të Ovçe Poljes”. Më tej H. Kokalari shpjegon infrastrukturën e përshtatshme për kohën, që e lidhte Shkupin deri me treva të largëta si Beogradi, Sofja, Selaniku etj. “Gjeografikisht, konkludon ai, është porta e Shqipërisë etnike me vendet e tjera ballkanike dhe ... njëkohësisht qendër komunikacionesh të brendshme për Shqipërinë mbasi rruga që lidh Kosovën me krahinat e Tetovës dhe të Dibrës kalon nga Shkupi ...”

H. Kokalari konstaton se pavarësisht nga politika qëllimkeqe e regjimit të Beogradit, komuniteti shqiptar, edhe pse u shpronësua e shpërngul pasivisht, “mundi të zhvillohej me anën e tregtisë dhe të punës”, duke “kontribuar në shkallë të gjerë në lulëzimin e qytetit”. Shkupi në vitet 1918–1941, thekson ai “ka qenë çerdhja ku shqiptarët gjenin mbrojtje; shumë familje, që në kohën e luftërave ballkanike dhe botërore ishin larguar, u kthyen rishtaz në Shkup; të tjera familje të dëbuara nga Kosova ... në vend që të shkonin në Turqi u vendosën në këtë qytet”.

H. Kokalari vlerëson se pavarësisht nga qëndrimi denigrues që mbanin për momentin, domethënë pas vitit 1941, edhe autoritetet bullgare dhe pavarësisht nga përjashtimi prej tyre i shqiptarëve nga nëpunësitë publike, përsëri shqiptarët e rregullonin disi ekonominë e tyre. Sipas tij afro 80 për qind për qind e popullsisë shqiptare të qytetit jetonte me të ardhurat nga pronat, nga tregtia e zejtaria dhe vetëm 20 për qind ishin punëtorë mëditës. Realist në vlerësimet e veta, H. Kokalari e konsideron “njafit modeste gjendjen ekonomike të shqiptarëve”. Të përjashtuar nga tregtia me shumicë, me nivel kulturor relativisht të ulët, me emër të pakët intelektualësh të rinj, me prani të shumta klerikësh myslimanë me një numër të konsiderueshëm familjesh shqiptare të paçliruar nga paragjykimet fetare, ata qëndronin ekonomikisht më dobët se maqedonët, arumunët dhe izraelitët. Duket sikur studiuesi i njohur bën indirekt një thirrje për shqiptarët e Shkupit, që të zhvilloheshin në drejtim të arsimit e kulturës dhe të emancipimit, sepse asnjë sundues i huaj nuk mund t’ua mbyllte shtigjet tërësisht.

Me një bazë të mirë ekonomike H.Kokalari vlerëson edhe 60 katundet shqiptare të rrethit të Shkupit, që me ndarjen e re politike të vitit 1941, duke marrë edhe vise nga qarku i dikurshëm i Tetovës e kishin shtuar periferinë e Shkupit në 90 katunde shqiptare. Krahasuar me to, 10 katundet serbe në Karadag (Mali i Zi i Shkupit), që ndodheshin në mesin e katundeve shqiptare, dhe rreth 15 katundet e vogla maqedonase në juglindje të Shkupit dhe në Karadag,

të përhapura midis katundeve shqiptare, nuk kishin shumë peshë dhe popullsia rurale shqiptare e qarkut të Shkupit shfaqej dominante. H.Kokalari thekson se edhe para vitit 1941, kur ekzistonin rreth 45 koloni të vogla me serbë e maqedonë përreth Shkupit, të vendosura ndër pronat e shpronësuara të shqiptarëve, përsëri popullsia shqiptare e fshatit ishte me shumicë.. Por ai sinjalizon se Bullgaria kishte planifikuar që vendbanimet e sipërpërmendura të kolonëve, të zbrazura pas prillit 1941, t'i kolonizonte me elementin sjellë nga territoret e Bullgarisë së paralutës dhe me elementin maqedon që e mbështeste politikën e Sofjes.

Informacionet që ofron H.Kokalari janë të shumëllojshme. Duke vlerësuar se qyteti “politikisht, etnikisht, materialisht dhe moralisht është krejt në dorë të shqiptarëve”, H.Kokalari prononcohet kundër përfshirjes së tij, Shkupit dhe rrethinave të tij, në ato terri-tore ku mund të realizohej shkëmbim popullsie. Ai argumenton se “Shkupi në dorë të huaj ... na ndalon të qarkullojmë brenda shtëpisë tonë”, sepse gjeografikisht është pjesë e viseve shqiptare dhe se “në dorë të huaj na shkakton edhe humbje të tjera të rënda, sepse, si qytet i madh, ka nevojë për një hinterland të përshtatshëm e të gjerë dhe sakrificat në këtë rast duhet t'i bëjë toka shqiptare”⁴⁵. H.Kokalari ka mendimin se, duke qenë qendër e madhe ekonomike e transiti, “Shkupi mund të bëhet... një ditë ... qytet ndërkombëtar” dhe “në rast se një hipotezë e atillë do të realizohesh, shton ai, elementit shqiptar të qytetit dhe të rrethit mund t'i sigurohesh një vend i përshtatshëm”.

Do të duhej përmendur edhe më tej informacioni i sjellë për Shkupin nga H.Kokalari dhe padyshim vlera e madhe e tij, por kjo nuk mund të realizohet me këtë kumtesë të shkurtër. Gjithsesi botimi i asaj çfarë publikoi dikur H.Kokalari për Shkupin dhe qarkun e tij,

⁴⁵ E ka fjalën për lënien në dorë të bullgarëve të krahinave shqiptare të Kumanovës, Preshevës, Moravës dhe Kaçanikut.

do të jetë brenda këtij viti në duart e kujtdo që është i interesuar të njohë të kaluarën.

Në këtë mënyrë do të jetë realizuar dhe obligimi ynë për të nderuar ata atdhetarë që e kryen me penë detyrën e tyre për kombin.

DAUT BISLIMI

Instituti Albanologjik – Prishtinë

HISTORIOGRAFIA PSEUDOSHKENCORE SERBE PËR SHQIPTARËT NDËRMJET DY LUFTRAVE BOTËRORE

Në fund të Luftës së Parë Botërore, Serbia dhe Mali i Zi, së bashku me kroatët, sllovenët dhe maqedonasit, më 1 dhjetor 1918, formuan shtetin e tyre të përbashkët: Mbretërinë Serbo-Kroate-Sllovene, Mbretëri e cila bashkoi pesë popuj. Edhe pse pesë popuj me zanafillë të ngjajshme (serbët, kroatët, sllovenët, maqedonasit dhe malazeztë), më parë kurrë nuk kishin qenë të bashkuar në një shtet të përbashkët. Kanë jetuar në tetë territore historikisht të definuara mirë dhe i kanë përdorur dy alfabetë, atë latin dhe çirilik.

Problemi jugosllav brenda dy luftërave botërore (Mbretërisë SKS), ishte vazhdimësi e situatës dhe vatër zjarri, e cila përfaqësonte një rrezik permanent. Fatkeqësia në marrëdhëniet në Mbretërinë SKS d.m.th. ndërmjet dy luftërave botërore, ishte e tillë që të vendosën në të dy anët e vijës së demarkacionit popujt, të cilët në këtë apo në atë kohë i ka ndarë Perandoria Romake e Perendimit dhe e Lindjes, Kisha Ortodokse e Lindjes dhe Kisha Katolike e Perendimit, civilizimi bizantin dhe i Evropës Perendimore, islamizimit dhe krishterimit, të territoreve kryesisht despotike dhe të atyre me udhëheqësi kryesisht demokratike, të cilët pa dëshirën e tyre ishin të shtrënguar të jetonin në shtetin ekstrem të ekspansionizmit serb, i cili shtet me përjashtim të Rusisë përbënin shumicën më të madhe se në çdo vend tjetër në Evropë. Me numër më të madh ishin: 1) Shqiptarët – të përqëndruar në trojet e tyre etnike, pra në Kosovë, në Maqedoni, në Malin e Zi dhe në Kosovën Lindore, dhe 2) Hungarezet – të cilët kryesisht jetojnë në Vojvodinë. Në këtë kohë

këtyre dy popujve i shtohet edhe popullsia e tretë–gjermane, e cila jetonte në Vojvodinë, në Sremë, në Sllavoni dhe në Slloveni e që në vitet e 30–ta kapte numrin rreth 550.000 banorësh.⁴⁶

Historiografia e kohës së re e popujve të Jugosllavisë versajase, nën ndikimin përshkrues besnik të kësaj historiografie, lidhur me akt–formimin të Mbretërisë SKS, ka të dhëna të përgjithësuara me disa vlerësime të historianëve sllavë dhe të disa historianëve të tjerë nga jashtë, nuk ka shenime të sakta e as studime të thelluara nga shkenca e historisë. Për këtë qëllim, duke i analizuar hollësisht të gjitha arsyet dhe momentet historike që kushtëzuan këtë akt, që për populli shqiptar në trojet e tyre etnike, ishte varr i hapur dhe i gjallë, shkenca e historiografisë shqiptare e ditëve tona, pas nëntë dekadave, ende nuk ka dhënë shpjegime të qëndrueshme të këtij momenti historik, me logjikën e rrjedhave të ngjarjeve që pësuan pas e deri në ditët tona e që janë të lidhura me këtë ngjarje historike.

Duke i hedhur një vështrim të përgjithshëm kësaj periudhe historike, me të drejtë mund të konstatojmë se formimi i Mbretërisë SKS më 1918, është ndodhi e veçantë në vargun e ngjarjeve me rëndësi në historinë e ekspansionizmit shoven serb. Përbërja shumënacionale e Jugosllavisë versajase, e dyta në Evropë, dhe fakti se numri më i madh i popujve që qeveria serbe i quante “pakica kombëtare”, kanë jetuar në territoret etnike – në afërsi të shtetit amë, siç është rasti me shqiptarët dhe Shqipërinë, dhe kur shovinizmi nacional ekstrem serb “pakicave të mëdha” – shqiptarëve, u imponoi kufizime politike, ekonomike, kulturore, dhe duke shfrytëzuar ligje diskriminuese, ushtroi dhunën, terrorin, vrasjet e deri në shfarosje fizike, bënë që shteti i ri i SKS–së të vendosej në shtyllat të qelqit, ndaj në horizont i shihej fundi i shpartallimit.⁴⁷

⁴⁶.Daut Bislimi, Formacionet poplitiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945, Prishtinë, 1997, f. 16.

⁴⁷.Daut Bislimi, vep.e cit., f. 17.

Sipas dekretligjit të vitit 1919, Shkupi ishte nën administrimin ush-tarak të Zonës së Armatës së III me qendër në Shkup. Krahës kësaj ndarje, me Dekretligjin e vitit 1922 u bë edhe ndarja e pushtetit civil.⁴⁸ Kështu, prijësit më ekstremë të shtetit të vjetër serb u bënë figura dominante politike në shtetin e ri jugosllav, të cilin pushteti i ri në thelb e trajtonte si Serbi të zgjeruar. Për t'u ruajtur forma, mbreti Aleksandar disa kroatë dhe sllovenë i emronte në qeveri, por postin e kryetarit të qeverisë dhe të ministrive më të rëndësishme (të Punëve të Brendshme dhe të Jashtme, të Jurisprudencës, Ushtrisë dhe Marinës), gjithnjë i mbanin serbët. Mospajtimi i mendimeve ishte i rrezikshëm. Për këtë flasin faktet se si në Kuvend, më 20 qershor 1928, në një debat, njëri nga deputetët e Partisë Radikale, ish kryetari i njëres bashkësi ekstreme çetnike – Punisha Radiqi, nxori revolen dhe shtiu në 5 anëtarë të Partisë Fshatare Kroate, duke i lënë dy të vdekur në vend.⁴⁹

Më shpalljen e Diktaturës së 6 janarit 1929, Shkupi u përfshi në tri zona, ndërsa në vitin 1931 u bënë disa ndryshime të mëtejme. Kjo ndarje në zona dhe administrimi territorial ushtarako-polikor, që kishte për qëllim dobësimin dhe shprishjen e kompaktësisë etnike të popullit shqiptar, mbeti e pandryshueshme deri në Luftën e prillit 1941.⁵⁰

Keqësimi i gjendjes së popullatës së Shkupit me rrethinë, vazhdoi të thellohej, sidomos pas fillimit të krizës së madhe ekonomike botë-rore dhe reformës ekstreme serbomadhe, ku mbi shqiptaret ushtrohej dhunë e terror, dhe me akte gjenocidale të vazhdueshme ndaj tyre, zhvillohej një presion permanent.

⁴⁸. Bogumil Hrabak, *Reokupacija srpske i crnogorske drzhave s arbanashkom veqinom stanovnistva u jesen 1918 odrzhavanje arbanasa prama uspostavljenjoj vlasti*, "Gjurmime albanologjike", Prishtinë 1969, nr.1, f. 254-297.

⁴⁹. Nusret Shehiq, *Qetnishtvo u Bosni i Hercegovini (1918-1941)*. Sarajevo, 1974, f. 83-91; Po aty kap, 5, 115-119.

⁵⁰. Liman Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1929-1941*, "Vjetari i Arkivit të Kosovës", Prishtinë, 1981, nr.XII-XIII, f. 59.

Prandaj, ajo e përqendroi vemendjen dhe forcat kryesore ushtarake në këtë territor, për të mbajtur Shkupin me rrethinë dhe popullin shqiptar të lidhur pas vetes dhe për ta përdorur atë si shembull karshi popujve të tjerë të Mbretërisë SKS, për përdorimin e dhunës dhe të terrorit.⁵¹

Deri më tash historiografia e kohës së re serbe, me disa vlerësime, ka të dhëna të përgjithësuara lidhur me marrëdhëniet shqiptaro-serbe ndërmjet dy luftërave botërore. Këto të dhëna të historiografisë serbe për shqiptarët në Shkup dhe rrethinë, janë kryekputë deshmitë e pseudoshkencës dhe pa marrë parasysh racionalizimin e situatës, vuan tërësisht nga mungesa e vërtetësisë shkencore. Gjatë 22 vjetëve të ekzistencës së Jugosllavisë Mbretërore në Shkup me rrethinë kanë ekzistuar rrethana shumë të vështira shoqërore, me kundërthënie të mëdha, ku korrupsioni, plaçkitja dhe spekulimet ishin veprimtari e përditshme që favorizoheshin me ligjin e sistemit në fuqi. Të gjitha këto veprimtari peshonin rëndë në supet e popullatës shqiptare dhe manifestoheshin me greva, atakime të ndryshme në forma të organizuara dhe individuale si dhe në mënyra të tjera të rezistencës.⁵²

Historiografia serbe konstatonte se me shtetin e ri jugosllav, fillon periudha e progresit dhe sipas këtyre pseudoshkencëtarëve, Serbia ishte për së tepërmi “e ngushtë për popullin e madh dhe të nesermen serbe”. Elita e intelektualëve, politikanëve veçmas e historianëve serbë, shumë para elitës së popujve të tjerë, periudhën ndërmjet dy luftërave botërore (Mbretërinë SKS), shtetin e ri Jugosllav e kalkuluan në programet pseudoshkencore të politikës ekspansioniste serbe dhe kështu para kohe i orientuan kahjet e diplomacisë serbe në shekullin XX-të.

⁵¹ Daut Bislimi, vep. e cit. f. 25.

⁵² Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë (1941-1945)*. Prishtinë, 1971, f. 18.

Për ta justifikuar hegjemonizmin, ekspansionizmin dhe ideologjinë kolonialiste serbe, qysh në fillim të shekullit XX u vu në veprim shkenca serbe. U vunë në veprim sidomos qarqet akademike dhe ato universitare. U vu në veprim shkenca e historisë, e gjuhësisë, e etnologjisë, e gjeografisë, e antropologjisë, e gjeologjisë dhe e arkeologjisë. U ndërtua pseudo-shkenca serbe, laboratorët e së cilës u shndërruan në fabrikues të kuazi-argumenteve.

Historikisht, prania e shkencëtarëve në proceset historike në Serbi është fenomen i shekullit XX. Në këtë periudhë edhe politika i ka shfrytëzuar rezultatet e shkencës historiografike, kështu që edhe këto dy fusha të veprimit filluan për së afërmi të bashkëpunojnë. Ky fenomen hegjemonist i historiografisë serbe mbeti konstant dhe pseudoshkenca e historianëve serb mbeti në ballë të të gjitha kombinacioneve të dijës dhe politikës serbe, në të gjitha periudhatn historike e deri në ditët tona dhe quhej politikë kombëtare.

Historianët – pseudoshkencëtarë si Jefto Dedijer, Jovan Zhujoviq, Kryetar i Akademisë Mbretërore të Shkencave në këtë periudhë, Kosta Kumandi, Branislav Petronijeviq, Radovanoviq, Jovan Cvijiq, Lubomir Stojanoviq, Aleksandar Beliq, Stanoje Stanojeviq, Stojan Novakoviq, Jovan Radoniq, Tihomir Djorgjeviq, Slllobodan Novakoviq, Slllobodan Jovanoviq, Pavle Popoviq, Bozhidar Markoviq, Niko Zhupaniq, Mileta Novakoviq, Grgur Jakshiq, historian i Universitetit të Beogradit dhe shumë të tjerë, ishin me ndikim të madh në sektorin e propagandës të Ministrisë së Punëve të Jashtme ndërmjet dy luftërave botërore. Këtu botoheshin “studime analitike” mbi kulturën dhe historinë e popullit serb dhe aspiratat serbe ndaj territoreve shqiptare, sipas udhëzimeve të qarqeve politike serbe. Shumica e këtyre historianëve-pseudoshkencëtarë, “studimet” e tyre i kanë shkruar me emra të tjerë (pseudonime), apo këta i kanë lutur miqtë e tyre jashtë, që të nënshkruhen me emër të tyre. Kështu veproi Jovan Radoniqi në revistën “La Petite Republique”. Në këtë drejtim Jovan Cvijiq, me plot dyshime, prapëseprapë botoi veprën kapitale “Siujdhesa ballkanike”, që në këtë periudhë arriti

efekt të konsideruar politik dhe propagandistik për shtrirjen dhe numrin e popullatës shqiptare në trojet e tyre etnike në Kosovë dhe në Shkup e me theks të veçant në Maqedoninë perendimore.

Nikolla Pashiqi, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, me anën e një qarkoreje publike i vënë në dijeni shkenctarët–historianë serb se: “Pa marrë parasysh mospajtimet tona në përcaktimet ndërpartiake në Serbi, në të ardhmën e nesërme shkenctarët serb kanë mundësinë që t’ia lajnë borxhin Serbisë dhe tërë krishterimit sllavo–ortodoks. Këtë e kanë obligim moral e intelektual, duke u inkuadruar në hartimin programit nacional serb”. Sipas këtij programi nacional të historiografisë retrograde serbe, **“shqiptarët nuk ishin komb, por myslimanë dhe mbetje apo mbeturinë turke në Ballkan”**. Maqedonia ishte **“Serbi Jugore” pa territor shqiptar**, sipas konceptit: **“e kujt është gjuha, i tij është edhe territori”**. Rrjedhimisht, sipas parimit: **“e kujt është feja, i tij është edhe territori”** – s’mund të kishte komb shqiptar apo komb maqedonas.

Qeveria serbe, historianëve serb u besoi botimin e historisë serbe, historinë e Maqedonisë nga Tihomor Gjorgjeviq, Bogdan Popoviqi “Serbia nën armiqtë”, dhe Aleksandër Beliq botoi tri studime “Mbi shkencëtarin francez Anri Bue, dhe mendimin e tij mbi çështjen maqedonase dhe shqiptare në Maqedoninë Perendimore, veçmas shqiptarët në Shkup dhe rrethinë.

Në këtë drejtim pseudoshkencëtari Jovan Cvijiq⁵³, për shkak të autoritetit që gëzonte edhe në meset jashtë shtetit sllav për çështjet ballkanike, ishte aktori kryesor, i cili politikanëve serb ua qiti përpara hartën dhe u shpjegoi për kufijt që duhet t’i ketë Serbia e

⁵³. Jovan Cvijiq (1865-1927), gjeografi më i njohur serb, ishte kryetar i Akademisë Mbretërore serbe, profesor dhe rektor i Universitetit të Beogradit, dallohet për qëndrimin e tij antishqiptar. Në punimet e tij, pa asnjë mbështetje shkencore, të gjithë popujt e ish Jugosllavisë, nga Istra e deri në Maqedoni, i ka quajtur serb, ndërsa gjuhën e tyre serbe. Punimet e tij janë pseudoshkencore dhe janë në shërbim të propagandës politike serbomadhe.

Madhe, me territoret që duhet t'i përfshinte ky shtet, më hollësisht mbi pretendimet territoriale serbe në Maqedoni, të punuara në hartë. Vështrimet e Cvijiqit mbi pasqyrën etnike të Gadishullit Ballkanik meritojnë një analizë të hollësishme nga aspekti etno-gjeografik dhe historik. Madje, për t'i bërë këto vështirime edhe më të qarta dhe më bindëse, Cvijiq këto i shoqëron me një hartë etnografike në të cilën i gjenë shqiptarët e Shkupit dhe të Maqedonisë Perendimore, të cilën ai vet e ka hartuar. Por, si teksti, ashtu edhe harta e tij etnografike e Ballkanit nuk e tregojnë realitetin e përbërjes etnike të kësaj treve. Cvijiq i këshillonte shumëherë edhe dijetarët e botës së jashtme lidhur me qëndrimet që do të merrnin ata për formimin e një Serbie të Madhe dhe të fortë në Ballkan, e cila do të jetë si baraspeshë në Evropë.

Edhe pse Shkupi dhe trojet shqiptare etnike në Maqedoni ishin të banuara mjaft dendur, pushteti ekstrem serb solli shumë kolonë, ndërtoi shumë shtëpi për kolonët dhe shqiptarëve u mori sipërfaqe të mëdha të tokës punuese për t'ua ndarë kolonëve. Po të shtoheshin edhe akte të tjera gjenocidiale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve, më këtë rast edhe vendosja e përdhunshme e një pjesë kolonësh, atëherë bëhet edhe më e qartë e tërë pesha e politikës agrare e shoviniste serbomalazeze e cila kishte dy qëllime themelore: 1. Shkombërtarizimin e popullësisë shqiptare, dhe 2. Krijimin e hendekut dhe gjendjes së padurueshme ndërmjet serbeve kolonë dhe shqiptarëve në trojet e tyre etnike.⁵⁴ Por përgjithësisht, në Kumanovën shqiptare u goditën pronarët shqiptarë të të gjitha shtresave, ngase kërkoheshin shkombëtarizimi sa ma i shpejtë dhe i thellë i këtyre trevave.⁵⁵

Ndërsa e para nuk u realizua kurrë, qëllimi i dytë i ekstremizmit shoven serbomalazez u arrit të realizohet në vazhdimësi.

⁵⁴ Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Prishtina, 1981, f. 130-204.

⁵⁵ Arkivi Qendror i shetit. Fondi 886, dosja 117, fleta 4. Shih edhe: Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve. *Botim i shoqatës për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova*, Prishtinë, 1991, lib.I., 7-335.

Në shtatorin e vitit 1921, kur Beogradi shoven e pa se masat kolonizuese nuk mund të arrinin në mënyrë të menjëhershme objektivat, urdhëroi Komandën e Armatës së Tretë të Shkupit për kryerjen e masakrave në krejt Maqedoninë shqiptare, përfshi edhe territoret e Kumanovës. E vërteta është se kjo masakër, nis më parë në trevat e Kërçovës, Gostivarit, Tetovës e Shkupit, ku shqiptarët ishin tejet kompaktë në pikëpamje demografike. Ndërsa dy aradha të Armatës së Shkupit, vijuan në Kumanovë një kontroll të imët nëpër fshatra duke evidentuar se ku ishin familjet shqiptare, çfarë marrëdhëniesh kanë ata me pushtetin civil dhe ushtarak duke përgatitur dhunën me qetësi dhe sipas një plani.

“Taktika luftarake e serbëve në Maqedoni ka marrë karakterin e një masakre të përgjithshme, pothuaj të tmerrshme. Ushtria po zbaton një taktikë shkatërimtare, barbare në kulm. Sipas tregimeve të ushtarëve dhe oficerëve, në mes të Kumanovës dhe të Shkupit janë vrarë mbi 3000 shqiptarë... Fshatrat shqiptare janë krejtësisht të djegur. Populli po gjurmohet nëpër shtëpitë e veta dhe po i vrasin si minjtë. Militaristët serb, këtë gjueti njerëzish, e kallëzojnë me një lavdatë të jashtëzakonshme”.⁵⁶

Pra, kishte një tendencë sistematike të Serbisë për asimilimin dhe zhdukjen e shqiptarëve nga këto troje. Këtë qëllim makabër të politikës serbe, në vazhdimësi e kishte shoqëruar pseudoshkenca serbe.

⁵⁶. Arkivi Qendror i shtetit – Tiranë. Fondi “Komiteti Kombëtar i Mbrojtjes së Kosovës”, dosja 35/2, fleta 4.

AVZI MUSTAFA

Universiteti i Shkupit

EDUKIMI DHE ARSIMI I SHQIPTARËVE NË SHKUP E RRETHINË NË MES TË DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Me ripushtimin e trojeve etnike shqiptare në viset lindore nga e ashtuquajtura Mbretëria Serbo–Kroate–Sllovene (SKS) ose, siç njihet në popull, “Serbia e dytë”, mbetet e pashlyeshme në vetëdijen e shqiptarëve politika e saj e shfarosjes fizike, grabitjes, dëbimit me dhunë, kolonizimit dhe asimilimit.

Me formimin e Mbretërisë SKS menjëherë u rivendos një aparat i fortë ushtarako–civil, duke e ndarë territorin e Maqedonisë së sotme në banovina, qarqe, rrethe e komuna, me qëllim që më lehtë ta kontrollojë. Lidhur me këtë Nikolla Pashiqi pohonte që në këtë mënyrë “do të sigurohet paqja dhe sa më shpejt do ta inkuadronte atë në ekonominë dhe administratën e saj”, për të asimiluar popujt e këtyre viseve si në pikëpamje kulturore ashtu edhe nacionale⁵⁷.

Ndaj shqiptarëve dhe turqve që nuk i takonin besimit ortodoks, Mbretëria çonte një politikë stagnuese dhe politikë shtrëngimi, që t’ua bëjë jetën sa më të padurueshme, bile edhe me vrasje në praninë e gjykatësve, të cilët heshtnin para opinionin botëror, kurse ndaj popullatës ortodokse çonte një politikë unitariste e indoktrinuese.

Qëndrimi i Mbretërisë ndaj çështjes së arsimit të shqiptarëve në Maqedoni edhe në Shkup ishte i prerë. Për shqiptarët kjo mbretëri lejoi vetëm edukimin fetar dhe veprimtarinë e institu-

⁵⁷ Ali Hadri, Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë, “Gjurmime albanologjike” nr. 2, Prishtinë, 1968, 178.

cioneve fetare, për të cilat planifikoi se do të shërbenin si instrummente, nëpërmes të cilave më lehtë do ta ushtronte ndikimin e vet ndaj masave të shtypura.

Qëllimi dhe karakteri i politikës serbomadhe në Maqedoninë Perëndimore, ku shumicën e popullatës e përbënin shqiptarët, për të dy palët ishte i qartë. Shqiptarët e dinin fare mirë se me cilin armik kishin punë, por edhe serbët e dinin se me çfarë populli kishin punë për t'i vënë ligjet dhe për të pasur disiplinë dhe siguri personale në këto troje.⁵⁸

Politika e saj çnjerëzore u pa që në fillim, kur ky pushtues në të gjitha vendet e okupuara nuk i zbatonte të njëjtat ligje. Kështu, në Serbinë zbatonte ligjet të tjera, ndërsa në Mal të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinë ligj tjetër, kurse në Kroaci e Slloveni ligje krejt të tjera. Këto laramani të ligjeve e arsyetonte me atë se në vendet “e çliruara” sa më parë të vendoset “rendi i qetësisë” në këto anë.

Në fillim Qeveria e Mbretit aprovonte ligje të posaçme për mbrojtjen e shtetit në “viset jugore”, ndërsa për ta jetësuar atë, pushteti parashihte metoda të ndryshme të represionit, dhunën dhe trysni, duke shpresuar se kështu mund ta realizojë Kushtetutën e Vidovdanit. Megjithatë, shqiptarët, nga pamundësia që të organizonin një rezistencë të armatosur, përsëri me vetëdije të plotë i kundërshtonin këto ligje në forma të ndryshme, qoftë të organizuar ose të rastit. Ja se çka shënohet në një raport të komandës së xhandarmërisë: “Në shumë rrethe të Serbisë jetojnë shqiptarë, popull i egër, i pakulturuar, i pabesë, dinak, i padëgjueshëm, me botëkuptime juridike nga periudha më e hershme e zhvillimit të së drejtës penale, ‘reaksionit privat, që shprehet në formë të hakmarrjes’; Përpos kësaj, ky popull nuk pranon kurrfarë këshille e as udhëzimi edhe është plotësisht konservator me botëkuptime të

⁵⁸ Halim Purellku, Rregullimi administrativ, territori i Kërçovës 1918-1929, temë magjistrature e mbrojtur në Prishtinë më 1984.

vjetruara mbi të drejtat dhe detyrat ndaj shtetit”⁵⁹. Për këtë arsye më shumë se kudo, në Maqedoninë Perëndimore dhe në Kosovë formacionet e xhandarmërisë gjithmonë ishin në rritje të vazhdueshme me qëllim të nënshtërimit me forcë të kësaj popullate. Gjithashtu ky pushtues për këto treva i aprovon 42 urdhëresa, që janë të njohura si “urdhëresa speciale”⁶⁰.

Kur pushteti serb i përforcoi pozitat e veta, nuk mundi ta fshehë politikën e tij okupuese, duke përdorë metoda më barbare, që i nuk njeh historia e njerëzimit, gjithë kjo me qëllim të mashtrimit të botës, gjoja se në këto toka ai nuk ishte robërues, por një shtet që kujdesej për ta ngritur kulturën dhe arsimin që i kishte futur në greminën e skëterrës Perandoria Osmane gjatë 550 vjetëve.

Periodha ndërmjet dy luftërave mund të ndahet në dy etapa. Etapa e parë është etapa e “Qetësisë”, që përfshin vitet 1919–1929, kur vendoset pushteti administrativ, policor dhe ushtarak, ndërkaq periudha e dytë i përfshinë vitet 1929–1941, që njihet si periudhë e Mbretërisë Jugosllave me pushtetin e saj monarko–fashist⁶¹.

Politika arsimore e asaj kohe ishte më tepër–r preokupim i pushtetit ushtarako–policor sesa politikë shtetërore–arsimore, sepse – siç shprehet një kryeshef i një rrethi, i quajtur dr. Karaxhiq – “Njëherë e përgjithmonë duhet të kuptoni se derisa të jenë analfabetë, deri atëherë do të sundojmë mbi këta, sepse kur të arsimohen, aty përfundon sundimi jonë.”⁶².

Pavarësisht nga ajo se çfarë politike arsimore ushtrohej në këto vende të robëruara, ku pjesa dërmuese ishte me përkatësi shqiptare,

⁵⁹ Shih. Ali Hadri vepër e cituar.

⁶⁰ Jovan Janev, Rezhimot na specijallnata Uredba vo Vardarska Makedonija ve tekot na 1919, Glasnik na INI br. 2-3, Skopje, 1982,132

⁶¹ D-r. Abdulla R. Vokri, Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941), Enti i botimeve dhe mjeteve mësimore të Kosovës, 1990,6

⁶² Bogolub Prokiç, Naprednoto učitelstvo vo Poreçe (1937-1941) Skopje, 1986, 6

qëllimi ishte që shqiptarët të asimilohen dhe të shkombëtarizohen dhe në fund sa më parë të largohen nga vatrat e tyre stërgjyshore.

Pas vitit 1919, kur në Beograd formohet Ministria e Arsimit në krye me Pribiçevićin, fillon të behet edhe unifikimi i shkollave fillore, ndërsa aty fillon edhe përgatitja e plan-programeve dhe miratimi i Ligjit mbi shkollat fillore, i cili aprovohet në gusht të vitit 1926. (Deri në miratimin e këtij ligji në disa shkolla është punuar sipas dispozitave të ligjit që nga viti 1899 e në disa të tjera sipas ligjit të vitit 1904.) Me miratimin e Ligjit të vitit 1929, pushteti serb kërkonte që sistemi edukativo-arsimor të vihet në shërbim të unitarizmit jugosllav, me çka synohej të rritet “atdheu i përbashkët” dhe rregullimi shtetëror, Shtëpia e Mbretit dhe besimi në Karagjorgjeviqët⁶³

Ligji i parë i Mbretërisë SKS për shkollat e ashtuquajtura “popullore” u soll më 5. XII 1929, ndërsa më pastaj u korrigjua më 7.VII.1930 dhe u miratua në kohën e diktaturës së mbretit Aleksandër. Po në këtë kohë u morën vendime që të hapen shkolla serbe në vendet e pushtuara, ku rinia do të arsimohej në frymën e pushtetit, edhe pse në disa gazeta të Beligradit njoftonin se do të debatohet për ligjin Shkollor⁶⁴. Po në këtë kohë pushteti serb e formoi edhe një komision të posaçëm, që ta shohë gjendjen e shkollave në këto troje. Mbi gjendjen dhe situatën e tillë u informuan nga njerëz të ndryshëm, ndërsa në disa vende bënë edhe vizita të drejtpërdrejta. Pasi e incizuan situatën, ata filluan të sjellin mësues në trojet shqiptare. Ardhja e këtyre mësuesve nuk u prit mirë nga popullata. Këtu kishin rol imamet, si njerëz që e mbanin gjallë jetën fetare dhe njerëz që e udhëhiqnin popullin dhe të cilëve populli u besonte.

⁶³ Avzi Mustafa, Rrethanat arsimore ne Dibër e rrethinë midis dy luftërave botërore, Dibra dhe etnokultura e saj, Dibër 1996, vll. II. 97-102

⁶⁴ Lj. Krneta, Jedinstvena Shkola, Breograd, 1963, 112-113

Qëllimi kryesorë i ligjeve shkollore ishte që sa më afër ta arsimojnë dhe edukojnë rininë në vendet e pushtuara në frymën e pushtetit. Mësimi në këto shkolla ishte i obliguar dhe i përgjithshëm. Shkolla fillore ishte katërklasëshe, ndërsa funksiononin edhe shkollat e larta popullore, të cilat zgjatnin katër vjet, por këto fillonin prej klasës V deri në klasën VIII. Më vonë filluan të hapen edhe shkollat e tipit të shkollave qytetare, shkolla zejtare, gjimnazet e ulëta dhe të larta, por edhe Fakulteti Filozofik në Shkup, që kishte për qëllim ta promo-vojë politikën shtetërore⁶⁵.

Si shkolla fillore shtetërore në Shkup e rrethinë, pa marrë parasysh përkatësinë nacionale, deri vitin 1941 ishin të evidentuara 247, por numri i nxënësve shqiptarë dhe turq ishte shumë i vogël. Në disa vendbanime edhe pse ishin të paraparë këso shkolla, ato as edhe nuk u hapën. Shkolla serbe u hapen pas vitit 1928, por edhe kjo në disa fshatra që llogariteshin si fshatra qendrore, ku mund të përfsiheshin edhe nxënës nga fshatrat përreth. Në Shkup e rrethinë kanë funksionuar në 19 këso shkollash serbe.

Kjo situatë ishte evidente për arsye se sistemi i shkollimit në bazë ishte jodemokratik dhe dualist. Prindërit shqiptarë pyetnin se ç'do të arrijnë edhe nëse e mbaronin këtë shkollë. Por, qëllimi kryesorë i politikës shkollore ishte që të vihet në shërbim të politikës së shtetit në një pjesë të popullatës, zakonisht nga ato më të pasurit, që nesër ata të bëhet qytetarë lojalë të Serbisë. Prandaj në shumë rekomandime dhe statute, por edhe nëpërmjet seminareve dhe premtimeve të ndryshme për mësuesit, pushteti shihte “shpirtin e mësuesit”. Nuk është thënë rastësisht se “mësuesi është personi i parë dhe kryesorë në shtet”.⁶⁶ Shumica e mësuesve që vinin në këto treva ishin mësues të dënuar të Shumadisë dhe të Malit të Zi. Pjesa dërmuese e tyre ishin në shkolla normale, por kishte edhe priftërinj, oficerë të pensionuar dhe me shkolla të ndryshme. Kushtet e

⁶⁵ Prosvetat vo Jugoslavija v Nezavisna Makedonija, Sofija, I 1923, br 2, 4,

⁶⁶ Mirash Vukić, Učitelje rat u narodu, Prosvjeta, Cetinje, 1898, 146

këqija të jetës, si edhe frika, bënë që shumica e tyre sapo të vinin, largoheshin nga shkollat dhe kështu në çdo vit 5 deri në 10 shkolla as që fillonin me punë.

Meqë gjatë viteve 1918–1929 Mbretëria e SKS nuk kishte sukses për hapjen e shkollave shtetërore, atëherë u drejtua kah arsimi fetar, se gjoja ai ishte i lënë padore ose, siç thoshin pushtetmbajtësit, ai lloj arsimi është në vullnetin e popullatës myslimane, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër në çdo mënyrë kërkonin që edhe mbi institucionet fetare të kenë pushtet të plotë, që edhe ato të jenë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit.

Pas vitit 1929 u bënë disa ndryshime, me të cilat Bashkësia Supreme e Beogradit e ndiqte mbarëvajtjen e jetës fetare, e cila angazhohej që ta forcojë moralin fetar te besimtarët myslimanë në Shkup. Prandaj formohet Ulema Mexhlisi i Shkupit, i cili do ta përgatiste plan-programin për lëndën e mësim besimit, do të emëronte nëpunës fetarë, por edhe do të ushtronte pushtet disiplinor mbi ta.

Ministri i Fesë për shkollat fetare do të theksojë: “Çdo fëmijë mysliman duhet të dijë ta lexojë Kuranin, pra të lexojë shkrim–leximin arab, por edhe t’i dijë përmendësh të gjitha elementet e besimit të drejtë ndaj Zotit – islamizimit”. Sipas tij, “shkollat shtetërore nuk janë gjendje të përfshijnë nxënës nëpër shkollat shtetërore për shkak të mentalitetit të tyre, andaj është e nevojshme të hapen shkolla fetare, në të cilat mësimi do të zgjasë 3 vjet dhe po ashtu edhe në shkollat fillore shtetërore do të mësohet mësimi i fesë me 2 orë në javë”. Për këtë qëllim në Shkup e rrethinë ishin angazhuar 19 mualimë (mësues të mësim–besimit islam).⁶⁷

Me vendimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 17531 të datës 5.III.1931, organet fetare fituan njëfarë autonomie. Mirëpo, pushteti nuk ishte i rehatshëm, sepse nëpërmjet këtyre shkollave ai deshi

⁶⁷ shih. dok. Nr. 4814/19

t'i realizonte objektivat e veta kryesore për shpërnguljen e popullatës me përkatësi fetare islame në vendet e Anadollit.

Ndër institucionet edukativo arsimore më të përhapura për edukimin fetar ishin sibjan-mejtepet, që ekzistonin pranë xhamive dhe mesxhideve. Në rrethin e Shkupit ato ishin ndër më të përhapurat, saqë nuk kishte lagje në qytet ose në fshat që nuk kishte së paku një sibjan-mejtepe. Ato janë të vjetra sa edhe xhamitë. Shpesh në llojin e mejtepeve themelore gjendej edhe sibjan-mejtepi,⁶⁸ përkatësisht shkolla fillore dominonte fetare, të cilat më së shumti hapeshin në fshatra, ku nuk kishte kushte për hapjen e shkollave të tjera në nivel më të lartë, si mejtep-ibtidaj ose medrese.

Sibjan-mejtepet ishin institucione fetare islame të nivelit më të ulët në periudhën e sundimit të kësaj Mbretërie. Edhe pse në këto shkolla nuk jepej asnjë lloj diturie, përsëri pushteti serb ishte i qetë, sepse qarqet qeveritare dyshonin dhe herë-herë e pengonin me të madhe veprimtarinë e këtyre shkollave. Andaj ato kishin ndërprerje të kohëpaskohshme, madje disa prej tyre edhe u ndërprejnë fare. Mbyllja e këtyre institucioneve fetare në qarqet qeveritare bëhej nën dyshimin se edhe në këto shkolla po zgjohej vetëdija kombëtare, ndërsa mësuesit e tyre cilësoheshin si njerëz shumë të rrezikshëm.

Për të pasur kontroll edhe mbi këta shkolla, Ministria e Arsimit në Qeverinë e Mbretërisë SKS në fillim solli vendim për mbyllje të këtyre shkollave, kundër të cilit vendim protestuan organet e atëhershme të Bashkësisë Fetare Islame, Ulema Mexhliasi dhe Reis-Ulemaja në atë kohë, Hfz. Ibrahim ef. Magllajliq, të cilët i dërguan një memorandum Ministrisë, për ta arsyetuar jetën e këtyre shkollave. Pas këtyre protestave, më 5 mars të vitit 1931 Ministria e Arsimit solli vendim që sibjan-mejtepet të vazhdojnë me punën e tyre, në të cilat do të mësonin fëmijët myslimanë të moshës 3 deri

⁶⁸ Fjala "sibjan mekteb" rrjedh nga fjala turqishte, që d.m.th. shkollë e fëmijëve.

në 7-vjeçare. Puna në sibjan-mejtepe do të vazhdojë në bazë të plan-programit të hartuar nga Perandoria, por gjithsesi ato do të ishin të kontrolluara nga pushteti serb.

Kjo hapje e sibjan-mejtepeve u bë në bazë të vendimeve që i merrte Ulema-Mexhlisi me seli në Shkup. Krahas hapjes së këtyre shkollave, ai i emëronte edhe sibjan-mualimët me dekrete të posaçme. Ulema Mexhlisi në Shkup përpiloi edhe plan-program për sibjan-mejtepe, i cili dukej kështu: në vitin e parë mësoheshin lëndët: Shkrimi arab (lif-baja), Ilmihali (dituritë themelore për shkencat islame), Edukimi dhe Edukata fizike, ndërkaq në vitin e dytë ishin këto lëndë: Leximi i Kur'ani Kerimit, Rregullat e leximit të Kur'ani Kerimit (texhvidi), Mësimi përmendësh i Kur'ani Kerimit (hifzi), Kaptina (sure) nga Kur'ani Kerimi për nevojat e faljes së namazit, Mësimi mbi rregullat e abdesit dhe guslit (larjes), Edukata, Të shprehurit dhe Edukata fizike.

Edhe pse në Shkup dhe rrethinë punonin më herët shkollat fetare të hapura nga qeveria osmane, më vonë u hapën edhe disa sibjan-mejtepe private, përsëri numri i tyre ishte i pamjaftueshëm për nevojat e popullatës.⁶⁹ Prandaj pas vitit 1931 sibjan-mejtepet filluan të shtohen, ndërsa shtimi i këtyre shkollave u ndje sidomos gjatë viteve 1931–1935, kur edhe u fitua e drejta që këso shkolla të mund hapen edhe si private.

Me një dekretligj, si dhe me vendimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 175312 të datës 5 mars 1931, ftohen organet fetare për hapjen e shkollave fetare, të cilat do të jenë nën kontrollin e shtetit, ngase ishte pikëpyetje se për çka do të flitej në orët e mësimit fetar. Ulema-Mexhlisi me aktin nr. 691 më 12 mars 1931 për këtë i njoftoi organet fetare në terren. Ndërkaq në bazë të shkresës të Myftinisë

⁶⁹ ДАРМ, фонд 619-Окружни и обласни муфтијства, Скопје, (i pa rregulluar), кутија 9, ?; Mr. Avzi Mustafa, Shkollat fetare, Hëna e Re, nr. 39, Shkup, 1992, faq. 17,

së Shkupit me nr. 1032/35 të datës 18 tetor 1935 drejtuar Kryesisë së Vakëf–Mearifit, me të cilën Myftinia e Shkupit kërkon nga Kryesia e Vakëf–Mearifit të japë të dhënat e sibjan–mualimëve dhe mësueseve të lëndës fetare, Kryesia e Vakëf–Mearifit i përgjigjet me urgjencë me shkresën nr. 2157 të datës 05. XI. 1935, ku Muftinia së Shkupit, në bazë të një pyetësoi dhe në bazë të shënimeve të organeve sekrete, flet për sibjan–mualimët dhe për mësuesit e lëndës fetare që të mund të angazhohen. Kjo kuptohet se organet shtetërore kërkonin ta dinë se cilët janë ata që do të japin arsimin fetar .

Në bazë të një dokumenti nr. 12, të nënshkruar nga inspektori i rrethit të Shkupit, “kur do të kënaqen imamët, kërkesa e shqiptarëve për shkolla në gjuhën shqipe do të shuhet”. Siç duket, kështu edhe ngjau. Shumica e imamëve, për t’i ruajtur pozitat e veta, çështjen e shkollimit të shqiptareve e lidhnin me punën e fesë, duke thënë se “myslimanëve, përveç mejtepit, nuk u duhet shkollë tjetër, duke i mbrojtur interesat e veta e të pushtetit.”⁷⁰

Disa mejtepe punonin pa leje ose me leje që nga koha e Perandorisë Osmane, siç ishin mejtepet e xhamive “Haxhi Balaban” Shkup me 80 nxënës, mejtepi i xhamatit “Vardar” me 32 nxënës, mejtepi në banesën në rrugën Stručka nr. 23, mejtepi në xhaminë “Jelen kaplan” në Shkup me 25 nxënës, mejtepi në mesxhidin “Qebir Mehmed Çelebi” me 25 nxënës, si dhe mejtepi në mesxhidin “Ismail vojvoda” me 50 nxënës

Sibijan–mejtepet, sipas ligjit serb, e humbën karakterin që e kishin në Perandorinë Osmane dhe u kthyen në çerdhe ose çerdhe fëmijësh. Në rrethin e Shkupit deri në vitet 1932–1935 vepronin gjithsej 34 sibijan–mejtepe dhe po aq kishte sibjan–mualim dhe mësues të lëndës fetare. Enrat personale, vendi i punës dhe të

⁷⁰ Avzi Mustafa, Edukata dhe arsimi nëpër shekuj, Shkupi, Shkup, 1997, f. 121.

dhënat e tjera për çdonjërin nga ata janë shënuar në hollësi në belën vijuese. Për këtë shih tabelën në vijim!⁷¹

Në vitin shkollor 1935 në rrethin e Shkupit u hapën edhe dy (2) sibijan-mejtepe, një në fshatin Grushinë dhe një Studeniçan.⁷²

Gjatë këtij viti shkollor në rrethin e Shkupit me vendim të Ulema Mexhlisit në Shkup u hapën edhe sibijan-mejtepe edhe në Dikavec me nr. 19/1935 me mualim Ibrahim Iktiman, pastaj në Bojanë, Paniçar, Laskarcë, Lubin, Draçevicë, Mojancë, Pagarushë, Sveta-Petkë, Matkë etj. Deri në vitin 1941 në Shkup e rrethinë vepronin gjithsej 50 sibijan-mejtepe, nga të cilat në disa fshatra ishin njëvjeçare, kurse 49 sosh ishin dyvjeçare. Prej tyre 32 ishin pronë e vakëfit, kurse 20 prej tyre ishin private. Njëzet e tetë prej tyre e kishin edhe banesën për mualimin, kurse 24 nuk kishin banesë për mualimin. Njëri prej tyre kishte vakëf,

Tridhjetë e tetë prej tyre i plotësonin kushtet për mësim, të cilat e kishin edhe lejen nga organet sanitare për mësim, kurse 14 prej tyre nuk posedonin leje nga organet sanitare. Në 50 sibijan-mejtepe ishin angazhuar 53 mualimë, një pjesë prej tyre paguheshin me rrogë nga shteti, kurse një pjesë nga vakëfi ose nga ehalija me natyrë.

Në të gjitha mejtepet, sipas statistikave jo të plota, këto shkolla i ndiqnin gjithsej 2.952 nxënës, prej tyre 1.746 meshkuj dhe 1.206 femra.

Në vazhdim do të japin edhe listën me të dhënat e mualimëve në sibijan-mejtepet në Shkup dhe rrethinë prej vitin 1932.⁷³

⁷¹ ДАРМ, фонд 619, кутија 9, Окружни и обласни муфтијства, Скопје (fond i parregulluar).

⁷² ИЗВЕШТАЈ о раду улема-меџлиса у скопљу у 1938 и 1939 години, Сарајево 1941, фақ. 80.

⁷³ .) ДАРМ, фонд 619, кутија 9, Окружни и обласни муфтијства, Скопје (fond i parregulluar).

N.r.	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr. i nxën.	Pagesa	nr. vend.	Viti		
1	Omer Selimi (viq)	Shkup (qytet)	30	4000 dinarë	2053	1932	9 anëtarë	Shpërbimi i dytë /
2.	Said Omer	Shishovë	18	720 kg. grurë	1343	1932	6 anëtarë	Shpërbimi i dytë /
3.	Halil Iljazi (viq)	Rasçë e Poshtme	28	950 kg. grurë	1165	1932	6 anëtarë	Shpërbimi i dytë /
4.	Hasan Shabi (iq)	Shkup (qytet)	35 nxënës	3.000 dinarë	2369	1932	18 anëtarë	Shpërbimi i dytë /
5	Qahil Sefullja	Krushopek	45 nxënës	Nga 3 dinarë mujor	1341	1932	7 anëtarë	Shpërbimi i dytë /
6	Lazim Adili (viq)	Ovetove	60 nxënës	1.500 dinarë	1342	1932	Një anëtarë	Shpërbimi i tretë /
7	Omer Omeri (viq)	Shkup (qytet)	30 nxënës	6.000 dinarë	2673	1932	11 anëtarë	Shpërbimi i dytë /
8	Kadri Ahmeti (viq)	Konjare e P. dhe Eper	150 nxënës	4.000 dinarë	-		4 anëtarë	Shpërbimi i tretë /
9	Omer Ismail	Koliçan	43 nxënës	3.000 dinarë	-		5 anëtarë	Shpërbimi i dytë /
10	Selim Sejfedin	Shkup (qytet)	47 nxënës	3.000 dinarë	-		7 anëtarë	Shpërbimi i dytë /
11	Shaban Murtezan	Glumovë	40 nxënës	Nga dy shinik grurë për një vit	-		4 anëtarë	Shpërbimi i tretë /
12	Sali Idri (viq)	Morane	43 nxënës	1.500 dinarë	4034	1933	3 anëtarë	Shpërbimi i dytë /

13	Sherif Ismail (viq)	Verzhale	40 nxënës	2,000 dinarë	4797	1933	4 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
14	Sulejman Mustafa (viq)	Studenica	75	3000 dinar	4271	1933	3 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
15	Osman Zejnelli (viq)	Kopanicë	50 nxënës	950 kg. grurë	4805	1933	4 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
16	Rexhep Hasan	Çajlane	45 nxënës	720 kg. grurë	4516	1933	4 anëtarë	Shpërbilimi i parë	/
17	Hashim Halil	Shkup (qytet)	80 nxënës	6000 dinar	3572	1933	3 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
18	Ibrahim Abdullah	Shkup	32 nxënës	4000 dinar	3572	1933	7 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
19	Illjaz Omeri (viq)	Svillare e poshtme	35 nxënës	1,000 dinarë	2147	1933	9 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
20	Hajredin Ahmedoviq	Nikishtanë	50 nxënës	Falas	2180	1933	2 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
21	Musa Shakir	Drazhillovë	85 nxënës	2,000 dinarë	2206	1933	4 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
22	Halim Ramiz	Sejmenishte	43 nxënës	Nga dy shnik grurë për një vit	3428	1933	2 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
23	Hmid Iljaz	Batincë	30 nxënës	1,500 dinarë	3468	1933	8 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
24	Selim M. Selim (viq)	Luboten	46 nxënës	Prej çdo prindi nga 40 dinarë	328	1933	3 anëtarë	/	Pasi që e ka lëshuar punën disa muaj, nuk ka punuar në bazë të aktit nr. 1348/35

25	Xhemal Kurtoviq	Aldince	30 nxënës	Falas dhe pak natyrë	2110	1933	3 anëtarë	/	Nga 250 dinarë në muaj paguhet nga buxheti i Kryesisë
26	Elmaz Musliu (vii)	Nerez	45 nxënës	Nga 4 dinarë mujor	1497	1933	Një anëtarë	/	Shtytëzon shtëpinë dhe merr rrogë prej 140 dinarësh
27	Fazli Rexhepi (vii)	Brezë	18 nxënës	falas	1402	1933	3 anëtarë	/	Shtytëzon shtëpinë e vakëfit
28	Adem Abdumexhit	Bukoviq	50 nxënës	900 kg. grurë	1112	1933	4 anëtarë	Shpërbilimi i parë	/
29	Rexhep Muhamed	Amaqi	50 nxënës	700 kg. grurë	1388	1933	2 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	/
30	Shaban Ibrahim (vii)	Svillare e Epërme	50 nxënës	600 dinarë	27	1934	2 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	
31	Rashid Adli (vii)	Shkup (qytet)		2.400 dinarë	167	1934	2 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	
32	Musli Mustafa	Patishka Rëkë	32 nxënës	1.500 dinarë	468	1934	2 anëtarë	Shpërbilimi i dytë	
33	Idriz Mustafa	Reshçe e Epërme	52 nxënës	Nga 3 dinarë mujor	287	1934			
34	Ali Iliayi (vii)	Rashçe e Poshtme	40 nxënës	950 kg. grurë	28	1934			

Në Shkup punonin edhe tri medrese më të njohura. Ato ishin “Medah dhe “Haxhi Ismail Agina”, si dhe ajo e Isa Beut.

Me 24.IV.1924 u nënshkrua akti nga vet Mbreti që në vitin e ardhshëm të fillojë punën edhe shkolla e mesme me emrin “Velika Medresa Kralja Aleksandra I”⁷⁴. Kjo medrese ishte e rangut të shkolle të mesme, sepse përveç lëndëve fetare, aty do të mësoheshin edhe të gjitha lëndët që mësoheshin nëpër gjimnazet shtetërore.

Pushteti mbretëror serb, duke shfrytëzuar kushtet për “stabilitet politik” sipas Mbretit dhe N. Pashiqit, ushqente iluzionin “se të gjitha shkollat me karakter fetar, por edhe kjo shkollë, nesër do të bëhej një çerdhe për pengimin e përparimit për ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarët”.

Edhe pse hapjen e kësaj medreseje në Shkup ideologët e arsyetonin me ngritjen kulturore të myslimanëve, hipokrizia e politikës serbe ishte “që të formoi rini religjioze myslimane të edukuar në frymën e tillë, që nesër ta kenë fjalën kryesore në popull”.⁷⁵

⁷⁴ Sluzbene novine br.148, 1924

⁷⁵ Muatafa Memić, Velika Medresa i njeni učenici u revolucionarno pokretu, Skoplje, 1984,

QERIM LITA

Arkivi Shtetëror i Maqedonisë – Shkup

DIPLOMACIA SHQIPTARE NË SHKUP (1935 – 1941)

Popullsia e Shkupit me rrethinë, rrjedhimisht deri në vitin 1912 përbëhej prej një shumicë shqiptare, si dhe disa pakicave, në radhë të parë sllave (bullgar–maqedonase, serbe), por edhe hebraike, romë, vllahe, etj. Pas Luftës së Parë Ballkanike dhe pushtimit të këtij qyteti nga ushtria serbe, filloi shpërngulja e dhunshme e popullsisë shqiptare për në Turqi.

Dokumentet e proveniencave të ndryshme, provojnë qartë se këto vise kanë qenë të banuara kryesisht me shqiptarë dhe se elementet sllave në trojet e përmendura shqiptare ishin vendosur pas vitit 1912. Mbështetur në ato të dhëna, si dhe në literaturën relevante shkencore të autorëve të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtar, shpërngulja e shqiptarëve nga vatrat e tyre u krye në tri faza: faza e parë filloi më 1912 dhe zgjatë deri më 1919; faza e dytë filloi nga viti 1919 që zgjatë deri më 1931 dhe faza e tretë nga viti 1931 kur Mbretëria Jugosllave shpall ligjin mbi kolonizimin e krahinave jugore.

Diplomati dhe atdhetari i shquar shqiptar Hamit Kokollari, në librin e tij: "Kosova – Djepi i Shqiptarizmit", duke e përshkruar numrin e popullsisë në trevat lindore shqiptare shkruan: "...Elementët serbe e malazeze të infiltuara gjerë më 1912 në krahinat shqiptare, që më vonë do të aneksoheshin nga Jugosllavia, nuk përfaqësonin veçse 5% të popullsisë së përgjithshme... Shkupi, Tetova, Gostivari, Kërçova, Struga, Ohri, Manastiri, ku elementi maqedhonas ka mundur të infiltrohet para vitit 1912, numri i tij ka qenë kurdoherë pa rëndësi në krahasim me numrin e Shqiptarëve..."⁷⁶

⁷⁶ Hamit Kokolari, "Kosova - Djepi i Shqiptarizmit", 1962, Lidhja Kosovare në Mërgim, fq. 86.

Gjenocidi serb i ushtruar mbi popullsinë shqiptare për të detyruar shpërnguljen e dhunshme të tyre në mënyrë të organizuar përshkruhet edhe në “Promemorien” e tre famulltarëve të Kishës Katolike Shqiptare të Kosovës: Don Jovan Bisaku, Don Shtjefan Kurti dhe Don Luigj Gashi, dërguar më 5 maj 1930, Sekretarit të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, Erik Dramondit. Në kreun dy të saj, hartuesit e këtij dokumenti e vënë në dijeni diplomatin e lartë botëror se: "Para okupacionit serb, shpërngulja ka qenë tërësisht e panjohur për banorët shqiptarë që shtrihen në viset të cilat tash janë nën sundimin jugosllav". Sipas tyre: "Arsyet për shpërnguljen e masave, që vërehet nga viti 1912, pa dyshim se janë përndjekja e çdo shtrese, me qëllim që t'i detyrojnë t'i lëshojnë vatrat e tyre." Krahës kësaj metode, ata në Promemorie i paraqesin edhe dy metoda tjera, që shovinizmi serbo-madh i vuri në shërbim së shpërnguljes të shqiptarëve të pambrojtur: "Përdorimi i forcës për shkombëtarizimin e popullsisë e cila nuk është në gjendje të mbrohet", si dhe: "përndjekja dhe eliminimi i elementeve të cilët nuk dëshirojnë t'i lëshojnë trojet, e as të shkombëtarizohet me forcë." Si pasojë e kësaj dhune deri në vitin 1930 nga këto treva ishin detyruar të shpërngulen "140.000 e më shumë shqiptarë... në Turqi, Shqipëri dhe vende tjera fqinje"⁷⁷, konstatojnë përveç tjerash tre misionarët e çështjes shqiptare në Promemorie.

Paralelisht me shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve, autoritetet e atëhershme serbe filluan edhe aksionin e kolonizimit të viseve shqiptare me serbë e malazez, që fillimisht do të zbatohej në emër të “Reformës Agrare”. Lidhur me këtë, Hamit Kokollari, në veprën e sipërpërmendur shkruan: "Deri me 1 janar 1928 janë kufizuar me

⁷⁷ Државен архив на Република Македонија (në vazhdim ДАРМ), Ф. Војни историски институт (në vazhdim ВИИ), Микрофилми 346. Proc. Nr. 3, Beograd, viti 1930 , fl. 38; Qerim Lita, Shaban Efendia atdhetar i devotshëm, Kumanovë 2010, fq. 71-86; Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, Politika e Mbretërisë jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941 (në vazhdim Politika e Mbretërisë jugosllave), përzgjedhjen, redaktimin dhe parathënien Qerim Lita, Shkup – Prishtinë 2012, dok. nr. 16.

qëllim kolonizimi 225.397 hektarë tokë ndër 1923 komplekse..." Toka e konfiskuar ju shpërndahej kolonëve serbë, malazezë, boshnjakë dhe elementeve sllave nga viset lindore të Maqedonisë, që vetëm në rrethin e Shkupit ishin krijuar: "10 koloni të mëdha dhe 22 të vogla." Po sipas këtij autori kështu veprohet edhe nëpër vendbanimet urbane, sidomos në Shkup, ku përmes: "kolonizimit të drejtpërdrejtë" e diçka me zhvillimin e nevojave të shtimit e kolonëve sllave nga viset më largëta, ky qytet kishte marrë një panje krejtësisht tjetër nga ai i para viteve 1912, sepse siç vë në pah, aty popullsia sllave ishte dyfishuar⁷⁸.

Në vazhdim, po e paraqesim një plan të Dhomës Agrare në Shkup, në të cilin përfshihen vendbanimet të rrethit të Shkupit dhe të Kumanovës, e që sipas udhëheqësve të atëhershëm të asaj dhome, ekzistonin kushte për vendosjen e kolonive serbe. Në rrethinën e Shkupit: Vllae, Orizare, Novo Sellë, Zllokuçan, Vuçi Doll, Bardovcë, Ormanë, Saraj, Vizbeg, Brazdë, Mirkovcë, Glluvë, Taftalixhe, Earanë, Lisiçe e Epërm, Draçevë, Lisiçe e Poshtme, Lubosh, Zelenikovë, Harashanë, Pakoshevë, Bujkovcë, Aleksandrovë, Belimbegovë, Hasanbeg, Trubarevë, Stajkovc, Inxhikovë, Dushanovë, Bërnjarcë, Ognjancë, Idrizovë, Jurumlerë, Rashtak, Creshevë, Butel, Konjare e Epërme, Konjare e Mesme, Shishovë, Katllanovë dhe Radishan. Në rrethinën e Kumanovës: Mërshëvcë, Umin Doll, Petrovo Sellë, Delladrovë, Buçincë, Rramanli, Gnillanovac, Studen Breg, Reçicë, Lubodrag, Çerkez, Opajë, Llopat, Ropalcë, Meteç, Tromegjë, Projevë dhe Millado Ngorariçan.⁷⁹ Sipas këtij plani, rezulton se në rrethin e Shkupit, ishin paraparë të krijoheshin 41 koloni serbe, ndërsa në rrethin e Kumanovës tetëmbëdhjetë⁸⁰.

Veç kësaj autoritetet e atëhershme serbe parashihnin edhe krijimin e kolonive serbe brenda në qytetin e Shkupit edhe atë: "Qendra e

⁷⁸ Hamit Kokollari, vepra e cituar, fq. 121-124.

⁷⁹ ДАРМ. I. 121.1.113/540-546

⁸⁰ Po-aty

Shkupit, Vodno e Poshtme, Vodno e Epërme, Nerezi i Poshtëm, Kisella Voda, Maxhari... etj.⁸¹ Ngjashëm u veprua edhe në qytetet e krahinat tjera shqiptare.

Është e rëndësishme të vihet në pah se pas shkatërrimit të organizatës “Xhemijet”, e cila zyrtarisht njihet si parti politike të “myslimanëve të jugut”, shqiptarëve ju ndalua e drejta e përfaqësimit në parlament nëpërmjet ndonjë partie të veçantë të tyre. Kjo e drejtë atyre u mundësohej vetëm nëpërmjet partive të ndryshme serbe, siç ishin në atë kohë “Partia Radikale” apo ajo “Partia Demokratike”.⁸² Në rrethana kur shqiptarëve ju mohohet çdo e drejtë, qoftë ajo qytetare apo nacionale, arsimore, kulturore, një pjesë e parisë shqiptare nën udhëheqjen e Ferhat bej Dragës, në fillim të viteve tridhjeta, të shekullit të kaluar, ndërmorën një sërë aktivitete politike dhe organizative, të cilat kishin për qëllim ndërgjegjësimin e shqiptarëve. Po në atë kohë, respektivisht, me shpalljen e monarkisë u vu re një rritje e vëmendjes të Mbretërisë Shqiptare për çështjen e Kosovës e atë shqiptare në përgjithësi. Trupi diplomatik shqiptar në Mbretërinë Jugosllave u porositi që të krijonte lidhje dhe të mbështeste emigrantët shqiptar nga Kosova, se Ahmet Zogu ka pas takim me Bedri Pejani, etj. Në kuadër të këtij ndryshimi politik, në vitin 1930, qeveria shqiptare lejoi vendosjen e krerëve të Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës, në Shqipëri, siç ishin Bedri Pejani, Ibrahim Jakova, etj., të cilët deri në atë kohë vepronin në shtetet e ndryshme të perëndimit.⁸³ Vetë shpallja e Zogut si “Mbret i gjithë

⁸¹ ДАРМ.1.121.1.114/547-556

⁸² ДАРМ.Ф.ОЗНА.К.2 док. 2/II/II, бр. 13 б. Податоци са пратениците од бивша Југославија; Në të duke e përshkruar aktivitetin politik të Zenel Strazimit, thuhet: “Gjatë kohës së Jugosllavisë së vjetër, si bej ka lëvizur në parti të ndryshme. Në vitin 1920, kandidohet për deputet në rrethin e Kaçanikut në listën e “Xhemijetit” (Parti Muslimane) dhe është zgjedhur. Në atë kohë ka qenë në anën e Pashçit. Në vitin 1925 përsëri është zgjedhur në rrethin e Kaçanikut edhe atë si kandidat i partisë Radikale. Gjithashtu është zgjedhur në vitin 1932, ndërsa në vitin 1935 është zgjedhur si kandidat i PPJ...”

⁸³ Prof.as.dr. Fatmira Rama, Komiteti i Kosovës në bashkëpunim me organizatat e tjera politike (1925-1939), kumtesë e lexuar në simpoziumin shkencor organizuar

Shqiptarëve”⁸⁴, më 1 shtator 1928, nënkuptonte, se ai dhe qeveria shqiptare, në të ardhmen do të angazhohen në shumë për pjesën shqiptare të pushtuar nga klika hegjemoniste serbe.

Në vitin 1935 pushtetarët e Beogradit, përkatësisht, Dhoma e Reformës agrare në Shkup, filloi një aksion edhe më të ashpër, sa i përket konfiskimit të tokës pjellore nëpër vendbanimet shqiptare. Aksioni i ri parashihte që “fshatarëve shqiptarë, t’u lejohej vetëm 0,4 hektar tokë për një anëtar të familjes.” Qëllimi i kësaj politike, siç bënin të ditur raportet e ndryshme të organeve policore dhe ushtarake serbe, ishte “dëshpërimi i banorëve shqiptarë”, sidomos i fshatrave “që shtrihen buzë Malit Sharr, e deri në hapësirën Kumanovë – Prishtinë.” Në këto treva fshatrat shqiptare ishin tepër kompakte”⁸⁵. Pushtetarët e Beogradit shpresonin se nëpërmjet konfiskimit të pronës, do ti detyronin shqiptarët të shpërnguleshin.

Si rrjedhojë e një politike antishqiptare, në Shkup si edhe në viset tjera shqiptare filloi një Lëvizje Kombëtare, e cila u iniciua nga studentët shqiptarë që studionin në Universitetin e Beogradit, të cilët në mars të vitit 1935, në Beograd themeluan organizatën studentore atdhetare “Besa”⁸⁶. Veprimtaria e saj së shpejti u përhap në

në Shkodër me 7 nëntor 2003 me rastin e 85 vjetorit të themelimit të Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”; Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, përmbledhje kumtesash, Akademia e Shkencave Tiranë, 2004 faq.129-149

⁸⁴ ДАРМ.Ф.ВИИ.М.349, Албанија измеѓу два рата, Београд, 11 мај 1952 год.ф. 63: Dokumenti në fjalë është hartuar nga organet e UDB-së të ish Federatës Socialiste Jugosllave ku në të përshkruhen ngjarjet që janë zhvilluar në Shqipëri gjatë kësaj periudhe, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, politikën e Ahmet Zogut etj.. Duke folur rreth politikës së Shqipërisë pas shpalljes së Monarkisë, në të veç tjerash thuhet: “Në prag të shpalljes së mbretërisë erdhi deri te konflikti i ri me Jugosllavinë. Në njoftimet e shërbimeve tona që Mbreti të thirret si “Mbreti i gjithë Shqiptarëve”, Beogradi urdhëroi që të intervënohet dhe filloi një acarim i gjatë. Mbështetur në paktin e Tiranës dhe me mbështetjen e Italisë, Zogu ishte këmbëngulës. Pa marrë parasysh insistimin tonë, Shqipëria i lëshoi sytë brenda kufirit tonë. Në Kosovë dhe Metohi, përsëri u ringjallën rymat irredentiste...”

⁸⁵ ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346, Прилике у Јужној Србији 1938 год.

⁸⁶ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР. К. 18

mbarë trojet e okupuara shqiptare. Nismëtarët e themelimit të saj ishin: Tahir Ismaili⁸⁷, Jahja Osmani nga Mateçi i Kumanovës, Shaip Mustafa nga Presheva, Abdulla Saqipi nga Presheva, Sokol Dobroshi nga Gjakova, Xhevdet Pallaska nga Gjakova, Shaip Kamberi nga Tetova, Esat Berisha nga Gjilani, Qazim Bllaca nga Bllaca e Malishevës, Ibrahim Lutviu nga Prizreni etj.⁸⁸ Të gjithë ata ishin studentë në Universitetin e Beogradit.

Parimet kryesore të “BESËS” ishin:

“1. Veprimtaria themelore në zgjimin e vetëdijes kombëtare te shqiptarët, nën sundimin e Mbretërisë Jugosllave,

2. Bashkëpunimi politik me popujt tjerë të robëruar apo të pakënaqur nga regjimi i Mbretërisë Jugosllave,

3. Fshehtësia e domosdoshme dhe veprimtaria gojore,

4. Betimi i detyrueshëm para flamurit dhe asnjë dokument i shkruar për veprimtarinë e organizatës.”⁸⁹

Siç vërehet, qëllimi i organizatës ishte përhapja e vetëdijes nacionale, agjitimi nëpër krahinat shqiptare kundër pushtuesit të

⁸⁷Po-aty, K.С.Д. Кочмет: Në deklaratën e Abdulla Saqipit, njërit ndër themeluesit të ‘Besës’, dhënë para organeve të UDB-së, lidhur me veprimtarinë Tahir Ismailit, thuhet: Student i drejtësisë në Beograd. Ai ishte ndër iniciatorët e parë për organizimin e organizatës ilegale shqiptare ‘Besa’. Ka zhvilluar aktivitet të gjerë në debatet parapërgatitore për themelimin e saj. Posaçërisht ka agjituat duke zgjeruar urrejtje nacionale madje edhe fetare ndaj serbëve. Mbante raporte të mira me ambasadën e Shqipërisë në Beograd, madje që para se ‘Besa’ të bëjë formalizmin e kontaktit me të. Ishte një ndër shtyllat e ashtu quajturës rrymës e djathtë e ‘Besës’ e cila ishte kundër çdo lloj bashkëpunimi të studentëve shqiptar me lëvizjen përparimtare studentore në Beograd, ndërsa ishte edhe kundër çfarë do lloj aksioni të ndërmarrë nga lëvizja e lartpërmendur. Mbronte qëndrimin që Kosova i takon Shqipërisë pa marrë parasysh se çfarë regjimi është atje...etj.

⁸⁸ Po-aty

⁸⁹ ДАПМ...1.427.60.8/130-149; Qerim Lita, Naçërtania, K.Cërvenkovski dhe identiteti shqiptar në Maqedoni (1945-1954, Shkup 2007. fq. 488-506

mbretërisë jugosllave, për masat antishqiptare e gjenocidiale që ndërmerreshin kundër shqiptarëve. Synimi i saj kryesor ishte: “Ri-bashkimi i Kosovës dhe Maqedonisë Veri-Perëndimore (dhe të gjitha viset tjera të banuara me shqiptarë) me Shqipërinë.”⁹⁰

Është e një rëndësie të vihet në dukje se, brenda udhëheqjes së organizatës, ekzistonin dy krahë politikë: krahui i djathtë, që refuzonte çfarëdolloj bashkëpunimi me studentët serbë, pa marrë parasysh ideologjinë e tyre, dhe krahui i majtë, i cili për dallim nga të parët, konsideronte se një bashkëpunim me studentët serbë me ideologji komuniste është e domosdoshme. Krahut të parë i prinin Shaip Kamberi (i cili në mbledhjen konstituive të Besës u zgjodh sekretar i organizatës)⁹¹, Ibrahim Lutviu, Sokol Dobroshi, Esat Berisha, Tahir Ismaili, Imer Rasimi etj. Krahun e majtë e përfaqësonin kryetari i organizatës Abdulla Saqipi⁹², Shaip Mustafa, Jahja Osmani, Xhevdet Pallaska etj.⁹³

Me qëllim të realizimit të programit të saj, krerët e “Besës”, së shpejti u lidhën me legatën e Shqipërisë në Beograd. Kontribut të çmueshëm dhanë dy diplomatët shqiptarë: Rauf Fico⁹⁴ dhe Shere-met Xhuxhuli, të cilët do të mbajnë disa takime me anëtarët e or-

⁹⁰ Po-aty

⁹¹ ДАРМ. Ф. УДБ-PCBP. K. 18, Abdulla Saqipi, para organeve të UDB, deklaroi: Shaip Kamberi, nga Tetova, student i drejtësisë në Beograd. Një ndër iniciatorët për formimin e “BESËS”, organizatë ilegale e studentëve shqiptarë në Beograd. Tregoi një aktivitet të lartë gjatë formimit të saj. Mbante lidhje me legatën Shqiptare para se “BESA” formalisht të vendos kontakte me legatën e lartpërmendur. Ishte një ndër shtyllat kryesore e së djathtës brenda “BESËS”. Posaqërisht angazhohej që me autoritetin e tij të ndikoj te studentët e rij shqiptarë që ata të mos binë nën ndikimin e e komunistëve në Universitet. Në mbledhjen konstituive në mars të vitit 1935 u zgjodh sekretar i “BESËS”....

⁹² Po-aty, K. .5

⁹³ Po-aty, K. 5,11, 17, 18

⁹⁴ Po-aty, K.11: Rauf Fico, diplomat shqiptar në Beograd, në vitin 1935 mbante lidhje me anëtarët e organizatës “Besa”, financiarisht ju ndihmonte dhe i këshillonte për veprimtarinë e mëtutjeshme.

ganizatës në lagjen e Koshutnjak të Beogradit.⁹⁵ Takimi i parë formal i anëtarëve të organizatës me Legatën e Shqipërisë u mbajt menjëherë pas themelimit të saj, në mars të vitit 1935, kur Rauf Fico u takua me kryetarin e “Besës” Abdulla Sakipin dhe Rasim Imerin, në selinë e Legatës shqiptare. Në fakt, Rauf Fico, si Ministër fuqiplotë i Legatës shqiptare në Beograd, mbante lidhje me studentët shqiptar edhe para themelimit të “BESËS”, sidomos me Rasim Imerin, Sokol Dobroshin etj.⁹⁶

Veprimtaria e “Besës” së shpejti u shtri në disa qendra të mëdha shqiptare, sidomos në Shkup, Tetovë, Kumanovë, Dibër, Preshevë, Gjilan. Kontribut të çmueshëm për veprimtarinë e saj të këtushme do të japin përfaqësuesit e konsullatës shqiptare në Shkup: Rexhep Stabla dhe Akshi Sulejmani.⁹⁷ Ata gjatë viteve 1935–1939, kishin kontakte të fshehta me disa veprimtarë të kauzës shqiptare të këtij qyteti si: Hasan Shukriun, Fetah Mehmetin, Nevzat Maksut Rexhepin, Gani Selimin etj. Takimet, zakonisht mbaheshin në Bojali Han të Shkupit, që më vonë ky lokal do të kthehet në qendër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, kundër politikës hegjemoniste serbe.⁹⁸

⁹⁵ Po-aty: Sheremet Xhexhuli: sekretar i Legatës shqiptare në Beograd para luftës. Ka marrë pjesë në një mbledhje të organizatës “Besa” mbajtur në lagjen Koshutnjak dhe ju dha detyrë anëtarëve të “Besës” që të grumbullojnë të dhëna statistikore për përbërjen numerike të shqiptarëve në Kosovë, Dukagjinë dhe Maqedoni. Miqtë më ngushtë të nga radhët e Besës ishin Sokol Dobroshi, Tahir Ibraimi, Lutvi Ibraimi dhe Esad Doko; Shih Dr. Sc. Prof. Vebi Xhemaili, në veprën e cituar fq. 45-46.

⁹⁶ Po-aty, K. 11: Rauf Fico. Ministër Fuqiplotë i Shqipërisë në Beograd.

⁹⁷ Po-aty.

⁹⁸ AM.F. UDB-RSVR, kut 11: Procesverbali nga dëgjimi i të dënuarit Fazli Vebi Shukri – Bakalli, i cili është i dënuar në grupin “JUXHEL” me 12 vjet. Procesverbali është përpiluar në burgun e Idrizovës me 21 shtator 1948. Në pyetjen e parashtruar nga ana e përfaqësuesve të UDB-së, se me cilët persona më me ndikim njihet në Shkup dhe si njeh, i akuzuari përgjigjet: “Nga personat më me ndikim në Shkup njihem me: 1/ Hasan Shuriun, pronar i Bojali Hanit, përndryshe është shqiptar, dhe në zgjedhjet fetare gjithmonë opozitar. 2/ Feta Mehmetin, i cili ka punuar në të njëjtin han te Shukriu, dhe njëri ndër mbështetësit më të fuqishëm të Hasan Shukriut; 3/ Nevzat Maksut Rexhepi, pronar i “Zhivi Hanit” përndryshe me ide të njëjtë si edhe Hasan Shukriu, i

Rexhep Stabla, ishte tepër i interesuar për gjendjen e shqiptarëve nën sundimin e atëhershëm serb, prandaj ai me qëllim të informimit sa më të shpejtë, krijoi një rrjetë të gjerë të bashkëpunëtorëve në disa qendra shqiptare, në mesin e të cilëve shquheshin: Idriz Čerćeri nga Tetova, Shaban Efendiut nga Kumanova, Gani Selimi nga Shkupi, Tefik Aruçi nga Gostivari, Nevzat Maksuti nga Shkupi etj⁹⁹. Nga këta atdhetarë ai informohej për “situatën politike në Shkup dhe në Kosovë, për konfiskimin e pronës të shqiptarëve nga pushteti serb, për arrestimet, përndjekjet etj...”. Në anën tjetër, Rexhepi, nëpërmjet këtyre veprimtarëve të “Besës”: “shpërndante ndihma për organizatën “Besa” si dhe “zgjeronte fushatë” me karakter kombëtar, me qëllim të vetëdijesimit të popullsisë shqiptare. Për çështje sigurie, lidhjet e këtyre veprimtarëve me Rexhepin, fillimisht mbaheshin nëpërmjet Akshi Sulejmanit, ndërsa nga viti 1937, kur ky diplomat tërhiqet në Shqipëri, lidhjet i mbanë Nevzat Maksuti¹⁰⁰.

Është e rëndësishme të vihet në dukje se në këtë periudhë kohore, falë aktiviteteve të Legatës shqiptare në Beograd, si dhe dy përfaqësitë e saj në Shkup e Manastir, brenda udhëheqjes së Ulema Mexhlisit të Shkupit, në sipërfaqe doli rryma opozitare, e cila për dallim nga klika serbomadhe, insistonte në ndryshimin radikal të politikës së deriatëhershme të BFI-së, që aspak nuk dallonte nga politika zyrtare e Beogradit. Ndër krerët më të dalluar të krahut kombëtar të BFI-së ishin: Muderizi nga Prishtina Remzi Abdullau, Shaban Efendia nga Kumanova, Akshi Sulejmani, profesor në Medresenë e Madhe, Lutfi Ahmeti nga Presheva, Azem Hoxha nga Kumanova,

cili është mik i tij; Gani Selimi, i cili në mesin e shqiptarëve njihet si politikanë edhe pse është i pashkolluar. Një kohë ishte kandidat për rrethin e Shkupit; Rexhep Stablen, i cili gjatë kohës së Jugosllavisë së vjetër ka punuar në konsullatën shqiptare.

Rexhepi pati marrëdhënie të mira me të ashtuquajturit Bojalhanxhitë, respektivisht me personat e lartpërmendur qëndronte mirë...

⁹⁹ Po-aty, Në deklaratën e Rexhep Nevzatit lidhur me veprimtarinë e Rexhep Stablës thuhet: Rexhepi, drejt për së drejti punonte me Idriz Čerćerin, Shaban Efendiun, Gani Selimin, Tefik Aruçin etj.

¹⁰⁰ Po-aty.

Mulla Idriz Gjilani, Bedri Hamidi nga Shkupi, pastaj atdhetarët dhe prijësit politik shqiptarë si Ferhat bej Draga, Kadri Saliu, Aqif Tetova, Idriz Ibrahim Cërcëri nga Tetova e shumë e shumë të tjerë. Të gjithë ata bashkëpunonin ngushtë me diplomatët e akredituar shqiptar në Beograd, Shkup e Manastir, siç ishin Asafa Pauli, Rexhep Stabla, Stavre Katundi, Hamit Kokolari, etj.

Burimet e atëhershme ushtarake e policore të Mbretërisë jugosllave, vinin në dukje se “Në kohë të fundit si qendër e lëvizjes kombëtare shqiptare po paraqitet Shkupi”. E gjithë kjo për ta, ishte e papritur, për faktin se siç pohonin: “Popullsia e kësaj ane shumë ngushtë ishte e lidhur me fenë” dhe se “institucionet fetare thuajse gjithmonë kanë pas ngjyrë fetare, e jo kombëtare.” Mirëpo, për tërë këtë ndryshim, vihej në dukje në një informatë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Mbretërisë jugosllave: “rol të rëndësishëm ka luajtur edhe konsullata shqiptare në Shkup me në krye Rexhep Stablen” i cili “ka pas kontakte të shumta me njerëzit e lëvizjes posaçërisht me hoxhallarët atdhetarë siç ishin Shaban Efendi Jashari dhe shumë të tjerë, të cilëve pa rezerve ju del në ndihmë, si në pikëpamje materiale, morale po ashtu edhe ndihma politike e organizative.”

Lidhur me aktivitetet e bujshme, që zhvilloheshin nga krerët e “Besës, të Bashkësisë Islame dhe Kishës Katolike Shqiptare, gjatë vitit 1938 Shërbimi Sekret i Armatës Jugosllave njoftonte se: “Në kohë të fundit po vërehet një lëvizje të shqiptarët për shkak aktiviteteve të pushtetit në konfiskimin e tokës.” Shqiptarët....”, thuhej më tej në njoftim: “shkojnë në Shkup deri te konsulli shqiptar dhe kërkojnë nga ai mbrojtje, ndërsa katolikët ju drejtohen klerikëve të tyre. Në përgjithësi gjendja është e alarmuar.”¹⁰¹ Siç shihet, gjatë viteve 1937–38, politika serbe rreth reformës agrare ishte gjithnjë

¹⁰¹ Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, Politika e Mbretërisë jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941 (në vazhdim Politika e Mbretërisë jugosllave), përzgjedhjen, redaktimin dhe parathënien Qerim Lita, Shkup – Prishtinë 2012, dok. nr. 48.

duke u ashpërsuar, madje ajo tash më ishte e dhunshme, gjë që e detyruan popullsinë shqiptare të kërkoj ndihmë nga konsullata shqiptare në Shkup. Për rrjedhojë, qeveria shqiptare e autorizoi ministrin e Punëve të Brendshme Musa Jukën, që të dërgoj disa njerëz të besuar në Kosovë dhe viset tjera shqiptare nën pushtimin jugosllavë, të cilët së bashku me krerët e atjeshëm shqiptarë, të ndikojnë te masat e përgjithshme shqiptare që mos i lëshojnë vatrat e tyre¹⁰².

Më 28 mars 1939, Komanda e Xhandarmërisë së divizionit të Qarkut të Vardarit, njoftonte komandantin e Armatës së III në Shkup, për një mbledhje të mbajtur më 20 mars 1939 në Tiranë, nga ana e krerëve më të njohur shqiptarë, ku është folur për rënien e qeverisë së Stojadinoviqit dhe rrethanat e reja të krijuara lidhur me Konventën turko-jugosllave. Në mbledhje siç bëhet me dije në informatë është konstatuar si vijon: “Duke e pasur parasysh rënien e qeverisë së Dr. Millan Stojadinoviqit, si edhe atë se edhe deri më sot parlamenti jugosllav e ai turk, nuk e kanë marrë në shqyrtim këtë Konventë e ajo as që është zbatuar në vepër, ndërsa i deleguari shqiptar në Ankara, me urdhër të qeverisë shqiptare ka ndërmarrë hapin e duhur të faktori kryesor i Turqisë, që ta pengojë zbatimin e Konventës, krijuesit kryesorë të së cilës janë Qemal Atatürku dhe Dr. Stojadinoviqi.” Qeveria shqiptare, thuhej më pas në njoftim: “ia ka dërguar udhëzimet e nevojshme konsullit shqiptar në Shkup, që në mënyrë të përshtatshme ta njoftojë popullsinë, siç thuhej në njoftim “myslimane në Serbinë e Jugut, se plani rreth shpërnguljes së popullit shqiptar ka rënë”¹⁰³.

Pas pushtimit të Shqipërisë, nga Italia fashiste (7 prill 1939), qeveritarët e Beogradit, duke e shfrytëzuar fatkeqësinë e shtetit Shqiptar, ndërmorën masa edhe më radikale, me qëllim siç theksonin: “që njëherë e përgjithmonë ta heqin nga rendi i ditës çështjen shqiptare..” Në kuadër të këtyre planeve, Komanda e Shtatmadhorisë së

¹⁰² Po aty, dok. nr. 55.

¹⁰³ Po aty, dok. nr. 83.

Armatës hartoi një Memorandum, në të cilin fillimisht përshkruhej disponimi i shqiptarëve nën sundimin jugosllav, pas pushtimit të Shqipërisë, ku sipas tyre gjithnjë e më tepër po e mbështesin politikën italiane. Hartuesit e Memorandumit në vazhdim shprehen qartë se: "Shqiptarët janë të pakënaqur me gjendjen e tyre aktuale në Jugosllavi. Ky është një fakt të cilin nuk mund ta mbulojmë.. Konfiskimin e tokës bujqësore shqiptarëve, si edhe të kuptuarit se ato në territorin tonë janë vërtetë elementë të padëshirueshëm, gjithsesi se ka ndikuar pozitivisht në zgjerimin e propagandës në favor të Italisë." Kjo gjendje sipas kësaj komande mund të paralizohet në dy mënyra: "ose sa më parë ti shpërngulim nga territoret tona ose tua plotësojmë kërkesat e tyre në pikëpamje materiale dhe kulturore." Lidhur me këto dy mënyra në memorandum thuhej: "Është e qartë se kjo e fundit ndoshta vetëm përkohësisht do ti kënaqte, dhe që pastaj në një kohë sa më të afërt dhe në një moment për ne shumë të pafavorshëm, përsëri të kërkojnë bashkimin me Shqipërinë. Për këtë arsye është nevojë e patjetërsueshme, që me shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje të filloj sa më parë. Kjo sa më parë, sepse në këtë moment shqiptarët janë të dezorientuar, ndërsa marrëdhëniet tona të politikës së jashtme përball shqiptarëve aq shumë kanë përparësi sa që mundemi të punojmë ashtu siç dëshirojmë ne."¹⁰⁴

Këto plane jugosllave nuk do të realizohen, falë aktivitetit politiko-organizativ, të parisë intelektuale dhe nacionaliste shqiptare, që vepronte në Shkup e që njihej si grupi opozitar i "Bojali Hanit". Në kuadër të këtyre aktiviteteve duhet përmendur takimin e Zenel Strazimirit, dhe Iliaz Agushit me konsullin shqiptar në Shkup, Hamit Kokollarin i cili, u kishte garantuar se qeveria shqiptare, nuk do të lejojë në asnjë mënyrë të bëhet depërtimi i dhunshëm i shqiptarëve nga këto treva. Rreth këtij takimi, shërbimet informative jugosllave nga Shkupi njoftonin: "Nga paria shqiptare me ndikim

¹⁰⁴ Po aty.

ndërmerren masa, që shqiptarët në vendin tonë të solidarizohen me gjendjen e re të krijuar në Shqipëri.

Të gjitha raportet e shërbimeve sekrete, qofshin ato të MPB-së apo ato ushtarake jugosllave, tash më, me të madhe njoftonin për një qëndrim anti-jugosllav të qeverisë italiane. Në këtë drejtim, fletë edhe informacioni i MPB-së, i lëshuar në maj të vitit 1939, ku thuhet: "përfaqësitë e fuzionuar italian-shqiptare në Jugosllavi (Ambasada në Beograd dhe konsullatat në Shkup dhe Manastir) do të vazhdojnë të punojnë me të njëjtin personel të ish përfaqësive shqiptare." Për këtë, siç thuhet në informatë, qenkan marr veshtë, autoritet italiane me parinë shqiptare në Jugosllavi, e që këta të fundit paskan marrë për obligim të: "propagandojnë, që për shqiptarët tanë (nën Jugosllavi-Q.L.) do të vinë ditë më të mira, sepse tash më nuk do tu merret toka, e aq më pak do të flitet për shpërnguljen. Për këtë garant do të jetë Italia, e cila do ti mbroj interesat e shqiptarëve nën Jugosllavi dhe do të kërkojë të realizohen të drejtat e tyre."¹⁰⁵

Në raportin e komandës së armatës së III, për muajin maj, jepen reagimet e shqiptarëve në Jugosllavi, në të cilin veç tjerash thuhej: "Fillimisht okupimi i Shqipërisë shkaktoi një revoltë anti – italiane, njëkohësisht mbështetjen e tyre ndaj Jugosllavisë, sepse shpresonin që shteti i ynë (Jugosllavia-Q.L.) do ti ndihmojë Shqipërisë. Mirëpo më vonë u kuptua, se italianët kanë shpallur me Shqipërinë një bashkim të veçantë dhe se ajo edhe më tutje do të ekzistoj si shtet, dhe kur atje erdhën në pushtet disa shqiptarë me ndikim, kjo urrejtje gradualisht filloi të shuhet."¹⁰⁶ Më poshtë raporti , njoftonte se: "Në zonën ndërkufitare me Shqipërinë, posaçërisht kjo në Gjakovë, ka filluar propaganda, se Italia me Shqipërinë ka krijuar bashkim të veçantë vetëm nga shkak, që të rruhet emri i Shqipërisë, dhe në bazë të kësaj Italia në momentin e volitshëm mundet ta

¹⁰⁵ ДАРМ. Ф. ВИИ, М-346, Пов. бр. 4603/39-Београд.

¹⁰⁶ ДАРМ. Ф. ВИИ. М. 345. Пов. бр. 465, 4 maj 1939-Скопје.

shtroj çështjen e bashkimit të atyre viseve ku në shumicë jetojnë shqiptarët."¹⁰⁷ Sipas ushtarakëve serbë, ideja për bashkimin e tokave shqiptare, ishte shtruar qysh në kohën e qeverisjes së Zogut, kur: "propaganda shqiptare në Jugosllavi është zhvilluar në drejtimin e ngritjes së vetëdijes kombëtare te shqiptarët e Kosovës, me qëllim të krijimit të kushteve për ngritjen e çështjes së bashkimit të Kosovës me Shqipërinë." Mirëpo, sipas tyre: "Pas okupimit të Shqipërisë, ky aksion dështoi dhe propaganda për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë mori kahje tjetër, sepse tash në mesin e shqiptarëve flitet, se atë çka nuk mundi ta arrijë Mbreti Zog, do ta kryejë Italia."¹⁰⁸ Qeveritarët e Beogradit, druheshin se: "Në një kohë sa më të afërt në mesin e popullatës shqiptare në Jugosllavi do të filloj një propagandë më e gjallë, se sa ka qenë deri tash, sepse këtë aksion pa mëdyshje do ta ndihmoj materialisht dhe moralisht Italia."¹⁰⁹

Prandaj, ata, së shpejti marrin një sërë masash represive kundër shqiptarëve, sidomos në zonat përreth kufirit me Shqipërinë, sepse sipas analizave të tyre: "para ardhjes së Italisë në Shqipëri, propaganda shqiptare ka pas për qëllim, që te shqiptarët të zonës sonë (serbe-Q.L.) ndërkuftare të përhapen ndjenjat nacionale", dhe si hap i parë për ndërprerjen e komunikimit shqiptaro-shqiptarë, ata: "hermetikisht i mbyllin vendkalimet kufitare me Shqipërinë."¹¹⁰ Veç kësaj, pushtetarët jugosllavë, fillojnë një aksion të dhunshëm mbi shqiptarët, me të vetmin qëllim që sa më shpejtë të bëjnë pas-trimin etnik të Kosovës, dhe viseve tjera shqiptare nën Jugosllavi. Ky aksion, filloi menjëherë pas një letre që ua dërgoi, Shtabi i Përgjithshëm ushtarak jugosllav, ministrive të luftës dhe marinës, të punëve të jashtme dhe asaj të brendshme, pastaj komandës së armatës III në Shkup dhe trupave kufitare, e cila fillimisht i njoftonte organet e lartpërmendura se: "Pas vendosjes së ushtrisë Italiane në

¹⁰⁷ Po-aty

¹⁰⁸ Po-aty

¹⁰⁹ Po-aty

¹¹⁰ ДАРМ. Ф. ВИИ. М. 344. Пов. бр. 760- 1939 година, Скопје.

Shqipëri, disponimi i shqiptarëve tonë (nën sundimin jugosllav–Q.L.) dukshëm ka ndryshuar". Sipas kreut ushtarak jugosllavë: "Shqiptarët katolikë janë tepër të gëzuar prandaj me siguri ata do të jenë rruga ma e mirë për zbatimin e propagandës italiane; shqiptarët myslimanë, edhe pse në masën e përgjithshme janë në pritje e sipër, por që tani mund të vërehet, se një pjesë e tyre shikojnë tek Italia si një forcë e sigurt për realizimin e shpresave të tyre drejt bashkimit të Shqipërisë së Re. Përderisa deri tash mendimi i tyre ka qenë se çështja e tyre do të vendoset nëpërmjet plebishitit, që në mbledhjet dhe takimet e tyre publikisht e kanë deklaruar, sot ata te Italia shohin një forcë të fuqishme, e cila është në gjendje që çështjen e tyre ta realizoj ashtu si dëshiron ajo."¹¹¹

Se përgatitjet për një pastrim etnik të tokave shqiptare, ishte një realitet, e shohim nga raporti mujor i komandës së armatës së tretë në Shkup për muajin maj, ku veç tjerash në të thuhet: "Lidhur me informacionet që jepen rreth shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi gjatë këtij viti, mund të pritët, që mos disponimi i shqiptarëve kundër shtetit tonë përsëri të rritet"¹¹².

Kjo politikë nuk e dha efektin e duhur, nga fakti se krerët shqiptarë, ju kundërvunë kësaj politike antishqiptare. Ata kudo që shkonin kërkonin nga shqiptarët që mos i lëshojnë vatrat e tyre, duke u thënë: "Mund t'u konfiskojnë gjithçka, por shtëpitë nuk mund tua merr", dhe se kjo politikë "është afatshkurtre ku do të vijë dita që Shqipëria do ti çliroj të gjitha viset e robëruara shqiptare edhe atë nga Shkupi e deri në Prishtinë." Mendimi i tyre provohet edhe nga burimeve policore serbe, ku sipas tyre: "Shqiptarët janë tepër të dëgjueshëm ndaj kërkesave të parisë së tyre... Tani më rreth tre vite të tëra nuk shesin as një pëllëmbë tokë."¹¹³

¹¹¹ ДАРМ. Ф. ВИИ. М. 346. Пов. Ц. Бр. 4881, Скопје, 1939 год.

¹¹² ДАРМ. Ф. ВИИ. М. 345. Пов. Ц. Бр. 610, Скопје, 1939 год.

¹¹³ ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346, Прилике у Јужној Србији 1938 год.

Përderisa, atdhetarët shqiptar, bënëin ç'mos që ta ndërpresin shpërnguljen e shqiptarëve, në anën tjetër, me qëllim të përçarjes së popullsisë shqiptare, pushtetarët serbë, në atë kohë nëpërmjet disa veglave të tyre, lëshuan parulla të ndryshme, se myslimanët nuk duhen të ndahen në kombe, sepse sipas tyre: "vetëm myslimanët janë vëllezër mes veti." dhe se: "për myslimanët vendi më i përshtatshëm është Turqia." Këto parulla u lëshuan kudo, posaçërisht në regjionin e Shkupit e të Kumanovës. Mirëpo, falë aktivitetit të krerëve opozitar shqiptar, të kryesuar nga Ferhat bej Draga, si dhe angazhimin dhe rolin konstruktiv të diplomacisë së atëhershme shqiptare e vendosur në Shkup, rreth pengimit të shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi dha rezultatet e duhura, sepse pikërisht në kohën kur autoritetet e Beogradit, bënëin plane të fshehta për depërtimin e dhunshëm të shqiptarëve, ndodhi e kundërta, përkatësisht, numri i familjeve që u shpërngulë gjatë viteve 1938–1941 ra në minimum.

SHINAZI MEMETI

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup

ROLI I BASHKËSISË FETARE ISLAME DHE MYFTINISË SË SHKUPIT NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Përkushtimi ndaj Shkupit dhe historisë së tij, në veçanti interesimi ndaj organizimit të jetës fetare në përgjithësi, lidhet me përkushtimin e kamotshëm tonin për zhvillimet fetare dhe rolin e Bashkësisë Fetare Islame në organizmin e jetës fetare, formimin dhe ngritjen e integritetit dhe vetëdijes fetare, në ruajtjen dhe transformimin e kulturës fetare dhe shpirtërore në kultivimin e jetës fetare, në ngritjen dhe zhvillimin e procesit të arsimimit të popullatës myslimane, në rihapjen dhe ngritjen e mejtepeve, shkollave fetare dhe veprimtarisë së tërësishme edukativo–arsimore, etj. Të gjitha këto janë çështje me interes të veçantë shoqëror dhe edukativ.

Jeta fetare në këto anë ka qenë shumë e pasur. Zhvillimi i arsimit dhe i shkollave fetare gjatë etapave historike e deri në vitin 1912, kur Shkupi me rrethinë ishte nën sundimin e Perandorisë Osmane, ka qenë proces unik me qëllime të caktuara dhe ideale të larta për ngritjen kulturo–arsimore dhe fetare të popujve të këtyre trevave.

Edhe pse më vonë do të flasim në pika të shkurta për historikun e Shkupit, në këtë punim do të kufizohemi veçanërisht në rolin e Bashkësisë Fetare Islame dhe prezantimin dhe zhvillimin e saj në jetën fetare si dhe në zhvillimin dhe ngritjen e vetëdijes fetare, e në veçanti në punën e mundimshme dhe të palodhshme të ulemasë dhe atë në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore, duke u përqendruar në:

–Shkupi – qendër e provincave osmane;

- Shkupi – qendra administrative e Serbisë Jugore;
- Organizimi i Bashkësisë Fetare Islame në viset e Ballkanit pas shpartallimit të Perandorisë Osmane;
- Organizimi i Bashkësisë Fetare Islame gjatë viteve 1918–1929;
- Organizimi i Bashkësisë Fetare Islame gjatë viteve 1929–1941;
- Roli dhe qëllimi i Bashkësisë Fetare Islame në realizimin e detyrave dhe obligimeve të saj; etj.

Shkupi qendër e provincave osmane:

Që nga viti 1391, kur në Shkup u vendosën osmanlinjtë, ky qytet shndërrohet në qendër të provincave osmane të këtyre anëve duke filluar prej Pasha Jigit Beu (1392–1440), mandej Is'hak Beu, (1414–1439) dhe djalit të tij Isa Beu (1439–1463).¹¹⁴ Gjatë periudhës së Perandorisë Osmane për popullatën e qytetit të Shkupit me rrethinë do të filloj një periudhë e re e zhvillimit të tij, e sidomos sa i përket formësimit dhe zhvillimit të jetës fetare, arsimit dhe shkollimit i cili vazhdimisht do të jetë në rritje dhe zhvillim.

Shkupi deri në shekullin XVII u zhvillua në një qendër të madhe tregtare dhe ekonomike me saraje të shumta, tregje, ujësjellës, çarshi, sahat kulla, hane, hamame dhe shumë objekte fetare si xhami, mesxhide, dhe teqe, dhe shumë objekte arsimore, *mejtepe*, *medrese* dhe *biblioteka*.

Udhëpërshkruesi i njohur turk Evlija Çelebiu, i cili dy herë vizitoi Shkupin ndërmjet viteve 1660 dhe 1668 ndër të tjera shkruan se Shkupi kishte 70 mëhalla me “afër 10 mijë e gjashtëdhjetë shtëpi të mrekullueshme, përdhese dhe me një kat të ndërtuara me material të fortë dhe të mbuluara me qeramidhe të kuqe”. Në qytet kishte

¹¹⁴ Стаменов, С., Чоловоќ, И., Драшко, Х.и К., Попов, Поглед врз старата Скопска чаршија, Скопје 1997, ф. 24.

120 xhami, një numër i madh i medreseve, 70 mektebe, 110 me, 200 sebile (shatërvanë), shumë hamame dhe hane, 9 imarete, 77 mijë dylime tokë private dhe po aq vreshta të vakëfuara. Duke e përshkruar Çarshinë ai përmendë se “ajo përbëhej nga 2.150 dyqane, sheshe dhe pazare të ndërtuara nga materiali i fortë dhe i dekoruar me pjesë të lëshuara dhe kupola”.¹¹⁵

Shkupi në këtë kohë ka pasur nëntë shkolla për mësimin e Kur’anit (Daru-l-kur’an). Ato nuk kanë qenë të vendosura në ndërtesa të posaçme, por kanë funksionuar pranë xhamive. Në këto shkolla është mësuar përmendësh Kur’ani, prandaj këto kanë shërbyer si shembuj që popullsia myslimane t’i kushtoj më tepër kujdes dhe vëmendje mësimin të Kur’nit.¹¹⁶

Në bazë të kësaj që përmendëm, shihet qartë se në gjysmën e parë të shekullit XVII në Shkup kemi një rrjet të zhvilluar të shkollave për fëmijë myslimanë dhe atë: *shtatëdhjetë mejtepe, gjashtë medrese dhe nëntë shkolla për leximin dhe mësimin e Kur’anit përmendësh, hivzit*. Në këtë periudhë sistemi arsimor ishte domi-nues nëpër mejtepe dhe medrese.

Shkupi qendra administrative e Serbisë Jugore:

Fillimi i shekullit XX për Shkupin dhe popullatën e këtyre anëve do të shënoj një tmerr të madh i cili do të shënojnjë gjurmë të pa shlyera dhe të paharruara për popullatën myslimane të këtyre trojeve.

Ushtria serbe më 25 tetor 1912 do të hyjë në Shkup, me të cilën edhe do t’i jepet fund pushtetit osmanli në këto troje. Më pastaj do të fillojnë Luftërat Ballkanike (1912–1913). Gjatë Luftës së Parë Botërore (1914–1918), Shkupi deri më 29 shtator 1918 do të jetë

¹¹⁵ Evlija Čelebi, Putopis, odlomci o Jugoslavenskim zemaljama, përktheu: Hazim Šabanović, Sarajevo, 1967, f. 280-281,

¹¹⁶ Ibid, f. 283,

nën okupimin e forcave bullgare–gjermane–austriake, i nënshtruar në vuajtje të vështira dhe terror të madh.¹¹⁷

Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore Shkupi do të bëhet qendra administrative e Serbisë Jugore, e pastaj do të zhvillohet si Kryeqytet i Banovinës së Vardarit të Mbretërisë Serbe. Kurse nga viti 1918 deri në vitin 1929, Shkupi gjendet nën sundimin e Mbretërisë Serbo–Kroate–Sllovene e më pas deri më 1941, nën Mbretërinë Jugosllave¹¹⁸.

Në periudhën e parë, kur territori i Shkupit rikthehet përsëri nën sundimin e Mbretërisë SKS deri në vitin 1929, e cila njihet si periudhë e konsolidimit të administratës serbe në Shkup. Shkupi bëhet një ndër qendrat më të zhvilluara tregtare dhe industriale, ku fillon me të madhe rritja e numrit të popullatës në qytet, kurse popullata myslimane nga presionet e pushtetit fillon me të madhe të shpërngulet nga këto troje.

Gjatë viteve 1929–1941 faza e dytë e sundimit i cili njihet me emrin Mbretëria Jugosllave, gjatë së cilës politika serbe edhe në këto vite sundoi në mënyrë tejet absolute.

Ky sundim më tepër u reflektua në trojet ku jetonin popullata myslimane e në Shkup popullata myslimane ishin ma të përqendruar dhe në një numër më të madh. Në këtë periudhë fillojnë edhe torturat politike kundra myslimanëve me dënime të ndryshme, burgosje, vrasje dhe shpërnguljet masive, ku në vitin 1938, u nënshkrua edhe traktati në mes Mbretërisë Jugosllave dhe Republikës së Turqisë për këmbimin e popullatës.¹¹⁹

¹¹⁷ Стаменов, С., Чоловоќ, И., Драшко, Х.и К., Попов, Поглед врз старата Скопска чаршија, Скопје 1997, ф. 40,

¹¹⁸ Ibid, ф. 40,

¹¹⁹ Ramiz Zekaj, Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX, Tiranë 1997, ф. 35,

Të gjitha këto ndodhi detyruan që një numër i madh i popullatës myslimane të braktisin vatrat e tyre shekullore, kurse pasuria kulturore e kultivuar gjatë shekujve me radhë mbetet e pa mbrojtur e si-domos zhvillimi dhe kultivimi edukativo-arsimor, mbyllja dhe shkaktërimi i një numri të madh të objekteve fetare-arsimore. Gjendja e vështirë ekonomike, politike, sociale, shoqërore kulturore, arsimore dhe fetare e popullit mysliman, e në veçanti popullatës myslimane në Shkup detyroi që të heqin dorë edhe nga aktiviteti fetar.

Pas formimit të Mbretërisë SKS për myslimanët do të filloj një periudhë e vështirë, periudhë kjo e cila për Bashkësinë Islame sipas disave mendohet periudha më e vështirë e organizimit të jetës fetare dhe myslimanëve. Në këtë periudhë do të vinë në shprehje një numër i madh i dobësive organizative të cilat do të vështirësojnë jetën fetare të myslimanëve në këto troje. Disa këto vështirësi mundohen t'ia hedhin sistemit të më hershëm organizativ të Bashkësisë Fetare Islame, por realiteti i paraqitjes të vështirësive duhet lypur në ndryshimet e rrethanave pas Luftës së Parë Botërore dhe ndryshimet politiko-shoqërore dhe shpirtërore të cilat seriozisht i kapluan myslimanët.¹²⁰

Pas ndryshimeve politike dhe formimin e Mbretërisë Jugosllave edhe për myslimanët do të filloj një organizim i ri i mbështetur në norma dhe ligje ku do të përforcohet pozita e tyre dhe zhvillimi i jetës fetare.

Mbretëria Jugosllave do të bëj unifikimin e të gjitha ligjeve, ku do të angazhoj organet shtetërore që të sjellin edhe Ligjin për Bashkësinë Fetare Islame, ky Ligj do t'i besohet Ministrisë së drejtësisë, i cili pas miratimit do t'i dorëzohet Mbretit për verifikim. Më 31 Janar të viti 1930 u soll Ligji për Bashkësinë Islame të Mbretërisë Jugosllave.¹²¹

¹²⁰ Muhamed Salkić, Ustavi islamike zajednice, Sarajevo, 1422/2001, f. 83,

¹²¹ Ibid, f. 83,

Organizimi i Bashkësisë Fetare Islame në viset e Ballkanit pas shpartallimit të Perandorisë Osmane:

Gjatë sundimit të Perandorisë osmane në këto troje myslimanët nuk kishin bashkësi të veçanta fetare, por organizimi i jetës fetare edhe këtu ishte i njëjtë sikurse në pjesët tjera të Perandorisë Osmane.

Udhëheqësi suprem fetar i gjithë myslimanëve ishte Halifja (Sulltanin)¹²², i cili pushtetin fetarë e kryente nëpërmjet Shejhul-islamit.¹²³ Ai për rajone të caktuara emëronte Myfti¹²⁴ të cilët kujdeseshin për jetën fetare për rajonet e veta. Ekzistonte ministria e veçantë që kujdesej për pronën e vakëfeve duke mbikëqyrur aktivitetet e Mutevelive¹²⁵ dhe personave tjerë fetarë. Me rënien e Perandorisë Osmane, shtetet e reja Ballkanike, veçanërisht Serbia dhe Mali i Zi shpallën krishterimin si fe shtetërore, kurse pranuan edhe islam, por jo si fe shtetërore të barabartë me fenë krishtere dhe ushtruan kontroll të rreptë mbi të. Në të vërtetë Shejhul-islami edhe më tej vetëm formalisht konsiderohej udhëheqës suprem fetar dhe parashihej që Bashkësia Fetare Islame mund të realizoj lidhje bashkëpunimi me qendrat e tjera islame jashtë Serbisë¹²⁶ ku pjesë përbërëse e së cilës ishte edhe Republika e Maqedonisë së sotme për çështjet fetare.

Në krye të Bashkësisë Fetare Islame të Serbisë ishte Myftiu, selia e të cilit ishte në Nish. Në Mali të Zi gjithashtu në krye të Bashkësisë Fetare Islame ishte Myftiu i cili sipas funksionit të tij ishte deputet i

¹²² Halifja - mëkëmbësi, udhëheqësi suprem i myslimanëve i cili kryesonte shtetin islam politikisht dhe fetarisht.

¹²³ Shejhul islami - Myftiu i Lartë, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në Perandorinë Osmane i cili ka pasur pushtetin dhe autoritetin fetarë, në interpretimin e dispozitave të sheriatit.

¹²⁴ Myfti - njohës i diturive fetare, njohës i sheriatit islam, përfaqësues i dijetarëve islam të një rrethi,

¹²⁵ Muteveli - Drejtues i vakëfit, i cili drejtonte me mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave nga vakëfi të përcaktuara sipas vakëfnamesë,

¹²⁶ Bećirbegović Edah, Organizacija Islamske zajednice u SFRJ, Sarajevo, 1981, f. 32-33,

popullit. Në praktikë, pozita e përfaqësuesve të Bashkësisë Fetare Islame në këto treva ishte shumë e rëndë dhe solli deri te shpërnguljet e mëdha të myslimanëve në vendet tjera. Në Dalmaci dhe Slloveni feja islame u pranua në vitin 1912, kurse në Sllavoni dhe Kroaci në vitin 1916.¹²⁷

Kjo që u përmend më lartë për pozitën e Bashkësisë Fetare Islame pas rënies së Perandorisë Osmane tregon se kjo bashkësi ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit të saj dhe ka qenë e detyruar që vazhdimisht të ndryshoj dhe të përshtat aktivitetin e sajë sipas rrethanave të krijuara. Duke u nisur nga obligimet ndërkombëtare, shteti i rri me anë të akteve ligjore dhe kushtetuese përcaktoi pozitën e islamit e cila Bashkësisë Fetare Islame si formë organizative e kësaj feje i krijoi mundësi që gradualisht të intensifikoj jetën fetare në të gjithë sektorët dhe të “çlirohet” nga kontrolli shtetëror.¹²⁸

Pozita e pjesëtarëve të bashkësisë islame (myslimanëve) do të përcaktohet nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe atë: Marrëveshja ndërkombëtare e Bukureshtit e 28 Qershorit të vitit 1913, Stambollit 1– 4 marsit të vitit 1914, e veçanërisht me nënshkrimin e marrëveshjes në Konferencën e Pages, që u mbajt në Versajë pas Luftës së Parë Botërore më 10 shtator të vitit 1919 në mes të Austrisë në të cilën Mbretëria e Re (SKS) obligohet që t’u garantoj mbrojtje familjare dhe statut të plotë myslimanëve, emërimin e reis ul-Ulemasë, mbrojtjen dhe sigurinë e xhamive, varrezave dhe institucionet tjera mirëbërëse. Organet shtetërore që mbikëqyrshin dhe udhëheqshin Bashkësinë Fetare Islame ishin: Ministria e Feve e cila u themelua në vitin 1919 dhe u anulua më 24 prill të vitit 1929, kurse kompetencat e mbikëqyrjes të kësaj ministrie i mori Ministria e Drejtësisë.¹²⁹ Mbretëria serbe pas nënshkrimit të këtyre marrë-

¹²⁷ Ibid, f, 33,

¹²⁸ Shih më shumë: Šeta, F., Reis-ul-Ulema u Bosni i Hercegovini i Jugoslaviji od 1882-1991 godine, Sarajevo 1991 god.

¹²⁹ Rastoder Šerbo, Vakuf u CG krajem XIX i početkom XX vijeka, Rožajski zbornik, br. 8, 1998 god, f. 36,

veshjeve disa herë i ratifikoi, por kurrë nuk i zbatoi në tërësi. Me fjalë të tjera, të gjitha këto “të drejta të mëdha” të myslimanëve Serbia asnjëherë nuk i zbatoi në praktikë.

Organizimi i Bashkësisë Fetare Islame gjatë viteve 1918–1929:

Pas formimit të Mbretërisë SKS për myslimanët filloi një periudhë e vështirë, e cila vlerësohet si periudha më e vështirë e organizimit të Bashkësisë Fetare Islame dhe myslimanëve në përgjithësi. Në këtë periudhë do të vinë në shprehje një numër i madh i dobësive të organizimit të pasurisë së vakëfit. Disa këto vështirësi mundohen t’ia hedhin sistemit të mëhershëm organizativ të Bashkësisë Fetare Islame, por realiteti i paraqitjes të vështirësive duhet kërkuar në ndryshimet e rrethanave pas Luftës së Parë Botërore dhe ndryshimet shpirtërore të cilat seriozisht i kapluan myslimanët e këtyre anëve. Këtë e vërtetojnë edhe organet e Vakëfit–mearif të cilat deri sa udhëhiqeshin nga myslimanët të devotshëm dhe të sinqertë, mirë funksionuan, nuk ishin në shprehje normat dhe rregullat por ishte në shprehje kualiteti i njerëzve.

Kjo situatë u gjet në vitin 1918 në mbretërinë e re të formuar të Serbëve Kroatëve dhe Sllovenëve dhe për një kohë nuk pësoi ndryshime të mëdha. Me formimin e Mbretërisë së Re nuk erdhi deri te formimi dhe bashkimi i një Bashkësie Fetare Islame të të gjithë myslimanëve që përfshiheshin kufijtë e Mbretërisë së Re, por erdhi deri te ndarja historike e myslimanëve jugosllav në, kushtimisht të themi, krahu jugor dhe ai verior i Bashkësisë Fetare Islame. Ashtu që, në një shtet, paralelisht ekzistonin dy bashkësi islame: njëra për Malin e Zi, Serbinë, Kosovën dhe Maqedoninë, në krye të së cilës qëndronte Myftiu me seli në Beograd, dhe e dyta për myslimanët në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Slloveni, Sllavoni dhe Dalmaci, nën udhëheqjen supreme të Reis ul–Ulemasë me seli në Sarajevë.¹³⁰

¹³⁰ Enciklopedija živih religija, Beograd, 1992, f. 306,

Të drejtat të cilat ju garantuan popullatës myslimane në rencën e Paqes që u Mbajt në Versaj, do të aprovohen edhe në Kushtetutën e Vidovdanit të miratuar më 28 Qershor të vitit 1921. Shteti duke pasur konsideratë ndaj myslimanëve, me këtë kushtetutë besimtarëve ju garantohet liria fetare kurse besimet janë të barabarta para ligjit. Besimet–fetë e pranuar tash ju lejohet që t'i rregullojnë obligimet fetare dhe të administrojnë me pasurinë e tyre në kufi me rregullat kushtetuese. Për çështjen e jetës familjare dhe të trashëgimisë të myslimanëve do të vendosin gjyqet e sheriatit.¹³¹

Ekzistimi paralel i dy bashkësive islame në Mbretërinë SKS, nuk ju përgjigjej myslimanëve që jetonin në një shtet, a të organizuar në dy bashkësi. Aspiratat e Bashkësisë Fetare Islame në shtetin e riformuar, haptazi i shpalosi Reis ul–Ulemaja Xhemaludin Çausheviq (D emaludin AUŠEVI) në deklaratën e tij zyrtare me rastin e “an–ketimit fetar” në Nëntor të vitit 1921 në Beograd në organizimin e Ministrisë së feve.

Ai me këtë rast deklaroi se organizimi i punëve të Bashkësisë Fetare Islame, nuk mundë të krahasohet dhe të përdoret asnjë analogji me konfesionet tjera me të gjitha specifikat e islamit. Ai gjithashtu kërko bashkimin e të gjithë pasardhësve të islamit në një organizatë të vetme.¹³²

Struktura organizative në aspektin administrativ e Bashkësisë Fetare Islame në Mbretërinë SKS deri në vitin 1929 ishte e këtillë:

–Kryetari suprem, Reis ul–Ulemaja me seli në Sarajevë për myslimanët në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Slloveni, Sllavoni e Dalmaci, dhe

¹³¹ Zvezdan Folić, Vjerske zajednice u CG 1918–1953, Podgorica, 2001, f. 158,

¹³² Zvezdan Folić, Vjerske zajednice u CG 1918–1953, Podgorica, 2001, f. 159,

– Myftiut Suprem me seli në Beograd për myslimanët në Serbi, Mal të Zi, Kosovë, Sanxhak dhe Maqedoninë dhe disa myftinj të qarkut në disa vende.¹³³

Organizimi i Bashkësisë Fetare Islame gjatë viteve 1929–1941:

Bashkimi i Bashkësisë Fetare Islame në Mbretërinë Jugosllave u themelua pasi që Mbreti Aleksandër më 06 Janar të vitit 1929 me vendosmëri zhvendosi luhatjet e tendosura në mes të centralizmit politik dhe federalizmit, dhe fiksoi atë në seksionin e integruar jugosllav. Me ligjin e Bashkësisë Fetare Islame të 31 janarit të vitit 1930 u caktua sjellja e ligjit për Bashkësinë Fetare Islame në Mbretërinë Jugosllave. Ky ligj siguron sjelljen e Kushtetutës të Bashkësisë Fetare Islame në mbledhjen e përbashkët nën udhëheqjen e kryesisë së reis-ul-ulemasë të të gjithë anëtarëve të dy Ulema-mexhlisave,¹³⁴ të të gjithë Myftive dhe të gjithë anëtarëve të dy gjyqeve të Sheriatit. Sjellja e Kushtetutës do t'i besohet Ministrit të drejtësisë, i cili pas miratimit do t'i dorëzohet Mbretit për verifikim. Sipas kësaj procedure është sjellë Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame të Mbretërisë Jugosllave e cila publikohet në gazetën zyrtare të 25 Qershor të vitit 1930. Me këtë Kushtetutë u themelua Bashkësia Fetare Islame pas të cilit u pezullua organizimi i deriatëhershëm i Bashkësisë Fetare Islame dhe më 9 Gusht 1930 u soll Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame për gjithë Mbretërinë e Jugosllavisë, sipas të cilës myslimanët e Mbretërisë së Jugosllavisë përbëjnë një Bashkësi Fetare me një kryesi të Bashkësisë Fetare Islame në krye me Reis ul-Ulemanë me seli në Beograd. Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame e Mbretërisë Jugosllave përmban 119 nene, e ndarë në katër kapituj dhe atë: Dispozitat themelore,

¹³³ Edah Bećirbegović, Organizacija Islamske zajednice u SFRJ, Sarajevo, 1981, f. 33,

¹³⁴ Ulema Mexhlisi-Këshilli i dijetarëve fetarë, Këshilli drejtues i Bashkësisë Islame,

Organet e Bashkësisë Fetare Islame, administrata dhe financimi dhe dispozitat e përgjithshme dhe kalimtare.¹³⁵

Në sferën e organizimit të Bashkësisë Fetare Islame, Kushtetuta ka sjellë ndryshime të rëndësishme. Skema e re organizative përfshinë organet vijuese: Mexhlisi i xhematit, në krye me Imamin e xhematit; Zyra e Vakëfit–mearif të qarkut, në krye me gjykatësin e shëriatit; Këshilli i Vakëfit–Maerif në Sarajevë dhe Shkup, me Këshillin drejtues të tij; Myftinitë, në krye me myftitë; Ulema–mexhlis në Sarajevë dhe Shkup; dhe, Kryesia supreme fetare, në krye me reisul–ulemanë.¹³⁶

Nga organet e paraparë me Kushtetutën e bashkësisë Fetare Islame do të prezantojmë vetëm disa nga ato:

Mexhlisi i xhematit është i definuar si organ themelor operativ në qarkun e një xhemati të Vakëfit–mearif, e i cili përbëhet prej myslimanëve të një apo të më shumë vendbanimeve në të cilat ka më së paku 300 shtëpi myslimane. Anëtarët e xhematit që kanë mbushur 21 vjet e përbëjnë kuvendin e xhematit. Kuvendi i xhematit zgjedh mexhlin e xhematit, kurse imami, ofiqari kompetent është kryetar i mexhlisit të xhematit dhe kuvendit të xhematit. Mexhlisi i xhematit numëron më së paku pesë anëtarë dhe ky numër në mënyrë progresive rritet, varësisht nga numri i myslimanëve në xhematin përkatës. Anëtarët e mexhlisit të xhematit nuk mund të jenë më të ri se 30 vjet.

Në pjesën e Kushtetutës në të cilën gjenden dispozitat mbi mexhlisin e xhematit është e rregulluar mënyra e zbatimit të zgjedhjeve për mexhlin e xhematit dhe i janë përcaktuar detyrat, mes tjerash edhe që:

¹³⁵ Muhamed Salkić, Ustavi islamičke zajednice, Sarajevo, 1422/2001, f. 83,

¹³⁶ USTAV Islamske vjerske zajednice Kraljevine Jugoslavije, od 9. Jula 1930 god.

–t'i zbatojë vendimet dhe urdhëresat e organeve dhe trupave më të larta fetare dhe të Vakëfit–mearif;

–t'i mbikëqyrë objektet fetare dhe arsimore si dhe objektet tjera të vakëfit;

–ta ruajnë inventarin e pronës së tundshme dhe patundshme;

–të kujdesen për mjetet e nevojshme për mirëmbajtjen e xhamisë dhe mektebit;

–më së paku njëherë në çdo muaj ta kontrollojnë punën e arkës së tyre.¹³⁷

Këshilli i vakëfit–mearif ka këshillin drejtues të vetin, i cili në Kushtetutë është definuar si organ suprem drejtues në të gjitha punët e vakëfit–mearif dhe punët tjera që kanë të bëjnë me pronën. Këshilli drejtues ka shtatë anëtarë nga të cilët njëri është kryetari i Ulema–mexhllisit, e tjetri është drejtori i vakëfit–mearif, kurse pesë të tjerët dhe po aq zëvendës të tyre i zgjedh këshilli nga mesi i vet. Kryetari i Ulema–mexhllisit është kryetar i këshillit drejtues sipas pozitës.¹³⁸

Organet fetare:

Organet fetare me Kushtetutë janë definuar: Muftitë, Ulema–mexhllis dhe Kryesia Supreme fetare me Reisul–ulemanë në krye.

Myftitë si dijetarë (alima) të shquar dhe pari e lartë islame kanë vepruar në vendet për rreth. Selia e myftiut dhe regjioni i myftinisë është përcaktuar me kushtetutë. Në Bosnje dhe Hercegovinë selia e myftiut ka qenë në: Banja Llukë, Tuzëll, Sarajevë dhe Mostar, kurse jashtë Bosnjës dhe Hercegovinës në Plevle, Novi Pazar, Prizren, Manastir dhe Shkup. Detyrat dhe obligimet e myftiut janë theksuar

¹³⁷ Muhamed Salkić, Ustavi islamike zajednice, Sarajevo, 1422/2001, f. 85,

¹³⁸ Ibid, f. 87,

në Kushtetutë dhe gati janë identike me obligimet e myftiut të përfshira në Statut.

Sipas Kushtetutës organi më i lartë pundërejtues—mbikëqyrës për tërë jetën fetare dhe fetaro—arsimore të myslimanëve, i cili ruan dhe paraqet unitetin e Bashkësisë Fetare Islame në Mbretërinë Jugosllave është Kryesia Supreme fetare. Atë e përbëjnë reisul—ulemja dhe kryetarët e dy Ulema—mexhliseve (Sarajevës dhe Shkupit). Selia e Kryesisë Supreme fetare është në Beograd.

Organet regjionale të Bashkësisë Fetare Islame korrespondencën e tyre me shkrim me pushtetin qendror të shtetit, në të dy drejtimet mund ta realizojnë, sipas Kushtetutës, vetëm përmes Kryesisë Supreme fetare. Zyrën e Kryesisë Supreme fetare e përbënë sekretari i cili doemos duhet të ketë të kryer fakultetin juridik dhe numri i personelit të nevojshëm.

Zgjedhja e organeve fetare nuk është e rregulluar me Kushtetutë, por me Ligj të posaçëm shtetëror për zgjedhjen e reisul—ulemasë, anëtarët e Ulema—mexhllisit dhe myftitë. Sipas këtij Ligji trupin zgjedhor për zgjedhjen e reisul—ulemasë e përbëjnë: të gjithë anëtarët e Ulema—mexhllisit në Shkup dhe Sarajevë, të gjithë myftitë, të gjithë anëtarët e gjykatës supreme të sheriatit në Shkup dhe Sarajevë dhe Medreseja e Madhe e Mbretit Aleksandar I në Shkup, shefi i repartit myslimanë pranë Ministrisë së drejtësisë, referenti për fenë islame pranë Ministrisë së ushtrisë dhe marinës dhe ministrat aktiv me përkatësi islame¹³⁹.

Anëtarët e Ulema—mexhllisit zgjedhin trupin zgjedhor të cilën e përbëjnë: reisul—ulema, anëtarët e Ulema—mexhllisit, për të cilin zgjidhet anëtar, myftitë nga regjioni i Ulema—mexhllisit për të cilën zgjidhet anëtar dhe anëtarët e Gjykatës supreme të sheriatit, në te—

¹³⁹ Muhamed Salkić, Ustavi islamike zajednice, Sarajevo, 1422/2001, f. 90,

ritorin e së cilës gjendet selia e Ulema-mexhlsit për të cilin het anëtar.

Myftitë i zgjedh trupi zgjedhor të cilën e përbëjnë anëtarët e Ulema-mexhlsit dhe Gjykatës supreme e sheriatit nga regjioni për të cilin zgjidhet myftiu nën kryesimin e reisul-ulemasë.

Për punët e përgjithshme administrative si dhe administrimin e të gjitha punëve pronësore dhe financiare të Bashkësisë Fetare Islame është themeluar Drejtoria e vakëfit dhe atë në Sarajevë për regjionin e Sarajevës dhe në Shkup për regjionin e Këshillit të Vakëfit-mearif të Shkupit. Në kuadër të Drejtorisë së vakëfit ekziston sektori financiar për kontabilitet i cili merret me të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet dhe administron me të gjitha punët pronësore-llogaritare të Bashkësisë Fetare Islame në territorin e vet. Drejtorinë e Drejtorisë së vakëfit e emëron Këshilli i Vakëfit-mearif. Pronën e Bashkësisë Fetare Islame sipas Kushtetutës e përbënë e gjithë pasuria e tundshme apo e patundshme e Bashkësisë Fetare Islame. Nevojat e veta Bashkësia Fetare Islame i mbulon nga të ardhurat e vakëfit dhe fondeve, të ardhurat nga taksat fetare, kontributeve vullnetare dhe vasieteve (testamenteve), nga ndihma e përhershme e shtetit dhe nga taksat plotësuese fetare.

Kushtetuta prej vitit 1936:

Me përfundimin e diktuarës së gjashtëjanarit të regjimit në Mbretërinë Jugosllave paralajmëroi një situatë më të volitshme për Bashkësinë Fetare Islame. Për këtë kontribut të madh dha qëndrimi i politikanit të shquar mysliman Dr. Mehmed Spahe, i cili hyrjen e JMO-së (organizatës myslimane jugosllave) në koalicionin qeveritar me Stojadinoviçin dhe Koroshecin, e kushtëzoi me revizionin e dispozitave ligjore për pozitën juridike të Bashkësisë Fetare Islame dhe Kushtetutën e saj, kthimin e selisë së reisul-ulemasë prej Beogradit në Sarajevë. E gjithë kjo ndikoi që trupi kompetent i Bashkësisë Fetare Islame më 25 mars 1936 të sjellë Kushtetutë të re të

bashkësisë fetare islame të Mbretërisë Jugosllave, e cila nga mbreti është nënshkruar më 24 tetor, kurse në gazetën zyrtare është shpallur më 5 nëntor 1936¹⁴⁰.

Në kreun “Organet e Bashkësisë Fetare Islame”, përcaktohet emërtimi i organeve i definohet selia e tyre, roli dhe obligimet në organizimin e Bashkësisë Fetare Islame si në vijim: –Mexhlisi i xhemitit; –Zyra e Vakëfit–mearif të qarkut; –Ulema–mexhlisi në Sarajevë dhe Ulema–mexhlisi në Shkup; –Kuvendi i Vakëfit–mearif në Sarajevë dhe Kuvendi i Vakëfit–mearif në Shkup me organet e veta, Këshillat e kuvendit dhe Drejtoritë e vakëfit; dhe, –Reisul–ulema në Sarajevë me këshilltarët e tij të ngushtë dhe të zgjeruar.¹⁴¹

Si organ suprem ligdhënës dhe mbikëqyrës për tërë veprimtarinë e Vakëfit–mearif dhe Drejtorisë pronësore të Bashkësisë Fetare Islame, me Kushtetutën e re është përcaktuar Kuvendi i Vakëfit–mearif. Praktikisht e përbëjnë dy kuvende dhe atë Kuvendi i territorit të Ulema–mexhlisit në Sarajevë dhe Kuvendi i territorit të Ulema–mexhlisit në Shkup.

Sa i përket Ulema–mexhlisit, Kushtetuta e re në mënyrë të saktë i përshkruan organizimin e tij dhe kompetencat territoriale. Kompetencat e Ulema–mexhlisit në Sarajevë përfshinë regjionin e Drinit, Vrbasit, Bregdetit, Savës dhe banovinën e Dravës, pastaj qarkun e Bileçit, Gadaçacit, Dubrovnikut, Lubinit, Nevesinjës, Trebinjës dhe Foçës dhe banovinën e Zetës. Ndërsa, kompetencat e Ulema–mexhlisit në Shkup, përfshinë regjionin e banovinave të Vardarit, Moravës dhe Danubit, rajonin e drejtorisë së qytetit të Beogradit dhe drejtorinë e qarkut të banovinës së Zetës e cila nuk i takon Ulema–mexhlisit të Sarajevës.

¹⁴⁰ Muhamed Salkić, Ustavi islamike zajednice, Sarajevo, 1422/2001, f. 118,

¹⁴¹ Ibid, f. 120,

Sa i përket procedurës zgjedhore regjioni i Ulema–mexhlisit në Sarajevë ndahet në gjashtë qarqe zgjedhore (i Sarajevës, Tuzllës, Banjallukës, Mostarit, Bihaqit dhe Travnikut), ndërsa regjioni i Ulema–mexhlisit në Shkup në tetë qarqe zgjedhore, (i Shkupit, i Tetovës, i Prishtinës, i Prizrenit, Mitrovicës, Manastirit, Plevles dhe Barit).

Faktorët të cilët kanë insistuar që të sillet Kushtetuta e re, shihet qartë se kanë qenë të vetëdijshëm për rolin e arsimimit, edukimit të myslimanëve në Mbretërinë Jugosllave. Për këtë dëshmon i tërë kreu që i kushtohet arsimimit në Kushtetutën e re. Dispozitat kushtetuese mbi edukimin dhe arsimimin islam të myslimanëve është gjithëpërfshirës, janë përmendur dhe definuar të gjitha çështjet relevante të kësaj lëmie. Është definuar termi shkolla fetare, me të cilën nënkuptohet secila shkollë që ka për qëllim mësimin e fesë dhe arsimimin teologjik. Si shkollë fetare islame në Kushtetutë theksohet: Shkolla e lartë e sheriatit–teologjike islame në Sarajevë e cila ka rangun e fakultetit. Medreseja e Gazi Husrev Beut në Sarajevë dhe Medreseja e Isa Beut në Shkup, janë në rangun e shkollave të mesme të plota. Në vazhdim përmendet edhe ekzistimi i medreseve të ulëta të cilat janë në rangun e medreseve të mesme jo të plota, medresetë fillestare, kurse dhe mektebe si shkolla autonome fetare. Kushtetuta gjithashtu vë në dukje se janë edhe shkollat shtetërore, gjimnazi i sheriatit në Sarajevë dhe Medreseja e Madhe e Mbretit Aleksanër I në Shkup, shkollat e mesme me emblemën islame në të cilat përgatiten kandidatë për Shkollën e lartë sheriatit–teologjike islame në Sarajevë dhe në ta në një masë të madhe mësohet mësim–besimi islam, gjuha arabe dhe turke. Harxhimet për mirëmbajtje të këtyre shkollave si dhe të Shkollës së lartë të sheriatit–teologjike islame i mbulon shteti. Harxhimet për mirëmbajtjen e Medresesë Gazi Husrev Beut dhe medresesë Isa Beut, nëse vakëfet e tyre nuk mjaftojnë për financimin e tyre, harxhimet i bartin drejtoritë pronësore të pavarura të Bashkësisë Fetare Islame në Sarajevë dhe Shkup.

Medresetë e ulëta janë definuar si shkolla të mesme profesionale jo të plota, të cilat nxënësve të tyre krahas arsimimit të përgjithshëm u ofrojnë edhe arsimim fetarë në frymën islame, edhe ashtu ata i përgatisin për profesione imam, hatib dhe mualim me honorar.

Medresetë fillestare me Kushtetutë janë të definuar si shkolla në të cilat fitohet arsimimi më i nevojshëm për kryerjen e detyrës e imamit dhe muezinit të fshatit apo të lagjes dhe nëpunësit tjerë të këtij rangu.

Kurset janë forma të arsimimit islam në të cilët mësohet mësim-besimi islam me qëllim të avancimit fetar dhe kulturor të myslimanëve dhe zgjerimin e moralit myslimanë në mes tyre, kurse mejtepet janë shkollat fillestare islame në të cilat mësohet mësim-besimi islam dhe mësohet shkrimi arab. Në çdo vend që është i banuar me myslimanë në hapësirë prej 4 km ka të themeluar një mejtep për fëmijët mysliman.

Administrim dhe mbikëqyrje të medreseve të ulëta, medreseve fillestare dhe mejtepeve bënë Ulema-mexhlisi kompetent përmes organeve të ulëta të veta.

Roli dhe qëllimi Bashkësisë Fetare Islame në realizimin e detyrave dhe obligimeve të saj:

Për rolin dhe organet e Bashkësisë Fetare Islame kemi cekur gati në tërësi rolin dhe detyrat e saj por, në pika të shkurta do të sqarojmë qëllimet dhe detyrat e Bashkësisë Fetare Islame.

Qëllimi i Bashkësisë Fetare Islame është që pjesëtarëve të saj t'ua ruaj dhe kultivojë moralin fetar dhe në mesin e tyre ta përhap atë, e pastaj t'i avancojë në aspektin kulturor. Bashkësia Fetare Islame dhe disa ente të saja kanë cilësinë e personit juridik. Prona e Bashkësisë Fetare Islame shërben vetëm për qëllimet e saj dhe në asnjë mënyrë nga ajo nuk mund të merret e as që mund të përdorët për qëllime të tjera. Me të, në mënyrë të pavarur administron dhe dispozicionon Bashkësia Fetare Islame përmes organeve të veta pronësore-administrative dhe fetare të

themeluara me Ligj dhe Kushtetutën e Bashkësisë Fetare Islame. Shteti ka të drejtën e mbikëqyrësit suprem mbi administrimin dhe dispozicionimin e pronës së Bashkësisë Fetare Islame.

Qëllim kryesor është që ta rruaj dhe ta zhvilloj jetën fetare ndër pjesëtarët mysliman. Organizimin e jetës fetare duhet ta zhvilloj në bazë të normave fetare si dhe në të kuptuarit e islamit sipas të arriturave bashkëkohore, shkencore në frymën islame. Për këtë arsye detyra parësore e organeve të Bashkësisë Fetare Islame është zhvillimi i jetës fetare dhe fetare-arsimore në mënyrën që përfaqësuesit e Bashkësisë Fetare Islame do të forcohen në besimin e tyre i cili do t'u mundësoj që nëpërmjet ritualeve të ndryshme të manifestojnë në mënyrën vetjake ose organizative përkatësinë e tyre islame.

Bashkësia Fetare Islame nëpër mes institucioneve të saja e sidomos nëpër xhamitë si institucione themelore për zhvillimin e jetës fetare dhe fetare-arsimore. Në xhami falen namazet, mbahen ligjërata dhe zhvillohen aktivitete të ndryshme që shërbejnë në përparimin e jetës fetare dhe fetare-arsimore.

Qëllimet e veta Bashkësia Fetare Islame i arrin edhe nëpërmjet mësimeve të ndryshme si dhe shkollimit të nëpunësve fetarë. Njëra nga obligimet kryesore të Bashkësisë Fetare Islame është që nëpërmjet zyrtarëve të sajë mësimin fetarë si për të miturit ashtu edhe për të rritur nëpërmjet të këtij mësimi të barten njohurit themelore të islamit dhe mësimet për ritualet fetare. Pjesën më të madhe të organizimit të jetës fetare dhe realizimit të mësim-besimit fetarë zhvillojnë punonjësit e Bashkësisë Fetare Islame. Njëra nga detyrat e Bashkësisë Fetare Islame është që ti shkolloj nëpunësit e sajë dhe t'i përgatit për kryerjen e detyrave obligimeve fetare të tyre. Kjo arrihet me themelimin e shkollave fetare (mejtepeve, medreseve, fakulteteve islame).

Medresetë janë shkolla të cilat zhvillojnë mësim fetarë të përgjithshëm, fillor dhe të mesëm, kurse Fakultetet Teologjike zhvillojnë arsim fetarë të përgjithshëm të nëpunësve fetarë në nivel

të arritura më të larta bashkëkohore të teorisë dhe praktikës bashkëkohore të interpretimit të mendimeve islame.

Arsimimi fetarë ishte njëri nga obligimet parësore të Bashkësisë Fetare Islame, për të cilën vetë vendoste. Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane në këto vende ekzistofshin vetëm shkollat fetare. Në Maqedoni përveç xhamive kishte edhe një numër të madh të mejtepeve, që luanin rolin e shkollave fillore.

Përpjekjet për arsimin fetar të myslimanët e këtyre vendeve, në këtë kohë i jepej rëndësi e veçantë e cila konsiderohej gjë e shenjt dhe i jepej një përkrahje e madhe nga popullata myslimane. Popullata myslimane e këtyre trevave për kohën vazhdonte mësimet e tyre nëpër shkollat shtetërore, shkolla këta ku përveç lëndëve shoqërore mësonin edhe lëndën e mësim-besimit.

Me formimin e Mbretërisë SKS, Ministria e arsimit e mbikëqyrte shkollimin, kurse Bashkësisë Fetare ju mundësoi të hapin shkolla fetare si dhe zhvillimin e lëndës së mësim-besimit nëpër shkollat shtetërore. Me sjelljen e Kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame në vitin 1930 dhe vitin 1936, kjo çështje u rregullua në bazë të akteve normative dhe rregullave të cilat miratoheshin nga organet kompetente.

Ulema Mexhlisi u përcaktua organ kryesor për arsimin fetarë. Ai përcakton dhe përpilon plan-programe për shkollat fetare, përcakton mual-limët (mësuesit) për shkollat fetare, mbikëqyrë dhe kontrollon punën e tyre, bën propozimin e mësuesve të mësim-besimit nëpër shkollat shtetërore dhe kontrollon punën e tyre.

Myftinia e rrethit e zbaton plan-programin të cilin e ka sjellë Ulema Mexhlisi, kurse Kryesia supreme e miratonte të njëjtin.

Përfundim

Periodhat në të cilat do të kalitej organizimi i Bashkësisë Fetare Islame, mundë t'i ndajmë në tri më kryesore:

– Periudha pas shpartallimit të Perandorisë Osmane;

– Periudha gjatë viteve 1918–1929, dhe

– Periudha gjatë viteve 1929–1941.

Periudha gjatë shpartallimit të Perandorisë Osmani është faza e parë e cila njihet si periudhë në të cilën fati i myslimanëve dhe Bashkësisë Fetare Islame do të përcaktohet nga marrëveshjet ndërkombëtare, konferencat e paqes.

Periudha gjatë viteve 1918–1929 është faza e dytë e cila njihet me emrin Mbretëria e SKS, për myslimanët kjo periudhë do të jetë periudha më e vështirë, periudhë kjo e cila për Bashkësinë Fetare Islame sipas disave mendohet periudha më e vështirë e organizimit të Bashkësisë Fetare Islame dhe myslimanëve, periudhë kjo e cila la pasoja në ndryshimet shpirtërore të cilat seriozisht i kapluan myslimanët e këtyre anëve.

Periudha gjatë viteve 1929–1940 është faza e tretë e cila njihet me emrin Mbretëria Jugosllave, gjatë së cilës politika serbe edhe në këto vite sundoi në mënyrë tejet absolute. Ky sundim u reflektua edhe në këto anë, pra në trojet ku popullata myslimane ishte më e përqendruar dhe në numër të madh.

Periudha këto të cilat Bashkësia Fetare Islame dhe myslimanët i kaluan nëpër faza të ndryshme ishin të detyruar që gradualisht të ndryshojnë dhe të adaptohen në veprimet dhe funksionimin e saj. Periudha të cilat gjatë këtyre proceseve popullata myslimane do të humb privilegjet e forcave shpirtërore të arritur gjatë sistemit shumë shekullor të Perandorisë Osmane. Përpjekjet e autoriteteve të shtetit të ri do të ushtrojnë një ndikim vendimtarë në organizimin, përzgjedhjes e menaxhimit dhe administrimit të pronës së vakëfeve dhe kujdesit të rregullimit të popullatës myslimane në vend.

Duke filluar nga detyrimet e pranuar nga ndërkombëtarët, aktet kushtetuese dhe ligjore të shtetit të ri për të vendosur barazinë e plotë të Islamit, Bashkësia Fetare Islame si një formë organizative të kësaj feje, i dha mundësinë ngadalë pa e kontrolluar qeverisjen dhe me kalimin e kohës të intensifikoj jetën fetare në të gjitha sektorët. Para Luftës së Dytë Botërore, nëpërmes angazhimit të partive politike me frymë islame, të cilat janë bërë faktorë i rëndësishëm politik, i cili është përfshirë në mënyrë aktive në zgjedhjen e rëndësishme për të ardhmen e vendit dhe të rajonit. Por, pa marrë parasysh rrethanat dhe situatën kaotike gjatë kësaj periudhe, organet e Bashkësisë Fetare Islame nuk do të qëndrojnë duarkryq, por do zhvillojnë një aktivitet të bujshëm pa mos kursyer as vetveten e tyre në ngritjen dhe zhvillimin e arsimit dhe shkollave gjatë tërë etapave historike në Shkupi me rrethinë, dhe ideale të larta për ngritjen kulturo-arsimore dhe fetare të popullit mysliman të këtyre trevave.

ADNAN ISMAILI

Universiteti Shtetëror i Tetovës – Filologji Orientale

ZHBËRJA E IDENTITETIT ISLAM NË SHKUP – 90 – vjetori i rrënimit të xhamisë Burmali –

Në vitin 2014 u bënë 90 vjet qëkur pushteti i Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve e Sllovenëve (në vitin 1924) e filloi rrënimin e simbolit rreth 5-shekullor të Shkupit – xhaminë Burmali. Dhe, kjo datë sa është e dhimbshme në vetvete, po aq është e rëndësishme, sepse ajo shënon kulmin e kulturocidit dhe islamofobisë në Shkup (dhe, përgjithësisht në Maqedoni), nga e cila nuk janë liruar as gjerat e sotme të politikanëve në Maqedoni.

Pak histori

Nga zbulimet arkeologjike, Shkupi (me emrin Scupi) përmendet qysh në kohën e neolitit, ndërsa në histori e ka regjistruar historiani romak Tit Livi në shek. I p.e.s.¹⁴², kur ishte i populluar nga fisi ilir i dardanëve, madje ka shërbyer si kryeqendër e Dardanisë deri në shekullin e parë të erës sonë. Meqë në vitin 518 në Shkup ndodhi një tërmet katastrofal, që e shkatërroi plotësisht Scupin, atë e rindërtoi Perandori bizantin Justiniani I (i cili sipas disa historianëve ka qenë i lindur në afërsi të Scupit), dhe e quajti Justiniana Prima. Në këtë kohë u ndërtuan plot kisha, bazilika etj. Në shek. VII në Shkup erdhën sllavët, ndërsa më vonë qyteti u sulmua nga normanët, bullgarët dhe, deri në ardhjen e osmanëve, u sundua nga serbët.

Më 6 janar 1392 Shkupin e morën osmanët në udhëheqjen e Jigít Pashës. Dhe, deri në vitin 1912 (plot 520 vjet) ai ishte nën mbrojtjen osmane. Gjatë kësaj kohe këtu u ndërtuan shumë xhami, saraje,

¹⁴² Për këtë pjesë, shih: Millan Mijalković dhe Katarina Urbanek, Shkupi – bastardi i botës (Arkitektura e qytetit të ndarë), GOTEN, Shkup, 2011, fq. 44-45.

hamame, hane, ura, çezme, u ngrit Çarshia, etj. Mes tjerash, kah fundi i shek. XIX Shkupi ka shërbyer edhe si kryeqytet i Vilajetit të Kosovës. Por, në periudhën osmane shënohen dy dëmtime të mëdha për qytetin: më 1555 ndodhi një tërmet tjetër po ashtu katastrofal, dhe në vitin 1687 gjenerali austriak Pikolomini, në shenjë hakmarrjeje ndaj osmanëve, ia vuri flakën Shkupit, me çka pësuan jo pak objekte të rëndësishme të Shkupit.

Pas ikjes së osmanëve Shkupin e morën përsëri serbët dhe Mbretëria Serbe (që më pas u quajt Mbretëria e Serbëve, Kroatëve e Sllovenëve dhe nga viti 1929 Mbretëria e Jugosllavisë) sundoi me qytetin deri në Luftën e Dytë Botërore. Gjatë kësaj kohe u bënë plane shumë të dëmshme urbanistike për Shkupin, siç do të shohim nga disa dokumente që do t'i prezantojmë më poshtë, ndërsa nga 140 xhami që i kishte llogaritur Evlija Çelebija në udhëpërshkrimet e tij, në vitin 1933 kishin mbetur vetëm 20 të tilla, nga të cilat një e treta nuk punonin.¹⁴³ Ky është dëmtimi më i madh që i është bërë kulturës islame në Shkup më shumë se kurdoherë tjetër dhe kështu ka ndodhur në histori vetëm në inkuizicionin spanjoll. Në këtë periudhë u rrënua edhe xhamia “Burmali”, që kishte qenë objekti i parë i ndërtuar (shek. XV) kurdoherë në anën e djathtë të Shkupit.¹⁴⁴

Deislamizimi i Shkupit vazhdoi edhe pas Luftës së Dytë Botërore, kur projektin e filluar nga Jugosllavia e parë, e vazhdoi RSFJ-ja, duke rrënuar xhami e objekte të kulturës osmane deri edhe në vitin 1989 (në këtë vit u rrënua xhamia e Faik Pashës – që ka qenë pranë Bankës Popullore të Maqedonisë – në anën e djathtë të Vardarit).

Në këtë drejtim mund të përmendim edhe se në vitin 1912 Shkupi kishte shumicë absolute myslimane: 40.000 myslimanë (shumica

¹⁴³ Насуф Гагичевик, Муслиманске старине у Скопљу, Arkivi i Qytetit të Shkupit, K. 159 пр. 142/832-1104, Shkup, 1933, fq. 4.

¹⁴⁴ Millan Mijallković dhe Katarina Urbanek, Shkupi – bastardi i botës (Arkitektura e qytetit të ndarë), GOTEN, Shkup, 2011, fq. 45

shqiptarë dhe turq) dhe rreth 4.500 sllavë,¹⁴⁵ ndërsa sot shqiptarët (bashkë me turqit) nuk përbëjnë as 25 % të Shkupit. Ky ndryshim demografik i gjendjes në Shkup ndodhi veçmas pas tërmetit të vitit 1963, kur autoritetet komuniste “u kujdesën” që “ta pastrojnë” Shkupin nga elementi islam dhe të sjellin sa më shumë kolonë nga Maqedonia Lindore.

Tani kryeqyteti shtrihet në 575 kilometra katrorë gjerësi dhe 40 kilometra gjatësi.

Xhamia “Burmali” dhe identiteti islam i Shkupit

Xhamia “Burmali” deri kah viti 1873¹⁴⁶ (kur u ndërtua stacioni hekurudhor) ka qenë objekti i vetëm i ndërtuar në anën e djathtë të Vardarit në pjesën e sheshit të Shkupit. Ajo, sipas autores Lidija Kumbaraxhi–Bogoeviq, ka përfunduar së ndërtuari në fund të vitit 1495. Xhamia është ndërtuar nga Mehmed beu, ndërsa ka qëndruar në sheshin e Shkupit deri në vitin 1925 kur ajo rrënohet nga push-teti serb. Është quajtur “Burmali” për shkak të formës së minares, që i ngjante burmës.¹⁴⁷

Arsyja e rrënimit të xhamisë, sipas disa dokumenteve që i kemi gjetur në Arkivin e Qytetit të Shkupit, ishte plani urbanistik i qytetit, që në atë vend parashikonte të ndërtojë një Pallat të Oficerëve. Kështu sipas proces-verbalit të 1 marsit të vitit 1925 nga mbledhja e Qytetit të Shkupit, thuhet se trualli i xhamisë Burmali i jepej Ministrisë së Ushtrisë dhe Marinës për ndërtimin e Pallatit të Oficerëve¹⁴⁸. Aty shpjegohet se ai truall ishte ekspropriuar tashmë nga Qyteti i Shkupit, që ashtu të mundësohet fillimi i punimeve për

¹⁴⁵ Shih: *Dëshmi për Shkupin shqiptar (dokument)* – përgatiti: Skender Asani, Shoqata e Historianëve Shqiptarë, SHB “Shkupi”, Shkup, 2011, fq. 20

¹⁴⁶ Millan Mijallkoviç dhe Katarina Urbanek, Shkupi – bastardi i botës..., fq. 45

¹⁴⁷ Shih: Лидија Кумбараџи-Богоевиќ, *Османлиски споменици во Скопје*, ИВЗ, Скопје, 1998, fq. 102-103

¹⁴⁸ Записник вонредне седнице одбора Општине града Скопља, одржана на дан 1 марта 195 године, Архиви i Qytetit të Shkupit, kutia 34, dokumenti nr. 823.

ndërtimin e Pallatit të Oficerëve. Në këtë dokument shpjegohet se hapësira që i merrej Burmalisë ishte 1.580 metra katrorë, kur përveç objektit binin edhe varrezat dhe tyrbja e xhamisë, që po ashtu u rrënuan dhe u shkatërruan. Arsyeja e këtij vendimi, që i referohet vendimit të Gjykatës nr. 10.540 të datës 08.12.1924¹⁴⁹ për rrënimin e plotë (rrënimi i saj kishte filluar më herët) të xhamisë dhe dhënien e truallit për Pallatin e Oficerëve, shpjegohet me nevojën që ushtrisë serbe t'i bëhet një nderim i madh që ka pasur në “çlirimin e Shkupit”.¹⁵⁰ Megjithëse nuk tregohet vendimi i Qytetit të Shkupit, është për të ardhur keq që këtë proces-verbal e kanë nënshkruar edhe katër myslimanë: Haki Morina, Mehmed Selim, Mehmed Ali Emin, Abdul Kadri H. Rauf. Nga këto dhe dokumente të tjera që i kishim në duar kuptohet se rrënimi i xhamisë ishte filluar në vitin 1924, porse rrënimi i saj ka përfunduar në vitin 1925. Prandaj edhe Lidija Kumbaraxhi dhe shumë studiues të tjerë e konsiderojnë vitin 1925 si vit të rrënitit të xhamisë.

Në kuadër të kësaj ironie të fatit të kësaj xhamie është edhe dokumenti i kësaj kutie me nr. 821–822, ku shpjegohet se sipërfaqja e xhamisë ka qenë 359,58 metra katrorë, e cila “për të mira të përgjithshme” i merret xhamisë dhe i jepet Qytetit të Shkupit, që pastaj ky i fundit t’ia dhurojë Ministrisë së Ushtrisë dhe Marinës. Aq më shumë, që në fund të këtij dokumenti “kërkohej” nga Këshilli i Xhamisë që vetë ta rrënojë xhaminë ose, në të kundërtën, vetë Qyteti i Shkupit do ta bënte këtë. Ndërkaq, shpenzimet rreth rrënitit do t’i merrte Qyteti i Shkupit.¹⁵¹ Në këto dokument jepen detaje edhe të dëmshtëpërlimit që shteti do t’ia bënte komunitetit mysliman për këtë.

¹⁴⁹ Суду Општине града Скопља, Arkivi i Qytetit të Shkupit, kutia 34, dokumenti nr. 515-516.

¹⁵⁰ Записник вонредне седнице одбора Општине града Скопља, ... по ату.

¹⁵¹ Arkivi i Qytetit të Shkupit, kutia 34, dokumentet nr. 821-822 të dates 18.06.1924.

Nga informacionet që i na jep edhe Kumbaraxhi–Bogoeviq, tohet se atëbotë ka pasur edhe reagime për këtë vendim. Kështu, sipas saj, ishte ndaluar botimi i gazetës “Hak” pikërisht për shkak se aty ishte botuar një reagim kundër rrënimit të Xhamisë¹⁵².

Sido që të jetë, në vitin 1925 (90 vjet më parë) xhamia “Burmali” u rrafshua me tokë dhe mbi atë truall u ngrit Pallati i Oficerëve, i cili qëndroi aty deri në vitin 1963, kur në tërmetin e Shkupit u rrënuar dhe trualli ka qëndruar i zbrazët deri në vitin e kaluar, kur në atë vend është dhënë leja për ta ndërtuar një objekt, që duhet ta kthejë imazhin e Pallatit famëkeq të Oficerëve. Pas disa reagimeve spontane të OJQ–ve të vendit dhe heshtjes së Bashkësisë Fetare Islame, xhamia “Burmali” gjithnjë e më shumë po hiqet nga kujtesa e shkupjanëve dhe nga identiteti i Shkupit.

Në të vërtetë, prej kësaj xhamie në Shkup kanë mbetur vetëm disa relikte: 4 shtylla, 5 kapitela më dekorim stalaktit dhe 4 baza të profilizuara, që gjenden në Parkun e Qytetit dhe shërbejnë në kuadër të dekorit të hortikulturës së këtij parku. Pra, autoritetet nuk kanë lejuar as vendosjen e një pllake aty ku dikur ka qenë xhamia, me çka është dëshmuar se ata janë vetëm zgjatim i asaj që ndodhi në Shkup para Luftës së Dytë Botërore.

“Shkupi 2014” – vulosja e projekteve serbe

Siç tashmë është e njohur, në shkurt të vitit 2010 në Maqedoni u prezantua publikisht projekti i ri i Qytetit, i quajtur “Shkupi 2014”. Ky plan parashikonte një spektër të gjerë të intervenimeve të pazakonshme, siç janë porta triumfale, lapidaret, shatërvanët, më shumë se njëqind skulptura, muze nacionale, arkiv, kisha, përmendore, si dhe garazhe shumëkatëshe dhe qendra tregtare. Projekti u quajt “Shkupi 2014”, sepse autoritetet kishin planifikuar që ai të përfundonte në vitin 2014. Pos tjerash, ky projekt nënkuptonte edhe

¹⁵² Vep e cit., fq. 102

ngritjen e shumë skulpturave, që me to të krijohej një identitet i ri i Shkupit. Natyrisht epiqendra do të ishte skulptura e Aleksandrit të Maqedonisë (Lekës së Madh), që u vendos në një lartësi prej 22 metrash në mes të sheshit “Makedonija” – pikërisht përballë vendit ku dikur ishte xhamia Burmalit. Dhe, kjo bëhej, sipas Pasko Kuzmanit – arkeolog dhe ish drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore me arsyen se: “Maqedonia mund ta mbrojë emrin [nga Greqia] vetëm nëse dëshmon se populli maqedonas ka rrënjë klasike antike”¹⁵³.

Megjithatë nuk është vetëm antikizimi ai që bie në sy në këtë projekt. Aty vërehen qartë edhe dy elemente shumë të rëndësishme: deislamizimi dhe serbizimi. Për faktin e parë njafton refuzimi kategorik që iu bë xhamisë “Burmalit”, ndërsa për të dytin ka një sërë simbolesh.

Sa i takon islamofobisë së këtij projekti, mund ta cekim se në kuadër të këtij projekti u parashikua kisha “Shën Konstantini dhe Elena”, që tash po ndërtohet në rrugën kah stacioni i vjetër i trenave, megjithëse ajo kishë nuk ka qenë kurrë aty ku është. Ajo ka qenë e vendosur së paku 150 metra larg sheshit¹⁵⁴ dhe është rrënuar gjatë tërmetit të Shkupit. Pastaj, në frymë të këtij argumentimi është edhe shfytërimi i Urës së Gurit dhe i mihrabit të saj. Siç dihet mirëfilli, deri në tërmetin e vitit 1963 në Urën e Gurit – në mihrabin e saj, qëndronte mbishkrimi osman, që fliste për historinë e ndërtimit të urës. Pas dëmtimit të mihrabit, pllaka u zhduk, ndërsa në vitin 2002 gjithë mihrabi u rrëzua. Ndërkaq tash, kur është ngritur mihrabi i ri, ai më as nuk quhet mihrab, ndërsa në mbishkrimin e tij është shkruar se ai objekt është një “Kullë roje”. Kështu u tjetërsua Ura e Gurit. Për këtë shkrimtari Kim Memeti në veprën shumë të rëndësishme me titull “Shkupi” do të shprehet kështu: Urës së Gurit, që ishte kronikë e saktë e kohës, ata ia zhveshën

¹⁵³ Millan Mijalkoviç dhe Katarina Urbanek, Shkupi – bastardi i botës..., fq. 80.

¹⁵⁴ Millan Mijalkoviç dhe Katarina Urbanek, Shkupi – bastardi i botës..., fq. 83.

“ferexhenë” orientale, që të jetë sa më “evropiane”, e tillë siç mundohen të bëjnë tërë Maqedoninë e sotme.”¹⁵⁵ Në frymë të kësaj islamofobie është edhe ndërtimi para disa viteve i Kishës së Shën Mërisë përballë gjykatës, ndërsa as nuk përmendet që në cepin para Gjykatës Themelore II deri në vitin 1975 ka qenë xhamia e Jelen Kapanit. Siç mund ta shohin shkupjanët, në vendin e kësaj xhamie tash është vendosur njëra nga përmendoret e shumta të këtij projekti famëkeq.

Për qëllimin antiislam të këtij projekti pajtohen edhe autorët e ciktuar Mijallkoviq dhe Urbanek, që e thonë hapur se: “Rikonstrukcioni në qendrën e qytetit synon ta dëshmojë lidhshmërinë e këtij qyteti me qytetin evropian, të krishterë dhe borgjez, të cilin Shkupi kurrë nuk e ka pasur më parë – ndërsa kështu synohet të mohohet e kaluara e tij orientale, myslimane.”¹⁵⁶ Madje, siç dihet, me idenë se secili qytet evropian ka objekt kishtar në sheshin kryesor, Ministria e Kulturës në vitin 2008 shpalli konkurs arkitektonik për të ngritur një kishë ortodokse që sot është pikërisht kisha “Shën Konstantini dhe Elena”.¹⁵⁷

Në lidhje me qasjen antiislame të arkitektëve në Shkup Kim Memeti thotë: “Këtë, deri diku, ajo Evropë e bën edhe sot, prandaj bëhet se nuk i dëgjon ankesat e shqiptarëve kur thonë se qarqet maqedonase e deshqiptarizojnë Shkupin e tyre, se Shkupit të tyre i zhvishet veshja vendore shqiptare, por edhe ajo orientale, duke dashur që ai të deislamizohet, dhe atij i vishen rroba sllave e ortodokse, të cilat janë bërë pjesë e veshmbathjes së tij në shekujt e vonshëm, por kurrë nuk kanë qenë e vetmja mbulesë që këtë qytet e ka mbajtur ngrohtë.”¹⁵⁸

¹⁵⁵ Kim Mehmeti, SHKUPI, Logos-A, Shkup, 2011, fq. 129

¹⁵⁶ Po, aty.

¹⁵⁷ Po aty, fq. 87.

¹⁵⁸ Kim Memeti,, fq. 70.

Ndërkaq lidhshmëria e këtij projekti me periudhën serbe të luftës së Dytë Botërore mund të vërehet në këto dimensione: kthimi i Teatrit Nacional, që ka qenë i ndërtuar në atë periudhë dhe është rrënuar në tërmetin e vitit 1963, dhe kthimi i Pallatit të Oficerëve. Kjo i bie se aty ka vend për ortodoksi, për serbizim, por jo edhe për elemente islame, osmane ose shqiptare. Shto këtu edhe përmendoren e Car Dushanit, që është bërë pjesë e këtij dekori, dhe krejt mozaiku bëhet i plotë. Të përkujtojmë se në periudhën serbe u zhvillua pikërisht një projekt i këtillë: u ngrit Stacioni i ri Hekurudhor (1938) në stilin neoklasicist, pra në kundërshtim me arkitekturën osmane,¹⁵⁹ dhe u rrënuan dhjetëra xhami që kështu të realizohej ai plan.

Ndërkaq në kohën tonë u pengua ndërtimi i Burmalisë, i Ibni Pajkos, i xhamisë së Faik Pashës, ndërsa u antikizua dhe u serbizua gjithë ajo pjesë e qytetit, krejt kjo duke e përjashtuar elementin islam dhe shqiptar prej epiqendrës së Kryeqendrës.

Përfundim

Marrë në përgjithësi, nga gjithë kjo që u tha më sipër, lirisht mund të përfundohet se pas largimit të osmanëve, Shkupi në vazhdimësi ka vazhduar të tjetërsohet. Periudhën e parë të këtij tjetërsimi e ka pasur para Luftës së Dytë Botërore, kur është filluar me projektin e deislamizimit e deosmanizimit të tij, ndërsa kjo ka vazhduar edhe pas Luftës, madje vjen deri në ditët tona, kur ky invazion antiosman e antiislam po vulozet përfundimisht.

Për këtë Kim Memeti në veprën e cituar do të thotë: “Shkupi i Maqedonisë demokratike, me asgjë nuk do t’u ngajë “shkupave” të mëparshëm, ngaqë atë do ta stolisë kryqi gjigant ortodoks i vënë mbi malin Vodno, si dhe dhjetëra kishat e ndërtuara rreth qendrës së tij, së bashku me dhjetëra përmendore të ngritura në afërsi të

¹⁵⁹ Millan Mijallkoviç dhe Katarina Urbanek, ..., fq. 46.

Kalasë dhe Urës së Gurit, thuajse vetëm sa për t'ia zhveshur këtë qyteti veshmbathjen shqiptare si edhe atë orientale që e laë pas vetes turqit.”¹⁶⁰

Nëse sot në Shkup parakalon një i huaj që nuk e di këtë histori, lirisht mund të konkludojë se ky qytet mund të jetë një kiç kinez me barok evropian, mund të konkludojë se është një qytet antik i karikaturuar në bashkëkohësi, mund të konkludojë se është një reprizë e bezdisshme serbe pas gati një shekulli, por askush nuk mund të gjejë më asnjë gjurmë në sheshin e Shkupit që këtë qytet mund ta identifikojë me një të kaluar 5-shekullore islame e osmane. Kështu në 90-vjetorin e rrënimit të xhamisë “Burmali” Shkupi e ndryshoi përfundimisht imazhin e tij.

Për fat të keq, ata ia dolën dhe ne pësuar.

¹⁶⁰ Vep e cit., fq. 99

NAIM HALIMI

ITSHKSH – Shkup

REFORMA AGRARE – KOLONIZUESE NË QARKUN E SHKUPIT, NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Shkupi me rrethin e tij, sikur shumë vise tjera shqiptare në Maqedoni, në Kosovë, në Luginë të Preshevës e në Mal të Zi, në fund të Luftës së Parë Botërore, ranë përsëri nën sundimin e pushtuesve të vjetër, tani të ri, të Serbisë e Mal të Zi.

Sunduesit e vjetër – të rinjë, planet e vjetra i vazhduan në rrethana të reja. Tokat e ripushtuara të shqiptarëve, ndryshe nga Mali i Zi, për t'i sunduar më lehtë, Serbia i ndau në 10 qarqe, në dhjetëra rrethe dhe në qindra komuna të vogla e të mëdha. Një ndarje të tillë, një optim administrativ, e bëri edhe në Shkup me rrethinë. Nga Shkupi me rrethinë krijoi Qarkun e Shkupit me 3 rrethe, 61 komuna e 249 fshatra.

Burimet e kohës flasin se në këtë zonë të banuar me shumicë shqiptare, qendër e lëvizjes kombëtare–shumvjeçare, me rrugë kryesore, fusha pjellore e vise malore, me ujëra, me klimë të butë e tokë pjellore, Serbia kishte planifikuar ngritjen e një kolonie sllave–serbe, si Beogradi, “Beogradin II”, nga ku do të sundoheshin tërë viset e jugut, siç i quanin ata Serbia Jugore. Kuptohet, kjo duhej të ndodhte pasi të bëhej kolonizimi, të ndryshohej përbërja e popullsisë në favor të popullsisë sllave, serbe, e në dëm të asaj shqiptare, dhe të shuhej lëvizja e tyre kombëtare.

Për realizimin e këtij qëllimi, kolonizimin e kësaj treve, qarqet sunduese serbe të Beogradit, angazhuan gjithë aparatit shtetëror, hartuan ligje e nënligje, shkresa e urdhëresa, në parlament (skupsh–

tinë), në qeveri e në organe tjera, madje në Shkup (më 1920), krijuan edhe Drejtorinë e Lartë të Reformës Agrare, me organe e nëpunës të saj, në përbërjen e të cilës u ngritën drejtori agrare të qarqeve, të rretheve e të komunave. Si për qarqet tjera edhe për atë të Shkupit, u formuan komisione të rretheve dhe ato komunale me këshillat këshilldhënës, që këshillonin e mësonin se si, kur dhe ku duhej zbatuar reforma agrare–kolonizuese. Në shërbim të këtij qëllimi, në Shkup u krijua edhe „Bashkësia agrare”.

Në shërbim të reformës, u vunë edhe Ministria e Drejtësisë, organet e ndryshme gjyqësore, Ministria e Financave, Ministria e punëve të Brendëshme, Ministria e Ushtrisë dhe Detarisë, Ministria e punëve të Jashtëme, e Komunikacionit, e Ndërtimtarisë, e Politikës Sociale dhe e Shëndetësisë, Dogana Shtetërore, etj.¹⁶¹ Zbatuesit e reformës, madje edhe studjuesit e saj, provojnë dhe dëshmojnë se pasuritë e shqiptarëve, toka e shtëpitë, ishin qëllimi kryesor i kolonizimit. Sipas tyre, ky proces u krye në tri faza: e para 1918–1920, e dyta 1920–1934 dhe e treta 1934–1941.

Në fazën e parë, kolonizimi u bë pa u bazuar fortë në ligje. Para terrorit shtetërorë shumë pronarë shqiptar, të mëdhenj e të vegjël, e humbën tokën, shtëpinë e pasurinë që kishin, dhe u detyruan të shpërnguleshin. Kjo ndodhi sidomos në qytetin e Shkupit, ku kolonët ardhacakë vunë në dorë mbi shtëpitë e pasuritë e shqiptarëve të shpërngulur me dhunë në vende tjera, sidomos në Turqi dhe në Shqipëri. Madje këta kolonë shumë prej të cilëve nuk ishin njerëz të tokës, kurrë nuk ishin marrë me bujqësi, merrnin tokë edhe në

¹⁶¹ Agrarna reforma-uredbe,naredbe i zapisi. Zagreb, 1928, f.10-15. Aleksanrar Apostolov, Kolonizacija na Makedonija vo stara Jugoslavija, Skopje, 1966,f.39-40. AQSH. Fondi 151,viti 1932,dos.42,fl.6-10. Milovan Obradoviq, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovo 1918-1941,Prishtinë,f.104. Gjorgje Krstiq, Kolonizacia na juzhnoj Serbiji,Sarajevo,1928,f.7. Marenglen Verli,Reforma agrare kolonizuese në Kosovë,Tiranë,1992,f.30. AQSH.Fondi 251,viti 1921, dos. 93.fl.18-26. Shembuj mbi grabitjen dhe abuzimet e nëpunësve agrarë në rrethinen e Shkupit.

rrethinat e qytetit, e meqë nuk dinin t'i punonin, ua jepnin me qira të tjerëve, duke nxjerrë prej saj jo pakë përfitime.

Në fazën e dytë, kolonizimi qe edhe më i vështirë për shqiptarët. Shqiptarëve iu morën pasuritë, pos në qytet edhe në pikat strategjike, vendet më të mira rreth qytetit, rrugëve kryesore, udhëkryqeve, pronat kolektive, meratë, pronat e shqiptarëve kryengritës e parisë të arratisur, “kaçakëve”, siç i quanin ata, pronat e atyre që nuk kishin dokumente pronësie, por edhe të atyre që kishin, e nuk ua njihnin për shkaqe të ndryshme edhe për atë se ishin përfshirë brenda komplekseve të krijuara për kolonizim, etj, etj.

Faza e tretë e reformës agrare, përfshinë kohën e spastrimit etnik të viseve shqiptare, pa zgjedhur forma, mjete e metoda. Në këtë kohë Qeveria e M.Stojadinoviqit, angazhoi po thuaj tërë shtetin duke mos lënë anash as institucionet shkencore të hartonin projekte për spastrimin e viseve shqiptare, për zvogëlimin në minimum të numrit të shqiptarëve e të rritjes të elementit sllav, sidomos serbë. Nga kjo kohë, Shkupi u bë dhe mbeti qendër e goditjes së reformës agrare dhe shpërnguljes së shqiptarëve për Turqi, për t’u lëshuar vend kolonëve ardhacakë. Në këtë kohë, me e pa letra pronësie (tapi), shqiptarëve me dhunë iu mor toka e pasuria, madje edhe oborri e shtëpia. Shumë fshatarëve iu mor edhe drithi pa korrë në ara. Qëllimi i kësaj politike agrare ishte që serbët të fitonin pasuri e pozita mbizotëruese edhe në trevën e Shkupit, ndërsa shqiptarët të detyroheshin të nënshtroheshin, të asimiloheshin dhe të shpërnguleshin.

Shpronësim arbitrar e të dhunshëm pësuan jo vetëm se pasuritë individuale, tokat, shtëpitë, mullinjtë, depot e dyqanet e tregtarëve e të zejtarëve në Çarshi, por edhe konaqet e Vilajetit të Kosovës me objektet përreth, qendra të Lëvizjes Kombëtare, ku shumë kohë, shumë ngjarje nisën, u zhvilluan dhe përfunduan aty, u plaçkitën e u shitën, madje ngjashëm pësuan edhe institucionet fetare shqiptare, myslimane e katolike, ndërsa ato sllave u rritën e u pasuruan. Kështu u shpronësuan varrezat myslimane – shqiptare të Shkupit, u

rënua Burmali Xhamia, mbi të cilën u ndërtua Shtëpia e Oficerëve, u konfiskua e gjithë pasuria e Gazi Mustafë Pashës, që për ç'do ditë ushqente nga 200 varfënjakë. Ngjashëm u veprua edhe me qendrat tjera bamirëse. Asnjë institucion fetar e kombëtar i shqiptarëve në Shkup nuk mbet i gjallë, shkruante asaj kohe gazeta “Shqipëria e Re”, duke u ndaluar edhe qelesnja, plisi i bardhë, krenaria e popullit shqiptarë.

Sipas të dhënave jugosllave, shumë kolonistë u përqëndruan edhe në rrethin e Shkupit, ku krijuan 45 koloni, vendbanime, si: Vllahë, Orizarë, Novo Sello, Zllokuçan, Vuçi Doll, Bardovcë, Ormanë, Saraj, Vizbeg, Brazdë, Mirkovcë, Glluvë, Tavglixhe, Maranë, Gorno Lisiçe, Dollno Lisiçe, Lubosh, Zelenikovë, Haraçinë, Pekoshevë, Bujkovcë, Aleksandrovë, Belimbegovë, Hasanbeg, Trubarevë, Stajkovc, Inxhikovë, Dushanovë, Bërnjarcë, Ognjancë, Idrizovë, Jurunlerë, Rashtak, Creshevë, Butel, Gorno Konjare, Sredno Konjare, Shishovë, Katllanovë, Radishan, Centar Skopje, Dollno Vodno, Gorno Vodno, Dollni Nerez, Kisella Voda, Maxhari,... etj.¹⁶²

Në këtë rajon, përveç të ardhurve përfituan edhe elemnti sllav vendas, kryesisht banorët e 10 fshatrave serbe të Karadakut të Shkupit, madje edhe ata që ishin dëshmuar për antishqiptarizëm, siç ishte vojvoda i Velesit, proserbi Vasilie Tërbiqi.

Kolonistët që erdhën në trevën e Shkupit, ishin nga vise të ndryshme të Mbretërisë SKS e të Jugosllavisë, por kishte edhe nga shtete tjera, sepse ligjet ua mundësonin e shteti u ndihmonte, mirëpo kryesisht ishin serbë e malazezë e më pak kroatë, sllovenë, boshnjakë, maqedonas, vllleh, rus, etj. Ardhja dhe vendosja e tyre bëhej

¹⁶²Gjorgje Krstiq, vep.e përm.,f.7-17. Shih edhe hartën e kolonizimit sipas Gj.Krstiqit, deri më 1 nanar 1927. AQSH.Fondi 251, viti 1928, dos. 152, fl.18-22.35-43,45-50. H.Islami, E vërteta mbi shqiptarët në disa vepra antropogjeografike, në „Dituria,nr.1, Prishtinë,1971,f.82. A.Apostollov, vep.e përm.f.120-125. Si e humbën shqiptarët Shkupin shqiptar. „Shqipëria e Re,, Kostancë, 3 qershor 1923.

zakonisht nëpërmjet qarqeve drejtuese, “bashkësive agrare”, mbikqyrëse të Beogradit dhe të Shkupit.

Dokumentet e shumta të kohës, madje jo vetëm ato, flasin se grupet e para që erdhën në Qarkun e Shkupit, kishin përkatësi të ndryshme sociale—klasore—nacionale, e veçanërisht ata shumicë me origjinë serbe, ishin “vullnetarë” të luftërave të mëparëshme, çetnikë, fshatarë të pasur, spekulant tokash, hajdutë e familje hajdutësh e jatakë të tyre, të dënuar e të posaliruar nga burgu, si dhe lloj-lloj aventurierësh e tipash të diskredituar në vendlindjen e tyre. Më vonë, pasurive të Shkupit ua mësynë edhe kolonistë të tjerë, si nëpunës të ndryshëm, deputetë, ministra, oficerë, etj. Se “nëpër koloni ishin vendosur kriminelë, plaçkitës dhe nëpunës, politikanë e tregtarë të dështuar”, dëshmon në shkrimet e tij edhe njohësi i mirë i situatës dhe i plotfuqishmi agrar në Shkup, Gjorgje Krstiqi.

Nga këto dhe dokumente tjera sa e sidoqofshin, shihet se shumë ardhacakë në koloni, nuk u morën kurrë me bujqësi, por u shndërruan në gazdallarë, “agallarë” të rinj. Kjo s’sishte rastësisht, por ishte e bërë qëllimisht, sepse ky element mund të nxiste më lehtë për të terrorizuar e mbajtur nën tension popullsinë shqiptare e myslimane, për të krijuar pasiguri e për t’i shpërngulur sa ma shpejtë. Dhuna dhe arbitrariteti i tyre gëzonin edhe përkrahjen e plotë jo vetëm nga i plotëfuqishmi agrar i lartë i Shkupit, por edhe nga mbreti, qeveria, borgjezia dhe nga një pjesë e mirë e shtresave të ndryshme të popullsisë, ku e shihnin veten dhe interesin e tyre si të privilegjuar.

Si pasojë e saj, popullsia shqiptare u shpronësua në masë dhe u varfërua si asnjëherë më parë. Dhjetëra mijëra shqiptarë u maltretuan, u burgosën, u rrahën e u torturuar, u vranë e u varfëruan dhe u detyruan të shpërngulen. Ekonomia u shkatërrua. Numri i popullsisë shqiptare u zvogëluar. Marrëdhëniet ndëretnike u keqësuan. Përbërja e popullsisë u ndryshua. Kështu, vetëm në Shkup, në vitin 1936 numëroheshin 30 mijë banorë “serbë, jo vendas”, të cilët

përbënin më shumë se 40% të popullsisë së qytetit, deri atëherë të banuar në pjesën më të madhe nga popullsia shqiptare, ndërsa deri në vitin 1941 në periferi të qytetit ishin vendosur rreth 10 mijë veta.

Pavarësisht këtyre ndryshimeve qëllimi kryesor i politikës agrare kolonizuese, nuk u realizua. Popullsia shqiptare fshatare, madje edhe ajo qytetare, nuk u nënshtrua, nuk u shkombëtarizua, qëndroi e ruajti kompaktësinë e vet, madje edhe rezistoi. Regjimi i Beogradit arriti ta zbrisë përqindjen e shqiptarëve në njëfarë shkalle, por nuk ia doli ta përmbysë raportin në favor të pakicave sllave, parasëgjithash asaj serbe. Masiviteti, kompaktësia dhe qëndresa e vendosur e popullsisë shqiptare, veçanërisht e fshatarsisë, e luajti rolin e vet. Për vendastit shqiptarë, kolonistët sllavë pavarësisht nga origjina kombëtare, fetare, sociale e profesionale, qenë dhe mbetën grabitës të tokave të tyre, e të pasurive të tjera të cilat i patën burim jete.¹⁶³

Politikën kolonizuese të terrorit e të dhunës serbe, në fillim e në vazhdim, popullsia shqiptare e kundërshtoi në forma të ndryshme. Shprehja më e pashme e kësaj qëndrese që lëvizja e armatosur nën udhëheqjen e Komitetit MKK dhe e forcave atdhetare të bashkuara me Organizatën Xhemijeti, e themeluar në Shkup, ku pa dyshim merita kishin veprimtarët e kauzës kombëtare, të cilët ditën t'i mbronin interesat e popullit, duke mos e kursyer as jetën.

¹⁶³ M. Obradović, vep. e përm. f. 220-225. Gj. Krstić, pun. i përm. f. 50-60. AQSH. Fondi 251, pa vit, dos. 61, fl. 255-256. AQSH. Fondi 261, viti 1941, dos. 99, fl. 8-10. A. Apostollov, vep. e përm., Tab. mbi rezultatet e kolonizimit. H. Islami, vep. e përm. f. 82-85. AQSH. Fondi 251, viti 1928, dos. 152, fl. 19-21, 38-45, 45-50. Gazeta „Rilindja” Prishtinë, 15 qershor 1990, Intervistë e akademikut kosovar M. Krasniqit. AQSH. Fondi 251, viti 1936, dos. 42, fl. 2. Statistika të Kryekonzullatës së Shkupit. AQSH. Fondi 251, viti 1930, dos. 194, fl. 77, 355. Njoftim i Kryekonzullatës së Shkupit dhe memorandumit i tre klerikve shqiptarë drejtuar Lidhjes së Kombeve të vitit 1930. „Shqipëria e Re”, Kostanc, 5.2.1931, f. 2. Protestë e H. Prishtinës, dërguar Lidhjes së Kombeve. AIH. Dos. A.-VII, 50. Ankime të shqiptarëve të Kosovës. M. Verli, vep. e përm. f. 41-42.

Më vonë, përdorën edhe forma të tjera qëndrese. Përveç protestave kundër organeve të pushtetit, organizuan edhe demonstrata në të cilat kundërshtoheshin vendimet dhe sjelljet e organeve të kolonizimit agrar. Në këtë rast po përmendim vetëm disa prej tyre. Më 2 dhjetor 1933 një delegacion i parisë së Shkupit, i shoqëruar me prijës shqiptarë të viseve tjera, u ankua te mbreti Aleksandër, për arbitraritetin e autoriteteve agrare. Dy vjet më vonë, një delegacion tjetër i përkrahur po ashtu nga shqiptarët e Shkupit, erdhi në Shkup, për të kërkuar ndaljen e shpronësimit të tokës së shqiptarëve. Në vitin 1937 në Shkup e vise tjera, u shpërndanë rreth 300 afishe të shkruara edhe në gjuhën shqipe, që kundërshtonin padrejtësit e reformës agrare ndaj shqiptarëve. Gjatë viteve 1938–39 studentët shqiptarë në Shkup e Beograd, shpërndanë afishe në të cilat dënonin padrejtësit e organeve agrare ndaj shqiptarëve. Në mbrojtje të fshatarëve shqiptarë, reagueshan edhe senatori tetovar Xhafer Sylejmani, deputeti i Gostivarit Kadri Saliu e senatori i Dibrës Mehmet Zllatku. Në janar të vitit 1938, rreth 100 politikanë e përfaqësues të popullit shqiptarë, kuptohet edhe të anës së Shkupit, i dorzuan dy memorandumë kryeministrit Stojadinoviç, duke kërkuar prej tij „të ndalej marrja e tokave të myslimanëve, kuptohet edhe të shqiptarëve, e t’u kthehet ajo e marrë”. Për këtë çështje reagueshan edhe deputetët kosovarë Ferat Draga, Ramë Bllaca e Sherif Voca, si rezultat i së cilës, kryeministri serb, premtoi lëshime, madje përherë të parë si pakicë i përmendi në parlament shqiptarët.

Gjatë kësaj kohe evidentohen edhe disa ndërhyrje të shqiptarëve me ndikim pranë pushtetarëve jugosllavë. Të rëndësishme janë edhe deklaratat e disa senatorëve maqedonas e qeveritarëve boshnjakë, se „ndarja e tokës së shqiptarëve ishte e paligjëshme...”. Lobimi i shqiptarëve dhe marrja e premtimeve nga ministri Stojadinoviç, shkoi deri aty sa Qemal Ataturku, kryetari i Turqisë, nëpërmjet sekretarit Hasan Riza, e njoftoi Ferat Dragën, se do ta pengonte ratifikimin e marrëveshjes turko-jugosllave të vitit 1938, për shpërnguljen e shqiptarëve. Si rezultat i kësaj, regjenti Pavle prem-

toi „ndalimin e marrjes së tokave dhe dëbimin e shqiptarëve në Turqi”, ndërsa kryeministri Stojadinoviq, pranoi formalisht kërkesat që iu paraqitën nga përfaqësuesit shqiptarë.¹⁶⁴ Duke vërejtur reagimet e shqiptarëve në të gjitha shtresat shoqërore, raportet sekrete të shërbimeve jugosllave njohtonin se, nëse vije deri te ndonjë konflikt me përmasa mbarëkombëtare „te shumica e shqiptarëve është ngritur vetëdija kombëtare dhe ndihet dëshira për t’u bashkuar me shtetin amë–Shqipërinë”.

Nga këto të dhëna që u thanë dhe shumë të tjera që kanë mbet pa u thanë, krejt në fund mund të konstatojmë, se Shkupi, ky qytet emnak me shqipen dhe me popullin shqiptar, edhe në këtë kohë përjetoi dhe përballoi dhunën antishqiptare njëzetvjeçare, ruajti emrin shqiptar të popullit, në qytet, madje jo vetëm në qytet, por edhe në rrethin e tij, ruajti shqiptarinë, ruajti emrin shqip dhe shqiptarësinë e vet, dhe sikur qe, edhe mbeti vend shqiptarësh për jetë.

¹⁶⁴ M.Obradoviq, vep. e përm.f.134. A.Apostolov, vep.e përm.f.82. AQSH. Fondi, 846, dos.54, dok.708154, Letër e Fehrat Dragës për Hoxha Kadriun, dt.20.2.1920.AQSH.Fondi 251, viti 1924, dos.101, fl.51. Diskutimi i Ferhat Dragës në Skupshtinë, data 20.3.1924. „Liria Kombëtare” Gjenevë, 1 janar 1928, f.4. 1928, f.4. Memorandumi i 24.1. 1938, i firmosur nga 20 delegat të Kosovës e Maqedonisë dhe komentet e përfaqësive shqiptare në Beograd e në Shkup. AQSH.Fondi 251, viti 1938, dos. 107/1, fl.234-235. AQSH. Fondi, 251, viti 1938, dos. 107/1, fl.319-365.

SKENDER LUTFIU

Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë

REFORMA AGRARE DHE KOLONIZIMI NË FERIZAJ ME RRETHINË, NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Ndarja territoriale në qarqe, rrethe dhe organizimi i pushtetit civil më 1918, sipas raportit të Gjorgje Matiqit mbeti ashtu siq ishte sipas ndarjes së vitit 1913. Kosova ishte e ndarë në tri qarqe si në Qarkun e Kosovës, atë të Zveqanit dhe të Prizrenit. Në kuadër të Qarkut të Kosovës hynte rrethi i Nerodimes (Ferizajt).¹⁶⁵ Po ashtu më 1 nëntor 1919, Komanda e Krahinës III të armatave parashihte sipas Dekretligjit ndarjen administrativo–ushtarake, ku në kuadër të Qarkut të Prishtinës hynte edhe rrethi i administrativo–politik i Nerodimës (Ferizajt).¹⁶⁶ Më konkretisht, gjatë viteve 1919–1920, u bë një ndarje e re e ashtuquajtur ndarje në qarqe. Kështu, Kosova u nda në qarqe, rrethe e komuna. Në mënyrë tabelare do të japim vetëm të dhënat Qarkut të Prishtinës dhe rrethit të Nerodimës, mbi numrin e vendbanimeve dhe numrin e banorëve.

Qarku/Rrethi	Nr. i komunave	Nr. i vendbanimeve	Nr. i banorëve
Prishtinë/Graçanicë	15	136	78.284
Nerodime/Ferizaj	10	73	32.845 *

¹⁶⁵ Limon Rushiti, *Lëvizja Kaçake në Kosovë (1918 – 1928)*, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1981, f. 26.

¹⁶⁶ Limon Rushiti, *Rregullimi administrative-territorial i Kosovës gjatë viteve 1918-1919*, Kosova, Nr.1, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1972, f. 248-249.

¹⁶⁷ Limon Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativë i Kosovës 1878-1941*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2004, f.78.

Në vitet 1919 dhe 1920, Kosova ka qenë e ndarë në pesë qarqe dhe në tetëmbëdhjet rrethe. Kështu, në kuadër të Qarkut të Kosovës hynte rrethi i Nerodimes me seli në Ferizaj, me prefekt Mill. Ra–dojkoviç. Kjo ndarje mbeti territoriale dhe administrtrative mbeti në fuqi deri më 28 prill 1922, ndërsa faktikisht deri deri më 1925, kur në Kosovë filloi të funksionojë ndarja në krahina (oblasti).¹⁶⁸

Rrethin e Nerodimes e përbënin 7 komuna si ajo e Babushit, Gaçkës, Kosinës, Nerodimës, Talinocit, Ferizajt dhe Shtimës. Këto komuna përfshinin 35 fshatra dhe 19 koloni.¹⁶⁹

Më 6 janar 1929, mbreti Aleksandër, përveç ndryshimit të emërtimit të mbretërisë, pastaj pezullimit të kushtetutës, bëri edhe një ndarje të re administrative, të quajtura banovina. Trojet e banuara nga shqiptarët në Kosovë u ndanë në tri banovina:

1. Zeta – pjesa veriore e Rrafshit të Dukagjinit;
2. Morava – verilindja e Rrafshit të Kosovës, dhe
3. Vardari – Kosova Qendrore.¹⁷⁰

Nga kjo del se treva e Ferizajt, i takoi Banovinës së Vardarit me qendër në Shkup, e cila përfshinte gjithsej 276.245 banorë, ndërsa vetëm rrethi i Nerodimes–Ferizajt më 1931 kishte 38.383 banorë¹⁷¹, ndërsa më 1920 kishte vetëm 31.852 banorë.

Kështu, Rrethi i Nerodimes qendrën e kishte në Ferizaj, ndërsa përbëhej prej këtyre komunave:

¹⁶⁸ Ibid., f. 98-99.

¹⁶⁹ Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, "Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpca"*, Prishtinë, 2004, f.25.

¹⁷⁰ Oliver Jens Schmitt, *Kosova, Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, f.148.

¹⁷¹ Limon Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi...*, f.80.

Rrethi i Nerodimes– Selia Ferizaj		
Komuna	Selia e Komunës	Numri i banorëve
Babush	Babushi i serbëve	4828
Kosinë	Kosinë	2218
Shtime – Muzeqinë	Shtime	5269
Ferizaj	Ferizaj	3529
Gaçkë	Gaçkë	2883
Shtërpçë	Shtërpçë	4551
Gotovushë	Gotovushë	2652
Nerodime	Nerodime	4129
Talinovc	Talinovc i Muhagjerëve. ¹⁷²	1793
Gjithsej:		31.852 ¹⁷³

Sa i përketë përkatësisë fetare të popullsisë së këtij rrethi, sipas të dhënave që kemi më 1921 na del të jetë: 22.401 shqiptarë mysliman dhe 7834 serb e malazez që ishin kolonista, ndërsa më 1931 numri i përgjithshëm i popullsisë ishte 38.383 banorë, prej tyre ishin 24.894 myslimanë shqiptarë, 13.090 ortodoks serb, 392 katolik shqiptarë dhe 7 të tjerë. Në këtë vit numri i popullsisë sipas komunave të rrethit të Nerodimes–Ferizajt dukej kështu: Babushi 5863, Gaçka 3263, Gotovusha 2685, Kosina 2845, Nerodinja 4579, Talinoci 2456, Shtinja 6445, Shtërpca 4839 dhe Ferizaji 5318 banorë.¹⁷⁴

Më 1937 Rrethi i Nerodimes kishte një sipërfaqe prej 616 km² dhe numëronte 42.000 banorë, ndërsa dy vite më pas kemi të dhëna vetëm për numrin e shqiptarëve të cilët kapnin shifrën prej 29.240 banorë.¹⁷⁵

Gjatë viteve 1930–1932 janë bërë ndryshime të emërtimeve të vendbanimeve, pastaj fuzionim të fshatrave dhe komunave etj.

¹⁷² Ibid, f.137.

¹⁷³ Gani Rekaj, *Pellgu dardan i Nerodimes*, StarGraf, Ferizaj, 2013, f. 66.

¹⁷⁴ Ibid.

¹⁷⁵ Ibid.

Kështu, më 1932, qytezës së Shtimës, që ishte në Rrethin e Nero-dimes, Banovinën e Vardarit, i merret statusi i qytezës dhe kthehet në fshatë, ndërsa më 1933, Komuna e Sevcës, Rrethi i Sharrit ndahet nga ky rreth dhe i bashkangjitet Rrethit të Nerodimes.¹⁷⁶

Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare

Mjetet që përdorte pushteti i mbretërisë SKS, për të marrë tokat e shqiptarëve me qëllim që t'i detyronin këta të linin vatrat e tyre ishin plani i kolonizimit dhe reforma agrare. Për të arritur këtë qëllim, qeveria jugosllave kishte nxjerrë ligje të posaçshme të cilat i konsideronin tokat private të një ose më shumë krahinave si toka shtetërore dhe titujt e pronësisë ose tapit e tyre quheshin të pavlefshme.¹⁷⁷

Si rezultat reforma agrare dhe kolonizimi u bënë format më drastike të presionit ekonomik dhe social që detyruan një numër të madhë të shqiptarëve autokton të lëshojnë trojet e veta për tu vendosur më pas kryesisht në Turqi.¹⁷⁸ Në një dokument që bënë fjalë mbi krimet serbe në tokat shqiptare, ndërë të tjera thuhet se Serbia që nga ripushtimi i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare, kultivoi urrejtjen ndaj tyre, që rezultoi në djegien dhe shkatërrimin siq thuhet në këtë dokument të mirëra fshatrave dhe largimin në male dhe e të emigronin mbi 100.000 shqiptarëve. Më tej këtu thuhet që mbi 7000 familje të përkatësisë sllave nga vise të ndryshme po vendosën në Gjakovë dhe në Drenicë, në tokat e shqiptarëve, të cilët po detyrohen të shpërngulen nga trojet e tyre.¹⁷⁹

¹⁷⁶ Limon Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi...* f.146.

¹⁷⁷ Hamit Kokalari, *Kosova, djepi i shqiptarizmit*, Biblioteka Shqiptare, Tiranë, 1943, f. 51.

¹⁷⁸ Ramiz Abdyli, *Vështrim mbi papunësinë në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)*, Vjetar, nr.XVII-XIX, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1984, f. 232.

¹⁷⁹ Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH), Fondi: Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (më tej vetëm KMKK), Dosja. 28/3, nr.161, II/1991. Datë: 12.02.1921.

Reformës agrare në Kosovë i parapriu kolonizimi, i cili filloi që nga viti 1912, e që vazhdoi gjatë gjithë periudhës të cilën po e trajtojmë. Kështu, që të dyja u përdorën krahas njëra tjetrës, për të realizuar synimet e Mbretërisë Jugosllave për ndryshimin e strukturës etnike, në dëm të popullsisë shqiptare, e cila përbënte shumicën dërmuese¹⁸⁰. Ky veprim institucional pati efekt, sado që jo atë çfarë dëshironte Mbretëria Jugosllave, ngase në kohën e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, popullsia shqiptare në trojet jashtë shtetit të përgjysëmuar përbënte mbi 90%, ndërsa më 1941 kjo përqindje u ulë në rrethë 70%. Ky fakt dëshmon për një punë intensive për realizimin e të cilës nevojitej i gjithë aparati shtetëror. Kështu, organet më të rëndësishme për zbatimin e reformës agrare dhe të kolonizimit, ishin Zyra shtetërore për reformën agrare, e themeluar që më 1919, pastaj Ministria e Reformës Agrare që shërbente si organ suprem qëndror administrativ për këtë veprimtari. Por edhe institucionet e tjera si Ministria e Bujqësisë, ajo e Drejtësisë, e Financave, pastaj Ministria e Punëve të Brendshme, ajo e Ushtrisë dhe Detarisë, ajo e Jashtme etj deri tek Oborri Mbretëror, në mënyrë direkte dhe indirekte ndikuan në zbatimin e reformës agrare dhe të kolonizimit në Kosovë.¹⁸¹

Zbatimi i Reformës Agrare dhe kolonizimit në Ferizaj dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore

Pas ndarjes administrative të territorit të Kosovës, përkatësisht të themelimit të rrethit të Nerodimes dhe të komunave, u caktuan nga pushteti ushtarak udhëheqësit e këtyre komunave. Më pas, më 25 shkurt 1919 Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene kishte miratuar

¹⁸⁰ Ramiz Abdyli, *Faktorët që ndikuan në ndryshimin e strukturës socialiste në fshatin e Kosovës (1918-1941)*, Kosova, Nr.15, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1986, f.163.

¹⁸¹ Jusuf Osmani, *Organet për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit në Kosovë ndërmjet luftërave botërore*, Kosova, Nr.15, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1986, f. 193-210, për më tepër shih edhe *Historia Popullit Shqiptar III*, Toena, Tiranë, 2007, f. 477.

projektin “Dispozitat paraprake për përgaditjen e zbatimit të reformës agrare”. Duke u bazuar në këtë projekt, filloi zbatimi i reformës agrare dhe i kolonizimit të Kosovës.¹⁸²

Kështu, me Dekretligjin mbi themelimin e Ministrisë së Reformës Agrare të 12 shkurtit të 1920 dhe me Ligjin mbi kolonizimin e viseve jugore të 11 qershorit 1931, u formuan drejtoratet agrare të qarkut. Kështu, në Kosovë u themeluan drejtorate në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Vushtri. Mirëpo, me Ligj më 1931 në vend të Drejtoratit agrar në Prishtinë formohet ai në Ferizaj. Ky drejtorat përfshinte rrethin e Nerodimës, Graçanicës, Gjilanit dhe të Kaçanikut.¹⁸³

Procesi i kolonizimit të Kosovës, në përgjithësi dhe i rrethinës së Ferizajt gjithashtu, ka zgjatur po aq sa zgjati ekzistimi i Mbretërisë së Jugosllavisë, përkatësisht gjatë viteve 1918–1941. Mirëpo, intensiteti ka variuar në varësi prej rrethanave të përgjithshme ekonomike–politike në Kosovë dhe në tërë mbretërinë.¹⁸⁴ Kështu, në vitin 1919 sipas statistikave mbi kolonizimin, në Kosovë janë kolonizuar vetëm 33 familje, ku 28 prej të cilave në rrethin e Nerodimes (Ferizajt) dhe atë konkretisht në Petrovë dhe Zhiti 17, në Pleshinë 8, në Rashincë 2 dhe në Talinoc 1 familje.¹⁸⁵ Vlenë të theksohet raporti jo i plotë, i datës 10.04.1921 i Komisarit të Jashtëzakonshëm për Kosovë M.Ceroviqit, që i’a kishte dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku ndërë të tjera thuhet që në Llogorin e Nishit ishin depërtuar 105 familje me 425 anëtarë. Këtu do të ofrojmë të dhënat vetëm për Qarkun e Kosovës dhe për qytetet shqiptare të Maqedonisë: Qarku i Kosovës – 16 familje me 81 anëtarë; Qarku i

¹⁸² Ali Mehmeti, *Talinoci i Jerlive*, Monografi, Ferizaj, 2012, f. 27.

¹⁸³ Ibid.

¹⁸⁴ Shaban Hashani, *Reforma agrare dhe kolonizimi në rrethinën e Nerodimes (Ferizajt) midis dy luftërave botërore*, Kosova, Nr.20/21, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 1998/1999, f.150.

¹⁸⁵ Milovan, Obradoviq, *Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941)*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2005, f.166.

Tetovës – 12 familje me 58 anëtarë; Qarku i Kumanovës 3 familje me 14 anëtarë; Qarku i Manastirit 6 familje me 69 anëtarë dhe Qarku i Ohrit 1 familje me 5 anëtarë.

Nga këto të dhëna del se vetëm nga qytetet shqiptare të Maqedonisë në këtë periudhë janë depërtuar gjithsej 22 familje me 158 anëtarë.¹⁸⁶

Për intensitetin e dhunës që u bëhej shqiptarëve nga Mbretëria SKS, flet një raport i datës 3 prill 1921, nga i cili mësojmë se vetëm brenda pak vitesh në tërë Kosovën janë vrarë 12.346 persona, ndërsa janë burgosur 22.160. Sa i përketë rajonit të Ferizajt dhe atij të Kaçanikut ku hynte edhe Hani i Elezit kemi këto të thëna:

Rajonet	Persona të vrarë	Përsone të burgosur	Përsone të rrahur	Shtëpi të djegur	Shtëpi të plaçkitura
Ferizaj	1690	3400	190	720	960
Kaçaniku dhe Hani i Elezit	340	1300	160	290	350

Nga të dhënat statistikore del së ne tërë territorin e rrethit të Nero-dimes (Ferizajt), deri në kohën kur është bërë ky raport, janë vrarë 2.030 persona, janë burgosur 4.700 persona, pastaj janë rrahur 350 persona, janë djegur 1.010 shtëpi dhe janë plaçkitur 1.310 të tilla.¹⁸⁷ Mirëpo, nga një burim tjetër mësojmë se në territorin e Ferizajt deri në vitin 1921 janë vrarë 1.885 shqiptarë.¹⁸⁸ Në mesin e tyre janë vrarë edhe personalitete të njohura në popull si bie fjala vrasja e Ahmet Sulejmanit nga Shtinja më 11 korrik 1923, atentat që u

¹⁸⁶ Abdulla A. Bytyçi, *Terrori shtetëror dhe gjenocidi serbo-malazias në Kosovë 1878-1991*, Prishtinë, 2007, f. 80.

¹⁸⁷ Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH), Fondi: KMKK, Dosja. 33/2, nr.800, 322, të datës 03.04.1921.

¹⁸⁸ Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999)*, Prishtinë, 2001, p. 54.

organizua nga Pashiqi, në bashkëpunim edhe me sekretarin e Qarkut të Kosovës dhe atij të Rrethit të Ferizajt.¹⁸⁹

Sa i përket kolonizimit mund të themi se gjatë kësaj periudhe njihemi me dy faza të kolonizimit dhe atë faza e parë e cila nisë me urdhëresën për kolonizimin e pjesëve jugore të 24 nëntor 1920, ndërsa faza e dytë u zhvillua gjatë viteve 1931–1941 është kryer në bazë të Ligjit mbi kolonizimin e viseve jugore të 11 qershorit 1931 dhe ndërrimeve e plotësimeve që u janë bërë këtij Ligji më 5 dhjetor 1933.¹⁹⁰

Sipas Oliver Schmitt, fushata të mëdha kolonizimi u ndërmorën gjatë viteve 1922, 1928, 1936 dhe 1937, që rezultuan me shpronësimin e 57.655 ha tokë, nga 360.000 ha tokë bujqësore sa kishte Kosova.¹⁹¹ Ndërsa sipas studiuesit Jusuf Osmani, ndërmjet dy luftërave botërore në Kosovë janë vendosë rreth 70.000 kolonistë në afro 600 vendbanime, ndërsa, në emër të reformës agrare, u morën 129.212,94 ha tokë.¹⁹² Mirëpo gjatë viteve 1945–1946, në procesin e revidimit të reformës agrare u kthye një pjesë e tokës së marrë në mënyrë të padrejtë. Kështu, kolonistëve iu muarën 15.784 ha tokë dhe iu kthyen pronarëve të mëparshëm të cilët ishin kryesisht shqiptarë.¹⁹³ Një burim tjetër thotë që ndërmjet viteve 1919–1941, në viset shqiptare që ishin pjesë e SKS, u shpronësuan rreth 218 mijë ha tokë, nga të cilat mbi 192 mijë në Kosovë.¹⁹⁴ Nga kjo del se synimi kryesor i mbretërisë ishte ndryshimi i strukturës së popullsisë në favor të serbëve dhe në dëm të shqiptarëve, qëllim që ishte

¹⁸⁹ Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake...*, p. 249.

¹⁹⁰ Ibid.

¹⁹¹ Oliver Schmitt, vep.cit, f.154.

¹⁹² Jusuf, Osmani, vep.cit, f. 24.

¹⁹³ Kocobo - Kosova, dikur e sot, *Ekonomska Politika*, Beograd, 1973, f.184.

¹⁹⁴ Lush Culaj, *Nën sundimin e Serbisë dhe të Jugosllavisë (1912-1941)*, Kosova, vështrim monografik, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2011, f. 231.

realizuar pjesërishtë, ngase në përqindje të popullsisë së përgjithshme të Kosovës, elementi serbë u rritë për 10% .¹⁹⁵

Ndërsa vetëm Drejtoria Agrare në Ferizaj, që vepronte në rrethet e Nerodimes (Ferizajt), Graçanicës (Prishtinës), Gjilanit dhe Kaçanikut, kishte marrë 352 ha tokë, duke shpronësuar shqiptarët me motivacionin e kryengritjes së tyre në kuadër të lëvizjes kaçake.¹⁹⁶

Autoritetet agrare në harkun kohor maj-qershor të vitit 1938, në rrethin e Nerodimes (Ferizajt), sekuestruan tërë tokën e komunës së Shtimes, që kapte 10.000 ha, e tëra nën kultura bujqësore dhe pyje. Ky veprim i padrejtë shtyu qytetarët të bëjnë ankesa, por prej 51 ankesave u morën parasysh vetëm 6 prej tyre, të cilëve iu premtua kompenzimi i tokës në një lokacion tjetër. Po ashtu në komunën e Kosinës u sekuestruan 900 ha tokë. Si rezultat pas rrethit të Graçanicës, për nga toka e sekuestruar radhitej Rrethi i Nerodimes (Ferizajt).¹⁹⁷

Shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova dhe viset tjera shqiptare, pushteti borgjez serbë e shihte si fanatizëm religjioz, ngase shqiptarët emigruan në rajonet e muslimanëve, konkretisht në Turqinë me motivacione fetare jo se ndërmerreshin masa që i detyronin të shpërnguleshin. Ndërsa për të shpërngulurit në Shqipëri, thuhet të jenë të paditurit që ndiqeshin nga Jugosllavia, që sipas këtij dokumenti ishin kryesisht kaçak që shkaktonin trazira në terrioret jugosllave.¹⁹⁸

Në tabelën e mëposhtme do të japim një statistik të Drejtoratit Agrar në Ferizaj, që krahason sipërfaqet e dhëna në vitet 1934, 1937 dhe 1979:

¹⁹⁵ Noel Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2011, f.362.

¹⁹⁶ Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë*, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Iliria, Tiranë, 1992, f.65.

¹⁹⁷ Ibid, f.77.

¹⁹⁸ Agjensioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës, (më tej vetëm ASHAK), Koleksioni i Hakif Bajramit, *Situata e pakicave kombëtare shqiptare në Jugosllavi*, f. 4.

Viti	Përkufizuar definitivisht	E matur		E pamatur
		E pamatur	E matur	
1934	37.913	12.573	19.743	1.146
1937	36.670	14.635	15.488	4.506
1939	37.910	12.573	19.743	1.147 ¹⁹⁹

Sipas të dhënave të Stojan Qupkoviçit, në territorin e rrethit të Nerodimes (Ferizajt) gjatë viteve 1918–1935 ishin vendosur 435 familje kolonistësh me 2.364 anëtarë, ndërsa deri më 1939 janë vendosur 680 familje kolonistësh.²⁰⁰ Mirëpo, sipas studiuesit Jusuf Osmani, në rrethin e Nerodimes, përkatësisht atij të Ferizajt, gjatë kësaj periudhe ishin vendosur 297 familje kolonistësh, ndërsa deri më 1938 në këtë rajon janë vendosur 374 familje me 1750 banorë (1055 serbë, 692 kroatë dhe 5 sllovenë).²⁰¹ Këto familje kolonësh u vendosën pothuajse në të gjitha fshatrat e rrethinës së Ferizajt, por krijuan edhe vendbanime të reja në tokat e shqiptarëve, si Gërllicën, Tankosiqin, Rakajt, Gërbolën etj.²⁰² Sipas një raporti të një gjykatësi të Gjyqit Agrar në Shkup, deri në vitin 1927, në në rrethin e Nerodimes janë krijuar 9 koloni dhe 23 vendbanime.²⁰³

Nga kjo sa u tha më sipër del se në rretin e Nerodimes, popullsia serbe dhe grupet e tjera joslave kapnin shifrën e 34%. Popullsia autoktone shqiptare ra deri në 62%, ndërsa përqindja e kolonëve arriti në 4%.²⁰⁴ Mbretëria Jugosllave nuk ishte e kënaqur me këtë përqindje, andaj ajo vazhdoi masat ndaj popullsisë autoktone shqiptare. Kështu, në një elaborat të hartuar nga komandanti i Armatës III në Shkup, dërguar ministrit të Ushtrisë dhe të Marinës, si dhe

¹⁹⁹ Milovan Obradović, *vep.cit*, f.184.

²⁰⁰ Shaban Hashani, *Reforma agrare...*, f. 152.

²⁰¹ Jusuf Osmani, *vep.cit*, f. 25.

²⁰² Rrahim Sadiku, *Ferizaj '68*, Shoqata e të Burgosurve Politikë, Ferizaj, 2008, f.33.

²⁰³ Limon Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi...*, f.176.

²⁰⁴ Oliver Schmitt, *vep.cit*, f.155.

kryeshefit të Departamentit Informativ pranë Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, ndër të tjera bëhet bëhet fjalë rreth politikës ideore të regjimit sa i përket kolonizimit të tokave shqiptare nën pushtimin jugosllav, ku në veçanti specifikohet rreziku që vije nga përqindja e madhe e numrit të popullsisë shqiptare në territoret e qarkut të Kosovës dhe atij të Vardarit. Në këtë dokument paraqitet përqindja e popullsisë shqiptare, e cila ishte pengesë e pushtetit borgjez serb. Vendet me përqindjen më të madhe të popullsisë shqiptare ishin: Rrethi i Kaçanikut me afër 97% shqiptarë, që i takonte qarkut të divizionit të Vardarit, por që gjeografikisht ishte më i lidhur me qarkun e divizionit të Kosovës, pastaj pasohet nga rrethi i Podrimës 90%, i Podgorës 85%, i Llapit rreth 80%, i Vushtrrisë me afër 70%, i Gjilanit me afër 67%, etj. Prandaj duke pas parasysh këtë numër të madhë të shqiptarëve në këto territore, pushteti jugosllavë shihte si të nevojshme që sa më parë të kryente kolonizimin në territorin e qarkut të divizionit të Kosovës, krahas shpërnguljes së vazhdueshme të popullsisë shqiptare. Ndërsa të dhënat për territorin e qarkut të divizionit të Vardarit, ku popullsia shqiptare ishte në numër të madhë ishin: në rrethin e Kaçanikut, ka 12.560 shqiptarë dhe vetëm 60 vendorë dhe 540 ardhacakë, pastaj në rrethin e Hanrievës (Gjorçe Petrovi – rrethi i Shkupit), si dhe në Pollogun e Poshtëm dhe Pollogun e Epërm, një pjesë e rrethit të Kërçovës, territore në të cilat popullsia shqiptare përbënte pjesën dërmuese, etj.²⁰⁵

Për shkak të përqindjes së madhe të shqiptarëve në territoret e tyre etnike, Mbretëria Jugosllave nuk ishte e kënaqur, edhe pse kishte ulur në mënyrë drastike numrin e tyre nëpërmjet reformës agrare dhe kolonizimit, por megjithatë ajo synonte të ndryshonte komplet strukturën e popullsisë, andaj ajo nënshkroi Konventën jugosllavo-turke më 1938, mbi shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre. Për të fshehur qëllimin e saj, Jugosllavia justifikonte këtë marrë-

²⁰⁵ Qerim Lita, *Politika e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941*, Arkivi Shetëror i Republikës së Maqedonisë & Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Shkup – Prishtinë, 2012, fq. 185-188.

veshje duke u “arsyetuar” që po shpërngulë popullsinë turke, sepse nëpërmjet fesë islame mundahej të manovronte me shqiptarët e besimit islam duke i quajtur turq. Ndër rrethet që do t’i përfshinte shpërngulja masovike ishte edhe ai i Nerodimes (Ferizajt).²⁰⁶

Për nevojat e kolonistëve ishte formuar fondi i tokave i reformës agrare. Nga ky fond deri më 1939 ishin matur dhe u ishin ndarë kolonistëve sllavë gjithsej 5.723 ha tokë, ku çdo familje koloniste kishte marrë afërsisht nga 8.31 ha tokë. Për më tepër, tokë u ishte ndarë edhe serbëve vendas, ku për çdo familje të tyre afërsisht u ishte ndarë nga 2.40 ha tokë.²⁰⁷

Në tabelën e mëposhtme keni të dhëna statistikore për vendosjen e kolonëve dhe shpronësimin e shqiptarëve vetëm për rrethin e Nerodimes (Ferizajt):

Rrethi	Tokë komplekset për kolonizim (në ha) deri 31.12.1932	Përfituan										Shtëpi të kol.	Fam. të kol.
		Familje kolonësh		Familje autokton		Familje vullnet.		Familje çetnikësh		Gjithsej			
		Nr.	ha.	nr.	Ha	nr.	ha	nr.	ha	Nr.	ha		
Ferizaj	6071	281	2452	15	125	7	73	2	10	305	2660	242	256 ²⁰⁸

Gjendja e shqiptarëve në këtë periudhë ishte tejet e vështirë, për faktin se ata që ishin të pabindur ndaj veprimeve të Mbretërisë Jugosllave dhe që i luftonin kolonët e shumtë, që vërsjuan nga të

²⁰⁶ Shaban Hashani, *Ferizaj dhe rrethina...*, f. 263.

²⁰⁷ Ibid. pp. 238-239.

²⁰⁸ Marenglen Verli, *vep.cit*, f. 120.

gjitha viset serbe, i shpallnin armiq të shtetit. Për më tepër, për likuidimin fizik të tyre, duke konfiskuar në radhë të parë pasurinë, udhëheqësit shtetëror merrnin shpërblime për krimet që bënin ndaj shqiptarëve, të cilët nuk kishin asnjë të drejtë.²⁰⁹

Për më tepër për gjendjen e krijuar akuzoheshin shqiptarët, duke i quajtur si prishës të rendit dhe kundërshtar të shtetit dhe pushtetit. Kështu, në një elaborat që komandanti i Armatës III në Shkup, gjenerali Millan S. Jeçmeniç, ia dërgon kryeshefit të departamentit Informativ pranë Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, të datës 15 tetor 1998, ndërë të tjera thuhet: *“Propaganda shqiptare në Serbinë e Jugut asnjëherë nuk ka qenë më e gjallë se sot. Në mesin e serbëve në Serbinë e Jugut është lansuar lajmi se shqiptarët përgatiten për kryengritje, dhe me këtë rast do të kryenin një kasaphane të vërtetë ndaj popullsisë serbe e posaçërisht ndaj kolonëve [...]”*²¹⁰ Gjithashtu në këtë elaborat thuhet që për marrjen e territoreve ku popullsia shqiptare përbëjnë pjesën dërmuese, nevojitet kolonizimi sa më i shpejtë i elementit tonë “të shëndoshë” krahas shpërnguljes permanente të popullsisë shqiptare. Madje bëhej thirrje që nëse ky kolonizim nuk zbatohet në një afat sa më të afërt dhe në baza racionale, ekziston rreziku se kjo, në të ardhmen, për shkak të natalitetit të popullsisë shqiptare, do të jetë e pamundur.²¹¹

Për shpërnguljen e popullsisë shqiptare nga territoret e tyre etnike, një ndikim të madhë ka pasur edhe pushtimi italian i Shqipërisë. Për këtë më së miri fletë plani sekret që Shtabi i Përgjithshëm në Beograd ia dërgoi strukturave më të larta shtetërore të Mbretërisë Jugosllave, lidhur me përsheptimin e shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi, plan në të cilin ndërë të tjera thuhej: *“Pas futjes së ushtrisë italiane në Shqipëri, disponimi i shqiptarëve tanë në Metohi dhe Kosovë dukshëm ka ndryshuar [...]. Shqiptarët janë të pakënaqur*

²⁰⁹ Rrahim Sadiku, *vep.cit.*, f. 31.

²¹⁰ Qerim Lita, *vep.cit.*, f. 192.

²¹¹ *Ibid.*, f. 196

*me gjendjen që kanë në shtetin tonë. Ky është një fakt që nuk mund t'i ikim... Marrja e tokës shqiptarëve, si dhe informatat e përhapura se ata vërtetë janë elementë të padëshirueshëm në territorin tonë, gjithësesi se kanë ndikuar shumë pozitivisht në zgjerimin e propagandës në favor të Italisë.*²¹²

²¹² Ibid., f. 241.

DON VIKTOR SOPI

Kisha Katolike dhe "Caritas"– Kosovë

VEPRIMTARIA DIPLOMATIKE E LAZËR MJEDËS, KARSHI TRYSNIVE FETARE DHE POLITIKE NDAJ SHQIPTARËVE

Imzot Lazër Mjeda lindi (më 6.03.1869) dhe vdiq (më 8.07.1935) në Shkodër. Rrjedh nga një familje modeste atdhedashëse. Në vitin 1900, si 31 vjeçar, emërohet ipeshkëv i Sapës (më 20.01.1901 shu-gurohet). Më 24.12.1904, emërohet kryeipeshkëv titullar pro hac vice i Aeropolit dhe ipeshkëv koadjutor i Shkodrës.

Më 14.04.1909, papa Piu X e emëron kryeipeshkëv në Shkup. Më 19.10.1921, emërohet kryeipeshkëv i Shkodrës ku qëndron deri në vdekjen e tij në vitin 1935.

Sipas arkivave të kohës, duket se problem kyç si shqiptar dhe si kryeipeshkëv për Lazër Mjedën, ishin padrejtësitë politike dhe fetare të shfaqura ndaj popullit shqiptar në Maqedoni dhe në Kosovë. Lufta e tij e pakompromis kundrejt trysnive të ushtruara nga qeveria e kohës, i shkaktuan telashe të shumta, kështuqë me intriga politike e dënuan dhe u dëbua nga Prizreni dhe Shkupi. Pas kësaj, Vatikani, Lazër Mjeden e emëroi kryeipeshkëv metropolit në Shkodër.

Veprimtaria atdhedashëse e Mjedës mund të vështrohet nga shumë aspekte, ai ishte edhe letrar i talentuar, patriot dhe i vendosur për ta mbrojtur popullin e vet të nëpërkëmbur nga aspekti politik, kulturor dhe fetar. Mjeda ka botuar vjersha dhe lutje me përmbajtje të zgjedhur që këndohen ende sot nga fshtatarët vendas por edhe nga katolikët e Kosovës. Edhe në argjipeshkvinë Shkup–Prizren, besimtarët ishin kalitur në lutje që recitoheshin në formë të poezisë apo edhe këndoheshin si lloj këngësh, si psh. urata: "*Kujto mirë, o*

njeri shkretë (Qëllimi i njeriut), *Un` prej Zotit jam i kështenë*, pastaj, siç quhej “Kanga e popullit”: *N`Cërnagore kem një Nanë*,²¹³ *Dhetë urdhnimet e Tënzot*, etj.

Këto lutje dëshmojnë privimin e lirisë fetare të shqiptarve (katolikë) në këto troje si dhe pretendimet politike dhe fetare të qeverisë në kohën e Mjedës. Këto lutje popullore por ka edhe shumë të tjera, për të parën herë i ka publikuar poeti, dom Nue Bytyqi i cili posaqe është marrë me uratë, lutje dhe këngë të ndryshme në formë poezie të përshtatura për rrethanat e kohës. Këto uratë që sot quhen “lutje të moçme”,²¹⁴ (disa nga to të përpiluara nga vet Mjeda e Bytyqi) flasin për një gjendje të çoroditur dhe të mjerueshme politiko-shoqërore dhe fetare të popullit tonë gjatë kësaj periudhe.

Si ipeshkëv, Mjeda ndërtoi shumë struktura arsimore dhe fetare, por krijoi dhe ndërtoi edhe shkolla (në Dajç, Hajmeli të Iballës si dhe nëpër Kosovë dhe Maqedoni). E ka renovuar/zbukuruar Konkatedralen e Prizrenit, kurse në Shkup e ka ndërtuar selinë argjipeshkvore dhe shtëpinë e Kishës famullitare. Së bashku me vëllain e tij, shkrimtarin don Ndre Mjeda, në Shkodër kanë themeluar dhe drejtuar shoqërinë letrare „Agini” si dhe shoqërinë botuese “Jeronyme” duke botuar edhe tekste shkollore.

Është për t’u spikatur fakti se pa ndihmën dhe përkrahjen e Mjedës, më 28.11.1912, nuk do të ngrihej flamuri i pavarsisë së Shqipërisë në Vlorë nga Ismail Qemali. Vet Mjeda (duke e aktivizuar dhe involvuar qeverinë austriake) e ka organizuar, stimuluar dhe financuar udhëtimin për në Vlorë të Ismail Qemalit dhe të tërë delegacionit. Në shkurt të vitit 1913, kur Mjeda është kthyer nga Londra, e ka konfirmuar mbështetjen e Londrës dhe të Vjenës për funksionalizim

²¹³ Nue Bytyqi, *Kanga e popullit. N`nderr t`Zois Zernaghores*, në: *Elçija e Zemrës së Krishtit*, Shkodër, qershor 1894, fq. 6-9.

²¹⁴ Gaspër Gjini, *Shujta shpirtnore*, Ferizaj 1978, fq. 205.

min e shtetit shqiptar dhe që Shkodra me rrethinën e saj do mbetet pjesë e sigurtë e Shqipërisë.

1. Fenomeni i laramanizmit dhe angazhimi i Mjedës për liri fetare

Vetë fjala “laramanizëm” jo vetëm se nuk tingëllon mirë, por ky fenomen tregon një gjendje të rëndë të popullit tonë të privuar nga liritë fetare. Nga ana tjetër, laramanizmi sfidon ndërgjegjen politiko-shoqërore dhe kombëtare të ditëve tona, duke na kujtuar rrugën e imponuar dhe trysnitë e ushtruara mbi shqiptarët shekuj me radhë.

Islamizmi kryesisht pranohej sipërfaqësisht nga kryefamiljari e më vonë edhe nga meshkujt tjerë të rritur të familjes, të cilët para pushtetit osman do të njihen me emra të ndërruarr islam për shkaqe tatimore, kurse në qarqet familjare fshehurazi ishin të krishterë. Të të tillët, vetëm gjatë natës prifti i vizitonte dhe i kryente shërbesat fetare.²¹⁵ Mbi këtë fenomen, posaçërisht është marrë studiuesi i historisë shqiptare, diplomati dhe konsulli austriak, Johann Georg von **Hahn**, i cili në librat e tij lidhur me këtë fenomen jep shumë të dhëna, si në: *Albanesische Studien, Reise von Belgrad nach Salonik* dhe *Reise durch die Gebiete von Drin und Wardar*.

Në Letnicë ruhen librat e pagëzimeve të laramanëve që quhen: *Liber baptizatorum occultorum*, I (1906–1915) dhe II (1920–1936) dhe në Stubëll *Matricularum baptizatorum Cryptocatholicorum Ecclesiarum Beatae Mariae Virginis Crnagorensis in Letnica Atque*

²¹⁵ Peter Bartl, *Kryptochristentum und Formen des religiösen Synkretismus in Albanien*, në: *Grazer und Münchener Balkanologische Studien*, München 1967, fq.117-127; i njëjti, *Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung. Bildung und Kultur*, Kovač, Hamburg 2007, fq. 423-425

Në koncilin kombëtar kishtar të mbajtur në Mërçi më 1703, është trajtuar poashtu edhe kjo temë. Edhe koncili tjetër kishtar shqiptar i 1871 dhe i vitit 1895 trajtonin këto tema. Jantë të njohura edhe enciklikat e Vatikanit lidhur me këtë fenomen sikur: *Inter Omnigenas* (1744) dhe *Quod Provinciale Concilium* (1754) të firmosur nga papa Benedikti XIV, dhe dekreti i nënshkruar nga prefekti Kongregatës Propaganda Fidae, Castelli: *Decretum que reprobantur nonnullae praxes christianorum occultorum muhamethanum sectam simultantium* nga 19.02.1774.

Sancti Joseph, Sponsi Beatae Mariae Virg. in Stubla Stubalae. Librat kanë të bëjnë me pagëzimin e kriptokrishterëve nga zona e Karadakut nga viti 1893 deri në kohën e Luftës II Botërore. Lovro Miha evi për „laramanët“ shkruan kështu: *“Kur prifti katolik e përshkon famullinë për t'i bekuar shtëpitë, duhet patjetër të kthehet edhe nëpër shtëpitë e myslimanëve, që ti spërkas (bekoj) edhe ato, kurse ata i japin lëmoshë sikur edhe katolikët; do të ndjeheshin të ofenduar, nëse nuk do të bekoheshin”*.²¹⁶

Shkrimtari bullgar P. Cilev, pas vizitës së tij argjipeshkvisë sonë më 1911, përmend raste interesante lidhur me interesat praktike të laramanëve si dhe mënyrën e praktikimit të fesë katolike fshehurazi në këto troje. Shumë informata kishte marrë edhe nga prifti koso-var, dom Luka Filiq. Në këtë kohë kishte shumë fshatra laramane, sikur ato në zonën e Karadakut të Shkupit dhe përreth Ferizajit, sikur Talinovci, Jerliu, Muhovci, Koshare, etj. Laraman kishte edhe në (Lla)Pushnik. Në rrethin e Pejës kishte në Belaj, Lumbardhë e Rashiq. Këto vende i kisthe vizituar deri vonë prifti i Ferizajit, por nga rrethi nuk ishte hetuar fare se është prift, ngase ai maskohej: Ishte veshur sikur fshatar i thjesht dhe kishte çantën në krah, ku kishte një armë për gjueti dhe disa pëllumba të mbytur në krah, kështu që në çantë kishte të gjitha përgatitjet e veta për meshë dhe ceremoni tjera fetare.

Më dobësimin dhe rënien e Perandorisë Osmane, gjendja e të krishterëve të fshehët duhet të ishte më ndryshe, sepse teoretikisht ishte shpallur mundësia e lirisë fetare. Mirëpo tash doli në pah një problem tjetër! Serbia nuk dëshironte që laramanët të deklaroheshin katolik, por vetëm ortodoks apo të mbeten „mysliman“. Në dhjetor të vitit 1912, Mjeda gjendej në Lubjanë, ku gazeta „Slovenec“ e citon atë për gjendjen e shqiptarve. Për këtë raporton edhe gazeta e Vjenës, *“Reichspost”*, më 27.12.1912 (botimi i pasditës), duke e cituar Lazër Mjedën mbi padrejtësitë e pësuar të shqiptarve.

²¹⁶ Lovro Mihačević, *Durch Albanien*, Prag 1913, fq. 34-35.

Në artikullin „*Serbien und die Katholiken*“, shkruhet se laramanët apo katolikët e fshehur ishin deklaruar para Serbisë se dëshirojnë haptas të jenë katolikë sepse janë të tillë. Kurse Serbia u kishte thënë atyre „ose duhet të bëhen ortodoks ose muhamedan“.²¹⁷ Gazeta tjetër vjeneze, *Wiener Sonn- und Montags Zeitung*,²¹⁸ shkruan për konvertimin e dhunshëm të shqiptarëve në ortodoksi dhe rolin e argjipeshkvit Mjeda për mbrojtjen e të drejtave fetare të shqiptarve. Në këtë artikull mësojmë se konvertimi i shqiptarëve ishte tejte i dhimshëm që u zhvillua me dhunë edhe nën pushtetin e Serbisë dhe të Malit të Zi.

Për kohën kur Mjeda ishte argjipeshkëv në Prizren, misionet fluturake të jezuitëve kishin përshkruar detaje për gjendjen e laramanëve në këtë argjipeshkvi.²¹⁹ Një libër në gjuhën kroate mbi veprimtarinë e jezuitëve në Kosovë e Maqedoni prej 1888–1912, është dashur të botohet edhe në shqip. Rreth veprimtarisë së jezuitëve mes laramanëve në argjipeshkvinë Shkup–Prizren mund të lexohen shumë detaje në këtë dorëshkrim. Sipas letrës së Genovizzi–t dërguar provincës së vet (të jezuitëve) në Milano, Shkup, 28.01.1912, mësojmë se autoritetet turke kërkonin nga laramanët e argjipeshvisë Shkup–Prizren që së paku kryefamiljari të shkoj haptas në xhami.²²⁰

²¹⁷ *Serbien und Katholiken*, në: *Reichsposts* (Nachmittagausgabe) 27.12.1912, fq. 1.

²¹⁸ *Wiener Sonn- und Montags-Zeitung*, „Die Anhörd Montenegros ist ausständig“ 24 mars 1914, fq. 1.

²¹⁹ Mbi laramanët në argjipeshkvinë Shkup–Prizren gjatë kohës kur L. Mjeda ishte argjipeshkëv shif edhe raportin e atë Giovanni Battista della Pietra për misionin fluturues të mbajtur në argjipeshkvinë Shkup–Prizren më 1911 në: *Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Venta, Serie XXII, Venezia 1912, fq. 20–31 dhe raportin e Atë Francesco Genovizzi për misionet në këtë argjipeshkvi më 1911 dhe 1912 në Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Venta, Serie XXII, Venezia 1913, fq. 3–20. Këto detaje janë poashtu në librin e përgatitur nga Albert Ramaj (ende pa botuar) që duhet të botohet në gjuhën kroate nga Misioni Katolik Shqiptar në Zagreb.*

²²⁰ *Lettere edificanti dei padri della Comp. di Gesu della Provincia Venta, Serie XXII, Venezia 1913, fq. 3.*

Në misionin fluturues të Jezuitëve ishte edhe një misionar nga Stublla e Vitisë që quhej Fratel Zef Antunoviqi. Zef Valentini ka shkruar një shkrim për fratel Zefin dhe cek se ai vjen prej rrethit laraman.²²¹ Ai iu bashkangjiti misioniart Domenico Passi, sepse e njihnte mentalitetin e laramanëve. Frateli ishte bashkangjitur misio- narëve jezuit për Kosovë dhe Shqipëri. Mbi këtë lexojmë edhe në librat e Cordignano: „L’Albania“. Fratel Zefi kishte jetuar kohë të gjatë në Shkodër, ku më 1936 kishte vdekur.

Në kohën e Mjedës kishte edhe priftërinjë katolikë që vinin nga vendet laramane, sidomos nga zona e Karadakut të Shkupit, fshatrat Lubishtë dhe Zhegër në afërsi të Vitisë. Ato vende ishin gati „krejtësisht“ laramane, sikur Viktor Pashku që zyrtarisht quhej Shahin Ferizi apo siç dihet me emrin Atë Viktor Pashku apo Viktor Paskes nga Selishta e Gjilanit dhe që më vonë nga qeveria franceze kishte marrë çmimin shumë të njohur “Palme d’officier d’Académie” për përhapjen e kulturës franceze. Nga Zhegra ishte edhe një tjetër prift që quhej Ahmet Fazlija.²²²

Për trysni dhe shtypje fetare në Kosovë dhe Maqedoni ishin marrë edhe shumë revista europiane. *Le Missioni Cattoliche* e Milanos kishte shkruar për kriptokatolikë se dëshironin të deklalroheshin haptas katolik, duke bërë një prezentim mbi gjendjen në kryei- peshkvinë Shkup–Prizren. Në artikullin e 20.04.1913, gazeta pye- tet: *Si është e mundur që Serbia të shkoj kaq larg në realizimin e politikës së turqve, ngase ajo krenohet se ka luftuar kundër turqve?* Këto trysni mbi shqiptarët, shtypi evropian i trajtoi si akte barbare. Artikulli e paraqet edhe ngjarjen kur Mbreti serb, Peter I. kishte shkruar në Shkup më 24.01.1913 dhe kishte takuar 50 familje lara- mane që i kishin deklaruar atij haptas se dëshirojnë të jenë katolikë.

²²¹ Zef Valentini, “*Il Fratel Zef e la Missione volante*”, në: *Notizier agli Amici dei gesuiti lambardo-veneto-emeliani*, Milano, 2 (1972), fq. 36-41.

²²² Franjo Djurić, *Die Geschichte der Krypto-Katholiken (Laramanen) in der Diözese Skopje-Prizren und die Probleme ihrer pastoralen Betreuung*, Innsbruck 1987 (punim diplome i pabotuar), fq. 204.

Mbreti i zëmëruar u kishte thënë: „Katolikë! Keq, bile edhe shumë keq! Ose ortodoks ose muhamedan, kurrësi katolikë“.

Një shkrim të ngjashëm lexojmë edhe në gazetën e Splitit, *Dan*, më 2.07.1913, e cila këto vështirësi të shqiptarve për liri fetare i trajton nën titullin: „Mëshoju katolikëve dhe lirisë së tyre“, duke vë në pah se qëllimi ishte shpartallimi i kombit shqiptar, i kulturës dhe identitetit të tyre autokton në këto troje. Laramanët e këtyre trevave me apo pa dashje, për shkak të politikës ditore ju imponohej feja ortodokse dhe islame. Serbia dhe Mali Zi kishin qëllim tjetër, sidomos gjatë vitit 1913, në rrethin e Pejës, Gjakovës dhe Malit të Zi,²²³ ushtrohej dhuna për konvertim të laramanve por edhe të katolikëve dhe myslimanëve shqiptarë në ortodoksizëm.

Atë Luigj Palaj nuk i lente besimtarët e vet që të konvertoheshin në ortodoksizëm dhe për këtë arsye u vra nga forcat malazeze më 1913 në Janosh afër Gjakovës. Lazër Mjeda përballej jo më vetëm me problemin e laramanëve në këto troje, por edhe të besimtarëve që prej torturave dhe mundimeve të lloj-llojshme ishin të detyruar se paku që sipërfaqësisht (edhe shqiptarët e besimit katolik e islam) të deklaroheshin si ortodoks, për t’iu shmangur masave ndëshkuese të qeverisë. Lazër Mjeda i vizitonte këto vende dhe u jepte kurajo që mos të bëjnë një gjë të tillë. Vizita e tij më 27 maj në Gjakovë, ku kishte biseduar me shqiptarë për deklarimin e dhunshëm të tyre. Mjeda nuk ishte angazhuar vetëm për katolikët e konvertuar në territorin e okupuar nga Mali i Zi më 1913, por siç cekët, ai u kujdesua për të gjithë njerëzit e shtypur dhe “për të gjitha konvertimet tjera me dhunë”,²²⁴ pra edhe për myslimanët dhe laramanët shqiptarë.

Më 19.03.1913 lidhur me këto probleme Lazër Mjeda shukruan këhstu: “me shëndet jam mirë; shumë gjera të këqija, te vështira i

²²³ Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913*, (Dokumente), fq. 216.

²²⁴ Zekeria Cana, *Gjenocidi...*, fq. 165.

kam pasur këto ditë, arsyeja kryesore/salvimet e trishtueshme, te hatashme të shpërthyer kundër katolikëve nën pushtetin malazez. Më se 70 familje fand kanë kaluar në skizëm (janë sllavizuar) dhe ekziston rreziku me arsye që edhe të gjitha familjet tjera të veprojnë në të njëjtën mënyrë, duke mos pasur rrugëdalje. Tri fashtra kanë pasur mundësi natën të ikën nga territori nën pushtetin serb, duke lënë çka kanë pasë e tjerët s'kanë pasë mundësi ta kalojnë kufirin..."²²⁵

Më 16.03.1913, Lazër Mjeda shkruan: "Tash jam vetë i nevojshëm për të holla, pasi kam pasur detyrë të kujdesohem për refugjatët e Gjakovës. Dje për Rrëshajë jam kthyer nga Gjakova, e nesër prapë do të kthehem për tri-katër ditë. Pasi çështja e refugjatëve ende nuk u zgjodh, dhe populli asht në lëvizje tash këtu e tash atje, është e nevojshme që kohë pas kohe t'i vizitoj dhe t'i ngushëlloj, duke u dhënë zemër dhe duke u ndihmuar materialisht, se kanë humbë çdo gjë dhe janë pa bukë. Kjo është arsyeja pse tani nuk mund të largohem, se përndryshe tani do isha në ato anë."²²⁶

2. Veprimtaria diplomatike dhe korrespondenca ndërkombëtare e Mjedës

Në dhjetor të vitit 1912, nga Lubjana Mjeda iu drejtua Kongregatës *Propaganda Fidae*, përkatësisht kardinalit Girolamo Gotti me një letër lidhur me mungesën e lirisë fetare që ndër të tjera thekson:

Lartesia Juaj e dij se në Kryepeshkvinë time kishte të krishterë të fshehur (laramanë); ata duke përfutuar nga ardhja e pushtuesve të rinj që "krenohen me emrin kristian", menduan se erdhi koha të shpalleshin haptazi atë që ishin dhe atë që ndjehen. Të gjitha fshatrat në Malin e Zi të Shkupit, Janjevës dhe Ferizajt u shpallën hapur katotikë. Nuk dihet asgjë për ata që banonin në krahinën e Prizrenit, por ka mundësi që edhe ato të kenë bërë të njëjtën gjë, pasi

²²⁵ Mark Sopi, *Shembulli i Bariut të mirë dhe atdhedashës, arritja e imz. Lazër Mjedës në Prizren*, në: *Drita*, viti XIII, nr 3-4 (95) 1982, fq. 8.

²²⁶ Mark Sopi, *Shembulli i Bariut të mirë dhe atdhedashës*, fq. 8.

ishin lidhur ngushtë me të tjerët. Se ç`numër kishin, s`mund t`ua them tani, por është e sigurt se duhet të jenë disa mijëra. Porse për serbët, që ndërkohë mburren se kanë ardhur t`i çlirojnë të krishterët nga zgjedha muslimane dhe t`i japin liri të gjithëve, ky fakt bën ndesh e t`i acaron nervat.

Është thirrë famulltari i Janjevës për t`i treguar se si është bërë ky kthim. Ai u përgjigj se ata kishin qenë gjithnjë katolikë, por nga frika e turqëve kishin qëndruar fshehur deri tash. Komandanti ka shtuar: “Nëse turqit (shqiptarët e islamizuar) duan të ndërrojnë fe, duhet të bëhen ortodoksë, e jo më katolikë, pëndryshe është më mirë të rrinë turqë”. Këto fjalë tregojnë mjaft qartë se ç`kriter kërkon të ndjekë qeveria e re dhe si shtypjet dhe perndjekja turke të lë të kuptosh atë të skizmatikëve (serbëve). Ia them këto Lartësisë Suaj... që me mjetet e mundëshme, të përpigjeni për liritë tona.”²²⁷

Mjeda kishte arritur në janar të vitit 1913 në Vjenë. Prej aty i shkruan një letër ministrit të punëve të jashtme austro-hungarez Leopold (Graf) Berchtold më 09.01.1913, lidhur situatën në argji-peshkvinë Shkup-Prizren. Ndër të tjera Mjeda shkruan:

Prej shumë kohësh, në Kryepeshkvinë time kishte të krishterë të ashtuquajtur të fshehtë, që fshehurazi ushtronin krishtërimin dhe ishin të pagëzuar, por publikisht, për arsëye frike dukeshin myslimanë. Kur erdhën serbët në këto krahina, disa fshatra të këtyre të fshehurve menduan se erdhi koha të shfaqen dhe u shpallën hapur katolikë. (Këto fshatra janë arbërorë e flasin atë gjuhë, jetojnë në Ferizaj e rrethinë, Janjevë e rrethinë dhe në të gjithë Malin e Zi të Shkupit. Ka edhe të tjerë në krahinat e Prizrenit dhe të Pejës, por për to nuk di gjë ç`kanë bërë). Qeveria Serbe thirri delegatin tim, Imzot Gllasnoviç, dhe kërkoi të dinte si ishte bërë ky kthim i muhamedanëve. Prifti iu përgjigj se nuk kishte ndodhur asnjë kthim

²²⁷ Gjergj Gashi, *Kosova Altari i Arbërisë II*, Eurorilindja 1997, fq. 35.

i muhamedanëve, por vetëm një manifestim i hapur i katolikëve, të cilët deri në atë kohë nga frika e turqëve kishin qëndruar të fshehur.

Megjithatë, ky shpjegim nuk e kënaqi komandantin serb, i cili i tha priftit se, nëse myslimanët duan të ndryshojnë fe, duhet të bëhen ortodoksë, por jo katolikë: përndryshe le të qëndrojnë myslimanë. Edhe në vende të tjera e di që gjysmë-muslimanët që donin të rikthehen në krishtërim, u ndaluan nga qeveria serbe.

Ndërsa më 29.09.1913, imzot Mjeda i shkruan kardinalit Gotti kështu:

Në të vërtetë këto ditë e para u bë një lëvizje e madhe sidomos në anët e Cërnagorës (Mali i Zi i Shkupit), ku pothuajse të gjithë të fshehurit ishin shfaqur tek famullitari i Stubllës dhe i kishin kërkuar një letër, ku të dëshmojnë se ishin katolikë. Famullitari nuk kishte kundërshtuar dhe njëri prej tyre, një farë Jetishi nga Dunavi, ishte shpallur i pari katolik me të gjithë familjen. Por qeveria, pasi mori njoftimin, kishte dërguar t'i thonin që, ose të bëhet ortodoks, ose t'i priste vdekja. I shkreti ishte endur si shtegtar nëpër shpella e ferra për disa kohë, por pastaj...ishte ktyher në shtëpi, duke rënë dakord me dëshirat e tyre.

Ndërsa një tjetër, megjithëse i kërcënuar dhe i rrahur... vazhdonte të mbetet katolik. Kështu edhe ata të Handrocit të Janjevës. Aty, nga 16 familje, vetëm pesë dezertuan; të tjerat i rezistuan me kurajo të gjitha kërcënimeve të qeverisë. Por patën favorin se në krye të komunës së Janjevevës në atë kohë ishte famullitari lokal dhe këta mund të kishin kurajo dhe të mbroheshin nga reprezaljet e serbëve. Kështu që deri tani nga ata që ishin të fshehur kemi vetëm rreth 70 vetë që janë shpallur dhe qëndrojnë hapur katolik. Të tjerët, nga frika, fshihen përsëri dhe kur u bë regjistrimi, u shkruan myslimanë.

Qeveria serbe në atë kohë nuk lejonte që priftërinjtë katolikë të kenë kontakt të drejtpërdrejt me kriptokrishterët apo laramanët në

argjipeshkvinë Shkpu–Prizren, duke i etiketuar priftërinjtë se bënë propagandë austriake dhe perendimore. Nga ana tjetër, shqiptarët e islamizuar ishin të frikësuar se së shpejti do të rikthehet Turqia në këto troje dhe se do të hakmerret keq ndaj katolikëve. Këto propaganda ndikuan shumë negativisht tek ata që donin t'i kthehen identitetit të tyre të lasht fetar. Rreth këtij problemi, Lazër Mjeda shkruan: *Qeveria i ndaloi priftërinjtë të shkonin tek ata dhe të komunikonin me ta, me pretekstin se bënë propagandë austriake. Në të njëjtin raport vazhdon Mjeda:*

...në këtë situatë të rëndë, mendova të shkoj në këto vende e të shikoja se ç'mund të bëhet. E në fakt, në ditën e shtatë të këtij muaji shkova në Letnicë dhe i ftova njerëzit e njohur të fshatrave të ndryshëm. I pyeta pse doni të riktheheni në katolikë? M'u përgjigjën me një zë se ishin katolikë dhe katolikë donin të mbeteshin; por te frikësuar nga njëra anë nga kërcënimet dhe ngacnimet e serbëve, e nga ana tjetër nga privilegjet e myslimanëve, të cilët thonin se së shpejti qeveria turke do të merrte këto krahina dhe do të hakmerrej egërsisht nga tradhëtia e tyre, ishin terhequr e s'ishin shfaqur publikisht katolikë, se prisnin kohë më të mira.

Iu thash të mos i dëgjojnë ata... do të vihesha përbri tyre, për t'i mbrojtur dhe për të vdekur me ta. Fituan besimin në vetvete e kërkuan se ç'duhej të bënin. U shtova atyre: Tani unë nuk jua kërkoj të shkoni shpejt tek qeveria për të bërë rrefimin tuaj të besimit e të nënshkruheni katolikë, sepse ka të ngjarë që tani nuk do të pranoheni, e nga ana tjetër mund të përbënte rrezik, meqë jemi në rrethanat e gjendjes së luftës. Për t'u njohur katolikë, unë ju kërkoj juve që deri në një urdhër të ri, të shkoni në kishën katolike një nga një, por ditën dhe jo natën.

Kështu, në mënyrë indirekte, mund të përmirësoni regjistrimin të bërë si mysliman pranë qeverisë. Për të dhënë këto shenja të rezistencës, ju jap kohë deri ditën e Shën Kollit (6 dhjetor); nderkohë lidhuni me të fshehurit e tjerë që i njihni dhe kërkoni që edhe ata

të bëjnë të njëjtën gjë e të jenë solidarë, nëse qeveria do t'i krijonte ndonjë shqetësim. Mbetën të kenaqur nga kjo zgjidhje dhe prem-tuan të bënin ashtu si ju thashë.

Në këtë raport Mjeda kërkon këshilla nga kardinali Gotti. Qeveria beogradase në atë kohë dhe më vonë kishte kërkuar nga priftërinjtë e argjipeshkvisë Shkup–Prizren emrat që janë të pagëzuar dhe që janë të shënuar në këtë libër, duhet të fshihen dhe kjo punë të mos ndodh më. Pagëzimi apo deklarimi haptas i kriptokatolikëve si katolikë në argjipeshkvinë Shkup–Prizren shihej me sy të keq nga ana e politikës së Beogradit, shihej si akt kundërshtetëror dhe kërkohej nga priftërinjtë që këto gjëra mos të ndodhnin apo ata përsone që dëshirojnë të dalin të krishterë, të deklarohen ortodoksë. Në të njëjtën kohë, edhe përfaqësuesit fetarë të besimit islam (të mbështetur nga qeveritarët) kërkonin nga Beogradi që rikthimi mos të lejohet.²²⁸

Gazeta *Reichspost*, më 20.03.1913 shkruan për laramanët dhe gjendjen e tyre në argjipeshkvinë Shkup–Prizren. Deri më tash ata nuk kishin mund të deklaroreshin haptas për shkak të turqve, kurse tash e kanë problem prej Serbisë, dhe shkruan se qarqet e Beogradit u kishin ndaluar laramanëve të deklaroreshin haptas si katolikë, ose duhet të bëhen mysliman e nëse dëshirojnë të bëhen të krishterë, atëherë ortodoksë.²²⁹ Poashtu edhe Leo Freundlich e merrë këtë artikull dhe e riboton në librin e tij të titulluar: *Golgota shqiptare* (Albaniens Golgotha).²³⁰

Më 31.01.1911,²³¹ Konsullata austriake në Shkup, njofton se kishte pasur një grup ortodoksë nga Kumanova që kishin shkuar tek argjipeshkvi Lazër Mejda dhe tek famullitari i Ferizajit dom Pashk

²²⁸ Krah. Nikola Žutić, *Rimokatolička misija i klerikalizam u Kraljevini Jugoslaviji 1918-1941*, Beograd 1998, fq. 108.

²²⁹ *Der Konflikt mit Montenegro*, në: *Reichspost*, 20 mars 1913, fq. 2.

²³⁰ Leo Freundlich, *Albaniens Golgotha, Anklageakten gegen die Vernichter des Albanervolkes*, Wien 1913, fq. 27.

²³¹ *HHStA XXXVIII PA. 441, Konzullate Üskutüb 1911-1913*, 31.01.1911, fq. 293-294.

Krasniqi, duke kërkuar ndihmën e tyre për t'u rikthyer në katolikë. Fjala është për besimtarë ortodoksë maqedonas, që dëshironin të kalonin në katolicizëm. Është i njohur komuniteti greko-katolik me kombësi maqedone në Maqedoninë e jugut, në Strumicë e rrethinë, por këta ishin tamam ortodoksë. Komunitetin greko-katolik në Maqedoninë e sotme ia kishte besuar Papa Benedikti XIV më 1915 argjipeshkvit të Shkupit L. Mjeda. Argjipeshkvi Mjeda ishte pra edhe argjipeshkëv i katoliëkve të ritit bizantin në Maqedoni, që me komb janë maqedonas. Argjipeshkvi Mjeda dëshironte që këtë komunitet ta vizitonte vetëm dhe të shihte saktë se si është gjendja e këtyre shpirtrave që Papa ia kishte besuar. Organet e atëhershme bullgare nuk i dhanë Mjedës leje që të viziton këtë komunitet.

Viti 1915 ishte shumë vit i vështirë edhe për katolikët e ritit bizantin, sepse bullgarët kishin vra e mbytë dhe kishin shkatërruar gati çdo gjë që ata kishin, shtëpia e pasuri tjera. Pasi që Mjeda nuk mund të shkonte në këtë zonë, ai organizoi që ndihmat tu dërgonte gjithësesi dhe përmes priftit Nedeljko, i cili më 20.03.1916 i shkruan një letër falenderimi Mjedës për këto ndihma të rëndësishme.²³²

Gjatë viteve 1913–14 zhvilloheshin bisedimet mes Vatikanit dhe Serbisë lidhur më një marrëveshje zyrtare apo konkordat. Ambasadori i Austrohungarisë në Vatikan, Alois (Fürst) Schöngurg-Hartenstein, dhe ministri i Punëve të Jashtme Austro-hungarez, Leopold (Graf) Berchtold, duke u angazhuar për përmirësimin e gjendjes shqiptare dhe ruajtjen e protektoratit austro-hungarezë, njëherit shqyrtuan edhe situatën e pavolitshme shqiptare. Bisedat dhe shkrimet që shkëmbeheshin mes zyrtarëve austrohu-hungarez dhe të kardinalit Merry de Val, Vatikani (duke iu referuar shkresave të imzot Mjedës, sidomos të asaj nga 9.01.2013) kërkonte lirinë fetare të shqiptarëve në Argjipeshkvinë Shkup-Prizren. Nga kjo

²³² Rudolf Grulich, *Die unierte Kirche in Maqedonien (1856-1919)*, Augustinus-Verlag, Würzburg 1977, fq. 91.

marrëveshje Serbia obligohet të respektojë lirinë fetare dhe të drejtat e shqiptarëve në këto troje.

Më 12.03.1913,²³³ ambasadori i Austro-Hungarisë në Romë Schönbürg, lajmëron se kishte biseduar me Vatikanin lidhur me lirinë fetare të shqiptarëve në argjipeshkvinë e Kosovës. Kështu që qysh në fazën e parë të bisedimeve lidhur me konkordatin kishte shprehur dëshirën për të siguruar të drejtat e shqiptarëve. Vjena dhe Roma ishin të njoftuara për gjendjen e shqiptarëve pas largimit të Turqisë nga Ballkani, por tash kishin lindur probleme të reja për ta, pra Serbia. Në këtë letër ceket se për trysnitë fetare në argjipeshkvinë Shkup-Prizren ishin njoftuar nga raportet e argjipeshvkit Lazër Mjeda.²³⁴

3. Lufta për të drejtat e shqiptarëve dhe intrigat politike të qeveritarëve

Nga disa reagime të prefektit të Prizrenit, më 1921, mësojmë se imzot Lazër Mjeda ishte thumb në sy nga fakti se gjoja e “atakonte” Serbinë me letrat e tija drejtuar faktorëve politik ndërkombëtar për trysnitë politike dhe kulturore mbi shqiptarët. Pushtetmbajtësit lokal serbë, erdhën deri te ideja duke iu drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, që “Dom Mikel Tarabulluzi të pensionohet” në mënyrë që gradualisht të krijohen mundësitë për ta larguar nga argjipeshkvia Shkup-Prizren, dhe jo vetëm dom Mikel Tarabulluzin, por edhe argjipeshkvin imzot Lazër Mjeda.

Sipas disa dokumenteve që gjenden në Arkivin Ushtarak të Beogradit, në to flitet për Lazër Mjedën se i kishte arritur një letër nga dom Mikel Tarabulluzi nga komuna e Vitisë (Stublla), letër kjo që e mban datën 15.01.1920. Ajo është e shkruar në gjuhën italiane.

²³³ *ÖStA*. PA, XIII, 314 Türkei, XXXIV / 5 A, më 12. shkurt 1913.

²³⁴ Këtë e dëshmon edhe letra e ministrit të Punëve të Jashtme, Leopold (Graf) Berchtold më 02.04.1914, dërguar përfaqësuesit Alois (Fürst) Schöngurg-Hartenstein. Shih në: *Östa*. PA. XIX, 93, Serbien XVIII/ (Rom - V.) 2480, më 02.04.1914.

Nga letra pushteti dyshonte se këta të dy (Mjeda e Tarabulluzi) veprojnë kundër shtetit jugosllav, sepse ata dëshironin që të mos mbyllen shkollat në gjuhën shqipe, që gjendeshin në kuadër të kis-have (famullive) nëpër Kosovë dhe në Shkup.

Kjo letër zihet nga pushteti i atëhershëm jugosllav. Në bazë të saj, dom Mikel Tarabulluzi burgoset për shkaqe të angazhimit për shkollën në gjuhën shqipe. Megjithatë, siç duket qeveria serbe kishte telashe edhe më të mëdha me argjipeshkvin e Shkupit, imzot Lazër Mjedën, se sa me dom Mikel Tarabulluzin. Mirëpo, pushteti serb ishte i vetëdijshëm se po të merrte masa represive kundër Mjedës, do të kishte probleme ndërkombëtare, sepse imzot Mjeda kishte raporte të mira dhe të intesifikuara me qarqe diplomatike nëpër Evropë. Duke filluar nga ky fakt, qeveria kërkonte mënyra tjera, më të sofistikuar për ta larguar atë nga kryepeshkvia Shkup-Prizren. Qarqet e caktuara, me rekomandim të Beogradit, e bënë aktpadinë kundër imzot Lazër Mjedës, të cilin edhe e dënuan. Ndërkaq, për t'iu ikur telasheve, në vitin 1922, Vatikani e emëroi Mjedën metropol të Argjipeshkvisë së Shkodrës. Largimi i tij nga Shkupi u bë me peripeci nga organet shtetërore, ndërsa për interesat shqiptare, largimi i Mjedës nga Maqedonia dhe Kosova ka lënë pasojë të dukshme.

Më 14.02.1922, Mjeda arrin në Shkodër. Kurse pas largimit të Mjedës nga Shkupi, Beogradi krijohet argjipeshkvi, kurse Shkupi bëhet ipeshkvi. Pas Mjedës, që kishte reziduar në Prizren, me pre-tendimet e kahershme të Beogradit që Selinë ipeshkvore ta shpërngulte nga Prizreni në Shkup, pasardhësi i imzot Mjedës, Ivan Gnidovec, sloven, do të rezidojë në Shkup.

Lazër Mjeda, i emëruar që më 1909, ishte argjipeshkvi i fundit i Argjipeshkvisë së Shkupit, e cila më vonë u transformua në ipeshkvi.

ALBERT RAMAJ

Instituti Shqiptar në St. Gallen – Zvicër

GJENDJA E ARGJIPESHKVISË SË SHKUPIT DHE VEPRIMTARIA E ARGJIPESHKVIT LAZËR MJEDA

Nëse e vlerësojmë punën e argjipeshkvit Lazër Mjeda, sa ishte argjipeshkëv i argjipeshkvisë Shkup, lirisht mund të dhuhet se L. Mjeda ishte për atë kohë jo vetëm argjipeshkëv, pra bari shpirtëror i kaktolikëve të argjipeshkvisë Shkup, por të njëjtën kohë, ai kishte marrë përmbi vete obligimin moral që të jetë diplomat, politikan e prijës për mbrojtjen e popullatës jo vetëm katolike, por edhe muslimane shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi, Serbi e më gjerë.

Gjatë këtij shkrimi për lexuesin ndoshta do të shfaqen habi, për shkak të temave të ndryshme, për shkak të kapërcimit prej një pjese në tjetrën gjatë leximit, por duhet pasur parasysh se të gjitha ato ndryshme dhe procese historike kishin ndodhur në Ballkan, pikërisht kur Lazër Mjeda ishte argjipeshkëv në argjipeshkvinë e Shkupit. Pra, është fjala “vetëm” për 13 vite, sa ai qendroi atje, sepse është e pamundur që në një shkrim të shkurtër të përfshihen të gjitha ngjarjet. Gjithsesi duhen pasur parasysh edhe gjithë ato procese: luftëra kundër turqve, luftërat ballkanike, botërore; pastaj shpallja e pavarasisë së Shqipërisë. L. Mjeda ishte edhe dëshmitar i shumë proceseve të lartpërmendura; dhe përveç përcjelljes së atyre proceseve, ishte angazhimi i tij si klerik jo vetëm në sferën shoqërore, politike e diplomatike, por edhe në atë fetare e pastorale.

Është me shumë rëndësi që të ceket se si ishte e mundur që popullata shqiptare, e sidomos ajo katolike në Kosovë e Maqedoni, të mbijetonte gjatë periudhës sa ishte Lazër Mjeda argjipeshkëv. Për

këtë gjë, më së shumti ka merita vetë argjipeshkvi me angazhimin e tij. Puna dhe veprimtaria e tij është tejet e rëndësishme për Kosovën dhe Maqedoninë dhe është në të njëjtën kohë poashtu zhgënjyese që historiografia shqiptare e ka lënë në harresë këtë personalitet të madh. Shpresojmë se kjo punë nuk bëhet qellimisht nga historianët shqitarë. Është poashtu edhe e papranueshme dhe që bie në sy, se në mbarë hapësirën shqiptare nuk ka asnjë shesh apo rrugë që të mbajë emrin e Lazër Mjedës, as në Kosovë apo Maqedoni, kur dihet sa kishte bërë ai për Kosovën dhe për Maqedoninë. Po të mos ishte Lazër Mjeda, me mençurinë dhe maturinë e tij, më 1913, territori i Kosovës së sotme, ndoshta nuk do të ishte si është, sepse ai ishte në fakt që prapë Kosovës iu kthye, më 1913, territori i Pejës, Gjakovës e rrethinës që kishin okupuar malazezët. Është poashtu e ditur se, po të mos e ndihmonte Lazër Mjeda Ismail Qemalin për të ardhur në Shqipëri, në nëntor të 1912, Plaku i Vlorës nuk do të kishte mundësi të arrinte në kohën e shpalljes së pavarësisë.

Për të kuptuar sa më mirë gjendjen e argjipeshkvisë së Shkupit gjatë veprimtarisë së Lazër Mjedës, duhet të shtjellojmë disa ngjarje historike të kohës, para se të emërohej Lazër Mjeda argjipeshkëv i Shkupit.

Protektorati austrohungarez gjendja e argjipeshkvisë së Shkupit

Shtrirja e pushtimit osman në Ballkan nënshtroi edhe tokat shqiptare. Popullata e krishterë e Ballkanit, pra edhe ajo katolike shqiptare, kërcënohej të konvertohej e gjitha në islam, prandaj fuqitë e mëdha bënë hapa diplomatikë për t'i marrë në mbrojtje këta besimtarë. Austria kishte arritur disa marrëveshje me Perandorinë Osmane për të mbrojtur katolikët në ato vende ku sundonin turqit, pra arrihen marrëveshjet e ashtuquajtura paqësore mes këtyre dy fuqive të asaj kohe, si ajo e Vjenës në vitin 1615. Kjo kontratë, në fillim, kishte për qëllim që të mbrohet kleri i krishterë, kurse me arritjen e marrëveshjes së vitit 1681 në Stamboll, e sidomos ajo e vitit 1699, në Sremski Karlovac, përfshinte jo më vetëm klerikët,

por edhe të gjithë besimtarët e krishterë që gjendeshin nën sundimin osman. Pastaj u nënshkruan edhe kontratat e vitit 1718 në Pozharevc, më 1739 në Beograd dhe më 1791 në Svištov, të cilat kishin të njëjtin qëllim: mbrojtjen dhe përkrahjen e besimtarëve të krishterë në trojet e okupuara nga osmanët. Por, me nënshkrimin e aktit të Svistovës, iu dha e drejta Austro-Hungarisë që të hapë përfaqësitë e veta diplomatike në trojet shqiptare. Këto marrëveshje i mundësonin Austrisë që të intervenojë dhe të mbrojë, sidomos katolikët në aspektin fetar e kulturor. Në këtë mbrojtje bëjnë pjesë edhe shqiptarët e krishterë. Si figurë e njohur që ka dhënë një kontribut të çmuar në këtë drejtim ishte edhe ipeshkvi i Shkodrës, Benino Alberini, që kishte kontakte të përhershme me Romën dhe Vjenën. Ndërsa në vitin 1837, zyrtarisht edhe Vatikanit ia bart kompetencat me dekret Austrisë që t'i mbrojë katolikët në Ballkan.²³⁵ Një etapë e rëndësishme në zhvillimin e *Protektoratit të Kultit* shënohet në vitin 1855, kur u arrit Konkordati në mes të Vatikanit dhe Austrisë, i cili parashihte mbështetjen e një "Programi Veprimi" të Ballhausplatz-it²³⁶, nga ana e Vatikanit, dhe posaçërisht veprimtarinë e Propaganda Fides. Si rezultat i këtij Konkordati, është edhe ardhja e disa etërve jezuitë në Shqipëri, të cilët u bënë një faktor përcaktues i politikës kulturore të Austro-Hungarisë në këtë vend. Prej 240 institucioneve katolike të Protektoratit të Kultit në Perandorinë Osmane, 220 ishin vetëm në Shqipëri. Hapësira e ndikimit të Austro-Hungarisë në kuadrin e Protektoratit të Kultit shtrihej në Shqipëri, sidomos në shtatë dioqeza katolike: Shkodër,

²³⁵ A. H. Bena, Studien zum Kultusprotektorat ÖSTERREICH-Ungarns in Albanien in Zeitalter des Imperialismus (1888-1918), Vjenë 1954. Shih edhe: Frok Zefi, Austria mbrojtëse e katolikëve në Ballkan, Urtia 1/1994, fq. 94-96.

²³⁶ Ballhausplatz është shesh në qarkun e parë të Vjenës, është fjalë që përdoret për monarkinë austro-hungareze. Në sheshin Ballhausplatz ishte atëherë edhe godina e ministrisë së punëve të jashtme austro-hungareze. Sot janë në atë apo afër këtij sheshi gati të gjitha strukturat shtetërore austriake, si kancelaria austriake që ishte ndërtuar si godinë qysh më 1717-19 nga arkitekti J. L. von Hildebrandt.

Lezhë, Durrës, Shkup, Sapë, Pult e Mirditë. Shkodra, si seli ipesh-kvore, ishte qendra e katolicizmit shqiptar.²³⁷

Duhet pasur parasysh se deri më 1890, konsujt që ishin në Shqipëri (kuptohet se nuk është fjala vetëm për Shqipërinë e kufijve shtetërorë të sotëm, por edhe Kosovë, Maqedoni e gjetiu), nuk kishin simpati të duhur në popull për shkak se deri në atë kohë, konsujt ishin njerëz të familjeve aristokrate austriake dhe në relacion me shqiptarët ishin mendjemëdhenj. Por duhet thënë edhe një gjë, se Austro-Hungaria, pas kongresit të Berlinit, më 1878, angazhimin konkret diplomatik e kishte marrë tamam me kuptimin e fjalës „*mbrojtëse e katolikëve në Ballkan*“. Më parë, ishte më shumë diplomaci reprezentuese se sa mbrojtëse. Sidomos kjo ka të bëjë po ashtu edhe me konsujt që njihnin shumë mirë Shqipërinë dhe popullin shqiptar, jo vetëm në aspektin gjeografik, por edhe në atë kulturor, gjuhësor, historik, etnografikë etj.

Më 1886 është nënshkruar konkordati i Malit Zi më Vatikanin. Kjo ndoshta nuk kishte shumë ndikim në raport me Austro-Hungarinë, sa ishte ideja tjetër që të nënshkruhej një konkordat mes Vatikanit dhe Perandorisë Osmane për çështjen e katolikëve në territoret e pushtuara të saj. Ideja për një gjë të tillë lindi nga Perandoria Osmane dhe si shembull duhet të merrej konkordati malazias me Vatikanin, qëllimi i të cilit ishte që të zbuste çështjen e protektoratit austro-hungarez, apo edhe tërthorazi (më vonë), të asgjëson politikën austro-hungareze në Ballkan, sidomos politikën në të mirë të popullit shqiptar. Për një gjë të tillë ishte përzgjedhur njeriu që ishte shumë i afërn në qarqet zyrtare dhe private në Perandori. Për këtë u zgjodh patriku armen, Stefan Azarian, i cili më 1878 vizitoi Romën dhe Vjenën, me qëllim të caktuar i dërguar nga Turqia, që Vatikani të mund të hyjë në bisedime me Perandorinë Osmane lidhur me konkordatin. Ministri i atëhershëm i punëve të jashtme i Austro-Hungarisë, Gustav Kalnoky kishte biseduar me Azarian

²³⁷ Krahaso. Kurt Gostentschnigg, Phoenix, 1-2 (15-16), Shkodër, 2000, fq. 37.

lidhur më këtë çështje, por ministri ishte i rezervuar për ndonjë konkordat të mundshëm²³⁸. Azariani ishte tepër dinak me diplomatët perëndimorë, sepse nuk u tregonte qëllimet që kishte për të arritur jo vetëm ai, por edhe Perandoria Osmane, kështu që edhe ministrit Kalnoky nuk i tregoi tamam si duhet, por as gjysmën e vërtetë. Ministri mendonte se një lloj konkordati mund të ishte një gjë e mirë për përmirësimin e gjendjes së Kishës Katolike në Shqipëri dhe i tha Azarianit se mund të bisedohet për këtë gjë e shpesh ndodhte që austro-hungarezëve u tregonte vetëm një pjesë, Vatikanit po ashtu, e francezëve të njëjtën gjë. Kështu ai kishte krijuar një gjendje kaotike diplomatike me mashtrimet e veta për qëllime private, pra atë që kishte qëllim të përbashkët me qarqet zyrtare turke, që të mënjanohej protektorati austro-hungarez në Shqipëri.

Qëllimi i Turqisë ishte që ipeshkvijtë dhe priftërinjtë në trojet shqiptare mos të kenë lidhje të mira me Austro-Hungarinë, e gjithsesi të mos jenë shtetas austro-hungarezë, siç ishte rasti i Fulgencije Carev, argjipeshkvit të Shkupit. Më të vërtetë është bërë një koncept me disa pika për konkordin mes Vatikanit dhe Turqisë, duke iu falënderuar dinakërisë së patrikut armen Stefan Azarian. Një ndër pikat e vendosura kishte të bënte edhe drejtpërdrejt me Protektoratin austro-hungarez mbasi edhe Turqia ruante të drejtën edhe në veto, kur është fjala për emërimin e ipeshkvijve në Shqipëri, pastaj ipeshkvijtë e Shqipërisë nuk duhet të caktoheshin nga Austro-Hungaria dhe ipeshkvijtë duhet patjetër të kishin *dëgjese* ndaj sulltanit.... Kur Vjena pa se nuk ishte puna për një konkordat për katolikët në Perandorinë Osmane, por në fakt kishte të bënte definitivisht për zhbërjen e Protektoratit austro-hungarez, u tërhoq nga ky synim i Turqisë. Këtë i deklaroi edhe ministri i atëhershëm, Kalnoky, ambasadorit të vet në Romë, pasi që ishte njoftuar se Azariani kishte vizituar prapë Romën.²³⁹ Lidhur me konkordin mes Vatikanit dhe Turqisë, ishte edhe një ide që të

²³⁸ Benna, Studien zum Kultusprotektorat, fq. 21.

²³⁹ Benna Studien zum Kultusprotektorat, fq. 28.

avancohet më shumë protektorati i Francës sesa ai austro–hungarez. Qëllimi i Portës së Lartë ishte që më të vërtetë të mënjanonte Austro–Hungarinë si mbrojtëse e katolikëve në Ballkan, konkretisht kishte problem me mbrojtjen e katolikëve shqiptarë. Rreth konkordatit mes Perandorisë Osmane dhe Vatikanit ishin shkëmbyer edhe letrat personale mes Papës Leonit XIII dhe perandorit Franz Joseph. Papa i shkruan letër Perandorit, më 6 mars 1893²⁴⁰, kurse perandori austriak kishte përgjigjur më 1 qershor 1893²⁴¹; dhe në të dy letrat bëhet fjalë edhe për konkordinin mes Vatikanit dhe Perandorisë Osmane; gjithashtu në të dy letrat flitej për gjendjen e kishës katolike në Shqipëri. Shihet shumë qartë se Austro–Hungaria dëshironte me çdo kusht të kishte Protektoratin, dhe pas këtij viti u ndërpre në bisedimet rreth këtij konkordati të mundshëm mes Vatikanit dhe Perandorisë Osmane. Kishte edhe disa memorandume austro–hungareze që i kishte dërguar Vatikanit rreth mospajtimeve lidhur me konkordinin e mundshëm mes Vatikanit dhe Turqisë, sikur ato të Abatit mirditor Prengë Doçi, i cili i kishte shkruar letër nuncit apostolik në Vjenë, Antonio Algiardi, më 5 tetor 1893, dhe kishte “nuhatur” se qëllimi i patrikut armen, Stefan Azanar, nuk ishte që të përmirësohej gjendja e Kishës katolike në Shqipëri, por që përmes një arritje të një konkordati të shpresohet që tek Porta e Lartë të kishte gjasa më të mira për përmirësimin e gjendjes së armenëve në Perandorinë Osmane dhe për interesa personale.²⁴²

Për të avancuar edhe më shumë punën e konkordatit mes Vatikanit dhe Turqisë dhe për të treguar “liberalizmin” e vet, Turqia i dha argjipeshkvit të Shkupit, Pashk Trokshit, më 1893, *fermanin* për liri fetare, duke shpresuar me këtë se do të fillonin prapë bisedimet lidhur me konkordinin mes Vatikanit dhe Turqisë, apo më mirë të thuhet se Turqia dëshironte me çdo kusht që Protektorati austro–hungarez për mbrojtjen e katolikëve shqiptarë, të mos ekzistonte

²⁴⁰ Friedrich Engel-Jánosi, fq. 343-346.

²⁴¹ Friedrich Engel-Jánosi, fq. 346-351.

²⁴² Krah. Andreas Gottsmann, 433.

fare, e kjo mund të ishte arritur, nëse do të ishte nënshkruar një konkordat sipas dëshirës së Turqisë.

Duhet pasur parasysh se kishte ipeshkvij shqiptarë që nuk e dëshironin konkordatin austro-hungarez e sidomos ata që ishin nën ndikim të italianëve, apo edhe dëshironin që të avanconin protektoratin francez në territoret shqiptare. Një prej tyre ishte edhe argjipeshkvi i Shkupit, Pashk Trokshi. Në raportet e konsujve të Prizrenit dhe në dosjen personale të Pashk Trokshit, shihet qartë se P. Trokshi nuk ishte në pajtueshmëri me Austro-Hungarinë²⁴³ dhe mendohet se Trokshi ishte kundërshtar i Austro-Hungarisë dhe se kërkon nga Franca të jetë mbrojtëse e katolikëve në argjipeshkvinë e tij e jo Austro-Hungaria. Atë e paraqesin edhe si „*ideolog i vërtetë shqiptar*“.²⁴⁴ Konflikti mes Austro-Hungarisë dhe Trokshit ishte ndoshta më shumë i panevojshëm dhe se ishin shumë mosmarrëveshje mes përfaqësuesve zyrtarë të Austro-Hungarisë dhe të argjipeshkvit Trokshi. Duhet pasur parasysh se Austro-Hungaria mendonte se ishte dobësuar çështja e Protektoratit në Ballkan, sidomos në territorin e popullatës shqiptare dëshironte që të angazhohej edhe më shumë, dhe të njëjtën kohë të mos linte Francën të kishte ndikim në qarqet kishtarë shqiptare dhe se Austro-Hungaria mendonte se duhej të përkujdesej edhe më shumë sesa deri para Kongresit të Berlinit për të krishterët e këtyre vendeve e kështu dëshironte të përforcohej edhe më shumë politikisht në Ballkan. Në të ashtuquajtur „*Memorand*“ austro-hungareze edhe në „*Archivio degli Affari Ecclesiastici Straordinari*“ janë të publikuar më 7 dhjetor të 1899, dhe para së gjithash në memorandet e 11 marsit 1899 (faqe 77–81) dhe gusht 1899 (faqe 90–95) edhe qëndrimet e argjipeshkvit Trokshi përballë protektoratit austro-hungarez²⁴⁵. Këtu akuzohet Trokshi se kishte bashkëpunuar me qeverinë turke duke iu kundërvënë edhe Protektoratit austro-hungarez. Dihet se në

²⁴³ Krahaso, HHStA A.R, F 27, 136 dhe Bischof Trokshi.

²⁴⁴ Hrabak, kulturni... fq 45.

²⁴⁵ Krahaso, Gottsmann, 433.

kohën e Trokshit ishin edhe bisedimet për konkordat mes Turqisë dhe Vatikanit, kështu që çdo gjë që bëhej kundër Austro-Hungarisë ishte në favor të Turqisë, sepse Turqia kishte pretendim që të arrinte deri te nënshkrimi i konkordatit, porse Austro-Hungaria nuk kishte kurrfarë interesash, sepse protektoratin e vet e merrte si të ishte një konkordat për shqiptarët, vetëm se kishte emërtim tjetër.

Në kohën e argjipeshkvit Lazër Mjeda, sidomos gjatë luftërave ballkanike, Protektorati austro-hungarez ishte tejet me rëndësi për popullatën shqiptare. Më nuk ishte rëndësia e Protektoratit për të mbrojtur katolikët shqiptarë ndaj turqve, por në fakt, ishte akt politik për mbrojtjen e popullatës shqiptare nga shumë sulme të pamëshirshme, sidomos nga ana serbe dhe përmes Protektoratit mbroheshin interesat e popullit shqiptar, përveç edhe interesave e monarkisë dualiste. Ballhausplatz-i vjenetz nuk ishte më vendi ku “*mbronte vetëm katolikët shqiptarë,*” por të gjithë popullatën shqiptare.

Më nënshkrimi e konkordatit mes Vatikanit dhe Serbisë, më 1914, ishte *de facto*, edhe përfundimi i Protektoratit të Austro-Hungarisë në Ballkan, më konkretisht për shqiptarët. *De jure*, zgjati deri më 1918, por *de facto*, me konkordin e 1914, përfundon. Në fakt, konkordati mes Serbisë dhe Vatikanit nuk ishte gjë tjetër, përveç që kishte qëllim zhdukjen e Protektoratit austro-hungarez ndaj shqiptarëve. Bisedimet rreth konkordatit mes Serbisë dhe Vatikanit, që ishin zhvilluar qysh më 1894, kishin të bënin me territorin e Serbisë, pra pa territorin e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi. Ato bisedime kishin të bënin, në fakt, me krijimin e një ipeshkvie kato- like në Beograd, rreth famullive katolike në Nish, Kragujevc e Beograd e asgjë tjetër me territorin e sotëm të Kosovës, kurse konkordati i 1914 ishte, në fakt, kishte të bënte për Kosovën e Maqedoninë, dhe ngrihej kundër Protektoratit austro-hungarez.

Me Protektoratin austro–hungarez, në bazë të marrëveshjeve me shqiptarët, dërgohen në Shqipëri misionarë dhe hapën shkolla katolike, përveçse u ndanë subvencione dhe ndihma tjera për të ndihmuar, ngritur dhe mirëmbajtur edhe objektet fetare katolike. Këto ndihma bënë që populli shqiptar të zhvillohet dhe të konstituohet, gjë që pengohej nga Serbia.

Argjipeshkvi i Shkupit Fulgencije Carev²⁴⁶ ishte shtetas austro–hungarez. Është e njohur që Carev dëshironte që argjipeshkvia e Shkupit të shtrihej me kufijtë e saj deri edhe në Selanik. Ai quhej edhe “Ipeshkvi i Austro–Hungarisë”, sepse “përfaqësonte” interesat e Austro–Hungarisë. Për këtë gjë, autoritetet turke e shihnin me dyshim argjipeshkvin Carev. Atë e burgosin dhe kishin qëllim që të izolonin nga popullata krishtere e argjipeshkvisë së Shkupit. Ai e kishte ndejën, në fillim në Prizren, por më vonë ishte i obliguar të shkonte me rezidencë në Shkup. Rezidencën e vet në Prizren ua dorëzon në shërbim motrave franceze, që të hapin shkollën në Prizren, më 1890. Kurse me ardhjen e argjipeshkvit Pashk Trokshi, vendos që rezidenca ipeshkvore të rivendoset prej Shkupit në Prizren. Pasi që në rezidencën ipeshkvore të Prizrenit ishin motrat, Trokshi vendosi që të marrë për banim disa dhoma në atë rezidencë, kurse motrat të vazhdojnë shkollën që kishin për fëmijët e Prizrenit. Austro–Hungaria nuk dëshironte që Franca të kishte ndikim mbi të krishterët në argjipeshkvinë e Shkupit. Kështu që, me ndikim të Austro–Hungarisë largohen motrat franceze nga Prizreni dhe vendosen motrat nga Zagrebi.²⁴⁷ Ishte pra, problem rreth rezidencës ipeshkvore të Shkupit të jetë në Shkup apo Prizren, për të cilën Trokshi ra në konflikt me Austro–Hungarinë. Trokshi ishte i mendimit që rezidenca ipeshkvore t’i rikthehet argjipeshkvit dhe motrat të ndërtojnë një godinë tjetër. Rikthimi i Trokshit në Prizren mendohej nga ana e tij se Prizreni ishte edhe

²⁴⁶ Mbi argjipeshkvin Carev shih më gjërësisht: VELNIC Teofil: Fulgencije Carev, Nadbiskup, Pazin, 1961.

²⁴⁷ Hrabak, 49, Zefi, 32.

afërsia gjeografike më e përshtatshme për të gjitha famullitë e argji-peshkvisë. Pas Pashkëve të vitit 1898, Trokshi vizitoi Vjenën dhe Romën dhe pas një marrëveshjeje, u pajtuan që të tre në një pikë që, me financa të veta, Austro-Hungaria të ndërtojë rezidencën ipeshkvore në Prizren, ku Trokshi, më 1900, u kthye në argji-peshkvi dhe filloi punën aty. Popullata katolike dëshironte që Trokshi të rikthehej në argjipeshkvi e jo ta lëshonte atë. Popullata nuk dëshironte të shkonte as në kishë, as nuk dërgonte fëmijët në shkollë apo kishë, kështu që kishte edhe të tillë që mendonin se më mirë të largohej konsullata austro-hungareze sesa argjipeshkvi Trokshi. Por me emërimin e argjipeshkvit të Shkupit më 1909, Lazër Mjeda, raportet me Austro-Hungarinë dhe ipeshkvinë ishin jashtëzakonisht të mira, në këtë kontekst kishte vepruar pozitivisht edhe vet dom Zef Ramaj famulltar i Shkupit në atë kohë, i cili kishte raporte shumë të mira me konsujt austro-hungarezë, sidomos atë në Shkup, ku dom Zefi ishte famulltar, një prej arsyeve ishte se dom Zef Ramaj kishte studjuar në Innsbruck të Austrisë deri më 1907.

Emrimi dhe ardhja e Lazër Mjedës në argjipeshkvinë e Shkupit

Argjipeshkvi Pashk Trokshi, ndonëse ishte në konflikt të vazhdueshëm me Austro-Hungarinë, megjithatë kishte raporte të mira me konsullatën Austro-Hungareze në Shkup. Kjo, sidomos kur ishte në pyetje e mira e përbashkët e popullatës shqiptare përgjithësisht dhe ajo e pjesës katolike në Argjipeshkvinë e Shkupit, në mënyrë të veçantë. Pa dyshim, interesat ishin të dyanshme, reciproke. Austro-Hungaria, thënë për hir të së vërtetës, provonte me çdo kusht t'i ndihmonte shqiptarët në Ballkan, sikundër edhe Trokshi, por që ky i fundit, ndonëse nuk kishte simpati për francezët, dëshironte në njëfarë mënyre që austriakët të zëvendësoheshin nga pala franceze. Në këtë kontekst, do ndryshonte dhe protektorati, që do thotë se shqiptarët do hynin nën protektoratin francez. Përkundër këtij mendimi a dëshire të P. Trokshit, ky më

1897²⁴⁸, kërkonte nga austriakët që 5 studentë nga Ipeshkvia e Shkupit të dërgoheshin për studime të teologjisë e të edukoheshin në shkollat, qarqet austriake. Ne nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë dëshmi (arkivore) nëse të njëjtën gjë P. Trokshi, do ta ketë bërë edhe me francezët. Pra, për shkollimin e të rinjve shqiptarë Trokshi parapëlqente Austrinë.

Trokshi kishte vështirësi të mëdha edhe me autoritetet turke. As ata nuk e dëshironin Trokshin ipeshkëv. Për profanizimin e një xhamie në afërsi të Gjakovës, besimtarë myslimanë dhe autoritetet turke ngarkonin Trokshin, me arsyetimin se ajo ishte një ndërmarrje e tij. Arsyetimet e P. Trokshit se ai nuk kishte dorë në këtë çështje ishin krejt të kota. Në këto rrethana, autoritetet e Austro-Hungarisë i kërkuar Vatikani largimin e Trokshit nga Argjipeshkvia dhe pensionimin e tij. Shih për këtë, në vitin 1908, Trokshi i ofroi dorëheqjen Papës Piut X. Ky i fundit e ftoi në Romë P. Trokshin, dhe po të njëjtin vit, më 29.04.1908, e emëroi atë ipeshkëv titullar të Ipeshkvisë Nacolia Nacolen(sis) të Azisë së Vogël, detyrë kjo, të cilën e mbajti deri në vdekje, më 29.07.1917. Do thënë se për datën e vdekjes së Trokshit kishte disa mendime, përmendeshin vitet 1909 e 1910. Vitet e jetës së tij, pas pensionimit dhe emërimit ipeshkëv titullar i Ipeshkvisë së sipërshënuar, Trokshi i kaloi në Romë. Për këtë periudhë kohore, do thënë se, nuk kemi dhe aq gjëra të shkruara që do na informonin për angazhimet e P. Trokshit. Është e njohur dhe kjo letër përshëndetëse e Trokshit, shkruar me rastin e largimit nga Argjipeshkvia e Shkupit. Se Trokshin nuk e dëshironte as Austro-Hungaria, flasin shumë dokumente, siç dëshmon edhe Gaspër Gjini.²⁴⁹ Deri në ardhjen e Lazër Mjedës (vëllai i Ndre Mjedës) në krye të Argjipeshkvisë, atë e udhëhoqi (për më shumë se një vit) Nikola Glasnovi nga Janjeva, administrator apostolik i Argjipeshkvisë së Shkupit. Nga e njëjta familje,

²⁴⁸ HHStA A.R, F 27/K. 49, Mission Albanien 1871-1911, Albanische Seminaristen in Innsbruck.

²⁴⁹ Gjini Gaspër, Ipeshkvia Shkup-Prizren, fq. 202.

Argjipeshkvinë, pas largimit të Mjedës, e udhëhoqi dom Toma Glasnovi.

Kur Mjeda u emërua në krye të dioqezës së Prizrenit ishte vetëm 40 vjeç. Prift u shugurua në vitin 1891. Angazhimi i tij kishte bërë që ai të ishte mjaft i respektuar nga besimtarët dhe vetë ipeshkvi i Pul-tit Nikola Marconi. Ky i fundit e emëroi njëkohësisht për këshilltar dhe sekretar të vetin, detyrë kjo që e kreu deri sa u emërua Ipeshkëv i Sapës, më 1901. Edhe këtu do fitojë zemrat e grigjës së vet, duke lënë një përshtypje të jashtëzakonshme. Më 1905 emërohet ipeshkëv ndihmës i Shkodrës e koadjutor i kësaj argjipeshkvie. Kjo do thotë se, sipas ligjit (kanonit) kishtar, pas Argjipeshkvit Pasquale Guerini, Mjeda do duhej të ishte Argjipeshkëv i Argjipeshkvisë së Shkodrës. Emërimi i Mjedës për Argjipeshkëv të Argjipeshkvisë së Shkupit, e kishte lënë sërish çështjen e hapur se kush do ishte pasardhësi i MonsinJOR Guerinit në Shkodër, duke krijuar “rrëmujë” tek kleri e populli, i cili nuk dëshironte largimin e Mjedës nga Shkodra. Emërimi i Mjedës, ndërkaq ishte bërë pa dëshirën e tij. Edhe Austro-Hungaria e shihte të një rëndësie të veçantë qëndrimin e Mjedës në Shkodër dhe nuk e dëshironte largimin e tij, meqë Shkodra ishte vend me shumë rëndësi jo vetëm për kishën katolike, por edhe për politikën ballkanike. Sidoqoftë, më 24.04.1909, konsullata Austro-Hungareze nga Roma lajmëron Vjenën se në krye të Argjipeshkvisë së Shkupit ishte emëruar Lazër Mjeda, kurse Kardinal Gotti shpreson se Mjeda do ta pranojë dekretin që do t’i dërgohet.²⁵⁰ Më datë 02.05.1909, konsulli Kral nga Shkodra e njofton Vjenën për dekretin e Vatikanit për emërimin e Mjedës, duke e cilësuar si një disfatë të madhe për politikën Austro-Hungareze ndaj shqiptarëve e sidomos për Shkodrën. Konsulli Kral kërkon që të ndërmerren të gjitha masat përkatëse që dekreti i Selisë së Shenjtë për emërimin e Mjedës Argjipeshkëv i Shkupit të

²⁵⁰ HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, fq. 2 telegram i konsullatës austro-hungareze në, Romë ,më 24 prill 1909 ku lajmëron për emërimin e Mjedës.

anulohet.²⁵¹ Në anën tjetër, Prohaska, konsull i Austro–Hungarisë në Prizren, e lajmëron konsullatën e Shkodrës, më 07.05.1909, se në Prizren kishte arritur lajmi për emërimin e koadjutorit të Shkodrës, Mjedës për Argjipeshkëv të Argjipeshkvisë së Shkupit. Kjo ishte një befasi edhe për meshtarët e kësaj argjipeshkvie, meqë e dinin se Mjeda ishte koadjutor i Shkodrës.²⁵²

Kundër kalimit të Mjedës prej Shkodre në Prizren kishte dhe protesta. Konsullata Austro–Hungareze njofton më 28 qershor 1909 (nr 35–40) se katolikët e Shkodrës i kishin dërguar një letër proteste Papës në Romë që të tërhiqte mbrapa dekretin për transferimin e Mjedës në Prizren. Nga kjo letër kuptohet, po ashtu, se as Austro–Hungaria nuk e dëshironte largimin e Mjedës. Ata mendojnë se këtu kishte dorë Italia. Ç’është e vërteta, kishte qenë dëshira e Austro–Hungarisë kalimi i Mjedës nga Sapa në Shkodër, me tendencën që ai më vonë të ishte dhe Argjipeshkëv i Shkodrës. Për këtë punë, atëbotë ishte angazhuar përmes kanaleve diplomatike në Vatikan edhe ambasadori i Austro–Hungarisë Konsulli Kral njofton dhe për sëmundjen e Mjedës, për nevojën që ai të dërgohej për t’u operuar në Vjenë. Atë, në korrikun e vitit 1909, e kishte shoqëruar mjeku nga Shkodra me mbiemrin Saracci. Për shkuarjen, dërgimin e Mjedës njofton edhe konsullata e Shkodrës, më saktë konsulli Kral, më 08.07.1909.²⁵³ Shpenzimet për shërimin e tij i kishte marrë përsipër Vjena.

Mjeda kishte pasur kontakte shumë të mira me Dr. Gjergj Pekmez–zin, i cili në atë ligjëronte gjuhën shqipe në universitetin e Vjenës. Pritjen e tij e kishte bërë Dr. Gjergj Pekmezi në Südbahnhof të

²⁵¹ HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, fq. 4, telegram i konsullatës austro–hungareze në Shkodër, 2 maj 1909.

²⁵² HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, fq. 5, telegram i konsullatës austro–hungareze në Prizren më 7 maj 1909.

²⁵³ HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 8, fq. 3, raport i konsullit Kral nga Shkodra më 8 korrik 1909.

Vjenës²⁵⁴. Edhe Kardinali Francesco Gotti kishte lajmëruar për ardhjen e Mjedës në Vjenë²⁵⁵. Për shëndetin e Mjedës kujdesej edhe kardinal Gotti, përndryshe pjesëmarrës në bisedime për konkordatin mes Serbisë dhe Vatikanit, me të cilin Mjeda kishte qenë në kontakte të vazhdueshme dhe shumë të mira, duke i dërguar raporte të herëpashershme për çështjen në fjalë.

Nga një raport i konsullit të Austro-Hungarisë, z. Lejhanec, datë 02.10.1909²⁵⁶, mësojmë se gjendja shëndetësore e Mjedës pas operimit në Klagenfurt (Austri) tashmë është e mirë. Raporti njofton se shpenzimet i kishte hequr Vjena. Pas vizitës së disa qyteteve austriake, Mjeda kishte udhëtuar për në Gjermani, ku kishte vizituar disa qytete, si: München, Koeln, Dueseldorf etj., për të kaluar më pas në Venecia, Bologna e Firenz e Romë. Në Romë kishte pasur audiencë private tek Papa Piu X, me të cilin kishin biseduar „shumë gjatë“ për gjendjen në Shqipëri. Mjeda ishte interesuar edhe rreth emërimit të tij në Prizren. Papa e kishte siguruar Mjedën se emërimi i tij nuk kishte të bënte me kurrfarë intrigash, por lidhej me nevojën e madhe që kishte Argjipeshkvia e Shkupit për të. Në këtë kohë selia e Argjipeshkvisë ishte në Prizren.

Në letrën e ashtuquajtur baritore e që ishte dhe letër përshëndetëse e Mjedës me rastin e largimit të tij nga Argjipeshkvia e Shkupit, më 1921, Mjeda, ndër të tjera, shkruante: „...*nuk kje punë e letë për Ne n'at koh me lanë vendin e t'lenit e Seliën e parë t'Shqypniës per me ardhë nder kto kto vise, ku Feja shejte gjindej nder ngushtime e travajë.*”²⁵⁷ Nga kjo shohim se nuk ishte vullneti i tij kur e lëshoi Shkodrën më 1909, sikundër që nuk është vullneti i tij as tash

²⁵⁴ shif HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 8, fq. 4, 5, 7 raport i konsullit Kral nga Shkodra më 8 korrik 1909.

²⁵⁵ HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 8, fq. 2, lajmrin i konsullatës austro-hungareze nga Roma 4 korrik 1909.

²⁵⁶ HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 5, 9, letër e konsulliat Lejhanec më 2 tetor 1909.

²⁵⁷ shif letrën e L. Mjedës botuar në “DRITA” Viti XI, 1(81), Jan. 1980, fq. 14.

kur po lëshon Argjipeshkvinë e Shkupit. Thjesht, ai po kryente detyrën ashtu siç i kërkohej, në mënyrën më të mirë të mundshme, gjithnjë për të mirën e popullit e të Kishës.

Rreth emërimit të Mjedës në Prizren, siç mësojmë nga raporte, dokumente të kohës, kishte spekulime të ndryshme. Konsulli Kral, më 11.08.1909²⁵⁸, njofton se kishte spekulime në Shkodër për gjoja zgjedhjen argjipeshkëv të At Lovro (Lorenz) Mihacevic, përndryshe provincial i urdhrit françeskan shqiptar. Ky njoftim kishte ardhur nga gazetatat italiane dhe kroate dhe se atij duhet t'i kenë ardhur urime nga vende të ndryshme. Të tjera spekulime flisnin për kinse tërheqjen e emërimit të Mjedës në Prizren dhe qëndrimin e tij në Shkodër, me arsyetimin se Kuria e vlerësonte të nevojshme qëndrimin e Mjedës në Shkodër; se Atë Lovro Mihacevic do jetë në krye të Argjipeshkvisë së Shkupit, dhe se për Austro-Hungarinë do ishte krejt në rregull, meqë ai e njihte mirë popullin shqiptarë e gjuhën shqipe, duke qenë se pjesën më të madhe të jetës e kishte kaluar ndër shqiptarë. Ishte spekuluar edhe me emrin e abatit Prenk Doçi, për të cilin konsulli gjeneral austriak kishte thënë se largimi i tij nga Shkodra do sillte paqe në këtë qytet dhe së këndejmi do ishte i qëlluar emërimi i tij në Shkup.

Përkundër gjithë kësaj, më 11.10.1909²⁵⁹, konsulli i Austro-Hungarisë në Shkodër, z. Lejhanec, njofton se Mjeda do udhëtojë për në Prizren, i shoqëruar nga Dom Ndue Bytyçi, nëna e tij Domenika Mjeda e p. Lorenc Mitrovi. Për të njëjtat kishte kërkuar edhe rezervimin biletave të udhëtimit me tren. Raporti i Lejhane-cit, i datës 30.10.1909²⁶⁰, njofton për përcjelljen e mirë që i ishte bërë Mjedës, me rastin e nisjes për në Prizren.

²⁵⁸ HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, 22 Letra e konsullit austriak, Kral, Shkodër, 11 gusht 1909.

²⁵⁹ HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 5, 10.

²⁶⁰ HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 5, 14.

Argjipeshkvia e Shkupit kishte fat të madh me emërimin e Mjedës në krye të saj. Ai ishte një prijës i vërtetë shpirtëror në kohëra mjaft të vështira për popullin e Argjipeshkvinë, siç ishin Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike, si dhe Lufta e Parë Botërore. Gëzimin e madh për emërimin e Mjedës në krye të Argjipeshkvisë së Shkupit e tregon edhe një shkrim i Dom Zef Ramajt (atëbotë zëvendës famullitar i Shkupit), botuar në revistën *Elçija e Zemres s'Krishtit* në Shkodër. L. Mjeda e dom Zefi ishin njohur qysh në kohën kur ky i fundit kishte mësuar në Kolegjin Saverian në Shkodër, para se të vazhdonte studimet në Innsbruck. Bashkëpunimi i tyre ishte tejet i madh, deri në vdekjen e dom Zefit më 1914. Në raportet që Mjeda i dërgonte botës perëndimore për gjendjen e rëndë të shqiptarëve e për masakrat që kryheshin ndaj tyre, shpesh i referohej emrit të dom Zefit (si: “*siç më njofton famullitari dom Zef Ramaj...*”, për çka do shohim më vonë).

Në vazhdim po sjellim botimin e dom Zefit, mbajtur me rastin e ardhjes së Mjedës në krye të Argjipeshkvisë në Shkup, e të botuar tek revista *Elçija*. Siç shihet, jo vetëm kleri, por edhe populli i gëzohej ardhjes së tij. Në pritje të Mjedës, ishin të pranishëm edhe kore diplomatike e personalitete të ndryshme.

***Emzot Lazer Miedia n`Shkup*²⁶¹**

Ishte një vjet e gjysë qi kishim mbetë paa Bari, pa Priis, e sakt qi fort t`vshtirshme kiene per nee kto dit vorfuimit. Por i Lumi Zot ne e mram na ngushlloi, tui na zgjedhë per Argjipeshkëv një njeri qi e kishte per zemer, e i cili prandej s`muite mos me ken edhe per zemer t`onë. Po, i Lumi Zot na ngushlloi tui na çue per Argjipeshkëv Emzot Lazer Mieden. Veç na diim se saa kemi dishrue me

²⁶¹ Dom Zef Ramaj: *Emzot Lazer Miedia n`S`hkup*, në: *Elçija Zemres s`Krishtit*, I, 20 (1910), fq. 8-12, për këtë shkruan edhe M. Peters, *Das ölteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur*, fq. 423.

pasë një Bari, e saa na u knaq zemra kuer ndienne se ky do t'ishte Emzot Lazer Miedia e me saa dishiir e kemi pritë!

Te tan Meshtarija me popull mbarë a gzue kuer kaa ndije se një-mend do t'na vite.

Famullija e Shkupit e pat nafak me kenë e para me e pritë ket Zot-nii çuemun prei Zotit per me na rregullue, e kio famullii tui ja diit Zotit per nderë u mundue me e pritë saa maa mirë qi t'muite. Prei Sarajevet i Shndritshmi Zotnii me tel na baike me diitë ditën qi do t'mriite, e at herë, një ditë perpara t'ardhunit, me pushtlla t'posaçme u dha fiala t'tanve shpii per shpii` si shqyptarve si t'hujve, (t'tan bashkë janë 140 shpii) se me 4 ndanorit kishte per t'ja mrii Argjipeshkvi i rii Emzot Lazer Miedia, e qi t'urdhnoishin me dalë me u pritë n`Stacion t'udhes hekrit. Njimend burrimini mar duel; graat e finija ishin mledhë n`oborr t`Kishës.

I Nderueshmi Zotni D. Nikoll Mazreku, Prifti i famuliis t`Pezrendit, bashkë me D. Pashko Krasniqin, kishin dalë me e pritë n`Kumnov, per me i thanë n`emen te tanve: "Mirë se po t'bie Zoti" I nderushmi Zotnii D. Nikoll Glaznoviç, D. Mikel Glaznoviç, Viçe-Korçlla i Nemces (Zotni Korçlla nuk ishte ktu), Gjergj Adamkievitz, Viçe-Korçlla i Italies Zotni Galanti, Viçe-Korçlla i Frances, bashkë me popullin mbarë, sikuer thaçë, ishin mledhë n`Stacion t'udhes hekrit. Qe ja mrrini ai ças i bardh, n`t`cillin i Shndritshmi Argjipeshvi i rii do t`shkelte n`Arkidioçez t`vet. Mbasi t'tanë ja murne doren, gjithmbarë u ndisne kah Kisha, ku kumont i baishin me diit gjytetit mar se kaolikt kishin një gzim t'posaçem. Prej deres t`oborrit deri n`derë t`Kishes ishte stolisë me bush, me lule e me bairage e para ders t`Kishes një qemer i bukur e n`të shyti (stenma) i perndritshmit Zotnii Emzot Lazer Miedes.

Kuer e pame tui hii n`oborr t`Kishes, zemra na gufoi t'tanve prej gëzimi. D. Nikoll Mazreku prej shkallës t`derës t`Kishes u kthye prej t`Shndritshmit Zotnii e prei popullit; prei Atii per me i thanë

n`emen t`tanve: “Mir se t`pruni Zoti nder nee”: prei popullit per me i than se t`ja falshim nderës Zotit qi e pruni shndosh e mirë Baben t`onë, tui vuu oroe se Kisha e Zemrës Krishtit po asht maa e para me pritë Bariin e vet e prande shpnesë n`Zemër t`Krishtit se kaa me i shprazë huret e veta permbyi Të e permbyi Arkidioçezin mbarë. U kthye masandei taliançe e n`emen t`Shnritshmit Zot nji ju falte ndeers t`tanve, qi kishin begeniis me i dalë perpara.

T`tanë masandei hiime n`Kishë, tui kndue “Benedictus Dominus Deus Israel ete”. N`at Kishë kurr nuk kishte kndue maa me eshtah t`zemers kio kang e Xakariis, e me arsyë, se ndimend Zoti i bekuem na kishte paa, tui na çue njat qi do t`na ngrente kah udha e pagjës “ad dirigendos pedes nostras in viam pacis.”

Per t`paren e herë prej Lterit Sheit u ktheike kah populli i Shkupit Argjipeshkvi i rii, tui thanë se saa kondend ishte tui pa se me ç`zemer e shyhret e kishin oritë, e tui ju falë ndeers, t`tanve u dha-ke behiniin sheit.

Ah! Po me t`sakt, o i Shndritshmi Zotnii qi i Lumi Zot, kuer e çove Ti doren t`ande me e bekue popullin e Shkupit, edhe Ai i Lumi na ka bekue t`tanve mbarë prei qillet; po qilla na kaa bekue tui zgiedhë Tye per Babë t`on, e lavd e ndeer i kioft Zotit t`qillës qi aq fort n`ket mndyrë na kaa gzue, e Zoti i qillës t`dhasht jetë t`gjat` e hiire plot, per me kenë gjithmon yrneku i jonë, per me na sundue si asht vullnesa e Zotit e per me na çue te kroni i gjith t`mirave, te Zoti i qillës e i dheut.

Meshtari D. Zef Ramaj

Ndimtaar i Famulliës t`Shkupit

Konsulli i Austro-Hungarisë në Shkup, Dr. Heimroth, më 25.08.1910, njofton për probleme të shumta që kishte Mjeda me autoritetet turke. Këta të fundit nuk e lejonin Mjedën që të ushtronte detyrën e Argjipeshkvit në Shkup, përkundër faktit që ky, së

paku tre herë, kishte kërkuar lejen për veprimtarinë baritore brenda argjipeshkvisë. Mjeda kërkoj nga konsullata e Austro-Hungarisë ndërmarrjen e masave të nevojshme për rregullimin e çështjes në fjalë, meqë ajo edhe ishte mbrojtëse e të krishterëve të Ballkanit. Kështu dhe ndodhi. Emërimi i Mjedës në Prizren, paraqiste problem të madh për Turqinë. Këta akuzonin Austro-Hungarinë se nuk po u përmbaheshin rregullave lidhur me protektoratin “*në territorin e Turqisë*”, duke shprehur hapur kundërshtimin dhe pakënaqsinë e tyre lidhur me Mjedën dhe dy këshilltarët e tij, Nikola dhe Toma Glasnovi.

Konsullata e Austro-Hungarisë në Prizren, më 08.03.1911 lajmëron për udhëtimin e Mjedës për në Romë e prej andej në Vjenë për t’u konsultuar rreth argjipeshkvisë. Bashkë me Mjedën udhëtuuan edhe dy këshilltarët e tij. Po ashtu, konsullata e Austro-Hungarisë në Romë informon Vjenën për çështjen e protektoratit dhe punën e ipeshkvijve në Shqipëri. Në bisedë me kardinal Gotti-n ishte rrahur sidomos çështja e Mjedës dhe e këshilltarëve të tij dhe problemet që po nxirrnin turqit.

Me zyrtarët në Vjenë, më 11 prill 1911²⁶², L. Mjeda kishte biseduar edhe për investimet e mundshme në Argjipeshkvi. Ishte vendosur si më poshtë:

- të ndërtohet një rezidencë e re ipeshkvore, në vlerë deri në 20.000 krona (i është lejuar);
- të ndërtohet një qele famullitare në Shkup (sa më parë që të jetë e mundur, mbase deri në vitin 2012, por jo e sigurt);
- të ndërtohet një qele famullitare në Prizren (që nuk ishte definitiv);

²⁶² HHSta, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 8, 1.

–të financohet shkolla në Pejë dhe t'i jepen të ardhura të reja për mësues;

–kërkon dhe një mësues tjetër për Janjevë (Kromic të shkonte në Shkodër e Mitrovicë të vinte si mësues në shkollën e Janjevës);

–për shkollën e Zymit kërkon dhe një mësues (që do shkonte në Shkodër tek Jezuitët);

–dëshiron që një mësues i shkollës së Prizrenit të kalojë në atë të Shkupit, meqë viteve të fundit ishte lënë disi pas dore;

–kërkon legalizimin e rregullit të Jezuitëve në Shkup nga ana e Turqisë, meqë nuk ishin të pranuar nga këta të fundit;

–kërkon që plus 500 krone t'i miratoheshin për shpenzime të rrugës nëpër argjipeshkvinë e vet.

Siç shihet pikat 2, 7 dhe 8 kanë të bëjnë direkt me famullinë e Shkupit, ku shërbente dom Zef Ramaj. Patjetër që kjo famulli ishte e rëndësishme për Mjedën. Mbështetja nga ana e Austro-Hungarisë, ishte një shtytje e madhe jo vetëm morale për këtë famulli.

Lazër Mjeda dhe Zef Ramaj për gjendjen dhe tmerret ndaj shqiptarëve në Kosovë e Maqedoni më 1912–1913

Luftërat ballkanike, më 1912 e 1913, për popullatën shqiptare në Maqedoni dhe Kosovë ishin shumë të rënda. Kjo gjendje e rëndë pasohet me Luftën e Parë Botërore, më 1914. Popullata shqiptare në Kosovë e Maqedoni kishte mbetur në shumë nën mëshirën e shteteve evropiane dhe të personave të caktuar sesa në diçka tjetër. Në këto rrethana, një rol shumë pozitiv (për këtë popullatë) e ka luajtur dom Zef Ramaj dhe kleri katolik shqiptar i Argjipeshkvisë së Shkupit në krye me Lazër Mjedën.

Shqipëria shpalli pavarësinë në Vlorë, një shpallje formale që nuk solli diçka konkrete për të mirën e shqiptarëve në Kosovë e Maqedoni, për më keq që gjendja e tyre u rëndua edhe më. Ndonjë ndryshim nuk u pa as për shqiptarët brenda Shqipërisë. Dihet mirëfilli se Shqipëria deri vonë nuk do të jetë e pavarur, por autonome, siç njihet në qarqet e huaja diplomatike.

Një rol të rëndësishëm për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë do të luante edhe argjipeshkvi i Shkupit, Lazër Mjeda bashkë me dom Zef Ramaj. Para nisjes për në Vlorë, Ismail Qemajli ndodhej në Vjenë. I gjendur pa para në xhep, më saktë me një çek bankar të pavlefshëm (asnjë nga bankat vjeneze nuk e merrte parasysh), I. Qemajli s'kishte se si të udhëtonte për në Vlorë për të shpallur pavarësinë e Shqipërisë.

I njohur me situatën, Mjeda mobilizoi miqtë që kishte pranë qeverisë së Austro-Hungarisë, dhe i mundësoi I. Qemajlit, që me një anije ekstra të financuar nga Vjena, të arrinte në Durrës.²⁶³ Mjeda duhej të merrte po ashtu pjesë në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë. Nëpunësi austriak i konsullatës në Shkup, më 29 nëntor 1912 i dërgon një letër qendrës me çka njofton se mësuesi i shkollës së famullisë katolike vendore, Logoreci bashkë me famullitarin dom (Zef) Ramaj, e kanë informuar se Logoreci dhe argjipeshkvi Mjeda, sot kishin pranuar një letër nga Durrësi, dërguar prej të deleguarve shqiptarë të Kosovës Veriore. Atyre u kërkohej që të dërgonin një delegat nga Shkupi, për mbledhjen e planifikuar në Vlorë, të organizuar nga krerët (paria) e gjitha anëve të Shqipërisë, që kishte të bënte me shpalljen e autonomisë së Shqipërisë. Ata, do të konsultohen edhe për marrjen e masave eventuale varësisht prej situatës që do krijohet pas shpalljes së autonomisë së Shqipërisë. Për këtë çështje i kishin dërguar edhe një memorandum shkëlqesisë apostolike të monarkisë.

²⁶³ Peteres, *Der älteste Verlag Albaniens*, fq. 424.

Nga Logoreci kërkohet që, në rast se i deleguari nuk mund të udhëtojë, të paktën për këtë çështje të dërgojë një letër përkrashe në emër të shqiptarëve të këtushëm, të ndërmjetësuar nëpërmjet entit të këtushëm konsullor të monarkisë. Në lidhje me këtë, Heimroth thotë se u ka shpjeguar (Logorecit dhe dom Ramajt) se për momentin nuk është i sigurt nëse ka mundësinë për një gjë të tillë. Nga një telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar Vjenës, në nëntor 1912, mësojmë se delegatët shqiptarë kishin lutur argjipeshkvin L. Mjeda, famullitarin e Shkupit dom Zef Ramaj dhe mësuesin Logorezi që të përbënin një delegacion për pjesëmarrje në Vlorë²⁶⁴, për të biseduar për gjendjen e shqiptarëve dhe mundësisht edhe të shpallet “autonomia” e Shqipërisë. Aty përmendet edhe Memorandumi për Pavarësinë e Shqipërisë²⁶⁵ i 12 nëntorit 1912 (përpilues dhe nënshkruesi i parë i të cilit është Dom Nikollë Kaçorri), dërguar Perandorit Franz Josef I, nga i cili kërkohet ruajtja e tërë territorit shqiptar. Për këtë arsye i kërkohet Mjedës formimi dhe pjesëmarrja e një delegacioni nga Shkupi e Prizreni në Vlorë.

Më 1913 ishte rrezik që Shkodra me dhunë t’i shkëputej Shqipërisë. L. Mjeda me angazhimin e vet politik si në Vjenë, ashtu edhe në Londër (në Konferencën e Londrës), kishte siguruar që Shkodra mos t’i shkëputej Shqipërisë.²⁶⁶

Në vitin 1913 ishte lufta ballkanike dhe gjendja e shqiptarëve (pa dallim feje) ishte jashtëzakonisht e vështirë. Popullin shqiptarë në Maqedoni e Kosovë nuk kishte kush ta mbronte në raportet ndërkombëtare. Kanalet për kontaktet ndërkombëtare në rrafshin

²⁶⁴ *Haus-Hof und Staatsarchiv* Vjenë, Liasse XLV/6, 128.

²⁶⁵ Memorandumi gjendet në *Haus-Hof und Staatsarchiv* Vjenë, Liasse XLV/6, 102-109. Është botuar edhe tek revista „Phoenix“ Shkodër 1998 nr. 2. fq. 33. Këtë memorandum e ka nënshkruar në rend të parë Dom Nikollë Kaçorri, pastaj vijnë Mustafa Asim Kruja, Rexhep Mitrovica, Faud Toptani, Abdi Toptani, Murad Toptani, Salih Gjuka Ipek dhe Bedri Pejani.

²⁶⁶ Krah. Peters, *Der älteste Verlag Albaniens...* fq. 424.

diplomatik, duke shfrytëzuar edhe marrëdhëniet, njohjet private, ishin, gati më të mirat, ato të Kishës katolike, sidomos të Mjedës dhe priftërinjve të asaj kohe që kishin studiuar nëpër vende të ndryshme të Evropës, përfshirë këtu edhe dom Zef Ramaj. Një vit pas shpalljes së pavarësisë, Shqipërisë i kanosej rreziku i madh i copëtimit dhe ndarjes nga fqinjët e saj, ndërkohë që, po thuaj, gati të gjitha personalitet e atëhershme shqiptare dhe e tërë popullata kishin shpresë që do t'i mbronte Austro-Hungaria dhe Vatikani. Në të vërtetë, viti 1913 ishte viti i *“Golgotës shqiptare”* siç e quan edhe Leo Freundlich në librin *“Albaniens Golgotha”*. Ky libër, i botuar në Vjenë, jep shumë informacione për opinionin e gjerë, i cili do njihet me gjendjen e rëndë të shqiptarëve. Autori kishte mbledhur materiale të botuara në gazetat ditore të asaj kohe, që për autorë kishin Lazër Mjedën, famullitarin e atëhershëm të Shkupit, Dom Zef Ramajn, Dom Pashk Krasniqi, Dom Nikola Glasnovi etj. Në libër shihet qartë edhe arsyeja e vrasjes së fratit, Atë Alois (Luigj) Paliqit.

Nganjëherë thuhet se shkrimet e dërguara nëpër gazeta të atëhershme austriake janë të Lazër Mjedës. Do thënë se disa nga informacionet për gjendjen e popullatës shqiptare ishin dërguar edhe nga Dom Zef Ramaj e Dom Pashk Krasniqi, siç njofton vetë L. Mjeda, kur i shkruan Vatikanit (më 24 janar 1913) letrën e njohur²⁶⁷ për gjendjen në Argjipeshkvi. Në këtë letër shihet shumë qartë se Dom Zef Ramaj e dom Pashk Krasiniqi raportonin sidomos për ato vende që ishin afër famullisë së tyre. Dom Zefi, raportonte për gjendjen në rajonin e Shkupit, Kumanovës, Kisela Voda, Tetovës (Kalkandele) e Gostivarit, kurse Dom Pashk Krasniqi raportonte për Prizrenin, Pejën e vende të tjera përreth.

Do thënë se Dom Zefi kishte informacione të mira edhe për Kara-dakun, meqë vinte nga ajo pjesë, nga Stublla. Një raport i konsullit austriak në Shkup, informon për tmerret e masakrat ndaj popullatës

²⁶⁷ Gjergj Gashi, *Kosova III*, fq. 80.

(shqiptare pa dallim religjioni) të zonës së Karadakut. Raporti njofton mbi bazën e informacioneve që konsullit ia kishte dhënë Dom Zefi, e këtij të fundit Mitat Aga nga Gjilani.

Heimrot, konsull austriak në Shkup, i përmend ministrit austro-hungarez, Leopold Berchtold, më 9 shkurt 1913²⁶⁸, një letër të Mjedës dhe shton se informacionet (që përmbante ajo) ishin dhënë nga Dom Zef Ramaj. Se Dom Zef Ramaj kishte raportuar vendet evropiane për gjendjen e shqiptarëve, tregon edhe botimi i letrave private të teologëve shqiptarë (të universitetit të Innsbruck–ut) në gazetën austriake *“Allgemeiner Tiroler Anzeiger”* të datës 28 mars 1913²⁶⁹. Shpesh, emri i autorëve të letrave, të shkrimeve që botoheshin, mungonte, për shkak të frikës nga reprezaljet e mundshme, por botuesit (gazetat), megjithatë, njoftonin se shkrimet ishin të studentëve (shqiptarë) të Universitetit të Innsbruck–ut, mandej se vendi prej nga vinin shkrimet ishte Shkupi, ku tashmë, Dom Zefi ishte me shërbim.

Në artikullin me titull *“Die serbische Unmenschlichkeit in Albanien”* (Jonjerëzorja serbe në Shqipëri), botuar në *“Allgemeiner Tiroler Anzeiger”* dhe *“Reichspost”*, datë 28.03.1913 (por dhe në gazeta të tjera gjermanofone), Dom Zef Ramaj (nga Shkupi) shkruan kështu: *“Për momentin nuk kam mundësi që t’ju dërgoj një raport të detajuar. Ju duhet të keni parasysh se gjendemi në gjendje lufte.... nuk mund të paramendoni atë se çka është mëkatuar ndaj bashkatdhetarëve tanë në këtë luftë.... zemra ime është përplot, për atë se çfarë mund t’ju shkruaj më tutje. Më mirë do të vdisja se Shqipërinë ta shihja në këtë gjendje, në të cilën gjendet”*.

Leo Freundlich, i merr këto të dhëna dhe i (ri)boton në librin e tij.²⁷⁰ (Edhe një herë: Mjeda njofton se të dhënat në raportin e tij

²⁶⁸ Haus- Hof- und Staatsarchiv, P.A. XII, K. 416, Türkei, Klasse XLV/5.

²⁶⁹ „Briefe aus Albanien“, *“Allgemeine Tiroler Anzeiger”* e 28 mars 1913, fq. 1.

²⁷⁰ Leo Freundlich, *Albanians Golgotha*, fq. 10-16.

(dërguar vendeve të ndryshme, si Vatikanit, Austro–Hungarisë etj.) janë nga famullitari i Shkupit, Dom Zef Ramaj e Dom Pashk niqi, famullitar i Prizrenit.

Gazeta “*Reichspost*” raporton për dhunën e tmerrshme që ushtrohet ndaj shqiptarëve e për vrasjet e tyre, dhe thotë se ka një dosje për këtë çështje (e cila duhet të hulumtohet). Pjesërisht këtë dosje e botojnë edhe mediat e tjera austriake, gjermane, si dhe ato angleze e italiane.

Në artikullin e gazetës *Reichspost*, jepen në detaje masakrat e bëra ndaj popullatës shqiptare (pa dallim feje) në territorin e Kosovës e Maqedonisë, duke filluar prej Shkupit, Kalkandeles, Ferizajt, Prishtinës, Prizrenit, Gjeneral Jankovicit, Tërstenikut, Pejës etj. *Reichspost* (botimi i mëngjesit) i jep rëndësi kësaj dosjeje dhe shkuan 3 faqe (duke filluar prej faqes së parë), në numrin e 17 janarit 1913²⁷¹. Në këtë shkrim ceket se dosja është autentike dhe nga një personalit shqiptar dhe se ka dëshmitar për gjithë atë çfarë ka ndodhur në Shkup. E ky, pa dyshim, është Dom Zefi, famullitar në Shkup, ndërkohë që Mjeda gjendej në Vjenë, në kontakt me qarqet diplomatike të atjeshme, por edhe me media, për çështjen shqiptare në Kosovë e Maqedoni.

Është interesant të theksohet se Leo Freundlich, në librin e tij (*Golgota shqiptare*, fq. 10–16), përshkruan vrasjet në rajonin e Kairadakut, si në Lubishtë, Smirë, Komogllavë, Shashare – të gjitha këto vende në afërsi të Stubllës, vendlindjes së Dom Zefit, të cilën ky i fundit e vizitonte shpesh edhe për të qenë mirë i informuar me gjendjen e përgjithshme. Ngjarjet e paraqitura në libër, autori i kishte marrë prej gazetës së sipërpërmendur, të datës 17.01.1913.

Në raportet e 24 janarit 1913, Mjeda tregon se informacionet e dhëna aty për gjendjen e shqiptarëve, i kishte nga Dom Zefi e Dom

²⁷¹ *Die Serbische Blutschuld in Albanien*, 17. I. 1913, fq. 1-3.

Pashk Krasniqi. Më 9 shkurt të vitit 1913, konsulli austro-hungarez në Shkup, Heimroth i shkruan Vjenës zyrtare se Mjeda, raportonte duke u thirr në informacionet e Dom Zefit. Edhe vetë Heimroth, në një rast shkruan: “Ashtu siç shkruan Mjeda në letrën mbi tmerret (ndaj shqiptarëve) më kanë ardhur edhe mua në vesh. Famullitari i Shkupit, Dom Ramaj më tregoi se ai ishte dëshmitar dhe përmend një ushtar serb me emrin Ciceric²⁷². Konsulli vazhdon tutje duke thënë se këto gjëra i kishte parë edhe murgesha katolike që vepronte në spitalin e Shkupit e që ishte edhe mësuese e subvencionuar nga Austro-Hungaria. Fjala është për murgeshën Protegjena Bekes nga Stublla, bashkëvendëse e Dom Zefit. Ajo kishte parë shumë kufoma të shqiptarëve myslimanë në lumin vardar²⁷³. Më vonë, konsulli shkruan se burim informacioni (i Dom Zefit, A.R.), ishte edhe Luigi Neracci që njihej shumë mirë me Dom Zef Ramaj²⁷⁴. Konsulli, në këtë raport përmend jo më pak se shtatë herë emrin e Dom Zefit, për grumbullimin e informacioneve mbi masakrat ndaj shqiptarëve.

Informacionet që jep Dom Zefi e që botohen në shtypin e huaj, i shfrytëzon Leo Freundlich në librin e tij dhe të njëjtat ia shpërndan botës. Është me rëndësi të theksohet se konsullata e Austro-Hungarisë i besonte shumë Dom Zefit. Raportet e tij mbi masakrat ndaj shqiptarëve, konsullata i merrte krejt të besueshme. Edhe vicekonsulli anglez, Walter Divie Peckham, njofton Londrën zyrtare për tmerret ndaj shqiptarëve. Ai shkruan se raporti është i bazuar në të dhënat që kishte ofruar famullitari i Shkupit, Dom Zef Ramaj. Të dhënat që jep ky raport përkojnë plotësisht edhe me ato informata që kishte dhënë edhe konsulli Heimroth, ato përkojnë saktësisht edhe me kohën e publikimi të të dhënave në shtypin austriak (të cekur dhe më lart), datë 28 shkurt 1913.

²⁷² Gjergj Gashi, *Altari III*, fq. 101.

²⁷³ Po ashtu, *krahaso III*, fq. 101.

²⁷⁴ *Altari III*, 102.

Në vazhdim, *Memorandumi* i famullitarit të Shkupit, Dom Zef Ramaj, që Peckham i kishte dërguar Londrës, titulluar *Memorandum on Massacres of Albanians—Statements of Catholic Cure of Uskub*:

“*Rajoni i Shkupit* – Menjëherë pas okupimit serb të Shkupit disa motra nderi katolike shkuan në spitalin ushtarak për t’u lidhur plagët e të plagosurve. Ditën e parë aty kishte 132 shqiptarë të plagosur, ditën tjetër 80, ditën tjetër 30, ditën tjetër 20. Shërbimet e motrave së shpejti u përjashtuan. Burrat e nxjerrë nga spitali²⁷⁵, i morën dhe i hodhën në Vardar.

‘Më 27 tetor tre shqiptarë ishin therë me bajoneta²⁷⁶ afër njërës prej urave të Vardarit.

‘Më 6 nëntor në orën 10:00 të mbrëmjes, prifti²⁷⁷ kishte kaluar përgjatë rrugës që shpinte në stacion²⁷⁸, me ç’rast kishte vërejtur shumë gjak i cili nuk ishte parë aty në orën 8:30 të pasdites. Të nesërmen, herët në mëngjes, ishte sjellë me makinë një kalë i ngordhur për ta arsyetuar gjakun. E vërteta ishte se komiteti e Hotelit London e kishin qëlluar një shqiptar në rrugë. [Pronari i Hotelit London, ku zot. Cahen²⁷⁹ qëndroi aty njëherë, i kishte thënë këtij se ishte çetnik, dhe me një rast i kishte treguar zot. Cahen se ai posa ishte kthyer nga qëndrimi katër javësh në krahinën e Lumes.]

‘Rreth 80 kufoma të shqiptarëve ishin gjetur në Kisella Vodë [afër Shkupit] dhe shumë të tjerë pas kalasë.

‘Në fillim të okupimit, ushtarët²⁸⁰ ishin futur në shtëpinë e një shqiptari, e dhunuan gruan e tij, e rrahën atë deri sa nuk tregoi se

²⁷⁵ Mendohet në shqiptarët e plagosur që u nxorën me dhunë nga ushtarët serbë.

²⁷⁶ Nga ushtarë serbë.

²⁷⁷ Fjala është për priftin katolik shqiptar që shërbente në Shkup.

²⁷⁸ Fjala është për stacionin hekurudhor, i cili gjendet në të njëjtin vend edhe sot, mu në qendër të Shkupit.

²⁷⁹ Mr. Cahen, si duket i takonte stafit të konsullatës britanike në Shkup.

²⁸⁰ Fjala është gjithnjë për ushtarët serbë.

ku i kishte dy bijat e tij (njëra 14 e tjetra 16 vjeçare), e pastaj i dhuan ato.

‘Njëfarë çetniku i quajtur Çiçeriq i kishte thënë një mikut të vet, pohim të cilin e kishte dëgjuar edhe prifti, “ Ne nuk kishim ngrënë dhe pirë për 48 orë, ishim tepër të zënë duke i kërkuar shqiptarët për t’i vrarë.” [kjo u pa në qytetin e Shkupit].

‘Në një fshat pranë Kumanovës ushtarët serbë dogjën shtëpitë²⁸¹ për t’i nxjerrë jashtë banorët të cilët ishin fshehur në tavane. Kur dolën gratë jashtë ato u vranë; për ta kursyer barotin fëmijët i therën me bajoneta. Këtë e kishin treguar vetë ushtarët serbë në prani të priftit, duke mos ditur se kush ishte ai.

‘*Tetovë* – Në ditën e parë të okupimit, ushtarët, çetnikët dhe serbët lokalë vranë 85 shqiptarë duke sulmuar shtëpi për shtëpi.

‘*Gostivar* – Gjashtë shqiptarë u vranë dhe qyteti pagoi 200 Funta Sterling për lirim.

‘*Dibër* – Rreth 120 ushtarë që kishin dalë të plaçkitnin, ishin vrarë nga shqiptarët; në shenjë hakmarrjeje serbët dogjën 24 fshatra. Numri i shqiptarëve të vrarë nuk dihet.

‘*Ferizaj* – Z. Gavrilloviq, ish-konsull i Serbisë në Shkup, deklaroi se 1.200 shqiptarë ishin vrarë më 24 tetor. Ushtarët serbë e kishin takuar në rrugë katolikun Zef Paletoni²⁸² dhe e urdhëruan të kryqohej në mënyrën ortodokse. Duke qenë deri diku i dehur, ai nuk arriti ta bënte atë, prandaj u vra. Një grua shqiptare e kishte marrë mauzerin e bashkëshortit të vrarë dhe kishte vrarë 5 ushtarë. Bile edhe tash, nga tre, katër, a pesë shqiptarë vriten për çdo natë në Ferizaj; burrat i kishin joshë të hynin në shtëpitë e tyre duke u premtuar ushqimin, e pastaj aty i kanë rrahur. Ushtarët dhe oficerët

²⁸¹ Fjala është për shtëpitë e banorëve shqiptarë.

²⁸² Qytetar shqiptar i Ferizajt.

iu plaçkitnin fshatarëve paratë kur ata ktheheshin nga tregu. [Serbët kishin bërë pikërisht ankesë të njëjtë kundër shqiptarëve në shtatorin e kaluar (shiko dërgesën time nr. 74 të 17 shtatorit nga Selaniku)]. Grupe shqiptarësh të cilët dolën për të marrë dru janë rrethuar nga ushtarët në male dhe janë pushkatuar. Në Ferizaj dhe në Prizren njerëzit burgoseshin vetëm pse kanë folur me priftin katolik.

‘Në Tërstenik 30 shqiptarë u vranë; në Smirë 32; në Vërban 20; në Kamenogllavë, fshat prej pesëdhjetë shtëpive, të gjithë burrat ishin vrarë. Në ato raste, burrat i kishin detyruar me forcë që të dilnin jashtë për t’i përshëndetur trupat serbe, pastaj i kanë lidhur së bashku dhe i kanë vrarë. Trupat e tyre ishin varrosur cekët dhe për pasojë ishin bërë ushqim për qentë.

‘*Prishtinë* – Më ose rreth 23 tetorit me lejen e mjekut ushtarak serb, rreth 5.000 shqiptarë ishin vrarë. Ata i kishin lidhur së bashku dhe i kishin kositë duke shtirë nga mitralozat. [Unë dëgjova një dëshmi mbi masakrat e mëdha ndaj shqiptarëve në Prishtinë, dhe atë nga një mjek ushtarak shqiptar, i përmendur në dërgesën time nr. 17 të 28 shkurtit. Ai pohoi se shqiptarët ishin vënë ndërmjet rrethojave dhe mitralozave të kthyer në drejtim të tyre.]

‘Në fshatin e Shalës, nga pesëdhjetë familje, të gjithë burrat ishin vrarë, dy nga ta i kishin varur për duar në drurë deri sa vdiqën.

‘*Prizren* – Katërqind shqiptarë ishin vrarë në tri ditët e para të okupimit. Kufomat e tyre nuk u lejua që të varroseshin. Deri në Vitin e Ri vetëm në qytet ishin vrarë 2000 veta.

‘*Nashec* – Me përjashtim të dy apo tri shtëpive, i tërë fshati ishte shkatërruar ndërkaq meshkujt ishin masakruar. Në Lutogllavë ushtarët kishin hyrë në një shtëpi duke dashur ta dhunojnë një grua, burri i saj i kishte vrarë ata dhe menjëherë edhe veten. Tri familje ishin masakruar. Në Gjilan katër familje u asgjësuan.

‘Në rajonin e Prizrenit tridhjetë muhtarë katolikë (pari e fshatrave) i kishin lidhur bashkë dhe i kishin pushkatuar. Gjenerali Jankoviq e kishte detyruar parinë e fshatrave t’i dërgojnë një letër falënderuese mbretit Petar.

‘*Lumë* – Katërqind shqiptarë të Lumes ishin dorëzuar dhe depërtuar në Prizren, ku i kishin vlarë sipas radhës nga afërsisht pesëdhjetë në ditë. Sipas një burimi të besueshëm që ishte me serbët, tridhjetë e dy fshatra ishin rrafshuar me tokë, ndërkaq banorët e tyre – burra, gra dhe fëmijë – ishin pushkatuar. Serbët humbën tetë batalione në Lumë.”²⁸³

Këtë raport kishte dërguar në Londër nga Shkupi vicekonsulli anglez Peckham, që kishte marrë, siç shkruan Peckham nga famullitari i Shkupit, pra dom Zef Ramaj.

Vrasja e Atë Luigj (Alois) Paliqit

Luigj (Alois) Paliqi është i lindur në Janjevë të Lipjanit (Kosovë) dhe i përkiste provincës françeskane shqiptare. Ndonjëherë e gjejmë emrin e tij Luis e ndonjëherë Alois, poashtu edhe ndonjëherë Pali e ndonjëherë Paliq. Ai vra nga ushtria malazeze në Janosh (në afërsi të Pejës) më 07.03.1931²⁸⁴. Ndonëse e kishte kryer aktin e vrasjes,

²⁸³ Teksti shqip marrë nga: Gazmend Rizaj, Imzot Lazër Mjeda në dritën e dokumenteve perendimore gjatë viteve 1912-1913, in: Imzot Lazër Mjeda mbrojtës dhe lëruës i identitetit shqiptar, St. Gallen 2009, fq. 288-292, sipas PRO-FO, 424/243, 4216, No.179. Sir R. Paget to Sir Edward Grey, Belgrade, March 7, 1913; Enclosure 1. in No. 179-Vice Consul Peckham to Sir R. Paget, Uskub, February 28, 1913; Enclosure 2. in 179-Memorandum on Massacres of Albanians-Statements of Catholic Cure of Uskub.

²⁸⁴ Për Alois Paliqin shih më shumë: P. Aloiz Paliq, OFM në Zani i shna Ndout, nr. IV, fq. 60-62, Nr. VI, fq. 92-93: „Kanibalizmi sllav ose deka e shëmtueme e At Luigj Paliqit OFM, Hylli i Drites, Viti I, 1913, fq. 79-85; „Atë Luigj Paliqi“ (me rastin e 70 vjetorit të vdekjes), Drita, 1983 nr. 3/4, fq. 6. Mbi vrasjen e Luigj Paliqit shih më shumë: Gjergj Gashi, Kosova vëll. II. (AtëLuigj Paliq, O.F.M.); Vdekja e Luigj Paliqit në Janosh, Drita, viti X, 1, 1979, fq. 11, po ashtu, Zef Mark Harapi, Ditët e trishtimit n’Pejë e nder rrethe 1912-1913 (shkruan po ashtu edhe për Lazër Mjedën dhe vrasjen e P. Paliqit).

a jo përpiquej ta mohonte një gjë të tillë. Austro–Hungaria, në bise–dimet me zyrtarët malazez, e detyroi Malin e Zi, që në shenjë „dëmshtëpërblimi“ për vrasjen e atë Alois Paliqit, në vendin ku e kishin vrarë atë, në Janosh, të ndërtonin një kryq, natyrisht, me shpenzimet e qeverisë malazeze. Po ashtu, Mali i Zi u detyrua të lejonte edhe ndërtimin e kishës famullitare të Glllogjanit (afër Pejës).

Aspekti financiar i shpërblimit nuk ishte me rëndësi, e rëndësishme ishte pranimi i veprës së kryer nga malazezët.

Meritat për këtë punë i kanë Mjeda dhe Dom Zef Ramaj në bashkëpunim me konsullatën austro–hungareze. Atë Luigi Paliqi ishte vrarë për shkak se luftonte kundër aksionit të qeverisë malazeze, e cila me dhunë po konvertonte shqiptarët në ortodoksizëm²⁸⁵. Do thënë se Atë Luigji e Dom Zef Ramaj njiheshin personalisht fare mirë.

Dom Zef Ramaj shkruan Në gazetën “*Allgemeine Tiroler Anzeiger*”, të 28 marsit 1913²⁸⁶, Dom Zefi shkruan për dhunën e tmerrshme ndaj popullatës shqiptare. Në po të njëjtin artikull ai njofton edhe për vrasjen, 13 ditë më parë, të Atë Luigjit. Këtë shkrim e ribotoi edhe gazeta vjeneze, “*Reichspost*” (botimi i pasdites).

Një dosje e arkivit të Vjenës (mbi vrasjen e P. Alois Paliqit), tregon shumë qartë gjendjen tejet të vështirë të popullatës shqiptare dhe rolin e Mjedës në këtë kohë, në bashkëpunim me konsullatën austro–hungareze në Prizren²⁸⁷. Gazeta *Reichspost*, e 20 marsit 1913, shkruan po ashtu, për gjendjen e vështirë të katolikëve në argjipeshkvinë e Shkupit, për Mjedën, e për vrasjen e p. A. Paliqit, për konvertimin e dhunshëm të shqiptarëve në ortodoksi dhe kërkesat

²⁸⁵ Shih më shumë në: HHStA PA XII 416-1-1 (Ermordung des P. Luigi Palic), fq. 43-48 të datës 28. 03. 1913.

²⁸⁶ „Briefe aus Albanien“ “*Allgemeine Tiroler Anzeiger*” e 28 mars 1913, fq. 1.

²⁸⁷ Shih më shumë: HHStA PA XII 416-1-1 (Ermordung des P. Luigi Palic, 11 prill 1913 dhe 19. 05. 1913 fq. 302, 312.

austro-hungareze ndaj Malit të Zi²⁸⁸. Artikulli e sipërpërmendur e merr edhe Leo Freundlich dhe e riboton në librin e tij *“Albaniens Golgotha”*²⁸⁹ Gjithashtu edhe *Wiener Sonn- und Montags-Zeitung*, shkruan, më 24 mars 1913, për gjendjen e vështirë të katolikëve në argjipeshkvinë e Shkupit²⁹⁰. Kjo gjendje do ta shtyjë Mjedën që të pyeste se *“a do të mbes më ndonjë katolik në këto troje, nëse vazhdon kjo politikë kundër katolikëve shqiptarë”* në argjipeshkvinë e tij.

Për vrasjen e Alois Paliqit shkruan shumë gazeta jo vetëm vjeneze. Shih për kë ngjarje: *Neue Freie Presse*²⁹¹, *Reichspost*²⁹² *Wiener Sonn- und Montags-Zeitung*²⁹³ *Albaniens Golgotha* (Leo Freundlich)²⁹⁴ etj.

Territori ndaj argjipeshkvisë së Shkupit dhe Lazër Mjeda

Serbia dëshironte të manipulonte edhe me një gjë që katolikëve t’u jepej një autonomi në kuadër të territorit të okupuar, pra Kosovës e Maqedonisë. Është e dikur se Vatikani, qysh pas Lidhjes së Prizrenit, nuk dëshironte që katolikët shqiptarë të ndahen në disa shtete të ndryshme ballkanike, por të jenë në një shtet. Andreas Gottsmann shkruan se *“Frika ishte e madhe që situata e shqiptarëve katolikë do të përkeqësohej në Malin e Zi, të dominuar nga ortodoksia, përveç kësaj Selia Shenjte donte të mënjanojë ndarjen e shqiptarëve katolikë në shtete të ndryshme.”*²⁹⁵

²⁸⁸ Der Konflikt mit Montenegro, Reichspost 20 mars 1913, fq. 2.

²⁸⁹ Leo Freundlich, *Albaniens Golgotha*, fq. 27-28.

²⁹⁰ Wiener Sonn- und Montags-Zeitung, artikulli „Die Antwort Montenegros ist ausständig“ 24 mars 1913 fq 1.

²⁹¹ Die Ermordung des Franziskaners Palic bei Djakova, Neue Freie Presse, 21 mars 1913, fq. 2. Mbi vrasjen e Alois Paliqit.

²⁹² Der Konflikt mit Montenegro, Reichspost 20 mars 1913, fq 2.

²⁹³ Wiener Sonn- und Montags-Zeitung, „Die Antwort Montenegros ist ausständig“ 24 mars 1913 fq 1.

²⁹⁴ Leo Freundlich, *Albaniens Golgotha*, fq, 28-29.

²⁹⁵ Andreas Gottsmann, Konkordat oder Kultusprotektorat, vep. e cit. fq. 426.

Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, më 1912, është paraparë që territoret e Kosovës e Maqedonisë të jenë pjesë e Shqipërisë, kështu që territori i argjipeshkvisë së Shkupit duhet të ishte pjesë e Shqipërisë, që ishte shtet më 1912.

Siç njofton gazeta e krishterë vjeneze *“Reichspost”*, më 22 janar 1913, në botimin e pasditës, famullitari i Prizrenit dom Pashk Krasniqi ishte ftuar në Beograd për të marrë *“informatat e duhura”* për krijimin e një autonomie shqiptare katolike. Pikërisht në atë kohë, L. Mjeda gjindej në Vjenë.

Për autonominë e katolikëve shqiptarë në Kosovë e Maqedoni shkruan edhe gazeta vjeneze *Reichspost*, më 22296 dhe 24297 janar 1913, duke u shprehur se ky “lloj autonomie”, me sy të Austro-Hungarisë shihej me sy skeptik.

Është e ditur se Austro-Hungaria dhe Italia, bashkë me Vatikanin, ishin faktorë kryesorë për krijimin apo shpalljen e shtetit shqiptar, më 1912, dhe se në këtë shtet parashihej edhe territori i Kosovës dhe, pjesërisht i Maqedonisë. Por dihet se problemi më i madh për territorin e argjipeshkvisë kishte lindur menjëherë pas shpalljes së pavarësisë shqiptare, më 1912, dhe në të njëjtën kohë, edhe territori i argjipeshkvisë së Shkupit, prandaj çështja mernte rëndësi edhe për Lazër Mjedën, sidomos për famullitë që ishin në kufi me Malin e Zi.

Pas Argjipeshkvit Simon Milinovi, që ishte argjipeshkëv i Tivarit, vjen Nikola Dobre i, nga Tivari. Ky vepron si argjipeshkëv prej 1912 deri 1955. Është e njohur se argjipeshkvi Dobre i përkrahte aspiratat e Malit të Zi për okupimin e Shkodrës, me pretendim se Shkodra paska qenë „*Selia e balshiqëve apo balshajve*”²⁹⁸, e meqë

²⁹⁶ Die Autonomie der Katholiken in Serbien, Reichspost 22 janar 1913, fq. 1 (botimi i pasditës)

²⁹⁷ Die Frage der Katholikenautonomie in Serbien, Reichspost më 24 janar 1913, fq. 3 (botimi i mëngjesit)

²⁹⁸ Rastoder, Konkordat izmedju Crne, fq. 260

ishite kështu, sipas perceptimit të tij, kërkonte të njëjtën përkrahje nga Vatikani për realizimin e, tani, zgjerimin e ndikimit malazez edhe në Shkodër. Ky argjipeshkëv ishte shumë i njohur për idetë proserbe dhe malazeze. Në këtë kontekst besimtarët katolikë shqiptarë, në këto troje, përballeshin me sfidat më të ndryshme. Nikola Dobre i e mbante veten për serb, e jo për kroat që ishte, sa që edhe qeveria e Beogradit, më 1923, si argjipeshkëv të parë të argjipeshkvisë së Beogradit, e dëshironte të ishte pikërisht ky e jo ndokush tjetër.

Në vitin 1913 ishte hapur lajmi edhe nëpër gazeta dhe revista se Papa e mbron Shkodrën²⁹⁹ dhe se ai nuk dëshironte që Shkodra të okupohej nga malazezët. Ky lajm e shtyn menjëherë argjipeshkvin N. Dobre i të vihet në lëvizje për konfirmimin e asaj çka shkruanin gazetat nga Vatikani dhe njëkohësisht kërkon njoftim zyrtar. Vatikanin, i cili i dinte qëndrimet e argjipeshkvit Dobre i, nuk lëshonte informata zyrtare, por në mënyrë diplomatike dëshironte ta zbuste përballë lajmit se, pse Papa mbron Shkodrën. Nga burimet e ndryshme del se, sikur të mos ishte aktivizuar kleri katolik shqiptar i argjipeshkvisë së Shkodrës, bashkë me të gjitha ipeshkvitë sufragane e në bashkëpunim me qarqet diplomatike të Vatikanit, Shkodra do të binte në duar të Malit të Zi. Një meritë të madhe kishte edhe vetë argjipeshvki i Shkupit, Lazër Mjeda, sepse ai kishte udhëtuar për Vjenë dhe Londër, për të mbrojtur jo vetëm interesat në argjipeshvkinë e Shkupit, por edhe për të shpëtuar Shkodrën nga okupimi i malazezëve, kështu që Mjeda ia kishte arritur qëllimit që Shkodra, sidomos me ndihmën e Austro-Hungarisë, të mbëtej nën territorin shqiptar.³⁰⁰ N. Dobre i instrumentalizonte postin e vet si argjipeshkëv për ta informuar qeverinë malazeze për realizimin e qëllimeve ekspansioniste, në disfavor të shqiptarëve. Këtu, le të përmendim faktin se Argjipeshvki i Tivarit Nikola Dobre i, vëllanë e vet, Filip, e kishte sekretar në Ministrinë së Punëve të Brendshme malazeze. Në këtë mënyrë, kur duheshin propaganda apo informata në

²⁹⁹ Rasdoter, Konkordat fq. 261

³⁰⁰ Markus Peters, der älteste Verlag Albaniens, fq. 424

favor të Malit të Zi, si nga ana shtetërore, po ashtu edhe nga ana e argjipeshkvisë së Tivarit, ato koordinoheshin, ashtu si ndodhi me rastin e vrasjes së P. Luigj Paliqit nga ana e malazezëve, por edhe lidhur me ripagëzimin me dhunë të katolikëve të Kosovës në besimin ortodoks, edhe të atyre në pjesën e rajonit të Ulqinit, duke filluar që nga viti 1913 e këtej. Këtu është luajtur një diplomaci kundërmuese, që ishte plotësisht në dëm të shqiptarëve, e sidomos të katolikëve.

Letërkëmbimi dhe shkëmbimi i informacioneve mes Merry de Val dhe N. Dobre i ishte jo në të mirë të shqiptarëve, sidomos për gjendjen e Shkodrës, më 1913, dhe okupimin nga Mali i Zi. Gjithsesi, në këtë drejtim, rol jashtëzakonisht të madh mbrojtës luante kleri katolik shqiptar, sidomos ai i Shkodrës³⁰¹, që edhe sot e kësaj dite llogaritet në publikimet serbe e malaziasë, si i rrezikshëm për Sërbinë dhe Malin e Zi, meqë ishte pjekuria e tij mjaft ndikuese që nuk u lejua të mbetej Shkodra në duart e malaziasve. (Dokumenti i arkivit të Austrisë për Shkodrën në këtë kohë).

Por, një sukses jo i vogël për politikën malazeze dhe për vetë argjipeshkvin Dobre i, ishte ndarja e famullive të Tuzit, Traboinit, Grudës dhe Klleznes, në vitin 1912, nga argjipeshkvia e Shkodrës, për t'iu bashkëngjitur argjipeshkvisë së Tivarit. Në anën tjetër, Mali i Zi kishte interesim shumë të madh që Protektorati i Austro-Hungarisë, sa më shumë e më shpejt të humbte fuqinë e mundësisht, të shpallej edhe si i tepërt e i tejkaluar, përkitazi me rolin e tij si mbrojtës i shqiptarëve katolikë në Ballkan, sepse ky protektorat, në të njëjtën kohë, ndikonte shumë në arenën diplomatike ndërkombëtare, dhe se shfuqizimi i tij do t'i hapte rrugë politikës antishqiptare.

Është për t' u theksuar se qeveria e Malit të Zi kishte filluar ofensivë jo vetëm përreth Shkodrës, por edhe në Kosovë. Në bashkëpunim me argjipeshkvin e Tivarit, Dobre i, kërkohej që famullitë e rajonit të Pejës dhe Gjakovës t'i bashkëngjiteshin argjipeshkvisë së Tiva-

³⁰¹ Romeo Gurakuqi, Aspekte të qëndrimit Fq. 277-294

rit.³⁰² Kurse për pjesët tjera të ipeshkvisë së Shkupit, Serbia kishte plan tjetër; në këtë mënyrë, besimtarët katolikë ishin mes dy zjarreve, atij malazias dhe serb. Siç dihet, më parë argjipeshkvia e Shkodrës dhe ajo e Shkupit kishin disa famulli nën juridiksionin e tyre që gjendeshin në territorin e Malit të Zi, por këto të drejta iu muarën nga qeveria malaziasë të dy argjipeshkvive dhe iu dorëzuan asaj të Tivarit. Në këto famulli jetonin vetëm shqiptarët dhe, sipas Konkordatit të vitit 1886, nuk ishte e lehtë, as në aspektin religjioz e as në atë kulturor, që ndonjë ipeshkëv shqiptar të ndikonte nga Shkodra apo Shkupi për atë që po ndodhte me katolikët në pjesët e sunduara tashmë nga serbët e malazezët. Më 1913, përveç asaj që edhe priftërinjtë katolikë vriteshin nga malazezët e serbët, tash qeveria malazeze dhe argjipeshkvi i Tivarit, Nikola Dobre i tentonin që edhe famullitë e rajonit të Pejës dhe Gjakovës t'i bashkëngjiteshin argjipeshkvisë së Tivarit, çka *de facto*, më vonë do të thoshte se edhe ky territor do t'i bashkëngjitej Malit të Zi.

Për këtë arsye, argjipeshkvi i Tivarit N. Dobre i , në vjeshtën e vitit 1913, udhëtoi për në Vatikan për të biseduar për këtë çështje. Kurse Vatikani këtë tendencë e refuzoi kategorikisht, sepse tamam u pa se ku ishte plani i qeverisë malaziasë. Për këtë çështje, më së shumti ka vepruar bariu i mirë dhe i zellshëm, argjipeshkvi i Shkupit, Lazër Mjeda.

Argjipeshkvi i Tivarit, Nikola Dobre i , i kishte shkruar një letër argjipeshkvit Lazër Mjeda, më 12 nëntor 1913, në të cilën thekson se të gjitha informatat për famullitë e territorit të okupuar nga Mali i Zi e që gjinden nën juridiksion të argjipeshvisë së Shkupit, do t'i kalonin Mjedës, por në këtë letër ai shënon se famullitë që tashmë gjinden në territor të Malit të Zi, i sheh më pjesë të bashkangjitura argjipeshkvisë së Tivarit. Për këto rrethana dhe letra kishte njoftuar Vjenën edhe konzullata e Prizrenit më 10. XII 1913.³⁰³ Lazër Mje-

³⁰² Rastoder, Konkordat...fq 263

³⁰³ HHSTA, PA, XVII, 49, Montenegro XIII, Nericht Kohlruß (Prizren) 125, 10. XII 1913.

da i kthen përgjigje argjipeshkvit Dobre i dhe i tregon se nuk është aspak i pajtuar më këtë gjë, por do të informonte edhe Vatikin për këtë problem.³⁰⁴ Të njëjtën kohë, gjenerali malazias Vesovi, që në atë kohë gjindej në Pejë, shkon te famullitari i Pjesës dhe i Prizrenit dhe u thotë se tash e tutje duhet të kishin punë me argjipeshkvin e Tivarit N. Dobre i. Kurse famullitarët iu përgjigjen se, nga ana e eprorëve të Kishës katolike, nuk u kishte ardhur asnjë shkresë për këtë çështje; kështu që edhe më tutje do të kishin argjipeshkëv të tyrin L. Mjedën. Gjenerali i zemëruar, u kthen përgjigje se në këto vende nuk ka se çka të përzihet më një “*argjipeshkëv i huaj*” dhe se nuk mund ta duronin më atë dhe se do t’ia ndalonte Mjedës të hynte në kufi.³⁰⁵

Lazër Mjeda kishte alarmuar Austro-Hungarinë për këtë fakt dhe Ministri i Punëve të Jashtme austro-hungareze, Leopold (Graf) Berchtold von und zu Ungarschitz, kërkon nga Vatikani spjegime për çështjen dhe, në të njëjtën kohë, nga Mali i Zi kërkon që edhe më tutje Lazër Mjeda, patjër, duhet të kishte mundësi që t’i vizitonte të gjitha pjesët e argjipeshkvisë së vet.³⁰⁶ Berchtold nuk diskuton fare për përkatësinë e Pejës dhe Gjakovës, të cilat i takojnë ipeshkvit. Ministri vjenetz, Berchtold, kishte pasur edhe bisedime zyrtare me Vatikanin lidhur me këtë punë, kështu që kërkonte nga Selia e Shenjtë që të deklarohet zyrtarisht për këtë problem. Vatikani ishte shprehur zyrtarisht se, deri sa mos të ketë ndryshime zyrtare nga Vatikani, edhe më tutje është në fuqi që argjipeshkvi L. Mjeda është argjipeshkëv i këtyre territoreve dhe se ai nuk do të kishte pengesa në vizita të territorit të argjipeshkvisë së vet. Vatikani i kishte siguruar përfaqësuesi zyrtar (ambasadorit) të Austro-Hungarisë në Vatikan, Alois (Fürst) Schöngurg-Hartenstein se atë

³⁰⁴ HHStA, PA, XVII, 49, Montenegro XIII, Bericht Kohlruß (Prizren) 125, 10. XII 1913.

³⁰⁵ HHStA., PA, XVII, 49, Montenegro XIII, Bericht Kohlruß (Prizren) 113, 11. XII 1913

³⁰⁶ HHStA., PA, XVII, 49, Montenegro XIII, (Cetinje) 248, 12. XII 1913

që dëshiron të arrijë argjipeshkvi Dobre i , nuk është e pranuar nga Vatikani, duke i treguar se Dobre i kishte vizituar Vatikanin para pak kohe; por, nëse Dobre i vazhdon të bëjë ndonjë hap lidhur me pengesën apo përzierjen në territorin e argjipeshkvisë së Shkupit, që nuk është nën jurisdikcionin e tij, por nën jurisdikcionin e L. Mjedës, ai mund të ekskuminikohej nga Kisha katolike.³⁰⁷

Për ta provokuar edhe më shumë Austro-Hungarinë, gjenerali malazias Vesovi , më 1914, mbylli shkollat katolike në territor të argjipeshkvisë së Shkupit, pikërisht në Pejë më 1914 mbylli shkollën katolike dhe përmes këtij akti dëshironte të vinte në bise-dime direkte me Austro-Hungarinë.³⁰⁸

Më 1913 ishte ideja e qarqeve malaziasë që, nëse dëshirojnë të “ja-pin” Shkodrën e mos të luftojnë më për të, duhej plotësuar kushti që pjesët e territorit të Kosovës së sotme, deri te Gjakova, t’i bashkangjiteshin Malit të Zi. Pra, Gjakova ishte në territor shqiptar, më 1913. Gazetat e ndryshme austro-hungareze i kushtonin rëndësi të madhe ngjarjes për ndarjen e Gjakovës nga territori shqiptar. *Reichspost*, më 23³⁰⁹ e 26 mars 1913,³¹⁰ dhe Gazeta “*Wiener Sonn- und Montags-Zeitung*” , 24 mars 1913³¹¹, shkruajnë se Gjakova duhet të jepet për Shkodrën dhe jo vetëm Gjakova, por pjesa deri të liqeni i Ohrit. Dorëzimi i Gjakovës do të thotë, në të njëjtën kohë, edhe të gjitha famullitë përreth saj.

Lazër Mjeda dhe laramanizmi në argjipeshkvinë e Shkupit

Lazër Mejda³¹² erdhi nga Shkodra në argjipeshkvinë e Shkupit më 1909 dhe ishte argjipeshkëv i kësaj argjipeshkvie deri më 1922, kur

³⁰⁷ HHStA., PA, XVII, 413, Türkei XLV/ Pözel (Prizrend) 69, 27.VI 1913

³⁰⁸ HHStA, PA, XII, 449, Montenegro XIII, Schönburg (Rom) 45, 12. XII 1913

³⁰⁹ Djakova aufgeben, Reichspost 23 mars 1913, (botimi i mëngjesit), fq. 5

³¹⁰ Reichspost më 26 mars 1913 „Djakova für Scutari, fq. 2

³¹¹ Gazeta “Wiener Sonn- und Montags-Zeitung” 24 mars 1913, fq. 1

³¹² Mbi argjipeshkvin Lazër Mjeda shif librin: *Imzot Lazër Mjeda - Mbrojtës dhe lëvruer i identitetit shqiptar*, Albanisches Institut, St. Gallen 2011.

u transferua në Shkodër. Lazër Mjeda ishte argjipeshkvi i fundit i argjipeshkvisë së Shkupit, pas transferimit apo më mirë të themi pas dëbimit, sepse L. Mjeda ishte i detyruar që të largohet nga rezidenca e vet në Prizren, ngaqë politika ditore serbe, e kishte dënuar edhe më burg. Këtu do të trajtojmë vetëm një pjesë së veprimtarisë së tij sa i përket çështjes së laramanëve në argjipeshkvinë e Shkupit.

Më dobësinin dhe rënien e Perandorisë osmane, gjendja e të krishterëve të fshehët apo kriptokatolikëve (laramanëve) në Kosovë e Maqedoni duhet të ishte më ndryshe, sepse ata tash kishin mundësi që të deklaroheshin të krishterë haptas. Siç shihet qartë, tash ka të bëjë me një problem tjetër, sepse politika ditore serbe nuk dëshironte që laramanët të deklaroheshin katolikë, por nëse dëshirojnë të deklarojnë si të krishterë atëherë kanë një mundësi, të deklaroheshin ortodoksë apo të mbeteshin „myslimanë“. Për Këtë raporton edhe gazeta krishtere vjeneze *Reichspost* më 27 dhjetor 1912 (botimi i pasdites), duke iu referuar po ashtu Lazër Mjedës, konkret gazetës slovene „Slovenec“, sepse Mjeda në dhjetor të vitit 1912 gjendej në Lubjanë. Në artikullin „Serbien und die Katholiken“ shkruhet se laramanët apo katolikët e fshehur, siç shkruhet në atë artikull, ishin deklaruar para serbëve se dëshirojnë haptas të jenë katolikë. Kurse Serbia u kishte thënë laramanëve se „ose duhet të bëheni ortodoksë (shizmatikë) ose muhamedanë, kurrësi katolikë“.³¹³

Po ashtu gazeta vjeneze *Wiener Sonn- und Montags-Zeitung*³¹⁴ shkruan për konvertiminin e dhunshëm të shqiptarëve në ortodoksi dhe rolin e argjipeshkvit Mjeda për rikthimin e besimtarëve. Në këtë artikull shihet se konvertimi i shqiptarëve ishte me dhunë dhe se Mali i Zi nuk kishte tolerancë fetare ndaj shqiptarëve.

³¹³ „Serbien und Katholiken“, in: Reichsposts (Nachmittagausgabe) 27. 12. 1912, fq. 1, dhe më shumë Ramaj, Lazër Mjeda në argjipeshkvinë Shkup-Prizren..., fq. 120.

³¹⁴ Wiener Sonn- und Montags-Zeitung, artikulli „Die Antwort Montenegros ist ausständig“ 24 mars 1914, fq. 1, dhe më shumë Ramaj, Lazër Mjeda në argjipeshkvinë Shkup-Prizren..., fq. 121.

Më 21. 12. 1912 Lazër Mjeda gjendej në Lubjanë të Sllovenisë dhe prej aty i drejtohet të Kongregatës së Propagandës Fide, Kardinalit Girolamo Gotti me një letër lidhur me laramanët ku ndër të tjera thekson: “*Lartësia Juaj e di se në Kryepeshkopatën time kishte të krishterë të fshehur (laramanë); ata duke përfutur nga ardhja e pushtuesve të rinj që “krenohen me emrin kristian”, menduan se erdhi koha të shpalleshin hapur se ç’dëshironin të ishin; dhe të gjithë fshatrat në Mal të Zi të Shkupit, Janjevës dhe Ferizajt u shpallën hapur katolikë. Nuk dihet asgjë për ata që banonin në krahinën e Prizrenit, por ka mundësi që edhe ato të kenë bërë të njëjtën gjë, pasi ishin lidhur ngushtë me të tjerët. Se ç’numër kishin, s’mund t’jua them tani, por është e sigurt se duhet të jenë disa mijëra. Porse për serbët, që ndërkohë mburren se kanë ardhur të çlirojnë të krishterët nga zgjedha myslimane dhe t’i japin liri të gjithëve, ky fakt bie ndesh e t’i acaron nervat, u thirr famullitari i Janjevës për t’i treguar se si është bërë ky kthim. Famullitari u përgjigj se ato kishin qenë gjithnjë katolikë, por nga frika e turqve kishin qëndruar fshehur deri atëherë. Komandanti shtoi: “Nëse turqit duan të ndërrojnë fe, duhet të bëhen ortodoksë, e jo katolikë, përndryshe është më mirë të rrinë turq”. Këto fjalë tregojnë mjaft qartë se ç’kriter kërkon të ndjekë qeveria e re dhe si shtypjet dhe përndjekja turke të lë të kuptosh atë të skizmatikëve (serbëve). Ia them këto Lartësisë Tuaj, sepse nën kujdesin Tuaj të lartë dhe mijetet e mundshme të përpigjeni për liritë tona.”³¹⁵*

Lazër Mjeda kishte arritur në janar të vitit 1913 në Vjenë. Prej aty i shkruan edhe me letër më 09. 01. 1913 ministrit të punëve të jashtme austro-hungarez Leopold (Graf) Berchtold von und zu Ungarschitz lidhur më gjendjen shqiptare dhe në argjipeshkvinë e Shkupit. Ndër të tjera shkruan Mjeda edhe për laramanët kështu: “*Prej shumë kohësh në Kryepeshkopatën time kishte katolikë të fshehtë apo laramanë, që fshehurazi ushtroheshin kristianë dhe ishin*

³¹⁵ Gashi Gj. Kosova Altari i Arbërisë, II, fq. 35.

të pagëzuar, por publikisht, për arsye frike, dukeshin myslimanë. Kur erdhën serbët në këto krahina, disa fshatra të këtyre të fshehurve menduan se erdhi koha të shfaqen dhe u shpallën hapur katolikë. (Këto fshatra janë arbërorë e flasin atë gjuhë, jetojnë në Ferizaj e rrethinë, Janjevë e rrethinë dhe në të gjithë Malin e Zi të Shkupit. Ka edhe të tjerë në krahinat e Prizrenit dhe të Pejës, por për to nuk di gjë ç 'kanë bërë). Kam dëgjuar që qeveria Serbe thirri delegatin tim Imzot Glasnovic, dhe kërkoi të dinte si ishte bërë ky kthim i muhamedanëve. Prifti iu përgjigj se nuk kishte ndodhur asnjë kthim i muhamedanëve, por vetëm një manifestim i hapur (publik) i katolikëve, të cilët deri në atë kohë nga frika e „turqve“ kishin qëndruar të fshehur.

Megjithatë, ky shpjegim nuk e kënaqi komandantin serb, i cili i tha priftit se, nëse myslimanët duan të ndryshojnë fe, duhet të bëhen ortodoksë, por jo katolikë: përndryshe le të qëndrojnë myslimanë. Dhe di nga vende të tjera që myslimanë që donin të përqafonin krishterimin, u ndaluan nga qeveria serbe“.³¹⁶

Më 20 dhjetor 1912 kishte raportuar nga Lubjanë Lazër Mjeda, po ashtu edhe Kardinal Gottin, lidhur me laramanët në argjipeshkvinë e vet ku kishte njoftuar se qeveria serbe nuk i lejon që ata të jetonin haptas si katolikë, por ata duhet të mbeteshin muhamedanë ose të kalonin në ortodoksi.³¹⁷

Më 29 shtator 1913 Mjeda i shkruan kardinalit Gotti lidhur me laramanët kështu: “Në të vërtetë këto ditë e para u bë një lëvizje e madhe sidomos në anët e Cërnegorës (Mali i Zi i Shkupit), ku pot-huajse të gjithë të fshehurit ishin shfaqur tek famullitari i Stubllës dhe i kishin kërkuar një letër, ku të dëshmojnë se ishin katolikë. Famullitari nuk kishte kundërshtuar dhe njëri prej tyre, një farë Jetishi nga Dunavi, ishte shpallur i pari katolik me të gjithë familjen.

³¹⁶ Gashi Gj.: Kosova... II., fq. 39-40

³¹⁷ Krah. Gashi Gj.: Kosova II., fq 66.

Por qeveria, pasi mori njoftimin, kishte dërguar t'i thonin që, ose të bëheshin ortodoksë, ose ti priste vdekja. I shkreti ishte endur si shtegtar nëpër shpella e ferra për disa kohë, por pastaj, duke parë që familja kontrollohej çdo ditë dhe turbullohej nga serbët, ishte kthyer në shtëpi, duke u shtirur se ishin dakord me dëshirat e tyre.

Ndërsa një tjetër, megjithëse kërcënuar dhe rrahur, që më i patundur dhe vazhdonte të mbetej katolik.

Kështu edhe ata të Androcit të Janjevës. Aty, nga gjashtëmbëdhjetë familje, vetëm pesë dezertuan; të tjerat i rezistuan me kurajo të gjitha kërcënimeve të qeverisë. Por patën favorin se në krye të komunës së Janjevës në atë kohë ishte famulltari lokal dhe këta mund të kishin kurajo dhe të mbroheshin nga reprezaljet e serbëve. Kështu që deri tani nga ata që ishin të fshehur kemi vetëm një shtatëdhjetë vetë që janë shpallur dhe qëndrojnë hapur katolikë. Të tjerët, nga frika, fshihen përsëri dhe kur u bë regjistrimi, u shkruan myslimanë”.³¹⁸

Është interesant fakti se qeveria serbe në atë kohë nuk lejonte që priftërinjtë katolikë të kishin kontakt të drejtpërdrejt me kriptokatolikët apo laramanët në argjipeshkvinë e Shkupit, duke i etiketuar priftërinjtë se bënë propagandë austriake, por Mjeda i vizitoi laramanët në Karadak apo në Malin e Zi të Shkupit dhe u dha kurajo që të deklarohen publikisht si katolikë e mos të mbesnin të fshehur apo zyrtarisht të deklarohen myslimanë. Për fat të keq, kishte edhe myslimanë fanatikë shqiptarë që këta laramanë i frikësonin se së shpejti do të kthehet Turqia në këto troje, ndaj ata u bënë me dije se do do ta pësonin keq. Lazër Mjeda shkruan për këtë gjë kështu: *“Qeveria i ndaloi priftërinjtë të shkonin tek ata dhe të komunikonin me ta, me pretekstin se bënë propagandë austriake”*.³¹⁹

³¹⁸ Gashi Gj.: Kosova II. fq. 66

³¹⁹ Gashi Gj.: Kosova II. fq. 66

Qeveria beogradase në atë kohë dhe më vonë kishte kërkuar nga priftërinjtë e argjipeshkvisë së Shkupit emrat që janë të pagëzuar dhe që janë të shënuar në këtë libër, duhet të fshihen dhe kjo punë të mos ndodh më. Pagëzimi apo deklarimi haptas i kriptokatolikëve si katolik në argjipeshkvinë e Shkupit shihej me sy të keq nga ana e politikës së Beogradit, shihej si akt kundërshtetëror dhe kërkohej nga priftërinjtë që këto gjëra mos të ndodhnin apo ata persona që dëshirojnë të dalin haptas si të krishterë, të deklarohen ortodoks. Kurse të njëjtën kohë, edhe përfaqësuesit fetarë të besimit mysliman kërkonin nga Beogradi që kjo gjë të mos ndodhë më dhe e alarmonin Beogradin për këtë akt “jo patriotik”³²⁰ që kleri katolik po pagëzon ata persona.

Për kohën kur Lazër Mjeda ishte argjipeshkëv në Prizren, misionet fluturuese të jezuitëve kishin përshkruar edhe detaje për gjendjen e laramanëve në këtë argjipeshkvi³²¹. Një libër mbi veprimtarinë e Jezuitëve në Kosovë e Maqedoni prej 1888–1912 është përgatitur nga autori i këtyre rreshtave dhe është dorëzuar në Zagreb për botim, dhe rreth veprimtarisë së Jezuitëve në mesin e laramanëve në argjipeshkvinë e Shkupit mund të lexohet me më shumë detaje në atë dorëshkrim. Sipas letrës së Genovizzi-t, dërguar provincës së vet në Milano më Skoplje, 28 janar 1912, shihet se autoritete turke kërkonin nga laramanët e argjipeshvisë së Shkupit që së paku kryefamiljari të shkonte haptas në xhami.³²² Në këtë letër shifet

³²⁰ Krah. Zutić N. : *Rimokatolicka mistija i klerikalizam na Kosovu*, fq. 108

³²¹ Mbi laramanët në argjipeshkvinë e Shkupit gjatë kohës kur Lazër Mjeda ishte argjipeshkëv shih edhe raportin e atë Giovanni Battista della Pietra për misionin fluturues të mbajtur në argjipeshkvinë Shkup-Prizren më 1911 në: *Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Venta*, Serie XXII, Venezia 1912, fq. 20-31 dhe raportin e Atë Francesco Genovizzi për misionet në këtë argjipeshkvi më 1911 dhe 1912 në *Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Venta*, Serie XXII, Venezia 1913, fq. 3-20. Këto detaje janë po ashtu në librin e përgatitur nga Albert Ramaj (manuskript) që duhet të botohet së shpejti në Zagreb.

³²² Shif: *Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Venta*, Serie XXII, Venezia 1913, fq. 3

shumë qartë se jeta e laramanëve në këto troje, sidomos në Karadakun e Shkupit nuk ishte aq e lehtë.

Është interesant se në misionin fluturues të Jezuitëve ishte edhe një misionar nga Stublla e Kosovës që quhej Fratel Zef Antunovic³²³. Zef Valentini ka shkruar një shkrim për fratel Zefin në ët cilin cek se ai vjen prej një rrethi laraman.³²⁴ Kjo ishte me rëndësi që ai iu bashkëngjiti misionarit At Domenico Passi S.J. sepse njihje shumë mirë mentalitetin e laramanëve në trojet e argjipeshkvisë së Shkupit. Frateli u ishte bashkëngjitur misionarëve jezuitë jo vetëm për territorin e Kosovës, por edhe atë të Shqipërisë. Këtë e përshkruan shumë edhe At Fulvio Cordignano në librat e tij „*L'Albania a traverso l'opera e gli scritti di un grande Missionaria italiano, il P. Domenico Pasi S.J.* (1847–1914). I–III. Roma (1933–1934). Fratel Zefi kishte jetuar kohë të gjatë në Shkodër, ku më 1936 edhe kish—te vdekur.

Me persekutimin e katolikëve në Kosovë e Maqedoni ishin marrë edhe shumë revista evropiane, jo vetëm ato vieneze, po ashtu edhe për çështjen e laramanëve në këto troje. „Le Missioni Cattoliche“ e Milanos kishte shkruar që ata dëshironin të deklaroheshin haptas si katolikë. Gazeta e cekur milaneze kishte shkruar një shkrim tejet interesant për gjendjen e Kishës katolike në Kosovë më 20. VI. 1913, në të cilin trajton temën se si është e mundur që Serbia kishte luftuar kundër turqve, pra myslimanëve, dhe se si të krishterët tash luftojnë kundër të krishterëve katolikë shqiptarë dhe se me aktet barbare ndaj popullatës shqiptare siç duket ky është vetëm fillimi. Në këtë shkrim ndër të tjera shkruhet edhe për laramanët e argjipeshkvisë së Shkupit. Kur Mbreti serb Petar I. kishte shkuar në Shkup më 24 janar 1913, kishte takuar 50 familje laramane që i

³²³ Mbi jetën e Zef Antunovic shif A. Ramaj, Burime dhe dëshmi, fq. 108-118

³²⁴ Giuseppe Valentini “Il Fratel Zef e la Missione volante” in Notizier agli Amici dei gesuiti lambardo-veneto-emeliani, Milano, 2 (1972), fq. 36-41. Shif poashtu edhe Sinishta Gj.: Jezuits in Albanien. Fq. 73 dhe Ramaj A: Burime dhe dëshmi, fq. 108-116.

kishin deklaruar atij haptas se dëshirojnë të jenë katolikë. Mbreti i zëmëruar u kishite thënë: „Katolikë! Keq e shumë keq! Ose ortodoksë ose muhamedanë, e kurrësi katolikë“. Shkrimin e ngjashëm e shkruan edhe gazeta katolike e Splitit të Kroacisë „Dan“ më 2 korrik 1913, e cila po ashtu shtjellon të njëjtën temë me titull „Mëshohu katolikëve dhe lirisë së tyre“.

Dihet se Serbia sidomos gjatë luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore kishte problem të madh me klerin katolik dhe besimtarët e tyre, kjo sidomos për shkak se katolikët shqiptarë trajtoheshin gati njëjloj sikurse austro-hungarezët. Kështu që laramanët e këtyre trevave me dashje apo pa dashje për shkak të politikës ditore ishin të detyruar që edhe më tej të mbeteshin laramanë e nuk i lejonte që të deklaroheshin haptas katolikë, pra, vetëm ashtu si dëshironin. Serbia e Mali Zi kishin qëllim tjetër, pra që të konvertonte (me dhunë) në ortodoksë, jo vetëm laramanët shqiptarë, por edhe katolikë dhe myslimanë shqiptarë në. Këtë qëllim tentuan Mali i Zi e Serbia kryesisht në vitin 1913, sidomos në pjesën e Pejës, Gjakovës dhe të Malit të Zi të sotëm.³²⁵ Atë Luigj Paliq OFM nuk i lejonte besimtarët e vet që të konvertoheshin në ortodoksë dhe për këtë arsye u vra nga forcat malazeze më 1913 në Janosh afër Gjakovës. Lazër Mjeda përballej jo më vetëm me problemin e laramanëve në këto troje, por edhe të besimtarëve që prej raprezaljeve, torturave, dhunës e mundimeve të lloj-llojshme ishin të detyruar se paku që sipërfaqësisht shqiptarët të besimit katolik e mysliman të deklaroheshin si ortodoksë, sepse nuk mund t'i përballonin gjithë atyre mundimeve të mëdha që i bëhej popullit shqiptar. Lazër Mjeda si bari i mirë i vizitonte këto vende dhe u jepte kurajo që të mos e bënë një gjë të tillë. Më 27 maj kishte vizituar Gjakovën dhe kishite biseduar me besimtarët e vet për deklarimin e dhunshëm të tyre.³²⁶ Për konvertimin e shqiptarëve (myslimanë e katolikë) në or-

³²⁵ Për këto gjëra shif më shumë Zekeria Cana Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913 (Dokumente).

³²⁶ Zekeria Cana, Gjenocidi i Malit të Zi... fq. 216

todoksië, Noel Malcolm thotë: „*this was applied with peculiar vigour by the Montenegrins*“.³²⁷ Është shumë e vërtetë se Lazër Mjeda nuk ishte angazhuar vetëm për katolikët e konvertuar në territorin e pushtuar nga Mali i Zi më 1913, por siurse ceket „*për të gjithë të gjitha konvertimet tjera me dhunë*“³²⁸, pra edhe për myslimanët dhe laramanët shqiptarë. Më 19. 03. 1913, lidhur me këto probleme Lazër Mjeda shkruan kështu: „*me shëndet jam mirë; shumë gjëra të këqija, të vështira kam pasur këto ditë, arsyeja kryesore/salvimet e trishtueshme, të hatashme të shpërthyer kundër katolikëve nën pushtetin malazez. Më se 70 familje fëmijë kanë kaluar në skizëm dhe ekziston rreziku me arsye që edhe të gjitha familjet tjera të veprojnë në të njëjtën mënyrë, duke mos pasur rrugëdalje. Tre fshatra kanë pasur mundësi natën të ikën në territorin nën pushtetin serb, duke lënë çka kanë pasë e tjerët s'kanë pasë mundësi ta kalojnë kufirin...*“³²⁹. Lazër Mjeda përnjëmend bari i mirë për besimtarët e vet, u jepte guxim që mos të lëshonin fenë e vet, i vizitonte ata rregullisht në kohët më të vështira. Më 16.III.1913 shkruan: „*Tash jam vetë i nevojshëm për të holla, pasi kam pasur detyrë të kujdesohem për refugjatët e Gjakovës...Dje për Rrëshajë jam kthyer nga Gjakova, e nesër prapë do të kthehem për tri–katër ditë. Pasi çështja e refugjatëve ende nuk u zgjidh, dhe populli është në lëvizje tash këtu e tash atje, është e nevojshme kohë pas kohe t'i vizitoj dhe t'i ngushëlloj, duke u dhënë zemër dhe duke u ndihmuar materialisht, se kanë humbur çdo gjë dhe janë pa bukë. Kjo është arsyeja pse tani nuk mund të largohem, se përndryshe tani isha në ato anë.*“³³⁰

Më 1913–14 zhvilloheshin bisedimet mes Vatikanit dhe Serbisë lidhur më një marrëveshje zyrtare e njohur si konkordati. Përfaqësuesi zyrtar (ambasadorit) i Austro Hungarisë në Vatikan Alois

³²⁷ Malcolm N.: Kosovo. short story, fq. 254

³²⁸ Cana Z., Gjenocidi fq. 165

³²⁹ Sopi M.: Shembulli i Bariut të mirë dhe atdhedashës, arritja e imz. Lazër Mjedes në Prizren, in *Drita*, viti XIII, nr 3-4 (95) 1982, fq. 8.

³³⁰ Mark Sopi. Shembulli i Bariut të mirë dhe atdhedashës, fq. 8.

(Fürst) Schöngurg–Hartenstein dhe ministri i punëve të jashtme austro–hungarez Leopold (Graf) Berchtold von und zu Ungarschitz, jo vetëm që angazhoheshin për përmirësimin e gjendjes shqiptare dhe ruajtjen e protektoratit austro–hungarezë, por ishin të vetëdijshëm edhe për shumë imtësi për popullatën shqiptare, pra edhe për laramanët e këtyre vendeve dhe nga bisedat e shkrimet që shkëmbeheshin mes zyrtarëve austro–hungarezë dhe të kardinalit Merry de Val kërkohesh që nga Vatikani të bisedohej edhe për lirinë fetare të laramanëve në Argjipeshkvinë e Shkupit nga ana e Serbisë. Më 12 mars 1913³³¹ lajmëron ambasadori i Austro–Hungarisë në Romë Schönbürg, se kishte biseduar me Vatikanin lidhur me lirinë fetare të laramanëve në argjipeshkvinë e Kosovës. Kështu që qysh në fazën e parë të bisedimeve lidhur me konkordatin kishte shprehur dëshirën për të siguruar lirinë fetare të laramanëve. Në qarqet e Vatikanit ishin të brengosur për laramanët. Vjena dhe Roma ishin të njoftuar për gjendjen e laramanëve pas largimit të Turqisë nga Ballkani, por tash kishin lindur probleme të reja për ta, pra Serbia. Në këtë letër ceket se për gjendjen e laramanëve në argjipeshkvinë e Shkupit ishin njoftuar nga raportet e ndryshme, pra të argjipeshkvit Lazër Mjeda.

Këtë e dëshmon edhe letra e ministrit të punëve të jashtme Leopold (Graf) Berchtold më 02. VI. 1914 dërguar përfaqësuesit Alois (Fürst) Schöngurg–Hartenstein.³³²

Gazeta Reichspost e 20 marsit 1913 shkruan po ashtu për laramanët dhe gjendjen të tyre në argjipeshkvinë e Shkupit dhe shkruan se ata deri më tash nuk kishin mund të deklaroheshin haptas për shkak të turqve, kurse tash e kanë problem prej Serbisë dhe shkruan se qarqet e Beogradit u kishin ndaluar laramanëve të deklaroheshin haptas si katolikë, ose duhet të bëhen mysliman e nëse dëshirojnë të bëhen të

³³¹ ÖStA. PA, XIII, 314 Türkei, XXXIV / 5 A, më 12. shkurt 1913

³³² Shif ÖStA. PA. XIX, 93, Serbien XVIII/ (Rom – V.) 2480, më 02. VI. 1914

krishterë atëherë ortodoks.³³³. Po ashtu edhe Leo Freundlich e merrë këtë artikull dhe e riboton në librin e tij “Albaniens Golgotha”³³⁴

Më 31 Janar 1911³³⁵ njofton konsullata austriake e Shkupit se kishte pasur një grup ortodoks nga Maqedonia, më saktë nga Kumanova që kishin shkuar tek argjipeshkvi Lazër Mejda dhe tek famullitari i Ferizajit Dom Pashk Krasniqi dhe u kishin kërkuar ndihmën e tyre që ata të kalojnë në katolicizëm. Pra ishte fjala për besimtarë ortodoks maqedonas e që dëshironin të kalonin në katolicizëm. Është e njohur komuniteti greko-katolik me kombësi maqedonase në Maqedoninë e jugut, pra në Strumicë e rrethinë, por këta ishin tamam ortodoksë. Nuk është fjala për komunitetin katolik të rritit bizantin që jeton edhe sot e kësaj dite në territorin e Maqedoniës, por është fjala për ortodoks të vërtetë.

Komunitetin greko-katolik në Maqedoninë e sotme ia kishte besuar Papa Benedikti më 1915 argjipeshkvit të Shkupit Lazër Mjedës. Argjipeshkvi Mjeda ishte pra edhe argjipeshkëv i katolikëve të rritit bizantin në Maqedoni, që më kombësi janë maqedonas. Argjipeshkvi Mjeda dëshironte që këtë komunitet të vizitonte vetëm dhe të shihte në të vërtetë se si është gjendja e këtyre shpirttrave që papa ia kishte besuar. Organet e atëhershme bullgare nuk i dhanë leje Mjedës që të viziton këtë komunitet.

Viti 1915 ishte shumë vit i vështirë edhe për katolikët e rritit bizantin, sepse bullgarët kishin vlarë e mbytur dhe kishin shkatërruar gati çdo gjë që ata kishin, shtëpi e pasuri tjera. Ngaqë Mjeda nuk mund të shkonte në këtë zonë, ai organizoi që ndihmat t’ua dërgonte gjithsesi dhe përmes meshtarit P. Nedeljko, i cili më 20

³³³ Der Konflikt mit Montenegro, Reichspost 20 mars 1913, fq. 2, poashtu edhe Ramaj : Lazër Mjeda në argjipeshkvinë Shkup-Prizren, fq. 132.

³³⁴ Freundlich L.: Albaniens Golgotha fq. 27

³³⁵ HHSTa XXXVIII PA. 441, Konzullate Üsküb 1911-1913 të datës 31 janar 1911, fq. 293-294.

mars 1916 i shkruan një letër falënderimi Mjedës për këto ndihma të rëndësishme.³³⁶

E vërteta për largimin e Mjedës nga Argjipeshkvia e Shkupit

Në disa shkrime gjejmë të shënuar, edhe nga autorë shqiptarë, pohimin se Lazër Mjeda e lëshoi argjipeshkvinë e Shkupit qysh me 1911, dhe se deri me emërimin e ipeshkvit të ri, Janez Gnidovec, nuk ishte i pranishëm. Kështu shkruajnë Milan Premrou M³³⁷, Gaspër Gjini³³⁸ Zef Mirdita³³⁹, Aloiz Turk³⁴⁰.

Se Mjeda e lëshoi argjipeshkvinë më 1911, kjo nuk mund të jetë e saktë. Në këtë pjesë do të trajtojmë këto gjera, ku dhe shihet taman se si është e vërteta, duke e trajtuar çështjen e Mjedës, sidomos prej vitit 1914 deri më 1921.

Argjipeshkvi Mjeda, në letrën e tij të datës 09.01.1913, dërguar Ministrin të Punëve të Jashtme austro-hungareze, Leopold (Graf) Berchtold³⁴¹, cek një gjë shumë interesante se, katolikët shqiptarë të argjipeshkvisë së vet nga ana e Serbisë, konsideroheshin si “*armiq të shtetit serb*”. Shqiptarët katolikë, e sidomos klerikët katolikë, paraqiteshin si armiq të shtetit serb, gjë që dëshmohet edhe sot nga vetë autorët serbë, të cilët tregojnë se njerëzit më të rrezikshëm për shtetin jugosllav ishin klerikët katolikë shqiptarë, e sidomos Lazër Mejda, që edhe „*serbofob*“ e quajnë³⁴². Kurse atë Gjergj Fishtën e quajnë „*serbofobin më të madh të njerëzimit*“³⁴³. Mjeda, në letrën e

³³⁶ Shif më shumë Rudolf Grulich: *Die unierte Kirche in Mazedonien* (1856-1919), fq. 91.

³³⁷ Premrou Milan, Katolicki nadbiskupi u Skopju, glasnik skopskog naucnog drustva, Shkup 1926.

³³⁸ Gjini Gaspër, Ipeshkvia, fq. 203

³³⁹ Zef Mirdita, Shqiptarët në dritën e politikës së jashtme të Shkrimi në dardania sacra shqip apo anglisht e kroatish i njajti.

³⁴⁰ Turk, Letnica, fq. 57.

³⁴¹ Krah Gj. Gashi, Kosova II, fq. 40

³⁴² Nikola Zutic, artikl nga Istoria 22 veka., krah. fq. 111

³⁴³ Nikola Zutic, artikl nga Istoria 22 veka., krah. fq. 112

09. 01. 1913, më tej thekson mendimin se do duhet të bëhej ndonjë marrëveshje mes Selisë së Shenjtë dhe Serbisë, për lirinë fetare, mbasi gjendja e katolikëve që gjendeshin nën territorin e Serbisë, ishte shumë e vështirë.

Në disa shkrime, nganjëherë paraqitet se *“largimi”* i Mjedës së 1911, ishte me vetëdëshirë. Kjo është thënë dhe thuhet edhe sot, se ai e ka lëshuar argjipeshkvinë me dëshirën e vet dhe se ka dashur të shkojë në Shkodër. Këtë e thotë edhe argjipeshkvi i Beogradit, Aloiz Turk³⁴⁴ dhe, në anën tjetër, kishte po ashtu zëra të cilët e akuzonin Mjedën, gjoja për faktin se, si ka mundur që, si prijës i Kishës në argjipeshkvinë e Shkupit, t'i lërë besimtarët e tij dhe detyrën për të ikur drejt Shkodrës, dhe kjo në një kohë kur ndihej nevoja më e madhe për prezencën dhe mbrojtjen e tij. Kjo akuzë vinte sidomos nga shtypi sloven.³⁴⁵

Në anën tjetër, kemi shumë fakte se Mjeda kishte lëshuar ipeshkvinë e Shkupit pas dekretit që ishte lëshuar nga Papa Benedikti XV. Dihet se më 14 prill 1909, Papa i Shenjtë Piu X, ka dekretuar Mjedën për në argjipeshkvinë e Shkupit, dhe 12 vite më vonë është emëruar argjipeshkëv metropolitan i argjipeshkvisë së Shkodrës nga Papa Benedikti XV, me dekretin e datës 19. tetor 1921. Dhe kjo kishte ndodhur pas vizitës që i kishte bërë rajonit vizitatori nga Vatikani, monsinjor Ernesto Cozzi, i cili kishte konstatuar se ai ishte i vetmi njeri që ishte i përshtatshëm, për ta bërë prijës të kishës në Shkodër. Pra ai, sipas kësaj vlerësimi, me 14 shkurt 1922, kthehet në Shkodër, për të shërbyer deri me vdekjen e tij, më 1935.³⁴⁶

³⁴⁴ Turk, Letnica, fq. 57.

³⁴⁵ Lexo më shumë artikulin e gazetës Druzina të Ljublanës: “Na svetolnik postavljeno, ob 55-letnici postavate skofa De. J. Fr. Gnidovec, 18.XI. 1979, fq. 13.

³⁴⁶ Krah. Markus Peters, Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbegegnung, Bildung und Kultur, Hamburg 2007, fq.423-424.

Dihet se Mjeda kishte qëndruar deri më 1921 në Prizren. Deri më 1918 dëshmojnë dokumentet që gjenden në Vjenë, në dosjen “*Prizren*”, apo në raportet e konsujve austro-hungarezë nga Prizreni³⁴⁷.

Raportet e Lazër Mjedës, dërguar në Vatikan e Vjenë, dihet se ishin deri më 1921, pra kur ai qëndronte në Prizren. Disa nga raportet i ka publikuar edhe Gjergj Gashi në librin e tij “*Kosova – Altari Arbërisë*”, kështu që, siç duket, është bërë një lëshim i madh nga historianët, apo autorët tanë që thonë se Mjeda kishte lëshuar argji-peshkvinë e Shkupit qysh më 1911. Burimi i këtij gabimi duhet të jetë tek M. Premrou, i stërcituar në botime të ndryshme.

Është e njohur se L. Mjeda, më 28 nëntor 1916, i kishte nda sakramentin e krezmimit edhe Gonxhe Bajaxhiut (Nënë Terezës) e kumbara i saj ishte Tade Simon Shiroka. Për këtë është dokumenti (Fletëkrezmimi) i saj.³⁴⁸ Dihet edhe raportet e Mjedës që rregullisht i dërgonte nga Prizreni, deri më 1921. Një raport i Mjedës për vdekjen e 1000 personave në Prizren, paraqet edhe Noel Malcolm.³⁴⁹

Konsullata e Shkupit, konkretisht konsulli Lejhanec, njofton më 26 korrik 1911,³⁵⁰ lajmin e Kolë Bojaxhiut (baba i Nënë Terezës), i cili kishte shkuar së bashku me Luigj Naraçin tek konsullata italiane në Shkup, për të hapur një shkollë italiane. Në këtë raport shihet se Kolë Bojaxhiu ishte më afër me konsullatën italiane sesa austriake. Më poshtë në këtë raport njoftohet se Mjeda nuk kishte ndërmarrë asnjë hap të duhur, por pret një herë nga Vjena konstrukcione të caktuara. Nga letra e konzullit Lejhanec del se L. Mjeda kishte njohur shumë mirë Kolë Bojaxhiun, babën e Nënë Terezës.³⁵¹

³⁴⁷ Krahaso HHStA, Diplomatie und Außenpolitik 1848-1918 GKA KsA, Konsulatsarchiv Skutari, Kt. 11, kath. Klerus, Miedia.

³⁴⁸ për më shumë shif. Alber Ramaj, Mutter Teresa... fq. 56

³⁴⁹ Noel Malcolm, Kosovo, fq. 261-262.

³⁵⁰ HHStA, HHSa, F 27, 139 Missionen Üsküb 1871-1911, Üsküb I, 1, raport i Lejhanec më 26 korrik 1911

³⁵¹ HHStA F27/K 135 –Missionen Üsküb 1871-1911, raport i konzullit Lejhanec nga Shkupi më 26 qershor 1911

Me konkordatin e viti 1914, shihet shumë qartë se Serbia dëshironte centralizëm për Kishen katolike, pra që çdo gjë të kontrollonte vetë, nëse ishte e mundur. Marrëveshja (konkordati) nuk kishte sjellë përmirësim të gjendjes së katolikëve shqiptarë, përkundrazi. Me sa shihet, si një nga qëllimet kryesore të Serbisë duhet të ketë qenë njohja indirekte e pushtetit serb nga Vatikani edhe në ato pjesë, si Kosova dhe Maqedonia. Dhe, meqë vetë kleri katolik shqiptar ishte ai që luftonte politikën serbe dhe ishte kundër nënshtrimit të këtyre pjesëve të banuara me shqiptarë nga pushtuesit serbë, marrëveshja ishte e mirëseardhur.

Mjeda, nga ana e politikës jugosllave gjykohej si njeri shumë i rrezikshëm, sepse ai ishte vënë në mbrojtje, pa dallime, të shqiptarëve, dhe mu kjo e bënte atë të kualifikohet si i rrezikshëm. Duke pasur parasysh rrethanat e kohës dhe gjendjen e arsimimit të popullatës, ishte kleri ai që kishte njohuri, aftësi e mundësi për t'iu kundërvënë politikës serbe e malazeze. Argjipeshkvi Mjeda ballafaqohej me një problem tjetër. Ai ishte shtetas i Shqipërisë, dhe për këtë punë, me nënshkrimin e konkordatit të 1914, ishin të paraparë që meshtarët të mos jenë të huaj, përveç atyre që janë të lindur në „Jugosllavi“. Është fakt që Mjeda, për qeverinë jugosllave, ishte një lloj „*zullumqari*“, me raportet e veta për mbrojtjen e të drejtave të besimtarëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Qeveria jugosllave dinte shumë mirë që L. Mjeda kishte lidhje të forta me botën perëndimore dhe e shihnin si të rrezikshëm.

Më 25 shkurt 1915, Mjeda i shkruan Beogradit lidhur me emërimin e famullitrit të Shkupit, pasi që më shumë se një vit më parë kishte vdekur famullitari i atyshëm dom Zef Ramaj. Qeveria dëshironte që edhe në emërimin e famullitarëve të ketë fjalën e vet. Mjeda vendos veton, pra pa konsultim dhe për famullitar emëron dom Shtjefën Zadrimën, për të cilin Beogradi nuk ishte i pajtimit me të. Poashtu Mjeda, me një letër të 29. II. 1915, kishte problem me burgosjen e tre meshtarëve të argjipeshkvisë së vet, si: Milosav Hulak, Giovani Nerkmer e Adolf Melan. Mjeda kërkon lirimin e

tyre, prej të ciklëve dy të shkonin të shërbenin në famullinë e Nis-hit – famullia ishte pjesë e argjipeshkvisë së Shkupit, kurse për njërin prej tyre kërkon që të vinte e të shërbente në Shkup.³⁵²

Lazër Mjeda duhej të emërohej administrator, e pastaj argjipeshkëv i parë në Boegrad. Largimi nga Prizreni

Nga një raport i diplomatit austro-hungarez Schönburg, del se kardinali Mery de Vall ishte personi i cili kishte pasur ndikim për konkordatin dhe se ai nuk ishte përherë në favor të elementit shqiptar, por diplomati Schönburg e shtyjnë shumë gjëra të mendonte ashtu dhe dëshironte të bindte se mbrojtja e shqiptarëve është poashtu gjë që duhet patjetër të trajtohet edhe përmes konkordatit e kërkon që edhe e drejta e shkollave shqipe të mbrohet përmes konkordatit. Ministri i jashtëm i Austro-Hungarisë, Bertchold dëshironte që me çdo kusht, kleri katolik shqiptar i argjipeshkvisë së Shkupit të kishte mundësinë e shkollimit vetëm në Shkodër, në Seminarin papnor³⁵³ dhe poashtu Serbia kishte problem që kleri katolik shkollohej jashtë, sidomos në Austri (Innsbruck)³⁵⁴. Ideja e Serbisë ishte që të ngrihej një seminar në territor të saj, në Beograd, dhe kjo të vendosej me konkordat, kurse Austro-Hungaria nuk lejonte një gjë të tillë, sidomos Ministri i Punëve të Jashtme i Austro-Hungarisë, Berchtold.

Në të njëjtin raport shihet poashtu se, po të krijohej një lloj seminari në Kosovë apo Serbi, Austro-Hungaria kërkonte që në këtë seminar duhej, patjetër, të ishte poashtu edhe gjuha shqipe, nëse jo e para, e dyta, apo së paku një seksion special i gjuhës shqipe. Ambasadori Schöngurg i kërkon kardinalit Mery de Vall, edhe nëse bëhet semianri në Beograd, duhet patjetër që të mësohet edhe në

³⁵² Krah Dragoljub Zivojinovic, Vatikan, Srbija ... fq. 83-84

³⁵³ HHStA, PA. XIX, 93 Serbien XVIII/ 1, 5736, raporti i Schönburg më 9 dhjetor 1913

³⁵⁴ HHStA, PA. XIX, 93 Serbien XVIII/ 1, 17 B, Raporti i Schönburg, më 19. maj 1914

gjuhën shqipe.³⁵⁵ Schöngurg—u, duke parë se puna e nënshkrimit të konkordatit nuk mund të mënjanohet, lajmëron dhe kërkon nga Ministri i Punëve të Jashtme i Austro—Hungarisë Berchtold, që patjetër të krijohet një seksion i gjuhës shqipe edhe nëse bëhet puna që seminari të ndërtohet në Beograd³⁵⁶

Për seksionin e gjuhës shqipe në seminarin e mundshëm në Beograd, Austro—Hungaria nuk dëshironte të lëshonte pe në bisedime për konkordat³⁵⁷, poashtu edhe të shkollave shqipe. Seksionin në gjuhën shqipe, në seminarin në Boegrad, ishte i paraparë që të udhëhiqte vetë argjipeshkvi Lazër Mjeda.

Në qershorin e vitit 1915, qeveria e Beogradit kishte dërguar në Romë përfaqësuesin (ambasadorin) e vet Gavrilovic. Kardinal Gaspari kishte pasur takim zyrtar me Gavrilovic. Në këtë bisedë ishte shfaqur edhe ideja që në Beograd të vendoset ipeshkvi siç ishte paraparë sipas konkordatit të vitit 1914. Kardinali i propozon që për administrtor të Beogradit Vatikani ka për qëllim të emërojë argjipeshkvin L. Mjeda. Gavrilovi nuk ishte aspak me këtë ide, i pakënaqur, mundohet që të bindë kardinalin Gaspari se Mjeda nuk gëzon aspak respekt dhe nuk ka kurrfarë besimi nga qeveria e Beogradit. Pra, është i padëshiruar në qarqet politike në Beograd e kështu që nuk do të ishte i kënaqur me këtë emërim. Mundësia e emërimit të Mjedës, si administrator i Beogradit, do të ishte humbje fatale për Serbinë, sepse ekzistonte mundësia që pas luftës, Mjeda të mbetej argjipeshkëv i Beogradit e jo vetëm administrator. Papa Benedikti XV i kishte dërguar Mjedës, në fillim të marsit 1915, një tekst zyrtar për ta lexuar. D. ivojinovi shkruan se është fjala për leximin e një enciklike për paqen, kështu që sipas saj del që papa i

³⁵⁵ HHStA., PA XIX, 93 Serbien XVIII / 1, raporti i Schönburg (Romë) – V), 17 B, më 19. 05. 1914

³⁵⁶ HHStA., PA XIX, 93 Serbien XVIII / 1, raporti i Schönburg (Romë) – V), 25 dhe 26, më 7 qershor 1914

³⁵⁷ HHStA., PA XIX, 93 Serbien XVIII / 1, raporti i Schönburg (Romë) – V), 32, më 23 qershor 1914

kishte dërguar Mjedës tekstin për lexim para publikimit të ndonjë dokumenti që papa këshillohej me Mjedën apo diçka tjetër. Është e njohur enciklika për paqën e Papës Benediktit XV, që quhet „*Ad beatissimi Apostolorum principis*“ dhe që është publikuar më 1 nëntor 1914. Ndoshta Papa i kishte dërguar tekstin e enciklikës para se të publikohet, kurse Beogradi kishte marrë vesh më vonë, apo është fjala për ndonjë dokument tjetër zyrtar. Duhet kërkuar më shumë kjo gjë. Kjo ishte për Beogradin shumë shqetësuese dhe dëshirohej që në krye të ipeshkvisë së Beogradit të mos vinte L. Mjeda, sepse siç thonin „*ishite njeri i Austro-Hungarisë dhe i Vatikanit*“. Sipas mbledhjes qeveritare në Beograd të datës 3 shtatorit 1915, shihet se emërimi i mundshëm nga ana e Vatikanit i Mjedës, për administrator të Beogradit, do të ishte qëllimi i Vatikanit, që përmes Mjedës, të aprovohet politika e Vatikanit në këto troje dhe do të ishte një disfatë e madhe për Serbinë. Deri sa emërimi i Mjedës për argjipeshkëv të Beogradit nuk erdhi. Serbia dëshironte që me çdo kusht të parandalohet ky emërim i Mjedës një herë administrator e më vonë argjipeshkëv i Beogradit. Siç duket, mandatin për administrator të Beogradit L. Mjeda e kishte. Këtë e potencoi edhe N. Zuti.³⁵⁸ Ndoshta, kjo ishte vetëm gojarisht, apo edhe ndonjë shkrim–letër nga Vatikani që i kishte drejtuar Mjedës, apo është ndoshta edhe fjala për „*enciklikën*“ që përmendëm më lartë, e dërguar nga Papa Mjedës. Për këtë duhet të ndërmerrej ndonjë gjë kundër Mjedës, që jo të emërohet por edhe mundësisht të largohet nga territori i argjipeshkvisë së Shkupit, pra mundësisht, të dëbohet në Shqipëri.

Qysh më 1918, kryetari i Prizrenit kishte alarmuar në Beograd se L. Mjeda është duke punuar vetëm për Shqipërinë dhe kthimin e saj në këto troje. Për fat të keq, kishte edhe meshtarë në argjipeshkvinë e Shkupit, që bashkëpunonin me pushtetin e Serbisë, si Simon Picini që ishte nga Istra e Kroacisë (kishte shkruar letër qeversie në

358 shif Zutic, Kraljevina . fq. 155-156.

Beograd). Picini e quan Mjedën „*propagandues shqipar, i cili e urren Serbinë*“, poashtu thoshte se „*për të nuk është me rëndësi katolicizmi, por mbajtja e shpirtit shqiptar dhe se qëllimi i tij ishte krijimi i Shqipërisë së madhe*“³⁵⁹ dhe në qarqe të Beogradit shihet me sy të keq, mbasi Mjeda bashkëpunonte jo vetëm në rrethet kishtarë në Shqipëri, por edhe me besimtarë të thjeshtë. Me Pecini kishin ndodhur edhe disa skandale e eksese, gjatë kohës së Mjedës. Ai kishte bashkëpunuar ngushtë me qeverinë e Beogradit, kishte djegur fotografinë e Franz Josef-it në Prizren dhe dëshironte që Zoja e Këshillit të Mirë të hiqej nga kalendari kishar i kësaj argjipeshkvie. Picinici ishte në shërbim të Serbisë. Për këtë kishte njoftuar L. Mjeda edhe Vatikanin, me letrën e tij të 17 gushtit, 1921, konkretisht kardinalin Van Rossum.³⁶⁰ Mjeda ia kishte ndaluar Simon Picinicit që të kryente shërbesa fertare në argjipeshkvinë e Shkupit.

Picinici e kishte tradhtuar Mjedën dhe informatat lidhur me aktivitetet e Mjedës në Prizren, i dërgonte në Beograd dhe „*jugosllavenët*“ kishin informacione të mjaftueshme për aktivitetin e L. Mjedës. Nga kryetari i atëhershëm i Prizrenit, më 1921 (për shkak se Mjeda bënte „atak“ në popullin serb me letrat e veta që i dërgonte botës mbarë), lindi ideja në qarqet politike serbe, për kërkesë drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme: që ai të pensionohet e kështu, gradualisht, të krijohet mundësia për ta larguar nga ipeshkvia, jo vetëm dom Mikel Tarabulluzin, por edhe argjipeshkvin Mjeda.

Sipas literaturës që citojnë burime arkivore të Beogradit³⁶¹, Lazër Mjedës i kishte ardhur një letër në gjuhën italiane nga dom Mikel Tarabulluzi, datuar më 15 janar 1920, tek e cila bazohej arsyetim nga regjimi i kohës se këta të dy po vepronin kundër shtetit jugos-

³⁵⁹ Zutic, Vatikan i Albanci, fq. 101

³⁶⁰ Gjergj Gashi, Kosova II, fq. 165-66.

³⁶¹ Kemi pyetur në arkivin e Beogradit se a është mundur që ti kemi dokumentët që kanë të bëjnë me Mjedën ti kopjojmë, nuk na është lejuar. Disa shkenctar nga Kosova pretendojnë dhe theksojnë se i kanë ato dokumente, por dyshohet kjo gjë, përveç ato literaturë që kanë botuar dhe citohet, nuk kanë në dorë asgjë tjetër.

llav, dhe kjo vetëm për faktin se ata përpiqeshin të mos mbylleshin shkollat në gjuhën shqipe, që gjendeshin pranë famullive në Kosovë e Shkup. Kjo letër u bie në dorë pushtetarëve dhe dom Tarabulluzin e burgosin (përsëri), më 24 korrik të 1921, ku dënohet nga gjykata e Gjilanit me 8 muaj burg. Dom Tarabulluzin e kishin burgosur edhe më herët (1919), nën akuzën për veprime në kundërshtim me shtetin jugosllav. Dënimin me burg të dom Tarabulluzit, Gjykata e Apelit në Shkup, më 4 mars 1922, ia zgjati burgimin për 2 vite, vendim ky që vërtetohet edhe një gjykatë e Beogradit, si instanca e fundit. Qeveria serbe e dinte se, po të provonte në të njëjtën mënyrë edhe me Lazër Mjedën, do të kishte probleme me karakter ndërkombëtar. Si alternativë veprimi kundër argjipeshkvit Mjeda, ishte ideja e kryetarit të atëhershëm të Prizrenit, më 1921, i cili kërkon nga Ministria e Punëve të Jashtme që ai të pensionohet nga detyra e kështu gradualisht të mund të largohet nga Ipeshkvia e Shkupit, dhe kjo arsyetohej me argumentin se *“Mjeda bënte atak në popullin serb me letrat e veta”*. Më 16 janar 1919, shkruan L. Mjeda për dom Mikel Tarabulluzin dhe burgosjen e tij kështu: “Fati i keq i dom Tarabulluzit shumë rëndë më ka pikëlluar. Edhe pse kam bërë çmos, duket se nuk është e mundshme ta liroj. Sa kam ndëgjuar për këtë ngjarje, fill i kam paraqitur ankesat e mia pranë Divizionit Kosovar dhe i kam siguruar që meshtari është pa faj, por nuk shihet kurrfarë suksesi. I kam shkruar edhe në Beograd Ministrit për çështje fetare, duke kërkuar drejtësinë, por me gjendjen e rrugëve sot, kur do të mërrijnë ajo atje. Çdo ditë pyes për të edhe më jepen premtime të mira, por ai gjendet ende në burg. Kisha shkuar personalisth në Prishtinë për ta mbrojtur... por më erdhi lajmi që ka vdekë imz. Toma Glasnovi . Ah, viti i ri për mua është me shumë dhembje! Kështu don Zoti, u bëftë vullnesa e tij”.³⁶² Siç duket, është ndërruar në përkthim të kësaj letre emri Toma me Nikola këtu Toma me Nikola Glasnovi , sepse Toma Glasnovi³⁶³

³⁶² Mark Sopi Marks Sopi, Shembulli i baritu të mirë dhe atdhedashës - Arritja e Lazër Mjedës në Prizren, in Drita Nr.Viti XIII, Nr. 3-4, 1982. fq. 8

³⁶³ Gjini, Ipeshkvia Shkup-Prizren, fq, 203.

nuk ka vdekë me 1919 por Nikola Glasnovi³⁶⁴ dhe se Toma Glasnovi pas largimit të Mjedës nga Shkupi me 1921 merr detyrën e administratorit apostolik, deri në emërimin e ipeshkvit të Shkupit Janez Gnidovec me 1924.

Më 17 mars 1919, nga Shkupi L. Mjeda i shkruan Romës, konkretisht kardinal Domenico Serafini, letrën lidhur më gjendjen e rëndë të Kishës në argjipeshkvinë e Shkupit, ku edhe shpjegon gjendjen e mjerë të dom Mikel Tarabulluzit kështu:

“Në letrën time, të 11 janarit, informova Lart. Tuaj të Nd. se kryetari i komunës së Vitisë (krahinë e Gjilanit), në 20 dhjetor, kishte zënë rob famullitarin katolik të Cënnagorës, dom Mikel Mesues Trabulluzin, sepse kishte shkuar në një vend tek një i sëmurë, pa kërkuar leje tek autoritetet lokale, duke ditur se atij si famullitar i vjetër i vlente çdo lloj pashaporte brenda kufijve të famullisë së tij.

Nga Vitia e kishin dërguar në Gjilan me duart prapa, të lidhura; e kishin goditur me qyta pushke, e kishin lenë të ecte në këmbë për shumë orë midis baltës e shiut, megjithëse kishte me vete kalin e tij. Aty ishte futur në burg për rreth pesë orë dhe ishte denuar me njëzet ditë heqje lirie, që pastaj u kthyen në dyqind e dy dinare gjobë, që vetë ai duhet të çonte në Gjilan, në 27 dhjetor. Kur kish-te shkuar atje ditën e caktuar për të dorëzuar shumën e përmendur, i ishte thënë që për momentin ajo monedhë nuk pranohej, prisnin udhëzime nga Prishtina e ndërkohë i ishin bërë qortime të mëdha e kërcëmime të ashpra, sepse nxiste arbërit në revoltë. Çdo shfajsim i tij nuk vlente, siç doli pa vlerë ndërhyrja ime pranë Prefektit të Prishtinës, prej nga varet Gjilani. Më një janar, me gjithë solennitetin e ditës, e detyruan të nisej për Gjilan, duke mos e lejuar të celebronte meshën e shenjtë për popullin, siç e kishte për detyrë. Sapo arriti në këtë qytet, e mbyllen menjëherë në burgun e përgjithshëm në shoqërinë e keqbërësve dhe që rreptësisht e nda-

³⁶⁴ Janjevo, fq. 188

luan për çdo katolik që mund të vizitonte dhe t'i jepte ndonjë ndihmë, si për të ngrënë apo për të veshur, kështu që i njeri duket të vuante nga uria, i flohti, shqetësimi i instikteve, veç shoqërisë së keqe me njerëz vulgarë e të paedukuar. Pas pesëmbëdhjetë ditësh që kishte ardhur, prefekti i ri u mor me këtë çështje dhe e futën në një birucë me dy zotërinj arbërorët muhamedanë. Ditën e njëzetë, kur mbaronte denimi, u thirr nga prefekti e u mor në pyetje, i vënë përballë dy dëshmitarëve që thonin se e kishin dëgjuar t'u thoshte arbërorëve muhamedanë se qeveria serbe s'e kishte të gjatë e do të vinte ajo e Arbërisë. Njëri nga dëshmitarët ishte një i poshtër, që në kohën e turqve ishte bërë muhamedan, pastaj me serbët serb, me bullgarët bullgar, e tani është kthyer serb; e megjithëse njëri i shkatërruar në çdo pikëpanjje, ishte bërë xhandar në bashki dhe nga autoritetet serbe mbahej si njeri i besuar. I pyetur kur e kishte dëgjuar këtë, ai i përgjigj para dhjetë ditësh!

Falsiteti dukej qartë para të gjithëve, pastaj kishte njëzet ditë që prifti kalbej në burg.

Megjithëkëtë, shpifësi nuk pati asnjë qortim, ndërsa famullitari, pas disa këshillimesh, iu lejua të kthehej në qelen e tij.

Kjo është e vërteta e faktit e nuk vlen të thuhet se një incident i tillë ka bërë përshtypjen më të keqe tek katolikët e mrekullinë më të madhe tek muhamedanët, të cilët nuk kanë parë kurrë prift ka-tolik të trajtuar në këtë mënyrë të padenjë.

Unë u ankova tek z. prefekt i Prishtinës për padrejtësinë ndaj priftit të pafajshëm dhe e pyeta nëse i ka dhënë një kënaqësi të denjë, por ai nuk u dha se e kuptoi.

Prandaj jam i detruar t'i drejtohem persëri Shkllq. Suaj të Nd. e t'i lutem me këmbëngulje të denjorë ta marrë në konsideratë këtë incident të pakëndshëm e të kërkojë që të ndreqet e keqja. Perveç kësaj, po deshi Sh. J. të urdhërojë që prifti të lihet i lirë pr të ush-

truar misionin e tij të shenjtë në të gjithë famullinë e tij, e cila përfaqon tri komuna, sepse autoritetet nuk kanë pranuar t'ia japin këtë leje; e ky është një dhunim i hapur i lirisë së kultit. Me këtë rast, më lejoni t'i raportoj L. S. të Nd. disa fakte, prej nga mund të nxirret mënyra e padenjë, përmes së cilës komandanti i komunës së Verbovcit, Milan Diqiq, e ai i Vitisë, një Rista, i trajtojnë katolikët e këtyre krahinave.

Së pari, asnjë katoliku të këtyre vendeve nuk i lejohet të shkojë në Shkup, as në Kumanovë, as në Ferizaj për të shitur e blerë, kështu që të njerët duhen të dergjen në varfëri.

Së dyti, u kanë marrë armët të gjitha rojeve e xhandarëve katolikë dhe i kanë nxjerrë jashtë çdo sherbimi.

Veç të tjerash, kryetari i komunës së Verbovcit, nën pretekstin e nxjerrjes së armëve fshehurazi e zbulimit të sekreteve, që nuk i duhen, i goditi e i përgjaku më kryesorët e katolikëve. Pastaj, për famullitarin nuk tregoi asnjë kujdes e, për fjalë të kota, e detyruan të bëjë disa orë udhëtim për të shkuar tek ai e për të dëgjuar atë që ai do.

Po ai, nxori me dhunë nga katolikët shuma të hollash, pa asnjë arsye të ndershme e kercënoi me jetën cilindo që guxonte të fliste.

Nuk u sollen më mirë ato të Vitisë.

Nje farë Lenci Nout, një katolik shumë i ndershëm nga Binça, pasi e rrahën mirë, i morën dhjetë lira turke ari e një herë tjetër njëmijë leva bullgare.

Ndrekë Gjergjit po nga Binça, i morën njëzet lira turke ari e katër—qind leva bullgare.

Koli Pjetrit, po nga ia vend, trembëdhjetë lira turke e pesëqind leva.

Shanit të Markut, katërqind leva.

Nocit të Sebës e Tomi Zefit njëqind leva secilit.

Gruas së Gegë Zefit, po nga Binça, i morën dymijë e shtatëqind leva bullgare, sepse i shoqi, me lejen e autoriteteve të Shkupit, shkoi në Selanik, për te vizituar dy motrat e tij që janë murgesha të Shën Vinkut nga Poli, në Institutin francez të atij qyteti.

Paratë u zhvatën nga një Gapi i Dodes, katolik, i cili doli vullnetar për këto veprime të këtij kryetari komune. Ka edhe të tjerë, por po i kaloj për të mos të lodhur Lrt. T. Të Nd.

Megjithatë, nuk mund të kaloj në hështje dëmin e konsiderueshëm që serbët e komunës së Verbovcit na kanë krijuar e vazhdojnë të na krijojnë, duke prerë një numër të madh lisash të dy pyjeve që i përkasin, njëri Menses Kryepeshkopale e tjetri, kishës famullitare. E megjithëse kryetari është lutur më shume se një herë nga famullitari dhe rojet e pyjeve t'i pengonin këto plaçkitje e jo vetëm s'i kanë dhënë kur kanë pasur nevojë, po i kanë shtyrë këta njerëz të vepronjë keq. Lidhur me këtë problem, i lutemi Shkllq. S. t Nd. të urdhërojë që të dërgohet në vend një komision i nderuar, i cili të shqyrtojë dëminin e të përcaktojë shumën e dëmtimit.

Më vjen keq të them se autoritetet e Gjilanit dhe Prishtinës i lënë të sillen si perëndi këta prepotentë dhe nuk kujdesën për vuajtjet e popullsisë. Përkundrazi, për çdo ankesë që bëhet, rëndohen mundimet. Prandaj gjendja e kësaj popullate është e mjeruar dhe padurueshme.³⁶⁵

Poashtu, në një letër tjetër, të 17 gushtit 1921, Mjeda i shkruan Romës, konkretisht kardinal Van Rossum për Dom Mikel Tarabulluzin dhe gënjeshtat e qeversisë serbe lidhur letrën e Tarabulluzit, në këtë mënyrë:

³⁶⁵ Gjergj Gashi, Kosova II, fq. 131-134 dhe Albert Ramaj, burime dhe dëshmi, fq. 209-212

Në datën 10 të këtij muaji, i nderuari dom Mikel Turabulluzi, famullitar i Letnicës, krahinë e Gjilanit, prefekturës së Prishtinës, u burgos nga autoritetet qeveritare të Gjilanit. Në datën 15 të po atij muaji, zëvendësprefekti i dërgonte një telegram prefektit të Prishtinës, ku e ngarkonte t'i komunikonte Kryepeshkopit se famullitari i Letnicës, dom Nikel Tarabulluzi ishte dënuar për fajin kundër paragrafit II të Kodit Penal Nr. 90, e në vend të tij të dërgonte një prift tjetër. Të nesërmen pastaj, përfaqësuesi im më dha një letër të Ministrisë të Kultit, ku më thoshte se ishte i informuar nga autoritetet e vendit, që famullitari i Letnicës, dom Mikel Tarabulluzi sillej në atë menyrë që interesat e qeverisë në ato krahina kërkonin heqjen e tij nga ajo famulli. Ngulmova pra, ta zbatoja me shpejtësi këtë urdhër dhe ta bëja përgjegjës për vendimin e marrë!

Tani ia vlen të thuhet se Tarabulluzi do të ketë të metat e tij, por s'mund të preket në politikë, sepse nuk kujdeset, nuk ka asnjë aftësi për një shërbim të tillë.

Është për t'u ditur se kjo është e treta herë që burgoset i njeri. Herën e parë, siç ka njoftuar në një rast tjetër Eminencës Tuaj të Nd., që në janar 1919, u mbajt për rreth 25 ditë nën pranimë e keqbërësve. Faji që iu vu se kishte shkuar për t'i shpërndarë sakramentet një të sëmuri të famullisë, pa lejen me shkrim nga kryetari i komunës. Famullia e tij përfshin tri komuna. Dëshën t'i vinin edhe faj politik, por dëshmitarët nuk ditën ta luanin mirë pjesën e tyre dhe u duk qartë falsifiketi, prandaj nuk u denua. (Por dëshmitarët e rrëmë nuk patën dënimin nga qeveria).

Të dytën herë u burgos këtë vit, në të gdhirë të Shtunës së Rrëshajve. Motivi ishte se çështja e 1919 nuk kishte qenë vendosur akoma, nga nuk e di se cila gjykatë e se duhej ta priste sentencën në burg; e pastaj sepse pa lejen e qeverisë kishte ndertuar një kishë në Binçë, për qellime politike.

(Kisha u ndertua gjatë pushtimit bullgar).

Qëndroi në burg tri ditët e Rrëshajve, pastaj u lirua për pathemelësi krimi.

Tani përsëri e kanë burgosur nën akuzën: shkatërrues të popullit dhe kundëshhtar të qeverisë.

Jam i bindur, i Lartmadhërishmi Princ, se edhe këtë herë dom Mikel Tarabulluzi i gJORË është i pafajshëm e se z. Minister i Kultit është informuar keq, pasi arsyet e pëmdjekjeve kundër këtij prifti janë krejt tjetër nga sa thuhet.

Një arsye, por jo kryesorja, ishte kjo se, duke qenë Tarabulluzi i nderuar famullitar i një vendi, ku ka një Shenjtërore të Shumë të Lumturës Virgjër Mari, Shenjtërorja e Zonjës së Madhe në Cernagore, siç duhet (që serbët e quajnë manastir, e mendojnë se është si manastiri i tyre për të ardhur në qejf), është i ekspozuar ndaj vizitave të nëpunësve qeveritarë, të cilët në dukje shkojnë për gjoja shërbim, por në fakt vetëm për të ngrënë e pirë prej atyre që vijnë. Por kjo nuk i kënaq gjithnjë, sepse mbase s'arrijnë të dehen. Për këtë janë ankuar shpesh e kanë kërcënuar se do të hakmerren, aq sa e ndjeva për detyrë ta këshilloja dom M. Tarabulluzin të ishte më bujar e t'i mirëpriste njerëzit, e t'i shmangte mundimet e njerëzve e të mos e vriste ndërgjegja!

Një arsye tjetër, e unë mendoj të jetë më e forta e që flitet nga goja e popullit edhe klerit, janë intrigat e dom Tade Ivanoviqit, të cilit e njeht tashmë ky konregacion.

Ky, që në fillim të mosbindjes që i bëri Kryepeshkopit, ka kërkuar të shkojë në famullinë e caktuar, me kusht që ta heqë të nderuarin dom Mikel Tarabulluzin e Letnicës; e kjo për kapriçot e tij. Natyrisht unë s'mund t'ia jepja këtë kënaqësi, edhe pse nuk kisha person tjetër për të dërguar në atë famulli. Prandaj u dha pas manovrave të tjera dhe kështu ka marrë të ngrinte kundër popullit dhe qeverinë. Me popullin që më i lehtë pajtimi, po me qeverinë jo kaq me fat.

*Ivanoviq është tepër në zemër të nëpunësve, e madje thuhet se paguhet nga qeveria si spiun. Është e qartë pse insinuatat e tij gjëjnë terren të mirë.*³⁶⁶

Paralel me përndjekjet që i bënin dom Tarabulluzit dhe argjipeshk-vit Mjeda, në korrik të vitit 1920, policia serbe burgos 3 meshtarë shqiptarë – dom Shjtefën Krasniqin (famullitarin e Gjakovës, Atë Klement Mirajn (famullitar i Pejës) dhe Atë Serafin Koda (famullitar në Rajë-Mertur), ndërsa në vjeshtën e vitit 1921, policia burgos tashmë për të tretën herë dom Mikel Tarabulluzin (famullitar në Letnicë), nën akuzën e dyshimit se ishin të involvuar në organizimin e një kryengritjeje shqiptare. Këta rrinin në burg pa u gjykuar fare, kurse argjipeshkvi Mjeda kishte kërkuar pa reshtur fillimin gjykimi i tyre. Me muaj të tërë kaluan këta 4 meshtarë të pafajshëm nëpër burgje.³⁶⁷ Për këtë rast propaganda e atëhershme serbe kishte informuar opinionin publik nëpërmjet gazetës *Politika*, të datës 04.06.1921. Në shkrimin me titull „*Medju nama – nozem u ledja*“ (mes nesh – me thikë në shpinë), shihet shumë qartë se kleri katolik, për politikën serbe, ishte ai i cili rrezikonte Serbinë dhe organizonte shqiptarët për kryengritje. Pas gjykimit të dom Tarabulluzit qeveria kërkonte që t'i ndërrohet vendi, nga famullia e Letnicës dhe Stubëll, në një vend tjetër, meqë qeveria serbe tashmë kishte vendosur që t'i mbyllte të gjitha shkollat shqipe që gjendeshin pranë famullive në argjipeshkvinë e Shkupit, ndërkohë si pishtarët kryesor të arsimit shqip ishin meshtarët, që kishin vepruar në shkolla në Shkup, Prizreni, Janjevë, Pejë, Stubëll, Letnicë etj. Është shumë interesant se dom Mikel Tarabulluzi kishte planifikuar të hapte shkollë në gjuhën shqipe, më 1918, në Zhegër afër Gjilanit, ndërsa ky pretendim ishte gjykuar si provokim i madh për qarqet politike serbe.

³⁶⁶ Botuar nga GASHI Gjergj: Kosova. Altari i Arbërisë 1910-1941, Imzot Lazer Mjeda, Tiranë fq. 131-134 dhe 161-163.

³⁶⁷ Colak-Mazuran, Janjevo, fq. 189, që shenohen dokumente arkivore të Vatikanit - Arhivin e Propagande Fide, Affari ecclesiastici straordinari, Austria-Ungheria, fasc. 448, post. 1052-1056, nr. 628, fol 56-59, dhe poashtu fasc. 600. Fol. Pos. 1475-1476, fol. 28.

Përndjekjet që i bëhen klerikëve dhe besimtarëve e shtyn Mjedën shtroj pyeten se, a do të mbes më ndonjë katolik në këto troje, nëse vazhdon kjo politikë kundër katolikëve shqiptarë në argjipeshkvinë e tij. Qeveria serbe kërkonte armë nga popullata katolike që fare nuk posedonin, i maltretonte duke përdorë mënyrat më brutale kundër popullatës katolike të pafajshme nëpër famullit e ndryshme të Kosovës. Më 1921 në famulinë e Zllakuqanit u maltretohen besimtarët shqiptarë, deri sa nuk iu thyejnë edhe eshtrat e tyre, në të njëjtin vit në rrethin e Gjakovës janë djegur shumë fshatra dhe vriten shumë besimtarë katolik. Bëhej një luftë që kishte edhe pasoja psikologjike e shtimit të frikës në popullatë me vrasjen e Atë Luiq Paliqit (1913) dhe burgosjen e 4 meshtarëve (1920/21).

S'ka fare dyshim se qëllimi kryesor i politikës dhe i diplomacisë serbe ishte përgatitja që Lazër Mjeda, sa më parë të largohej prej Kosove, por edhe klerikët katolikë që komunikojnin me Vatikanin dhe shtetet tjera perëndimore, përkatësisht të të gjithë atyre që kishin ngritur zërin kundër përndjekjeve dhe maltretimeve serbe. Këtë e dëshmojnë edhe shumë dokumente.³⁶⁸

Ëdhtë e ditur se qeveria serbe pretendonte që selinë ipeshkvore ta shpërngulte në Shkup e të mos rrinte në Prizren, sepse kështu edhe mund t'u ikte kontakteve më të shpeshta me njerëz. Por dihet se largimi apo më mirë të themi dëbimi i Mjedës nga argjipeshkvia e Shkupit, për qeverinë serbe, ishte më i përshtatshmi. Që të arrihej kjo ishte veprim i vështirë për qeverinë serbe, sepse ajo ishte kompetence për të cilën duhej të vendoste Vatikani. Si hap i rëndësishëm që ndërmerret nga Milivoj Jovanovic, Ministër për çështje fetare, vjen urdhri i adresuar policisë vendore që ta marrë Mjedën fshehurazi në arrestim, për të shikuar më vonë se si vepronet më atë. Kështu qarqet vendore, me rekomandim të Beogradit, e detyruan që Lazër Mjeda, fshehurazi ta lëshojë argjipeshkvinë e të

³⁶⁸ Shih më shumë në Arhivin e Propagande Fide, Affari ecclesiastici straordinari, Austria-Ungheria, fasc. 600. Fol. Pos. 1475-1476, fol. 159.

kthehet për në Shqipëri. Kështu Mjedës nuk i mbetet tjetër rrugë— dalje. Në vitin 1921 largohet “*në heshtje*” prej Prizrenit, ku e kishte selinë ipeshkvore të Shkupit. Me 14 shkurt arrin në argjipeshkvinë metropolitane të Shkodrës³⁶⁹, një hap ky i marrë pa dëshirën e vet. Pra, si arsyetim kryesor i strukturave serbe, ishte letra e dom Mikel Tarabulluzit, e 15 janart 1920, që u bie në dorë qarqeve të sigurimit shtetëror, ku vlerësohet se ai duhej ose të gjykohej, apo të lëshonte argjipeshkvinë.³⁷⁰ Ky ishte arsyetimi, por jo shkaku. Vlerësimet e qarqeve policore e politike serbe kishin gjykuar se kleri katolik po përgatiste një lloj revolucioni kundër ushtirës serbe në Kosovë.

Është e ditur letra përshëndetëse për meshtarët dhe për popullin e argjipeshkvisë së vet që kishte lënë Lazër Mjeda, më 27 nëntor 1921, që do ta sjellim në tërësi këtu më poshtë. Para kësaj letre, dëshiroj të cek edhe diçka tjetër. Me ardhjen e argjipeshkvit Mjeda në Prizren, kishte sjellë me vete shërbëtorën e vet nga Shkodra, që quhej Leze Suma, lindur në Shkodër më 1882, dhe vdekë në Velezhë (shërbei në këtë famulli deri në vdekje), afër Prizrenit, më 1968. Ajo thotë: “*Para Kërshëndellave zotni argjipeshkvit i kishte ardhur një shkresë nga qeveria. Ai dukej shumë i merzitur dhe kishte kerkuar që sa ma shpejt t’ia pergaditnim disa gjera të tij, që janë më të nevojshme, sepse duhej të shkonte urgjentisht në Shkodër. Se a do të kthehej, – kishte thanë se nuk e dinte, por, nëse nuk do të kthehej, duhej që gjërat tjera të tij, t’ia dërgonim në Shkodër Të nesërmen u largua nga Prizreni. Ai ma nuk u kthye dhe ne ia dërguam në Shkodër të gjitha gjërat e tija personale*”; kurse natën, para se të largohej, shkruan letrën përshëndetëse që po e sjellim këtu e që ishte botuar në revistën Drita³⁷¹:

³⁶⁹ Krah. Filip Fishta, njoftime historike mbi argjipeshkvijt e Shkupit, Hylli i dritës, vj. X. nr. 11, 1934, fq. 552.

³⁷⁰ Për këtë ka akte të mjaftueshme në arkivin jugoslav në Beograd, në dosjen „Ministarstvo inostranih poslova – politicki arhiv (1922-1923) dhe Ministarstvo pravde – versko odeljenje sidomos 26-28.

³⁷¹ Botuar në “DRITA” Viti XI, 1(81), Jan. 1980, fq. 14-15.

“LETER BARITORE PER LAMTUMIRE ARKIDIEÇEZIT T'SHKUPIT

Meshtarve t'ndershem e Popullit te dashtun t' Arkidieçezit t'Shkupit, shendet e bekim prej Zotit.

Dymdhet vjet janë mushë n'ket muej t'nandorit qi Na per me çue n'vend fjalën e madhnueshme t'Shejtit Atë Papë duelme Shkodret e erdhme nder jue. Nuk kje punë e letë për Ne n'at koh me lanë vendin e t'lenit e Seliën e parë t'Shqypniës per me ardhë nder kto vise, ku Feja shejte gjindej nder ngushtime e travajë. Por besimi i ngulët qi prej Zotit drejtohen t'tana punët rozollinut, e qi shka t'na ndollin per t'miren t'onë e premton i Lumi, ky besim Na forcoj zemren me qitë poshtë t'tana arsyenat e shekullit e me ja shtruve kraht pa fâr pritjet asajë barrë qi Dora e Zotit na ngarkote. E kjo e shtruveme e unjishme vullneses s'Tenzot kje cok njajo 'qi Na xuer prej Zotit hirin e fuqishem me muejt per pak koh e me një mëndyrë fort t'letë me i qetue zemrat e popullit, e me hjekë ç'farë do ndryshkut ndermjet t'Ti e t'Meshtatareve. E jo veç kaq, por edhe me gjith kohna t'vshtira qi Na u desht me kalue Na ndimoj Zoti me perparue e me ndertesa t'reja si me permirsime t'vjetrave. Lavdi i kofjte t'Lumit! Por shka e kuer kjeme tuj ende giatë e ma giatë per me i dhanë ma shkelxim shejtes Fe, e me e xe popullin ma fort kah shpirti, pa pritë pa kujtue Na u kputne t'tana fjet. Ajo fjal e madh-nueshme qi prej Shkodret Na prunë ktu, Na urdhnoij persri me kthye m'at gjytet. E asht e ditun, se t'betuem me nigiue, Na do t'a kryjmë pa kundershtim urdhnit t'Parit. Por me gjith kte nuk mujtme me e ndalë qi zemra e jenë mos t'ndalë dhimtë, e dhimtë t'fortë. E jo per vedi, pse sikurse e dini, nuk jena tuj shkue m'nji vend ma t'poshter as nuk jena tuj dalë per ndonji punë t'pamire; veç dhimten e ndiëme per jue, qi mbas sa vjetve po Na duhet me ju lanë. Jena ken msue me kja me jue e me jue me gzue; e dashtnija qi kishim me shoqishoj Na nepte fuqi me i ba ballë sa t'vshtirave qi na rane nder kto vjet. Patme edhe kujtue se ky do te ishte caku ma i mbrami i joni e se ktu do t'a sosshë jetën; por Zotyn premtoj

ndryshej, e kjoftë ba vullndesa e t'Lumit. E mbasi ket punë Ne as nuk e lypme, as nuk e dishrueme kurr, duhet me thane se prej Zotit ka rriedhë, e prandej do t'jetë per t'mirë t'dyë palna. Ky mendim do t'ma nep zemer me ju shtruve per ankim vullndeses s 'Zotit.

E tesh, ndoshta per t'mbramen herë, po m'hjek zemra me ja u tha – nun ndojë fjalë. O ju Meshtarë qi ju ka vue Zoti me i prie popullit t'Krishten kah rruga e shëlbimit, peshonie detyren t'uaj, e kujdesni me e krye. Dunie popullin, si Krishti don shpirtnat t'onë, e kjo dashtni ka me ju msue se si me i ardhë rreth popullit per me e shëlbue. E ti popull i kti Arkidieçezit, nderoje e nigioje Meshtariën t'ande, ne daç me pasë bekimin e Zotit. Mos u dajë kurr prej ti, n'daç mos me dalë jashta rruges t'shëlbimit. Dunie edhe shoqishojnë jo veç me fjalë, por edhe me vepra, qi t'shoftë gjithkush se jeni besimtarët e vertetë t'Lumit J. Krisht. I lum Arkidieçezi ne ecshi mbas ktyne fjalve. – Ne e mbram tuj ju thanë lamtumirë po ju lypim t'falun per gjithshka qi dashtë pa dashtë kena muejt me folë e me ba kundra kuej; por ç'far do sendet qi ka muejt kuej me i ra n'syë e me i dhane shkandull; tuj ju sigurue se kundra kerkuj s'kena pasë qellim t'keq por n'pasim reshqitë prej pa dies. Edhe Na juve ç'far do idh – nin o fjalet po jau falim unjië, si miqve si anmiqve e kurrfarë ndryshkut kundra kuej s'ka me metë ne zemer t'Onë. T'gjith sa jeni kjoshi lirë e bekue, e Zoti i shprazhtë huret e veta permbi jue.

Lutnie Zotin per Ne si Na jena lutë e kena per t'a lutë per jue, e sidomos lutnie Zotin pa da qi t'a çojnë nji Bari t'mirë, si e lypë ne – voja e fësë shejte, dobija e shpirtnave t'uej, e lulzimi i atdheut t'onë.

Bekimi i t' Naltit kjoftë gjithmonë me jue, e ju forcoftë me

mbrie n'lumni t'pasosme.

Ne Perzerend me 27 nanduer 1921

Lazri, Argjipeshvi”.

Nga përmbajtja e saj ne mund të nxjerrim një vlerësim tjetër, përkitazi, për arsyen e largimit të tij nga argjipeshkvia e Shkupit. Largimi i tij, del nga përmbajtja e letrës, kishte qenë i përcjellë me një dhimbje tejet të madhe, dhe nga përmbajtja shihet se sa i dhemb shpirti bariut të popullit për grigjën e vet; ai e dinte saktësisht se ishte detyruar, në gjendje nevojë të madhe, ta linte grigjën e vet, dhe sa dashuri të madhe kishte ai ndaj popullit të argjipeshkvisë së Shkupit. Ai shkruan po ashtu se nuk ishte dëshira e tij të linte argjipeshkvinë e Shkupit. Megjithëkëtë, ai kishte mbetur me shpresë të madhe në meshtarët, të cilët i porositi ta duan popullin e vet.

Është shumë interesant se, shpeshherë, është thënë që Mjeda e ka lëshuar Ipeshkvinë e Shkupit me dëshirë të vet. Se ky është një pohim dhe vlerësim i pasaktë, do të shihet më poshtë. Detyrimi që ta lëshojë Shkupin ishte e planifikuar e kurditur mirë, sa “*ikja*” e tij në heshtje kishte qenë alternativa e vetme dhe më e arsyeshmja. Do të krijohet një situatë e pa përballueshme kundruall zullumit të kurditur nga pushteti i atëhershëm. Për gjendjen në fjalë, edhe Vatikani ishte i informuar në detaje, për çka atij i jepet detyra e re në argjipeshkvinë metropolitane të Shkodrës. Selia Shenjte ishte në dijeni për rastin e L. Mjedës, se qeveria serbe nuk e donte aspak dhe, siç duket, Vatikani ishte i obliguar “*ta largonte*” L. Mjedën prej argjipeshkvisë së Shkupit, që t’u ikte konflikteve diplomatike në rajon. Atë e emërojnë argjipeshkëv metropolit të Shkodrës, me Dekretin e datës 05.11.1921, kurse zyrtarisht, më 3.12.1921, lajmërohet edhe qeveria në Beograd se është e patinut me largimin e Mjedës.

Para se të kalonte për në Shkodër, Mjeda kishte emëruar administrator të ipeshkvisë dom Tomë Glasnivi (famullitar në Ferizaj) dhe dom Ferdinand Hirdin (famullitar në Nish), për ta udhëhequr argjipeshkvinë e Shkupit – siç duket gjatë kësaj kohe, pra, deri në emërimin e ipeshkvit Gnidovec, argjipeshkvia e Shkupit duhet të jetë shndërruar një herë në administraturë apostolike, për t’u ngritur përsëri në ipeshkvi. L. Mjeda kishte pasur shumë besim në dom

Tomë Glasnovi –Shala. Kardinal Gaspari kishte lajmëruar qeverinë serbe, me 02..04.1922, se dom Toma dhe Ferdinandi do të administrojnë ipeshkvinë deri në emërimin e ipeshkvit të ri, pra të Janez Gnidovec nga Sllovenia, që do të jetë ipeshkëv i parë i Shkupit, pra pasi që i merret titulli argjipeshkvi.

Përpos kesaj letre larntumirëse, arqipeshkvi Mjedja u kujdesua edhe për zëvendësin e vet të përkohshëm dhe si delegat e emëroi dom Toma Glasnovi . Me këtë rast ai u shkruan kështu meshtarëve: “... *Mbasi Zotyn neper gojë t'Shejtit Atë Papë Na urdhnoj me i lanë kto vende, Na për mos me metë Arkidioçezi pa prisë, e me prandim t'Selisë Shejte, kena sjellë fort t'ndertin Zotni D. Tomë Glasnoviçin për me ken sundues i Arkidioçezit, deri qi Rroma t'na ndreqin punen ndryshej ...*”³⁷²

Ipeshkvi i ri i Shkupit Janez Gnidovec prej 1924

Me kalimin e Lazër Mjedën në Shkodër, për shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë, Serbisë e Malit të Zi do të jetë një humbje e madhe. Me largimin e Mjedës “Jugosllavia” nuk do të pranojë më shtetas të huaj në krye të kësaj detyre. Me emërimin e Janez Gnodovec nga Sllovenia, më 29.10.1924, ipeshkvia e Shkupit tashmë bëhet ipeshkvi sufragane e argjipeshkvisë së Beogradit. Selia ipeshkvore detyrohet të bartet më 1934 nga nga Prizreni në Shkup. Me emërimin e ipeshkvit Gnodovec fillon krejtësisht një periudhë e re, sidomos për besimtarët shqiptarë në territorin e Jugosllavisë. Konkordati i vitit 1914 ishte ratifikuar dhe Serbisë i konvenonte të vepronte sipas këtij dokumenti, deri në bisedimet për konkordatin e ri të vitit 1935. Në fakt, sipas konkordatit të vitit 1914, për çdo ndryshim në ipeshkvinë e Shkupit, duhej miratimi i qeverisë serbe. Kështu për shembull, për formimin e famullisë së Velezhës nga ana e administraturës apostolike të Shkupit, më 10.10.1922, ku si famullitar ishte vendosur dom Luigj Gashi, ishte dashur lejimi dhe

³⁷² Shif Drita, 3/1980., fq. 8

miratimi nga ana e Ministrisë për çështje fetare në Beograd. Më 01.01.1923 Ministria për çështje fetare e miratoi kërkesën. Edhe ndërrimi i famullitarëve nuk parashihej pa u informuar ministria e lartpërmendur.³⁷³ Mbështetur në autorët serbë, shihet shumë qartë se problemi i famullitarëve nuk ishte aq i madh, nëse ata nuk ishin shqiptarë. Problem ishte nëse ishte fjala për shqiptarë.

Përfundim

Kemi bërë një lloj pasqyre të gjendjes së Argjipeshkvisë e më vonë Ipeshkvisë së Shkupit, sidomos në kohën e Lazër Mjedës, i cili kontribuoi shumë për popullin shqiptar, jo vetëm në aspektin pastoral, por edhe atë politiko-diplomatik, në kohën kur ai ishte argjipeshkëv, kishin ndryshuar shumë pushtete, prej atij osman, pastaj serb e jugosllav, po ashtu edhe ngjarjet të rëndësishme historike sikur luftërat ballkanike dhe ajo e parë botërore e shumë gjëra të tjera, dhe kur shikojmë, Mjeda nuk ishte shumë argjipeshkëv në Argjipeshkvinë e Shkupit, vetëm 12 vite, por gjatë këtyre vitesh, fati i popullit shqiptar ishte në mëshirën e pamëshirshme, kështu që L. Mjeda ishte ai që më të vërtetë mbrojti më kujdes dhe maturi të madhe të drejtat e popullit shqiptar. Pas L. Mjedës vjen J. F. Gnidovec, ai ishte njëri i përshtirshëm, situata në të cilën veproi Gnidovec, ishte ndryshe nga ajo e Lazër Mjedës, Jeta dhe vepra e ipeshkvit Gnidovec sa ishte ipeshkëv në Shkup, nuk është hulumtuar ende si duhet, kështu që kjo mbetën në të ardhëm të bëhet. Kohëve të fundit, kam hasur në disa dokumente të rëndësishme që gjenden në Zagreb (tek Jezuitët) për ipeshkvinë e Shkupit, pikërisht në kohën kur ishte Gnidovec ipeshkëv në Shkup e që këto dokumente duhet përpunuar e publikuar, për t'u shëndritur edhe më mirë kjo periudhë.

³⁷³ Shif edhe Nikola Zutić, kraljevina jugoslavija, fq. 163-164.

*METIN IZETI**Universiteti Shtetëror i Tetovës*

TEQETË E SHKUPIT MIDIS DY LUFTËRAVE BOTËRORE DHE NDIKIMI I TYRE NË NGRITJEN INTELEKTUALE DHE FETARE TË POPULLSISË SHQIPTARE

Islami si një lëvizje e gjerë teologjike, ideore, qytetëruese, kulturore dhe si mënyrë e jetës, ka pasur nevojë t'u përgjigjet një numri të konsiderueshëm të pyetjeve dhe të ndërtojë institucione dhe organizma të cilët në mënyrë pragmatike do t'i zbërthejnë nevojat e individit dhe të shoqërisë. Një pjesë e institucioneve të nevojshme për mënyrën e jetës dhe botëkuptimin islamik janë të themeluara në kohën e Pejgamberit a.s., pjesa tjetër në periudhën e katër halifeve të drejtë, ndërsa pjesa tjetër është sendërtuar në periudhat e mëvonshme. Klasifikimi dhe kodifikimi i disiplinave dhe shkencave islame, si Tefsiri, Kelami, Historia Islame, Kiraeti, Tesavvufi, datojnë në fillim të shekullit II/VIII³⁷⁴, ndërsa diskutimi shkencor, filozofik dhe teologjik i tyre ka vazhduar në të gjitha periudhat e mëpasme, herë me intensitet më të madh e herë me energji më të zbehtë. Edhe Tesavvufi si shkencë ose disiplinë e posaçme e provi-niencës islame, është zhvilluar paralelisht me shkencat tjera dhe ka arritur deri në ditët e sotme.

Në parim Tesavvufi mëton ta paraqesë traditën e përgjithshme shpirtërore të shoqërisë muslimane, obligim i së cilës është mbrojtja e pasurisë së amshueshme metafizike të besimit islam nga çdo përdorim i pjesërishëm në përditshmërinë e jetës njerëzore.³⁷⁵

³⁷⁴ Në lidhje me kodifikimin e shkencave islame shih: Ahmed Emin, *Fexhru'l-Islam*, Kajro 1957, f. 35.

³⁷⁵ Hafizoviq, Resid, *po aty*. f. 6.

Mirëpo përkufizimi do të mbetet i gjymtë nëse nuk zbritet në sitë dhe karakterin e kësaj perspektive shpirtërore të përfaqësuar në përditshmërinë metageografike dhe metahistorike të njerëzve të emërtuar si sufi. Këta persona të shoqërisë muslimane, të cilët me një flakë të posaçme kanë dëshiruar të qëndrojnë me respekt pranë pastërtisë së brendshme të Ligjit Islam, pranë etikës universale islame dhe traditës shpëtimtare, Tesavvufin e kanë konsideruar si zhveshje të zemrës nga raportet njerëzore, braktisje të etikës natyraliste, largim nga cilësitë ekzoterike, tërheqje nga përpjekjet epshore dhe egoiste dhe kapje e fuqishme për cilësitë metafizike dhe disiplinat e urtisë primordiale – *sophia perennis*.³⁷⁶

Si në Anadulli, ashtu edhe në Ballkan, mënyra osmane e jetesës me vete ka sjellë një sintezë të ndikimit reciprok të strukturave të ndryshme shoqërore dhe ndërtimit të një shoqërie me botëkuptim të qytetërimit kozmopolit, multikulturor dhe multidimensional. Trashëgimia kulturore e cila ekzistonte në viset ballkanike në masë të madhe është mbrojtur dhe ka vazhduar jetën e saj gjatë pesë shekujve të sundimit osman. Politika shtetërore e Perandorisë osmane ka qenë e orientuar në mbrojtjen e vlerave kulturore, fetare dhe etnike të të gjithë popujve ballkanik, si dhe të shqiptarëve.

Në periudhën osmane Tesavvufi përveç brenda popullatës së rëndomtë është përhapur edhe në mesin e administruesve dhe dije-tarëve vendorë. Trajtat e sjelljes sociale të vendosura me shtresat e ndryshme shoqërore nga ana e sufijve dhe uniteti i qëllimeve të sufijve, administruesve dhe dijetarëve, edhe më tepër i ka afruar këto shtresa të shoqërisë me njëra-tjetrën.

Teqetë në fillim janë ndërtuar në periferi të qyteteve dhe vendbanimeve, në vendet e zgjedhura nga vetë dervishët udhëtues, ndërsa më vonë, me ndihmën e posaçme të Portës së Lartë, ato janë ndërtuar në vende të cilat kanë qenë më të përshtatshme për prak-

³⁷⁶ Madkur, A. Abdulmumin, *Nadharat Fi't-Tasavvufi'l-Islami*, Kajro 1993, f. 21.

tikimin e obligimeve të udhëzimit (*irshad*). Këto ndërtesa përveç përmasave sufike kanë ndihmuar edhe në largimin e pengesave të ndryshme për tregti me këto vise, në bartjen e mendimeve dhe ideve prej qendrës në periferi, kanë shërbyer si vendstrehime për të pashpresët etj. D.t.th. teqetë janë inkuadruar pothuajse në të gjitha shërbimet për përforcimin e jetës shoqërore dhe bartjen e idesë islame deri në viset më të largëta.

Si në pjesën tjetër të botës islame ashtu edhe në Ballkan teqetë kanë patur fushë të gjerë të veprimit. Ato gjatë periudhës osmane kanë shërbyer si shkolla, vende për njëkim, vende për rekreim, pus-himore, qendra për arte të bukura, ndërtesa letrare, faltore etj.³⁷⁷

Themelimi i qyteteve dhe teqetë...

Qytetet janë të vjetra sa edhe qytetërimet e lashta. Pikërisht për këtë edhe në viset ku kanë ekzistuar qytetërimet e vjetra ka gjurmë të qyteteve të tyre. Përveç qytetërimeve më të vjetra është realitet se në Ballkan një periudhë mjaft të gjatë ka qenë i vendosur edhe qytetërimi islam osman. Prezentimi i qytetërimit islam osman në tokën pjellore kulturore ballkanike, ku janë gërshtuar disa qytetë-rime të lashta, ka nxjerrë në pah qytete me veçori orientale-oksidentale.

Është e njohur se Shteti Osman, pas depërtimit ushtarak në viset ballkanike, ka motivuar transferimin e dervishëve, zejtarëve, treg-tarëve dhe së bashku me ta edhe të popullatës anadoliane në këto vise. Ardhja dhe pranimi i elementeve kulturore të tyre nga ana e pjesës dërmuese të popullatës vendase, do të ndikojë dukshëm në ndryshimin e strukturës fizike të qyteteve ekzistuese. Ndërsa në viset e pabanuara do të fillojnë të paraqiten qytete të reja me veçori orientale.

³⁷⁷ Për më gjerë shih: Kara, Mustafa, *Din Hayat Sanat Açısından Tekkeler ve Zaviyeler*, f. 178.

Qyteti dhe struktura e tij në periudhën osmane në viset tona shumë pak është hulumtuar. Mirëpo, ekziston një e vërtetë se një numër i madh i qyteteve të Bosnjës, Kosovës, Maqedonisë dhe pjesërisht të Shqipërisë ende i mbajnë simbolet dhe veçoritë e tipit të qytetit osman. Dervishët dhe teqetë e tyre kanë ndikuar dukshëm në ris-truktuimin e qyteteve ekzistuese dhe themelimin e qyteve të reja në viset ballkanike.³⁷⁸

Përreth teqeve dhe zavijeve të ndërtuara në viset pjellore dhe udhëkryqet tregtare të viseve ballkanike, janë vendosur familje dhe fise të ndryshme dhe në këtë mënyrë janë ndërtuar qytete të reja. Qendrat sufike duke i kushtuar rëndësi të posaçme sjelljes së mirë, komplimentit, dashurisë ndërnjerëzore, urtisë, artit kanë ndikuar që përreth teqeve të tyre të vendosen njerëz prej feve, etnikumeve dhe statuseve të ndryshme shoqërore.

Rolin e teqeve në themelimin, ngritjen dhe zhvillimin e qyteteve e shohim edhe në rastin e teqeve sinanije-halvetijje në Shkup dhe Prizren, në Teqenë Harabati Baba në Tetovë, në Teqenë Xhelvetijje në Berat, në aktivitetin e ahikadirijsve në Elbasan, në teqetë halveti-hajati në Kërçovë, Strugë dhe Ohër etj.

Teqetë e Shkupit ndërmjet dy luftërave botërore

Shkupi gjatë tërë periudhës osmane ka qenë një nga qendrat më të rëndësishme administrative të Shtetit Osman në viset ballkanike. Administrita osmane, si nga aspekti i përmasave qeveritare ashtu edhe nga ai i organizimit civil, është përpjekur që institucionet funksionale shoqërore të qendrës t'i bartë dhe të njëjtat të përfaqësohen edhe në qendrat periferike, siç në këtë rast është Shkupi. Edhe administrata qeveritare por edhe ajo e organizimit civil në Shkup në periudhën osmane ka qenë e përfaqësuar në masë të madhe nga elemente lokale dhe vendase, rrjedhimisht, nga shqip-

³⁷⁸ Barkan, *po aty*, f. 279-280.

tarët. Në rastin e tarikateve dhe teqeve numri më i madh i shejh-lerëve të teqeve kanë qenë me prejardhje lokale dhe autoktone. Kjo ka ndikuar dukshëm që edhe pas tërheqjes së administratës osmane teqetë të funksionojnë në Shkup por edhe në pjesën më të madhe të viseve shqiptare.

Periodha midis dy luftërave botërore ka qenë ndër periudhat më të vështira të popullatës shqiptare në viset që kanë ngelur jashtë kufijve fizik të Shqipërisë. Rasti është identik edhe me Shkupin. Si rrjedhojë e kësaj organizmat civile, në korpusin e të cilave rol të rëndësishëm do të lozin edhe teqetë, kanë qenë vendstrehimet kulturore, intelektuale dhe organizative shoqërore të popullsisë e cila kishte mbetur në mëshirën e sunduesit arrogant dhe të vrazhdë sllav. Administrata e re e vetëdëshme për këto çerdhe në masë të madhe është përpjekur që t'i shkatërrojë edhe intelektualisht por edhe fizikisht. Pjesa më e madhe e teqeve është rrënuar me arsye-time qesharake urbanistike ose të tjera, ndërsa bartësit e gjallë të idesë së përshtirshmërisë islame janë ekzekutuar ose dëbuar nga Shkupi. Rast më eklatant është dëbimi i familjes së shejhit në të qenë rifaite të Shkupit.

Teqja mevlevite e Shkupit

Në territorin e Maqedonisë së sotme teqe mevleviane ka patur në Manastir, Shtip, Veles, Kriva Pallankë dhe Shkup.³⁷⁹ Në periudhën e shekullit XVIII dhe XIX Tarikati Mevlevi ka qenë tarikat i klasës administrative, prandaj edhe teqetë e vendeve të vogla janë mbyllur.

Veprimtaria më e bujshme e mevlevive është përqëndruar në qytetin e Shkupit, ndërsa sema'ja (vallëzimi mistik) i cili është karakteristikë e këtij tarikati është prezentuar edhe në qytetet tjera. Në vitet 1818–1821 udhëpërshkruesi gjerman Johann Karl Weyand ka

³⁷⁹ Shih: Golpinarli, Abdulbaki, *Po aty*; Popoviç, Alexandre, *Les Dervishes Balkaniques*, f. 270; Ayverdi, Ekrem Hakki, *po aty*, III, 371; Elezoviç, Glisa, *Turski Spomenici*, I, 683.

kaluar nga Greqia nëpër Maqedoni dhe është ndalur Shkup dhe Manastir. Ai në veprën *“Lohann Karl Weyand’s Reisen durch Europa, Asien und Afrika von dem Jahre 1818 bis 1821”*, flet për disa grupe të dervishëve në Shkup dhe Manastir, të cilët janë lutur duke u rrotulluar në trajtë të sistematizuar. Ai këtë ritual të semasë ua ka përngjarë vallëzimeve hinduse. Me rëndësi është ajo që ne prej memoareve të tij kuptojmë se në ato vite në Shkup dhe Manastir është kultivuar *semaja* si një formë e dhikrit melevit.

Në Shkup në afërsi të Bit Pazarit ka patur një teqe meleviane, e cila është rrënuar në vitin 1955. Njohuritë e para në lidhje me këtë teqe i jep Evlija Çelebiu i cili e ka vizituar Shkupin në gjysmën e dytë të shekullit XVII. Ai thotë se në Shkup ka njëzet teqe, në mesin e tyre edhe Konaku i Pashës, i cili me urdhrin e Melek Ahmed Pashës është shndërruar në teqe meleviane.³⁸⁰ Në bazë të të dhënave të prezentuara në raportin e Mexhlis-i Meshajihit të Shkupit në vitin 1939, nga fundi i shekullit XIX në melevihanen e Shkupit është dërguar Husein Dedeu nga Konja. Pas tij në post janë ulur Mustafa Dedeu dhe Abdalbaki Dedeu, po ashtu të dërguar nga Konja. Në vitin 1267 (1850–51), pas vdekjes së shejhut të teqesë Abdulfettah Efendiut, në teqe shejh është bërë Nijazi Efendiu nga Elbasani i cili dyzetë vjet ka qëndruar në këtë detyrë. Pas tij në vitin 1307/1889–90 në post është ulur i biri, Ali Efendiu. Shejhu i fundit i Teqesë Melevite në Shkup ka qenë Shejh Hakki Efendiu i cili në vitin 1954 së bashku me dorëshkrimet dhe librat me rëndësi të teqesë është shpërngulur në Turqi. Teqeja ka pasur edhe shumë vakëfe, si p.sh., tre mullinj të gurit, një dyqan, një shtëpi, 3500 donum tokë etj.³⁸¹

Çdo ditë të premte, deri në pushtimin nga ana e bullgarëve, në këtë teqe është zbatuar *semaja*. Në bazë të pohimeve të Glisha Elezovi–

³⁸⁰ Evlija Çelebi, *Seyahatname*, V, 556; Ayverdi, E.H., *po aty*, III, 391.

³⁸¹ Ayverdi, E.H., *po aty*, III, 391; Çoliq, Liljana, *Derviski redovi u Skoplju*, f. 49.

çit, Sulltan Reshadi në vitin 1909 gjatë vizitës së tij Shkupit e ka ndihmuar materialisht Teqenë Mevleviane të këtij qyteti.³⁸²

Shkupit kanë qenë nga Elbasani, mund të pohojmë se në Elbasan ka patur mevlevi dhe teqe mevleviane.³⁸³

Një udhëpërshkrues i huaj flet për dervishët vallëzues, që me gjasë janë mevlevi, edhe në Petrelë.³⁸⁴ Në bazë të dokumenteve ekzistuese shihet se me tërheqjen e Shtetit Osman nga Shqipëria, aty nuk ka mbetur as teqeja mevleviane.³⁸⁵

Si te popujt e tjerë ballkanikë ashtu edhe te shqiptarët Mevlana Xhelaluddin Rumi dhe vepra e tij *“Mesnevi”*, kanë patur vend të posaçëm. Disa prej poetëve shqiptarë në periudhën osmane si dhe në atë pasosmane kanë shkruar poezi në të cilat kanë qenë të frymëzuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga veprat e Mevlanës. P.sh., doajeni i letërsisë shqiptare, Naim Frashëri, në *“Dhembjet e Fyellit”* në mënyrë të drejtpërdrejtë është frymëzuar nga tetëmbëdhjetë vargjet e para të *“Mesnevisë”* kushtuar *Naj-it*.³⁸⁶

Teqja nakshibendite e Shkupit

Lutfullah Uskubi është muridi i Mulla Ilahiut në Vardar Jenixhe si dhe Emir Buhariut në Stamboll. Ai pasi ka përfunduar sejr-i sulu-kin pranë këtyre dy shejhëve të mëdhenj, është kthyer në Shkup

³⁸² Elezoviç, Glisa, *Turski Spomenici*, I, 683.

³⁸³ Ayverdi, Ekrem Hakki, *po aty*, IV, 393. Për Teqenë Mevlevite të Elbasanit flet edhe Nathalie Clayer, *L'Albanie, pays des derviches, Les ordres mystiques musulmans en Albanie à l'époque post ottomane (1912-1967)*, Berlin 1990, f. 13.

³⁸⁴ Riedl, Richard, *“Die tanzenden derwische von Tirana”*, në *“Österreichische Rundschau”*, 11, f. 230-231.

³⁸⁵ Popoviç, Alexandre, *Balkanlarda Islam*, përkth në turq. Komisioni, Stamboll 1995, f. 21 dhe 55.

³⁸⁶ Naimi në *Dhembjet e fyellit* thotë: *Pa dëgjo fyellin ç'thotë / Tregon mërgimet e shkreta / Qahet nga e zeza botë / Me fjalë të vërteta*. Ndërsa Mevlana Xhelaluddin Rumi në poezinë kushtuar Naj-it: *Dëgjo çka thotë naji, ai ankohet nga ndarja / Mua që kur më prenë nga kallamishtja, gra e burra rënkuan nga vaji im*.

dhe brenda mureve të kalasë ka themeluar një teqe ku e ka duar aktivitetin e vet.³⁸⁷ Teqeja e themeluar nga ana e Lutfullah Uskubiut është teqeja e parë nakshibendiane në këto vise.³⁸⁸ Teqeja e Lutfullah efendiut e ka bartur Tarikatin Nakshibendi në Maqedoni, mirëpo më vonë ky tarikat tokë më pjellore ka gjetur në Bosnjë dhe aty është zhvilluar më tepër.

Teqetë halvetijje të Shkupit

Tarikati Halveti është tarikati më i përhapur në Ballkan gjatë periudhës osmane. Në veçanti në shekujt XVIII dhe XIX nëpërmjet këtij tarikati në shumë vise të Ballkanit, e si pjesë e tij edhe në trojet shqiptare, është prezentuar botëkuptimi sufik i fesë islame.

Tarikati Halveti me degët e tij ka qenë mjaft i përhapur edhe në Maqedoni. Shejh Salih Babai i lindur në fshatin Shat të Prizrenit dhe murid i Teqesë Halveti–Karabashi të Prizrenit, në bregun e djathtë të lumit Vardar në Shkup ka themeluar një teqe të këtij tarikati. Edhe në këtë teqe posti ka kaluar nga babai në birin dhe shejhë kryesisht kanë qenë bijtë e Shejh Salih Babait.³⁸⁹ Teqeja ka patur numër të konsiderueshëm të muridëve edhe nga Maqedonia Lindore.

Në shekullin XVII në Shkup është themeluar edhe një teqe halvetiane nga ana e Adem Babait e cila ka mbajtur emrin Zinxhirli Tekke. Përveç Adem Babait në këtë teqe shejhë kanë qenë edhe: Shejh Haxhi Sulejmani, Shejh Ebu Beqiri, Shejh Haxhi Osmani, Shejh Ali

³⁸⁷ Taskopruzade, *Esh-Shekaik*, f. 364.

³⁸⁸ Evlija Çelebiu thotë se ky person ka qenë vaiz dhe hatip në Xhaminë e Jahja Pashës dhe se ka ndërtuar teqenë në Kalanë e Shkupit. *Seyahatname*, V, 560.

³⁸⁹ Shejhu i fundit i kësaj teqeje e cila është rrënuar në periudhën komuniste ka qenë Shejh Hajdari, babai i Shejh Erollit, shejhut të Teqesë Rifaije në Shkup. Shih: Galaba Palikruseva, *“Derviskiot red Halveti vo Makedonija”*, në *“Zbornik na [tipskiot Naroden Muzej]”*, I (1958-59), Shtip, f. 111; Clayer, *po aty*, f. 215; Kubarad i Lidija, *Osmanliski Spomenici vo Skopje*, f. 133.

Efendiu, Shejh Mustafa Kenziu, Shejh Ali Fahriu. Shejhu i fundit i teqesë, Mehmed Ferid Sulejmani, ka qenë halveti-xherrahi.³⁹⁰

Në Shkup kanë vepruar edhe dy teqe sinanije. E para prej tyre është Teqeja e Velijuddin Vardarit. Kjo teqe është themeluar nga fundi i shekullit XVI dhe ka vepruar deri në fund të shekullit XIX. Themelues i kësaj teqeje është muridi i Umme Sinanit, Abdullhadi Vardari.³⁹¹ Kjo teqe përmendet edhe në dy-tre berate me të cilat është cëmruar shejhu i kësaj teqeje. Njëri prej berateve mban datën 5 Dhilhixhxe 1220/25 Janar 1806, ndërsa të tjerët janë të viteve 1833, 1836 dhe 1878.³⁹²

Teqeja e dytë Sinanije në Shkup është themeluar nga Iplikçi Hasan Efendiu dhe quhet Bukagili. Kjo teqe ka qenë afër xhamisë së Jahja Pashasë dhe është rrënuar nga tërmeti i vitit 1963. Shejhë të kësaj teqeje kanë qenë: Shejh Dervish Efendiu, Shejh Shit Efendiu, Shejh Terzili Ali Efendiu, Shejh Ibrahim Bukagili, Haxhi Abbas Babai, Shejh Ibrahim, Shejh Bahaeddini, Shejh Halidi, Shejh Ibrahim, Shejh Abbasi dhe Shejh Kadri Efendiu.³⁹³

Tarikati Halveti në viset ballkanike në masë të madhe ka qenë i pranishëm nëpër qytete dhe është ndihmuar nga ana e administratorëve vendorë të Shtetit Osman. Vija e drejtë sunnite e këtij tarikati ka ndikuar në përhapjen e këtij tarikati në mesin e shtresës intelektuale ballkanike. Siç u përmend hollësisht edhe më lart, një numër i konsiderueshëm i shejhëve përveç detyrës së tyre në teqetë kanë punuar edhe si mësimdhënës (muderrisë) në medrese. Teqetë halvetiane njëkohësisht kanë qenë edhe çerdhe të poetëve të periudhave të ndryshme.

³⁹⁰ Palikruqeva, *po aty*, f. 113; Masulović Marsol Liljana et Çolançevska Olga, *Propos Recueillis et Documents Sur des Tekke de Skopje Disparus*, në "Anatolia Moderna", IV; *Derviches Des Balkans, Disparitions et Renaissances*, Paris 1992, f. 80.

³⁹¹ Clayer, *po aty*, shtojca.

³⁹² Qehajić, *po aty*, f. 116.

³⁹³ Masulović-Çolançevska, *po aty*, f. 75; Clayer, *po aty*, f. 152, 172:

Teqja kadirite e Shkupit

Në Maqedoni, në bazë të hulumtimeve tona, teqe kadirite ka patur në Shkup, Ohër, Dibër dhe fshatin Sopot të Kumanovës. Teqeja Sinanije e Dyqanxhikut, e cila deri në shekullin XVIII ka vepruar si teqe sinanije–halvetijje, duke filluar prej mesit të këtij shekulli e ka vazhduar aktivitetin si teqe kadirite. Në raportin e Ulema Mexhlisit të Shkupit theksohet se në Ohër ka patur një teqe kadirite.³⁹⁴ Një teqe kadirite është regjistruar edhe në Dibër.³⁹⁵

Në shumicën e qyteteve të Shqipërisë por edhe në Shkup tarikartet dhe teqetë kanë qenë ngushtë të lidhura me esnafët e profesioneve të ndryshme.

Përderisa në Anadoli *ahijte* si shoqata mistike–zejtare më tepër kanë qenë të afërta me bektashinjtë, në Shqipëri afërsia e tyre krahas bektashinjve ka qenë evidente edhe me kadirijtë. Ja si e ka vlerësuar këtë relacion z. Zija Shkodra: “Ahikadirizmi dhe bektashizmi qenë dy nga sektet më të përhapura të dervishëve në vendin tonë. Si njëri ashtu edhe tjetri luajtën një rol të dorës së parë në drejtimin shpirtëror dhe në atë esnafor të zejtarëve. Ritualit i dhënies së testireve mbështetej pothuajse krejtësisht në projektregulloren e Evren Veliut, udhëheqësit të sektit të dervishëve ahinj. Për tabakët, sikurse e pamë, drejtuesi i këtij sekti, ahi–babai, ishte njëkohësisht edhe udhëheqësi shpirtëror i këtyre esnafeve. E njëjta ndodhte edhe me bektashinjtë, të cilët nën drejtimin e pasuesve të Haxhi Bektashit, mbajtën nën kontroll dhe frymëzuan shekuj me radhë esnafet e kondakçinjve, leshpunuesve, takijexhinjve, etj. Ideologjia dhe botëkuptimi fetar i esnafeve s’mund të ishin pra veçse ato të këtyre sekteve, të cilat, megjithëse mbështeteshin në parimet themelore të islamizmit, lejuan liri më të madhe fetare dhe veprimi”.³⁹⁶

³⁹⁴ *Izvestaj o radu Ulema Med’lisa u Skoplju*, Sarajevë 1941.

³⁹⁵ Ayverdi, E.H., *po aty*, III, 30.

³⁹⁶ *Po aty*, f. 274.

Teqja rifajte e Shkupit

Në shekullin XIX teqe rifajje në Maqedoni ka patur në Shkup, Veles, Manastir, Vallandovë dhe Koçanë.

S'ka dyshim se teqeja më e rëndësishme dhe më aktive e rifainjve në Maqedoni është Teqeja Rifajje e Shejh Mehmed b. Ismail Efendiut. Siç kuptohet nga vakufnameja e saj, teqeja është theme-luar në vitin 1233/1817 nga ana e Mehmed b. Ismailit.³⁹⁷

Mehmed b. Ismaili është prej fshatit Grupçin të Tetovës. Ai si fëmijë ka ardhur në në Shkup ku e ka kryer medresenë dhe ka punuar si arkëtar. Në Shkup është njohur me Shejhun arab Sejjid Haxhi Hatif dhe ka hyrë në Tarikatin Rifai. Dervish Mehmedi një kohë të gjatë i ka shërbyer shejhut të tij dhe në fund ka marrë iXHazet për të shërbyer si shejh në teqe. Pas diplomimit para shejhut ai ka blerë një shtëpi në lagjen e Hatunxhikëve dhe atë e ka shndërruar në teqe rifajte. Teqeja edhe sot e kësaj dite është aktive dhe gjendet në të njëjtin vend. Pas vdekjes së Shejh Mehmed Efendiut në vitin 1238/1822 në post është ulur i biri Shejh Sa'duddini. Shejh Sa'duddini ka qenë dijetar dhe poet. Ai në teqe ka ndërtuar dy çezme dhe ka shkruar dy mbishkrime (kitabe). Në kitabën mbi çezmen thuhet kështu: *"Shiko në këtë çezme të thatë! Kush është Haxhi Sa'duddini/ Dhe me bashkangjitje gjallëro atë shejh të kohës/ Në zi ishte në kohën kur e ndërtoi atë/ Ai me të i gëzoi shpirtrat e heronjve të Qerbelasë/ Me një llogari e nxorra unë datën e plotë/ Për dashuri të Hasanit dhe Huseinit le të rrjedhë ky ujë rrjedhës/ Në fillim të muajit Muharrem viti 1265/1848."*³⁹⁸

³⁹⁷ Vakufnameja gjendet në: Evkaf Kuyud-i Kadime, def. 758, f. 65 dhe def. 757, f. 7-18. Shih: Ayverdi, *po aty*, III, 292; Marsol Liliana Masulović, *Structure et impact de la confrerie des Rifais a Skopje*, Paris 1982, f. 42; Popović, *po aty*, f. 145.

³⁹⁸ Teksti origjinal është: *"Bu kuru çesme-i bak! El-Hac Sa'duddin kim / hem himmet eyle iHYa idup ol seyhi zeman / Meh matemde idi çunki sebil itti dem / Kerbela erleri ruhuni kildi sadan / bir hesapte çikarup bende kemali tarih / Hase-neyn askina cari ola bu mai revan / fi gurre m.1265."*

Kitabeja e dytë e shkruar nga ana e Shejh Sa'duddinit gjendet në tyrben dhe është e shkruar në gjuhën persiane: *“Në kopshtin e virtytit dhe njohjes së dymbëdhjetë pirave/ Vijnë e shkojnë der-vishët me zemra të lënduara/ Në këtë moment edhe Shejh Sa'duddini biri i Shejh Mehmedit/ Ec nëpër rrugën që kalon pranë Mëshiruesit të Lartësuar/ Nëse thua që dëshiroj të të njoh, dije që unë jam kull i Luanit të Zotit/ Vendi i Shejh Sa'deddinit qoftë më i larti, mëso datën e kalimit të tij/ Tyrben për dashuri të Zotit e ndërtoi Sejfullah beu/ Sa vend i bukur është ai për vizitë/ Prej meje merr datën e vdekjes 2 Shaban 1269/ Tyrbeja është ndërtuar në vitin 1273/1857”*.³⁹⁹

Teqja Sadije në Shkup

Tarikati Sadi në Maqedoni ka depërtuar në fund të shekullit XIX me emigrimin e banorëve muslimanë të Vranjes dhe Leskocit prej Serbisë Jugore dhe vendosjen e tyre në Maqedoni. Vefa Baba kishte ardhur së bashku me emigrantët dhe ka themeluar një teqe sadije në Shkup e cila vazhdon të ekzistojë edhe sot e kësaj dite.

Në Shkup ka patur edhe dy teqe bektashiane: Teqeja e Mustafa Babës e ndërtuar në fillim të shekullit XIX dhe Teqeja e Sulejman Babës.

Teqja Melamite e Shkupit

Themelet e periudhës së tretë të melamijes i ka hedhur Sejjid Muhammed Nuru'l Arabiu (v.1305/1882) i cili është me origjinë

³⁹⁹ Teksti original është: *“Be bag-i fazl-u irfan-i duvazdeh hazreti piran / Hemi ayende mirevend dervisan-i dilrisan / Der in dem Sheyh Saduddin ibn Shejh Mehmed hem / Guzer kerd zin guzergah ba xhivar-i hazret-i rahman / Eger guji tura gulam-i Shir-i Jezdanem/ Mekani Sa'd Shejh a'la buved tarih-i rihlet dan / Bina kerd mir Sejfullah bina tyrbe ra lillah / Çi xhaj-i hubb zijaret gah, zeman tarih-i abistan Rihlet fi 2 Shaban 1269, binaji tyrbe 1273”*. Shih: Bo{kov, V. - Is'hak, F, *“Rifaiskoto Teke vo Skopje”*, Glasnik INI, II, Shkup 1958, f. 179-191; Ayverdi, *po aty*, III. 293; Marsol, *po aty*, f. 63-66; Bogoeviq, Lidija, *Osmanliski Spomenici vo Skopje*, f. 130-131.

arabe dhe ka lindur në Kajro. Pas përfitimit të mësimëve të para në familje, është regjistruar në Universitetin e Az'harit dhe aty është afruar njafat me profesorin e tij Hasan Kuvejsiun. Hasan Kuvejsiu e ka dërguar Muhammed Nuru'l Rabiun në Anadoli, mirëpo ai pa u ndalur shumë atje ka shkuar në Ballkan dhe ka rënë në kontakt me grupet Nakshijje–Melamijje në Serez dhe Selanik. Ai ka marrë dorë në Tarikatin Nakshibendi prej Shejh Jusuf en–Nakshibendiut të Janinës, ndërsa nëpërmjet të Shejh Ibrahimushshemariut është lidhur për tariketet Halvetijje, Ekberijje dhe Uvejsijje. Në vitin 1249/1833–34 është emëruar si muderris në Medresenë e Koçanit dhe është njoftuar me pjesën e madhe të dijetarëve islamë të kësaj ane. Në vitin 1255/1839 ka ardhur në Shkup dhe ka marrë dorë prej shejh Kazanli Abdulhalik Efendiut. Në vitin 1266/1849 me ftesë nga valiu i Shkupit, Selim Pasha, ka qëndruar gjashtë muaj në Stamboll. Pas kësaj edhe dy herë ka qëndruar nga gjashtë muaj në Stamboll, herën e parë me ftesë të kryeshefit të policisë, Husni Pashës, ndërsa herën e dytë me ftesë të valiut të Bosnjës, Topall Osman Pashës.

Në vitin 1287/1870 duke qenë në Kavadar ka proklamuar se është bërë kutub. Ka vdekur në vitin 1305/1882 në Strumicë.⁴⁰⁰

Muhammed Nuru'l Arabiu ka vepruar në Maqedoni dhe ka patur numër të madh muridësh edhe në viset e Maqedonisë dhe të Kosovës. Halifet e shejhut në këto vise kanë qenë: Abdurrahim Fedai Efendiu⁴⁰¹, Salih Rif'at Efendiu nga Shtipi⁴⁰², Filintilizade Hoxha,

⁴⁰⁰ Shih: Golpinarli, A., *po aty*, f. 232-242; Isin, Ekrem, "Melamilik", DBIA, V, 386; Çiçek, Yakup, *Haririzade Mehmet Kemaleddin, Hayati, Eserleri ve Tibyanu Vesailil-Hakaik*, (temë e pabotuar e doktoraturës) f. 12-23.

⁴⁰¹ Ka qenë nga Prizreni dhe halif kryesor i shejhut. Ka shërbyer si muderris në Shkup dhe ka vdekur në rrugë në Kanalin e Suezit gjatë kthimit prej haxhit. Ka disa vepra: *Risale-i Vehbijje*, *Kaside-i Nunijje*, *Hedijjetu'l-Haxhixh*, *Tefsiru Sureti'l-Kevther*, etj. Halifet më të njohur të tij janë: Abdulahad Efendiu, Haxhi Hafiz Abdurrauf Efendiu nga Shkupi dhe Junus Efendiu nga Prishtina.

⁴⁰² Pasi që ka marrë dorë prej shejhut ka ndërtuar një teqe në Shtip. Ka vdekur në vitin 1326/1908.

Mahmud Efendi Shkupjani⁴⁰³, Faik Mehmed Beu⁴⁰⁴, Haxhi Sulejman Beu⁴⁰⁵, Haxhi Abdu'l-Kadir Beu⁴⁰⁶, Ali Riza Vasfi Efendiu⁴⁰⁷, Elmas Efendiu⁴⁰⁸, Xhengori Mustafa Efendiu⁴⁰⁹, Hafiz Topall Baba Gjakovari⁴¹⁰, Topall Rexhep Efendi Prizrenasi.⁴¹¹

Teqja melamite në Shkup është themeluar nga dhëndri dhe halifi kryesor i shejhut Abdurrahim Fedai Efendiu. Pas tij shejh janë bërë Haxhi Kemal Efendiu dhe djali i tij Hakki Efendiu.

Funksionet shoqërore të teqeve

Sufijtë dhe tarikatat e tyre janë zgjeruar në shumë fusha të jetës shoqërore të viseve ballkanike dhe kanë ndikuar në formimin shoqëror të shtresave të ndryshme të shoqërisë ballkanike. Sufijtë kanë qenë në marrëdhënie të mira me dijetarët dhe administruesit, por asnjëherë nuk e kanë mbajtur veten larg brengave të popullatës së rëndomtë.

Teqetë, të njohura në popullatë si vende të dervishëve, kanë qenë vende ku është sendërtuar edukimi i unit njerëzor. Përveç kësaj ato në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi janë inkadruar në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe me metodat e posaçme të tyre i

⁴⁰³ Ka qenë prej ulemasë së Shkupit dhe ka vdekur në vitin 1310/1892 në Hixhaz.

⁴⁰⁴ Ka qenë nga Strumica dhe pas vdekjes së shejhut është bërë shejh në teqenë e tij. Ka vdekur në vitin 1319/1901 në Selanik.

⁴⁰⁵ Ka qenë prej aristokratëve të Strumicës dhe shejhu shpesh ka ndenjur në konakun e tij. Ka vdekur në vitin 1889.

⁴⁰⁶ Ka qenë nga Strumica dhe vëlla i Sulejman Beut. Është vendosur për shejh të Teqesë së Kavadarit. Ai e ka shpëtuar teqenë që të mos e djegin bullgarët. Ka vdekur në moshën 95 vjeçare.

⁴⁰⁷ Ka qenë shejh i Teqesë Rifaite të Manastirit. Ka vdekur në vitin 1331/1913.

⁴⁰⁸ Ka ndërtuar një teqe në vendlindjen e tij në katundin Dedeli të Dokranit. Ka vdekur në vitin 1906.

⁴⁰⁹ Ka qenë shejh i Teqesës së Dojranit. Ka vdekur në vitin 1907.

⁴¹⁰ Ka qenë gjakovar dhe në teqenë e tij i ka dhënë ixhazet Haxhi Adem Efendi Prizrenasi dhe Hasan Efendiut. Ka vdekur në vitin 1902.

⁴¹¹ Është shejhu i parë i Teqesë Melamite të Prizrenit dhe ka punuar si mësues në shkollën e mesme të qytetit.

kanë sistematizuar aktivitetet e ndryshme të shoqërisë. Si rrjedhim teqetë dhe zavijet janë bërë vende ku përveç qetësisë shpirtërore janë plotësuar edhe shumë nevoja materiale të popullatës.

Teqetë, si vende ku janë bashkuar shumë institucione shoqërore, në relacionet e tyre me popullatën në viset ballkanike kanë vepruar si konaqe, spitale, qendra specializimi, qendra arti, vende qetësimi, vende pikniku, strehimore për pleqtë etj. Pothuajse në të gjitha teqetë në viset tona një herë ose dy herë në javë janë mbajtur ligjë-rata për popullatën. Tradita të këtilla vazhdojnë edhe sot e kësaj dite në disa prej teqeve.

Pranë ose brenda teqeve janë ndërtuar kuzhina (imarete) ku janë ushqyer të varfërit, endacakët, pleqtë, skamnorët. Ky aktivitet i teqeve ka ndikuar në rritjen e simpatisë ndaj tyre në shoqëritë ball-kanike. Herë pas here shejhët e teqeve kanë përdorur afërsinë e tyre me administruesit shtetërorë dhe kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së popullatës në mjedise të caktuara.

Njerëzit të cilët kanë përjetuar tronditje psikike ose kanë qenë të sëmurë prej sëmundjeve psikosomatike kanë gjetur prehje në teqe. Teqetë gjithashtu kanë shërbyer edhe si qendra ku janë mësuar zeje të ndryshme. Janë të njohura shoqatat mistike-zejtare të ahijve në sistematizimin e zejeve dhe përgatitjen e mjeshtërve të rinj.

SKENDER ASANI & MEHMET PRISHTINA

Shkup – Prishtinë

SHKUPI – QENDËR E RËNDËSISHME E ORGANIZATËS POLITIKE XHEMIJETI

Ngadhënjimi i revolucionit të turqve të rinj kishte rëndësi të madhe për gjithë popullatën shqiptare, sepse për herë të parë në histori iu dha mundësia e organizimit politik. Në ditët dhe javët e para, vërtetë erdhi deri tek binjakëzimet e mëdha ceremoniale të grupeve të ndryshme kombëtare dhe fetare. Në Manastir dhe rrethinën e tij, të gjithë popujt dhe bashkësitë fetare, hapën institucionet e tyre arsimore e fetare, të shoqatave dhe komiteteve të tyre kulturore dhe ideologjike. Në momentet e para pas revolucionit, dhe me rrethanat e reja të krijuara pas miratimit të kushtetutës, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, u angazhua në themelimin e klubeve shqiptare.

Nga fundi i gushtit i vitit 1908, në Manastir shqiptarët e formojnë klubin politik të quajtur “Bashkimi” (në gjuhën turke, në shtypin e kohës të viteve 1908–1912, quhej Xhemiet. – S.A.). Me një intensitet të madh, edhe në qytetet tjera të banuara me shqiptarë, formohen klube politike me emrin “Bashkimi”.⁴¹² Klubi “Bashki–

⁴¹² Klubi “Bashkimi” ishte i udhëhequr nga intelektualë, nga shtresa më e arsimuar dhe më e ngritur kombëtare, e cila gëzonte autoritet të madh në popull. Gjithashtu duhet të përmendet se në klubin e Shkupit “Bashkimi” merrnin pjesë Nexhip Draga, Emin dhe Qemal bej Kumbara etj., të cilët më vonë janë themelues të Xhemietit në Shkup, në dhjetor 1919; Нуман Аруч, Придонесот и влијанието на внатрешните движења во Македонија за младотурската револуција, 100 години од прогласувањето на младотурската револуција и нејзиното влијание на положбата во Македонија, Зборник на трудови од меѓународен научен собир одржан на 18 декември 2008 година, Македонска Академија на науките и Уметностите, Скопје, 2011, 246; Катерина Тодоровска – Исамедин Азизи, Bashkim'i Kombit (Национално единство), Скопје, 2008, 5; Рамиз Абдули – Музафер Бислими, Извештаи на австроунгарски конзули од Македонија за албанските клубови во Македонија, Гласник на Институт за национална историја, 46/1, Скопје, 2002, 132. (Корје e veçantë)

mi“ i Shkupit, aktivitetin e tij e kishte përqendruar në çeljen e shkollave në gjuhën shqipe, dhe jorastësisht quhej “Klubi arsimor“. Anëtarë të këtij klubi ishin figura që ishin bartës të Lëvizjes Kombëtare të Vilajetit të Kosovës, si Nexhib Draga, Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Emin dhe Qemal bej Kumbara, etj.

Me fillimin e Luftës së Parë Ballkanike, ndërpritet edhe veprimtaria politike e “Komitetit për Bashkim dhe Përparim” dhe klubit shqiptar “Bashkimi”, i cili vepronte edhe në Maqedoni. Nga nëntori i vitit 1912 e deri në dhjetor të vitit 1912, për shkak të aktiviteteve luftarake gjatë luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, popullata shqiptare në trevat lindore nuk pati mundësi të organizohej politikisht. Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe formimit të Mbretërisë SKS, u dha mundësia e organizimit politik në baza etnike dhe fetare. Për shkak të rregullave ligjore, meqë shqiptarët, turqit, boshnjakët dhe të tjerët, nuk kishin mundësi të organizohen politikisht në baza etnike, ata u bashkuan në bazë fetare dhe e formuan organizatën politike të myslimanëve Xhemijeti.

Zhvillimi i parlamentarizmit në Mbretërinë SKS, në periudhën e viteve 1919 – 1925, karakterizohet me luftëra politike dhe mosmarrëveshje. Këto zhvillime tek partitë politike me ideologji të ndryshme, me koncept të ndryshëm nacional dhe fetar, ndërthuren veçanërisht gjatë aktiviteteve para, gjatë dhe pas zgjedhjeve⁴¹³. Me Marrëveshjen e Pakicave, nënshkruar në dhjetor të vitit 1919 në San Zhermen⁴¹⁴, Mbretëria SKS obligohet se do t’u sigurojë të drejtat themelore pakicave kombëtare: të drejtën e jetës, të drejtat qytetare-politike, lirinë e përdorimit të gjuhës amtare, lirinë e be-

⁴¹³ Надежда Цветковска, Политичките партии во парламентарните изборни борби во вардарскиот дел на Македонија (1919 - 1929), Скопје, 2004, 5.

⁴¹⁴ Pakicat nacionale ekzistonin edhe më herët në shumë shtete kombëtare anekënd Evropës, por statusi i tyre nuk ishte i pranuar. Bile pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore vendoset si e drejtë e rëndësishme ndërkombëtare dhe si çështje politike.

simit⁴¹⁵. Në këtë periudhë, organizimi politik i popullsisë shqiptare ishte i pamundësuar, dhe mundësia e vetme ishte që të organizohen në çadrën fetare, që ishte determinuar në përcaktimin e fatit të popullit shqiptar. Nëpërmjet Xhemijetit, popullsia myslimane (shqiptare, S.A) e trevave lindore shqiptare, u përpoq që t'i realizojë të drejtat kombëtare në Mbretërinë e SKS.

Partia politike është organizatë e cila përfshinë njerëz me ideologji të njëjtë, me qëllim të zgjerimit të mëtejshëm për arrijten e qëllimeve të parashtruara. Partitë politike në jetën politike të Mbretërisë SKS, në këtë kontekst edhe në trevat veri – lindore shqiptare, u treguan si shembull real politik, si pjesë e veprimit aktiv të popullit në politikë. Në këtë drejtim, popujt që nuk ishin konstitutiv në shtet, duhej të gjenin forma për formimin e partive politike, që të mund lirisht të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare, që të përgatiten drejt zgjidhjes së çështjeve të tyre nacionale dhe fetare, por edhe ta shfrytëzojnë partinë si instrument për ndryshimin e jetës shoqërore.⁴¹⁶ Me formimin e Mbretërisë SKS, përkaj partive të lartpërmendura politike (Partia Radikale, Partia Demokratike, etj), u themeluan edhe disa parti qytetare, parti nacionale, parti me orientime fetare, por edhe parti me orientime ideologjike djathtiste dhe majtiste. Kjo gjendje ndikoi që jeta politike të jetë më e ashpër

⁴¹⁵ Shteti i ri, Mbretëria SKS, në samitin e të ashtuquajturit “Sistemi i Marrëveshjes së Versajit”, me të cilin përcaktohet rendi i ri i shteteve në Evropë dhe posaçërisht çështja e zgjidhur e suksesionit të shtetit të Austro-Hungarisë i cili nuk ekzistonte sipas marrëveshjes së paqes të nënshkruar më 10.09.1919. Çfarë obligimesh ndërmerr Mbretëria SKS me marrëveshjen e Shën Zhermenit? Para së gjithash, Mbretëria SMS obligohet “të gjithë qytetarëve t’u sigurojë barazi të plotë dhe mbrojtje të të drejtës së jetës dhe lirisë pa dallim të prejardhjes, kombësisë, gjuhës, racës ose fesë”. Gjithashtu, të gjithë qytetarët jugosllavë “do të jenë të barabartë para ligjit dhe do t’i gëzojnë të drejtat e njëjta qytetare dhe politike pa e marrë parasysh racën, gjuhën ose fenë”; Димитрије Богдановић, Књига о Косово, Београд, 1984.

⁴¹⁶ Надежда Цветковска, Политичките партии во парламентарните изборни борби во вардарскиот дел на Македонија (1919 – 1929), Скопје, 2004, 19 – 21.

dhe më komplekse.⁴¹⁷ Në partitë dhe organizatat politike, ndikim të madh kishin liderët e tyre, të cilët ishin dominues, dhe e diktonin orientimin politik. Shembull për këtë është ndikimi i madh që kishte Nikolla Pashiqi në Partinë Radikale dhe Nexhib Draga në organizatën politike të myslimanëve Xhemijeti.

Konsulli italian në Shkup, duke u bazuar në informacionet nga Kuvendi themelues në Shkup, e informoi Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, për formimin e organizatës politike të myslimanëve (nga kombësia shqiptare) nga Serbia Jugore, me emrin Xhemijeti. Sipas informatave të konsullit, “kjo organizatë, veprimin e vetë politik e shtriu në pjesën e Maqedonisë së sotme, Kosovës dhe Sanxhakut”.⁴¹⁸ Pas Luftës së Parë Botërore, Italia kishte për qëllim t’i aneksojë këto treva dhe kjo ishte arsyeja që ajo ta ndjek me kujdes të veçantë gjendjen shoqërore-politike në Mbretërinë SKS. Ndërsa, Lëgata e Shqipërisë në Beograd, e informoi Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë, se shumica e myslimanëve nga trevat Veri – lindore, pa dallime nacionale u organizuan në organizatën politike me emrin Xhemiet, me seli në Shkup.⁴¹⁹ Këtë organizatë politike e formuan shtresat aristokrate (bejlerët dhe agallarët), të cilët dëshironin t’i ruanin pronat e privilegjet, të përfitojnë nga politika, dhe këto ishin elementet të cilat i bashkonin myslimanët për ta formuar Xhemijetin.

Në periudhën e viteve 1919–1925, me parlamentarizmin në Mbretërinë SKS, e në këtë kontekst edhe në kryeqendrën e trevave veri – lindore shqiptare në Shkup, me norma kushtetuese u mundësua paraqitja dhe veprimtaria e organizatës politike të myslimanëve.

⁴¹⁷ Për shkak të elektoratit kompakt me fe myslimane, Xhemiet kishte shtrirje regjionale të veprimtarisë politike.

⁴¹⁸ Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Shkup, Fondi: Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë, Partito politico myslimano albanese “ Cemiet “, AK – 5, 16.02.1925.

⁴¹⁹ AMPJSH, Viti.1923, dosja.206, fleta.7, Raport i Legatës së Shqipërisë në Beograd dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë.

manëve – Xhemijeti. Kjo organizatë politike, e mblodhi borgjezinë qytetare myslimane, pasanikët e mëdhenj (agallarët dhe bejlerët), por edhe parinë myslimane të rretheve, me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre klasore, fetare dhe kombëtare.⁴²⁰ Gjatë veprimtarisë së saj politike, Xhemijeti ishte aktive në trevat lindore shqiptare (Maqedoni, Kosovë dhe Sanxhak), meqë selia e saj qendrore ishte në Shkup. Qëllimet kryesore të programit të kësaj organizate politike ishin: sigurimi i të drejtave qytetare-politike, liria e përdorimit të gjuhës amtare, liria e besimit, etj. Pas themelimit, Xhemeti gjatë veprimtarisë së vetë, mori pjesë në tre cikle zgjedhore për Kuvendin Popullor. Më 1920 fitoi 8 deputetë, më 1923 madje 14 deputetë, kurse më 1925 nuk arriti të merr asnjë mandat.

Agallarët, bejlerët dhe funksionarët e lartë fetarë, arritën që përmes organizatës politike Xhemijeti, t'i realizojnë disa nga kërkesat e tyre themelore. Shumë nga ata i ikën reformës agrare dhe arritën që shumë shtrenjtë t'i shesin çifligjet e tyre; shumë nga ata që ikën gjatë Luftës së Parë Botërore dhe e humbën të drejtën e pronës, arritën që të kthehen vetë dhe të rikthejnë pronat e tyre, etj. Çmi-

⁴²⁰ Asnjëri nga obligimet e ndërmarra në marrëveshjen e Shën Zhermen nuk ishte implementuar në vepër. Përkundrazi, në Mbretërinë SKS, pakicat nacionale nuk ishin të pranuar. Kjo marrëveshje në vitin 1920 është vënë nën garancinë e Lidhjes së Popujve, por as në kohën kur Monarkia e mban emrin e Mbretërisë së SKS, në kushtetutat e monarkisë, nuk janë të mbrojtura të drejtat e pakicave nacionale. Vetëm Ligji i Shkollave Popullore shkruan që në vendet ku është i madh numri i shtetasve të cilët flasin gjuhë tjetër duhet të hapen klasa të veçanta. Edhe këto norma asnjëherë nuk janë zbatuar; Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (Mëtej AMPJSH), Dosja.69, viti.1920, *Traite entre, Les Principales Puissances Alliees et Associees et L'etat Serbe – Croate Slovene, Signe a Saint Germain – en – laye, Le 10 septembre 1919*; Димитрије Богдановић, Књига о Косову, Српска Академија Наука и Уметности, књига. DLXVI, Београд, 1986; Yasar Nabi, *Balkanlar ve Turkluk*, Ankara, 1936, 190 – 194; Борче Илиевски, Политика на Кралството на СХС/ Југославија кон миграционите движења на турското и муслиманското население од вардарскиот дел на Македонија 1918 – 1941 год, Скопје, 2009, 310; Мухамед Пираку, „Културно-просветно движење на Албанците во Југославија”, Југословенско историско списание, „Култура”, Београд, 1978, 357.

min që duhej ta paguanin udhëheqësit e Xhemijetit ndaj borgjezisë udhëheqëse serbomadhe, nuk ishte i madh, duke pasur parasysh shërbimin që Xhemijeti kishte bërë ndaj tyre.⁴²¹

Fillimisht, aktiviteti i organizatës Xhemijeti në qarkun e Shkupit në periudhën 1919–1921, ishte i përqëndruar për ti rezistuar implementimit të reformave agrare⁴²² dhe kolonizimit, pastaj në konsolidimin dhe realizimin e programit të saj, nxjerrjen e organit të shtypit “Hak”, përgatitjet për zgjedhjet parlamentare të 28 nëntorit 1920, si dhe aktiviteti i deputetëve shqiptar nga Shkupi në Kuvendin Ligjdhënës dhe jashtë tij. Ndërsa aktiviteti i Xhemijetit në periudhën 1921 (që nga miratimi i Kushtetutës së Vidovdanit) deri më 1923, ishte përqëndruar tek deputetët e Xhemijetit në Kuvendin Popullor dhe jashtë tij, aktivitetet para dhe pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1923. Periudha më aktive e Xhemijetit është në periudhën e viteve 1923–1925, periudhë e veprimit të saj të pavarur politik pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1923, paraqitja e fërkimeve të brendshme të Xhemijetit, aktivitetet para dhe pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1925, shkaqet për ndërprejen veprimtarisë së Xhemijetit dhe zhdukjes nga skena politike.

Krërët e Xhemijetit në Shkup ishin në lidhje të afërta me çetat kaçake, të cilat bënë rezistencë aktive kundër organeve shtetërore të SKS-së, për çka shpesh nga politika zyrtare dhe nga gazetatat serbe

⁴²¹ П. Здравковски, Националните малцинства во Народна Република Македонија, „Социјалистичка Зора“, Скопје, 1949, 53.

⁴²² Në fillimet e shtetit të ri, Mbretërisë SKS, reforma agrare ishte në kompetenca të Ministrisë për Politikë Sociale (më 2 prill 1919 ishte emëruar edhe ministri i Reformës Agrare), kurse me dekretin e datës 12.02.1920, ishte themeluar Ministria e Reformës Agrare e Mbretërisë SKS. Në strukturën e saj organizative, Ministria e Reformës Agrare e kishte nën kompetencë departamentin e përgjithshëm dhe atë agrar. Në nenin 27, departamenti agrar solli dekret që në Shkup të formohet Drejtoria Agrare, kurse si organe të saja ekzekutive u formuan rregulloret qarkore agrare, përfaqësitë qarkore agrare dhe komisionet.⁴²² Shkupi ishte qendër e Komitetit Agrar, i cili kishte komitetet qarkore në pjesën e trevave lindore shqiptare (Maqedoninë, Kosovën dhe në Sanxhak).

akuzohej për bashkëkoordinim me çetat kaçake. Po ashtu krerët e Xhmietit ishin në funksion të realizimit të programit të Komitetit të Kosovës, për t'i rezistuar politikës shtypëse të Mbretërisë së SKS.

Organizata politike Xhemijeti, gjatë verimit të saj disavjeçar, nuk arriti që të profilizohet si parti e pavarur politike. Shkaqet mund t'i gjejmë në pamundësinë për t'i rezistuar ndikimit të partive kryesore politike, për çka edhe nuk arriti që ta ndërtojë shtratin e vetë ideologjik. Për shembull, në ciklet zgjedhore nga vitet 1920, 1923 dhe 1925, Xhemijeti nuk arriti që të del e vetme (e pavarur) në zgjedhje. Si rezultat i kësaj, përsikaj listave të pastra të kandidatëve radikalë dhe demokratë, u theksuan edhe listat e përziera myslimane–radikale, përkatësisht myslimane–demokrate, në të cilat u kandiduan dhe më pas zgjodhën anëtarë të Xhemijetit.⁴²³ Xhemijeti në veprimin e saj politik, më tepër ishte e varur ndaj Partisë Radikale, kurse dëshmi për këtë ishin edhe listat e përbashkëta zgjedhore të kandidatëve. Moment i rëndësishëm do të jetë kur filloi lufta e brendshme politike për ose kundër koalicionit me Partinë Radikale, çka shkaktoi humbjen e ndikimit të saj në Mbretërinë SKS, e me të edhe në trevat lindore të banuara me shqiptar. Një shembull i tillë është momenti kur më 1924, Xhemijeti iu bashkua bllokut opozitar dhe u nda nga Partia Radikale, çka ndikoi në humbjen e zgjedhjeve të vitit 1925, dhe nuk fitoi asnjë deputet.⁴²⁴

⁴²³ Надежда Цветковска, Политичките партии во парламентарните изборни борби во вардарскиот дел на Македонија (1919 – 1929), Скопје, 2004, 66.

⁴²⁴ Me këtë Program politik, Xhemieti hyri në bisedime me partitë parlamentare në Kuvendin popullor, dhe me programin e njëjtë u prezantua në fushatat zgjedhore para elektoratit në zgjedhjet parlamentare dhe lokale (komunale)⁴²⁴. Në jetësimin e programit dhe ngritjen e organizatës politike Xhemieti, rol të rëndësishëm kishte lideri i saj shpirtëror Nexhib Draga, e pastaj edhe Ferhat Draga. Xhemieti dinjitetshëm përmes disa deputetëve të saj në Parlamentin e Mbretërisë SKS, i përfaqësoi interesat e myslimanëve (shqiptarëve dhe turqve), në këtë shtet, duke kundërshtuar në radhë të parë kolonizimin dhe reformën agrare, si dhe ndërprerjen e depërtimit të tyre në Turqi dhe Shqipëri.

Për shkak të dallimeve nacionale, kulturore dhe historike mes popullsisë në Mbretërinë e SKS, modeli më i mirë për rregullimin shtetëror ishte koncepti federal, për çka u angazhuan partitë opozitare të prira nga S. Radiq, M. Spaho dhe A. Koroshec. Partitë që e përbënin qeverinë, dëshironin që nëpërmjet shtetit centralist të ruhet ndikimi serb në shtetin e ri të Mbretërisë së SKS. Edhe veprimtaria politike e Xhemijetit gjatë kohës së funksionimit të tij, u ndesh me këto dy koncepte të rregullimit shtetëror: në periudhën nga formimi i saj deri në zgjedhjet parlamentare në vitin 1923, veprimi i saj ishte nën kapelën e Partisë Radikale, ndërsa pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1923, kjo organizatë ishte e orientuar në mbrojtje të partive opozitare, të cilat u angazhuan për rregullimin federativ të shtetit, që ishte njëra nga arsyet që aparatura shtetërore serbe në Beograd të ndërmerre masa ndëshkuese ndaj kësaj organizate politike, që ishte shumë qartë e theksuar me rrënimin e xhamisë Burmal, burgosjen e kryetarit të Xheminetit, ndërprerjen e botimit të gazetës “Hak” dhe masat represive ndaj aktivistëve të kësaj organizate në zgjedhjet parlamentare të vitit 1925.

Rëndësia historike e politike e Xhemijetit, qëndronte në tendencat e hapura për realizimin e synimeve fetare dhe nacionale të myslimanëve në Mbretërinë e SKS. Por për fat të keq, kjo organizatë shumë pak do të arrijë t'i realizojë qëllimet e saja. Edhe krahas kësaj, Xhemijeti do të mbetet në memorien kolektive të popullit shqipëtar, edhe si një përpjekje solide për afirmimin e tyre politik dhe fetar. Ndërprerja e aktivitetit politik të Xhemijetit, do të jetë goditje e rëndë për tërë popullsinë myslimane në trevat lindore shqiptare, që mbeti pa formuluesin dinjitoz të interesave të saja, diçka që do të shkaktojë thellim të pakënaqësisë së saj ndaj politikave shtetërore të cilat ishin në kundërshtim me të gjitha konventat ndërkombëtare.

Në vend të përfundimit... Një rol të rëndësishëm për jetësimin e programit dhe ngritjen e organizatës politike Xhemijeti, luajti lideri shpirtëror Nexhip Draga, pastaj Fehrat Draga edhe familja Kumbara, të cilët Shkupit ia rikth-

yen peshën politike shqiptare në periudhën më të vështirë të mbijetesës së tij. Programi i Xhemijetit ishte jetësimi i programit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ajo me deputetët e saj në parlamentin e Mbretërisë SKS, përfaqësoi denjësisht interesat e shqiptarëve në këtë shtet, duke kundërshtuar në radhë të parë kolonizimin dhe reformën agrare, si dhe pengimin e shpërnguljes së tyre në Turqi e Shqipëri.

NURIDIN AHMETI

Instituti Albanologjik – Prishtinë

DËMTIMI SISTEMATIK I PRONAVE PRIVATE DHE VAKËFEVE NË SHKUP, SIPAS NJË SHKRESE ZYRTARE TË FERHAT DRAGËS TË VITIT 1935

Me plotë të drejtë thuhet se format e torturimit të shqiptarëve nga pushtetet e caktuara dhe posaçërisht ai serb, “nga Kriza Lindore (1878) e këndej morën përmasa të mëdha në faza të veçanta, të periudhave të zhvillimit politik e kombëtar të shqiptarëve. Këto ndryshime nuk ishin të rastësishme, por të determinuara nga motivet dhe nga qëllimet e caktuara të pushtetit serb”⁴²⁵. Njëra nga format e presionit të shpërnguljes së shqiptarëve nga tokat e tyre stërgjyshorë, ishte edhe reforma agrare. Nga vitit 1918 ky presion nga qarqet e atëhershme serbe u bë edhe më i theksueshëm. Gjatë periudhës në mes dy luftërave botërore, organet e atëhershme serbe, nxjerrin legjislacione specifike dhe si rezultat i kësaj ishte përmbyjsja e gjendjes aktuale pronësorë.

Në këtë rast ne nuk dëshirojmë të futemi në analizë të reformës agrare dhe si erdhi deri te kjo gjendje, sepse për këtë gjë, disa nga studiuesit tanë, me mjaftë kompetencë, tanimë i kanë dhënë informacionet e nevojshme dhe mendimin e tyre për këtë çështje, duke publikuar studime monografike.⁴²⁶

⁴²⁵ Pajazit Nushi, *Determinantet psiko-sociale të gjenocidit të pushtetit serbe ndaj shqiptarëve dhe struktura kognitive e tyre*, në: “Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të pushtetit Serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndej, ASHAK, Prishtinë, 1995, f. 37.

⁴²⁶ Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Pristina, 1981; Milovan Obradović, *Reforma agrare dhe kolonizimi në*

Mirëpo, në këtë kumtesë tonën do të vemi në pah një shkresë tare të Ferhat Dragës⁴²⁷ të vitit 1935 që bënë fjalë për dëmtimin sistematik të pronave private dhe vakëfeve⁴²⁸ në Shkup.

Në vitin 1935 nga ajo çfarë po ndodhte në viset shqiptare, jashtë Shqipërisë politike, konkretisht me pronën e tyre dhe duke parë mjerimin që po u sillte ky trajtim i padrejtë ndaj shqiptarëve, që po u bëhej nga pushteti serb i kohës, pinjolli i njohur familjes Draga, Ferhat Draga, i nis një ankesë zyrtare kryeministrit të atëhershëm të Mbretërisë Serbo–Kroate–Sllovene në emër të myslimane të Jugut dhe e njofton mbi padrejtësitë që po ndodhin në tokat e shqiptarëve në emër të reformës agrare. Shqetësimi i tij përfshin gjithë hapësirat ku jetonin shqiptarë në Mbretërinë SKS. Është për t'u theksuar se kjo ankesë është nënshkruhet edhe nga një pjesëtar i komunitet serb i quajtur Dr. Momçilo Ivaniç. Ne jemi fokusuar vetëm në të dhënat që kanë të bëjnë me Shkupin dhe rrethinën. Që në fillimin e kësaj shkrese nënshkruesit tregojnë se “*me aplikimin e reformës agrare dhe ligjit t'emigrimit prej anes se Gjykates agrare dhe zyrave te këtij*

Kosovë (1918- 1941), (Përktheu nga serbishja Vehap Shita), IH- Prishtinë, 2005; Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë (1918- 1941)*, Ilira, Tiranë, 1992; Jusuf Osmani, *Lënda arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare në Kosovë 1918-1941*, Prishtinë, 1996; Fatmir Sejdiu, *Politika agrare si instrument i shtypjes nacionale në Kosovë*, UP- FJ, Prishtinë, 2011.

⁴²⁷ **Ferhat bej Draga(1880-1944)**. Veprimtar politik për të drejtat e kombëtare të popullit shqiptar në Kosovë, në gjysmën e parë të shek.XX. Më 1919 ndihmoi të vëllanë, Nexhipin, për ngritjen e organizatës legale “Xhemijeti”, bashkëpunoi me Komitetin Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në Shkodër. Më 1921, pas vdekjes së Nexhipit, u bë kryetar i “Xhemijetit”, ishte përfaqësues në parlamentin jugosllav në gjysmën e parë të viteve të 20-ta. Në fillim të viteve të 30-ta, kur rivendos jeta e partive politike në Jugosllavi, ishte aktiv në gjirin e “Komunitetit Fetar Mysliman për Serbinë Jugore”. Më 1935-1938 përmes disa përkujtesave kërkoi liri politike dhe kulturore për shqiptarët, dhe anulimin e shpronësimit agrar e të shpërnguljes së tyre në Turqi. Vdiq në rrethana të paqarta në Kralan të Gjakovës. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 1*, ASHSH. Tiranë, 2008, f. 508.

⁴²⁸ **Vakëf:**(arab)- Pasuri e lënë testament për qëllime bamirësie, nën kushte të veçanta që gjenden në vakëfname. Kjo pasur shfrytëzohet vetëm për destinim të caktuar dhe ajo nuk është në dispozicion të lirë të askujt. Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare(islame, ortodokse, katolike, çifute)*, FSI, Prishtinë, 2010, f. 96.

dikasteri te formueme ne krahinat Jugore t'atdheut tone per manet e atjeshem, si me than gjendje e padurueshme, prandaj kemi lirsin qe kete gjendje te deshprueme, ne pikat ma kryesore, t'ia prashtrojm Zotnis se tij Kryetarit te Keshillit Ministruer, me lutje qe te marr masat sa ma te shpejta per gabimet e bame qe keshtu pa drejtesia te ndreqet"⁴²⁹.

Vendin kryesor në këtë shkresë zënë tokat e Shkupit me rrethinë, duke qartësuar padrejtësinë e pushtetit në dy fusha:

E para – Toka personale private që u merret shkupjanëve. Gjeja më e padrejtë sipas nënshkruesve të kësaj shkrese thuhet të jetë loja më dy dëshmitarë, pa u përfillur dokumentacion që e kanë pronarët. Edhe pse sipas ministrisë së Reformës agrare, ata fshatarë që kanë dokumentacion, tokat e tyre nuk do ta prekën, në fakt ndodhi e kundërta. Edhe ata dëshmitarë, që pushtetarët i zgjidhin vetë, sipas nënshkruesve ishin të dyshimtë, sepse ata ishin njerëzit që i mbrojnë në përgjithësi interesat e pushtetarëve, e jo të pronarëve të vërtetë të tokave. Për këtë, në fund të kësaj Përkujtese kërkohet që për të gjitha ata dëshmitarë që kanë dëshmuar rrejtshëm të dënohen sa më parë : *“Ne vend te kesaj gjyqet kenaqen vetem me deshmimin e thjesht te dy deshmitareve tue mos u besue aspak vërtetimeve te shkresave qe gezojn pronaret e tokave. Çka ma teper ka ndodh, si me Zotin Dushan Jovcici, Kryetarin e Reformes Agrare ne Shkup, ku ky kryetar si Gjykates i nalt del ne korridor dhe thot me ze te nalt: ” Le te vine dy deshmitare, se per ndryshe tokat s’mund t’i grabiten askujt.” Me Nr. 2230 dt. 10/ VI/ 1924, Komisioni i Reformes Agrare ne Shkup ka kufizue 200 hektare toke per Reformen Agrare ne katundin Orizare i Siperin dhe kete kufizim e ka pranuar Zyra e nalte Agrare e Shkupit me shkresen e saj Nr. 3908 dt. 10/II/ 1925. Per kete vendim jane ankue pronaret dhe marredhenje çifliklleku. Keto arsye i ka pranuar Ministria Agrare me Vendimin e*

⁴²⁹ Arkivi i Institutit të Historisë – Tiranë (më tej: AIHT), Fondi (më tej: F), A – VII – 50.

saj Nr. 26296 me dt. 27/VI/1926, ka anulue marrjen e tokave dhe ka urdhnuë kthyenjen e tyre pronareve, kejo toke iu asht marre perseri prej kohe reformes agrare. Te gjitha vertetiemt e dokumen-time me shkrim jan paraqit me kohe prej pronareve te vertet, tashti i ka anulue fakti i deshmis se dy vetave te dyshimit.

Çeshtja e katundit Vizbegov komuna Moravickes i Nenprefektures se Shkupit, ashtu tregon çeltazi veprimet e Zyres Agrare te Shkupit. Ketu Xhafer Ahmet Kumbarexhi ka toke te veten. Ne kohen e saj Zyra Agrare e Shkupit me Nr. 31911 e dt. 23/III/1925 ka vendos qe kejo toke e tij nuk i takon reformes agrare, pse nuk asht pasuni e madhe, as qe nonje here nuk kane egzistue marredhanjet çitliklleku. Kundra këtij vendimi nuk jane ankue ata qe nuk iu dha kjo toke, siç shifet nga certifikata e Ministris se Reformes agrare me Nr. 15. 705 me dt. 21/ 7/ 1923 me 3/ XII/ 1930, toka i asht doreze te zotit, i cili e ka pas mbajt disa vjet. Por Ministrija e Bujqesis me gjith kete ka urdhnuë qe kejo toke te mirret nga i zoti ligjor dhe t'iu epet atyne per përdorim, te cilet nuk kane mundur qe te anko-hen kundra vendimeve t' autoriteteve agare. Mbas kërkinut te kuej u ba kjo, nuk dihet⁴³⁰ – theksohet në këtë shkresë.

Një çështje tjetër që u luajt nga ana e reformës agrare me pronarët e tokave, është edhe ajo e gjoja “kompensimit”, duke ju marrë toka pjellore që vlejné shumë dhe duke i kompensuar me shuma përbuzëse. Në këtë shkresë thuhet:” *Keshtu Z. Emin Jasharit, ish deputet radikal prej Shkupit, ja muar token prej 45 hektare. Kjo toke ndodhet prane Shkupit anes lumit Vardar. Me qene se ne tokat e tij rriten me bollëk njomësirat si: duhan, mak, pamuk etj. Nje hektar shitet per 25– 50.000 dinare. Gjyqi agrare ne Shkup i dha Zotnis tij per te gjithë token vetem 17 dinar. Kjo asht nje shum sa artheqosre aq dhe qesharake. Sidomos asht per te qeshur vendimi i këtij gjykaci te sakt, i cili jep te tilla gjykime. Gjithashtu ka ndodhe edhe me rastin e nje tokes prej 19 hek. E grabitur prej Z. Kemal*

⁴³⁰ AIHT, F. A – VII – 356, fl. 21.

*Osmani, ish deputet prej Shkupit, ne Dushanovac. Nje hek. Toke shitet ketu 70–80mije dinare, por gjyqi agrar i Shkupit i dha zotni per te gjithë token 900 dinare*⁴³¹.

E dyta fushë që ngre shqetësim për Shkupin e rrethinën në këtë shkresë është prona e vakëfit, siç njihet edhe sot. Reforma agrare në Shkup nuk kurseu as tokat që i përkisnin vakëfit, e për të cilin tokë nënshkruesit nga vetë mënyra se si e paraqesin këtu, shprehin edhe një dhimbje, ku theksohet se “*As xhamit myslimane nuk u kursyen prej Reformes Agrare. Me vendimin e Gjykates se nalte agrare te Shkupit ne Nr. 530 hyni ne fuqi vendini i Gjykates agrare Nr. 392, mbas se ciles u grabit pasuria e katundit Zakuqani qe i perket vaku- fit te Mehmet Pashes prej 59 hektar 33 ar dhe 77 copa. Ne kete pasuni ka dhe 5 shtepi brenda ne Shkup, ne vendin e quajtur Qiri- lishani, te marre prej Reformes agare. Per kete pasuni bashk me 8 hek. 41 ar dhe 5 km.2 i-u dha vakufit 15. 251 dinare. Vendimi i Gjyqit Nr. 524 i morri Vakufit Ibni Pajko ne Tahtajlic te Shkupit pasunin prej 6 hek. Dhe i dha vetem 7. 404, 50 dinare. Vendim gjyqi Nr. 622 dt. 5/III/ 1935 i mori vakufit Kasum Gazi bashten me shtepi prej 183 km.2 per 505, 40 dinare. Vendim gjyqi Nr. 621 dt. 5/ 3/ 925 i mori vakufit te Mehmet Pashes bashten e kafë “Prolece” sipërfaqe 1 hek. E 6 ar per shpërblimin dinare 2241, 26. Asgje tjeter nuk duhet te themi per kete reforme agrare se ne te asht lare çdo ide agare dhe çdo mendim reformativ. Me grabitjen e pasunive jane te godituna familjet e vobekta fshatre, sidomos tashti përpara dinini. Tuj thane se fshataret ndodhen ne toke qeveritare, u mueren kete vjet edhe bereqetin. Reforma agrare kete bereqt i-a shet tregtareve spekulate dhe keta u a shesin prape po atyre ka- tundareve me çmime te nalta*”⁴³².

⁴³¹AIHT, F. A – VII – 356, fl. 21.

⁴³²AIHT, F. A – VII – 356, fl. 23.

Shkresa përmbillet duke shkruar, “se per shkak shkurtimit nuk i përmendim te gjitha keqpërdorimet e reformes agrare te cilat jane me qindra dhe me mijra ne çdo krahin te Jugut.

Tuj pas si baze reformen agrare dhe ligjin e emigrimit ne Jugen e atdheut, asht organizue potera dhe bombardimi mbi muhamedanet qofshin prej origjines serbe ose shqiptare. Prandaj eshte e domosdoshme qe ky aplikim te ndalohet dhe per zyrtaret e reformes agrare, kerkojm denim ne qofte se vërtetohet se ata me qellim e kan keqperdore detyren e tyre, si dhe per gjithë ata deshmitare, qe kane dëshmuar si gënjeshtar”⁴³³.

Një ndodhi tjetër që aplikohet nga reforma agrare, e ndoshta ky veprim më së mirë tregon se çfarë masash ishin në gjendje të përdornin pushtetarët serb ndaj shqiptarëve, tregon edhe fakti se, prodhimet e tokës që e kishin punuar, në kohën e vjeljes së tyre, pronarët e vërtet nuk i merrnin, por sipas dokumentit ata ishin të detyruar t’ua “shitnin” njerëzve të caktuar, kryesisht atyre serbë dhe më pas ata ua shitnin më një shumë më të madhe pronarëve nga të cilët e kishin blerë. *“Ish nepunes i plocis Gjylakoviçi, ne pension, bleu prodhimin e Shaqir Xhemalit prej katundit Pirane per 3000 dinare dhëm bas disa diteve po kete prodhim i-a shiti per 59000 dinar. Po keshtu ka fillue dhe ne Nenprefekturen e Shkupit(ka-tundi Studeniçan) grabitjet vazhdojne*”⁴³⁴.

Meqenëse kjo shkresë përmban edhe të dhëna për trevat tjera shqiptarë që ishin nën mbretërinë SKS, mendojmë ta paraqesim në tërësi, ashtu siç e kanë shkruar autorët që kanë venë firmat e tyre, sepse lexuesi më mirë do ta vërejë se format e presionit ndaj shkupjanëve me rrethinë nuk dallonin ndaj atyre të trevave tjera.

⁴³³ AIHT, F. A – VII – 356, fl. 24.

⁴³⁴ AIHT, F. A – VII – 356, fl. 24.

“Zotit Kryeminister

ne BELGRAD

*Me aplikimin e reformes agrare dhe ligjit t’emigrimit prej anes se Gjykates agrare dhe zyrave te këtij dikasteri te formueme ne krahi-
nat Jugore t’atdheut tone per myslimanet e atjeshem, si me than
gjendje e padureshme, prandaj keni lirsin qe kete gjendje te
deshprueme, ne pikat ma kryesore, t’i-a prashtrojm Zotnis se tij
Kryetarit te Keshillit Ministrues, me lutje qe te marr masat sa ma te
shpejta per gabimet e bame qe keshtu pa drejtesia te ndreket.*

E para *asht pa drejtësia e tmerrshme e bame myslimaneve te krahi-
nes jugore, me ane se ciles pergjithesisht u meret pasunije e pa-
tundeshme, edhe pse ato nuk mund te numërohen si pasuni te
medha, edhe pse ne keto vende kur s’kane gene marredhenjet e
vifcilyke. Prej shembellave te pa numurta po numrojm ketu posht
disa raste ne shum katunde te Prizrenit (Zagradaska Hoca), Poslishte,
Zhuri, Pirana, Lahovica, Krajka, Ljubishte etj.), ne te cilat u asht
marr e tana pasunija e te gjithë myslimaneve bujq. As katundet atje
kurr githe myslimanet e atjeshem jane pronare te pasurive te vogla
dhe kryesisht te gjithë rrojne prej bujqesise, sic kan qene edhe gjus-
hat e tyne krejt bujq qysh prej kohave ma te vjetra.*

*Ne qoft se deshirohet sinqerisht dhe perzemersisht t’aplikohet prin-
cipi i reformes agrare, tokat iu përkasin atyne qe e punojn, at-
here keta mysliman duhet te kane te drejten e shenjte dhe te pa-
mohueshme mbi tokat qe punojn dhe qe punuan baballarët e tyne
qysh prej kohe. Akoma edhe kjo: prej ç’ka kane me rrojtur keta
njerez me famijet e veta kur dine vetem mjeshterit e bujqesise, kur
se tashti iu kane marre edhe pllamben e fundit te tokes? A mund te
kuptohen mire interesat shtetnore kur punohet keshtu, kur keta
bujqe qene neneshtetas te qete dhe rregullisht paguajshin taksat
qeveritare dhe tani u eshte ba kejo padrejttesi?*

E dyta padrejtësi gjakasore: Ne baze te cilavet arsye gjyqet agrare dhane mendimet e veta mbi grabitjet e mallnave te patundshme te myslimaneve me qellim qe te zbatohet reforma agrare? Me kete gje as nuk nderohen vendimet e Ministris per reformen agrare, as gjykimet e konfliktit te dhana me vendim te Keshillit te Shtetit, te cilat vendime jane te dhana ne themel te shkresavet plotesisht te vertetueme (tapi etj.). Ne vend te kesaj gjyqet kenaqen vetem me deshmin e thjesht te dy deshmitareve tue mos u besue aspak vërtetimeve te shkresave qe gezojn pronaret e tokave. Çka ma teper ka ndodh, si me Zotin Dushan Jovcici, Kryetarin e Reformes Agrare ne Shkup, ku ky kryetar si Gjykates i nalt del ne korridor dhe thot me ze te nalt: " Le te vine dy deshmitare, se per ndryshe tokat s'mund t'i grabiten askujt." Me Nr. 2230 dt. 10/ VI/ 1924, Komisioni i Reformes Agrare ne Shkup ka kufizue 200 hektare toke per Reformen Agrare ne katundin Orizare i Siperin dhe kete kufizim e ka pranuar Zyra e nalte Agrare e Shkupit me shkresen e saj Nr. 3908 dt. 10/II/ 1925. Per kete vendim jane ankue pronaret dhe marredhenje çifliklleku. Keto arsye i ka pranuar Ministria Agrare me Vendimin e saj Nr. 26296 me dt. 27/VI/1926, ka anulue marrjen e tokave dhe ka urdhnue kthymjen e tyne pronareve> kejo toke iu asht marre perseri prej kohe reformes agrare. Te gjitha vertetimet e dokumentime me shkrim jan paraqit me kohe prej pronareve te vertet, tashti i ka anulue fakti i deshmis se dy vetave te dyshimit. Me Nr. 261 e me vendim gjyqi me dt. 3/I/1935 Gjyqi agrar ka gjykue token e Blagoje Pavloviç nga Kuçevishta. Kejo toke para disa vjet ka qene e ndame per Pavloviçin me vendim te Zyres se Nalt agrare me Nr. 2384 dt. 28/ 7/ 1926. Ky vendim ashta anulue se gjoja nuk asht ma ligjor nga ana e Ministris per Reformen agrare me shkres Nr. 21301 dt. 6/ IV/ 1928, mandej nga ana e këshillit Ministrues me Nr. 28034 dt. 5/ I/ 1931. Edhe pse u vendos prej Kasacionit per punet administrative, kejo toke u asht marre zotuesve ligjore ne baze te dy deshmiateve te naltpermendun, dhe Kryetari i kesaj gjykate ka qene Z. Jovicici cili vet ka dal ne korri-

dor dhe ka therit qe te paraqiten deshmitaret, por thirrjes se tij asnjë nuk i asht lajmerue.

Çeshtja e katundit Vizbegov komuna Moravickes i Nenprefektures se Shkupit, ashtu tregon çeltazi veprimet e Zyres Agrare te Shkupit. Ketu Xhafer Ahmet Kumbarexhi ka toke te veten. Ne kohen e saj Zyra Agrare e Shkupit me Nr. 31911 e dt. 23/III/1925 ka vendos qe kejo toke e tij nuk i takon reformes agrare, pse nuk asht pasuni e madhe, as qe nonje here nuk kane egzistue marredhanjet çifliklleku. Kundra këtij vendimi nuk jane ankue ata qe nuk iu dha kjo toke, siç shifet nga certifikata e Ministris se Reformes agrare me Nr. 15. 705 me dt. 21/ 7/ 1923 me 3/ XII/ 1930, toka i asht doreze te zotit, i cili e ka pas mbajt disa vjet. Por Ministrija e Bujqesis me gjith kete ka urdhnu qe kejo toke te murret nga i zoti ligjor dhe t'iu epet atyne per përdorim, te cilet nuk kane mundur qe te anko—hen kundra vendimeve t' autoriteteve agare. Mbas kërkinut te kuej u ba kjo, nuk dihet.

Mos respektimi i vendimeve te mëparshme kemi edhe rastin e te ndjerit Xhevdet Ajdinagicit, ne Ilixhen e Tharte(Kiselo Ilixha) komuna e Pozhegut prefektura e vjeter Novi— Pazar. Xhevdet Ajdinit ju dha toka, ne te cilen mbronojshin mardhanjet e cifliklleke dhe aj me 1923 fitoj deshmin se pasunija e ti nuk ka te beje me reformen agrare. Por ky besim dhe vendim i maparshem tashti nuk perfillet ma dhe pasunija i grabitet dhe pronaret e ligjshem çvishen prej çdo te drejte mbi kete.

E treta, gjithashtu nje padrejtesi e madhe e bame prej anes se Komisioneve agrare pronareve mysliman, kurr, tuj mos mate korrek—tesisht pasunin, veç e smadhuan dhe e sgjanuan, dhe mandej ia grabit me arsyetime qesharake se po ja zevendesojne me aq toke te tjera sa thone autoritetet agrare.

Keshtu Z. Emin Jasharit, ish deputet radikal prej Shkupit, ja muar token prej 45 hektare. Kjo toke ndodhet prane Shkupit anes lumit

Vardar. Me qene se ne tokat e tij rriten me bollëk njomësirat si: duhan, mak, pamuk etj. Nje hektar shitet per 25– 50.000 dinare. Gjyqi agrare ne Shkup i dha Zotnis tij per te gjithë token vetem 17 dinar dhe 80%(17. 80%). Kjo asht nje shum sa arthkeqosre aq dhe qesharake. Sidomos asht per te qeshur vendimi i këtij gjykaci te sakt, i cili jep te tilla gjykime. Gjithashtu ka ndodhe edhe me rastin e nje tokes prej 19 hek. E grabitur prej Z. Kemal Osmani, ish deputet prej Shkupit, ne Dushanovac. Nje hek. Toke shitet ketu 70–80mije dinare, por gjyqi agrar i Shkupit i dha zotni per te gjithë token 900 dinare.

Me sa qellime te keqija, me sa padrejtësi dhe pa ligje kalohet ketu mbi te drejtat e myslimaneve, rrefën edhe kejo rrethane qe Z. Qemal Osmani ka ne xhep vendimin e Keshillit te Shtetit ku thuhet se ne kete pasuni te tij nuk mund t'aplikohet reforma agrare, pse eshte fort e vogel dhe kurr s'ka qene çifçillek. Kejo deshmi nuk qe njaft per me kënaq gjyqin agrar, dhe pse konfliktet qytetare zgjidhen mbas deshve me shkrim. Ne baze te dy deshmítareve gjyqi agrar kaloi neper te gjitha, nuk e shikoi vendimin e gjyqit te nalte, se morri parasysh vendimin e Keshillit te nalte dhe aq lark shikoi me padrejtesin e tij sa toka ia u kan dhene pronareve te ri t'a livrojn dhe t'a gezojn edhe pse vendimi gjyqësor akoma s'ka marre formen ekzekutive.

Keto te dite u grabitet gjithë pasuria(bahçe, kopshte, vreshta, li-vadhe) mehmet Age Ivkoviçi prej Novi– Pazarit. Kete pasuni e përmenduni e gezon tash 100 vjet. Ne kete pasuni kurr s'kane qene marredhanjet çifçilleku. Ivkoviçi vertet ka pas 20 shtepi çifçileke, por kete pasuni ia morri me kohe Reforma Agrare. Per at pasuni qe i mbeti i përmenduni paguan taksat rregullisht. Ay dhe shtëpia e tij tashti me masat e fundit mbeten me gjishte ne goje, edhe pse Ivkoviçi eshte mysliman pej origjines serbe. Kete gje e theksojm me teper, pse gjyqi agrar ka vendosur qe çdo musliman t'a çdukij si te damshem. Kur se njerëzit perzehen nga shkaku i besimit fës), ateher

kemi ne shekullin e sotshem ate ndjekje te tmerrshme te njoftun ne Histori me eminin ndjekje fetare.

Nuk dime se sa i dhane Ivkoviçit si shpërblim te mallrave te grabitura, por sigurisht s'qe edhe ay ma i lumtur se te tjeret.

Egzistojn me mijra kesi rastesh qe deftojne shpërblime qesharake per ish-pronaret dhe nuk besojm qe asnjë prej ketyne te paguhet seriozisht per tokat qe grabiten.

Nje rase ne Komunen e Ilim-berdit, ne katundin Verbanic. Ketu u maten 14 hek. Tok, kurse ne realitet ishte fort ma pak. Shperblimi vetem 700 dinar. Ne ket vend po sjellim edhe nje shembull prej ka shifet shuma bukur se si gjykatat agrare po na formojne te tjere bejlere e te tjere çifçi.

Nje fare sherbetorit nga Novi- Pazari i-u dha gjithe pasuria e nje muhamedani. Pronari i ri thot te vjetrit: “ Une kam nepunesi, kam rrogen, as di me lavrue as te punoj. Hajde t'a godisin punen se bashku. Ti ke me punue ket toke dhe ke me me dhan hesap per prodhimin e saj”. Dhe keshtu u ba. Sherbetori u ba bej dhe begu sherbetor. Ka mjaft kesi shembella qe sherbetoret ortodokse behen çifçi dhe çifçit mysliman behen sherbetor. Mjafton vetem qe sherbetoret t'i paraqiten Gjykates agrare , dhe menjeher behen bejler.

Kjo menyre aplikimi e reformes agrare s'ka mbet as pa gjak. Qe shembella:

Ne komunen Cerna Aucka, ne katundin Lapushnik, N/ prefektura Podrinska, u-vra Ibrahim Murtezai prej nje t'ardhuri ne pasuni. Ky i ardhur filloi me livrue token e fqinjes se vet Ibrahimut, dhe pse askush s'i kishte dhene te drejte, po as vete Gjykata agare. Kur ibrahini i tha se toka nuk i asht nda atij, i ardhuni qiti pushken dhe e vrau, ne nje menyre qe keshtu kishte me vra cilindo qe kishte guxue me i dale perpra per me e ndaluem. Ne katundin Krusha e Madhe i dhane Kos Simicit 15 hek. Toke pjellore tue lane 15

familje pa toke, pse ajo qe u grabit qe toka me pjellore ne kete qark.

As xhamit myslimane nuk u kursyen prej Reformes Agrare.

Ne Novi- Pazar u mat dhe duhet te ndahet toka e Vakufit haxhet, ku ndodhen e regullume bukur varrezat muhamedane. Populli pyet” po a thue as te vdekurit nuk lehen te qete?” kesaj çudie prej reformes agrare i shtojn ç’fare reforme asht kejo kurse dhe varrezat i damton?

Ne vendin banja ku me banjat t’atjeshme vakuf ndodhet edhe pasuria e patundshme e cila u mat dhe duhet te ndahet. Me sa na dime, ne qarkun qe quhet Mosavski, Manastiri Monasi ka tremije hektare toke. Kete toke kallogjeret kaq keq e punojn sa as Manastiri s’mund te paguaje taksat e veta rregullisht. Pse keyo toka nuk ndahen askujt, kurse katundaret reth e përqark jane te vobekte? Pse as kishe kristiane nuk imerret pasuria? Qe edhe disa shembella te tjera se si vetem xhamit e vakefet myslimane grabiten prej reformes agrare:

Me vendimin e Gjykates se nalte agrare te Shkupit ne Nr. 530 dt. 23/ 4/ 92 hyni ne fuqi vendimi i Gjykates agrare Nr. 392, mbas se ciles u grabit pasuria e katundit Zakuqani qe i perket vakufit te Mehmet Pashes prej 59 hektar 33 ar dhe 77 copa, dhe si shpërblim vakufit i dhane: Si rente prej 1919 deri ne ditën e vendimit 22. 594. 79 dinare. Per toke prej 1919 deri ne ditën e vendimit 48. 964. 50 dinare.

Ne kete pasuni ka dhe 5 shtepi brenda ne Shkup, ne vendin e quajtur Qirilishani, te marre prej Reformes agare. Per kete pasuni bashk me 8 hek. 41 ar dhe 5 km.2 i-u dha vakufit 15. 251 dinare. Vendimi i Gjyqit Nr. 524 i morri Vakufit Ibni Pajko ne Tahtajliç te Shkupit pasunin prej 6 hek. Dhe i dha vetem 7. 404, 50 dinare. Vendim gjyqi Nr. 622 dt. 5/III/ 1935 i mori vakufit Kasum Gazi bashten me shtepi prej 1883 km.2 per 505, 40 dinare. Vendim gjyqi Nr. 621 dt. 5/ 3/ 925 i mori vakufit te Mehmet Pashes bashten e

kafë “Prolece” sipërfaqe 1 hek. E 6 ar per shpërblimin dinare 2241, 26. Asgje tjeter nuk duhet te themi per kete reforme agrare se ne te asht te asht lare çdo ide agare dhe çdo mendim reformativ. Me reforma ndriten ide dhe zbukurohen jetime, nxihen zemra dhe lihen njerez pa buke. Kush kishte me mendue se midis Shkupit ekziston kesi Zyre reformash e cila i fyen çdo njeriut edhe ma te shenjtat ndjenja fetare tuj mos i lene as vakëfet rahat.

Me grabitjen e pasunive jane te godituna familjet e vobekta fshatre, sidomos tashti përpara dimini. Tuj thane se fshataret ndodhen ne toke qeveritare, u mueren kete vjet edhe bereqetin. Reforma agrare kete bereqt i-a shtet tregtareve spekulate dhe keta u a shesin prape po atyre katundareve me çmime te nalta. Keshtu qe Çetniku Gjuro Tripkoviç bleu per 1000 dinare prodhimin e ketyre fshatrave qe vijojne: Ibrahim Veselit, Brg Zejnelit, Halit Ramadanit, Hajrullah Vehap, Qazim Hajrullah, Bislim Ademi, Bajram Ibishi, Halit Mehmedi, Agush Rrahmani dhe Mustafâ Durmishi. Ndersa prej gjith ketyne e bleu per 1000 dinara, ky vetem Bajram Ibishtit i mori 1 700 dinare per prodhimin e tij qe ia shiti.

Dr. Bozhidar Popoviçi, mjek i sigurnit te punëtoreve ka ble per 1000 dinare prodhimin e 10 fshatareve te katundit Krajca: Abedin Osman, Ramadan Selimit, Fetah Rexhepit, Hara Ssyles, Ramadan Umerit, Halili Mahmutit, Xhem Mahmutit, Xhem Shabanit, Ras-hit Kadris, Avdi Demes, dhe Din Bajramit.

Ish nepunes i plocis Gjulakoviçi, ne pension, bleu prodhimin e Shaqir Xhemalit prej katundit Pirane per 3000 dinare dhem bas disa diteve po kete prodhim i-a shiti per 59000 dinar. Petar Gjuriçi, Kontrollor i Finances, bleu prodhimin e Halil Tifes e shoke nga katundi Gjona i N/Prefektures Sharplanines per 1000 dinare, dhe mbas disa ditesh u shiti zotuesve te parshim per 4000 dinare. Gjithashtu asht marr prodhimin ne katundin Maleshove dhe ne te tjera katunde te Nenprefektures Podrines e gjithë toka pjellore e fshatareve te kesaj Nenprefekturë, përveç shtepis dhe kopshteve u grabit per qellime

agrarë 90% e tokave pjelore a 10% t'atyre që japin prodhim. Kejo gjë po kështu ndahet tash dhe në nënprefekturën e Gjilanit, siç kemi marrë vesh deri sot në këte rreth janë marrë 5000 hektarë dhe marrja e tokave është tash vazhduar. Po kështu ka filluar dhe në Nënprefekturën e Shkupit (katundi Studeniçan) grabitjet vazhdojnë.

Thëksojmë sidomos, se për shkak shkurtimit nuk i përmendim të gjitha keqpërdorimet e reformës agrare të cilat janë me qindra dhe me mijra në çdo krahin të Jugut. Tuj pas si baze reformën agrare dhe ligjin e emigrimit në Jugen e atdheut, është organizuar potera dhe bombardimi mbi muhamedanët qofshin prej origjinës serbe ose shqiptare. Prandaj është e domosdoshme që ky aplikim të ndalohej deri sa të hyjë në fuqi ligjet e reja, por të mirë dhe të drejtë, se kështu s'bahen gjë tjetër veç një keqpërdorim të reformës agrare.

Ndalimi i kësaj organizate duhet që t' anulohet dhe çdo vendim e ekzekutim t'asaj deri tash, deri sa të hyjë në fuqi ligjet e reja që i presim t'u kthehen në rregull ato që janë marrë. Gjithë veprimet në baze të këtyre ligjeve për çmime e pasurive të mbrohen prej Komisionit, në të cilën të këte dhe përfaqësues muhamedanë të Jugut. Për prodhimin e marrur prej fshatareve me çmime të ulta, këte prodhim në qoftë se spekulantët nuk e kanë shitur akoma, t'u kthehen fshatareve në gjendje të rregulltë. Për zyrtarët e reformës agrare, kërkojmë denim në qoftë se vërtetohet se ata me qëllim e kanë keqpërdorur detyrën e tyre, si dhe për gjithë ata deshmitarë, që kanë dëshmuar si gënjeshtar.

Më mirënjohje dhe shprehje të nderimeve më të thella...

N'emen të myslimanëve të Jugut

Ferhat Draga d.v.

Dr. Momcilo Ivanic d.v.

"Belgrad,

17 tetor 1935.⁴³⁵

⁴³⁵ AIHT, F. A – VII – 356, fl. 21-24.

Përfundim

Nga sa u tha më sipër kuptojmë, se nga të gjitha vakëfet për të cilët behët fjalë në këtë shkresë, ku përfshinte reforma agrare, vakëfet e Shkupit me rrethinë, ishin më të prekura, në kuptimin e marrjes, konfiskimit të pronës së tyre, pavarësisht se toka vakëfit nuk u la pa u prekur edhe ne rajonet tjera, si ai i Novi Pazarit. Për Ferhat bej Dragën dhe për bashkënkështuesin e këtij dokumenti, me këtë reformë “*zbukurohen jetime, nxihen zemra dhe lihen njerëz pa buke*”. Kurse, sa i përket konfiskimit të pronës së vakëfit ata këtë veprim e cilësojnë se i “*fyen çdo njeriut edhe ma te shenjtat ndjenja fetare tuj mos i lene as vakëfet rahat*”. Për këtë njeri, elementi fetarë por, edhe ai kombëtar ishte shkasi kryesor i largimit të myslimanëve nga pronat e tyre.

Po që se do të flasim me shifra të cilat janë përmendur në këtë Përkujtesë rezulton se janë marrë toka në: *Shkup* – 200 hektarë në Orizare të Poshtme, Emin Jasharit 45 hektarë dhe Kemal Osmanit 19 hektarë që i bije gjithsej 264 hektarë tokë private. Kurse, toka e vakëfit në Shkup dhe rrethinë u mor në: *Vakufin e Mehmet Pashës (në Zakuqan dhe Qirilishan etj)*, 68 hektarë, 80 ari, 77 copa, 5km² dhe 5 shtëpi. *Vakufin Ibni Pajko* (në Tahtalijç), 6 hektarë. *Vakufin Kasum Gazi*, 1883 km², që i bije se gjithsej në Shkup tokë e vakëfit sipas autorëve të kësaj Përkujtese, janë konfiskuar 74 hektarë, 80 ari, 77 copa, 1888 km² dhe 5 shtëpi.

QEMAL MURATI
ITSHKSH – Shkup

POPULLSIA SHQIPTARE E SHKUPIT NË DRITËN E GJUHËS DHE TOPONIMISË SË SAJ NË DISA PUBLIKIME SERBE

(Në periudhën midis dy luftërave botërore)

Toponomastika e Shkupit fatkeqësisht nuk është hulumtuar sa duhet dhe nuk është studiuar me akribi shkencore. Megjithatë, në bazë të disa makrotoponimeve, siç është vetë emri Shkup, Vardar, dhe disa emrave të lokaliteteve të tjera përreth Bardovc, Ginovci, Paligrad, Arbanašnica, Matka, mund të pohohet me vërtetësi se areali i Shkupit paraqet bërthamën e etnikunit shqiptar ku flitej shqipja në të kaluarën, këtu e dy mijë vjet më parë, dhe ku flitet kjo gjuhë edhe sot e kësaj dite.

Emri i sotëm Maqedoni përpara Luftës së Dytë Botërore nuk ekzistonte si i tillë

Në periudhën midis dy luftërave botërore pjesa e Maqedonisë që i përkiste Jugosllavisë quhej zyrtarisht “Stara Srbija” (Serbi e Jugut) apo “Vardarska Banovina” (Banovina e Vardarit). Përpara mbarimit të Luftës II Botërore sllavishtja maqedonase nuk ekzistonte. Gjuha zyrtare dhe ajo që përdorej në arsim ishte serbishtja, kurse dialektet lokale maqedonase konsideroheshin si një serbishte e shtrembëruar. Sllavistët evropianë – të tillë ishin shumë – kishin shprehur mendimin se dialektet sllave maqedonase ishin diçka kalimtare midis serbishtes dhe bullgarishtes, në fonologji më shumë serbe dhe në morfologji më shumë bullgare (Skendi 1980: 61). U shtymë pak në histori për të treguar ç’ishte në thelb visi i quajtur sot Maqedoni

përpara Luftës së Dytë Botërore, kur ky as nuk ekzistonte si shtet dhe maqedonasit e sotëm nuk njiheshin si komb i mëvetësishtëm, por që tani na dalin të jenë maqedonas me prejardhje “antike”. Kurse shqiptarët që gjëllinin në këto hapësira e njiheshin si Arbanasi e Arnauti, i ishin ekspozuar asimilimit të tyre në elementin serb në Jugosllavinë Mbretërore të Mbretit I Aleksandër (Витешки Крал Александар I Ujedinitelj, “Osloboditelj Skoplja e Ju ne Srbije” (Çlirimtar i Shkupit dhe i Serbisë Jugore), siç ndodhi me asimilimin e shqiptarëve ortodoksë të Rekës së Epërme në elementin sllav.

Çështjet shqiptare në disa botime të proveniencës serbe në Maqedoni

Në periudhën midis dy luftërave botërore, gjatë ekzistencës së Jugosllavisë së parë (1918–1941), kur serbët ishin dominues, do të botohen në Shkup në gjuhën serbe një seri publikimesh: revistat periodike prestigjioze “Godišnjak Muzeja Ju ne Srbije” dhe “Glasnik Skopskog Naučnog Drustva” / “Bulletin de la Société scientifique de Skoplje” e Shoqatës “Skopsko Naučno Drustvo” (Société scientifique de Skoplje), si dhe disa botime të tjera monografike, – ku mecen do të ishte Mbreti I Aleksandar, me mëtinin që t’i paraqisnin botës shkencore studime e materiale nga fusha e shkencave shoqërore edhe nga areali i Maqedonisë, natyrisht jo dhe pa një dozë të theksuar ideologjike hegjemoniste panserbe e të paraqitjes së shtrembëruar të historisë së elementit shqiptar, për çfarë dhe ishin themeluar ato publikime.

Te këta dy periodikë, ndër të tjera, do të botohen nga autorë të njohur sllavë si Petar Skok, Dušan Nedeljkovi, Petar S. Jovanovi, etj. edhe studime me interes për çështjen shqiptare nga aspekti i hulumtimeve linguistike, toponomastike, etnografike dhe etnopsikologjike etj., por ku shfaqen edhe teori më bizare për shqiptarët e Shkupit dhe për shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme të cilët paraqiten si “sllavë të shqiptarizuar”. Kurse, në fakt, dihet botërisht që ka ndodhur e kundërta, tek ky komunitet etnik mund të flitet

për “shqiptarë ortodoksë që u bënë sllavë”. Megjithatë, hiq ato interpretime të njëanshme tendencioze, studimet komparative të një grupi dialektesh shqiptare të gegërishtes lindore të luginës së Shkupit dhe të onomastikës së Shkupit, të hartuara sidomos nga ballkanologu i njohur Petar Skok, mbeten me vlerë të qëndrueshme. “Linguisti P. Skok, si romanist dhe ballkanolog që ishte, në leksikun e gjuhës shqipe gjurmonte, kryesisht, ndikimin e latinizmave dhe bëri studime të thelluara mbi toponiminë e Ballkanit. Me peshë është studimi dialektor i tij “Lingvisti ka prou avanja neslovenskog stanovništva Skopske kotline”, të cilit do t’i sillmi me pak fjalë në vijim.

Hulumtime gjuhësore te popullsitë joslave të Luginës së Shkupit

Romanisti i çmuar dhe ballkanologu kroat i Universitetit të Zagrebit, Petar Skok, mu në prapen e shpalljes së luftës italo–jugosllave (1941), do të botojë te “Godišnjak Muzeja Ju ne Srbije” 1/1941 studimin dialektologjik për të folmen shqipe të luginës së Shkupit “Lingvisti ka prou avanja neslovenskog stanovništva Skopske kotline”, në të cilin midis katër kombësive joslave në rrethin e Shkupit (shqiptarët, arumunët, turqit dhe evgjitët) studiohen dialektet shqiptare dhe turke. Skoku e bëri këtë udhëtim kërkimor në këtë region më 1929, dhe sapo kishte publikuar elaboratin për pjesën e toponomastikës, që përmbante edhe shënime interesante për dialektet shqiptare. Punimi i Skokut është shumë i kujdesshëm dhe përmban një material mjaft të pasur, i mbledhur me kujdes dhe i përpunuar me hollësi dhe përgatitje të gjerë albanologjike. Skoku u përpoq të stabilizojë cilat janë vendbanimet thjesht shqiptare, cilat janë ato mikste (sllavo–shqiptare) e cilat janë ato thjesht sllave; tenton të bëjë një klasifikim lingvistik të secilit dialekt shqiptar të regjionit, duke kërkuar të sqarojë ardhjen e shqiptarëve të fshatrave të ndryshme (që ai kujton se janë të vonshme, okupohet me qenien bilingviste e pastaj jep karakteristikat fonetike të dialekteve të rrethit të Shkupit, duke shtuar edhe disa vërejtje interesante mbi leksikun (Tagliavini 1978: 109). Ky punim për rëndësinë që kishte do të përkthehet 37 më vonë në shqip “Hulumtime gjuhësore te popull–

sitë joslave të Luginës së Shkupit” nga Rexhep Ismajli dhe do të botohet në një vëllim të veçantë “Studime gjuhësore” I (Dialektologji) të Institutit Albanologjik të Prishtinës (1978).

Linguisti Petar Skok në punimin e tij të vështruar këtu sipër (1941: 83), si një njohës i mirë i problematikave albanologjike e ballkano-logjike, kur flet për prejardhjen dhe shtrirjen gjeografike të popullsisë shqiptare të luginës së Shkupit, për atë pjesë të ardhur nga Reka e Epërme (disa familje ortodokse të Patishkës, shqiptarët e Mallçishtit, Krushopekut), përveç trajtimit lucid e përgjithësisht shkençor, bën edhe shkarje si të thuash diletante. Ai, duke u mbështetur në terminologjinë e tyre fetare e cila qenka kryesisht sllave, shqiptarët ortodoksë të ardhur nga Reka i paraqet si “serbë të shqiptarizuar”: “Mund të thuhet gati me siguri se këta janë serbë të shqiptarizuar. Nuk mund të hetohet, ndërkaq, nëse ky shqiptarizim u bë këtu apo në Rekë!” Soku flet për “sllavë të shqiptarizuar” e për “arumunë të shqiptarizuar” edhe për shqiptarët e Krushopekut të Shkupit, të ardhur gjithashtu nga Reka, duke u mbështetur vetëm nga emrat e mëhallëve të tyre: Mahalla Torbeshallarve, Krivegozve, Fiçorve, Shishkallarve të këtij vendbanimi. “Emrin Krivegos ata vetë e shpjegojnë si byth shtremët (bythë shtrembër). Ky gallap, si dhe Torbesh, Shishka tregojnë qartë se ndër këta shqiptarë ka sllavë të shqiptarizuar. Fiçor nga ana tjetër është fjalë thjesht arumune. Domethënë “djalosh”. Ndër ta ka prandaj edhe arumunë të shqiptarizuar” (f. 84). Për arsye të ndikimeve të ndryshme fetare e sociokulturore dihet që shqiptarët në sistemin e antroponimisë dhe patronimisë së tyre kanë pësuar ndikime të shumta të huaja sllave, turke etj., prandaj jo te çdo patronim a llagap të kësaj provenience që mbartin ata duhet të flitet për “sllavë të shqiptarizuar”. Gjykimi vetëm mbi bazën e disa elementeve leksikore sllave që kanë hyrë në fjalorin e popullsisë shqiptare të luginës së Shkupit, si dhe te disa llagape të familjeve shqiptare me elemente superstratike sllave, për përkatësinë etnike të kësaj popullsie si “sllavë të shqiptarizuar”, konsiderojmë se janë të pabaza dhe të paargumentuara. Gjykimet e

tilla të P. Skok do të thoshim përkojnë më tepër jo me bindjet core të këtij linguisti të shquar, por me presionet e etatizmit jugosllav të asaj periudhe të Jugosllavisë monarkiste, kur çdo gjë propagandohej si sllave dhe nuk mund të thuhej e vërteta siç ishte, sidomos për elementin shqiptar. Ndryshe nuk ka si të binte Skoku në këto lajthitje krejt të pabaza e joshkencore, kryekreje propagandistike.

Shqiptarët e Shkupit në dritën e toponomastikës së sotme dhe historike

Nga fusha e toponomastikës, që ishte po ashtu një specialitet i tij, P. Skok boton edhe një studim të gjerë Iz toponomastike Ju ne Srbije I. Predeo izmedju Prilepa i Kajmak alana, në “Glasnik Skopskog Naučnog Društva”, XII (Skoplje 933), dhe Iz Toponomastike Ju ne Srbije II. Skopska Kotlina, në “Glasnik Skopskog Nau nog Društva” XV–XVI, 1935–1936. Këto studime me observime të gjera e të thella janë një kontribut i çmuar edhe për çështjen e onomastikës shqiptare të Shkupit me rrethinë dhe jo vetëm, të cilat meritojnë të përkthehen në gjuhën shqipe e të botohen sa më parë qoftë në revistën tonë shkencore “Studime Albanologjike” të ITSHKSH e qoftë si vëllim më vete.

Në hulumtimet e tij në vështrim mbi toponomastikën e luginës së Shkupit, Petar Skok për emrin e qytetit të Shkupit antik do të arrinte në këtë konstatim të tij bindës e të paluajtshëm dhe shumë të rëndësishëm se ku ishte djepi i hershëm i shqiptarëve:

Emri shqip Shkup, i këtij qyteti të ngritur qysh në kohën antike në truallin e Dardanisë para portave të tri grykave – Kaçanikut, Dervenit dhe Matkës, lidhet direkt me emrin e vjetër Scupi, sipas të cilit forma fonetike Shkup tingull për tingull mbulohet me formën latino–dardane Scupi, –orum me ndërrimin e s–së nistore në sh, pra është një kontinuate e drejtpërdrejtë e formës antike të latinitetit ilirik. Skupi (Scupi) i ka takuar sferës së latinitetit ballkanik, që dëshmohet dhe me emrin Justiniana Prima që i dha mbreti ilir Jus–

tiniani, dhe me mungesën e formës greke Justinianopolis. “Në vështrimin e stratigrafisë toponomastike, shqiptarët janë aq më të rëndësishëm sepse kanë ruajtur emrin e vjetër për qytetin e Shkupit saktësisht sipas ligjeve të gjuhës së tyre. Emërtimi i tyre Shkup germë për germë përputhet me formën latine–dardane Scupis dhe assesi nuk mbështetet në formën sllave ose turke. Ky fakt ka rëndësi edhe për çështjen se ku ka qenë vendbanimi më i hershëm i shqiptarëve. Hipoteza e Joklit që ai të ketë qenë Dardania, me këtë konstatim fiton peshë vërtetësie” (Skok 1933: 103).

Në këtë areal, si vendbanim i hershëm tipik i shqiptarëve në periorodën antike, nuk është e rastësishme që në Gorno Solnje (Sollnje e Epërme), fshat që ndodhet në jugperëndim të Shkupit (në anën e pasme të lagjes Vodno dhe fshatit Nerez), në vitin 1930, është gjetur nga Nikola Vuli, në një stelë të shekullit II, një emër i gdhen–dur në gjuhën latine Albanop(oli).

Duke u mbështetur në materialin toponomastik, gjithnjë sipas këtij linguisti të shquar, shqiptarët janë tërhequr nga Dardania në vijën Krujë–Prizren menjëherë pas shpërnguljes së sllavëve në këto hapësira dhe kanë qëndruar atje në shtetin e vjetër serb. Në këtë vijë ata janë kthyer prapë më vonë në kohën turke dhe vetëm te Shkupi kanë kaluar dhe në anën e djathtë të Vardarit.

Toponomastika e sotme dhe historike shqiptarët e Shkupit i gjen në vendbanimin e tyre si rrënjës a ndejtarë së paku qysh nga perioda antike. Këtë e dëshmojnë gjurmët e disa emrave gjeografikë shqip që janë ruajtur nga periodat më të vjetra e deri në ditët e sotme.

Në hetimet e tij rreth toponomastikës së Shkupit, Petar Skok merr në vështrim edhe emrin e lumit Vardar dhe shtron pyetjen: Përse humbi emri i vjetër i këtij lumi Aksios dhe përse u zëvendësua me emrin e ri Vardar, të cilin sllavët e morën nga një mjedis josllav, nga turqit ose përmes manastireve greke? “Emri i lumit Vardar nuk mund të ketë një moshë shumë të vjetër, së paku jo të sllavët, për

shkak se nuk njih metatezën sllave të likuideve”, konstaton Skoku (Skok 1936: 101), që do të jepte ★Vradar, ngjashëm sikurse dhe tek emri i lumit Ardika – Radika ku ka vepruar kjo dukuri. Ç’është e vërteta, sllavët këtë emër e kanë marrë nga një mjedis etnik gjuhësor josllav, veçse këtu mbase jo siç shprehet Skoku me dyshim nga turqit ose nga manastiret greke, por me gjasë nga popullsia vendëse shqiptare.

Toponimia e Shkupit me rrethinë dhe etimologjia

Toponimia e Shkupit me rrethinë është shumëshitesore, ngase në ato hapësira gjeografike kanë gjëllirë grupe të ndryshme etnike: dardane (shqiptare), trakase, romake, sllave, hebreje, turke etj. të cilët kanë lënë gjurmët e tyre edhe në emrat e vendeve. Në këtë areal posaçërisht janë të dukshme edhe gjurmët toponimike shqiptare, të cilat autorët sllavë shpesh janë përpjekur t’i mohojnë, porse ato gjurmë janë aty, të paluajtshme.

P. Skok në hulumtimet e tij rreth toponomastikës së luginës së Shkupit, nuk i sheh shqiptarët si ndejtarë në këto anë, por si një element recent: “Mund të thuhet, si rregull, se Arnautët (shqiptarët – siç i quan ai në atë kohë) të luginës së Shkupit nuk kanë krijuar asnjë emër vendbanimi. Nëse ka gjurmë të gjuhës së tyre në toponomastikë, kjo ka të bëjë vetëm me ara të punuara, me atë që toponomastika gjermane i quan “Flurnamen” (emrat e fushave)”. Një pohim i tillë, të cilin e merr si të mirëqenë edhe ballkanologu maqedonas Petar Ilievski (Ilievski 1988: 508) në përpjekjet e tij për të mohuar gjurmët e vjetra toponimike shqiptare në toponiminë e trullit të Maqedonisë, natyrisht është fare pa mbështetje shkencore. Emri i sotëm Shkup është një nga reliktet e periodës antike që ka mbijetuar vijimisht a pandërprerë në gojën e shqiptarëve, sikurse dhe topikët Sharr, Shtip, Vardar etj. Pra, gjurmët e tilla shqiptare në onomastikonin e Maqedonisë nuk dalin të ruhen vetëm tek emrat e fushave, por dhe tek emrat e tjerë të vendeve, të maleve e të lumnjve më të mëdhenj të periodës antike, si: Scupi: Shkup, Scardus

mons: Sharr, Astibos: Shtip, Drinus: Dri, Drin etj., ku trajtat e sotme të tyre mund të shpjegohen vetëm përmes fonetikës historike të gjuhës shqipe (Çabej 1976: 40).

P. Skok në studimin e tij mbi toponomastikën e Shkupit do t'i sillet edhe etimologjisë së disa topikëve, si: Bader, Nerez, Paligrad, Solnje etj., tek të cilët shih një burim sllav, kurse në fakt dëshmohet se aty kemi të bëjmë me gjurmë shqiptare e jo sllave.

Bade(a)r – vendbanim dardan, te Pçinja, që te Prokopi del me formën Bederiana, që ka reflektuar trajtën e sotme Bade(a)r. Në këtë lokalitet ruhen ende Varret e Vjetra (Varret Llatine), të cilat edhe te popullsia maqedonase njihen me emrin Latinski grobišta, që në përkthim do të thotë varre të vjetra të shqiptarëve. Varreza të tilla ka dhe në Gradmanci (Skok 1933: 118).

Nerez (maq. Nerezi) – fshat në jugperëndim të Shkupit (maq. Dolno i Gorno Nerezi). Në regjistrat turq të shek. XV (1467–1468) e hasim të regjistruar me formën “Nirez” (TD 1971: 441). Vendbanim me emër të njëjtë dhe Nerezi (maq. Нерези) – fshat në komunën e Strugës. Skok në hulumtimet e tij linguistike për rajonin e Shkupi i sillet dhe etimologjisë së emrit të këtij fshati, e që sipas tij fjala Nerez mund të merret si kompozitum negative ne + rez, d.m.th. “tokë e palëvruar, e pakultivuar” (Skok 1927: 278). Natyrisht që një etimologji e tillë është e paargumentuar, mbështetet kryesisht në një përngjasim fonetik të rastit me formën sllave nerez, por nuk ka asnjë bazë shkencore. Në regjistrat osmanë të popullsisë të shek. XV, emrin e këtij fshati e ndeshim të regjistruar me formën Nirz (TD 1976: 184), kurse në po këta regjistra hasim dhe një vendbanim të paubifikuar, në Vilajetin e Shkupit (1452), me formën fshati Nir (TD 1976: 242). Tipi i enrave të këtyre fshatrave në fakt përmban një emër vetjak homonim Nir, që si një antroponim të tillë e hasim dhe tek emri i fshatit Nerovë në rrethinat e Prilepit.

Paligrad – fshat në rrethinat e Shkupit, të cilin Skok (1933: 105) etimologjikisht e shpjegon gabimisht nga sll. palenje, si vend që është çelur duke e djegur. Në fakt, ky topik ruan një emër të vjetër personal të proveniencës shqiptare Pal, dhe elementin tjetër grad me kuptimin locus “vend”, jo të qytetit. Pra vendi i Palit.

Solnje – fshat i cili ndodhet në jugperëndim të Shkupit (në anën e pasme të lagjes Vodno dhe fshatit Nerez), në kreshtën e malit Vodno. Ndahet në Solnje e Epërme (maq. Gorno Solnje) dhe Solnje e Poshtme (Gorno Solnje). Ky lokalitet ka qenë i banuar qysh në periodën romake. Për këtë flet dhe fakti se në vitin 1930 në Sollnjen e Epërme është gjetur një stelë mbivarrore e shek. II, nga Nikola Vulji, me një emër të skalitur në gjuhën latine, Albanop(oli). Ky vendbanim përmendet edhe në dokumentin e mbretit Milutin, në vitin 1300, me emrin Gorni-Smbsoulni (Idrizi 2003: 36). Skok (Skok 1933:107) emrin e këtij topiku Solnje e sheh të ketë dalë nga sll. sol “kripë”. Ky në fakt është një shpjegim krejt i pakripë. Po të rridhte nga një apelativ i tillë sllav, do të ishte Solište, që shqiptarët përdorin për këtë një fjalë të vjetër të tyre gjollë-t. Solnje sigurisht rrjedh nga një emër vetjak homonim.

Shpella e Bozgunit – Në rajonin e Patishkës është dhe Shpella e Bozgunit – shpellë rreth 2 km në veri të fshatit Patishkarekë, në Malin e Thatë, në jug të Shkupit. Në një trajtesë të veçantë me titull Špela Bozguni, Petar S. Jovanović (Jovanović 1928: 197) elementin e parë Shpella e shpjegon si fjalë shqipe, kurse Bozgun thotë se rrjedh nga turqishtja që do të thotë “disfatë në luftë, masakër”. Siç shënon ai, sipas tregimeve popullore, shpella e ka marrë këtë emër ngase aty janë vrarë të gjithë banorët e parë të Patishkarekës të cilët janë fshehur për t’u ikur reprezaljeve të një ushtrie armiqësore.

Emri topik Bozgun nuk ka asnjë lidhje me adjektivin e turq. bozgun “shkatërrim”. Veçse rrjedh nga një emër personal Bozgo, Bozgun, i cili mund ta ketë zbuluar i pari shpellën ose të ketë ndenjur

aty. Një emër i tillë del të përmbahet edhe te topiku Bozovcë – fshat i rrethit të Tetovës; Bazopan (Prilep) e Bazovci (Gorë), nga emri vetjak shqiptar Bozo, Bezo. Një variacion i tij dhe Bozdogan e Bozge, sh. Martini, b. Bozdoganit (Veles). Bozge, b. Blasit (Gostivar, Gashi 1980: 131).

Topikë të tjerë të proveniencës shqiptare në arealin e Shkupit janë dhe: **Bardovc, Matka, Ginovci** – katund, sot i zhdukur (Vasiljevi 1930: 187), rrjedhur nga antropnimet përkatëse Bard (Bardh), Mat, Gin/ Gjijn.

Topikët me burim sllav në nomenklaturën gjeografike shqiptare nuk do të thotë aspak se ato territore që në krye të herës kanë qenë sllave

Toponomastika e Shkupit fatkeqësisht nuk është hulumtuar sa duhet dhe nuk është studiuar me akribi shkencore. Megjithatë, në bazë të disa makrotoponimeve, siç është vetë emri Shkup, Vardar, dhe disa enrave të lokaliteteve të tjera Bardovc, Ginovci, Paligrad, Arbanašnica, Matka, mund të pohohet me vërtetësi se areali i Shkupit paraqet bërthamën e etnikumit shqiptar ku flitej shqipja në të kaluarën, këtu e dy mijë vjet më parë, dhe ku flitet kjo gjuhë edhe sot e kësaj dite.

Siç vë në dukje Cimohovski: “Emrat gjeografikë, në qoftë se lokalizohen me përpikmëri, marrin një rëndësi shumë më të madhe se emrat e personave, kuptohet vetvetiu se tiparet topografike mund të shpjegojnë në njëfarë mënyre shpjegimet e këtyre toponimeve” (Chimochovski 1975: 60). Toponomastika ka edhe ajo shtresat e saj, sikurse gjeologjia që ka shtresat e tokës, stratigrafinë. Stratigrafia në toponomastikë mbështetet në këtë, që gjuhët dhe popujt mund të zhduken në një territor të caktuar, por emrat që u dhanë popujt e zhdukur objekteve gjeografike në territorin përkatës mund të mbesin gjallë te popujt që i zëvendësuan (Skok 1933: 194).

Prania e numrit të konsiderueshëm të toponimeve me burim sllav në hapësirat shqiptare në Ballkan nuk do të thotë aspak se ato terri-tore në krye të herës kanë qenë sllave. Kjo është e kuptueshme, sikurse pohon Sh. Demiraj edhe për në Shqipëri: “Prania e një numri të madh toponimesh sllave në Shqipëri është e shpjegueshme po të mbahen parasysh dy rrethana: së pari të kihet parasysh se viset e banuara nga shqiptarë kanë qenë të pushtuara për një kohë të gjatë nga dy mbretëri sllave; Së dyti, është e ditur që pushtuesit përpiqen të zëvendësojnë toponimet e mëparshme me emërtime nga gjuha e tyre” (Demiraj 1999: 129). Edhe toponimet sllave në truallin e Maqedonisë janë refleks i pushtimeve shumëshkulllore sllave, e jo se ato mund të flasin për një dëshmi tenaciteti (ngulimi) parashqiptar në këto hapësira.

Shënime gjuhësore nga një udhëtim në “Jug të Serbisë”

Në revistën “Glasnik Skopskog Nau nog Društva”, Knjiga II, Skoplje 1927 botohet edhe një punim studimor me njaft interes nga P. Skok “Lingvisti ke beleške s puta po Ju noj Srbiji” (Shënime linguistike nga një udhëtim në jug të Serbisë), në këndvështrimin e studimeve interballkanike (= përzierjet sllave, arumune, shqiptare, greke moderne, turke), nga një udhëtim që u kishte bërë autori kryq e tërthor vendbanimeve Shkup, Prilep, Prilepec, Krushevica, Makovo, Iveni, Skočivir, Vlashke Kolibe e Manastir, në shtator të vitit 1926. Mbi korpusin e një materiali burimor leksikor e onomastik që e kishte qëmtuar vetë nga informatorë të terrenit, Skok bën analiza të hollësishme linguistike për fjalë të leksikut të përgjithshëm e terminologjik dhe për një radhë emrash topografikë, si: për Shkup, Bitolj/ Manastir, Prilep etj., mbi bazën e të cilëve konstaton edhe historinë e atyre fjalëve dhe përkatësinë etnike të popullsisë. Emrin Prilep e nxjerr nga folja sllave lepiti, si një formim metaforik me të cilin shënjohej një terren ose vendbanim që i është mbështetur, “prilepilo”, një tjetri. Emrat e vendeve vështirë është të shpjegohet të kenë dalë nga foljet, pothuajse është e pa-

mundur, si në rastin tonë te Prilep, një topik që gjithsesi do të ketë dalë nga ndonjë emër vetjak homonim.

Skok merr në vështrim edhe emërtimin porta “derë e avllisë”, një fjalë shumë e përhapur në Maqedoni, por thotë se nuk është në gjendje të tregojë kufijt e shtrirjes së saj gjeografike. Sigurisht që kjo fjalë nuk vjen nga latinishtja sepse nuk do të pritej të kishim ruajtjen e një –or–, kurse vllëhtë dihet se nuk kanë jetuar në vendbanime të qëndrueshme prandaj nuk mendon që kjo fjalë të ketë hyrë në maqedonishten nga arumanishtja, e cila më shumë përdor u e sesa poart për derën e dhomës. Nga kjo që u tha, s’mbetet tjetër veçse kjo fjalë të merret si e burimit latin që ka hyrë këndej përmes bizantinëve, ngaqë e ka edhe greqishtja e re – thotë Skok. Sa për gjeografinë e shtrirjes, mund të thuhet që kjo fjalë përdoret edhe në arealin e shqipes së Kërçovës, ku përveçse me kuptimin e vështruar më sipër porta “derë e madhe në avlli”, del të përdoret dhe si topik Porta – për një shteg mali që është si derë kalimi në Tuhin të Kërçovës. Pra kjo fjalë jo domosdoshmërisht do të ketë depërtuar në maqedonishten dhe në shqipen nga greqishtja e re.

Nga terminologjia pastorale sllave, në shënimet e terrenit në folmen e Prilepit, Skoku kishte regjistruar edhe emërtimet “crnobarza” e “sivobarza” = dele me ngjyrë të përzier, të zezë e të bardhë, ku te pjesa e dytë përmbahet fjala shqipe bardhë “beo”.

Në nomenklaturën toponomastike të rrethinës së Prilepit Skok shënon edhe emrin e njëllor lisi ste aj, kjo nga arum. stejar “lis”. Një leksemë të tillë ne e gjejmë edhe te Shtezha – topik në Serbicë dhe në Shutovë të Kërçovës që ruan gjurmë të elementit vllëh.

Hulumtimet linguistike që kishte ndërmarrë P. Skok në arealin e Maqedonisë (atëherë “Serbisë Jugore”) kishin për qëllim njohjen me themel të karakteristikave të popullsisë të vjetra të Ballkanit: shqiptarëve, cincarëve e grekëve dhe hetimin e raporteve e konfakteve të tyre me popullsitë sllave. Studimi sistematik i këtyre pro-

blematikave promovohej si një projekt për t'ia paraqitur botës shkencore një herë e përgjithmonë “të vërtetën” për përzierjet e popullsive dhe karakterin e vërtetë etnik “në Serbinë Jugore”. Por, në të vërtetë, qëllimet ishin të tjera: të tregohej që të shqiptarët, e në një masë edhe të turqit, ka shumë elemente që janë me origjinë serbe, porse kanë pranuar besimin muhamedan përkatësisht diku dhe atë katolik, e më pas kanë marrë edhe gjuhën e atyre popujve, por këto grupe shqiptare e turke kanë ruajtur në disa vendbanime e krahina edhe shumëçka nga karakteri i tyre i vjetër i pastër etnik serb. Dhe kjo është me rëndësi të veçantë etnike dhe të përgjithshme shkencore – sikurse shprehet Erdeljanovi (Erdeljanovi 1928: 277).

Karakteristikat etnopsikologjike të banorëve të Rekës së Epërme

Mbi bazën e platformës së Jovan Erdeljanovi –it, antropogjeografi serb Dušan Nedeljkovi, profesor i Fakultetit të Letërsisë në Shkup, ndërmori të hartonte dy punime të thelluara studimore për popullsinë e etnoregjonit të Rekës së Epërme: “Mavrovska psihi ka grupa”, “Glasnik Skopskog naucnog drustva”, Skoplje, 1930, dhe “Gornjorekanska etnopsihološka grupa”, “Glasnik Skopskog naucnog drustva”, Skoplje, 1934, ku këtë popullsi e trajton si një rast etnopsikologjik të veçantë dhe përpiket të “provojë” se shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme janë “serbë të shqiptarizuar”.

Autori Nedeljkovi, i cili i ka studiuar karakteristikat etnopsikologjike të banorëve të Rekës së Epërme, si një veçori të tyre karakteristike thotë se ata me lehtësi i kanë mësuar gjuhët. Të gjithë meshkujt janë bilingë – flasin njëllë shqip dhe serbisht; pastaj, duke shkuar në kurbet, gati të gjithë të rriturit dinë së paku tri gjuhë. Disa nga ta dinë nga pesë deri shtatë gjuhë, zakonisht serbisht (të folurën e Mavrovës), shqip, greqisht, rumanisht, frëngjisht, anglisht (shqiptimin amerikan). Gjithnjë sipas këtij autori, banorët e Rekës së Epërme në pjesën dërmuese janë serbë (somatikë) – në pikëpamje etnopsikologjike disa janë me prejardhje arumunë (shumica e familjeve në Kiçincë, Beliçicë, Vollkovi e Vërben), disa malazias (në

Bogdë, Krakornicë e Niçpur), disa me prejardhje grekë (me siguri në Grekaj), disa me prejardhje shqiptare (si shumica në Tanushë, Nivishtë dhe Bibaj), disa turq (në Vërben) etj. Pra Nedeljkovi nuk i sheh fshatrat e pastra shqiptare si ato që i përmend B. Vidoeski tri decaie më vonë (1968): Nivishta, Zhuzhnja, Vërbjani, Tanusha dhe Grekaj. Ndërkaq për fshatin Grekaj pohon të jetë i banuar me siguri me grekë, për shkak të emrit homonim që i asocion atij me “grek”, paçka se këtu nuk ka pasur asnjë grek, por të gjithë kanë qenë shqiptarë. Ç’është e vërteta, në pikëpamje të formimit të topikut Grekaj, ky në thelb rrjedh nga një emër vetjak Gregorius të proveniencës romane, përshtatur sipas fonetikës së shqipes në Grek–aj, me desonorizim të g–së në k dhe me prapashtesën –aj.

Me këto karakteristika, në pikëpamje etnopsikologjike, nënvijëzon Nedeljkovi – këta diferencohen plotësisht nga torbeshët e Rekës së Poshtme, të cilët nuk mund të mësojnë asnjë gjuhë tjetër përveç të folmen e tyre amtare serbe, kështu që rrallë mund të gjesht ndonjë torbesh i cili do të dinte gjuhë të huaj. Për faktin që banorët e Rekës së Poshtme në pikëpamje etnopsikologjike janë më të pazhvilluar, atëherë për këtë autor është e qartë “pse ata pranuan besimin mysliman, por e ruajtën gjuhën, kurse banorët e Rekës së Epërme pranuan gjuhën shqipe, por e ruajtën besimin e krishterë dhe zakonet popullore serbe”.

Enigmës bezdisëse që ka krijuar vetë ky autor serb: përse njëra palë pranoi bash fenë, kurse pala tjetër bash gjuhën, përse të dy grupet nuk e pranuan ose vetëm gjuhën, ose vetëm fenë, ose përse nuk e pranuan të dy grupet edhe gjuhën, edhe fenë – përpiqet ta shpjegojë me mënyrën për t’iu përshtatur rrethanave të reja dhe me aftësitë psikologjike e me strukturën etnopsikologjike të këtyre grupeve të popullsisë.

Ndërkaq, konstatimin e studiuesit pionier të antropogjeografisë, Jovan Cviji (Balkansko poluostrvo, knj. II, 163), kur flet për atë se: “Mavrovastit i bëjnë martesat e përziera vetëm me “shqiptarët or–

todoksë të Rekës së Epërme”, D. Nedeljkoviç në rezymenë e ninit të tij këtë e quan si një lapsus ose lajthitje rastësore, kuptohet për shkak të detyrës misionare të tij për ta paraqitur popullsinë ortodokse të kësaj enklave si “serbë që kanë pranuar gjuhën shqipe”, me anë të dhunës që paskan ushtruar shqiptarët, të cilët janë shpërngulur në këto hapësira para 200 vjetësh, e Maqedoninë si Serbi Jugore (Ju na Srbija). E se çfarë ‘dhune’ e presioni mund të kenë bërë shqiptarët mbi sllavët, kur ata nuk e kanë pasur shtetin e tyre, por jetonin në Jugosllavinë Mbretërore (Kraljevina Jugoslavi-ja), mund ta ilustrojmë me këtë fakt të njohur nga vetë autorët sllavë: “Në gjithë këtë rajon etnik deri para Luftës së Dytë Botërore ka pasur shkolla vetëm në gjuhën serbe, nuk ka pasur asnjë shkollë në gjuhën shqipe” (Mir evska 2009: 54).

Të mos flasim këtu pastaj për periudhën e komunizmit jugosllav, dhe për variantin e tij më rigid sllavomaqedonas, që zbatoi një platformë shtetërore për konvertimin e popullsisë shqiptare në atë sllavomaqedonase në rajonin e Rekës së Epërme e më gjerë. Nga vitet 50 të shek. 20 e këndej nxënësit shqiptarë të Rekës së Epërme detyroheshin me masa administrative shtetërore të ndiqnin shkollën në gjuhën maqedonase, që ta asimilonin njëherë e mirë këtë popullsi. “Shpeshherë takonim në autobus burra dhe gra nga të krahinës së Rekës, të cilët na tregonin se fëmijët e tyre refuzonin të shkonin në shkollë në gjuhën maqedonase dhe qanin kur ktheheshin nga shkolla, sepse thoshin që nuk kuptonin asnjë fjalë nga kjo gjuhë” – më rrëfente prof. Mahmut Hysa nga Dibra, njohës i mirë i rrethanave të tilla të asaj kohe.

Shkupi dhe rrethina e tij: të dhëna historike, etnografike, kulturore

Autori serb Јован Насхи Василеви për Shkupin dhe rrethinën e tij do të botojë një studim monografik “Skoplje i njevoga okolina – историјска, етнографска и културно политичка излагања” (Beograd, 1930), me të dhëna historike, etnografike, kulturore dhe

politike, me interes edhe për gjuhën dhe onomastikën e elementit shqiptar atje.

Është me interes të sjellim këtu disa evidenca të etnologut serb Jovan Haxhi Vasiljevi (Vasiljevi 1930: 314) për shqiptarët e rrethit të Shkupit, për të cilët popullsia sllave ka përdorur emërtimet Arnauti, Arnautashi dhe Pljake. Arnautashët dhe Plakët nuk kanë lejuar të quheshin kështu publikisht. Arnautët janë hidhëruar edhe kur janë quajtur Arnaut. Ata kanë dashur të quhen shqiptar. Dhe, më tepër sesa shqiptar, kanë dashur të quhen agë dhe zotëri. Arnautët e Studeniçanit, me tallje, ata të Moranës i kanë quajtur cigane, edhe pse moranasit me rrënjë janë studeniçanas. Gjithnjë sipas Vasiljevi –it, “Srbe katolike zovu Latinima, retko i papistanima” (“serbët katolikë” i kanë quajtur “llatinë”, e rrallë “papistan”). Në fakt, përcaktimi etnik “Serbë katolikë” është një shpikje e administratës serbe për të mbuluar me këtë emërtim “shqiptarët katolikë” që kanë humbur gjuhën e tyre dhe kanë folur sllavisht. Është e paqartë përse shqiptarët janë quajtur Pljake në gojën e sllavëve. Ndoshta sepse me egzonimin Pljake përdorur për shqiptarët, lidhen dhe një kategori mbiemrash familjarë Plaka, Pljaka, Pljakiç, mbase dhe Blak–u.

Në veprën e Jovan Haxhi Vasiljevi – it për Shkupin dhe rrethinën e tij hasim topikë që dëshmojnë për praninë e vjetër të shqiptarëve në këto anë: **Arbanašnica** – ara, prona të Manastirit Shën Panteleimon (Sv. Panteleimon) në Nerez të Shkupit (Vasiljevi 1930: 423).

Në publikimet serbe midis dy luftërave botërore, të përmendura këtu sipër, problematikat shqiptare të gjuhës, toponimisë dhe etnografisë të arealit të Shkupit dhe të arealeve të tjera të Maqedonisë, janë hetuar për herë të parë nga autorë të njohur serbë dhe sjellin të dhëna me interes. Porse ato i shquan edhe objektiviteti joshkencor në përpjekjet për ta paraqitur elementin shqiptar recent dhe si “serbë të shqiptarizuar” në Maqedoni.

–BIBLIOGRAFIA:

Cimochovski, Vaclav, Pozicioni gjeografik i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoevropiane, Kuvendi i Studimeve Ilire, Tiranë, 1975.

Demiraj, Shaban, Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Shtëpia Botuese “Shkenca”, Tiranë, 1999.

Erdeljanovi, Jovan, Predlog za prou avanje naroda u Ju noj Srbiji, “Glasnik Skopskog naučnog društva”, Skoplje, 1928.

Idrizi, Xhemaludin, Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit. Shkup 2003.

Jovanovi, S. Petar, Špela Bozgun, Glasnik Skopskog Nau nog Društva, Skoplje, 1928.

Mir evska, P. Mirjana, Jazikot, kulturata i nacionalnriot (etni ki) identitet – teoriski razgledi, Kulturata i jazikot, Institut za Makedonski jazik, Skopje, 2009.

Nedeljkovi, Dušan, “Mavrovska psihi ka grupa”, “Glasnik Skopskog naucnog drustva”, Skoplje, 1930.

Nedeljkovi, Dušan, “Gornjorekanska etnopsihološka grupa”, “Glasnik Skopskog naucnog drustva”, Skoplje, 1934.

Skok, P., Lingvisti ke beleške s puta po Ju noj Srbiji, Glasnik Skopskog Nau nog Društva, Knjiga II, Skoplje 1927.

Skendi, Stavro, Studime kulturore ballkanike, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 1980.

Skok, P., Iz toponomastie Ju ne Srbije I. Predeo izmedju Prilepa i Kajmak alana. II, Skopska kotlina, Glasnik Skopskog Nau nog Društva, Knjiga XII To. Skoplje 1933.

Skok, P. Iz Toponomastike Ju ne Srbije II. Skopska Kotlina, Glasnik Skopskog Nau nog Društva XV–XVI. 1935–1936.

Skok, P., A. M. Selišev, Slavjankoe naselenie v Albanii, Sofija, Mak. Nau ni Institut, 1931, Glasnik Skopskog Nau nog Društva XV–XVI. 1935.

Skok, Petar, Etimologijski rje nik hrvatskoga ili srpskoga jezika, Zagreb, 1972

Skok, Petar, Etimologijski rje nik hrvatskoga ili srpskoga jezika, Zagreb, 1973.

Skok, Petar, Hulumtime gjuhësore te popullsitë joslave të Luginës së Shkupit, “Studime gjuhësore” I (Dialektologji), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1978 (Lingvisti ka prou avanja neslovenskog stanovništva Skopske kotline, Godišnjak Muzeja Ju ne Srbije, Skopje, 1/1941).

Tagliavini 1978 = Tagliavini, Carlo, Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore, “Studime gjuhësore” I (Dialektologji), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1978.

Turski dokumenti za istorijata na Makedonskiot narod, Opširen popisen defter Nr. 4/1467–1468/, Skopje, 1971; Opsirni popisni defteri od XV vek. Tom II. Skopje, 1973; Tom III. Skopje, 1976; Tom IV, Skopje, 1978; Opširni popisni defteri od XVI vek za Kustendilski ot sanxhak. Tom V. Kn. VI, Skopje, 1985.

Vasiljevi, Haxhi Jovan, Skoplje i njevoga okolina – istorijska, etnografska i kulturno politička izlaganja, Beograd, 1930.

MIXHAIT POLLOZHANI

Universiteti Shtetëror i Tetovës

SHQIPTARËT DHE TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE MIDIS DY LUFTËRAVE BOTËRORE NË SHKUP

Hapat e para mbi përkujdesjen e trashëgimisë arkeologjike, si një segment i rëndësishëm i jetës së gjithmbarshme shoqërore, në Shkup dhe rrethinën e tij, kanë filluar pikërisht ndërmjet dy luftërave botërore. Duke e marrë parasysh kontekstin kohor tejet turbulent dhe kontrovers, subjekti i kumtesës të titulluar **“Shqiptarët dhe trashëgimia arkeologjike midis dy luftërave botërore në Shkup”** i cili në përgjithësi është rezultat i interpretimeve krahasuese teorike, do të shtjellohet nëpërmjet disa hipotezave bartëse. Nëpërmjet këtyre hipotezave para se gjithash do të trajtohen: zbulimet arkeologjike, rileximi i disa mbishkrimeve, krijimin e institucioneve të para për përkujdesjen e trashëgimisë, qëndrimi i studiuesve (jugosllavë ndaj çështjes ilire dhe shqiptare, si dhe vendin dhe rolin e shqiptarëve në këtë drejtim gjatë asaj periudhe. Kështu, nëpërmjet një qasje të këtillë do të vihet në pah shtrirja e Dardanisë, funksionim i Skupit antik, si dhe rëndësia e mbishkrimit me toponimin Albanopolis i zbuluar në rrethinën e Shkupit

★ ★ ★

Qytetit të Shkupit, duke qenë kërthiza e Ballkanit, historia ia përcaktoi fatin për të funksionuar si kryeqendër nëpër epoka dhe sisteme të ndryshme. Në këtë qytet, aq sa janë gërshtuar traditat, kulturat dhe gjuhët, po aq edhe janë kryqëzuar rrugë, pushtues dhe interesa nga më të ndryshmet. Por megjithatë, shpirtin e Shkupit e mbajtën gjallë ata të cilët (për)jetuan luftëra, pushtime dhe regjime nga më të egrit, duke (mbi)jetuar për dekada, shekuj dhe mileniu—

me me radhë në këtë tokë të bekuar. Ndërkohë që tërmetet dhe fenomenet tjera natyrore që e kanë përfshirë këtë nën–qiell janë rrëfim në vetë!

Në këtë prizëm duhet shikuar edhe mbijetesën e shpirtit shqiptar, i cili përbënë bërthamën më vitale dhe më domethënëse për Shkupin, që nga parahistoria e deri më sot. Por, edhe pse autokton, megjithatë, shqiptarët, jo rrallëherë kanë qenë të nënshtuar dhe të lënë në margjinat e jetës shoqërore të këtij qyteti. Jo pse këtë e kanë dashur shqiptarët, por sepse i atillë ka qenë raporti i forcave, qoftë në suaza të brendshme apo dhe ndërkombëtare. Megjithatë, duhet theksuar faktin që, shqiptarët dhe paraardhësit e tyre iliro–dardanët, në epoka të caktuara patën momente të ndritura.

Por, sidoqoftë, edhe përkrah aq peripecive me të cilat janë përballur shqiptarët, megjithatë, ata nuk i ndalën përpjekjet e vazhdueshme për të mos e tkurrur qenien e tyre akoma më shumë. Pikërisht këto përpjekje janë të shprehura në gjurmët e kulturës materiale, përkatësisht, te trashëgimia arkeologjike. Për të qenë brenda temës së konferencës, kumtesa në fjalë do të pasqyroj një realitet, sa para–doksal po aq edhe real, i cili ka të bëjë me periudhën midis dy luftërave botërore.

Konteksti politik dhe administrativ

Gjysma e parë e shekullit XX e përcaktoi fatin e gjeopolitikës së ardhshme të Shkupit, duke e vënë atë në një kontekst të ri politik dhe administrativo–territorial. Rrethanat të krijuara nga ky realitet i ri administrativ dhe politik, ndikuan drejtpërdrejtë akoma më shumë në eliminimin e komponentit shqiptar nga organizimi i gjithmbarshëm i jetës shoqërore dhe politike të këtij qytet.

Pas luftërave ballkanike (1912–1913), Shkupi bije nën duart e ushtrisë serbe dhe bëhet pjesë e kësaj Mbretërie. Pas Luftës së Parë Botërore (1914–1918) Shkupi vazhdon të mbetet nën Mbretërinë

Serbe – Kroate – Sllovene, e cila më vonë u transformuar në Mbretërinë Jugosllave⁴³⁶. Ashtu që, nga vitit 1929 dhe deri në vitin 1941, Shkupi do të bëhet kryeqendër e Banovinës së Vardarit, e cila përbënte një rajon të veçantë administrativ dhe territorial në kuadër të mbretërisë së lartpërmendur.

Në kontekstin gjeopolitik ndërmjet dy luftërave botërore duhet shikuar edhe hapat e para të ndërmarra nga autoritet e Mbretërisë Jugosllave, në përkujdesjen e trashëgimisë arkeologjike, si një dëshmi për ndriçimin e të kaluarës së Shkupit dhe rrethinës së tij. Duke e marrë parasysh kontekstin historik tejet turbulent dhe kontrovers, subjekti i kumesës në fjalë, i cili më shumë është ndërtimi i krahasimit të trajtimeve teorike dhe i interpretimeve të rezultateve të publikuara, nëpërmjet disa hipotezave do të shtjellojë qenien ilire dhe shqiptare në këtë nën–qiell. Kështu do të ngrihen tezat mbi të cilat do të qëndrojnë argumente të rëndësishëm për pasqyrimin e momenteve domethënëse nga trashëgimia arkeologjike të nën–qiellit të Shkupit.

Themelimi i muzeut të parë

Ngjarjet gjatë dekadës së dytë të shekullit XX të zhvilluara në fushën arsimor ndikuan edhe në planin kulturor të këtij qyteti. Themelimi i Fakultetit Filozofik⁴³⁷ në Shkup në vitin 1920 ka hapur rrugë edhe për themelimin dhe krijimin e institucioneve të ndryshme shkencore edhe kulturore në këtë qytet. Në këtë kontekst duhet shikuar edhe themelimin e muzeut si institucioni i parë për përkujdesjen e trashëgimisë kulture në qytetin e Shkupit. Nuk

⁴³⁶ <http://www.iea.pmf.ukim.edu.mk/EAZ/EAZ> - 2009 Владан Јовановиќ, *Псевдоевропски поглед помеѓу урнатините на истокоот – градот Скопје во југословенската национална политика од 1918 до 1941 година*.

⁴³⁷ https://mk.wikipedia.org/wiki/Филозофски_факултет_-_Скопје_Филозофскиот_факултет_во_Скопје_од_1920_година - проф. Даринка Петреска, *Филозофски факултет – Скопје: Fakulteti Filozofik në shkup është themeluar më 26 dhjetor të vitit 1920 si degë autonome e ndara e Universitetit të Beogradit*.

vonon shumë dhe në vitin 1921 themelohet Shoqata Shkencore e Shkupit, e cila rreth vetes ka grumbulluar studiues dhe specialist të fushave të ndryshme shkencore, dhe do të merrej me publikimin e literaturës nga fusha e historisë dhe etnologjisë.

Këta studiues përveç për themelimin e shoqatës shkencore dhe arkivit të qytetit kontribut të madh kanë dhënë edhe në themelimin e muzeut të parë në Shkup, i cili kishte për qëllim që ti hulumtoi, fotografoi, mbroji dhe të ruaj lokalitetet antike dhe mesjetare. Fillimet e aktivitetit muzeor gjatë asaj periudhe lidhen me themelimin dhe konsolidimin e institucionit të parë për përkujdesjen e trashëgimisë kulturore, i cili fillimisht u mbante emrin Muzeu i Serbisë së Jugut në Shkup. Aktiviteti për themelimin e këtij muzeu pat filluar që nga vitit 1921, fillimisht i themeluar si koleksion privat i ndihmuar financiarisht nga Grujiç, i cili aso kohe e ka mbajtur emrin Muzeu Historiko – Arkeologjik në Shkup. Që më vonë, në vitin 1924, pasi legalizohet ligjërisht, ky institucion edhe financohej nga buxheti shtetëror. Po në këtë vit, këtij muzeu i jepet për shfrytëzim godina e Kurshumli Hanit⁴³⁸, dhe që atëherë dhe deri më sot e kësaj dite aty qëndron lapidariumi i muzeut.

Me kalimin e viteve ky muze bëhet një institucion kompleks të cilit do ti shtohen edhe disa sektorë tjerë, siç janë sektori etnografik, gjeologjik – petrografik dhe zoologjik. Edhe pse sipas vlerësimeve të disa studiuesve detyrë primare i këtij muzeu ka qenë veprimi për qëllimi nacionaliste serbe, megjithatë, falë aksionit gjithëpërfshirës për grumbullimi e artefakteve arkeologjike, në fondin e tij sot ruhen gjetje me vlera dhe rëndësi të madhe shkencore. Vetëm të përmendim numrin e madh të pllakave të gurit me mbishkrime, të cilat kryesisht i përkasin territorit të Dardanisë antike, brenda së

⁴³⁸ Nikola Vulu}, “Skopski muzej”, Ju..na Srbija, Skoplje, 124, br, 44 – 45, sur. 882 – 889; Nismëtar dhe kontribut për krijimin e këtij institucioni ka dhënë dr. Radoslav M. Grujiç, i cili gjatë shëtitjeve përnjohëse nëpër lokalitet të ndryshme të territorit të Maqedonisë (së sotshme) arrin të regjistroi dhe të grumbulloj numër të konsiderueshëm të monumentesh kulturore të rëndësishme.

cilës përfshiheshin pjesë të territorit administrativ të Maqedonisë së sotshme si dhe të Republikës së Kosovës.

Historiku dhe rezultatet i hulumtimeve

Kur jemi këtu duhet theksuar se, krijimi i institucioneve të para për përkujdesjen e trashëgimisë u dha një impuls të ri zbulimeve arkeologjike gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave, jo vetëm për Shkupin, por edhe më gjerë. Trashëgimia e pasur arkeologjike e Shkupit, në mënyrë të vazhdueshme ka tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe udhëpërshkruesve të ndryshëm, tash më shumë se një shekull e gjysmë. Që pastaj, këto hulumtime dhe publikime shkencore u bënë bazë për vënien e themeleve të arkeologjisë bashkëkohore në vend.

Edhe pse kontaktet e studiuesve me këtë terren arkeologjik fillimisht ishin me karakter vizitues, apo shëtitës (rekognoscues ose survejues), ata rezultuan me shënime dhe rezultatet të rëndësishme shkencore. Shënimet e para nga këto studiues të huaj mbi lokalitetet arkeologjike nga ky nën-qiell, që paraqiten akoma më herët, pra që në fillim të gjysmës së dytë e shekulli XIX, ndihmuan dukshëm në ndriçimin e dy momenteve të rëndësishme. Për tu veçuar në këtë drejtim është kontributi i albanologut të shquar gjerman, Johan Georg Hahn (Johann Georg Hahn), i cili në publikimet e tij të botuara në vitin 1868, që dolën si rezultate nga udhë-përshkrimet e tij, që nga Beogradi deri në Selanik, të ndërmarra në vitin 1861, arrin që ta bëjë ndërlidhjen e toponimit antik Skupi me Shkupin⁴³⁹.

Gjithashtu, për tu nënvizuar është edhe kontributi i studiuesit anglez, Artur Xhon Evans (Arthur John Evans), i cili shkon edhe një hap më tej në drejtim të ndriçimit të së vërtetës mbi antikitetin të Shkupit. Gjatë vizitës që ia pat bërë Shkupit në vitin 1883 arrin me

⁴³⁹ Johan Georg Hann, Reise von Belgrad nach Salonik (1861) Wien, 1868,

saktësi që ta përcaktojë vendndodhjen e qytetit antik Skupi⁴⁴⁰ të Dardanisë. Ky studiues, në këtë mënyrë duke regjistruar muret të periudhës romake arriti që ti verifikoi në terren edhe të dhënat që i sjellë Ptolomeu⁴⁴¹ që në shekullin II të. e sonë.

Gjatë kësaj ekspedite Artur Evans ka regjistruar edhe disa fortifiki-me⁴⁴² në rrethinën e Shkupit, ku ndër të tjera një vëmendje të veçantë i ka kushtuar kastelit në fshatin Taor, për të cilin arkeologu Ivan Mikulçiq supozon se aty duhet kërkuar vendlindja e perandorit Justinian. Vendbanimi, Taor është një fshat i vogël, i cili gjendet rreth 17 km në juglindje të qytetit të Shkupit, ndërkaq në veri të tij ndodhet fshati tjetër me emrin, Bader. Ivan Mikulçiq këtë e ka verifikuar me anë të hulumtimeve të tij në terren, duke konstatuar se, te fshati Taor ekziston një kështjellë me katër kulla, e njohur si Tetrapyrq⁴⁴³. Ashtu edhe siç ka shkruar edhe Prokopi, rreth 6 km në lindje të fshatit Taor shtrihet edhe një kastrum skaj-rrugor në fshatin e vogël Bader, gjurmët e të cilit u përkasin shekujve IV – VI.

Duke u nisur nga fakti se Justinana Prima ka qenë edhe seli arkiepiskopike, kurse në aspektin kishtar – juridik edhe trashëgimtare e Mitropolisë së Shkupit, udhëpërshkruesi dhe studiuesi i njohur, Artur. J. Evans⁴⁴⁴, gjatë vizitës së Shkupin dhe rrethinës së tij ka mbështetur edhe me dëshmi materiale nga terreni shënimet e Prokopit, i cili si vendlindje të Justinianit e përmend Taurision (Tauri-

⁴⁴⁰ Artur Evans, *Antiquarian Reserches in Iliricum*, parts III- IV, Supi, Scopia and Skopia and Birthplace of Justinian, *Archaeologia*, Vol. 49, 1, Westminster, 1885, 79-167: Ky është i pari që tha se Skupi ndodhet nën gërmadhat te lokaliteti Zajçev Rid pranë fshatit Bardovci.

⁴⁴¹ Ptol. C. *Ptolomaei Geografiae* (ed. Ch. Myllerus, Vol, 1, Parisiis 1883)

⁴⁴² Artur Evans, *Antiquarian Reserches in Iliricum*, parts III- IV, Supi, Scopia and Skopia and Birthplace of Justinian, *Archaeologia* vol. 49, Westminster, London, 1885, 79-167; Иван Микулчиќ, Скопје со околните тврдини, Скопје 1982, 13

⁴⁴³ Иван Микулчиќ, Скопје, со околните тврдини, Скопје, 1982, 103 - 103

⁴⁴⁴ Artur Evans, *Antiquarian Reserches in Iliricum*, parts III- IV, Supi, Scopia and Skopia and Birthplace of Justinian, *Archaeologia*, Vol. 49, 1, Westminster, 1885, 79-167

sium) që mendohet të jetë fshati Taor. Ndërkaq në Kalanë e pit, Evans ka identifikuar akropolin e qytetit Justinana Prima⁴⁴⁵.

Duhet përkujtuar se hulumtimet e deritanishme kanë dëshmuar që emërtimet Taor dhe Bader nuk kanë prejardhje sllave, atëherë është e kuptueshme që këto toponime të shpjegohen me ekzistimit të popullatës vendase, pra me domethënie iliro – dardane⁴⁴⁶. Ndaj dhe sipas të gjitha analizave studimore rreth antroponimit dhe toponimit Justinian(a) është e nënkuptueshme se në zbërthimin e këtyre toponimeve mund të zbulohet edhe domethënia e vërtetë e toponimeve të lartpërmendura me prejardhje nga antikiteti, Tauresium dhe Bederiana.

Një shënim me interes mbi dardanët sjellë edhe Salih Asim⁴⁴⁷, i cili duke përshkruar historinë e lashtë të Shkupit, ka theksuar: “*Njëherë e një kohë në këto treva jetonin dardanët, madje këtu ishte si të thuash qendra administrative edhe e fiseve dardane që jetonin përrethi*”. Kur flet për qendrën administrative ky autor aludon në qytetin e Shkupit, kurse përdorimi i toponimit Torasium (në vend të Taurision ose Taurisium) mbase fjalën e ka për vendlindejn e Justinianit, i cili edhe pse biri i një bujku, (i lindur në vitin 847), u bë edhe perandori i Bizantit. Autori shton se Justiniai e zhvilloi edhe më shumë qytetin e lindjes, duke e zgjeruar atë dhe duke

⁴⁴⁵ Po aty

⁴⁴⁶ Mixhait Pollozhani, *Materialet e reja arkeologjike dëshmi për Justinian Prima në Kalanë e Shkupit*, Kërkime Historike 4, Shkup, 2011, 37 - 50

⁴⁴⁷ Salih Asim, *Historia e Shkupit*, Shkup, 1911: Ky libër është shkruar me rastin e vizitës së Sulltanit në qytetin e Shkupit në vitin 1908, ndërsa i plotësuar është ribotuar në vitin 1923. Një falënderim i veçant i takon studuesit, Dr. Skënder Hasani, që na ofroi versionin shqip të këtij libri, i cili së shpejti do ta botoi si të veçantë me titull: “*Shkupi ndërmjet dy luftërave botëror*”. Ndërkohë që mbi librin në fjalë mësova nga hsitoriani, Besnik Emini, i cili e prezantoi atë në konferencën shkencore “*Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup ndërmjet dy luftërave botërore*” të organizuar nga ITKSHKSH. Originali është në gjuhën osmane i përkthyer nga osmanologu, Ermal Nurja, studiues në Arkivin e Shtetit në Tiranë. Edhe pse ky libër ka disa gabime të emërtimeve dhe të dhënave, siç është viti i lindjes së Justinianit, megjithatë ato nuk ia zvogëlojnë dot vlerën atij.

ngritur objekte arkitekture dhe i dha emrin Justinania Prima.⁴⁴⁸ Një periudhë të gjatë kohore Shkupi qëndroi nën sundimin romak dhe më pas kaloi nën sundimin sllav, të cilët e quajtën Uskupi ose Uskupija, emër me të cilin quhet edhe sot ky qytet nga ana e sllavëve. Sot në Shkup gjendet një kala që daton nga koha e romakëve, e restauruar më pas nga osmanët, si dhe një han që quhet Kurshunllu (lexo: Kurshumli Han).

Por, një interesim diç më i shtuar por edhe më profesional i arkeologëve mbi të kaluarën e Shkupit, vërehet sidomos gjatë periudhës 1914 – 1945. Këtë e dëshmon edhe ndërmarrja e disa ekspeditave hulumtuese gjatë kësaj periudhë, kur edhe filloi grumbullimi i materialeve arkeologjike dhe materialeve epigrafike nga terreni. Sado që ishin modeste megjithatë janë për tu vlerësuar hulumtimet e arkeologëve: Çiro Truhelka⁴⁴⁹ dhe Radoslav Grujić të realizuara gjatë viteve 1928/1929, kur edhe është zbuluar një vilë me kompleksin termal në para-lagjen perëndimore të qytetit antik Skupi, si dhe një bazilikë paleokristiane te fshati Bardovci.⁴⁵⁰

Por, gërmimet e para arkeologjike të planifikuara janë bërë nga ana e arkeologut serb, Nikolla Vuļić, i cili gjatë viteve 1935 – 1937, ka filluar me zbulimin e teatrit antik⁴⁵¹ të qytetit Skupi, kur edhe janë përcaktuara konturat e shtrirjes së këtij monumenti imponant kulturor. Ekzistimi i teatrit antik në qytetin Skupi, flet për nivelin e

⁴⁴⁸ Po aty

⁴⁴⁹ Jiro Truhelka, arheolo{ke bele{ke iz J. Srbije, GSND, kw. V - 2, Skopje, 1929, 71 - 86

⁴⁵⁰ Shih: Ленче Јованова, *Скupi - Scupi, Colonia Flavia Scupinorum*, водич, Скопје 2008, 28

⁴⁵¹ Никола Вулић, *Римско позориште код Скопља*, Посебна издања САН књ. 39, Београд 1961, 3-33 и сл. I – 56; Shih: Иван Микулчиќ, Скопје со околните тврдини, Скопје 1982, 41 – 42; Иван Микулчиќ, Антички Градови во Македонија, книга 8, МАНУ, Скопје 1999, 140: Sipas Mikulciq, rreth 2000 fragmente të plastikës dekorative nga fasada e skenës së teatrit antik ruhen te lapidariumi në Kurshumli Han në Shkup.

zhvillimit të jetës urbane dhe kulturore të tij si kryeqendër administrative, politike, kishtare dhe kulturore të Dardanisë.

Dëshmitë ilire e dardane në materialin epigrafikë

Me interes shumë të madh shkencor janë edhe të dhënat që i ruajnë brenda tyre materialet epigrafike të grumbulluara nga dhe Nikolla Vuliç, të rilexuara dhe interpretuar nga Anton Fon Premeshtajn (Anton von Premierstein) dhe më vonë edhe nga Borka Dragojeviç – Josifovska, Exhalel Saliu – Dobruna, por edhe studiues tjerë. Të dhënat onomastike ilire që hasen në materialin epigrafikë të shkruar në greqishten e vjetër dhe latinisht, japin argumentet të mjaftueshme mbi konstatimin e dominimit të kulturës autoktone ilire si dhe pozicionimin e këtij etnosi edhe në brendinë e territorit të Republikës së Maqedonisë. Në këtë drejtim duhet shikuar edhe të vërtetën mbi praninë e ilirëve dhe dardanëve në Shkup dhe rrethinën e tij, gjë që ndihmon shumë në përcaktimin e kufirit jugperëndimor të Dardanisë. Tani më është pranuar konstatimi se etnonimi Dardani në kuadër të tërësisë të saj gjeografike ka përfshirë edhe territore të konsiderueshme të pjesës veriore të Republikës së Maqedonisë. Sipas disa gjetjeve epigrafike, të cilat sigurisht që edhe më herët kanë qenë temë trajtimi nga studiues të ndryshëm, duket se kemi të bëjmë me një zonë të veçantë territoriale e cila i përket njësisë politike dhe administrative – Dardania.

Sipas historiografisë botërore Dardania përbënë një trevë etno-gjeografike por edhe administrative dhe politike të veçantë. Fillimisht, nga shekulli IV deri në shekullin I p. e. sonë përbënte Mbretërinë Dardane,. Nga shekulli I p. e. sonë, pasi nënshtrohet nga Perandoria romake, territori i Dardanisë i bashkëngjitet Provincë Mezia Superior. Me riorganizimin e Perandorisë romake nga ana e perandorit Dioklecian, i hiqet Mezisë dhe e shpallë Dardaninë Provincë në vete me kryeqendër Naisus (Nishi i sotshëm). Kurse më vonë, Justiniani I atdheun e tij Dardaninë e ka avancuar administrativisht, duke i dhënë kështu njëherësh vendlindjes së tij

Justiniana Prima (Shkupit të sotshëm) rolin e kryeqendrës politike, administrative dhe kishtare.

Treva e Dardanisë, qoftë sipas studiuesit, Zef Mirdita⁴⁵², por edhe sipas burimeve tjera pothuajse i ka të definuar kufijtë e saj. Dardania gjatë epokës romake lartë-poshtë ka përfshirë një territor relativisht të gjerë⁴⁵³, në veri duke u kufizuar me Moravën Perëndimore, në lindje shtrihej deri në kufirin e sotshëm serbo – bullgar, në perëndim deri te lugina e Drinit të Bardhë dhe lumit Ibër, kurse në jug deri te Billazora antike apo Velesi i sotshëm në Republikën e Maqedonisë.

Si një dëshmi të rrallë duhet shikuar edhe mbishkrimin me toponimin, Albanopolis, i zbuluar në rrethinën e Shkupit. Mbishkrimin e stelës⁴⁵⁴, e cila gjendet e muruar (vendosur) në një çezmë të vjetër, por të braktisur në perëndim të fshatit Gorno Sonje, për herë të parë e ka regjistruar arkeologu serb, Nikolla Vuluç, në vitin 1930, por e ka deshifruar pjesërisht. Dy rreshtat e fundit të mbishkrimit janë identifikuar shumë më vonë, pra gjatë rishikimit të stelës në vitin 1968, ndërkohë që publikimin e tij është bërë akoma më vonë, në vitin 1982 nga studiuesja maqedonase, Borka Dragojeviq – Josifovska⁴⁵⁵. Ky mbishkrim brenda tekstit të tij përmban emra

⁴⁵² Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake*, Rilindja (Redaksia e botimeve), Prishtinë, 1981.

⁴⁵³ Mixhait Pollozhani, *Gjetjet e antroponimit Genthiane në Maqedoninë Veriperëndimore*, Iliria XXXV, Tiranë 2012, 255 – 265: Kontestuese mbetet vetëm ana veriperëndimore e saj, përkatësisht fushëgropa e Pollogut, respektivisht treva Tetovë – Gostivar, nëse është përfshirë në kuadër të provincës të Mezisë së Epërme, respektivisht Dardanisë

⁴⁵⁴ Nikola Vuluc, *Antiki spomenici na {e} zemlje, Spomenik, SAN kw. 71, Beograd, 1931*: Fjala është për stelën (gurë varri) që është gjetur në fshatin Gorno Sonje, i cili ndodhet në jug - perëndim të Shkupit (në anën e pasme të lagjes Vodno dhe fshatit Nerez).

⁴⁵⁵ Borka Dragojević-Josifovska, Borka (1982), *Inscriptions de la Mésie Supérieure, Scupi et la de région de Kumanovo: Centre D'études épigraphiques et numismatiques de la Faculté de Philosophie de L'université de Beograd*, Vol. VI, Beograd, 1982, 135-136

me karakter ilirë, por mbi të gjitha ai na jep dëshminë e parë dhe të vetmen deri më tani me karakter epigrafiq mbi ekzistimin e toponimit Albanopolis⁴⁵⁶.

Por, gjithashtu duhet përkujtuar se, edhe brenda teksteve të mbishkrimeve tjerë janë deshifruar edhe emra dhe të dhëna tjera mbi etnosin ilirë dhe atë dardanë. Përmbajtja e toponimeve dhe antroponimeve të këtyre mbishkrimeve, të cilët, përbëjnë pjesë të pandarë të kulturës materiale e shpirtëror të popullatës së këtyre trevave gjatë antikitetit, jo vetëm që ndriçon praninë e elementit etno – kulturor ilir, por njëkohësisht e vë në spikamë edhe statusin shoqërorë dhe politik të tyre.

Qëndrimi i studiuesve serb ndaj ilirëve

Në vijim do të pasoi interpretimi i qëndrimit shkencor jugosllav, përkatësisht atij serb ndaj çështjes ilire. Duke iu referuar publikimeve të shumta nga fusha e arkeologjisë gjatë periudhës midis dy luftërave botërore, (por edhe më vonë) lirisht mund të thuhet se vërehet një qasje dhe qëndrim pozitiv shkencor i studiuesve jugosllav ndaj çështjes ilire. Këtë konstatim mund ta mbështesim sidomos me publikimin pa censurë të burimeve të shkruara dhe interpretimin të paanshëm të rezultateve të hulumtimeve arkeologjike nga studiuesit serb, kroat, sloven, boshnjak, por më vonë edhe ato maqedonas.

Meqenëse në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore me trashëgiminë arkeologjike të Shkupit dhe rrethinës së tij merreshin kryesisht studiuesit serb, nga distanca e sotshme kohore mund të thuhet se ata ishin edhe bartësit kryesor të mendimit teorik dhe shkencor mbi çështjen ilire në këtë pjesë të Ballkanit. Padyshim që një rol të rëndësishëm në qëndrimin objektiv qoftë në regjistrimin e të dhënave nga terreni, apo edhe në përligjen e autoktonisë së ele-

⁴⁵⁶ Mixhait Pollozhani, Mbishkrimi me toponimin Albanopolis i gjetur në Shkup, Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca - AKTET VI, 4: 447-451, 2013

mentit ilirë ka luajtur arkeologu Nikolla Vuliç⁴⁵⁷. Pothuajse në të gjitha publikimet e tij në periodikun e kohës “Starinar”, revista shkencore e Shoqatës Serbe të Arkeologëve, si dhe nëpër revista tjera të vendit dhe të vendeve tjera, publikimet tjera shkencore dhe monografike, del në pah qëndrimi i tij objektiv ndaj çështjes ilire.

Terminologjia adekuate si dhe saktësia e vlerësimeve të këtij studiuesi mbi kulturën e ilirëve si populli më i lashtë në Ballkan, u bënë udhërrëfyes për gjeneratat e ardhshme të arkeologëve, jo vetëm të atyre serb, por edhe për të tjerët. Saktësia e vlerësimeve të tij shkencore tejet objektive mbi kulturën ilire edhe sot e kësaj dite janë aktuale.

Nga kjo që u tha më lartë duket qartë se, fillimisht, studiuesit jugosllavë i kishin përqaftuar metodat e shkollave objektive perëndimore në interpretimin e trashëgimisë arkeologjike të trojeve ilire. Edhe gjenerata e dytë e arkeologëve të hapësirave ish-jugosllave (ku dominuan studiuesit serb) ndër të cilët duhet veçuar: Millutin Garashanin, Draga Garashanin, Branko Gavella, Ajloz Benac, Fa-
nulla Papazogllu, Ivan Mikulçiq, Borka Dragojevic-Josifovska, etj, të cilët e deri diku e vazhduan edhe më tutje kursin objektiv shkencor në studimin e ilire dhe dardane. Këta studiues duke marrë në (ri)interpretim hulumtimet dhe publikimet e studiuesve evropian dhe atyre serb, por edhe duke u mbështetur në rezultatet e hulumtimeve të tyre nëpër lokalitete të shumta, dhe analizat e mbishkrimeve të shumtë kanë dhënë kontribut të madh në identifikimin dhe diferencimin e elementit ilirë përballë kulturave tjera të cilët hasen në këtë rajon.

Megjithatë, këto dy apo tre dekadat e fundit, nga ana e disa studiuesve (por jo nga të gjithë) ka përpjekje për t’iu shmang këtij kursi shkencor. Në këtë vazhdë duhet shikuar edhe ligjëratat e disa anëtarëve të Akademisë Serbe, të cilët duke shfrytëzuar dhe trajtuar të

⁴⁵⁷ Nikolla Vuliç ka studiuar arkeologjinë në Universitetin e Mynihut në Gjermani.

dhënat nga fusha e arkeologjisë, linguistikës dhe historisë që rezultoi edhe me një publikim, dolën me qëndrime që në një farë mase e problematizojnë formimin e etnosit ilirë dhe procesin e kalimit të tyre në shqiptarë⁴⁵⁸. Nga ky cikël i ligjëratave akademikët serb rreth tre dekada më parë dolën me konstatimin se nuk mund të kontestohet fakti “...se, *ilirët janë paraardhësit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve...*”, por ata parashtrojnë edhe disa dilema në lidhje me të vërtetën e ilirëve dhe shqiptarëve. Në të vërtetë, nga këto akademik, kontestohet deri diku territori i shtrirjes së ilirëve në periudha parahistorike dhe historike, sidomos lidhja e dardanëve me ilirët, si dhe niveli i vetëdijes së ilirëve për ruajtjen e atij uniteti brenda tyre si tërësi etnike.

Po shqiptarët, ku janë?

Dhe në këtë kontekst, duhet kërkuar njëherësh edhe vendi dhe roli i shqiptarëve në relacion me trashëgiminë arkeologjike gjatë kësaj periudhe. Por, domosdo, shtrohet pyetja se, ku janë shqiptarët në këtë rrëfim? Në të vërtetë, vendi dhe roli i shqiptarëve në fushën e trashëgimisë arkeologjike të Shkupit, ndërmjet dy luftërave në Shkup, duket që ka qenë i njëjtë me gjendjen që ndodhën sot, pra, të përjashtuar nga e drejta për tu përkujdesur mbi trashëgiminë arkeologjike⁴⁵⁹.

Por, sidoqoftë, duhet ri-konfirmuar konstatimin se megjithatë shqiptarët dhe ilirët duhet kërkuar brenda këtij rrëfimi. Por, shqiptarët asokohe nuk kishin mundësi për të qenë faktor aktiv në përkujdesjen ndaj trashëgimisë arkeologjike që u kishin lënë të parët

⁴⁵⁸ Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, *Iliri i Albanci*, Naučni skupovi, kwiga XXXIX, Beograd, 1988: Milutin Garashanin, *Krijimi dhe prejardhja e ilirëve*; Fanulla Papazoglu, *Mbretëria Ilire dhe Dardane*; Vlladislav Popoviç, *Shqipëria në antikitetin e vonë*; Bozhidar Ferijançiç, *Shqiptarët në burimet bizantine*; Sima Çirkoviç, *Shqiptarët në pasqyrën e burimeve të sllavëve të jugut*.

⁴⁵⁹ Aktualisht nëpër institucionet që përkujdesen për trashëgiminë arkeologjike ka të punësuar vetëm dy arkeolog shqiptarë, një në Muzeun e Tetovës dhe një tjetër në Muzeun Arkeologjik të Maqedonisë, por si ciceron.

e tyre. Kjo ndodhte për shkak të politikave diskriminuese të regjimeve jugosllave në planin e arsimimit, ashtu si edhe në fushat tjera, jo vetëm që ishin privuar nga e drejta për t'u marr me trashëgiminë e tyre, por në mungesë të kuadrit të specializuar ata as nuk ishin në gjendje që të merreshin me këtë çështje.

Prandaj, është koha që studiuesit tanë në rrafshin mbarëkombëtarë të ndërmarrin projekte më serioze studimore për t'i vjelë deri në hollësi dhe për t'i interpretuar me objektivitet dhe akribi shkencore materien që kanë të bëjë me ilirët dhe shqiptarët, jo vetëm në Shkup dhe rrethinën e tij, por edhe në përgjithësi.

*ZEQIRIJA IBRAHIMI**ITSHKSH – Shkup*

KUJTESA HISTORIKE E SHKUPIT PËRMES PLANEVE URBANISTIKE (1914–2014)

Shkupi, si qytet bërthamë që nga koha e neolitit (për herë të parë e përmend Tit Livi në shek. I p.e.s. si Scupi)⁴⁶⁰, gjithnjë ka qenë me interes për të gjithë ata që kanë sunduar me të, që të lënë gjurmët e tyre aty. Dhe, kjo rëndom u ka shkuar për dore. Kur flasim për Shkupin historik, duhet ta themi se Shkupi – siç e njohim sot – u ndërtua në kohën osmane, pra pas vitit 1392. Me gjithë objektet më të hershme (Akuedukti, Kalaja, kisha “Sveti Spas”, lagjet e aty–këtushme, shumica e të cilave e pësuan në tërmetin e vitit 1555, ndërsa aq më shumë u dogjën nga Pikolomini më 1687), qyteti filloi të zhvillohet dhe të marrë pamjen e një qyteti të zgjeruar në këtë pjesë ku është sot, sidomos në anën e djathtë të Vardarit, fill pas vitit 1873, kur u ndërtua për herë të parë stacioni hekurudhor. Nga ajo kohë e këndeje, Shkupi u urbanizua dukshëm: u ndërtuan rrugë me kalldrëme, u zhvillua Çarshia, u bënë hamame, hane, bezistane, xhami, imarete, saraje etj., duke e bërë kështu Shkupin një qytet tipik osman.

Dhe, historia e këtij qyteti do të ishte ndryshe nëse në vitin 1912–13 Perandoria Osmane nuk do t’i humbte këto territore, rrjedhimisht edhe Shkupin. Ky moment shënon kthesën historike të ndërrimit të identiteteve të tij. Pas ikjes së osmanëve, siç dihet, këto territore i pushtuan serbët. Me këtë filloi edhe eksodi masiv i po–

⁴⁶⁰ Millan Mijallković & Katarina Urbanek, Shkupi – bastardi i botës, GOTEN, Shkup, 2011, fq. 43.

pullsisë myslimane (ku shumica ishin shqiptarët) për Turqi, por edhe masakrat e shumta, që historianët i kanë shënuar në detaje.⁴⁶¹

Në këtë mënyrë fillon historia tjetër e Shkupit, që zgjat deri në ditët tona. Autorët e librit “Shkupi bastard i botës”, Mijallkoviç dhe Urbanek, këtë fazë e dallojnë me faktin që qyteti nga Üsküp u bë Skoplje. Në këtë periudhë filloi serbizimi i Shkupit dhe shkatërrimi i identitetit osman në qytet. Kjo bëhej me arsye publike se po bëhej plani i ri urbanistik në Shkup, ndërsa arsyeja e vërtetë ishte se pushteti serb dëshironte që t’i hakmerrej Perandorisë Osmane dhe t’i fshinte gjurmët e saj në këtë qytet. Historia tjetër e Shkupit vazhdon gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur edhe bullgarët vepruan ngjashëm si serbët – duke e bullgarizuar me përmendore bullgare, vijon më vonë me Shkupin e RSFJ-së, që veçmas ishte e hovshme pas tërmetit të vitit 1963, kur – me planin e ri urbanistik të hartuar nga arkitekti japonez Kenzo Tange – Shkupi mori pamjen e një qyteti urban me elemente soc-realiste. Ky projekt zgjati diku deri në fillim të viteve të ’80 të shek. të kaluar.

Por, asgjë nuk përfundon këtu. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe krijimit të Maqedonisë, janë bërë po ashtu një varg ndërhyrjesh në identitetin e Shkupit (sa për ilustrim e kemi Urën e Gurit dhe mirababin e saj, të cilave iu ndryshua pamja, si edhe kryqi mbi Vodno i vendosur në vitin 2002), ndërsa vulën e identitetit të ri të qytetit po e lë projekti tashmë i famshëm “Skopje 2014”. E theksojmë “Skopje 2014”, sepse ashtu është emri i përveçëm i këtij projekti dhe në raste të këtilla nuk është i drejtë shqipërimi i tij.

⁴⁶¹ Këto ditë (tetor 2015) në Tiranë doli nga shtypi libri “Vdekje dhe dëbim – spastrimi etnik i myslimanëve osmanë, 1821-1922” i autorit amerikan Justin McCarthy, që flet pikërisht për dëbimin masiv të popullsisë myslimane nga Ballkani, por edhe për shfarosjet që i pësoi kjo popullsi gjatë luftërave ballkanike, por edhe më vonë. Sipas tij, vetëm gjatë luftërave të viteve 1912-1922 kishin vdekur më se 3 milionë myslimanë të Ballkanit. Ndërsa dihet se shumica e myslimanëve të Ballkanit kanë qenë shqiptarë.

Shkupi maqedonas dhe ortodoks

Kur i referohemi planit urbanistik të Kenzo Tanges, mund të themi se ideja e tij ishte që vendbanimet e të dyja anëve të Shkupit të lidhen mes vete përmes hapësirave të përbashkëta, që do të ishin objekte tregtare, hapësira argëtuese, sportive, kulturore, parqe etj. Kjo i bie që pjesa përreth Vardarit do të ishte e mbushur me këso elementesh. Dhe, deri diku ky plan u zhvillua – objekti i fundit i kësaj fryme ishte shtëpia e mallrave “Most”, e ndërtuar në vitet e ’80-ta të shek. të kaluar, por pas kësaj Shkupi gjithnjë shkoi duke u ndarë në pjesën “evropiane” – ana e djathtë e Vardarit dhe pjesa “aziatike” – ana e majtë e Vardarit.

Në të vërtetë, në fund të viteve të ’80-ta u hartuan plane që edhe pjesa “aziatike” të “evropianizohet”, duke ndërtuar ndërtesa shumëkatëshe në lagjet shqiptare (siç janë ndërtesat në Jahja Pashë – “Çairçania”), që duke sjellë kolonë nga Maqedonia Lindore, të ndryshonte përbërja demografike edhe në këtë pjesë dhe kështu Shkupi nuk do të kishte më pjesë me shumicë jomaqedonase, por do të bëhej qytet plotësisht maqedonas. Megjithëse planet e tilla ranë me rënien e Jugosllavisë, tash projekti “Skopje 2014” i ka rikthyer në pamje të re dhe me imazh krejt tjetër, por që pashmangshëm shkojnë në atë drejtim. Këtu mund ta ilustrujmë me shembullin e Çarshisë, e cila gjithnjë e më shumë po bëhet pjesë e sheshit të shtrirë “Makedonija” dhe hyrja e saj po bëhet nga “Most”-i, ashtu që tash gjithnjë e më pak ajo i takon pjesës së vjetër të qytetit.

Ndërkaq, kur flasim për projektin “Skopje 2014”, sepse ai tashmë e projekton identitetin e ri të Shkupit, pyetja që na shtrohet është se a është ky një projekt i ri apo është një projekt i kombinuar me projekte më të hershme, që ka synimin e njëjtë. Këtu duhet të theksojmë se ky projekt u iniciua nga qeveria e VMRO-DPMNE-së, që erdhi në pushtet në vitin 2006, por publikisht u prezantua në

shkurt të vitit 2010.⁴⁶² Ai nënkupton ndërtimin e dhjetëra përmen-doreve, shatërvanëve, skulpturave, ndërtesave, por edhe të një kishe. Meqë tashmë një pjesë e këtyre objekteve është realizuar, nga një analizë e thjeshtë mund të shihet se cila është fryma identitare e këtij projekti. Aty ka skulptura të antikitetit, që konsiderohen “ma-qedonase”, si Leka i Madh dhe Filipi i Dytë, pastaj të mesjetës, si Car Samoili e Justiniani, ka figura të kryengritjeve antiosmane, si Nikolla Karev, Pitu Guli, “Gjemixhii”, pastaj të LDB-së, si Meto-dija Antonov Çento etj., por aty nuk gjen asgjë që nuk është ma-qedonase (në kuptimin e sotëm) dhe ortodokse. Madje, edhe përmendoret shqiptare, që janë përcaktuar të jenë aty dhe që ende nuk janë vendosur (Nexhat Agolli, Josif Bageri e Pjetër Bogdani), janë zgjedhur me kujdes që të mos bien ndesh me historinë “ma-qedonase”, madje kujdesi ka shkuar deri aty sa shqiptarët të përfaqësohen me dy figura të krishtera, megjithëse shqiptarët e Ma-qedonisë janë gati 99% myslimanë.

Ndërkaq, kur bëhet fjalë për figurën e Nënës Terezë, që është e lindur në Shkup në një familje shqiptare me shtëpi pikërisht në sheshin e Shkupit, edhe ajo e pëson ngaqë ka qenë shqiptare. Së pari nuk është lejuar që shtëpia e saj të jetë aty ku ka qenë (në hyrje të Qendrës Tregtare të Qytetit). Në vend të kësaj hapësire, një shtëpi muze për të është ndërtuar rrugës për te stacioni i vjetër hekurudhor, ndërsa përmendorja që planifikohet të ndërtohet në shesh, që mendohet të jetë mjaft e lartë, as në të nuk do të shkruhet siç është quajtur vetë ajo – “Gonxhe Bojaxhiu – Nëna Terezë”, pra nuk do të shkruhet në gjuhën shqipe, dhe identiteti i saj do të mbulohet me identitetin e përkatësisë qytetare – “shkupjane”.

“Skopje 2014” – vazhdim i planit serb të vitit 1919

Kundruar kështu, kur e shohim edhe Muzeun e VMRO-së, Tea-trin Popullor Maqedonas (ish teatrin e kohës serbe), Muzeun Ar-

⁴⁶² https://en.wikipedia.org/wiki/Skopje_2014 (tetor 2015)

keologjik, Portën “MAKEDONIJA”, Pallatin e Oficerëve dhe një sërë objektesh të tjera, të gjitha me stilin barok, konstatimi është se identiteti i ri i Shkupit do të jetë antik maqedonas (ndonëse i kontestuar), mesjetar bizantin, detyrimisht antiosman, rikonstruksion i identitetit serb, shumë pak mbetet socialist, por detyrimisht do të jetë identitet ortodoks.

Krejt kjo na asocion në një projekt që edhe më parë është planifikuar në Shkup. Është ky plani urbanistik i Shkupit, i projektuar në vitin 1914, por i shtyrë për shkak të Luftës së Parë Botërore, dhe i miratuar në vitin 1919. Në dokumentin me titull “Zhvillimi i qytetit të Shkupit 1919–1939”, i siguruar nga Arkivi i Qytetit të Shkupit, thuhet: *“Menjëherë pas çlirimit të Shkupit në vitin 1919 është filluar të krijohet plani i situatës të Shkupit, nga ana e Komandës Supreme, ndërsa sipas kërkesës së prerë të Trashëgimtarit të Fronit të atëhershëm, tani Lartmadhëria e Tij Mbreti Aleksandër. Këtë incizim e kanë kryer autoritetet ushtarake me tavolinën e gjeodezisë dhe në bazë të matjes së këtyllë të fituar të Shkupit – sepse qyteti deri atëherë nuk ka pasur asnjë plan – në vitin 1914 është shpallur konkurs për përpilimin e planit të përgjithshëm të rregullimit. Në atë konkurs është pranuar plani i arkitektit Dimitrije Leka. Megjithatë, lufta evropiane e ka prerë punën e filluar bukur për krijimin e parakushteve për zhvillim të drejtë të Shkupit”*.⁴⁶³ Sipas këtij plani, ndërmjet viteve 1922–1927 janë miratuar 1.242 leje ndërtimore, që e përmbushnin detyrimin e këtij plani. Për këtë serbizim të Shkupit flet edhe një raport i konsullit shqiptar, i cili i dërgohet shtetit shqiptar, i cili flet se – përmes ndërtimit të objekteve serbe dhe ndërrimit të identiteti të ri të qyteteve shqiptare – Serbia po e sforcon shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje. Për ndërtimet e reja në Shkup konsulli thekson: *“Kështu veç Qeverisë dhe Mbreti vet tregon një kujdes të madh për këtë qellim. Në kohët e fundit janë ndërtuar në Shkup (Kryevend i Kosovës) kazerna për*

⁴⁶³ Serbizimi i Kosovës, MPJ Arkivi, vitit 1925, dosja 112, fleta 140

*ushtare, shkolla, banja, spitale per malarja, ndertesa per teatra etj. Qeverija po mbledh te gjith jetimat e po i sjell ketu ne Belgrad ku pa dyshim do t'u nepet nji edukate fare serbe. Me 18 te muajit vazhdues, vet Mbreti ka vu ne Shkup gurin e pare te themelit te klubit te rij t'oficeravet. Ceremonia ka kene e madhnueshme per me e krenmtue ket akt qi per keta ka nji randesi historike.*⁴⁶⁴ (Inte-resant është të theksohet se ky raport thotë që shpërngulja e shqip-tarëve në Turqi është e imponuar, pra me dhunë, ngase vetë shteti turk u ka dërguar porosi myslimanëve të Jugosllavisë që mos të shpërngulen nga trojet e tyre.)⁴⁶⁵

Rikonstruksioni i projektit serb

Projekti serb vazhdoi deri në vitin 1941, ndërsa gjatë kësaj kohe u ndërtuan shumë objekte, disa prej të cilave po rikthehen me pro-jektin “Skopje 2014”. Të tilla janë Pallati i Oficerëve (që u ndërtua për lavdinë e ushtrisë serbe, që e pushtoi Shkupin nga osmanët), Teatri Popullor Maqedonas (i filluar në kohën serbe më 1915 dhe i përfunduar më 1927), si dhe kisha “Shën Konstantini dhe Helena”, e ndërtuar në vitet e '30-ta të shek. të kaluar. Gjithë këtë mozaik e plotëson fakti që objektet bëhen në stilin barok, të ideuar qysh në projektin e 1919-tës. Kemi të bëjmë pra me rikthimin e një pjese të planit serb për Shkupin dhe, në anën tjetër, njësoj si qasja serbe, kemi përjashtim të elementit shqiptar dhe mysliman.

Për opinionin shkencor tashmë dihet se objekti më emblematic në Shkup gjatë kohës osmane (kur – si e thamë – Shkupi u bë qytet në plotkuptimin e fjalës) ka qenë xhamia “Burmali”. Ajo është ndërtuar diku në fund të shek. XV (1495) dhe ka qëndruar aty deri në vitin 25, kur pushteti serb – në emër të po atij plani të sipërci-tuar⁴⁶⁶ – e rrënoi që aty ta ndërtojë Pallatin e Oficerëve, kjo si sim-

⁴⁶⁴ Развитаг Града Скопља 1919-1939, Архив на Р. Македонија, Архив на Град Скопје, Градско поглаварство, кутија 236, fq. 125/331-335

⁴⁶⁵ По аты.

⁴⁶⁶ Serbizimi i Kosovës...

bol i ngadhënjimit të ushtrisë serbe ndaj ushtrisë osmane. Rrënimin i xhamisë “Burmali” dhe ndërtimi i Pallatit të Oficerëve mbi të u ngjason shembujve të antikitetit e të mesjetës kur një ushtri e te një tjetër dhe pastaj komandanti fitues ia merrte gruan komandantit humbës. Në këtë mënyrë, serbët pikërisht mbi truallin e simbolit të Shkupit (xhamisë “Burmali”) e ndërtuan simbolin e ushtrisë së tyre. Ajo që është e rëndësishme të thuhet në këtë rast është se edhe projekti “Skopje 2014” e bëri të njëjtin – e rikthen Pallatin e Oficerëve (të rrënuar në tërmetin e Shkupit) – simbolin antiosman dhe antinysliman në Shkup dhe e refuzon vendosjen edhe të një pllake në shenjë kujtimi për xhaminë “Burmali”.

Ashtu siç u gjetën edhe disa shqiptarë/myslimanë për ta nënshkruar proces-verbalin për rrënimin e xhamisë “Burmali”, edhe sot u gjetën plot shqiptarë që ose nuk e kërkuan fare këtë xhami ose që nuk u angazhuan fare që ajo të bëhet ose, madje, me heshtjen e tyre, e miratuan planin e rikonstruksionit të Pallatit serb të Oficerëve mbi themelet e Burmalisë, njësoj si para 95 vjetëve. Dhe, ashtu siç janë të njohur për historinë ata të ’25–tës, edhe këta të kohës sonë do të mbeten të njohur për historinë. Me këtë rast duhet të theksojmë se insistimi për xhaminë “Burmali” nuk duhej të bëhej për shkaqe religjioze (aty mund edhe të mos kryheshin kurrë rite fetare), por vetëm për shkaqe indentitare – vetëm ashtu Shkupi do ta shpërfaqte identitetin e vet të vërtetë si qytet i shumë kulturave, i shumë religjioneve dhe i shumë etnive.

Momenti i dytë i rikonstruksionit është ndërtimi i kishës “Shën Konstantini dhe Helena”. Rikthimi i një kisha të ndërtuar në kohën serbe është po ashtu një dëshmi se “Skopje 2014” e rikthen historinë serbe në Shkup dhe ia vulos qytetit identitetin ortodoks. Në kohën që xhamia “Burmali” nuk lejohet as si pllakë përkujtime, në kohën që as bëhet fjalë për rikthimin e xhamisë “Ibni Pajko” (të rrënuar në vitet e ’30–ta) afër hotelit “Stone Bridge”, në kohën që as që bëhet fjalë për rikthimin e xhamisë “Faik Pasha” (deri në vitin 1989 e ka pasur minaren – gjendej pranë Bankës Po–

pullore), në kohën që as flitet për rikthimin e xhamisë “Jelen pan” (të rrënuar në vitet e ’70-ta – ka qenë në këndin pranë Gjykatës Themelore “Shkupi 2”) dhe, në anën tjetër, me projektin “Skopje 2014”, që – si e thamë – është hallkë e re në projektin serb të vitit 1919, rikthehet kisha ortodokse serbe “Shën Konstantini dhe Helena”, përfundimisht vuloset ngadhënjimi sllav dhe ortodoks mbi shqiptarët dhe mbi myslimanët e Shkupit. Thënë ndryshe, atë që nuk arriti ta përfundojë Mbretëria SKS – ngadhënjimin përfundimtar mbi “turqit” (lexo: myslimanët) – po e përfundon Qeveria “Gruevski” e Maqedonisë, natyrisht e ndihmuar edhe nga shqiptarët si pjesëmarrës në të.

Baroku si rikonstrukcion

Element tjetër i rikthimit të projektit serb të vitit 1919 është edhe rikthimi i stilit barok. “Ristiqeva Pallata”, e ndërtuar para Luftës së Dytë Botërore, por edhe disa shtëpi në rrugën “Ilindenska” që janë krejt të njëjta me barokun e sotëm – po ashtu të ndërtuara në atë kohë, janë sinapsat që e lidhin barokun e projektit të para LDB-së me barokun e projektit “Skopje 2014”. Tash e kemi objektin e Qeverisë, Ministrinë e Drejtësisë, Teatrin Popullor Maqedonas, por edhe thuaja të gjitha objektet e ndërtuara dhe fasadat e ripunuara afër sheshit “Makedonija”, të gjitha me stil baroku dhe të gjitha në frymë të projektimit të vitit 1919⁴⁶⁷.

Shkupi me emër të ri

Pas kësaj, nëse Shkupi i vitit 2010 do të krahasohet me atë që do të jetë në vitin 2016, përfundimisht Mbreti serb Aleksandar mund të flejë rehat se projekti i tij përfundoi dhe Shkupi është “pastruar” nga identiteti shqiptar dhe mysliman.

⁴⁶⁷ Këto ditë (tetor 2015) u përrua meremetimi i fasadës së një shtëpie të ndërtuar në vitin 1929. Kjo vepër është bërë me financa publike në kuadër të projektit “Skopje 2014” (<http://vecer.mk/kultura/na-ilindenska-vraten-prvobitniot-izgled-na-kukja-od-periodot-megju-dvete-svetski-vojni> - 05.10.2015)

Nëse u referohemi autorëve Mijallković dhe Urbanek, të cilët se-cilën periudhë të Shkupit e tipizojnë me emrin e qytetit, si Scupi, Üsküp, Skoplje, Skopje etj., i bie të themi se emri i ri i këtij qyteti tash e tutje do të jetë “Skopje 2014”. Ky është identiteti i Shkupit të ri. Ndërkaq ky identiteti i ri Shkupit është plotësisht ekskluziv, nuk shpreh kurrfarë karakteri multikulturor, multietnik e multireligjioz, madje në shumë segmente – siç e argumentuam më sipër – është edhe antishqiptar dhe antimusliman.

GABRIELA TOPUZOVSKA & LIDIJA GJUROVSKA

Instituti i Historisë Nacionale – Shkup

MORBIDITETI DHE MORTALITETI NË SHKUP DHE RRETHINËN E TIJ MES DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Shkupi, si qendër administrative, ekonomike dhe politike e Maqedonisë së vardarit, në periudhën e përmendur ka qenë në kufijtë tokësorë të Mbretërisë së S.K.S./Jugosllavisë. Në paraqitjen analitike–sintetike të rrethanave sociale–ekonomike në qytetin e Shkupit në periudhën mes dy luftërave botërore, mund të shqyrtohet zhvillimi ekonomik, prosperiteti, ngritjet dhe rëniet e qytetit dhe barorëve të tij, në periudhën kohore të dy dekadave (1918–1941).

Pozita specifike gjeografike i ka mundësuar qytetit të jetë i lidhur me arterien kryesore të komunikacionit të Moravës–Vardarit, e cila i mundëson komunikim të pandërprerë me qendrat tjera të mëdha tregtare dhe kulturore në region.

Pikërisht ky komunikim qytetit me pjesët e tjera të regjionit, migrimi i popullsisë nga mjediset e fshatit në mjediset e qytetit si edhe kushtet e këqija higjienike, kanë mundësuar rritje të transmetimit të sëmundjeve ngjitëse dhe shfaqjes së epidemive të shpeshta, të cilat kanë qenë pjesë përbërëse e përditshmërisë së popullsisë në qytetin e Shkupit dhe rrethinës së tij.

Detyra kryesore e autoriteteve të komunës dhe të qytetit të krijojnë dhe të gjejnë kushte për ruajtjen e shëndetit të mirë të popullsisë me qëllim që të pengohet përhapja e sëmundjeve ngjitëse dhe të zvogëlohen arsyet e morbiditetit dhe mortalitetit.

Artikulli i shqyrton arsyet e morbiditetit⁴⁶⁸ dhe mortalitetit⁴⁶⁹ të popullsisë në Shkup dhe rrethinën e tij dhe jep pasqyrë statistikore për të njëjtat.

★★★★★

Duke e pasur parasysh pozitën specifike gjeografike, sipas strukturës gjeologjike dhe morfologjike si edhe sipas llojlojshmërisë në përbërjen e popullsisë, në të kaluarën, mjedisi i Shkupit ka paraqitur bazë jashtëzakonisht të mirë për shfaqjen, zhvillimin dhe përhapjen e shumë sëmundjeve, për çka flasin edhe studimet e caktuara epi-demiologjike të cilat e përpunojnë atë problematikë.

Në periudhën mes dy luftërave botërore, hapësira qytetëse e Shkupit është shtrirë në të dyja anët e lumit Vardar në sipërfaqe prej 5 km², në të cilën hapësirë kanë jetuar rreth 70.000 banorë, ose sipas dendësisë së popullsisë kjo ka paraqitur 14.000 banorë në 1 km².⁴⁷⁰ Sipas planit të atëhershëm të rregullimit të qytetit, autoritetet e qytetit kanë paraparë që në qytet dhe në zonën përreth të sigurohen kushte jete për 400.000 deri 500.000 banorë.⁴⁷¹ Mundësitë e Shkupit për zhvillim të shpejtë ekonomik dhe ngritja e tij në qendër të madhe, moderne, kulturore-ekonomike, kanë qenë reale për shkak të pozitës së tij specifike e cila ka qenë në qendër të Gadishullit Ballkanik, dhe në vet aksin e komunikacionit transballkanik dhe të Moravës-Vardarit.

⁴⁶⁸ **Morbiditeti** paraqet proporcionin e numrit të personave të sëmurë në një interval të caktuar kohor, zakonisht prej një viti, në raport me numrin e popullatës të e cila është paraqitur sëmundja.

⁴⁶⁹ **Mortaliteti** paraqet proporcionin e numrit të personave të vdekur në një interval të caktuar kohor në raport me numrin e popullatës të e cila është paraqitur sëmundja.

⁴⁷⁰ Алманах Општине града Скопља 1918-1928, Штампарија “Стара Србија”, Скопље 1928, 11.

⁴⁷¹ По ату.

Në vitin 1918, autoritetet e qytetit të Shkupit, janë ballafaquar me sfidën për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të cilat janë shfaqur si pasojë e luftës. Me miratimin e kushtetutës së re të Mbretërisë SKS në vitin 1919, krijohet mundësia për zgjedhje të udhëheqjes së re komunale, e cila është zgjedhur në vitin 1920, me anë të votimit të fshehtë. Në krye të udhëheqjes së komunës, e cila është zgjedhur në vitin 1920, me anë të votimit të fshehtë. Në krye të udhëheqjes së komunës është vënë Kosta Stevanoviq, i cili në mandatin e tij tre-mujor është marrë me zgjidhjen e çështjeve komunale të qytetit.⁴⁷²

Në periudhën prej vitit 1923 deri në vitin 1926 janë bërë përpjekje që të krijohen dhe të përmirësohen kushtet e jetës së qytetarëve të qytetit të Shkupit. Janë ndërmarrë masa dhe aktivitetet për shtruarjen me pllaka të 12 rrugëve të qytetit, është formuar këshilli për ushqyerjen e popullsisë, ujësjellësi komunal dhe centrali elektrik janë dhënë me qira, ndërsa është kthyer taksa e konsumit⁴⁷³ dhe sigurisë publike, mjete me të cilat komuna është dashur të mundësojë zbatim më të lehtë të politikës komunale.

Numri dhe struktura e popullsisë në qytetin e Shkupit

Në fillim të shek. XIX, qyteti i Shkupit është karakterizuar me llojllojshmëri sipas strukturës dhe numrit të popullsisë e cila ka jetuar në të. Numri i popullsisë ka qenë rreth 20.800 banorë, prej të cilëve fesë myslimane i kanë takuar 13.000 banorë dhe 7.000 banorë popullsi e krishterë. Deri në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, numri i popullsisë në Shkup ka filluar të rritet, ndërsa është vërejtur edhe zgjerim i konsiderueshëm i qytetit i cili ka filluar të zgjerohet në anën e djathtë të Vardarit. Në atë periudhë sipas të dhënave statistikore të qytetit, Shkupi ka qenë i populluar me rreth 32000 banorë, prej të cilëve 17000 myslimanë, 14500 të krishterë dhe 800 hebrenj. Pjesëtarët e bashkësisë hebraike janë

⁴⁷² Po aty.

⁴⁷³ Për mallrat e transportuara.

përqendruar në pjesën qendrore, popullsia myslimane është përqendruar në qytetin e vjetër të anës së majtë të lumit Vardar, ndërsa pjesa e re e qytetit e cila është shtrirë në anën e djathtë të lumit Vardar ka qenë e populluar me popullsi të krishterë.

Rritje veçanërisht e madhe të popullsisë në Shkup është vërejtur në fillim të vitit 1921. Atëherë qyteti ka pasur rreth 8525 shtëpi me rreth 41066 banorë, ndërsa në mesin e vitit 1926, në qytet ka pasur afër 9130 shtëpi me afërsisht 69269 banorë. Prej tyre 38.392 kanë qenë pjesëtarë të fesë ortodokse, 1890 popullsi katolike, 26270 popullsi myslimane, 2567 popullsi hebraike dhe 150 persona pjesëtarë të feve të tjera.⁴⁷⁴

Shërbimet shëndetësore në qytet

Në fillim të shek. XX, Shkupi gjithnjë e më tepër ka fituar pamjen e qendrës së madhe dhe të rëndësishme. Udhëheqja e re komunale në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetit Publik, ka ndërmarrë masa dhe aktivitete të caktuara për zbatim të suksesshëm të politikës komunale në qytet. Të gjitha aktivitetet janë zbatuar nëpërmjet dhe me ndihmën e Njesisë Sanitare dhe me institucionet tjera shëndetësore në qytet, qëllimi primar i të cilave ka qenë kujdesi për shëndetin dhe gjendjen shëndetësore të popullsisë.

Njësia Sanitare e qytetit të Shkupit i ka kushtuar kujdes mbajtjes së pastërtisë dhe higjienës në të gjitha pjesët e qytetit (në shtëpitë, tregjet, kanalet ujore, thertoret, punëtoritë për shitjen e prodhimeve ushqimore, në vendet për hedhjen e mbeturinave etj.). Njësia sanitare ka dorëzuar propozime dhe masa për pengimin dhe parandalimin e epidemive dhe sëmundjeve të ndryshme, të cilat kanë qenë dukuri e shpeshtë në atë kohë. Në kuadër të kompetencave të njesisë sanitare ka bërë pjesë edhe analiza bakteriologjike e prod-

⁴⁷⁴ Алманах општине града Скопља, Прошлост, садашњост и будућност града Скопља, Скопље 1928,7.

himeve ushqimore dhe ujit për pije. Kujdes i veçantë i është tuar shëndetit dhe higjienës së popullsisë së varfër, e cila për shkak të shprehive të këqija higjienike dhe kushteve të vështira për banim, ka qenë e manifestuar ndaj sëmundjeve ngjitëse.

Numri i mjekëve është rritur me rritjen e numrit të popullsisë në qytet. Në vitin 1921, në Shkup fillon me punë edhe stacioni i përhershëm bakteriologjik, detyra kryesore e të cilit ka qenë mënjanimi i sëmundjeve ngjitëse, veçanërisht mbrojtja dhe parandalimi i malaries. Vëllimi i punës në stacionin bakteriologjik të Shkupit ka qenë i madh, për çka flasin edhe të dhënat për kryerjen e kontrollimeve ambulatorë në periudhën nga viti 1920 deri në vitin 1928. Në vitet e para të formimit të njësisë sanitare, janë kryer 1.039 kontrole ambulatorë të qytetarëve të varfër, ndërsa në fund të vitit 1927 janë bërë 7982 kontrollime, ose për periudhën prej dhjetë viteve, ambulanca pranë njësisë sanitare ka bërë gjithsejtë 31457 kontrollime të qytetarëve të varfër nga qyteti i Shkupit dhe rrethinës së tij.⁴⁷⁵

Në raport me shpenzimet e bëra për furnizime me ilaçe të cilat kanë qenë të destinuara për shërimin e popullsisë së varfër, gjendja ka qenë si në vijim: në vitin 1919 shpenzimet për ilaçe kanë qenë 189 dinarë, ndërsa në fund të vitit 1927, shpenzimet kanë qenë 86147 dinarë, ose gjithsejtë 385405 dinarë për dhjetë vite. Në atë periudhë, si parandalim ndaj sëmundjeve ngjitëse janë bërë nga 32 deri në 240 dezinfektme në qytet.⁴⁷⁶

Te popullsia e varfër në qytet janë bërë rreth 4502 kontrollime parandaluese për malarien dhe rreth 2728 kontrollime parandaluese për tuberkulozin, ose 38687 kontrollime për periudhën prej dhjetë viteve, që domethënë se mesatarisht ambulanca ka kryer rreth 4000 kontrollime në vit.⁴⁷⁷

⁴⁷⁵ Po aty.

⁴⁷⁶ Po aty.

⁴⁷⁷ Po aty.

Krahas kontrollimeve të popullsisë së varfër, në ambulancën e munës janë kryer kontrollime dhe shërim edhe të nëpunësve munalë. Ambulanca komunale ka organizuar dhe ka kryer min e popullsisë nga fruthi i madh, tifoja dhe fruthi i zi. Për periudhën e atëhershme dhjetëvjeçare janë bërë gjithsejtë 12420 vaksinime, për të gjitha sëmundjet e lartpërmendura bashkërisht, ose: 11627 vaksinime për fruthin e madh, 783 vaksinime për tifon dhe 10 vaksinime për fruthin e zi.⁴⁷⁸

Për popullsinë në qytetin e Shkupit janë kujdesur rreth njëqind mijekë civilë dhe ushtarakë, ka pasur rreth 11 farmaci qyteti dhe tre barnatore, ndërsa gjithashtu janë hapur më shumë ente private dhe shtetërore edhe atë: Ambulanca e Sigurimit të Punëtorëve, Ambulanca Shtetërore te Spitali i Qarkut, Ambulanca Komunale, Ambulanca Komunale, Spitali Ushtarak “Gjysmëhëna” te Ura e Hekurudhore mbi Vardar, Spitali i Qarkut prapa Stacionit Hekurudhor (në drejtim të Vodnos), Sanatoriumi “Vardar” te Idadija, Sanatoriumi “Shkupi” i Dr. Aleksandër Stavridisit dhe Enti Higjienik (Instituti i Sëmundjeve Tropikale) prapa Stacionit Hekurudhor. Një objekt tjetër shumë i njohur shëndetësor në Shkup ka qenë Stacioni Hekurudhor, i cili është gjendur në Idadi, në afërsi të Parkut të Qytetit dhe ka qenë i pajisur në mënyrë solide për atë kohë. Numri i madhe i punëtorëve dhe nëpunësve të Hekurudhave të Shkupit aty kanë marrë shërimin spitalor. Spitali ka disponuar me inventar solid dhe instrumente, si edhe me kuadër autoritar shëndetësor, qëllimi i të cilit ka qenë kujdesi dhe mirëmbajtja e shëndetit të mirë te popullsia.⁴⁷⁹

Edhe krahas ndërmarrjes së masave parandaluese dhe shëruese për mbrojtjen shëndetit të popullsisë, deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore, gjendja shëndetësore te popullsia nuk është përmirësuar shumë. Morbiditeti dhe mortaliteti ende kanë mbetur të larta.

⁴⁷⁸ По аты.

⁴⁷⁹ Живот во Скопје од 1918-1941 година, <http://www.staroskopje.vestel.com.mk>

Sëmundjet ngjitëse janë shfaqur thuajse në të gjitha vendet e Mbretërisë. Arsyet për dukurinë e tillë kanë qenë mirë të njohura, higjiena e keqe në mëhallët ku kanë jetuar por edhe në shtëpitë e popullsisë së varfër, analfabeti i tyre i madh dhe mosarsimimi, ushqyerja e keqe dhe e pamjaftueshme si edhe puna e mundimshme dhe shteruese.⁴⁸⁰

Sëmundjet ngjitëse dhe lufta për pengimin dhe përhapjen e tyre

Vitet mes dy luftërave botërore kanë qenë veçanërisht të vështira për popullsinë maqedonase, për shkak të politikës specifike, pozitën shoqërore dhe sociale. Këto kanë qenë vitet pas copëtimit tokësor të indit etnik maqedonas, me ç'rast mjaft familje dhe pronat e tyre kanë qenë të ndara mes dy ose tre shteteve. Me këtë është zvogëluar edhe mundësia për të jetuar në mënyrë dinjitoze nga bujqësia. Pikërisht kjo ka qenë arsyeja që popullsia e fshatit gjithnjë e më tepër të shpërngulet nëpër qytete. Përzierja e popullsisë së fshatit dhe qytetit ka ndikuar në bartjen e pakontrolluar të sëmundjeve ngjitëse, që ka paraqitur arsye të madhe për nxitjen e më tepër nis-mave për çrrënjosjen e kolerës, malaries, tifoja e morrit, të cilat në periudhën e përmendur kanë qenë problem i vërtetë për shtetin.

Në kuadër të kushteve të reja që janë krijuar për veprimtari parandaluese, ndërsa me nismë të D-r Andrija Shtampar⁴⁸¹, në vitin 1922 janë organizuar shërbime kundër malaries. Në Shkup filloi me punë

⁴⁸⁰ Боро Николовски, Прилози за историјата на здравствената култура на Македонија, Македонско фармацевтско друштво, Скопје, 1995, 266.

⁴⁸¹ D-r Andrija Shtampar është lindur në vitin 1888, në f. Drenovci, komuna Sllavonski Brod në R. e Kroacisë. Fakultetin e Mjekësisë e ka mbaruar në Vjenë në dhjetor të vitit 1991. D-r Shtampar llogaritet si themelues i mjekësisë sociale dhe parandaluese. Ai ka arritur të dëshmojë se në mjekësinë parandaluese qëndron edhe funksioni themelor i mbrojtjes shëndetësore dhe se njeriu është vlera më e madhe shoqërore, shëndeti nuk është çështje personale por shoqërore, edhe ruajtja e shëndetit nuk është detyrë e individit por e tërë shoqërisë. Sipas tij, ka qenë naiv kuptimi se me shërimin individual kanë mundur të çrrënjosen sëmundjet e rënda infektive (malaria, tifoja, tuberkulozi, sifilizi).

edhe stacioni bakteriologjik, detyra kryesore e së cilës ka qenë analiza dhe zhdukja e sëmundjeve ngjitëse. Në vitin e njëjtë stacionet e këtitlla kundër malaries janë hapur edhe në qytetet tjera si Manastiri, Shtipi, Ohri.⁴⁸² Në vitin 1923 krahas parandalimit në Shkup është organizuar shërbim mjekësor kurativ. Spitali i Qytetit të Shkupit, i cili gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore ka qenë i stacionuar në anën e majtë të lumit Vardar, i a.q. spitali ushtarak “Gjysmëhëna”, është zhvendosur në Vodno në vendin ku sot gjendet Qendra Klinike.

Në atë periudhë u hapën shumë njësi për trajtimin e sëmundjeve të shpeshta dhe të rënda. U hap reparti për shërimin dhe trajtimin e të sëmurëve nga tuberkulozi, reparti për sëmundjet e veshit, hundës dhe fytit, si edhe reparte për sëmundjeve të fëmijëve dhe sëmundjeve ortopedike.

Detyra për ballafaqimin me situatën serioze shëndetësore i është besuar D-r Andrija Shtamparit, i cili menjëherë i është rrekur formimit të stacioneve bakteriologjike, me ç’rast është montuar baraka e Dekerit në stacionin bakteriologjik në Shkup, me të cilën ka udhëhequr bakteriologu D-r Vaclav Nohejl. Ky ka qenë faktikisht institucioni i parë social-mjekësor në historinë mjekësore të Maqedonisë, për të cilin është sjellë “Rregullorja për formimin e stacioneve bakteriologjike nr. 29.964 e vitit 1920”.⁴⁸³

Stacioni i parë bakteriologjik i Shkupit është ngritur në Ent për Sëmundje Tropikale⁴⁸⁴, ndërsa më vonë duke falënderuar ndihmën financiare nga fondacioni i Rokfelerit⁴⁸⁵ pasurohet në aspektin e kuadrit dhe hapësirës, me ç’rast ngrihet në Ent Higijenik (1927).

⁴⁸² Боро Николовски, Прилози за историјата на здравствената култура на Македонија, Македонско фармацевтско друштво, Скопје, 1995, 264.

⁴⁸³ Благоја Алексоски, 80 Години Републички завод за здравствена заштита, Бурен интензивен и успешен развој, Скопје 2004, 13-14.

⁴⁸⁴ Завод за тропски болести бр.1752, 3.04.1926 г. Скопје.

⁴⁸⁵ Фондациони i Rokfelerit në atë kohë ka qenë mjaft aktiv, ndërsa edhe përfaqësuesit e Lidhjes së kombeve shpesh herë kanë qëndruar në Shkup për realizimin e idesë

Për shkak të punës më të suksesshme dhe të kontrolluar të stacioneve kundër malaries Ministria e Shëndetit Popullor është ndarë në tre regjione më të mëdha, edhe atë: Shkup, Manstir dhe Shtip. Në të gjitha aktivitetet është punuar në ngritjen e përgjithshme të vetëdijes shëndetësore te popullsia e cila ka qenë në nivel shumë të ulët. Duke dëshiruar të kryhet parandalimi i sëmundjeve, është kryer vaksinimi i popullsisë, ndërsa veçanërisht i është kushtuar vëmendje e madhe shëndetit të fëmijëve sepse vdekshmëria e ta në këtë periudhë ka qenë e madhe, ndërsa malaria ka lënë pasojë fizike dhe psikike te organizmat e rinj. Në atë periudhë ka filluar propaganda e rëndësishme shëndetësore për përkushtimin shëndetësor dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse në mesin e popullsisë.

Qëllimi i këtyre stacioneve bakteriologjike ka qenë konstatimi i të gjitha sëmundjeve ngjitëse, hetimi i burimeve të sëmundjeve ngjitëse, përdorimi i të gjitha mjeteve të pranura deri atëherë dhe ndërmarrja e masave përkatëse për pengimin infektimit. Stacionet bakteriologjike me vetëdije dhe shpejtë i kanë kryer kontrollimet mikroskopike, bakteriologjike dhe serologjike të materialeve, të cilat u janë dorëzuar. I kanë shfrytëzuar të gjitha metodat shkencore të njohura deri atëherë që të arrijnë deri te diagnoza e sigurt dhe e saktë. Me zbatimin e masave profilaktike dhe higjienike e kanë penguar përhapjen e infeksionit.⁴⁸⁶

Në periudhën e viteve të krizës, me rëndësi të veçantë ka qenë veprimtaria e D-r M. Rankivit e cili është përpjekur që institucionet pranë Entit Higjienik t'i përfshijnë të gjitha shtresat e qytetarëve

së D-r Shtamparit. Ai ka arritur të sigurojë 20 milionë dinarë të atëhershëm nga fondacioni i Rokfelerit dhe ndërtesa e Entit ka filluar të ndërtohet në vitin 1923. Ajo është përfunduar në vitin 1924, ndërsa zyrtarisht është lëshuar në përdorim më 5 prill 1925. Nga fondacioni Rokfeler në hapjen e Entit Higjienik të Shkupit edhe përfaqësuesi i posaçëm D-r Miçel. Ndërtesa ka ekzistuar deri në tërmetin e Shkupit. Në vendin e saj sot gjendet ndërtesa e Ministrisë së Shëndetësisë.

⁴⁸⁶ Ивица Бален, Лука Ковачиќ, Денови на Андрија Штампар во Славонски Брод, Славонски Брод, 2009.

të Shkupit. Krahas obligimeve të shumta, Enti Higjienik është marrë edhe me analizën e ujit për pije. Në raportet e vitit 1934, janë theksuar edhe mundësitë për infektimin e ujit në disa objekte në qytet. Sipas rezultateve, në shumë objekte të qytetit uji nuk ka qenë i përdorshëm. Në obligimet e Entit Higjienik përveç konstatimit të problemeve sanitare–higjienike, ka bërë pjesë edhe zgjidhja e tyre. Njësia Sanitare e Udhëheqjes së Qytetit e ka ndaluar shfrytëzimin e ujit të ndotur, ndërsa në bashkëpunimin me Njësine Teknike janë hulumtuar mundësitë për përmirësim të ujit. Problem i këtillë me ujin e ndotur është hasur edhe në qytetet e tjera maqedonase. Për shkak të kësaj autoritetet shëndetësore si një prej prioritetëve shumë të rëndësishme në luftën kundër sëmundjeve ngjitëse e kanë theksuar edhe sigurimin e ujit të pastër dhe të shëndetshëm për pije. Në periudhën prej vitit 1926 deri në vitin 1937, në territorin e Banovinës së Vardarit, ndërsa nën udhëheqjen e Entit Higjienik të Shkupit, janë ndërtuar një sërë ujësjellësish, janë hapur puse dhe kaptazhe me çezma.⁴⁸⁷

Vështrim ndaj personave të sëmurë dhe të vdekur në Shkup

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, kanë mbetur një numër i madh i vatrave të cilat kanë qenë burime të mëdha të sëmundjeve ngjitëse me të cilat është ballafaquar popullsia. Regjioni i Shkupit ka qenë burim endemik për infeksione të rënda të zorrëve, tifoja e zorrëve, dizenteria pres së cilës janë sëmurë rreth 1000 persona, qindra fëmijë kanë vdekur nga difteria, ndërsa nga morbili (fruthi i vogël) dhe nga pertusis (kollitja e madhe) kanë vdekur edhe nga 1000 deri në 2000 persona. Kushtet ekonomike kanë qenë arsye për shfaqjen e prostitucionit në atë kohë, i cili ka qenë arsye për shfaqjen e sëmundjeve të bartura gjinore (sifilizi dhe gonorrreja).⁴⁸⁸

⁴⁸⁷ Уредба за сузбивање на заразните болести, Службене новинебр.224, 1927. (Arkivi i Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë)

⁴⁸⁸ Боро Николовски, Прилози за историјата на здравствената култура на Македонија, Македонско фармацевтско друштво, Скопје, 1995, 265.Ристо

Në njërin prej raporteve të D-r Vaclav Nohejlit, për punën e njësisë higjienike qëndron se Shkupi është njëri prej atyre qyteteve të cilët janë rritur shpejtë pas luftës, dhe për shkak të kësaj ka qenë e vështirë të arrihet në kohë, shpejtë dhe në mënyrë efikase organizimi i të gjitha segmenteve, të rëndësishme për zhvillimin dhe përparimin e një qyteti.⁴⁸⁹ Mendimet e ndara të organeve kompetente, se shërbimi higjienik është dashur të organizohet si “korpus separatum”⁴⁹⁰, ka krijuar vijë të madhe ndarëse mes mjekësisë parandaluese dhe kurative, që është treguar si anë e dobët, e cila ka pasur edhe pasoja serioze.⁴⁹¹

Në pajtim me atë mangësi dhe sipas shumëllojshmërisë në përbërjen e popullsisë e cila ka jetuar në territorin e qytetit të Shkupit, autoritetet kompetente dhe institucionet kanë bërë analiza statistikore, me të cilat është bërë pasqyrimi i lëvizjes së morbiditetit dhe mortalitetit në qytet.

Që të fitohet pasqyrë e përafërt për natalitetin, morbiditeti dhe mortaliteti në qytetin e Shkupit, si edhe arsyet të cilat kanë ndikuar ndaj tyre, janë bërë më shumë analiza, të cilat përafërsisht e paraqesin gjendjen në qytet në periudhën prej vitit 1919 deri në vitin 1927.

Në analizën e cila është bërë nga autoritetet e atëhershme shëndetësore për periudhën 1919 deri në vitin 1927, së pari është bërë vështrimi dhe pasqyrimi i natalitetit në qytet, ku shihet se shkalla e fëmijëve të lindur të gjallë është më e madhe në raport me fëmijët e lindur të vdekur, të paraqitur në tabelën nr. 1.

Брезјанин, Историја на здравствена култура на Македонија-материјал во ракопис ИНИ, Скопје. 195.

⁴⁸⁹ Алманах општине града Скопља, Санитет, Скопље 1928,80.

⁴⁹⁰ E ndarë dhe e pavarur nga shërbimet e tjera.

⁴⁹¹ Елена Јосимовска, Завод за здравствена заштита-Штип, 90 години, Штип, 2004, 62.

Tabela nr. 1. Numri i fëmijëve të lindur të gjallë dhe të vdekur në Shkup⁴⁹²

viti	fëmijë të lindur të gjallë			fëmijë të lindur të vdekur			Gjithsej të lindur		
	m	f	gjithsej	m	F	gjithsej	m	f	gjithsej
1919	36	44	80	2	3	5	38	47	85
1920	35	44	79	1	2	3	36	46	82
1921	49	50	99	3	4	7	52	54	106
1922	45	48	93	2	2	4	47	50	97
1923	51	58	109	-	4	4	51	62	113
1924	45	49	94	6	8	14	51	57	108
1925	56	47	103	3	4	7	59	51	110
1926	84	116	200	11	9	20	95	125	230
1927	81	86	167	6	5	11	87	91	178
gjithsej	482	542	1024	34	41	75	516	583	1149

Popullsinë në Shkup e kanë përbërë pjesëtarët e katër feve: ortodokse, myslimane, katolike dhe hebraike. Analizat e bëra për paraqitjen e natalitetit dhe mortalitetit në qytet, tregojnë një situatë të baraspeshuar në raport me natalitetin, ndërsa dallimet dhe lëshimet janë shfaqur në raport me mortalitetin. Vdekshmëria më e madhe është vërejtur te popullsia myslimane dhe ortodokse, ndërsa një përqindje shumë më e vogël e vdekjeve është vërejtur te popullsia

⁴⁹² Алманах општине града Скопља, Санитет, Скопље 1928, 78.

hebraike dhe katolike. Kjo qartë tregon se statusi social i popullsisë ka qenë faktor i madhe për dukurinë e këtyllë, respektivisht morbiditeti dhe mortaliteti kanë qenë dukuri karakteristike për popullsinë e varfër.

Mortaliteti te fëmijët deri në moshën nëntëvjeçare ka qenë veçanërisht i madh dhe ka arritur deri në 50% të të gjitha rasteve të vdekjeve. Arsyet për dukurinë e tillë kanë qenë të lidhura me imunitetin e fëmijës me të cilin lindet ai ndërsa pastaj mjedisi në cilin lindën dhe jeton. Fëmija i cili e ka pasur prejardhjen nga prindërit e shëndoshë ka pasur identitet më të madh të lindur, ka qenë më rezistues ndaj ndikimeve të jashtme në krahasim me fëmijën i cili e ka pasur prejardhjen nga prindërit e sëmurë.

Vdekshmëria e fëmijëve në qytet nuk ka qenë e njëjtë gjatë tërë vitit. Gjegjësisht muaj të caktuar gjatë vitit, veçanërisht gjatë verës (qershor, korrik, gusht), kanë qenë muaj kur mortaliteti i fëmijëve e ka arritur maksimumin e tyre. Kjo ka qenë periudha kur fëmijët janë sëmurur shpesh nga kolitet dhe sëmundjet gastrointestinale, të cilat janë shkaktuar nga temperaturat e larta të cilat kanë qenë arsye për prishjen e shpejtë të ushqimit dhe qumështit. 38% e rasteve të vdekjes te fëmijët deri në dy vite moshë kanë qenë për shkak të sëmundjeve gastrointestinale, 25% kanë vdekur nga llojet e ndryshme të sëmundjeve atrofike dhe distrofike, 22% e rasteve të vdekjes kanë bërë pjesë në sëmundjet e mushkërive, 15% kanë bërë pjesë në sëmundjet e tjera.⁴⁹³

Te fëmijët nga mosha 3 deri në moshën 10 vjeçare 47% e vdekshmërisë është shkaktuar nga sëmundjet ngjitëse, 23% e fëmijëve kanë vdekur nga tuberkulozi, 22% nga anteri dhe 8% nga sëmundjet e tjera. Vdekshmëria te personat në moshën nga 10 deri në 20 vite ka

⁴⁹³ Алманах општине града Скопља, Наталите и морталитет и његови узроци у Скопљу 1927 године, Скопље 1928, 90. Надежда Цветковска, Морбидитетот и морталитетот на децата во Скопје и околината меѓу двете светски војни, ГИНИ, 46, 1, Скопје, 2002, 27.

qenë më e vogël. Te kjo grupimoshë arsyeja më e shpeshtë e vdekjes kanë qenë sëmundjet ngjitëse dhe tuberkulozi deri në 63%, sëmundjet e mushkërive kanë qenë arsye për vdekshmëri te 10% e popullsisë dhe 27% e sëmundjeve të tjera. Tuberkulozi ka qenë arsyeja e vdekjes së 1/5% të popullsisë në Shkup. Vdekshmëria dhe tuberkulozi, ka qenë i pranishëm te popullsia e varfër, para së gjithash për shkak të kushteve të këqija për banim dhe shprehitë e këqija higjienike. Si arsye për vdekshmërinë shumë shpesh ka qenë edhe malaria dhe tifoja.⁴⁹⁴

Në periudhën mes dy luftërave botërore, vdekshmëria e përgjithshme nga malaria, tuberkulozi, tifoja, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, vazhdimisht ka lëvizur dhe ka përjetuar ngritje dhe rënie. Lëvizja e sëmundjeve si dhe vdekshmëria nga të njëjtat, vështirë ka mundur të ndiqet dhe të kontrollohet në tërësi, para së gjithash për shkak të mosedukimit të madh shëndetësor të popullsisë, e cila nuk e ka kuptuar nevojën e paraqitjes së personave të sëmurë dhe/ose të vdekur pranë autoriteteve kompetente. Numri më i madh i personave të sëmurë dhe/ose të vdekur nuk janë paraqitur⁴⁹⁵ te autoritetet kompetente shëndetësore, ndërsa familjet i kanë fshehur dukuritë e këtilla, që ta ruajnë autoritetin e familjes. Kjo dukuri ka qenë më në masë te popullsia e varfër.

Në tabelën nr. 2, jepet pasqyrë e numrit të përgjithshëm të personave të sëmurë (të kategorizuar sipas llojit të sëmundjes).

Tabela nr. 2. Numri i personave të sëmurë (1919–1927)⁴⁹⁶

⁴⁹⁴По ату.

⁴⁹⁵Надежда Цветковска, Морбидитетот и морталитетот на децата во Скопје и околината меѓу двете светски војни, ГИНИ, 46, 1, Скопје, 2002, 30.

⁴⁹⁶Алманах општине града Скопља, Санитет, Скопље 1928, 76.

Sëmundja	viti								Gjithsej
	1920	1921	1922	1923	1924	1925	1926	1927	
Tifoja e barkut, fruthi i zi, differia, vari-cela, fruthi i madh, tifoja e morrit efj.	27	139	42	200	84	102	106	219	919

Në tabelën nr. 3, jepet pasqyra e numrit të përgjithshëm të personave të vdekur (të kategorizuar sipas llojit të sëmundjes).

Tabela nr. 3. Numri i personave të vdekur (1919–1927)⁴⁹⁷

sëmundja	viti									gjithsej
	1919	1920	1921	1922	1923	1924	1925	1926	1927	
Tuberk.	112	98	90	139	163	153	145	171	200	1271

⁴⁹⁷Po aty, f. 79.

Malaria	4	7	10	8	15	22	16	14	14	110
Fruthi i zi	4	8	46	7	11	7	8	12	34	137
Tifoja	8	6	5	1	5	4	5	5	1	40
Sëmundje të tjera	2	12	6	4	29	-	40	21	18	132
Gjithsej:	130	131	157	159	223	186	214	223	267	1690

Lufta me sëmundjet ngjitëse ka vazhduar edhe më tej sepse vdekshmëria në periudhën 1930 deri më 1939 ka qenë 52,27%. Kjo është periudha kur janë ngritur disa dispenserë kundër tuberkulozit, janë bërë përpjekje për zvogëlimin dhe zhdukjen e tuberkulozit dhe malaries me organizimin e kontrollimeve falas dhe shërimin e popullsisë së varfër. Deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore, numri i të sëmurëve nga tuberkulozi në Banovinën e Vardarit ka lëvizur nga 20.000 deri në 25.000, ndërsa numri i rasteve të vdekjes ka qenë rreth 2.000.⁴⁹⁸

Dhe si përfundim i cili e përshkruan gjendjen shëndetësore të popullsisë në periudhën mes dy luftërave botërore, do ta marrim përshkrimin e ilustruar të D-r Millosh Jakovleviqit, i cili ka thënë:

⁴⁹⁸Ристо Брезјанин, Историја на здравствена култура на Македонија-материјал во ракопис, ИНИ, Скопје. 196.

...”krahas disa sukseseve, gjendja shëndetësore e popullit nuk është përmirësuar shumë. Morbiditeti dhe mortaliteti janë të mëdha. Sëmundjet ngjitëse shfaqen në të gjitha rajonet. Problemi i sëmundjeve sociale vetëm sa është prekur. Vdekshmëria e fëmijëve të vegjël është shqetësuese. Arsyet për këtë gjendje të palakmueshme janë të shumta dhe të mirënjohura: mosarsimimi i përgjithshëm i masave të gjera popullore, lagjet e parregulluara dhe johigjienike, ushqyerja e keqe dhe e pamjaftueshme, puna e mundimshme dhe shteruese dhe kushtet e këqija ekonomike”.⁴⁹⁹

Situata e këtillë ka mbetur në trashëgimi të gjeneratave të ardhshme, gjëra për të cilat është dashur të luftojnë dhe të përpuqen shumë fuqishëm dhe me mundim.

⁴⁹⁹ Po aty, 198.

ISAMEDIN AZIZI & AGRON SALIHI

IHN & ITSHKSH – Shkup

LËVIZJET DEMOGRAFIKE TË SHQIPTARËVE NË SHKUP ME RRETHINË MIDIS DY LUFTËRAVE

Numri i shqiptarëve në Maqedoni, posaçërisht i shqiptarëve të Shkupit me rrethinë, është një problematikë e cila i ka përcjellë shqiptarët e Maqedonisë hap pas hapi, që nga e kaluara e deri më sot, e që assesi të gjejë zgjidhje të kënaqshme e të drejtë. Tani më është më se i njohur fati që ka përcjellë shqiptarët e Maqedonisë gjatë procesit të regjistrimeve zyrtare të popullsisë, duke filluar nga regjistrimet e para, pas përfundimit të periudhës osmane, pra ato të vitit 1921, 1931, 1948, 1953 etj. e deri më sot. Nga rezultatet e analizave tona, duke u bazuar në të dhënat e statistikave zyrtare si dhe burimeve të tjera jozyrtare, por jo edhe me më pak rëndësi, del se numri i dhënë nga statistikat zyrtare asnjëherë nuk është përputhur me numrin e vërtetë të popullsisë në terren. Tendenca e manipulimeve të të dhënave zyrtare, lidhur me numrin e saktë të shqiptarëve, nuk ka përfunduar ende. Ndoshta edhe dështimi i regjistrimit të fundit në Maqedoni mund të lidhet me një tendencë të tillë. Mirëpo, analizat tona do të përqendrohen vetëm sa i takon harkut kohor nga viti 1908–1910, përkatësisht nga regjistrimet e fundit të Perandorisë Osmane e deri më vitin 1953, përkatësisht deri në dy regjistrimet e para të pasluftës së dytë.

★ ★ ★

Cungimi territorial i tokave shqiptare pas 1912–ës, pati pasoja të rënda në jetën politike dhe ekonomike të shqiptarëve, e sidomos të atyre që mbetën jashtë kufijve të shtetit amë. Mbase, kjo edhe ishte periudha më e rëndë për shqiptarët të mbetur jashtë kufijve të shtet-

tit amë, periudhë kjo, kur edhe ndodhën lëvizjet më të mëdha demografike të shqiptarëve. Pas vitit 1912, duke u bazuar në regjistrimet osmane të kohës, shqiptarët e Maqedonisë, e sidomos ata të Shkupit, filluan të humbasin pozicionin dominues të tyre, pozicion të cilin e kishin deri në atë kohë. Për të analizuar, krahasuar dhe për të nxjerrë në pah lëvizjet demografike të shqiptarëve që ndodhën pas luftërave ballkanike dhe pas Luftës së Parë Botërore, kemi bërë krahasimin e statistikave osmane, atyre të vitit 1908–1909 dhe statistikës së fundit të vitit 1910, me statistikën zyrtare të regjistrimit të popullsisë të shtetit të ri të Mbretërisë së SHKS-së.

Në shekullin e fundit të sundimit të Perandorisë Osmane, çështja e numrit të popullsisë dhe struktura religjioze e saj paraqet rëndësi të madhe edhe për vetë Perandorinë Osmane. Të dhënat që i gjejmë lidhur me këtë çështje i takojnë dy burimeve të cilat ndahen në dy grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë të dhënat zyrtare të Perandorisë Osmane, si: defterët osmanë dhe regjistrimet e të dhënave nga vilajetet në veçanti (salnamet). Në grupin e dytë përfshihen të dhënat jozyrtare, përkatësisht të dhënat nga udhërrëfyesit e huaj, të dhëna nga përfaqësitë konzulare si dhe të dhëna të tjera statistikore. Edhe pse jozyrtare dhe dytësore, këto të dhëna janë të një rëndësie të madhe për shkak se bazohen në informata kryesisht të marra nga terreni, megjithatë, burimet osmane kryesisht vlerësohen si më të sakta. Në të dy grupet e burimeve, gjejmë të dhëna, si për numrin e popullatës, ashtu dhe për numrin e shtëpive/ansivërëve. Këto të dhëna, ka raste kur gjenden vetëm për qytetin e Shkupit, po edhe raste të tjera për tërë qarkun e Shkupit.

Nëse e përcjellim praktikën osmane, etnitë ishin të evidentuara sipas përkatësisë fetare (myleteve).⁵⁰⁰ Në vitet e fundit të periudhës osmane në Shkup ekzistonin këto komunitete, përkatësisht mylete:

⁵⁰⁰ Bëhet fjalë për etni të cilat janë të bashkuara në bazë të përkatësisë fetare ose përkatësisë së tyre ndaj ndonjë kishe të caktuar. Përcaktonte me ligj statusin e pakicave jo-myslimane dhe autonominë e bashkësive fetare.

myslimane, ekzarkiste, çifute, katolike dhe vllehe. Sipas këtyre rimeve, në Shkup përmenden edhe romët të cilët i përkisnin dy religjioneve më të mëdha, asaj myslimane dhe të krishtere. Ndërsa sipas burimeve të tjera, udhërrëfyesve të huaj apo të dhënave të konsujve të ndryshëm, popullsia e Shkupit, përveç përkatësisë fetare, evidentohet edhe sipas përkatësisë kombëtare, pra myslimanët emërtohen ose si shqiptarë (në të shumtën e rasteve), ose si turq, ndërkohë që të krishterët janë të paraqitur, ose si bullgarë, ose si serbë, varësisht nga përkatësia e burimeve.

Në këto rrethana, ndarja e elementit shqiptar nga ai turk është e vështirë. Nëse për këtë ndarje mbështetemi në kriterin e gjuhës të cilën kanë përdorur, mund të dilet me të dhëna jo të sakta duke e pasur parasysh faktin se në Shkup shqiptarët kanë folur edhe gjuhën turke, ndërkohë që edhe turqit kanë folur gjuhën shqipe. Nëse këtyre parametrave u shtohet edhe e dhëna për nivelin e ulët të vetëdijes kombëtare, krahasuar me vetëdijen fetare, atëherë vështirësitë për t'i ndarë këto dy etni, vijnë e zmadhohen edhe më shumë.

Sipas një burimi që mbështetet në një statistike turke⁵⁰¹, në vitin 1908–1909 në kazanë e Shkupit kanë jetuar gjithsej 90.419 banorë, prej tyre 50.258 shqiptarë, ose 55,5%, 9.264 serbë ose 9,8%, 29.080 bullgarë, përkatësisht 36,4% dhe 1.817 të tjerë ose 2,5%. Sipas të gjitha gjasave, këto të dhëna duhet të pranohen me një dozë rezerve, nëse bazohemi në faktin se, në statistikat zyrtare osmane asnjëherë nuk jepen të dhëna për përkatësinë etnike, pos asaj fetare, gjë që nuk ndodh edhe me këtë statistikë. Ajo që duhet theksuar për të dhënat e kësaj statistike është se, elementi etnik mund të jetë ngatërruar me elementin fetar, nga fakti se elementi turk fare nuk është paraqitur si element i veçantë, por mbase është paraqitur si element shqiptar, ose thënë ndryshe e tërë popullata myslimane është paraqitur si popullatë

⁵⁰¹ Skender Asani; Ardian Limani, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Shkup 1908-1912* (dokumente), Shoqata e historianëve shqiptarë në Maqedoni, Shkup, 2012, fq. 147-148

shqiptare. Sigurisht se për këtë statistikë duhet të kemi një dozë të rezervës, sidomos për sa i përket numrit të shqiptarëve në Shkup. Nëse këto të dhëna i krahasojmë me statistikën e regjistrimit të popullatës të vitit 1921, do të shohim se raporti ndërmjet elementit shqiptar dhe atij turk në Shkup dhe rrethinë është 60% me 40% në favor të elementit shqiptar. Nëse këtë mesatare do ta kishim përdorur edhe në këtë statistikë, atëherë i bie që në këtë periudhë në Shkup mund të ketë pasur diku rreth 30–35.000 shqiptarë.

Në vitin 1910 Perandoria Osmane del me statistikën e saj të fundit për qytetin e Shkupit⁵⁰², në të cilën të dhënat jepen vetëm për numrin e shtëpive, e jo edhe për numrin e banorëve. Sipas kësaj statistike, qyteti i Shkupit pa rrethinë kishte gjithsej 9600 shtëpi, nga të cilat, 6400 shtëpi janë të evidentuara si myslimane, 2450 të krishtera, 400 çifute dhe 150 katolike. Nëse numrin e shtëpive e shumëzojmë me një mesatare prej 5 anëtarëve, aq sa edhe disa udhërrëfyes i kanë llogaritur shtëpitë, i bie që vetëm në Shkup kanë jetuar diku rreth 48.000 banorë, nga të cilët, rreth 33.000 banorë duhet të kenë qenë myslimanë, rreth 12.000 të krishterë, 2.000 çifutë dhe 750 katolikë. Mirëpo, edhe kjo statistikë nuk tregon numrin e saktë të banorëve të qytetit të Shkupit. Nëse e kemi parasysh mënyrën e jetesës të familjet shqiptare, mënyrë e cila kishte formë më të shprehurë të jetës patriarkale, atëherë numri prej 5 anëtarëve për shtëpi të shqiptarët mund të mos jetë i saktë, për shkak se dihet që nën një kulm kanë jetuar më tepër familje shqiptare. Një mendim të tillë e mbështet edhe inspektori ekzarkist Vasill Këncov në punimit e tij për Shkupin, i cili thirret në të dhënat zyrtare të vjetarit statistikor të Vilajetit të Kosovës, ku mes tjerash përmend faktin se shumë shpesh ka ndodhur që në disa shtëpi myslimane kanë jetuar dy e më tepër familje. Ai, si numër mesatar për familjet myslimane konsideron numrin prej 7 anëtarëve.⁵⁰³ Nëse

⁵⁰² Петар Тодоров, *Скопје од почетокот на век до крајот на османлиското владеење* (докторска дисертација), Скопје, 2013, fq.62

⁵⁰³ По аty, fq. 64

kësaj statistike ia shtojmë edhe rrethinën e Shkupit, e cila, sipas të dhënave statistikore kishte po aq banorë sa edhe vetë qyteti i Shkupit, i bie që Shkupi me rrethinë në këtë kohë të ketë pasur diku mes 85.000 dhe 95.000 banorë, nga të cilët, rreth 70% ishin të përkatësisë fetare myslimane. Në pamundësi për të bërë një ndarje të saktë të elementit shqiptar nga ai turk, marrim mesataren prej statistikave të tjera që u përmendën më lartë, pra raportin 60% me 40% në favor të elementit shqiptar, sipas së cilës i bie që në Shkup me rrethinë duhet ketë pasur diku rreth 35.000 deri 40.000 shqiptarë.

Këto të dhëna statistikore mbështeten edhe nga disa dokumente të tjera jozyrtare, nga të cilat, do t'i citojmë disa, si në vijim: të dhënat statistikore që jepen nga konsulli serb në Shkup⁵⁰⁴, z. Gavrilloviq, në vitin 1912, në të cilat thuhet se shënime të sakta për numrin e banorëve në Shkup nuk ka pasur as qeveria turke, por me bindje thuhet që në këtë qytet jetojnë rreth 50.000 banorë. Nga ky numër, sipas të njëjtit burim, shumicën e përbëjnë myslimanët, nga të cilët pjesa dërmuese janë autoktonë, kurse një numër i vogël janë arnautë. Nga ky dokument, qartë bie në sy tendenca e politikës shtetërore serbe për të zvogëluar sa më shumë elementin shqiptar në Shkup dhe për ta zëvendësuar atë me elementin fetar. Por duke e pasur parasysh faktin e pamohuar që popullatë autoktone në këtë rast janë shqiptarët, atëherë kjo tendencë bëhet edhe më e qartë, duke e trajtuar si autokton elementin mysliman dhe duke e veçuar nga ky element popullatën shqiptare.

Dokumenti tjetër i radhës është ai i konsullatës gjermane në Sofje, dërguar ambasadës gjermane në Berlin⁵⁰⁵, në të cilin thuhet se, në vitin 1912, qyteti i Shkupit ka pasur rreth 50.000 banorë, prej të

⁵⁰⁴ Државен архив на Република Македонија (ДАРМ), Министерство Иностранних Дела Србије-Београд, Shkup 24 tetor, 1912, Komanda Supreme e Departamentit të policisë, nr. 661, 25.10.1912.

⁵⁰⁵ Skender Asani; Ardian Limani, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Shkup 1908-1912* (dokumente)..., ДАРМ, фонд – Министерство за Надворешни Работи на Италија, fq. 151.

cilëve: 40.000 shqiptarë, 4.000 bullgarë, 150 serbë, si dhe hebrenj, romë etj. Ndërsa të dhënat për rrethin e Shkupit janë si në vijim: 63 fshatra shqiptare me 45.000 banorë, 3 koloni turke me 2.500 banorë, 9 fshatra të mëdha serbe me 7.000 banorë dhe 22 fshatra bullgare me 15.000 banorë. Sipas këtyre dokumenteve i bie që Shkupi me rrethinë në vitin 1912 të kishte diku rreth 95.000 banorë shqiptarë, pra, një numër shumë i madh dhe vështirë i besueshëm. Duke marrë parasysh faktin se edhe në këtë dokument elementi turk fare nuk është paraqitur, element i cili në këtë kohë ka qenë bukur shumë i përfaqësuar, atëherë mund të konstatojmë se numri prej afërsisht 95.000 banorëve shqiptarë i përket elementit fetar mysliman e jo vetëm atij shqiptar, megjithëse ky i fundit është në dominues. Edhe përkundër këtyre të dhënave për numrin e banorëve shqiptarë të Shkupit me rrethinë, për lëvizjet demografike të shqiptarëve dhe krahasimet midis regjistrimeve të popullsisë së Shkupit, kryesisht do të bazohemi në të dhënat zyrtare statistikore, si ato turke dhe ato të Mbretërisë së SKS-së, duke mos anashkaluar edhe burimet dytësore.

Regjistrimi i parë në Mbretërinë e SKS-së u bë në vitin 1921⁵⁰⁶. Sipas të dhënave statistikore për qarkun e Shkupit, kuptojmë se numri i përgjithshëm i popullsisë (me qëndrim të përkohshëm dhe të përhershëm, qytetarë dhe ushtarak) arrinte në 145.880 banorë. Nga vetë titulli i statistikës zyrtare shohim se qëllimi kryesor i kësaj statistike ka qenë që, pos banorëve të Shkupit, të regjistrohen edhe të gjithë personat e tjerë të pranishëm në këtë kohë në qarkun e Shkupit, pra jo vetëm qytetarët, por edhe ushtarakët, edhe ato me qëndrim të përhershëm, por gjithashtu edhe ata me qëndrim të përkohshëm, dhe krejt kjo, sipas të gjitha gjasave, me të vetmin qëllim që të dilet me një pasqyrë tjetër, joreale, për strukturën etnike në Shkup. Kjo statistikë del me të dhëna duke u mbështetur në kriterin e përdorimit të gjuhës amtare dhe të përkatësisë fetare, e jo

⁵⁰⁶ “Дефинитивни резултати Пописа Становништва“ од 31 јануара 1921 године.

në bazë të kriterit të përkatësisë etnike. Nga këto të dhëna kup-tojmë që 82.148 banorë ose 56,3% e popullsisë flasin gjuhën serbe ose kroate, 32.035 ose 22%, gjuhën shqipe, 26.341 ose 18%, atë turke, ndërsa 4322 ose 3% e popullsisë mbetet e panjohur. Ndërsa, duke u bazuar në përkatësinë fetare, rezultatet janë si në vijim: 75.498 ose 51%, të përkatësisë krishtere (ortodokse), 67.376 ose 47%, të përkatësisë myslimane, 1872 ose 1,3% të përkatësisë çifute dhe 1012 ose 0,7% , të përkatësisë katolike.

Pas një analize më të thellë të kësaj statistike zyrtare, takohen elemente apo të dhëna që nuk përkojnë me njëra tjetrën. Te të dhënat që jepen për përkatësinë fetare, shohim që numri i banorëve të deklaruar si myslimanë është për 9.000 banorë ose për 15%, më i madh se sa numri i përbashkët i banorëve që flasin gjuhën shqipe dhe atë turke (pra dy etnitet më të mëdha myslimane), gjithashtu dhe nga ana tjetër, numri i të krishterëve shënon ulje për rreth 5% në krahasim me të dhënat e banorëve të deklaruar sipas përdorimit të gjuhës amtare. Në këtë rast, paraqitet dilema, nëse kjo përqindje kaq e lartë e elementi fetar në raport me atë etnik apo gjuhësor mund të lidhet me banorët e përkatësive të tjera etnike myslimane që mund të kenë jetuar në Shkup, konkretisht atij boshnjak dhe torbesh. Nëse bëjmë krahasimin e kësaj statistike me statistikën e mëhershme, do të shohim se elementi boshnjak dhe ai torbesh fare nuk janë të pranishme në statistikën e mëhershme, qofshin ato zyrtare turke, qofshin ato jozyrtare. Edhe në grafën e “të tjerë” në statistikën e mëhershme, përqindja nuk është më e lartë se 2,5%. Nëse këto komunitete kanë qenë të pranishme edhe më herët në Shkup dhe rrethinë, kjo mund të nënkuptojë që ata të kenë qenë deklaruar si turq, dhe në këtë rast, dallimi ndërmjet popullsisë shqiptare dhe asaj turke mund të jetë edhe më i madh, në favor të elementit shqiptar. Mirëpo, nëse e analizojmë mënyrën e jetesës, sidomos të komunitetit torbesh, mund të konstatojmë se ky komunitet në këtë kohë pothuajse fare nuk ka qenë i pranishëm në pjesët urbane sepse i njëjti, kryesisht ka qenë i koncentruar në pjesë të

larta malore, fenomen i cili është i pranishëm edhe sot e kësaj dite. Po qe se do të përjashtoheshin këto dy komunitete të cilat rrisin përqindjen e popullsisë myslimane në Shkup, atëherë parashtrohet dilema se si është e mundur që elementi fetar të jetë për 15% më i lartë se elementi etnik, pra element ky që nënkupton popullatën myslimane të përkatësisë etnike shqiptare e turke.

Këto të dhëna flasin qartë për synimin e politikës shtetërore të Mbretërisë së SKS-së dhe raportin e saj diskriminues e jotolerant ndaj elementit etnik shqiptar kundrejt raportit më privilegjuar e më tolerant ndaj elementit fetar mysliman dhe elementit etnik turk. Në këtë konstatim mund të arrihet duke e marrë parasysh, përveç fakteve të tjera, edhe faktin e moslejimit të funksionimit të shkollave shqipe gjatë tërë sundimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, kundrejt lejimit të funksionimit të shkollave fetare. Duke i marrë parasysh këto fakte, mund të konstatohet se e vetmja mundësi për rritjen e përqindjes së elementit fetar në raport me elementin etnik ka qenë presioni ndaj një pjese të shqiptarëve për tu deklaruar si serbë folës, nga njëra anë, dhe liria e të njëjtëve për tu deklaruar për përkatësinë fetare, përkatësisht si myslimanë.

Një analizë tjetër e cila besojmë se duhet bërë, është ajo që ka të bëjë me fenomenin e rritjes së madhe të popullatës sllave në Shkup dhe rrethinë. Në statistikën osmane të viteve të fundit të sundimit Osman në Ballkan, elementi sllav nuk ka qenë i përfaqësuar me më shumë se 25% nga numri i përgjithshëm i banorëve të Shkupit me rrethinë. Më konkretisht, në statistikën e vitit 1908–1909, elementi sllav në Shkup me rrethinë ishte i përfaqësuar me rreth 38.000 banorë, ndërkohë që në vitin 1910 në Shkup kishte vetëm 2450 shtëpi të krishtera me një mesatare prej 12.000 banorëve. Në statistikën e vitit 1921, nga gjithsej 145.880 banorë të qarkut të Shkupit, elementi i krishterë sllav përbën shumicën e popullatës me një përqindje prej 56% ose 82.148, banorë që në përdorim kishin gjuhën serbo-kroate si gjuhë amtë. Kjo lë të kuptohet që elementi sllav, nga viti 1910 shënon rritje në Shkup dhe rrethinë për më shumë se

116%. Sigurisht se për të shpjeguar një rritje të këtillë të elementit sllav në Shkup me rrethinë duhet bërë analiza më të detajuara.

Viti 1912 ishte një vit i ndryshimeve të mëdha në Ballkan. Me përfundimin e misionit të Perandorisë Osmane në Ballkan pasojnë ndryshime kufijsh e në këtë kontekst, edhe cungimi i tokave shqiptare, për të vazhduar pastaj me vrasje civilësh, me rrënime të qyteteve, djegie të fshatrave të tëra, shpërngulje të dhunshme masive e kështu me radhë. E gjithë kjo situatë rezultoi me lëvizje të mëdha demografike të popullatës të cilat shqiptarët i ndjenë si pasojë të drejtpërdrejta në kurrrizin e vet. Së bashku me tërheqjen e ushtrisë osmane filloi edhe shpërngulja e një pjese të konsiderueshme e popullatës myslimane. Edhe Shkupi me rrethinë nuk mbeti i paprekur nga një procesi i tillë. Menjëherë pas Luftës I Ballkanike filloi instalimi i organeve të pushtetit serb, qëllimi parësor i të cilit ishte ndryshimi i strukturës demografike, qëllim që përkohësisht u pengua për shkak të fillimit të Luftës I Botërore, për të vazhduar më pas me një intensitet edhe më të madh.

Shkupi u bë qendra kryesore administrative e të ashtuquajturës Serbi e Jugut. Aty u instaluan të gjitha organet shtetërore, ushtarake dhe policore. E kjo, me automatizëm, nënkupton edhe ardhjen e një numri të konsiderueshëm të administratorëve të rinj shtetërorë së bashku me familjet e tyre. Krahas këtij procesi, u zhvillua edhe procesi i prurjeve me elemente serbe. E gjithë kjo situatë rezultoi me ndryshimin e strukturës demografike në qytetin e Shkupit. Për kësaj, Shkupi për shkak të hekurudhës që kalonte këtu, u bë edhe qendra kryesore për shpërnguljen e popullatës myslimane për në Turqi. Pa humbur kohë, pushteti i ri filloi me zbatimin e një procesi shumë të dhimbshëm për popullatën myslimane, e në veçanti atë shqiptare, pra procesin e kolonizimit.

E gjithë kjo situatë ka ndikuar në ndryshimin e madh të strukturës etnike në Shkup, përkatësisht në rritjen dhe shtimin e elementit sllav në Shkup. Rritja e popullatës sllave, e cila ka arritur deri më

116% sipas rezultateve që dalin nga krahasimi i të dhënave statistiko-kore të vitit 1921 me atë të vitit 1909 dhe 1910, mund të shpjegohet me dy fenomene: atë të shpërnguljes masive të popullatës shqiptare dhe turke, nga njëra anë, dhe me prurjet masive të elementeve sllave në Shkup, nga ana tjetër.

Ndryshimet që ndodhën pas vitit 1912 ishin shumë të dukshme, sidomos nëpër qytete. Sipas të dhënave statistikore të vitit 1921 për qytetet e “Serbisë së Jugut dhe ato të Serbisë së Vjetër”, në 24 qytete kemi zvogëlim të popullsisë për 60.770 banorë në krahasim me regjistrimin e vitit 1910. Më konkretisht, qyteti i Manastirit në vitin 1921 kishte 41.2% më pak banorë se në vitin 1910; Dibra për 30,7%, Shtipi për 26.9% e kështu me radhë.⁵⁰⁷ Kjo tregon shumë qartë se, krahas numrit të viktimave në luftërat ballkanike dhe në atë botërore, një pjesë e konsiderueshme e banorëve të këtyre qyteteve janë shpërngulur, gjë që ka ndikuar në ndryshimin e strukturës etnike në Maqedoni në përgjithësi, e në Shkup në veçanti.

Sipas statistikës së vitit 1931⁵⁰⁸, qarku i Shkupit kishte gjithsej 128.052 banorë, nga të cilët 76.586 banorë që gjuhë amtare kishin gjuhën serbe-kroate-sllavene-maqedonase, ose shprehur me përqindje, rreth 60%, ndërsa 25.132 ose rreth 20% gjuhën shqipe, dhe 24.304 ose rreth 19% regjistrohen si të tjerë.⁵⁰⁹ Ndërsa sa i përket elementit fetar në qarkun e Shkupit, të dhënat janë si në vijim: 70.592 banorë ose 55,1% janë të deklaruar pjesëtarë të përkatësisë fetare të krishtere (ortodokse), 50.845 ose 39,7% asaj myslimane, 3720 ose 2,9% asaj katolike dhe 2793 ose 2,3% të tjerë. Nëse krahasohet kjo statistikë me atë të vitit 1921, shihet se në sta-

⁵⁰⁷ Димитар Тасић, *Рам После Рата*, Војска Краљевине Срба, Хрвата и Словенаца на Косову и Метохији и у Македонији 1918-1920, Београд, 2014 fq. 14.

⁵⁰⁸ “Становништво по вероисповести и матерњем језику“ по попису од 31 марта 1931 године. Преглед по општинама – Београд 1945.

⁵⁰⁹ Mendojmë se grafa e të tjerëve përbëhet vetëm prej elementi turk, për shkak se për gjuhën turke nuk ka pasur grafë në vete.

tistikën e vitit 1931 është regjistruar vetëm popullata e pranishme dhe jo edhe ajo e përkohshme dhe ajo ushtarake, siç ndodh në statistikën e vitit 1921. Sipas statistikës së viti 1931, qarku i Shkupit ka më pak banorë në krahasim me statistikën e vitit 1921. Nëse krahasojmë strukturën etnike të shqiptarëve në Shkup, do të shohim se ajo në vitin 1931 shënon ulje në krahasim me statistikën e vitit 1921 për 6903 banorë ose për rreth 21,6%. Po ashtu, edhe elementi fetar mysliman në përgjithësi shënon ulje prej 24,5% në krahasim me statistikën e vitit 1921. Sigurisht që kjo ulje e numrit të shqiptarëve bazohet në shpërnguljet sistematike të tyre për shkak të presionit të vazhdueshëm shtetëror ndaj etnisë shqiptare.

Edhe në këtë statistikë, sikurse në atë të vitit 1921, numri i të dhënave për elementin fetar të krishterë dallon nga numri i të dhënave për elementin gjuhësor sllav. Nga këto të dhëna shihet se numri i banorëve të deklaruar si pjesëtarë të përkatësisë fetare krishtere është për 5994 banorë ose për 7,8% më pak se numri i të dhënave për banorët që flasin gjuhën sllave.

Nga burimet dytësore⁵¹⁰, si bie fjala dokumenti i konsullatës gjermane në Sofje, dërguar ambasadës gjermane në Berlin, kuptojmë se Shkupi para okupimit të forcave gjermane dhe bullgare kishte 87.000 banorë, prej të cilëve 33.000 ose rreth 40% ishin shqiptarë, 30.000 serbë, 11.000 bullgarë, 5.000 hebrenj dhe 3.000 romë. Edhe në këtë statistikë elementi turk nuk përmendet si element i veçantë. E nëse i krahasojmë këto të dhëna me statistikat zyrtare të mbretërisë së Jugosllavisë, atëherë mundë të fitojmë një pasqyrë pak më të saktë për sa i përket elementit sllav. Të gjitha burimet dytësore bëjnë ndarjen e elementit serb nga ai bullgar, dukuri të cilën nuk e hasim në statistikat zyrtare serbe. Në statistikat serbe, elementi bullgar (maqedonas) nuk paraqitet i ndarë në grafik të veçantë por pa-

⁵¹⁰ Skender Asani; Ardian Limani, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Shkup 1908-1912* (dokumente)..., ДАРМ, фонд – Министерство за Надворешни Работи на Италија, fq. 151.

raqitet në grafikun e përbashkët me atë serbe. Sipas mendimit tonë, kjo dukuri ka qenë tendencioze, me të vetmin qëllim për të paraqitur elementin serb si element dominues në qarkun e Shkupit.

Fatin e shqiptarëve të Shkupit, të cilët, siç përmendëm edhe më herët, nga viti 1912 do të humbasin pozicionin e tyre dominues në qarkun e Shkupit, do ta kenë edhe shqiptarët e tjerë të Maqedonisë në krahasim me popullsinë turke. E kjo bie në sy sidomos në dy regjistrimet e para të pas Luftës II Botërore, të zhvilluara në vitin 1948 dhe në vitin 1953. Sipas statistikës të vitit 1948, banorët e rrethit të Shkupit ishin të regjistruar në tri pjesë ose në tri qarqe: në atë të rrethit të Shkupit, të qytetit të Shkupit dhe në atë të rrethit të Gjorçe Petrovit.⁵¹¹ Sipas kësaj statistike, Shkupi me rrethinë kishte gjithsej 172.384 banorë. Prej tyre 95.276 ose 55,2% ishin maqedonas (për herë të parë në ndonjë statistikë e hasim popullsinë maqedonase si popullsi në vete), 35.727 ose 20,7% shqiptarë (të regjistruar si *Šiptari*), 16.817 ose 9,7% turq, 11.546 ose 6,7% serbë dhe 13.018 të tjerë (ku shumica prej tyre janë, romë dhe vlleh). Ndërsa nëse e paraqesim këtë statistikë vetëm për qytetin e Shkupit pa rrethinë, atëherë do të kemi një pasqyre tjetër për sa i përket numrit të shqiptarëve në të. Sipas kësaj statistike, prej 87.654 banorëve të qytetit të Shkupit: 51.819 ose 59% janë maqedonas, 5209 ose 5,9% shqiptarë, 13.928 ose 15,8% turq, 5872 ose 6,7% serbë, 5796 ose 6,6% romë dhe 5030 ose rreth 6% të tjerë. Nëse e analizojmë këtë statistikë, do të shohim se elementi etnik shqiptar në Shkup, nga pozicioni i parë si etni më e madhe që kishte në statistikën e mëhershme, në regjistrimin e vitit 1948 kalon në pozicionin e pestë. Edhe komuniteti serb dhe ai rom, është më i madh se komuniteti shqiptar në Shkup. E të mos flasim për komunitetin turk. Se a ka qenë kjo pasqyrë reale e të dhënave për numrin e banorëve sipas përkatësisë etnike në Shkup në atë kohë, flasin vetë faktet e përmendura më herët dhe ato që do të përmenden në vijim.

⁵¹¹ Stanovnišvo po Narodnosti, *Konačni rezultati popisa stanovništva od 15 marta 1948 godine*, Knjiga IX, Beograd 1954.

Një fenomen që është i pashmangshëm për tu diskutuar është edhe fenomeni i deklarimit të shqiptarëve si turq. Mirëfilli dihen arsyet për një hap të tillë të shqiptarëve, si: gjendja e vështirë e tyre në periudhën pas Luftës së II Botërore e që, përveç tjerash, nënkupton edhe vrasjet e burgosjet politike të tyre, akuzat si bashkëpunëtorë të fashizmit, si dhe rruga më e lehtë për tu shpërngulur për në Turqi ishte deklarimi i tyre si turq e të ngjashme.

Sipas po të njëjtës statistikë, pasqyra e shqiptarëve jashtë qytetit të Shkupit është më ndryshe. Në rrethin e Shkupit, shqiptarët janë komuniteti i dytë më i banuar. Nga gjithsej 63.684 banorë, 37.936 ose 58,5% janë maqedonas, 16.123 ose 25,5% shqiptarë, 5202 ose 8,1% serbë, 2836 ose 4,4% turq, ndërsa 1587 ose 2,6% të tjerë. Ndërsa në rrethin e Gjoçe Petrovit, ku përfshihen fshatrat shqiptare të komunës së sotme të Sarajit, shqiptarët paraqesin shumicën e banorëve të kësaj komune. Nga gjithsej 21.046 banorë, 14.395 ose 68,5% janë shqiptarë, 5.521 ose 26% maqedonas, 472 serbë ose 2,2% dhe vetëm 53 ose 0,2% turq dhe 605 ose 3,1% të tjerë.

Nga kjo statistikë arrijmë në përfundim se dëshira apo edhe presioni për tu deklaruar si turq, ka qenë shumë më i madh te shqiptarët e Shkupit, sesa te shqiptarët e rrethinës së Shkupit.

Nga të dhënat e statistikës së vitit 1953, del në pah se elementi turk për herë të parë është më i lartë se elementi shqiptar, jo vetëm në Shkup, por edhe në tërë Republikën e Maqedonisë.⁵¹² Nga 1.304.244 banorë, sa kishte gjithsej Republika e Maqedonisë, 860.699 ose 66% ishin maqedonas, 203.938 ose 15,6% turq, 162.254 ose 12,4% shqiptarë dhe 77.353 ose 6% të tjerë.⁵¹³ Nëse e krahasojmë këtë statistikë me atë të vitit 1948, do të shohim se elementi shqiptar

⁵¹² Стојан Киселиновски, Ирена Ставови-Кавка, *Малцинствата на Балканот (XX)*, ИНИ, Скопје, 2004, fq.93.

⁵¹³ Завод за статистика на НР Македонија, *Население и Домаќинства во НР Македонија по Населби (според пописите од 1948, 1953, 1961 година)*, Скопје, ноември 1962 година, fq. 27-31.

shënon ulje prej 35.135 banorëve, përkatësisht numri nga 197.389 banorë, sa kishte në regjistrimin e vitin 1948, ulet në 162.254 banorë, gjegjësisht një ulje prej 18,2%.⁵¹⁴ Në regjistrimin e vitit 1948, shqiptarët përbënin 17,1% të popullatës së përgjithshme të Maqedonisë, ndërsa në regjistrimin e vitit 1953 shqiptarët përbëjnë vetëm 12,4% të numrit të përgjithshëm. Po qe se e njëjta analizë shtrihet edhe për komunitetin turk, rezulton se elementi turk, nga regjistrimi i vitit 1948 në atë të vitit 1953 shënon rritje për 25,7%, ose thënë ndryshe, numri nga 162.254 banorë, sa kishte në vitin 1948, në vitin 1953 rritet në 203.938 banorë.

Situatë të ngjashme, madje edhe më të rëndë për shqiptarët, takojmë edhe në Shkup me rrethinë. Sipas regjistrimit të vitit 1953, vetëm pjesa urbane e qytetit të Shkupit (komunat: Idadija, Kalaja, Kisella Voda dhe Sahat Kulla) kishte 148.040 banorë.⁵¹⁵ Prej tyre 93.671 ose 63,3% ishin maqedonas, 5.461 ose 3,8% shqiptar, 25.346 ose 17,1% turq, 9.446 ose 6,5% serbë, 8.554 ose 5,9% romë dhe 5.102 ose 3,5% të tjerë. Nga të dhënat për përkatësinë etnike të kësaj statistike, vërehet se shqiptarët e qytetit të Shkupit renditen në vendin e fundit. Ndërsa Shkupi me komunat përreth (Draçevën, Butelin, Gjorçe Petrovin dhe Petrovecin), në vitin 1953 kishte gjithsej 213.586 banorë.⁵¹⁶ Prej tyre 115.846 ose 54,2% janë maqedonas, 44.654 ose 21% turq, 23.696 ose 11,1% shqiptarë dhe 29.399 ose 13,7% të tjerë. Ajo që bie në sy në këtë statistikë është se, ashtu si në tërë territorin e Maqedonisë, edhe në Shkup me rrethinë, përqindja e komunitetit turk për herë të parë rezulton të jetë më e lartë se përqindja e komunitetit shqiptar, duke u rritur gati se dyfish, dukuri kjo, jo e zakonshme, sidomos për rrethinën e Shkupit. Në

⁵¹⁴ Qerim Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi (1953-1959)*, Studime Albanologjike, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Nr. 1, Shkup, 2009, fq. 85.

⁵¹⁵ Завод за статистика на НР Македонија, *Население и Домаќинства во НР Македонија по Населби (според пописите од 1948, 1953, 1961 година)*, Скопје, ноември 1962 година, fq. 27-31.

⁵¹⁶ Завод за статистика на НР Македонија....., fq. 27-31.

pjesën urbane të qytetit të Shkupit shqiptarët marrin pjesë me vetëm 3,8% të numrit të përgjithshëm, dhe kjo shënon edhe uljen më të madhe të shqiptarëve në historinë e Shkupit. Ndërsa ajo që vlen të përmendet është se, edhe në pjesët rurale të rrethit të Shkupit, komuniteti turk shënon rritje drastike në krahasim me regjistrimin e para pesë viteve, pra të vitit 1948. Do të përmendim vetëm disa shembuj për ta dëshmuar këtë gjendje. Në komunën e Butelit në vitin 1948, të regjistruar ishin 4755 shqiptarë dhe vetëm 14 turq, ndërkohë që, në po të njëjtën komunë, por pesë vite më vonë, janë të regjistruar 2958 shqiptarë dhe 2204 turq. Kjo statistikë na jep një pasqyrë të saktë të situatës së atëhershme, ku numri i shqiptarëve përgjysmohet, ndërsa numri i turqve rritet për më tepër se 1500%. Situata edhe më të rëndë kemi në komunat e Gjorçe Petrovit dhe të Draçevës, ku nga 53 turq, sa ishin të deklaruar në vitin 1948 në Gjorçe Petrov, në vitin 1953 numri i tyre u rrit në 4783 turq, ndërsa në komunën e Draçevës, numri nga 178 banorë të deklaruar si turq në vitin 1948, në vitin 1953 rritet në 5195 banorë.⁵¹⁷ Mendojmë se pasqyra që fitohet nga këto statistika, e të cilat njëherazi tregojnë edhe situatën e mjerueshme të shqiptarëve të Shkupit me rrethinë, nuk do shumë koment. Koston e turqizimit, asimilimit, shpërnguljes dhe dhunës së pushtetit të kohës si duket, shumë më tepër se të tjerët, e kanë paguar shqiptarët e Shkupit. Kjo, mbase edhe për arsye se Shkupi në këtë kohë ishte edhe qendra kryesore administrative për rregullimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për shpërngulje, prandaj jo rastësisht, presioni më i madh i pushtetit për ta ndryshuar strukturën etnike ishte pikërisht këtu, në çka edhe patën sukses. Mënyra më e lehtë e turqizimit të shqiptarëve në këtë periudhë ishte nëpërmjet shkollimit, përkatësisht nëpërmjet hapjes së shkollave turke në vendbanime të pastra shqiptare. Sa për ilustrim, do të japim numrin e shkollave turke për tërë territorin e Maqedonisë për vitin shkollor 1950/51,

⁵¹⁷ Qerim Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi (1953-1959)*,, fq. 90.

kur ekzistonin 104 shkolla turke, dhe për vitin shkollor 1951/52, kur ekzistonin 144 shkolla turke, numër ky, i cili tregon se vetëm për një vit shkollor u hapën 40 shkolla turke.⁵¹⁸ Gjithashtu, kontribut jo të vogël për asimilimin, e njëherazi edhe për shpërnguljen e shqiptarëve dhanë edhe vetë shqiptarët, sidomos një pjesë e klerit fetar mysliman, shtresë kjo e cila kishte ndikim të dukshëm të popullata. Jo vetëm elementet të cilat nga pushteti depërtuan edhe në jetën fetare, por edhe fanatizmi i madh fetar që ishte i prekur me anë të Ligjit për ndalimin e fereksesë, patën rol shumë të rëndësishëm në bindjen e qytetarëve për tu shpërngulur në Turqi e sidomos tek ajo pjesë e popullatës myslimane me ndërgjegjësim më të ulët kombëtar. Nga të dhënat që na jep Qerim Lita, i cili thirret në të dhënat që i ofron Komisioni i Pakicave Nacionale pranë KQ të LKM, shohim se numri i përgjithshëm i të shpërngulurve nga Maqedonia, deri më 15 mars 1959, arrin shifrën prej 143.800 banorësh, që përbën rreth 11% të popullatës së përgjithshme të Republikës së Maqedonisë.⁵¹⁹ Supozohet se nga ky numër i të shpërngulurve, rreth 100.000 kanë qenë shqiptarë, edhe pse një gjë të tillë është shumë e vështirë që të dokumentohet me fakte, nga shkak se kriteri kryesor dhe i vetëm për të marrë të drejtën e shpërnguljes ishte deklarimi i tyre si turq.

Faktor shumë i rëndësishëm në ndryshimin e strukturës etnike në Shkup me rrethinë ishte edhe kolonizimi me elemente serbe, dhe në momente të caktuara, edhe me elemente bullgare (maqedonase). Një nga prioritetet kryesore të Mbretërisë Serbe, menjëherë pas pushtimit të tokave shqiptare pas vitit 1912, ishte ndryshimi i strukturës etnike të viseve të pushtuara shqiptare. Kjo politikë serbe përkohësisht u ndërpre pas fillimit të Luftës I Botërore, për të vazhduar me një intensitet edhe më të lartë menjëherë pas përfundimit të luftës.

⁵¹⁸ Qerim Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve.....*, fq. 80.

⁵¹⁹ Po aty, fq. 104.

Nëse analizojmë zhvillimin e kolonizimit në përgjithësi në Mbretërinë e Jugosllavisë na del se territoret e banuara me shqiptarë në kuadër të këtij shteti nuk përbënin më tepër se 7–8% të territorit të përgjithshëm të mbretërisë, ndërsa në anën tjetër këto territore ishin të detyruara të pranojnë rreth 40% të numrit të përgjithshëm të kolonëve serbë. Kjo statistikë në mënyrë shumë të qartë na e tregon tendencën e pushtetit të atëhershëm në ndryshimin e strukturës etnike në këto vise.

Edhe Shkupi me rrethinë nuk ishte imun ndaj një procesi të tillë. Madje, kur Shkupi u shndërrua në qendrën kryesore administrative të pjesës jugore të mbretërisë, menjëherë filloi procesi i vendosjes së familjeve të administratorëve dhe ushtarakëve të rinj serbë në Shkup, ndërsa në rrethinën e Shkupit filloi procesi i vendosjes së kolonëve të parë serbë. Sipas një statistike që na e jep Aleksandar Apostolov, deri në fund të vitit 1929, në qarkun e Shkupit janë vendosur 2751 familje kolonësh.⁵²⁰ Nëse çdo familjeje ja shtojmë një mesatare prej 5 anëtarësh, atëherë i bie se qarku i Shkupit është rritur afërsisht me mbi 10.000 banorë. Nëse këtyre të dhënave u shtohet edhe fakti i shpërnguljeve të popullatës myslimane në këtë pjesë, vetvetiu kuptohet se ndryshimi i strukturës etnike të popullatës ishte i pashmangshëm.

⁵²⁰ Александар Апостолов, *Колонизацијата на Македонија во Стара Југославија*, Скопје, 1966, fq. 330.

BESNIK RAMETI

Shkup

NDARJA ADMINISTRATIVE– TERRITORIALE CIVILE NË SHKUP DHE RRETHINË

Gjatë ndarjes së re territoriale të vitit 1920, territori i Kosovës u nda në 5 qarqe: i Zveçanit, i Kosovës, i Dukagjinit (Metohisë), i Prizrenit, Tetovës dhe i Shkupit. Territori i Rrethit të Podgurit (Suharekës) ishte në kuadrin e Qarkut të Prizrenit. Sipas ndarjes së re administrativo–territoriale, Mbretëria SKS–së, sipas Kushtetutës së Vidovdanit, ishte e ndarë në 33 krahina. Sipas Dekretligjit të 22 prillit 1922, territori i vilajetit të Kosovës ishte i ndarë në mes të këtyre krahinave: Kosovës, Vrajës, Zetës, Rashkës, Tetovës dhe Shkupit. Rrethi i Podgurit me qendër në Suharekë bënte pjesë në kuadrin e Krahinës së Kosovës. Kjo ndarje administrativo–territoriale ka mbetur deri më 1 janar 1929, kur vendoset Diktatura e Gjashtë Janarit. Atëherë Mbretëria e SKS–së, e ndërroi emrin në Mbretëri Jugosllave, ndërsa territori i saj është ndarë në njësi të reja administrativo–territoriale – në BANOVINA, në krye me Banin. Kjo ndarje është bërë me ligjin e datës 3. X 1929. Tërë shteti është ndarë në 9 banovina. Territori i banovinave, në mes të cilave u copëtua vilajeti i Kosovës, sipas Ligjit mbi emrin dhe ndarjen e Mbretërisë në njësi administrative, 25% ishte i ndarë në mes të Banovinave të Vardarit, Zetës dhe Moravës. Territori i Rrethit të Podgurit me seli në Suharekë i takonte Banovinës së Vardarit.

Shkupi si qendër administrative pas shpëlljes së diktaturës në Mbretërinë Jugosllave

Krizën e shtetit të Mbretërisë S.K.S. Mbreti Aleksandër do të mundohet ta ”zgjidh” me grushtshtetin që u krye më 6 janar të vitit

1929,⁵²¹ me përkrahjen aktive të oficerëve në pajtim me borgjezinë serbomadhe. Pas shpalljes së diktaturës monarko-fashiste të vitit 1929, mbreti do të deklaroj: “me këtë pushon së ekzistuari Kushte-tuta e Mbretërisë SKS, e 28 qershor të v. 1921”.⁵²²

Mbreti formoi qeverinë e parë në krye me Gjeneral Zhivkoviqin, i cili më 13 janar 1929 do të deklaroj: “se qeveria ka për qëllim kryesor, të sjell rend, rregull dhe disiplinë në administratën shtetërore, që në përdhë sa më të shkurtë të bëjë barazimin e ligjit në tërë hapësirën jugosllave dhe me këtë të siguroj kushte të plota të sigurisë dhe sistemit.”⁵²³ Mbreti solli Kushtetutën në vitin 1931, ndërsa aparati shtetëror u nda në tri pjesë, ku pushteti qe organizuar në principet e burokratizmit-centralist, kurse çështjen nacionale nuk e përmendi as kjo kushtetutë si dhe Kushtetuta e Vidovdanit e vitit 1921. Me themelimin e Mbretërisë Jugosllave shteti u nda në 9 Banovina, kurse banovinat në rrethe dhe komuna.⁵²⁴ Sipas kushtetutës së vitit 1931 bëhet dhe korrektura e kufijve të banovinave, territori i të cilave ishte i caktuar në bazë të ndarjes së vitit 1929. Ndarja e re nuk solli asgjë të re në pikëpamje të rregullimit administrativ, përveç të disa ligjeve të reja, me anën e të cilave edhe më rritej absolutizmi i mbretit, e në anën tjetër varësia e drejtpërdrejtë e udhëheqësve të banovinave, të cilët e kishin tërë pushtetin në duart e tyre. Për ban të parë të Banovinës së Shkupit u emërua Zhika Llaziq.⁵²⁵

⁵²¹ Branko Petranović-Momčillo Zečević, *Jugoslovenski federalizam idje i stvarnost, 1914-1943*, Beograd 1987, f. 287. Proklamacioni i Mbretit Aleksandër, më 6njanar 1929.

⁵²² Sluzhbene novine, 6 janar 1929.

⁵²³ “Novosti Zagreb, 14 siječna 1929.

⁵²⁴ Almanah, *Vardarska banovina*, Beograd 1931 f.9.

⁵²⁵ Arkivi i Maqedonisë-Shkup, “*Materiali juzhni pregled*”, nr. 19, kut. 8 f. 130; banovina dhe bani Zhivoin Laziq, f.89; Zika Llaziq i lindur më 8 mars 1876, në Svakovcima, Qarku i Takovës, nga baba Aleksieje dhe nëna Milojka. Gjimmazin e ulët e ka mbaruar në fshatin Ajdan, të lartën në Beograd, ndërsa fakultetin juridik në 1900. Pasi që e kreu ushtrinë, u punësua në udhëheqësin e qytetit në

Ndërrimet më të mëdha, sa i përket territorit të Kosovës, u bënë me Ligjin e 9.09.1931, që nga shteti ishte proklamuar si ligji për ndryshime dhe plotësime të të ligjit për ndarjen e shtetit në bano-vina të 03.10.1929.⁵²⁶ përveç disa ndryshimeve të vogla në hapsirat e Jugosllavisë. Në Kosovë këto ishin të dukshme në pikëpamje të ndarjes territoriale midis banovinave që edhe më parë e ndanin Kosovën. Këto ndarje territoriale qeveria tentoi ti arsyetonte si të nevojshme për shkak të pozitës-lidhshmërisë gjeografike, të afërsisë në mes vendeve, të cilat iu morën një banovine dhe iu dhanë tjetrës. Me këtë ndarje, më tepër ndërrime pësoi ndarja e hershme në mes të banovinave të Vardarit dhe të Zetës. Ndryshime u bënë edhe në Banovinën e Moravës. Banovinës së Vardarit iu morën dy rrethe; i Gjakovës dhe i Podrimës, kurse Banovinës së Moravës iu mor rrethi i Drenicës. Këto tri rrethe iu bashkëngjitën Banovinës së Zetës. Kur është fjala për numrin e banorëve, duhet të cekim se numri i popullsisë sipas regjistrimeve të bëra më 1921 dhe 1931, si dhe të dhënave të shënuara më lartë, nuk duhet të merren si plotësisht të sakta për shumë shkaqe. Ne po i përmendim vetëm disa prej tyre si p.sh. shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Kosova, pamundësisë së regjistrimit të saktë nga organet shtetërore të qeverisë së Mbretërisë së Jugosllavisë, e cila për shkak të rezistencës së armatosur të popullit në Kosovë dhe trojeve tjera shqiptare, posaçërisht për shkak Lëvizjes Kaçake dhe formave të tjera të rezistencës, nuk e ka kryer këtë detyrë drejtë. Një gjë të tillë e pranojnë edhe vetë organet zyrtare në botimin e rezultateve përfundimtare të regjistrimit të popullsisë më 31.3.1931, ku thuhet se për këto vende janë bërë plotësime nga statistikat e regjistrimit të popullsisë të vitit

Beograd. Në vitin 1912 u emërua “načallnik Beogradskog ogruga”, Ka marrë pjesë në luftën e Parë Botërore kundër Austrisë. Më vitin 1919 mbante postin načallnikut të sigurimit deri në vitin 1928. Gjatë këtij viti u emërua zëvendës ministër. Nga viti 1920, iu nda resori i inspektoratit dhe ka punuar më së shumti për çështje e Maqedonisë. Me ndarjen e shtetit në banovina në vitin 1929, u emërua për banë të Vardarit. Në vitin 1932 u emërua Ministër Punëve të Brendshme deri ë viti 1934, kur edhe u pensionua.

⁵²⁶ “Sluzbene Novine”, *Kralevine Jugosllavije*, 5.X.1929.

1910, të cilin e kishin bërë autoritetet e qeverisë turke.⁵²⁷ Sipas regjistrimit të vitit 1931, në territorin e Kosovës kishte gjithsej 554.667 banorë.⁵²⁸ Për përbërjen e popullsisë në këtë kohë nuk mund të bëhet fjalë, ngase në regjistrim jepen sipas përkatësisë fetare. Gjithashtu relative është edhe numri i popullsisë, nga shkakut se, në një anë bëhej shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Kosova, kurse në anën tjetër shtohet elementi sllav si rezultat i kolonizimit. Sipas disa shënimeve të vitit 1930, territori i banovinave që e ndanin Kosovën në km² ishte ky: Banovina e Vardarit kishte sipërfaqe të përgjithshme prej 36.672 km² me 1.574.243 banorë, me dendësi mesatare të banorëve prej 42,9 në një km². Banovina e Zetës, me sipërfaqe prej 30.997 km² e me 925.516 banorë, me dendësi mesatare prej 29,9 banorë në një km². Banovina e Moravës, me sipërfaqe prej 25.466 km², 1.435.584, banorë ku dendësia mesatare ishte 56,4 banorë në një km².⁵²⁹ Me ndryshimet e fundit territoriale-administrative, të bëra në bazë të ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit të vitit 1929, është bërë edhe ndarja e territoreve të banovinave në rrethe dhe në komuna. Sipas kësaj ndarjeje, ndarja e rretheve në komuna është bërë në këtë mënyrë.

Shkupi si qendër e administratës shtetërore (1929–1941)

Në rregullimin dhe pushtetin e organeve të brendshme shtetërore, të Mbretërisë së Jugosllavisë merrnin pjesë policia dhe xhandarmëria. Këto organe ishin të vendosura me seli në Shkup. Këto ishin organe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Policia ishte organ dhe institucion nën kontrollin e kësaj ministrie, kurse xhandarmëria ishte organ i formuar nga kuadri ushtarak, e nën kontrollin e MPB, por të gjitha urdhërat i merrte dhe iu nënshtrohej ligjeve të Ministrisë së Ushtrisë. Pas shpalljes së diktaturës bëhet dhe ndërimi i rregullimit të këtij organi. Kjo bëhet me ligjin për rregullimin e

⁵²⁷ Definitivni rezultati popisa stanovnistva 31.X.1931 Sarajevë 1940.

⁵²⁸ Definitivni rezultati popisa stanovnistva 31.X.1931 Sarajevë 1940.

⁵²⁹ Staticki Godisnjak 1931. Beograd 1934.

brendshëm të proklamuar në vitin 1929, dhe rregulloren për aplimin e saj. Sipas ligjit në fjalë, ky ishte organ për sigurinë publike dhe organ ndihmës i pushtetit të brendshëm për mbajtjen e rendit dhe të ruajtjes barazisë të interesave të rendit ekzistues shtetëror.⁵³⁰

Xhandarmëria ishte pjesë përbërëse e ushtrisë. Në pikëpamje të disiplinës marrëdhënieve personale e të edukimit i nënshtrohej Ministrisë së Ushtrisë. Sipas këtij ligji xhandarmëria ishte organ policor, që vepronte në suazat e komunës, rrethit, banovinës etj, që u përgjigjej para organeve gjegjëse administrative, dhe kishte karakter ushtarak.⁵³¹ Përveç xhandarmërisë, në Shkup ekzistonte edhe policia komunale. Ky organ shtetëror shërbente për sigurimin e rendit publik brenda në qytet, të cilin pjesërisht e financonte komuna, që ligjërisht ishte e detyruar t'ia sigurojë të gjitha mjetet për punë të suksesshme. Kjo çështje rregullohej me nenin 66, paragrafi 57 i ligjit në fjalë.⁵³² Mënyrën e bashkëpunimit, vëllimin e saj në mes të policisë komunale dhe xhandarmerisë e caktonte organin më i lartë se komuna e rrethi-bani, përfaqësuesi i Banovinës.⁵³³

Për rregullimin e brendshëm, respektivisht, për mbajtjen e rendit publik, me dekretligjin e 4 nëntorit të vitit 1929, nr.49106 janë formuar drejtoratet e policisë së qyteteve. Në Banovinën e Vardarit u formuan: Drejtoratet e policisë në Prishtinë dhe Prizren.⁵³⁴ Në pjesën e Banovinës së Moraves (rrethi i Llapit dhe Vucitërnës) nuk kishte këtë lloje të policisë. Veprimtaria e drejtoratit të policisë në fjalë të qyteteve e përcaktonte dekretligji i MPB i 8.X.1929,⁵³⁵ të cilin së shpejti u abrogua me ligjin e datës 31.X.1929.⁵³⁶

⁵³⁰ Slluzhbene Novine, 6 janar 1929.

⁵³¹ Zakon o unutrashnjoj upravi 1929, Beograd 1932.

⁵³² Zakon o unutrashnjoj upravi 1929, Beograd 1932.

⁵³³ Zakon o unutrashnjoj upravi 1929, Beograd 1932.

⁵³⁴ "Sluzbene Novine" nr. 243, 17. XI. 1929.

⁵³⁵ Po aty dhe "Sluzbene Novine" nr.250 25.II.1929.

⁵³⁶ Po aty dhe "Sluzbene Novine" nr.250 25.II.1929.

Me ligjin mbi drejtoratin e Banovinës,⁵³⁷ në kuadër të banovinave formohen edhe drejtoratet e policisë të cilat paraqitnin pushtetin e përgjithshëm të shkallës së parë. Shtrirja territoriale rregullohej me nenin 85 të Kushtetutës së vitit 1931 dhe me nenin 50 të ligjit mbi rregullimin e brendshëm. Funksionet e këtij drejtorati kanë qenë të shumëllojshme si: funksioni reprezentativ, drejtues, mbikëqyrës, dënues–policor, përfaqësues i pushtetit në rrethe, organ i administratës shtetërore, përfaqësues i pushtetit në popull dhe njëkohësisht ndërmjetësues në mes të popullit dhe shtetit. Kishte për detyrë të përcjellë disponimin e popullit dhe kërkesat e tij në lidhje me çështjet ekonomike, sociale dhe kulturore, por kuptohet krejt këto ishin dhe qëllimet e veta politike, të përcjellin dhe disponimin politik të popullit ndaj organeve të pushtetit.

Drejtoratet policore në rrethe, ishin organ kolektiv, që përveç punëve të përgjithshme kishin edhe referate të posaçme të ndara sipas psh. për politikën sociale, teknike, arsimore, veterinë, ekonomi, pylltari etj. Kurse në rrethe me territor më të gjerë mund të formoheshin përfaqësitë e tyre sipas propozimit të Banit. Vendimin për formimin e këtyre përfaqësive e merrte Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave, kurse vendimin duhej ta aprovonte Këshilli Ministror.⁵³⁸

Drejtoratet e policisë, gati menjëherë më 1931, filluan të abrogohen në disa vende. Abrogimin e tyre e parashihte neni 55 i ligjit mbi rregullimin e brendshëm. Me vendimin e Këshillit Ministror, me kërkesë e MPB–së, në muajin dhjetor të vitit 1931 u abroguan disa drejtorate të policisë, dhe ato së pari në zonat kufitare, ku konsiderohej se regjimi nuk ishte në rrezik, ku kishte numër të madh të xhandarmerisë dhe të ushtrisë. Funksionin, detyrën e këtyre drejtorateve iu ngarkua xhandarmerisë, në bazë të rregullores e cila u proklamua nergut për këtë çështje. Në bazë të vendimit të përmendur

⁵³⁷ “Iluzhbene novine” Kralevine Jugoslavije, nr. 261, 7. XI.1929.

⁵³⁸ *Po aty dhe “Sluzbene Novine” nr.250 25.II.1929.*

më 18 dhjetor të vitit 1931, abrogohet drejtorati policor në Pejë, i cili vendim hyri në fuqi më 1.I.1932,⁵³⁹ kurse drejtorati i policisë në Prishtinë u abrogua një muaj pas, më 1.II.1932 dhe kështu të njëjtin vit abrogohet dhe drejtorati i policisë në Prizren.⁵⁴⁰

Inspektoratet u formuan në bazë të vendimit të MPB, paragrafit 20 dhe 22, të ligjit për emërimin dhe ndarjen e mbretërisë në krahina sunduese-banovina, i cili u shpall më 23.X.1929. Këto ishin organe ndihmëse të banit, në të gjitha punët e sigurisë publike, në lëmin e inspektimit. Si organ i lartë shtetëror inspektoratet ishin të obliguara të kujdesen për sigurinë publike, të bëjnë mbikëqyrjen në kryerjen e detyrave në të gjitha organet shtetërore, nga banovina e deri në komunë, të japin udhëzime për kryerjen e detyrës, kishin të drejtë që në çdo kohë, të bëjnë kontrollin për të gjitha ato organe që ishin nën mbikëqyrjen e tyre.

Në trojet shqiptare u formuan dy inspektorate të këtij lloji. Në pjesën e Banovinës së Vardarit u formua në Prizren, i cili në vetë përfshinte këto rrethe administrative: Gjilanin, Gorën, Gjakovën (deri në vitin 1931, kur u bënë ndërrimet territoriale) Nerodimën, Suharekën dhe Podrimjen. Pra, territori i Kosovës që bënte pjesë në Banovinën e Zetës qendra e këtij inspektorati ishte në Mitrovicë, e që përfshinë këto rrethe: Mitrovicës, Dezhevën, Istogun, Pejë, Studenicën, Shtavicën dhe prej vitit 1931 edhe rrethet e Gjakovës dhe të Podrimës (Rahovecit).⁵⁴¹ Pas vitit të përmendur inspektoratit të Mitrovicës i bashkëngjitet edhe rrethi i Drenicës me qendër në Skenderaj, i cili rreth deri në vitin 1931 bënte pjesë në Banovinën e Moravës. Në këtë banovinë sa i përket territorit të Kosovës nuk pati inspektorat të këtillë. Si organ shtetëror kishte për detyrë të inspektoi-kontrolooi punën e organeve të punëve të brendshme,

⁵³⁹ "Sluzbene Novine" nr.297, 18.XII.1931.

⁵⁴⁰ "Sluzbene Novine" nr. 21, 29.I.1932, nr.37 17. II.1932.

⁵⁴¹ Vlad. Marinković, recnik-imenik, mesta Kraljevine Jugoslavije, Bgd . 1930, dhe "Sluzbene Novine" NR. 250, 25.x.1929.

financave si dhe të ndihmojë në kryerjen e kësaj detyre që nga banovina e deri në komunë.

Si organ kontrollues i organeve të punëve të brendshme, puna e tij qe e përkohshme, çfarë ishin edhe drejtoratet e policisë. Kështu me pëlqimin e kontrollit kryesor, MPB, në mars të vitit 1934 solli vendimin për anulimin e disa inspeksioneve në disa banovina. Vendimi i përmendur më parë u mor në bazë të nenit 20 të ligjit për ndarjen dhe emërimin e mbretërisë së Jugosllavisë në banovina.⁵⁴² Me këtë vendim anulohen shumë inspektorate të inspeksionit në gjithë territorin e Mbretërisë së Jugosllavisë, e poashtu edhe ato në Kosovë, të cilat i përmendëm, në Prizren dhe në Mitrovicë. Detyrat nga fushëveprimi i tyre, të inspektorateve të anuluar, në territoret e tyre mbikëqyrëse kalojnë në mbikëqyrjen e banëve të banovinave gjegjëse.

Në rregullimin dhe pushtetin e organeve të brendshme shtetërore, të mbretërisë së Jugosllavisë merrnin pjesë policia dhe xhandarmëria. Këto ishin organe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Policia ishte organ dhe institucion nën kontrollin e kësaj ministrie, kurse xhandarmëria ishte organ i formuar nga kuadri ushtarak, dhe nën kontrollin e MPB, por të gjitha urdhrat i merrte, dhe iu nënshtrohej ligjeve të Ministrisë së Ushtrisë.

Numri i organeve shtetërore në territorin shqiptarë ka qenë shumë i madh, jo vetëm sa i përket shumëllojshmërisë së tyre, por edhe nga numri i tyre dhe se barrën kryesore në pikëpamje të sigurisë së rendit e ka mbajtur vetë ushtria në bashkëpunim me xhandarmërinë, e cila vepronte e para, për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi dhe vende të tjera.

- Me marrjen e gjithë pushtetit nga ana e mbretit, më 1929 e veçanërisht pas forcimit të pushtetit të gjeneral Zhivkoviçit, likuidimit të partive

⁵⁴² “Sluzbene Novine” nr. 66 21.III.1934.

politike, filloi të veprohet jo vetëm sipas dëshirës së garniturës ushtarake në pushtet, por edhe të atyre sundimtarëve të vegjël-banëve, të cilët e kishin fituar besimin e plotë, prandaj vepronin sipas qejfit të tyre e në emër të popullit. Kështu që nga viti 1930, fillon ndërrimi i emrave të vendbani-meve-fshatrave, të selive të komunave e të tjera, e duke e paraqitur çdo veprim të tyre, si dëshirë e popullit. Rëndësia historiografike e emërtimeve të reja, qëndron në atë se edhe sot disa vende i njohim sipas ndërrimeve në fjalë, ndërsa në popull edhe tash ruhen emrat e vjetër. Në anën tjetër, rëndësia e emërtimeve të reja ishte se synohej zhdukja e emrave të lashtë toponomastikë.

NATASHA DIDENKO & ALBERT HANI

Shkup

LËVIZJET KULTURORE NË SHKUP, MES DY LUFTËRAVE BOTËRORE (1918–1928)

Lënda e hulumtimit tonë është “Lëvizjet kulturore në Shkup, mes dy luftërave botërore (1918–1928)”. Arsyeja për zgjedhjen e hulumtimit të kësaj periudhe dhjetëvjeçare është për shkak të asaj që sipas specifikave dhe karakteristikave të saja, kjo periudhë paraqet tërësi të rëndësishme e cila do të kontribuojë për ndriçimin dhe hulumtimin e mundësive kulturore në të ashtuquajturën Serbi Jugore, më saktësisht për të gjitha shoqëritë shkencore, nacionale–arsimore dhe kulturore–arsimore dhe institucionet tjera kulturore. Në këtë rast do të paraqiten rezultatet e hulumtimit tonë, të cilat kanë të bëjnë me: “Shoqërinë Shkencore të Shkupit”, të themeluar më 25 mars 1921; degën e “Shoqërinë Gjeografike”, të themeluar në Shkup në vitin 1922; Shoqëria shkencore “Shoqëria e gjuhës serbe dhe letërsisë”, e themeluar në Shkup, në vitin 1926; Shoqëria Kulturore Nacionale “Shën Sava”, e cila ka vepruar nëpërmjet hapjes së shkollës së natës në Shkup në vitin 1925; “Shoqëria e Sokolave” në nivel nacional e cila pas hapjes së “Unionit të Sokolave” në Shkup, në vitin 1923 fillon të veprojë dhe ta rrisë numrin e shoqërive të tyre; “Shoqatat muzikore dhe të këngëtarëve” të cilat kanë qenë të përshtatshme për të vepruar në mesin e masave të gjera, posaçërisht në mesin e gjeneratës së re, si edhe “Shoqëritë e arsimit fetar” të cilat e kanë përhapur arsimimin fetar dhe kulturën në mesin e ithtarëve të tyre”. Njëkohësisht, do të prezantohen edhe rezultatet të cilat do të kenë të bëjnë me institucionet e ndryshme kulturore edhe atë: bibliotekat, vendet e leximi dhe Shkolla Popullore, të cilat është dashur ta theksojnë karakterin serb të maqedonasve, shqiptarëve, turqve, vllahëve, boshnjakëve. Hulumtimi para-

qet përpjekje për paraqitje gjithëpërfshirëse të kësaj teme në shkencën tonë historike, për shkak të plotësimit të plotësimit të njohurive për proceset historike dhe tendencat e lëvizjeve kulturore në Shkup, mes dy luftërave botërore, si pjesë e rëndësishme e historisë sonë kulturore.

★★★★★

MUNDËSITË KULTURORE NË SERBINË JUGORE

Të gjitha shoqëritë, organizatat dhe institucionet kulturore të cilat kanë ekzistuar prej më herët, janë pezulluar dhe në vend të tyre janë themeluar vetëm shkolla serbe. Janë krijuar shoqata të ndryshme rinore, kulturore–arsimore, shoqata femrash, vende për lexim, shoqata mësuesish dhe institucionet të tjera.

Maqedonasve në Serbinë Jugore u është ndaluar të organizojnë shoqata të tyre vetjake. E njëjta, ndoshta në masën më të vogël është zbatuar edhe ndaj shqiptarëve, turqve, vllahëve, boshnjakëve.

Populli maqedonas, shqiptar, turk dhe popullsitë e tjera kanë qenë nën shtypje dhe është dashur të anëtarësohen në shoqata dhe organizata të ndryshme serbe të cilat kanë pasur përkrahje të madhe nga pushteti. Udhëheqja e atyre shoqatave çdoherë është përbërë nga njerëz, në të cilët pushteti ka pasur besim të plotë. Detyra e tyre ka qenë ta ndjekin në mënyrë aktive çdo anëtar individualisht.

Me nismë të pushtetit serb në Serbinë Jugore janë organizuar degë të shoqatave kulturore–arsimore serbe. Është formuar dega e shoqatës kulturore arsimore serbe në Sarajevë “Prosveta” (“Arsimi”), ndërsa në Shkup dhe në qytetet tjera maqedonase janë formuar degë të posaçme të kësaj shoqërie.⁵⁴³

⁵⁴³ “Дружество за србизирањето на Македонија”. в. Независима Македонија: Софија, бр. 82, 31.X.1924, f. 2.

Pjesa më e madhe e shoqatave, të cilat kanë vepruar mes popullsive tanimë të përmendura, nga janë ndihmuar materialisht nga pushteti. Të udhëhequr nga personat në të cilët pushteti ka pasur besim të plotë, këto shoqata kanë shërbyer si vende ku më mirë kanë mundur të vëzhgohen, ata të cilët kanë qenë të dyshimtë.

Vëmendje të posaçme i është kushtuar rinisë së Serbisë Jugore, që të mos organizohen rastësisht në shoqata të veçuara kulturore–arsimore, sportive, mirëbërëse ose shoqata tjera. Kjo ka qenë rreptësisht e ndaluar. Rinisë nga Serbia Jugore është lejuar që të anëtarësohet vetëm në organizatën serbe, e cila është themeluar dhe udhëhequr në Beograd.

SHOQËRIA SHKENCORE E SHKUPIT

Shoqëria Shkencore e Shkupit është themeluar me nismë të një grupi të profesorëve të Fakultetit Filozofik në Shkup, disa mësimdhënësve të arsimit të mesën dhe intelektualë të tjerë, më 25 mars 1921. Kryetari i parë i kësaj shoqërie ka qenë dekani i Fakultetit Filozofik D–r Tihomir Ostojiq ndërsa më vonë edhe D–r Radoslav Grujiq. Detyra themelore e kësaj shoqërie ka qenë që në mënyrë të gjithanshme t’i studiojë Serbët Jugorë nga aspekti historik, arkeologjik, etnografik, social, ekonomik, gjeografik, historik–artistik, lingvistik, antropologjik dhe të ngjashme.⁵⁴⁴

Në fillim të vitit 1922, kjo shoqëri ka bërë riorganizimin dhe ka formuar seksion historik–arkeologjik, ku kanë mbajtur ligjërata të rregullta. Ligjëratat janë mbajtur nga ana e ligjëruesve të njohur, të cilët kanë qenë profesorë, doktorë shkencash që janë marrë me hulumtime shkencore. Megjithatë, të gjitha ato ligjërata janë drejtuar drejt asimilimit të maqedonasve, shqiptarëve, turqve, vllahëve, boshnjakëve dhe mohimit të ekzistimit të tyre d.m.th. është dëshmuar se këta popuj janë serbë dhe se atdheu i tyre Maqedonia ka

⁵⁴⁴ „Скопско Научно Друштво“. Јужна Србја: Скопље, 1922, књ. I, бр. 3, ф. 118.

qenë Serbia Jugore. Për shkak të qëllimeve, të cilat kanë dashur t'i arrijnë, këto ligjërimi nuk kanë hasur në praninë të mirë dhe për këtë arsye më 21 mars 1925, shoqëria ka ndërmarrë riorganizim të ri.⁵⁴⁵

Do të përmendim disa motive të cilat e kanë udhëhequr punën e kësaj shoqërie: Aksion të madh dhe gjerësisht të menduar i cili është planifikuar për zbatim, e i cili ka qenë e pamundur të realizohet për shkak të mjedisit; deficit i numrit të njaftueshëm të kuadrit të përgatitur dhe mungesa e mjeteve materiale. Për shkak të të gjitha këtyre rrethanave, si edhe për shkak të përkrahjes së dobët të mjedisit ku ka vepruar Shoqëria, nuk ka mundur të theksohet me aktivitetin e vet, me ndonjë aksion më të gjerë dhe më dinamik në organizimin e punës shkencore dhe hulumtimin sistematik të problemeve të shumta me të cilat është ballafaquar Serbia Jugore.

Me zbatimin e organizimit të ri të “Shoqërisë Shkencore të Shkupit”, në vitin 1925 janë krijuar kushte më të mira materiale, të cilat kanë mundësuar botimin e revistës “Glasnik” (“Zëdhënësi”) të Shoqërisë Shkencore të Shkupit. Në këtë “Glasnik” janë botuar rezultatet e hulumtimit dhe studimit shkencor të Serbisë Jugore me zonat përreth.⁵⁴⁶

Nga e theksuara më lartë mund të përfundojmë se në “Glasnik”, kanë pasur mundësi të shpallen vetëm shkrime, të cilat kanë qenë në përputhje me zbatimin e politikës denacionalizuese dhe asimiluese, me sundimin e borgjezisë së madhe serbe në Serbinë Jugore, ku është dashur të zbatohet kjo politikë antinaqedonase.

Nëse fillojmë të analizojmë kush ka mundur të jetë anëtar i “Shoqërisë Shkencore të Shkupit”, duke theksuar se ata kanë mundur të jenë punëtorë shkencorë dhe artistë të cilët janë theksuar me

⁵⁴⁵ Рад. М. Грујић. „Скопско Научно Друштво“. Јужна Србија: Скопље, 1925, бр.48, ф. 54.

⁵⁴⁶ Рад. М. Грујић. „Скопско Научно Друштво“. Јужна Србија: Скопље, 1925, бр.48, ф. 54.

punimet e tyre shkencore ose artistike ose me kontributet e tyre të posaçme në fushën e shkencës dhe artit në “Serbinë Jugore”⁵⁴⁷, mund të nënvizojmë se edhe në këtë mënyrë janë diskriminuar maqedonasit, shqiptarët, turqit, vllahët, boshnjakët, me atë që as në rrugën e shkencës këtyre popujve nuk u është lejuar të marrin pjesë në diskutimet të cilat i kanë prekur edhe atë në mënyrë të drejtpërdrejtë në atdheun e tyre.

Materialet që janë botuar në “Glasnik”, kanë qenë me fakte të përvetësuara, të paraqitura si serbe nga e kaluara historike e kombësive të theksuara më lartë. Glasniku i “Shoqërisë Shkencore të Shkupit”, bashkë me botimet e tjera të cilat i ka botuar kjo shoqëri, janë shkëmbyer me 50 qendra kryesore shkencore në Evropë dhe me botën tjetër.⁵⁴⁸ Sipas përmbajtjes së saj mbishkrimet kanë pasur për qëllim të bindin botën për karakterin serb të Serbisë Jugore.

Si edhe një vërtetim se Shoqëria ka shërbyer edhe paraqitur përcjellëse të politikës racionalizuese dhe asimiluese të Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (SKS) në Serbinë Jugore paraqet: mbështetja materiale e kësaj shoqërie nga ana e shtetit, ndërsa në vetëqeverisje dhe në mesin e krijuesve privatë, vend kryesor ka pasur mbreti Aleksandër.⁵⁴⁹

Sipas qëllimeve të theksuara më lartë, në vitin 1922 është themeluar edhe dega e “Shoqërisë Gjeografike” në Shkup. Nismëtarë për formimin e kësaj shoqërie kanë qenë mësimdhënësit e Fakultetit Filozofik në Shkup. Në këtë shoqëri janë bashkëngjitur edhe mësimdhënësit e arsimit të mesëm. Shkrimet të cilat janë diskutuar dhe janë shqyrtuar në mbledhjet e kësaj shoqërie kanë qenë nga

⁵⁴⁷ По аty, ф. 55.

⁵⁴⁸ Др. Вој. С. Радовановић. „Скопско Научно Друштво“. Споменица двадесетпетгодишњице ослобођења Јужне Србије 1912 – 1937: Скопље, 1937.

⁵⁴⁹ По аty, ф. 1010.

fusha e gjeografisë, etnografikë, folklorit maqedonas, ndërsa janë botuar në Glasnik të “Shoqërisë Shkencore të Shkupit”.

Në rendin e shoqërive shkencore ka bërë pjesë edhe “Shoqëria e gjuhës serbe dhe letërsisë”⁵⁵⁰, që është formuar në vitin 1926, me nismën e mësindhënësve të Fakultetit Filozofik në Shkup. Si në shoqëritë paraprake, edhe në këtë shoqëri janë bashkëngjitur edhe mësindhënësit e arsimit të mesëm. Vetë emri i shoqërisë, na udhëzon se i ka përfshirë çështjet e fushës së gjuhës serbe, letërsisë serbe dhe gjuhës mësimore në shkollat e mesme. Megjithatë edhe kjo shoqëri, gjithashtu nuk ka pasur mundësi ta zhvillojë aktivitetin e saj sepse qëllimi kryesor i saj ka qenë ta potencojë gjuhën serbe, me të cilën është dashur të kryhet serbizimi i maqedonasve, shqiptarëve, turqve, vllahëve, boshnjakëve.

SHOQËRIA “SHËN SAVA”

Në mesin e shoqërive të cilat kanë luajtur dhe kanë pasur rol të posaçëm në përhapjen e arsimit dhe kulturës nacionale serbe në Serbinë Jugore, vend të rëndësishëm merr edhe shoqëria “Shën Sava”, e cila është themeluar në vitin 1886 në Beograd. Kjo shoqëri posaçërisht është theksuar me aktivitetin e saj në atë fushë, si në periudhën e themelimit të saj deri në Luftën e Parë Botërore, ashtu edhe më vonë.

Me krijimin e Mbretërisë SKS, Shoqëria “Shën Sava” në Shkup menjëherë e ka themeluar komisionin e saj dhe ka filluar të veprojë në mënyrë aktive në Serbinë Jugore në zbatimin e politikës së de-nacionalizimit dhe asimilimit në mesin e të rinjve.

Për atë qëllim është shërbyer me forma dhe metoda të ndryshme të punës. Njëra nga metodat themelore ka qenë shkolla e natës e cila është hapur në Shkup në vitin 1925. Në këtë shkollë janë regjis-

⁵⁵⁰ Др. Вој. С. Радовановић: „Скопско Научно Друштво“, Споменица ... ф. 1010.

truar 88 nxënës, në mesin e të cilëve kanë mbisunduar fëmijët me fe myslimane.⁵⁵¹

Në vitin shkollor 1925–1926, në këtë shkollë kanë ekzistuar 3 paralele me 120 nxënës, prej të cilëve 98 nxënës kanë përfunduar në paralelen e analfabetëve. Në vitin vitet vijuese 1926–1927 kanë ekzistuar dy sektorë me 6 seksione dhe me 163 nxënës, prej të cilëve 110 e kanë mbaruar vitin shkollor. Ndërsa, në vitin shkollor 1927–1928 kanë punuar dy sektorë me 6 seksionet me 143 nxënës.⁵⁵²

Mund të përfundojmë se në këtë shkollë nate të shoqërisë “Shën Sava”, në periudhën e vitit shkollor 1925 deri në vitin 1929 janë regjistruar dhe kanë qenë të pranishëm 426 nxënës, si kadetë të shoqërisë “Shën Sava”.

Forma tjetër të veprimit kanë paraqitur bursat e studentëve dhe nxënësve të Serbisë Jugore gjatë kohës së shkollimit të tyre në Universitet dhe në Shkollat e Mesme në Mbretërinë SKS. Shoqëria “Shën Sava” u ka ndihmuar dhe ka mbajtur 52 studentë të në fakultet. Në vitin e njëjtë u ka ndihmuar edhe 58 nxënësve dhe punëtorëve arsimorë.⁵⁵³

Në mesin e formave të ndryshme të veprimit në praktikë ka qenë edhe ndarja e shpërblimeve të posaçme në përpilimin e temës, e ashtuquajtura “Tematika e Shën Savës”, e cila është përfshirë nga ana e këshillit kryesor të Shoqërisë “Shën Sava”. U është ndarë nxënësve të gjimnazit në Serbinë Jugore. Në vitin 1926 i janë ndarë dy shpërblime të këtilla “Gjimnazit të Strumicës”⁵⁵⁴. Lartësia e

⁵⁵¹ „Извештај Главног Одбора Друштва Св. Сава, од раду у прошлој години (1925)“. Братство, XXI: Београд, 1927, f. 334.

⁵⁵² С.: „Школо Друштво Св. Сава во Скопје“. Јужен Преглед: Скопје II, 1928, бр. 5, f. 234.

⁵⁵³ „Извештај Главног Одбора Друштва Св. Сава, од раду у прошлој години (1925)“. Братство, XXI: Београд, 1927, f. 334

⁵⁵⁴ По ату, f. 335.

shpërblimit të parë ka qenë 200, ndërsa e shpërblimit të dytë ka qenë 100 dinarë”.

Shoqëria njëkohësisht ka shërbyer edhe si organ këshillëdhënës, i cili ka dhënë mendim në lidhje me “çështjet e ndryshme nacionale” dhe gjithkund është theksuar si shoqëri më e vjetër, më dramatike, më kulturore—arsimore dhe nacionale.⁵⁵⁵

Për zgjerimin e ideve nacionaliste dhe shoviniste serbe në mesin e maqedonasve, shqiptarëve, turqve dhe popullsive të tjera në Serbinë Jugore, Shoqëria i ka dërguar publikimet e saja si dhuratë falas te shkollat e caktuara fillore, shkollat e mesme, bibliotekat, vendet e leximit. Publikimet e kësaj shoqërie janë ndarë si shpërblimet të nxënësve të shkëlqyeshëm dhe solidë në fund të vitit shkollor.

Shpirtgjërësia e këtillë e shoqërisë “Shën Sava” mund të zbatohet, sepse mjetet financiare me të cilat ka disponuar shoqëria janë siguruar nëpërmjet dhuratave të pasura nga mbreti dhe qytetarët e pasur, të cilët nuk i kanë kursyer mjetet kur kanë qenë në pyetje idetë e mëdha serbe në mesin e kombësive në Serbinë Jugore. Mjetet financiare Shoqërisë “Shën Sava” i janë nga ana e Ministrisë së Arsimit, e cila në vitin 1925 vetëm për nevojat e shkollës së natës të Shoqërisë “Shën Sava” në Shkup, ka ndarë dhe dhuruar 6000 dinarë.⁵⁵⁶ Në vitin e njëjtë kësaj shkolle në Shkup edhe mbreti i ka dhuruar 10.000 dinarë.⁵⁵⁷

Shoqëria “Shën Sava” i ka kushtuar vëmendje të madhe zbatimit të politikës së planifikuar denacionalizuese dhe asimiluese në Serbinë Jugore. Shoqëria është kënaqur në përkrahjen e shumëllojshme të borgjezisë sunduese.

⁵⁵⁵ Јов. Хаџи Василевиќ. „Прилике под којима је постало друштво Св. Сава и његов рад од постанка до сада“. Братство: Београд, XVIII, 1924, књ. 1, ф. 14.

⁵⁵⁶ По ату, ф. 331.

⁵⁵⁷ По ату, ф. 331.

Si e ka menduar borgjezia serbe aksionin politik të Shoqërisë “Shën Sava” në Serbinë Jugore, tregon edhe akti i rëndësishëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Mbretërisë SKS, të drejtuar drejt kësaj shoqërie në mjedisin e vitit 1923.⁵⁵⁸

Nga Shoqëria “Shën Sava” është kërkuar që ta ndërmerr shkollimin e një numri të caktuar të maqedonasve, shqiptarëve, turqve dhe popullsisë të tjera si bursistë të kësaj shoqërie, e cila është dashur ta kultivojë “Shpirtin e Shumadisë” dhe t’i kthejë si mësimdhënës në Serbinë Jugore. Së këndejmi mund ta shohim rolin e rëndësishëm të Shoqërisë “Shën Sava” në zbatimin e politikës nacionale serbe në Serbinë Jugore. Shoqëria “Shën Sava”, në mënyrë të përpiktë i ka kryer detyrat e vendosura para vetes, ndërsa kjo shihet nga raportet vjetore të cilat i ka dorëzuar në kuvendin e përgjithshëm vjetor.⁵⁵⁹

SHOQËRIA E SOKOLAVE

Shoqëria e Sokolave zë vend të rëndësishëm në mesin e shoqërive të cilat kanë qenë të përcaktuara që ta përhapin kulturën nacionale serbe dhe arsinin në Serbinë Jugore. Te sllovenët lëvizja e sokolave është zhvilluar në vitet e 60-ta të shek. XIX, nga lëvizja e përgjithshme gjimnastike. Në fillim, ka paraqitur lëvizje të pastër shëndetësore e cila sokolave u ka shtuar shpirt të fuqishëm nacional.⁵⁶⁰

Të parët të cilët e kanë zhvilluar lëvizjen e sokolave në mesin e popujve sllavë kanë qenë çekët. Miroslav Tirsh ka qenë udhëheqësi

⁵⁵⁸ Dokumentin e ka botuar K. Xhambazovski. „Два документа за проучувањето на националниот развој на македонскиот народ меѓу двете светски војни“. Историја: Скопје, IX, 1973, бр.2, ф. 283-285.

⁵⁵⁹ Shih: „Извештај Главног Одбора Друштва Св. Саве...“, Братство... ф. 327-341; „Друштво Свети Сава“, Извештај са XIX редовне скуштине, одржане 30 марта 1930 године, Братство: Београд, XXV, 1931, књ. 40, ф. 198-206.

⁵⁶⁰ Др. Перо Слијепчевић. „Развој соколства у Чехословачкој и осталих Словена“. Јужни Преглед, Скопље, II, 1928, бр.10, ф. 38.

i tyre dhe “shpirti i lëvizjes”, i cili në Pragë e ka themeluar shoqërinë e parë të sokolave”.⁵⁶¹

Pas Çekëve, ideja e sokolave ka kaluar te jugosllavët dhe re sllovenët, të cilët në vitin 1863 në Lubjanë e themelojnë shoqërinë e sokolave “Sokoli i Jugut”.⁵⁶²

Lëvizja e Sokolave në Serbinë e Jugut ka filluar të përhapet nga koha e Revolucionit Xhonturk (1908), si lëvizje nacionaliste serbe, bashkë me institucionet tjera nacionaliste.⁵⁶³ Në atë kohë shoqëritë e sokolave nuk kanë pasur ndonjë organizim të madh, kryesisht e kanë përfshirë rininë e shkollave të mesme nëpër internate, gjimnaze dhe shkolla mësuesish. Aktiviteti i këtyre shoqërive, më së shpeshti është varur nga personat të cilët janë vendosur në krye. Me largimin e tyre është shuar edhe puna e shoqërive të sokolave. Këto shoqëri kanë qenë si institucione kulturore dhe kanë qenë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të komunës kishtare-shkollore.⁵⁶⁴ Zakonisht, mësimdhënësit nëpër gjimnaze janë vendosur në krye të shoqërive të sokolave.

Shoqëritë e sokolave, si organizatë për përhapjen e kulturës fizike në Serbinë e Jugut, si edhe për përhapjen e propagandës serbe, para së gjithash tipare nacionaliste, e jo gjithësllave, respektivisht jugosllave – përkundër idesë për vëllazërim dhe bashkim të popujve sllavë dhe luftës së përbashkët për liri kundër të huajve.

Në Shkup, në vitin 1909 me nismë të Rajka Karakllajimës (mësimdhënëse e gjimnastikës në gjimnazin propagandistik serb), gjithashtu është formuar shoqëria e parë e sokolave, si shoqëri na-

⁵⁶¹ Po aty, f. 40.

⁵⁶² Po aty, f. 40.

⁵⁶³ Т. М. Живковиќ. „Прилог историји соколства у Јужној Србији“. Јужни Преглед: Скопје, II, 1928 бр. 10, ф. 45.

⁵⁶⁴ Po aty, f. 45.

cionaliste serbe⁵⁶⁵, nën emrin “Silni” (“Të fuqishëm”). Në atë kohë ka punuar bashkë me shoqërinë e porsaformuar të këndimit “Var–dar” në Shkup nën udhëheqjen e dirigjentit Pere Iliç.⁵⁶⁶

Me nismën e Rajka Karaklajimës, shoqëria e sokolave në vitin 1910 është themeluar edhe në Kumanovë.⁵⁶⁷ Në vitin 1911, mësimdhënësi Gjorgji Bozhinoviç e ka themeluar shoqërinë e Sokolave në Kumanovë.⁵⁶⁸ Në vitin 1912 i njëjti mësimdhënësi e ka themeluar shoqërinë e sokolave në Kriva Pallankë, ku është zhvendosur me shërbim. Megjithatë, me largimin e tij, është ndërprerë funksionimi i shoqërisë në Tetovë.

Në vitin 1909 në Veles është themeluar shoqëria e sokolave “Veleshki junak” (“Trim i Velesit”), e cila ka ekzistuar deri në vitin 1912.

Pas Luftërave Ballkanike, ministri i atëhershëm i arsimit Ljubo Jovaniç, u ka kushtuar rëndësi të madhe shoqërive të sokolave, në kuptim të përhapjes së propagandës serbe në Serbinë Jugore dhe me qëllim ka dërguar punëtorë të dalluar të sokolave në më shumë vende në Serbinë Jugore. Kështu janë dërguar: Mihajlo Gradojeviç (mësimdhënësi i diplomuar i gjimnastikës) në Kumanovë; çeku Josip Prohaska, si mësimdhënësi i gjimnastikës është dërguar në Manastir; Frantishek Vanjik, si mësimdhënësi i gjimnastikës në gjimnaz, është dërguar në Tetovë, ndërsa Jarosllav Voshta, si mësimdhënësi i gjimnastikës, është dërguar në Shkup.⁵⁶⁹ Nën udhëheqjen e këtyre personave, shoqëritë e sokolave kanë filluar të zhvillojnë aktivitete më të mëdha.

Posaçërisht, me punën e tyre janë theksuar shoqëritë e sokolave në Shkup dhe Kumanovë. Megjithatë edhe këto shoqëri kanë punuar

⁵⁶⁵ Т. М. Живковиќ: „Прилог историји соколства у Јужној Србији“. Јужни Преглед: Скопље, II, 1928 бр. 10, ф. 46.

⁵⁶⁶ По аty, ф. 46.

По аty, ф. 46.

⁵⁶⁸ По аty, ф. 47.

⁵⁶⁹ По аty, ф. 48.

me ndërprerje. Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, në Mbretërinë e porsakrijuar të SKS, ka filluar t'i kushtohet vëmendje më e madhe punës së shoqërive të sokolave. Në fillim edhe krahas të gjitha përpjekjeve, nuk ka pasur rezultate të dukshme. Situata e këtillë ka zgjatur deri në vitin 1923, kur është formuar Unioni i Sokolave në Shkup.⁵⁷⁰

Megjithatë, këto shoqëri të sokolave janë organizuar në mënyrë të parregullt. Me formimin e Unionit të Sokolave “Kraleviç Marko”, me aktvendim të Lidhjes Jugosllave të Sokolave, të sjellë më 2 prill 1923 në Shkup⁵⁷¹, ka filluar të rritet numri i shoqërive të sokolave. Problemi më i madh i punës së këtyre shoqërive ka qenë kuadri kryesor udhëheqës.

Gjatë vitit 1923–1924, me qëllim të krijimit të udhëheqësit profesional kanë filluar të mbahen të ashtuquajturat “Trajnime të avancuara”. Edhe pse drejtorja e unionit i ka ndërmarrë të gjitha masat e mundshme, që t'u mundësohet individëve të sokolave të forcohen dhe ta zhvillojnë punën e tyre, megjithatë kanë ekzistuar edhe momente kritike të cilat i kanë pranuar edhe vet bashkëkohësit.⁵⁷²

Krahas popullit maqedonas edhe popullsitë e tjera në Serbinë Jugore kanë shfaqur rezistencë të madhe dhe mosbesim ndaj shoqërive të sokolave.

Në periudhën nga vitit 1918 deri në vitin 1928 populli e ka shfrytëzuar situatën, në të cilën pushteti borgjez serb ende nuk ka

⁵⁷⁰ Мирко Јовановић. „IV Национално витештво. Соколство“. Споменица...стр. 1027; Т.М. Живковић. „Прилог историји соколства у ...“. Јужни Преглед... f. 49.

⁵⁷¹ По ату, f. 49.

* Sqarimi i terminologjisë: Dr. Vojo Kushevski, në vend të “Serbisë Jugore”, e shfrytëzon shprehjen Maqedonia e Vardarit.

⁵⁷² Мирко Ф. Јовановић, проф. Учитељске школе у Скопљу, у напису. „Соколство у Јужној Србији од ослобођења до данас“. Јужна Србија: Београд, 1937, f. 76.

pasur kuadër të mjaftueshëm të përgatitur udhëheqës për shoqëritë sokolave. Megjithatë, situata e parregulluar e Mbretërisë SKS, ka sjellë deri te ajo që të mos ketë numër të madh të anëtarëve të anëtarësuar në këto shoqëri, prandaj janë ndërmarrë masa që të tejkalohet kjo rezistencë.

Në vitin 1927 është ndërtuar edhe Shtëpia e Posaçme e Sokolave në Shkup. Prej atëherë, Shkupi është shpallur si qendër e rëndësishme e aksioneve të organizuara nacionaliste të sokolave në pjesët jugore të Mbretërisë SKS. Rëndësia e këtij institucioni, të cilit i është kushtuar kujdes i veçantë, është vërtetuar me të që edhe vet mbreti ka ndihmuar në zgjerimin e punës së këtyre shoqërive me dhurimin e 60.000 dinarëve.⁵⁷³ Me ndihmën e këtyre parave është përgatitur kuadër i veçantë (38 anëtarë dhe 28 anëtare), në trajnimet shtatë javore, të cilat pas mbarimit të tyre në tetor 1927 janë shpërndarë në tërë Serbinë Jugore. Qëllimi i tyre ka qenë që ta popullarizojnë sa më shumë veprimtarinë e sokolave në tërë Serbinë Jugore.

Në shtator të vitit 1928 në Shkup është mbajtur marshi i VI krahnor i lidhjes jugosllave të sokolave. Arsytet themelore dhe reale për moseset u janë veshur sokolave, e cila e ka zbatuar politikën nacionaliste serbe, e cila ka synuar drejt denacionalizimit dhe asimilimit të kombësive në Serbinë Jugoreve dhe për shkak të kësaj nuk është pranuar vullnetarisht.

Veprimtaria e sokolave edhe krahas anëve negative që i ka pasur në Serbinë Jugore, mund të thuhet se ka luajtur edhe rol të caktuar pozitiv në kontributin për zhvillimin dhe pavarësimin e kulturës fizike në këtë pjesë të Serbisë Jugore.⁵⁷⁴

⁵⁷³ Т. М. Живковић. „Прилог историји соколства у...“. Јужни Преглед...f. 50.

⁵⁷⁴ Мë терëг пëр кëtë те Др. Војо Кушевски. „Преглед на појавата и развитокот на соколството во Вардарска Македонија“. Прилози за историјата на физичката култура на Македонија: Скопје, 1975, f. 63-64.

SHOQËRITË MUZIKORE DHE TË KËNDIMIT

Këto shoqëri kanë qenë të përshtatshme për veprim në mesin e masave të gjera shoqërore, posaçërisht në mesin e gjeneratës së re. Janë shfrytëzuar për realizimin e qëllimeve të politikës së madhe serbe në Serbinë Jugore. Shoqëritë kanë pasur përkrahje të gjithanshme, duke iu falënderuar përkushtimit dhe dashurisë ndaj muzikës.

Shoqëritë muzikore janë shfaqur para atyre të këndimit. Me ta ka filluar të përhapet arsini dhe kultura nacionale e propagandave të caktuara të cilat kanë vepruar në Serbinë Jugore, mes rinisë së shkollave të mesme. Qëllimi i tyre ka qenë që krahas afirmimit të këngëve ta afirmojnë edhe krijimtarinë popullore. Për shkak të kësaj, janë llogaritur si shoqëri arsimore–nacionale, të cilat në përdorim të ndryshme kohore kanë luajtur rol të rëndësishëm.

Në një kohë më të vonshme paraqiten edhe shoqëritë e këndimit. Deri në formimin e këtyre shoqërive është arritur nën ndikimin e këndimit në grup, që ka qenë i përhapur në shkollat e mesme. Në këto shoqëri, më së shpeshti janë anëtarësuar fëmijë të cilët tanimë kanë pasur të kryer shkollë të mesme ose janë mësimsdhënës të arsimimit të mesëm muzikor në shkolla.

Në dekadën e parë të shek. XX është themeluar shoqëria e këndimit “Vardar” në Shkup, se në Kumanovë është formuar edhe orkestra e muzikore.

Themelimi dhe puna e këtyre shoqërive, më së shpeshti është lidhur me ndonjë person aktiv, sepse me largimin e atij personi shuhet edhe puna e shoqërisë, deri në ardhjen e personit të ri aktiv. Në atë mënyrë ekzistimi i aktivitetit të shoqërive të këtilla është varur nga aktivitetet e personave të caktuar, e jo nga dëshira e rrethit të gjerë të popullsisë për ekzistimin e llojit të tillë të shoqërive. Me zbatimin e punës së tërësishme arsimore dhe nacionaliste është synuar që t’u ndihmohet këtyre shoqërive të këndimit.

Në Mbretërinë e porsakrijuar të SKS shoqëritë e këndimit kanë qenë në mesin e shoqërive të para të cilat janë themeluar në qytetet dhe vendet më të vogla anekënd Serbisë Jugore. Me hapjen e shkollës së mesme është disponuar edhe me kuadër muzikor arsimor i cili është përfshirë si udhëheqës i shoqërive të këndimit.

Në Shkup janë formuar 5 shoqëri: Vardar; Mokranjac; Shoqëria Serbe—muratore e këndimit; Shoqëria Shekullare e Këndimit; Shoqëria Akademike e Këndimit “Obiliq”. Për këtë periudhë, është e rëndësishme të përmendet edhe shoqëria muzikore e Gonxhe Bojaxhiut (sot e njohur si Nëna Terezë).⁵⁷⁵ Sipas autorit Dom Lush Gjergjim në librin *Dashuria që nuk vdes (të mëdhenjtë e shekullit XX)*, Gonxhe Bojaxhiu që si e re në bashkësinë e famullisë ka kënduar në korin e kishës, ka recituar në teatër, ka shkruar poezi, i ka rënë mandolinës, ka qenë anëtare e kongregacionit “Mëria për të rinjtë”.⁵⁷⁶

Vërtetim për këtë paraqet edhe dëshmia e Lorenci Antoni: “Gonxhja ka kënduar shumë mirë, ajo ka qenë soprano, ndërsa motra e saj Age ka qenë alt. Ata bashkërisht e kanë kënduar kompozimin tim të ri, që e shkrova derisa isha në shkollë të mesme. U quajt “Në kodrën afër liqenit”, me tekst të Hil Mosit. U ekzekutua në Koncertin Humanitar në mars të vitit 1928. Gonxhja ishte shumë precize gjatë provave. Rregullisht merrte pjesë në manifestimet e Rinisë Katolike: shpesh recitonte, këndonte, u binte ins—

⁵⁷⁵ Gonxhe Bojaxhiu (Nëna Terezë), ka qenë shqiptare e cila është lindur në Shkup, më 27 gusht 1910. Babai i saj është quajtur Nikolla Bojaxhiu dhe ka qenë ndihmës farmacist, ndërsa nëna e saj është quajtur Dranda. Vëllai i Gonxhes, Llazari-e ka mbaruar akademinë ushtarake dhe ka jetuar në Palermo, ndërsa motra e saj Ageja ka punuar si spikere në Radio Tirana. Prindërit e Gonxhes janë përpjekur t’i shkollojnë të gjithë tre fëmijët. Kështu, Gonxhja është regjistruar në gjimnaz në Shkup, bashkë shoqet e saja shqiptare. Ka qenë shumë inteligjente, e dëgjueshme dhe çdoherë e përgatitur t’u ndihmojë të tjerëve. Malkolm Muggeridge. „*Majka Tereza*“. Pavao Crnjac, 41000: Zagreb Omiska 10, 1975, f. 5.

⁵⁷⁶ Don Lusin Greqju. „*Dashuria që nuk vdes (të mëdhenjtë e shekullit XX)*“. Prizren, 2013, f. 158.

trumenteve, prezantonte dhe shumë punë tjera... Ishte person rreth së cilës mbledheshin të gjithë vullnetarisht. Ajo ishte organizatore e lindur. Bashkë me atin Jambreković ajo ishte frymëzuesja dhe organizatori ynë". Për këtë arsye Gonxhe dhe Age Bojaxhiu u quajtën "Bylbylat e kishës".⁵⁷⁷

Gonxhja gjithashtu shumë bukur i binte edhe mandolinës. Para se ta sjellë vendimin e saj përfundimtar që tërësisht t'i përkushtohet zotit, para statujës së Shën Mërisë së Shenjtë në Letnicë, si periudhë e rëndësishme e jetës së saj është e nevojshme të përmendet periudha kur Gonxhja ka pasur shoqërinë e saj muzikore⁵⁷⁸ (emri i së cilës nuk është dhënë), ku tetë vite ka qenë mësime dhënëse e muzikës. Për këtë flet dëshmia e Lorenc Antonit i cili i citon fjalët e saj: "Mësoja tre vajza t'i bien mandolinës. Ata dëshironin të më pagujnë. U thashë që kjo nuk është e nevojshme, sepse i mësoj me zemër të madhe dhe me kënaqësi. Prandaj Lorenci im i dashur mërri paratë, sepse do të mund t'i dërgosh për misionin në Indi..."⁵⁷⁹

Kështu, më 25 shtator të vitit 1928 Gonxhja ka shkuar në mision në Indi. Nëna e saj Dranda, motra e saj Age, si edhe të tjerët kanë mbetur të habitur dhe të impresionuar nga vendimi i saj. Në mesin e njerëzve të tjerë ka qenë edhe Lor Gozhuri i cili ka thënë: "Mikja ime, nuk e di ku je dhe pse ike, por e di se për mua je engjëll i cili dëshiron t'u ndihmojë të gjithëve. Shumë do më mungosh: gjithë"

⁵⁷⁷ Don Lush Gjergji. „*Mother Teresa, The saint of love*“. Republika e Kosovës, 2010, f. 30-31.

⁵⁷⁸ Njëkohësisht edhe babai i saj Nikolla (Kolë) Bojaxhiu, pas shpërnguljes në Shkup, pas vitit 1900 ka qenë njëri ndër themeluesit dhe financuesit e orkestrës „*Zani i Maleve*“, e cila ka bërë parada nëpër rrugët e Shkupit, me rastin e çlirimit nga Perandoria Turke-Otomane – duke kënduar dhe luajtur për lirinë, e cila është paguar me çmim të lartë.

Don Lush Gjergji. „*Mother Teresa, The saint of love*“. Republika e Kosovës, 2010, f. 23

⁵⁷⁹ Don Lush Gjergji. „*Mother Teresa, The saint of love*“. Republika e Kosovës, 2010, f. 35.

hashtu edhe Dranda, Lazari dhe Age, të gjithë do të na mungoni... Paçi udhëtim të mirë!...”⁵⁸⁰

Janë formuar edhe një numër i madh i shoqërive të këndimit në qytetet e tjera edhe atë: në Manastir janë formuar dy shoqëri këndimi; Mokranjac dhe Kajmakçallan; në Tetovë: Binički dhe Kirill Pejčinoviq. Krahës këtyre edhe në Kumanovë janë formuar dy shoqëri këndimi, në Gostivar një “Shijački”; në Dibër dhe Ohër nga një “Biljana”; në Kavadar, Gjevgjeli dhe Strumicë nga një “Rela Krilatica”; në Veles “Mladost” (Rinia); në Shtip dhe Koçan “Jovan Skerliç”; në Prilep “Kraleviç Marko”.

Në këto shoqëri numrin më të madh të anëtarëve e ka përbërë rinia. Kanë ekzistuar edhe shoqëri këndimi, të përbëra nga punëtorët e industrisë së duhanit.⁵⁸¹

Kanë ekzistuar edhe përpjekje që të themelohen shoqëri këndimi edhe nëpër fshatra, megjithatë kjo nuk është arritur. Puna e këtyre shoqërive ka qenë me ndërprerje. Shumë gjëra janë varur nga dirigjenti. Borgjezia sunduese serbe, duke e zbatuar rëndësinë e madhe të denacionalizimit dhe asimilimit të popullsisë në Serbinë Jugore, nëpërmjet këtyre shoqërive të këndimit ka mbajtur llogari të posaçme për personalitetet të cilat është dashur t’i udhëheqin këto shoqëri. Që të arrihet ky qëllim në ato vende janë vendosur profesorë, priftërinj, mjekë, drejtorë, gjykatës, mësues. Puna e këtyre shoqërive është përbërë nga tubimi në masë i të rinjve të cilët me këngë dhe nëpërmjet këngës e kanë zhvilluar vetëdijen nacionale serbe. Për këtë detyrë kryesore, shoqëritë e këndimit kanë vlejtur si shoqëri eminente nacionale. Gjendja materiale e shoqërive të këndimit nuk ka qenë në nivel të duhur. Mjetet janë siguruar nëpërmjet kishës komunale, ndërsa te disa shoqëri edhe

⁵⁸⁰ По аty, ф. 36

⁵⁸¹ Стојан Зафировић. „Певачка и музичка друштва “. Споменица двадесет-петогодишнице ослобођења Јужне Србије 1912 – 1937: Скопје 1937, ф. 1016-1017

nëpërmjet anëtarësimit. Shteti nuk ka siguruar mjete, megjithatë prej tyre ka kërkuar zbatimin e politikës së denacionalizimit.

SHOQËRITË FETARE–ARSIMORE

Në mesin e shoqërive të cilët është dashur ta përhapin arsimin dhe kulturën, janë numëruar edhe shoqëritë fetare–arsimore; Bashkësia Ortodokse e Krishterë; Aksioni Katolik dhe Klubi i Hebrenjve të Shkupit. Këto shoqëri e kanë përhapur arsimin dhe kulturën fetare mes ithtarëve të tyre. Kanë synuar ta përforcojnë fenë e tyre personale: ortodokse, katolike ose hebraike, varësisht nga ajo nëpërmjet cilës shoqëri kanë vepruar. Shoqëritë, më së shpeshti janë themeluar nëpër vendet e mëdha. Kështu me nismë të priftërinjve është themeluar bashkësia ortodokse e krishterë në dioqeza e Ohrit, Bashkësia Katolike në Shkup dhe Manastir, e cila ka punuar në mënyrë intensive të arsimimit fetar të besimtarëve katolikë, më së shpeshti rinia. Për propagandën fetare e kanë botuar revistën “Blagovjest” (“Lajmi i mirë”, e cili ka filluar të dalë nga vitit 1927.⁵⁸²

Klubi i hebrenjve të Shkupit është organizuar në vitin 1922⁵⁸³. Qëllimi kryesor i këtij klubi ka qenë të zhvillohet lidhja e

⁵⁸² Në revistën „Blagovijest“ (“Lajmi i mirë”), revistë e katolikëve në Serbinë Jugore, në dhjetor 1932 është botuar tekst i Famullisë së Shkupit, e cila Zotit i ka paraqitur disa zemra fisnike. Derisa ka jetuar në Shkup, kanë punuar në shoqëri, janë theksuar me mirësi. I ka ngacmuar mendimi i misionarëve. Shembulli i tyre, pasi kanë shkuar në misione, tani zgjon idealizëm te të rinjtë. Nga këta misionare vlen të përmenden tre vajzat shqiptare: misionarja tanimë e njohur Gonxhja, e cila tani quhet me emrin e murgeshës Nëna Terezë dhe Nasta Mihilit, e cila e ka ndjekur në Bengal. E treta është Ana, e cila ka mbetur në Jugosllavi, por ka shkuar lar nga prindërit e saj që të bëhet motër që shërben në spital.

Më tepër për këtë në: „Blagovijest“- List za Katolike Južne Srbije, dhjetor, (1932): 116-118.

Ose në: *Një Shekull Dashuri, Еден век љубов, One centry of love*. Përkthimi: Skender Asani, Ardian Limani, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni: Shkup, 2010.

⁵⁸³ Мирко Јовановић. „Верско-просветна друштва“. *Клуб скопских јевреја*“. Споменица..f. 1047.

ndërsjellë, arsimimi kulturor, tradita e tij dhe ndihma e anëtarëve të varfër. Ky klub i ka pasur edhe hapësirat e veta në të cilat janë vendosur: biblioteka, hapësira e leximit dhe seksioni i rinisë, kulturës dhe arsimit. Ky klub çdoherë ka mbajtur lidhje të ngushta me akcionet tjera kulturore dhe humane mes qytetarëve.

INSTITUCIONET KULTURORE

Bibliotekat dhe hapësirat e leximit:

Bibliotekat dhe hapësirat e leximit janë numëruar në mesin e institucioneve kulturore nëpërmjet të cilave është dashur të përhapet ideja e madhe serbe në Serbinë Jugore. Qëllimi i këtyre institucioneve ka qenë që ta përhapin arsimin në mesin e masave të gjera popullore. Gjatë kohës së luftës një numër i madh i librave janë shkatërruar.

Me nismën e grupit të profesorëve të Fakultetit Filozofik në Shkup, në vitin 1922 është hapur “Biblioteka Shkollore”, me fondin letrar kanë mundur të shërbehen edhe njerëzit të cilët nuk kanë qenë të lidhur me fakultetin. Gjegjësisht kjo bibliotekë e ka paraqitur Bibliotekën Popullore të Shkupit.⁵⁸⁴

Biblioteka ka pasur rreth 10.500 vepra ose mbi 30.000 kopje. Librat më së shpeshti kanë qenë nga fusha e atyre lëndëve, të cilat janë ligjëruar në Fakultetin Filozofik, por ka pasur edhe libra nga letërsia jugosllave, historia e përgjithshme, arti dhe filozofia.

Vëmendje të madhe gjatë furnizimit të librave i është kushtuar edhe politikës, respektivisht librat të përmbajnë të dhëna për çështje të ndryshme të lidhura me Serbinë e Vjetër dhe Serbinë Jugore. Librat

⁵⁸⁴ Дим. Кириловић. „Библиотека Универзитета у Скопљу“. Јужна Србија: Скопље, 1922, књ. I, бр. 6, ф. 238.

janë furnizuar nëpërmjet blerjes, ose kanë qenë dhuratë e institucioneve të ndryshme. Institucionet e tilla kanë qenë: Matica Srpska (Amza Serbe) – Novi Sad; Akademia Mbretërore Serbe; Seminari Serbi i Shkollave në Beograd, Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Arsimit; Kuvendi Popullor i Akademisë Jugosllave në Zagreb.⁵⁸⁵

Biblioteka është vendosur në hapësirat e Fakultetit Filozofik. Përpjekjet që Biblioteka Shkollore të ngrihet në Bibliotekë Popullore nuk kanë mundur të përballohen plotësisht. Si pengesë ka qenë ajo që librat janë dhënë për lexim një rrethi të gjerë të dhamirëve të librit, mospasja e hapësirës së posaçme, si edhe koha e punës e cila i është përgjigjur numrit të kufizuar të njerëzve. Për çdo ditë janë bërë përpjekje që në Shkup të hapet bibliotekë moderne, megjithatë ka qenë e vështirë të sigurohen mjete.

Në vitin 1926, duke iu falënderuar qytetarëve të caktuar, kanë filluar të organizohen më shumë shfaqje, nëpërmjet të cilave janë siguruar mjete për ngritjen e bibliotekës moderne.⁵⁸⁶ Ende nuk kanë pasur bibliotekë dhe hapësirë leximi të posaçme, megjithatë thuajse të gjitha shoqëritë në hapësirën e tyre kanë pasur doracakët e tyre. Shkollat fillore dhe të mesme kanë pasur numër të caktuar të librave me të cilat kanë mundur të shërbehen mësimdhënësit, nxënësit dhe populli në përgjithësi.

Mësimdhënësit, më së shpeshti janë shërbyer me literaturë profesionale. Prej mjeteve të cilat i kanë fituar si mësimdhënësit, nuk kanë mundur të ndajnë mjete për blerjen e librave, andaj janë shërbyer me librat e shkollës së tyre. Për plotësimin e fondit të librave në bibliotekën e tyre janë fituar pak mjete. Prandaj numri i librave është rritur shumë ngadalë.

⁵⁸⁵ По аty, f. 240.

⁵⁸⁶ „Скопје ќе ускоро добите једну модерну библиотеку“. Наша Стара Србија: Скопје, III, 1926, бр. 72, f. 2-3.

Fëmijët e varfër, të cilët nuk kanë qenë në numër të vogël, janë shërbyer me literaturë nxënësish. Ndonjë literaturë shkollore është paraparë si e detyrueshme nga ana e Ministrisë së Arsimit për klasa të caktuara.

Ngadalë ka përparuar edhe hapja e bibliotekave popullore edhe në qytetet tjera në Serbinë Jugore. Në Kumanovë, Biblioteka Popullore është hapur më 17 dhjetor të vitit 1929, ndërsa së shpejti është hapur edhe në Tetovë. Të gjitha këto biblioteka të cilat janë hapur më vonë, në një vend e kanë mbledhur fondin letrat të të gjitha shoqërive dhe shoqatave. Në vitin 1924 në Shtip është themeluar hapësira e leximit me bibliotekë. Në të janë anëtarësuar 160 lexues të rregullt. Biblioteka është mbajtur nga anëtarësia dhe për këtë nga Dobrica Markoviq (prefekti i madh i zonës së Bregallnicës), është kërkuar të fitohet ndihmë nga Ministria e Arsimit në Beograd, me qëllim që të mundet ky institucione të punojë në mënyrë normale mes rinisë së Shtipit.

Ministria e Arsimit nga 20000 denarët e kërkuar ka miratuar 1000 dinarë.⁵⁸⁷ Kjo shumë ka qenë shumë e vogël, e që nuk ka mundur t'i mbulojë të ardhurat dymujore të arkëtares. Kanë munguar mjete edhe për furnizim me librat e nevojshëm. Në këtë rast, po të mos kishin ekzistuar mjetet e rregullta, do të ishte e detyrueshme të gjenden mënyra, që të mbulohen mjetet e kërkuara, megjithatë e tërë kjo nuk ka qenë e sigurt dhe do të varet nga shumë rrethana të tjera.

Shkolla popullore:

Shkolla popullore, është numëruar në ato institucione të cilat kanë pasur qëllim ta përhapin arsimin popullor serb dhe kulturën në mesin e maqedonasve, shqiptarëve, turqve, vllahëve, boshnjakëve në Serbinë Jugore. Nisma për hapjen e saj rrjedh nga një grup intelekt-

⁵⁸⁷ A.J. 66-62-161-1924

tualësh dhe punëtorësh publikë.⁵⁸⁸ Megjithatë, së shpejti është treguar se kjo çështje nuk ka qenë mjaft e pjekur dhe për këtë arsye nismëtarët kanë hequr dorë nga aksioni i mëtejshëm i Shkollës Popullore.

Me hapjen e Fakultetit Filozofik në Shkup, është pritur që kjo çështje të kalojë në duar të profesorëve të porsaemëruar të Fakultetit Filozofik në Shkup. Megjithatë, kjo çështje në fillim është lënë pas dore. Në vitin 1921 në Fakultetin Filozofik janë organizuar disa ligjërata. Gjithashtu edhe Shoqëria Shkencore e Shkupit ka mbajtur disa ligjërata.

Aktivitet të posaçëm kanë zhvilluar rusët emigrantë—mësimdhënës në Fakultetin Filozofik dhe Shkollën e Mesme në Shkup, duke organizuar një cikël ligjëratash në gjuhën ruse. Gjithashtu edhe drejtorja e teatrit ka paraqitur shfaqje javore, me ligjërime hyrëse nga ana e profesorëve të Fakultetit Filozofik. Megjithatë, drejtorja e teatrit së shpejti e ka lëshuar këtë lloj të shfaqjeve.

Të gjitha të dhënat e theksuara më lartë, e paraqesin fillimin modest të Shkollës Popullore në Shkup, e cila është themeluar në vitin 1925.⁵⁸⁹

Çdo vit është zgjedhur këshilli ekzekutiv.⁵⁹⁰ Me atë ka filluar puna sistematike e Shkollës Popullore. Kjo shkollë popullore është dashur të jetë amza për themelimin e institucioneve të tjera të tilla anekënd Serbisë Jugore. Megjithatë, kjo nuk është arritur. Ligjëratat të cilat janë organizuar në Shkollën Popullore, nuk kanë paraqitur interes të posaçëm te masat e gjera popullore. Rezultat për këtë kanë para—

⁵⁸⁸ Група интелектуалаца на челу са професором Глишом Елезовичем, Петром Митропаном и Др. Алексије Јелачичем, састали су се код Милана Чемерикича, директора банке „Вардар“, са циљем да формирају народни универзитет.

Др. Алексије Јелачић. „Народни универзитет у Јужној Србији“. Јужни Преглед: Скопље, VI, 1931, бр. 3, ф. 131.

⁵⁸⁹ По ату, ф. 132.

⁵⁹⁰ Në krye të këshillit kanë qenë: Dr. Petar S. Jovanović, kryetar dhe Dr. Prvosh Sllankamenac, sekretar, profesorë të Fakultetit Filozofik në Shkup. По ату, ф. 132.

qitur tematikat e njëanshme të cilat janë prezantuar para publikut, nga ana e ligjëruesve të cilët i kanë takuar një rrethi të njëjtë dhe të cilët kanë qenë profesorë të Fakultetit Filozofik.

Nga e tërë kjo mund të përfundojmë se qëllimet të cilat është dashur të arrihen me punën e tillë nuk janë arritur. Për këtë arsye, janë kërkuar forma, mënyra të reja për veprim. Gjatë vitit shkollor 1927–1928 Shkolla Popullore ka mbajtur dy konferenca në lidhje me këtë.⁵⁹¹

Posaçërisht janë bërë përpjekje që t'i kushtohet kujdes sjelljes indifferente ndaj punëtorëve në këtë institucion. Më saktësisht, nëpërmjet ligjëratave praktike, është dashur të tërhiqet një numër sa më i madh i punëtorëve, zejtarëve, tregtarëve, zyrtarëve, e jo vetëm intelektualët të cilët deri tani kanë qenë vizitorët e vetëm të ligjëratave të cilat i ka organizuar Shkolla Popullore. Që të arrihen rezultatet e këtilla, e kanë filluar propagandën për tubim nëpër vendbanime, ku kanë mbajtur ligjëratat mesimdhënësit, profesorët dhe të gjithë intelektualët.

Me aksionin e këtillë të organizuar, për dallim prej vitit 1923–24 në të cilën kanë mbajtur 2 ligjëratat, në vitin shkollor 1927–28, janë mbajtur 29 ligjëratat. Kështu për pesë vite janë mbajtur 98 ligjëratat.⁵⁹²

Në Tetovë, në vitin 1927 është themeluar Shkolla Popullore. Në vitin shkollor 1927–28 për zgjerimin e punës së vet, ka filluar me publikimin e broshurave të vogla për edicionin “Biblioteka e Shkollës Popullore në Shkup dhe Serbinë Jugore”. Në vitin 1928 ka dalur edhe libri i parë i këtij edicioni.⁵⁹³ Këto broshura kanë

⁵⁹¹ П.М. „Народни Универзитет у Скопљу“. Јужни Преглед: Скопље, II, 1927, бр. 4, ф. 191.

⁵⁹² „Извештај Скопског Народног Универзитета 1923/28 г.“. Јужни Преглед: Скопље, IV, 1929, бр.3, ф. 139.

⁵⁹³ Др. Првош Сланкаменац. „О савременом васпитању“. Библиотека Народног Универзитета у Скопљу и Јужној Србију, књ. I, 1928.

përmbajtur ligjërata të caktuara, dhe në to posaçërisht është theksuar se “duhet të gjithë të jenë në dispozicion dhe të dobishëm dhe se e përmbajnë të vërtetën e kontrolluar dhe shkencërisht të dëshmuar”. Në fakt, “E vërteta e vërtetuar shkencërisht”, për maqedonasit, shqiptarët, turqit, vllahët, boshnjakët domethënë se si të tillë, ata nuk ekzistojnë dhe se faktikisht janë serbë jugorë. Kjo paraqet edhe një dëshmi, me çfarë qëllimesh është shërbyer ky institucion kulturor–arsimor, i cili e ka mbajtur emrin e shkolla popullore.

PËRFUNDIM

Për përhapjen e kulturës në Serbinë Jugore janë themeluar shoqëri të ndryshme dhe institucione kulturore, ndërsa institucionet e vjetra të këtij lloji janë mënjeluar. Maqedonasit, shqiptarët, turqit, vllahët, boshnjakët, nuk kanë guxuar të organizojnë shoqëri të tyre, por janë detyruar të jenë anëtarë të shoqërive të ndryshme serbe. Pjesa më e madhe e këtyre shoqërive kanë qenë degë të shoqërive tanimë ekzistuese kulturore–arsimore serbe dhe shoqërive nacionale, qendra e të cilëve është gjendur në Beograd. Nëpërmjet programit të saj për punë, e kanë përhapur kulturën serbe dhe serbizimin mes popullsive të përmendura më lartë në Serbinë Jugore. Udhëheqësit kanë qenë njerëz zë besueshëm të cilët në mënyrë të zgjuar e kanë ndjekur aktivitetin e çdo anëtari. Për realizimin e punës së tyre, shoqëritë materialisht janë ndihmuar nga përfaqësuesit më të lartë të pushtetit.

Në mesin e shoqërive të përmendura dhe të theksuara më parë, rol të rëndësishëm në përhapjen e arsimit dhe kulturës nacionale serbe, nëpërmjet formës më të ndryshme të punës ka qenë Shoqëria “Shën Sava”. Gjithashtu edhe shoqëritë muzikës–këndimit kanë bërë pjesë në ato të cilave u është përcaktuar ta zbatojnë arsimimin dhe kulturën nacionale serbe. Kjo formë e veprimt, është shfrytëzuar për realizimin e qëllimeve politike.

Ekzistimi dhe aktiviteti i të gjitha këtyre shoqërive më së shpeshti ka qenë i lidhur me ndonjë person aktiv, e jo për shkak të dëshirës

për ekzistim të shoqërive të këtilla, mes masës së gjerë popullore. Me largimin e atij personi, është shuar edhe puna e shoqërisë. Prandaj kanë pasur kujdes për zgjedhjen e personit i cili është futur në udhëheqësin e këtyre shoqërive. Shoqëritë fetare kanë bërë pjesë në grupin e shoqërive kulturore–arsimore, roli i të cilave ka qenë ta përhapin arsimin dhe kulturën fetare në mesin e ithtarëve të tyre. Kanë synuar ta forcojnë fenë e tyre: ortodokse, katolike ose hebraike, varësisht nga ajo nëpërmjet cilës shoqëri kanë vepruar.

Edhe institucionet tjera kulturore të cilat janë themeluar, e kanë luajtur rolin e njëjtë asimilues dhe denacionalizues. Bibliotekat dhe hapësirat e leximit nëpërmjet fondeve të tyre letrare, Shkolla Popullore nëpërmjet ligjëratave të veta, kanë qenë të obliguara ta theksojnë karakterin serb të popullsisë në Serbinë Jugore.

Sipas tërë kësaj mund të përfundojmë: politika e zbatuar e denacionalizimit dhe asimilimit e borgjezisë së madhe serbe në të gjitha sferat e jetës në Serbinë Jugore edhe krahas të gjitha anëve negative, mund të themi se ka pasur edhe anën e vet pozitive, sepse nëpërmjet përhapjes së rrjetit të shkollave dhe formës së shoqërive shkencore, kulturore–arsimore dhe nacionale, e ka ngrit nivelin kulturor të popullit maqedonas, shqiptar, turk dhe të popullsisë të tjera dhe e ka zgjuar vetëdijen e tyre nacionale. Në periudhën e ardhshme, këtyre popullsisë kjo u ka ndihmuar që në mënyrë më të organizuar të luftojnë për realizimin e të drejtave të tyre.

IZAIM MURTEZANI

Instituti i Folklorit, Shkup

SHKUPI NË RAPSODINË POPULLORE, NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Në këtë trajtesë shkencore pretendohet të jepen disa të dhëna që i destinohen Shkupit si një qendër e rëndësishme e Mbretërisë Jugosllave, përkatësisht aktiviteteve që janë zhvilluar në këtë kohë në funksion të kauzës kombëtare. Nënkuptohej se këto të dhëna jepen nga prizmi i përmbajtjes së disa këngëve popullore që kanë arritur të pasqyrojnë disa ndodhi të rëndësishme që përputhen edhe me të dhënat historike. Edhe pse kënga është art i fjalës dhe gjakon pas së vërtetës estetike, megjithatë epika historike është lloji letrar që më së shumti pretendon të pasqyrojë realitetin objektiv.

Nëpërmjet punimit në fjalë që fokusohet vetëm në ca ndodhi brenda qytetit të Shkupit e jo edhe në rrethinën e tij shtjellohen disa momente të rëndësishme të këtij harku kohor e që kanë të bëjnë me reformën agrare, shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, veprimtarinë e disa personaliteteve patriotike, si Ahmet Shtinja, Nazmi Gafuri, Ferhat Draga, Ramë Bllaca, etj. Segmente të caktuara të këtyre ndodhive ndërliken, apo zhvillohen në qytetin e Shkupit, kurse kënga popullore ka regjistruar këto pulsime të kohës, nënkuptohej në përputhje me veçoritë e saja krijuese.

Shkupi si një qytet tejet i lashtë dhe me prani të vazhdueshme të elementit shqiptar, ka luajtur një rol të rëndësishëm pothuajse nëpër të gjitha periudhat historike në të cilat janë zhvilluar ngjarje të përmasave me konotacione dramatike. Nënkuptohej se protagonistë të këtyre ngjarjeve janë gjithsesi edhe shqiptarët të cilët duke dashur

të ruajnë, sidomos qenësinë e tyre kombëtare u ballafaquan me një numër të madh të sfidave të ndryshme të cilat fatkeqësisht ndonjëherë ishin me prapavijë edhe tejet tragjike. Të kësaj natyre ishin edhe ndodhitë që zhvilloheshin në Shkup, por edhe më gjerë në periudhën midis dy luftërave botërore. Shkupi i kësaj kohe frymonte nën diktatin e Mbretërisë Jugosllave e cila e kishte shpallur këtë qytet si qendër të të ashtuquajturave “treva jugore serbe”, përkatësisht, Banovinës së Vardarit. Duke pasur një trajtim të kësaj natyre, në Shkup ishin përqëndruar një numër i madh i institucioneve të karakterit civil. Këtu kishin zënë vend institucioni i Banovinës në krye me Banin, institucione të ministrive rajonale, si të policisë, arsimit, drejtësisë, fesë e kështu me radhë.

Shkupi ishte edhe qendër fetare, pasi këtu funksiononte edhe institucioni i BFI-së duke përfshirë edhe Medresenë e Madhe e cila ishte hapur në vitin 1924. Shkupi ishte shndërruar në këtë kohë edhe në një qendër të karakterit ushtarak, pasi këtu ishin përqëndruar një numër i madh i ushtarëve të cilët vepronin menjëherë në rast nevojë, sidomos ndaj shqiptarëve të cilët assesi nuk pajtoheshin me gjendjen në të cilën ishin katandisur. Vargjet e një kënge popullore përshkruajnë nisjen, apo mobilizimin e forcave ushtarake të Mbretërisë Jugosllave pikërisht nga Shkupi. Në të vërtetë, kreu i atëhershëm jugosllav kërkon nga kreu i Shkupit që të niste ushtrinë drejt Drenicës për të marrë masa ndaj Azem Bejtës dhe çetës së tij në rajonin e Drenicës. Kjo situatë paraqitet në këngë si vijon: *Tel zhupanit n'Shkup i ka çue: / – Çou zhupan, tha, ti m'u shtërngue, / ti n'Drenicë, kije me shkue, / Azem Bejtën kije me rrethue* (KPH, 2007: 147). Nga këto vargje të këngës, por edhe të tjera bëhet e ditur se mbreti, apo kralji Aleksandër, siç thuhet në këngë, kërkon nga Pashiqi që të marr masa kundër Azem Bejtës, pasi ky i fundit kishte paralizuar jetën e shtetit monarkik, veçmas në rajonin e Drenicës. Pashiqi kërkon nga zhupani i Shkupit që të jepte urdhër për të nisur ushtrinë monarkike të vendosur në Shkup drejt Drenicës me qëllim që të mposhte çetën e Azem Bejtës. Pra,

kënga bën të ditur, siç ishte edhe realisht në atë kohë Shkupi i cili nën sundimin e monarkisë jugosllave ishte shndërruar në një qendër të mirëfilltë edhe të përmasave ushtarake.

Të gjitha këto institucione të ngritura në Shkup, qofshin civile, apo ushtarake, ishin vërsulur kundër popullatës shqiptare e cila po përjetonte momente tejte dramatike, si asnjëherë më parë, apo siç thotë rapsodi popullor: *Qysh qat vjet hurrjet qi a kanë, / gjith Shipnija ngusht ish kanë; / gjithmonë ngusht a kanë Shipnija / pej si u çue Asmanlija, / ktu janë lshue t'shtatë kralija, / u çue Nemci, erdhi Serbija. / N'kamë janë çue krejt hafija, / krejt hafija janë çue n'kamë, / ni burrë t'mirë kun s'po dojnë me lanë!* (KPH, 2007: 146). Kënga në fjalë pasqyron vuajtjet e popullit shqiptar, veçmas në kohën e sundimit të monarkisë jugosllave. Kënga popullore duke qenë një shoqëruese e denjë e njeriut në të gjitha gëzimet dhe hidhërimet e tij ka regjistruar, më pak ose më shumë, këto pulsime të kohës, nënkuptohet në përputhje me veçoritë e saja krijuese. Arti popullor në përgjithësi, por edhe kënga si pjesë e rëndësishme e tij, ngërthejnë në vetvete gjithsesi funksionin, apo pragmatizmin estetik, apo të vërtetën estetike e cila mund edhe të mos përkojë me realitetin objektiv, por edhe t'i afrohet atij më afër, madje ta transponoj atë në vargje edhe në mënyrë objektive. Nënkuptohet se nga të gjitha zhanret e letërsisë popullore, epika historike është ajo që pretendon të përshkruaj më objektivisht realitetin të cilit i referohet. Ndërkaq, epika historike e kësaj kohe, përkatësisht e periudhës midis dy luftërave botërore, si kryefjalë të saj ka shqetësimet që i referohen reformës agrare, shpërnguljes së shqiptarëve nga vatrat shekullore, likuidimin fizik të patriotëve shqiptarë e kështu me radhë.

Shkupi i kësaj kohe, por edhe më gjerë, veçmas pjesa shqiptare jeton edhe nën ankthin e ngjarjeve politike, përkatësisht zgjedhjeve, apo kanosjeve që i bëhen asaj për të votuar partinë e Nikolla Pashiqit, të etabluar në pushtetin e atëhershëm të monarkisë jugosllave. Një këngë e kësaj natyre pasqyron një realitet të tillë, përkatësisht zgjedhjet e vitit 1923 kur Nikolla Pashiqi mban një kuvend në

Shkup me të gjithë kryetarët e njësive të atëhershme administrative territoriale, por edhe deputetët e kësaj ane me qëllim që t'i mobilizonte ata për të votuar për Partinë Radikale të cilës i printe ai. Kënga e paraqet këtë ndodhi në këtë mënyrë: *Rrafsh dhjetë ditë kur u ban, / atëherë Pashiqi n' Shkup ish ardhë, / presednikëve u çojke fjalë: / "Tanë në Shkup ju për me dalë!" / E pashallarët tanë janë ardhë. / U çue Pashiqi e majke fjalë; / po u man fjalë e po u kallzon: / – Ni gllasanje kem me ba,* (KPH, 2007: 147). Më tej në vargjet e këngës vërehet synimi i Pashiqit për të motivuar parinë e mbledhur në kuvend me qëllim që ajo të bindte pastaj elektoratin për t'i dhënë mbështetje të padiskutueshme partisë së tij: *– Ngoni, vllazën! – po jau ban, / çilni vesht, çka due m'ju thanë, / kto votime qi domë me banë, / çilni syt, kokrrat kah shkojnë; / n'radikal kokrrat me i lanë, / na dërzhavën ta forcojmë, / n'demokrat mos t'i lamë / se dërzhavën na shkatron!* (KPH, 2007: 231). Ndërkaq, në një version tjetër të vargjeve popullore thuhet: *n'radikall kokrrat me i lanë, / na dërzhavën ta forcojmë, / demokrati mos t'na shkon / se qeverinë tona na rrxon* (KPH, 2007: 230). Këto vargje të fundit të lënë të nënkuptosh se radikalët tanimë janë në pushtet dhe mobilizohen me siguri në prag të zgjedhjeve të reja. Sipas të gjitha gjasave bëhet fjalë për vitin 1923, apo në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të monarkisë jugosllave kur beteja zhvillohej mes Partisë Radikale që i printe Pashiqi dhe asaj Demokrate si rivale e tij.

Kjo kërkesë e Pashiqit, përkatësisht për të votuar për radikalët, sipas vargjeve të mëtejme të këngës popullore, nuk pranohet heshtazi, pasi disa pjesëmarrës në këtë kuvend kërkojnë që të përmbushet paraprakisht ndonjë kërkesë e tyre: *– Ni beg i Ohrit na u çue n'kamë: / – Ngo, Pashiq! Po m'ja ban, / na me ty kemi me kanë, / tana kokrrat kem' me t'i dhanë, / n'radikall i qesim të tanë, / n'demokrat asnja s'kem' me lanë, / veç kontrollën ki me nalë, / poreznikin me gjithë shumar / edhe kit agrarin ki me na nalë, / tokë t'punueme mos me marrë!* (KPH, 2007: 147). Sipas një versioni tjetër të këngës, edhe kërkesat e një pjesëmarrësi në këtë kuvend të Shkupit me emrin Sherif Voca nga njëra anë e Kosovës

ishin të njëjta, apo si vijon: *N'radikall kokrat po t'i lamë, / pak porezin ti t'na liron, / e shumarin ti t'na largon, / tokë t'punueme mos me na zanë, / pak ma t'libë na m'u kanë* (KPH, 2007: 224). Vargjet në fjalë pasqyrojnë një realitet të zymtë të kohës, pasi dihet historikisht se gjatë monarkisë ish-jugosllave është bërë reforma tanimë e famshme agrare me pretekstin e kinse, siç trumbetonte pushteti i atëhershëm, të likuidimit të pronave të mëdha dhe marrëdhënieve çifligare me qëllim që të mundësohej kolonizimi i trojeve, sidomos aty ku jetonin veçmas shqiptarët. Duke iu referuar këtij problemi, historiani i njohur shqiptar, Ali Hadri thekson: “Pa-drejtësia e reformës agrare borgjeze është shprehur më së shumti pikërisht në Kosovë, sepse në këtë anë, me popullsi tepër të dendur, është vendosur numri më i madh i familjeve të kolonistëve dhe janë marrë sipërfaqet më të mëdha të tokës për kolonistët. Kur kësaj t'i shtohet një varg i tërë padrejtësish të tjera, siç janë: vendosja me dhunë e një pjese të kolonistëve në shtëpitë e fshatarëve shqiptarë dhe marrja e tokës së tyre të punuar, e të tjera, – atëherë shihet edhe më mirë tërë pesha e politikës së padrejtë agrare të borgjezisë serbomadhe” (Hadri, 1971: 188–189). Megjithatë, një fat të tillë, ndoshta edhe më të keq, përjetoi edhe Shkupi, “përkatësisht disa pronarë tokash me përkatësi shqiptare të cilët pas situatës së vështirë, të krijuar në vitet 1912–1915, braktisën këto troje dhe pas vitit 1918 nuk kishin më asnjë mundësi për t'u rikthyer në tokat e tyre. Si rrjedhojë, këto toka u sekuestruan nga organet e kolonizimit agrar dhe u shfrytëzuan për nevojat e strategjisë së atëhershme serbomadhe. Në këtë drejtim, u shpronësuan nga toka e tyre edhe shtresat e pasura agrare shqiptare, po ashtu edhe prona e disa xhanive në Shkup dhe rrethinë e kështu me radhë. Strategjia e politikës kolonizuese me serbë, ndikoi që Shkupi në mënyrë drastike të zmadhonte numrin e popullsisë. Vetëm në Shkup, në vitin 1936 numëroreshin 30 mijë banorë “serbë jo vendës”, të cilët përbënin më shumë se 40% të popullsisë së qytetit, deri atëherë të banuar kryesisht nga shqiptarë e maqedonas. Me këtë kolonizim të madh krenoheshin madje publikisht njëfarë Gjorgje Kërstiq, në cilësinë

e të ngarkuarit me kolonizimin e trevave shqiptare dhe maqedonase duke theksuar se “Shkupi tanimë e ka dyfishuar popullsinë e vet” (më gjerësisht, Verli, 1994: 349–359). Jo vetëm kolonizimi, por edhe “ndër format e tjera të eksploatimit nga ana e organeve të pushtetit ishin edhe tatimet, taksat, tagrat plotësuese e detyrimet e ndryshme, si dhe keqpërdorimet e malverzimet dhe makinacionet që bëheshin duke shfrytëzuar mosdijen dhe varfërinë e shqiptarëve” (Hoxha 1970: 312).

Megjithatë, reforma agrare, kolonizimi i viseve shqiptare, varfëria e skajshme, nuk ishin problemet e vetme me të cilat ballafaqoheshin shqiptarët, andaj në tubimin e organizuar në Shkup nga Pashiqi në prag të zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 1923, kërkohen edhe të drejtat kombëtare: *Ahmet Aga veç po ngon, / i dha zor e na u çue n'kamë: / – Ngo Pashiq, bre! – i kish thanë. / U nal Pashiqi mirë p'e ngon) / – N'desh me ty na me kanë, / tana kokrrat me t'i dhanë, / n'radikall i qesim t'tanë, / n'demikrat asnjë s'i lamë, / shkolla shqipe ki me m'i dhanë, / e n'guhë tone na do t'knojmë!* (KPH, 2007: 147). Dihet historikisht se kjo kërkesë ishte e Ahmet Agës, apo ndryshe i njohur si Ahmet Shtimja, kryetar i komunës së atëhershme të Shtimes. Në të vërtetë, kjo kërkesë e parashtruar në Shkup para Pashiqit në vitin 1923 ishte kërkesë e Xhemijetit. Sipas të dhënave historike, Xhemijeti (Bashkini) ishte themeluar në Shkup në vitin 1919 në cilësinë e një partie legale politike të shqiptarëve myslimanë të Kosovës dhe Maqedonisë. Ishte formuar si organizatë fetare, pasi “sipas ligjeve të Mbretërisë SKS, bartës të shtetësisë ishin vetëm tre popujt (serbët, kroatët dhe sllovenët) të cilët kishin edhe të drejtën ekskluzive për të formuar partitë e tyre nacionale” (Hasani, 2013: 93).

Kërkesa e sipërpërmendur e Ahmet Shtimjes e kishte tërbuar Pashiqin, por aspak nuk e kishte frikësuar Ahmet Shtimen i cili pas braktisjes së tubimit në fjalë organizon në Ferizaj një tubim me masën popullore dhe bën thirrje të votohet Xhemijeti: *Se do fjalë Ahmeti i jep: / – Kush a turk, qi bje shahadet, / n'radikall ai kokërr*

nuk qet; / Krejt i qesim n'xhinjet, / krejt Kosovën e sundojmë vet! (KPH, 2007: 225). Në shenjë hakmarrjeje për këtë guxim të tij, pushteti i atëhershëm i Pashiqit organizoi vrasjen, apo likuidimin e tij të menjëhershëm.

Megjithëkëtë, veprimtaria e Xhemijetit, nuk u ndal, por u bë edhe më e theksuar, madje duke fituar edhe përkrahjen e konsiderueshme të shqiptarëve: *Kur erdh dita me gllasitë, / shka ka turk n'xhemiet kimi qitë, / xhemieti ka fitue, / ministert turq i kimi çue, / venin tonë kemi zanë me sunue!* (KPH, 2007: 250). Këngët popullore kanë pasqyruar edhe segmente të caktuara të aktiviteteve patriotike të Nazmi Gafurit që janë zhvilluar në Shkup. Ky atdhetar i devotshëm kishte arritur ta demaskonte një krim të madh të kryer nga forcat serbe në disa fshatra të Kosovës.

Vargjet e këngës e kishin regjistruar këtë aktivitet të tij, përkatësisht shkruarjen e tij në Shkup për ta denoncuar krimin në fjalë në faqet e gazetës në Shkup: *I hyp trenit n'Shkup a shkue, / gazatar lyp me takue, / ngjarjen ren me ja kallxue, / e n'gazetë tana me i çkrue, / kit Evropën me ma njoftue: / çka asht ka ban kjo Serbi, / qi therre gra e djeg thni! / Në paçin zemër kanë me u trishtue, / kit Serbinë kanë me dënue. / Rren e skej gazeta ka çkrue, / krejt Evropa e ka knue; / të shtatë kralat kanë kuvenue: / "Qysh Serbija kshtu me punue?"* (KPH, 2007: 253). Në të vërtetë, vargjet e këngës i referohen një krimi barbar të forcave serbe në Kosovë të cilat në vitin 1921 kishin djegur të gjallë në një shtëpi më tepër se 100 veta të moshës prej 15 vjet e deri më 70 vjet. Këtë masakër⁵⁹⁴ të ushtrisë serbe, patrioti Nazmi Gafuri e kishte përshkruar në gazetën *Hak* që asaj kohe publikohej në Shkup. Gazeta në fjalë, sipas të dhënave që jep historiani Muhamet Pirraku ishte organ i organizatës Xhemijeti dhe ishte publikuar katër vite me radhë në gjuhën turke, gjuhën

⁵⁹⁴ Më gjerësisht në: <http://www.albaniapress.com/lajme/9865/KUSH-ISHTE-NAZIM-GAFURRI.html>

serbe, dhe atë frënge duke qenë zëri më autentik i lirisë së shqip-tarëve nën robërinë albanofobe serbe e jugosllave.⁵⁹⁵

Veprimtaria e patriotit Nazmi Gafurit, duke iu referuar këngëve popullore, ngërthen edhe sekuenca të caktuara të bashkëpunimit me Ferat Dragën një ndër politikanët më të shquar të Xhemijetit. Shkupi padyshim se është epiqendra ku fokusohet aktiviteti i tyre kombëtar. Ky i fundit, pra Ferat Draga për shkak të këtij aktiviteti ishte burgosur në Shkup, kurse vargjet popullore përshkruajnë tentativën e helmimit të tij nga organet drejtuese të burgut. Patrioti Ferat Draga për shkak të syçeltësisë së manifestuar i shmanget këtij ndëshkimi: – *Ju kit bukë, shokë, s’kini me kërkue, / keq po tutna qi e kanë xehrue! / Shih, ni macë aty ish kanë, / ni trohë bukë ja kanë dhanë; / maca bukën e ka kërkue, / pesë dekika, ma shumë nuk ka rrnue!* (KPH, 2007: 248). Sipas këngës në fjalë, Ferat Draga jo vetëm që i shpëton këtij helmimi, por edhe lirohet nga burgu në saj të ndihmës së bashkëpunëtorit të tij të ngushtë, Nazmi Gafuri i cili paraprakisht kishte siguruar një përkrahje ndërkombëtare për rastin në fjalë.

Një problem tejet shqetësues, madje që cungoi dukshëm elementin demografik shqiptar jo vetëm në Shkup, por edhe më gjerë ishte shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë. Kjo dukuri është reflektuar edhe në vargjet popullore: *A, vllada e serbit na u çue n’kamë, / paskan nisë po marrojshin pllan: / kta shqiptarë qysh me i përzanë, / paskan qitë reformën agrare; / e shiptarve tokat tuj jau marrë, / deri n’derë tokat tuj jau marrë, / tuj jau marrë tokat e tuj zaptue, / t’gjithë shiptart pej venit me i çue. / Ah, zullumin jau paskan shtue,* (KPH, IV, 2007: 263). Në këto vite “territori i Maqedonisë i ngjante një trampoline gjigande, që herë pas here lëshonte matanë kufijve shtetërorë me dhjetëra, qindra dhe mijëra familje shqiptare nga të gjitha krahinat e banuara prej tyre. “Qyteti i

⁵⁹⁵ Më gjerësisht në: http://pashtriku.beepworld.de/files/Pirraku/Pirraku2009/muhamet_pirraku_gazeta_hak-1920_1924_22.10.09.htm

Shkupit dhe veçanërisht stacioni i tij hekurudhor ishte dhe mbeti nyja më e rëndësishme tranzite e largimit të shqiptarëve drejt së panjohurës dhe së huajës në tokat e shtetit turk. Në territorin e Maqedonisë së sotme, përkatësisht në krahinat e populluara nga shqiptarët, vepronin si para, ashtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore, organizma e institucione shtetërore, e gjysmëzyrtare, që kishin si detyrë kryesore organizimin, zbatimin dhe nxitjen e shpërnguljes së shqiptarëve, kurse Shkupi mbeti vazhdimisht qendra ku ato sinkronizonin veprimtarinë rreth shpërnguljes dhe kontaktet përfundimtare me të shpërngulurit” (Shtylla, 1994: 364). Për shkak të të gjitha këtyre ngjarjeve tronditëse që ndodhnin në Shkup lidhur me shpërnguljen e shqiptarëve, qeveria shqiptare e Ahmet Zogut kishte hapur konsullatën e saj në Shkup. “Nga të dhënat që raportonte kjo konsullatë në Tiranë, qeveria shqiptare, përmes memorandumeve drejtuar Lidhjes së Kombeve dhe Fuqive të Mëdha, kërkonte që qeveria jugosllave të ndalonte këtë formë të re të përndjekjes, që i detyron shqiptarët e Jugosllavisë të braktisin vatrën e tyre” (Milo, 1994: 395).

Një figurë simpatike e rapsodit popullor që i kundërvihet dukurisë të shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi është Ramë Bllaca. Ai në cilësinë e deputetit në Beograd edhe përkundër presionit të madh refuzon të nënshkruaj një dokument, përkatësisht një traktat serbo – turk të vitit 1937 që i dedikohej shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. Pas refuzimit të nënshkrimit, Ramë Bllaca kthehet të nesërmen në Shkup, kurse kënga e ka fokusuar këtë moment si vijon: *Ah, në Shkup vetun ardhë ish kanë, / sabah zoti kur p’e maron, / krejt kryepleqt tubue janë kanë, / rreth katunet kah janë ma ngat. / E n’sabah tanë çue janë kanë, / thonë, kryepleqt kur janë tubue, / fill te Rama n’kullë i kanë shkue. / Mirë përshnetin, n’grykë kokan marrë, / muhabet shumë Rama po u ban, / e po i vetë: – Çka kemi n’ket anë? / – Boll kena, more zotni, / xhanaria janë dalë shpi për shpi, / apin zor me dalë n’Turki; / afat t’shkurtë ne na kanë kallxue, / mos me dalë, na mysin me dru-e!* (KPH, 2007:

226). Megjithatë, Ramë Bllaca, këtë guxim të tij do ta paguaj me jetën e vet, pasi do të vritet menjëherë, madje edhe nga plumbat e bashkëkombasve të vet, nënkuptohet të dirigjuar nga pushteti i atëhershëm serb. Rapsodi popullor e përkujton këtë moment tragjik në këtë mënyrë: *Ramë Bllaca po n'rrojke jetë, / i pastë ra shpirti n'xhenet! / Krejt shyptarët ne t'i knojnë ramet, / se ka punue për popull t'vet, / me qitë popullin n'selamet; / se gjithmonë ka hjekë zamet*, (KPH, 2007: 280–281).

Në vija të përgjithshme mund të konkludohet se këngët që i dedikohen këtij harku kohor të historisë shqiptare e që kanë të bëjnë me segmente të caktuara që ndërlidhen me Shkupin pasqyrojnë një realitet tejet tragjik i cili seriozisht kërcënoi substancën tonë kombëtare, madje duke e cunguar atë në mënyrë drastike dhe njëherit duke krijuar raporte të reja demografike, veçmas në Shkup. Nënkuptohet se këngët e tilla sakrifikojnë elementin estetik, apo artistik në funksion të pasqyrimit të të dhënave që i dedikohen këtij realiteti objektiv tejet të zymtë në kuadër të kësaj pjese të historisë sonë kombëtare.

Bibliografia:

Asani, Skender (2013): *Gjurmë nëpër kohë (Përmbledhje artikujsh dhe punimesh)*. Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni. Shkup.

Hadri, Ali (1971): *Historia e popullit shqiptar për shkollat e mesme*. Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK. Prishtinë.

Hoxha, Hajredin (1970): Elemente të presionit ekonomik ndaj shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër. *Përparimi* (1970, nr. 4), Prishtinë.

KPH (2007): *Këngë popullore historike*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.

Milo, Paskal (1994): Shqiptarët e Maqedonisë në marrëdhëniet shqiptare–jugosllave midis dy luftërave botërore. *Shqiptarët e Maqedonisë*. Meshihati i BI në RM. Shkup.

Verli, Marenglen (1994): Politika e kolonizimit sllav të trevave shqiptare në periudhën midis dy luftërave botërore (1918–1941). *Shqiptarët e Maqedonisë*. Meshihati i BI në RM. Shkup.

Shtylla, Zamir (1994): Shpërnguljet e shqiptarëve në shekullin XX. *Shqiptarët e Maqedonisë*. Meshihati i BI në RM. Shkup.

SEVDAIL DEMIRI

ITSHKSH – Shkup

ÇËSHTJA SHQIPTARE NË SHTYPIN E KOHËS QË BOTOHEJ NË SHKUP

(shembuj nga “Privredni Glasnik” gjatë vitit 1921)

Me ndryshimet e reja politike që ndodhën gjatë Luftërave Ballkanike, përkatësisht Luftës së Parë Botërore, e deri në Luftën e Dytë Botërore, kur edhe territori i Maqedonisë së sotme u gjend nën pushtimin serb, u shuan të gjitha organet e shtypit në gjuhën shqipe. Në kohën e Mbretërisë SKS, më vonë Mbretërisë Jugosllave (ku fjalën kryesore e kishin serbët), këtë fat të keq e patën edhe të gjitha shkollat shqipe, maqedonase dhe të popujve më të vegjël, të cilët u ndodhën në një situatë jashtëzakonisht diskriminuese.

Pra, për periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, realisht nuk mund të flitet për shtyp shqiptar në territoret e Maqedonisë dhe Kosovës. Në këtë kohë, një periudhë të shkurtër kohore (23 janar 1920 – 10 dhjetor 1924), në Shkup botohej gazeta “Hak” (Drejtësia), organ i organizatës politike të myslimanëve – Xhemijeti. Kjo gazetë botohej në gjuhën turke (në variantin e vjetër osman) e serbokroate (cirilikë), dhe përpos tematikave politike, ekonomike e fetare islame, shpeshherë trajtonte edhe çështje arsimore, kulturore e kombëtare, me çka bie ndesh me Partinë Radikale Serbe të Nikolla Pashiqit, dhe shpartallohet bashkë me Xhemijetin.

Pas ndërprerjes së botimit të gazetës “Hak”, më 1925 në Shkup filloi të botohet një gazetë në gjuhën turke me alfabet arab “Yeni vakit” (Koha e re), nga një grupacion i cili ishte në shërbim të plotë të radikalëve serbë që ishin në pushtet. Gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy luftërave botërore, në Shkup u botua edhe një tjetër gazetë në turqishten e vjetër, përkatësisht gazeta “Sag i Milet” (Po–

pulli i shëndoshë), në vitet 1928–1933, e cila gjithashtu ishte në varësi të radikalëve serbë.⁵⁹⁶

Por, politika nacionaliste serbe, me qëllime asimiluese, madje edhe shfarosëse ndaj popullatës shqiptare të mbetur nën Mbretërinë Serbo–Kroato–Sllovene, përkatësisht Jugosllave, pas Luftës së Parë Botërore, ishte fare e dukshme në të gjitha organet e shtypit serb të kohës, që botohej në këto hapësira. Faktikisht, në këtë kohë, në Shkup botoheshin një sërë gazetash në gjuhën serbe, shumica e të cilave ishin në funksion të drejtpërdrejtë të politikës serbe, të drejtuar nga mbreti Aleksandër Karagjorgjeviç.

Pra, në atë kohë, Shkupi ishte një qendër shumë e rëndësishme e politikës hegjemoniste serbe, prej ku po realizoheshin planet e Beogradit për kolonizimin, e siç e quanin ata, të “Serbisë Jugore”. Paralelisht me këtë proces, po zhvillohej edhe procesi i shkombëtarizimit të shqiptarëve të Kosovës e Maqedonisë, por edhe i kombeve të tjera jashtë orbitës serbe.

Kështu, zëdhënëse të politikës shtetërore serbe që botoheshin në Shkup, ishin disa gazeta⁵⁹⁷, si: “Вардар” (“Vardar” – gazetë e pavarur e Serbisë Jugore, e botuar në vitet 1925–1926 në Shkup), “Немања” (“Nemanja” – gazetë themelore e Banovinës së Vardarit, Shkup), “Глас југа” (“Glas Juga” – e përditshme informative, 1940–1941, Shkup), “Јужна Србија” (“Juzna Srbija” – gazetë e pavarur për çështje kulturore, sociale, ekonomike dhe politike, 1922–1925, 1938–1940, Shkup), “Наша Стара Србија” (“Nasa Stara Srbija” – gazetë e botuar në Shkup, në vitet 1924–1929), “Скопски Гласник” (“Skopski Glasnik” – gazetë zyrtare e Qytetit të Shkupit, 1921–1941), “Стара Србија” (“Stara Srbija” – gazetë e botuar në Shkup në vitet 1918–1923), “Привредни Гласник”

⁵⁹⁶ Sherafedin Hoxha, *Shtypi i kombeve dhe kombësive të Kosovës (1871-1983)*, Rilindja, Prishtinë, 1987, fq.94-95.

⁵⁹⁷ <http://www.staroskopje.vestel.com.mk/> Алла Качева, Славица Христова, Тајјана Ѓорѓиовска, *Градом Скопје и формирањето граѓанска класа во периодот меѓу двете светски војни (1918-1941 год.)*, Музеј на град Скопје ;

(“Privredni Glasnik” – gazetë ditore – organ i Organizatës Rinore Ekonomike të Shkupit, 1921–1934), etj.

Në të gjitha materialet e botuara nëpër këto gazeta serbe, spikatë propaganda antishqiptare, e cila herëpashere shpërthen edhe me tone kërcënuese ndaj personaliteteve të dalluara ose zhvillimeve të caktuara brendashqiptare. Aty elementi shqiptar më së shumti kamuflohet dhe barazohet me atë të etnitetit turk – një tendencë e hapur nënçmuese dhe asimiluese e propagandës serbe. Ndërsa, gati se në të gjitha rastet e tjera kur shkruhet për shqiptarët, përdoret emri pezhorativ “Arnaut”.

Në fillim do të marrim një segment të kësaj problematike, duke zbardhë disa tekste të gazetës “Privredni Glasnik”, gjatë pjesës së parë të vitit 1921, ku shkruhet për veprimtarinë e organizatës politike Xhemijeti, dhe për familjen e njohur shkupjane Kumabaraxhiu, e cila ishte njëra nga shtyllat kryesore të asaj organizate.

Një person i cili i nënshkruante tekste me emrin “El Muslim”, rregulisht botonte shkrime tendencioze nën titullin e përgjithshëm “*Nga bota myslimane*”, rreth veprimtarisë së Xhemijetit, dhe posaçërisht rreth temave dhe problemeve të shqiptarëve që hapeshin kohë pas kohe. Themeluesit e Xhemijetit, deputetët Nexhip Draga dhe Kumbarajt, ishin në thumbin e kritikave të propagandës serbe nëpërmjet kësaj gazete dhe organeve të tjera të shtypit.

Kështu, në numrin 14 të gazetës “Privredni Glasnik”⁵⁹⁸, në mënyrë tendencioze shkruhet një artikull lidhur me themelimin dhe veprimtarinë e Xhemijetit, e cila i pengonte pushtetit serb. Në këtë artikull më tej thuhet se në Kongresin e fundit të Xhemijetit të mbajtur në Shkup, Qemal bej Kumbaraxhiu, ka dhënë një propozim-vendim, i cili është miratuar nga kuvendarët, me këtë përmbytje:

1. Mësimi në shkollat e ulëta, të mesme dhe të larta, të zhvillohet në gjuhën e popullit;

⁵⁹⁸ „Из муслиманског света“, “Привредни Гласник”, dt.26.2.1921, f.2, Shkup;

2. Të gjitha shkollat ku do të mësojnë nxënësit myslimanë, të varen nga institucionet e tyre fetare;
3. Gjuha serbe të mësohet në mënyrë fakultative, si gjuhë e huaj; etj.etj.

Me këto kërkesa, bëhet një kthesë e madhe drejt artikulimit të nevojave reale të popujve të shtypur, e sidomos të popullit shqiptar në Shkup e rrethinë, i cili kërkonte shkolla shqipe dhe autonomi të institucioneve fetare islame.

Problematika e mësipërme aktualizohet edhe në numrin 23 të gazetës “Privredni Glasnik”, të fillimarsit të vitit 1921, ku një hapësirë e madhe i jepet dilemës së shtruar, nëse shqiptarët e Shkupit do të duhet të mësojnë shqip ose turqisht. Gazeta shkruan se deputetët Qemal dhe Emin bej Kumabara, në një mbledhje të Xhemijetit në Shkup, kishin deklaruar se nuk dëshirojnë që fëmijët e tyre të mësojnë turqisht, por shqip. Për këtë kishin reaguar disa përfaqësues turq të Xhemijetit, sipas të cilëve, gjuha amtare e fëmijëve të tyre është turqishtja dhe nuk mund të mësojnë gjuhë tjetër. Ndërsa, Qemal dhe Emin beu ua kyshin kthyer me fjalët se: “Ne kemi luftuar për shkolla shqipe edhe gjatë sundimit të Turqisë këtu, dhe për këtë edhe sot luftojnë, dhe nuk do të heqim dorë as në të ardhmen”. Sipas këtij shkrimi, Kumbarajt madje kishin kërcënuar se do të tërhiqen tërësisht nga postet që mbanin në shtet dhe në organizatën Xhemijeti, në llogari të këtyre kërkesave të tyre kombëtare. Ndërsa, në numrin e 24 të kësaj gazete, të datës 10 mars 1921, lexojmë një koment kritik të “El-Muslimit” për përfaqësuesit shqiptarë të Shkupit. Këtu autori “zbulon” një fotografi të vjetër të periudhës osmane, dhe shkruan se “Në fotografi ndodhen luftëtarët për pavarësinë e shqiptarëve – në qendër deputeti i tashëm i qarkut të Shkupit – Emin Jashar bej Kumbaraxhiu, pranë tij Qemal Osman beu, Qamil beu dhe Refik bej Kumabaraxhiu”⁵⁹⁹.

⁵⁹⁹ „Из муслиманског света – Једна фотографија“, “Privredni Glasnik”, dt.10.3.1921, Shkup;

Edhe në disa tekste tjera autoriale, thumbohen Kumbaraxhinjtë e Shkupit, për qëndrimet e tyre proshqiptare, gjë që flet për peshën e tyre të madhe jo vetëm se brenda komunitetit shqiptar të Shkupit, por edhe brenda qarqeve shtetërore antishqiptare.

Në gazetën “Hak”, organ i Xhemijetit, shpeshherë vërejmë mbrojtje të qëndrimeve promyslimane, të cilat shpeshherë mund të karakterizohen edhe si proshqiptare. Kështu, shpifjeve të parreshtura të “Privredni Glasnik”—ut, do t’u kundërvihet gazeta “Hak”, e cila ishte zëri i vetëm i mbrojtjes së të drejtave të popujve të besimit islam, të mbetur nën Jugosllavi. Në numrin e 1 dhjetorit 1921, deputeti Sakib Korkut, bën një reagim ndaj të përditshmes serbe “Privredni Glasnik”, pasi që i njeiti reagim ishte refuzuar të botohet në gazetën e sipërpërmendur serbe.

Në këtë tekst, deputeti Korkut, demaskon politikën shtetërore serbe ndaj myslimanëve. Veç tjerash, në reagim parafrazohet me ironi një tekst i “Privredni Glasnik”—ut, se: “Nëse Sakib Korkut dhe shokët e tij ngrisin çështje të mbrojtjes së myslimanëve në Serbinë Jugore, dhe mbrojnë qëndrimet e Xhemijetit, kjo nënkupton një gjë, se Kumbaraxhinjtë i kanë përfutur dhe i kanë përvetësuar njerëzit e Organizatës së Myslimanëve të Jugut, për t’i mbrojtur kaçakët dhe përkrahësit e tyre”⁶⁰⁰.

Kur jemi te gazeta “Hak”, është me interes një edicion i 18 marsit të vitit 1921, kur gati e gjithë gazeta (që botohej në dy faqe), i kushtohet një “Letre proteste të myslimanëve të Prishtinës”, me rastin e vizitës së komisionit shtetëror, të udhëhequr nga ministrat Drashkoviq dhe Jankoviq. Në letër përshkruhet në hollësi zullumi i serbëve e malazezëve kundër popullatës së pafajshme myslimane (shqiptare) gjatë asaj periudhe. Veç tjerash, theksohet se vetëm në tetë fshatrat e rrethinës së Podujevës, kohën e fundit janë vrarë gjithsej 519 veta. Shumica nga ata janë popullatë civile, meqë vras—

⁶⁰⁰ „Мало одговора (Писмо уредништва Привредног Гласника)“, “Хак”, nr.7-252, dt.1.12.1921, Shkup;

jet janë kryer me armë të dorës dhe mjete të ftohta, kurse nga çakët thuajse nuk ka asnjë të vrarë⁶⁰¹.

Në këtë gazetë, shpesh jepen lajme tendencioze edhe nga Shqipëria. Kështu për shembull, në numrin e 5 marsit 1921, theksohet se qeveria bën rekrutimin e njerëzve të vetë për ushtri. Sipas këtyre informatave, “Qeveria e Tiranës paguan shqiptarë edhe nga territori ynë, duke u dhënë rroga të majme xhandarëve. Madje, sipas disa zërave, në Shqipëri ka hyrë një numër i madh i monedhave të huaja, që nënkupton se ndonjë shtet i huaj punon për ta prishur paqen tonë”⁶⁰². Po në këtë frymë është edhe informata e 15 marsit, ku thuhet se Shqipëria është në anarki, dhe se qeveria e saj ka vendosur trupa ushtarake në kufi dhe është në gatishmëri për ta sulmuar vendin fqij nga ana e Dibrës⁶⁰³.

Siç dihet, alibitë për gjoja organizime ushtarake të shqiptarëve, përdorshin me qëllim të fillimit të aksioneve brutale për mbledhjen e armëve në rajonet kufitare me Shqipërinë, si dhe për sulme ndaj vendbanimeve shqiptare, me arsyetimin se po kërkonin kaçakë.

Gazeta i kushton një artikull ndërhyrjeve shqiptare në Kosovë, të cilat thotë se motivohen nga ana e ish-ministrit të Qeverisë së Princ Vidit, Hasan bej Vuçitërnj (Hasan Prishtina), ndërsa sipas tyre, qeveria shqiptare është kundër këtyre veprimeve. Hasan Prishtina vlerësohet si “fajtori kryesor” për organizimin e shqiptarëve në Kosovë kundër regjimit serb⁶⁰⁴.

Shkrimi i radhës raporton për përfundimin e afatit për dorëzimin e kaçakëve shqiptarë, dhe fillimin e aksionit për internimin e familjeve të tyre: “Përmes Shkupit, këto ditë janë deportuar shumë familjarë nga Mitrovica dhe Vushtrria”. Me këtë rast theksohet në mbrotje

⁶⁰¹ „Представка приштинских муслимана“, “Хак”, nr.11-149, dt.18.3.1921, f.2, Shkup;

⁶⁰² „Из муслиманског света“, “Привредни Гласник”, nr.20, dt.5.3.1921, Shkup;

⁶⁰³ „Анархија у Албанији“, “Привредни Гласник”, nr.28, dt.15.3.1921, f.2, Shkup;

⁶⁰⁴ „У памет се Арнаути!“, “Привредни Гласник”, nr.38, dt.26.3.1921, f.2, Shkup;

të këtyre shqiptarëve ka dalë gazeta “Hak”, e cila thotë se internohen familje të pafajshme të cilat nuk kanë lidhje me kaçakët⁶⁰⁵.

Një lajm i shkurtër që vjen nga Manastiri dhe që tërheq vëmendjen, është ai i 29 prillit 1921, ku thuhet se “Në rrethinën e Prespës janë paraqitur çeta bullgaro-shqiptare, të trajnuar me veshje shqiptare. Shtabi i tyre kryesor gjendet në afërsi të Korçës. Aty vepron vojvo-da bullgar Çaulev⁶⁰⁶, për organizimin e çetave sulmuese”⁶⁰⁷.

Në qershor të vitit 1921, mbahet Kongresi i Dytë i organizatës Xhemijeti, e cila tani merr emrin e ri Organizata Myslimane e Serbisë Jugore. Gazeta “Privredni Glasnik” boton në tërësi 33 vendimet (kërkesat) e këtij kongresi, ndër të cilat, si më të rëndësishme, dhe të parat sipas renditjes, po veçojmë kërkesat për shkolla në gjuhën amtare deri në nivelin e universitetit⁶⁰⁸:

1. Myslimanët e Serbisë Jugore të kenë shkollat e tyre, edhe atë nën drejtimin e Organizatës Myslimane. Në këto shkolla do të mësohet në bazë të programit të përgatitur nga ana e organizatës;
2. Të kërkohet nga shteti kredi e duhur për mirëmbajtjen e këtyre shkollave;
3. Gjuha fetare dhe popullore të jetë e lirë për mësim në shkollat myslimane;

⁶⁰⁵ „Интернација квалитетних породица и цинизам Хака“, “Привредни Гласник”, nr.41, dt.30.3.1921, Shkup;

⁶⁰⁶ Petar /Petrush/ Çaulev (1880 – 1924), sipas kujtimeve të bashkëkohanikut të tij, Milan Matov, rridhte nga një familje shqiptare-ortodokse-toske nga jugu i Shqipërisë, e cila ishte vendosur në Ohër në shekullin e XIX. Çaulevi ishte urë lidhëse ndërmjet Organizatës Revolucionare Maqedonase dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në vitin 1912, me Qeverinë e Ismail Qemalit në vitet 1912 – 1913, dhe me Komitetin e Kosovës në vitet 1919 – 1924, dhe ky angazhim i tij do të kulmojë me veprën e shkruar për Shqipërinë. Për më shumë, shih: Skender Asani: “Çaulevi dhe vepra e tij për Shqipërinë”, Libraria e Çarshisë, Shkup, 2015.

⁶⁰⁷ „Бугарско-арнаутске припреме“, “Привредни Гласник”, nr.67, dt. 29.4.1921, f.1, Shkup;

⁶⁰⁸ „Одлуке са Конгреса Муслиманске Организације Јужне Србије“, “Привредни Гласник”, nr.124, dt.7.7.1921, f.2, Shkup;

4. Sipas nevojës, të hapet një ose dy shkolla mësuesie, të cilat do të përgatisin mësuesit dhe mësueset për shkollat fillore myslimane;
5. Të hapet universitet, nëse paraqitet nevoja për të;
6. Në të gjitha shkollat myslimane, do të mësohet edhe gjuha shtetërore, sipas programit të paraqitur nga Organizata Myslimane, etj. etj;

Pra, ishin këto kërkesat legjitime dhe reale të myslimanëve të Serbisë Jugore, ku siç dihet, shumica ishin shqiptarë. Meqë vendimet ishin marrë në Shkup, ku edhe ishte themeluar Xhemijeti (1919), atëherë lirisht mund të thuhet se viti 1921, paraqet edhe artikullimin e parë zyrtar të kërkesës për shkolla dhe universitet në gjuhë amtare (shqipe) në Shkup.

Poashtu, një “margaritar” i radhës është edhe shpallimi i kërkesës së “Xhemijetit”, përmes gazetës “Hak”, që në Shkup të hapet një bankë myslimane, qoftë edhe si filijalë e ndonjë banke të Sarajevës. Natyrisht, edhe këtë nismë, “Privredni Glasnik”—u e kritikon ashpër⁶⁰⁹.

Në këtë vijë, është edhe një kritikë e ashpër e nënshkruar nga autori Alija Hoxhiq, i cili duke e theksuar karakterin gjithnjë e më proshqiptar të organizatës myslimane, veç tjerash potencon se “Xhemijeti në Shkup shërben si kryeqytet i dytë i qeverisë së Tiranës”⁶¹⁰. Zaten, me këtë deklaratë vulolet angazhimi i njëmendtë kombëtar shqiptar i organizatës Xhemijeti, e cila në pamundësi të organizimit politik në bazë të përkatësisë etnike, ishte e detyruar që të organizohet përmes petkut fetar islam.

Marrë në përgjithësi, çështja shqiptare është vazhdimisht aktuale nëpër të gjitha organet e shtypit të kohës që botohej në Shkup në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Fatkeqësisht, pamundësia e botimit të gazetave në gjuhën shqipe, ngulfaste edhe mundësinë e

⁶⁰⁹ „Муслиманска банка у Скопљу“, “Привредни Гласник”, nr.215, dt. 21.10.1921, f.1, Shkup;

⁶¹⁰ „Издајнички рад Џемијета“, “Привредни Гласник”, nr.189, dt.21.9.1921, Shkup;

artikulimit të drejtpërdrejtë të kërkesave kombëtare shqiptare në opinion dhe në organet e pushtetit antishqiptar të kohës. Gazeta “Hak”, edhe pse në gjuhë të huaj, ishte zë i vetëm i interesave shqiptare dhe islame në këto hapësira, por u shua pa e pritur vitin e pestë të botimit.

Shtypi serb i kohës që botohej në Shkup, e shfrytëzonte makinerinë e vetë propagandistike, për realizimin sa më të lehtë të planeve të qeverisë mbretërore jugosllave (serbe), për asimilimin e shqiptarëve të Maqedonisë e Kosovës, dhe për shpërnguljen e tyre në Turqi e gjetiu.

NASER RAMADANI

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup

FUNKSIONIMI I MEDRESEVE TË SHKUPIT NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Çdo studiues i historisë e ka të qartë se Shkupi ka qenë dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite të jetë qendër e rëndësishme politike, kulturore, administrative, ekonomike, shoqërore dhe fetare.

Para depërtimit osman në këto troje, Shkupi ishte nën sundimin serb. Mirëpo, pas Betejës së Kosovës, e cila ndodhi më 15.06.1389, respektivisht në kohën e sulltan Pajazitit I, më 1391, ky qytet bie në duart e Shtetit Osman.⁶¹¹

Defterët osmanë rreth të dhënve statistikore të shekullit XV, na bëjnë me dije se regjistrimi në qytetin e Shkupit është realizuar dy herë. Në herën e parë, e cila u realizua ndërmjet viteve 1431–1455 shihet se përqindja e muslimanëve në këtë qytet ishte 62%. Ndërsa në herën e dytë, e cila ishte realizuar në periudhën 1465–1468 përqindja e muslimanëve kishte arritur në 69%.⁶¹² Në shekullin XVI, regjistrimi i popullsisë është realizuar tri herë. Në regjistrimin e parë, i cili ishte realizuar në periudhën 1519–1523, përqindja e muslimanëve në Shkup ishte 67 %. Në regjistrimin e dytë të realizuar në periudhën 1528–1530, përqindja e muslimanëve kishte arritur në 73 %, ndërsa në herën e tretë të realizuar më 1550, përqindja e muslimanëve ishte ngritur në 83 %.⁶¹³

⁶¹¹ Душанка Бијанич, Како турците го презеле Скопје (1391), f. 5-6, Музеј на градот Скопје, ЗБОРНИК –II-III- 1965-1966.

⁶¹² Duhet pasur parasysh se regjistrimi i popullsisë në atë kohë është realizuar sipas përkatësisë fetare.

⁶¹³ Мë gjerësisht në lidhje me këtë çështje lexo: Naser Ramadani, “Zhvillimi i arsimit islam në Maqedoni gjatë shekujve XV-XVI”, Toper, Shkup, 2010, f.39-45.

Rënia e Shkupit nën sundimin osman, shënoi një kthesë historike, ngase ndryshoi natyra e jetës dhe natyra e panjes së tij. U shfaqen në të shenjat e jetës lindore, respektivisht jetës islame.

Qyteti i Shkupit ishte qyteti më i madh dhe më i rëndësishëm në rajon. Prandaj, në këtë qytet u vendosën shumë dijetarë, tregtarë, vakëflënës dhe bamirës të ndryshëm etj. Sipas të dhënave që i ofron Evlija Çelebiu, në shekullin XVII, në qytetin e Shkupit kishte institucione të ndryshme kulturore, fetare dhe tregtare, ndërmjet të cilave: “2150 shitore, 54 xhami të mëdha, 75 mesxhide të vogla, 20 teqe, 70 mektebe, 5 medrese, 7 hotele falas, 9 restorante falas për të gjithë. Për banorët e Shkupit thotë se janë të arsimuar dhe të ndershëm. Tregun e Shkupit e përngjanë me tregun e Bagdadit dhe Halepit”.⁶¹⁴

Qyteti i Shkupit më pas fitoi edhe një rol shumë të madh politik, ngase ishte qendër e Vilajetit të Kosovës.

Përhapja e institucioneve të ndryshme edukativo–arsimore, duke përfshirë mektebet, xhamitë, medresetë, bibliotekat etj., kishte një rol të madh në lindjen e një numri të madh të dijetarëve në sfera të ndryshme shkencore, si *fikh*, *tefsir*, jurisprudencë, letërsi arabe, perse dhe turke etj.⁶¹⁵

Më 1912, Shkupi ra në duart e fuqive aleate serbe dhe bullgare, që më pas më 1913, në Luftën e Dytë Ballkanike mes serbëve dhe bullgarëve, bie nën sundimin e plotë të serbëve.⁶¹⁶ Më 1914, Austria i shpall luftë Serbisë dhe kështu fillon Lufta e Parë Botërore, ku më pas më 1916, qyteti i Shkupit bie nën sundimin bullgar, i cili vazhdon deri më 1918, ku me përfundimin e Luftës së Parë Botërore kthehet nën sundimin serb në kuadër të Mbretërisë Serbo–

⁶¹⁴ Evlija Çelebi, Putopis, Sarajevo, 1979, f. 280.

⁶¹⁵ Naser Ramadani, Kontributi i shkupjanëve në kulturën islame dhe arabe...

⁶¹⁶ Luftërat tjera ballkanike, Onufri, 1993, f. 6-7.

Kroate-Slllovene (SKS), që të vazhdojë në këtë gjendje deri më 1941 kur fillon Lufta e Dytë Botërore.⁶¹⁷

Largimi i Shtetit Osman nga Ballkani, respektivisht nga Shkupi, i la banorët e këtyre trevave në një gjendje të palakmueshme. U prek rëndë dinjiteti i muslimanëve, u shkatërrua prona e përbashkët dhe ajo private, u mbyllën dhe u rrënuan pjesa dërrmuese e xhamive dhe medreseve. Filloi persekutimi dhe dëbimi i muslimanëve, respektivisht i shqiptarëve nga trojet e tyre. Thjesht muslimanët në përgjithësi dhe shqiptarët në veçanti ishin në një gjendje të rëndë politike, kulturore, fetare, ekonomike etj. Këtë gjendje më mirë e përshkruan korrespondenti i gazetës ukrainase “Kyevska Mysl” në Vjenë, Lev Trocki, i cili shkruan: “në orën pesë të mbrëmjes iu afruan qytetit të Kumanovës. Çdo gjë përreth nesh ishte në zjarr. Gjitha fshatrat shqiptare dhe muslimane të afërta dhe të largëta ishin në zjarr dhe të shndërruara në hi... Dy ditë pas arritjes në Shkup, gjënë e parë që e kishin parë njerëzit brenda qytetit, në fund të lumit Vardar, pas zgjimit nga gjumi, ishte një grumbull i madh i trupave shqiptarë muslimanë me koka të prera. Shihej qartë se këta njerëz me koka të prera, nuk ishin të vrarë në luftë. I tërë qyteti i Shkupit ishte shndërruar në një kazermë ushtarake. Banorët muslimanë ishin fshehur tërësisht dhe në rrugë nuk shfaqej askush përpos ushtarëve...”.⁶¹⁸

I tërë pushteti gjatë kësaj periudhe kishte në shënjestër gjithë muslimanët, konkretisht shqiptarët. Ai synonte dobësimin e muslimanëve në aspektin politik, fetar, planifikonte dëbimin e muslimanëve nga trojet e tyre, duke përdorur lloj-lloj metode, në mesin e të cilave edhe reformat agrare.

⁶¹⁷ Historia e Popullit Shqiptar, f. 145.

⁶¹⁸ Shih: Ratni izvestaji Lava Trockog Balkanski ratovi 1912-1913. The war korrespondence of Leon Trocky: Balkan wars 1912-1913. tr. by Brian Pearce; ed by George Wiestman and Dunean William, New York: Pathfinder, 1993, pp. 267-272, 275-277, 285-287.

Pa dyshim, feja islame ishte faktori më i rëndësishëm që ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë edhe sot në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar të shqiptarëve. Për këtë vërejmë se gjatë periudhës mes dy luftërave botërore, pushteti serb përdorte gjitha mundësitë për dobësimin e shqiptarëve muslimanë, duke ushtruar dhunë ndaj hoxhallarëve dhe fetarëve në përgjithësi, duke ua uzurpuar pronat, duke shkatërruar dhe duke mbyllur institucionet edukativo–arsimore islame.

Muslimanët në përgjithësi dhe shqiptarët në veçanti, ishin në një gjendje të rëndë politike dhe ekonomike. Për këtë nuk kishin shumë hapësirë të merreshin me aspektin edukativ dhe arsimor. Megjithatë, të prirë nga ndjenjat fetare, shumë hoxhallarë bënë përpjekje maksimale, duke shfrytëzuar xhamitë dhe mektebet, të ngrenë vetëdijen fetare në mesin e muslimanëve.

Krahas xhamive dhe mektebeve që funksiononin në Shkup në periudhën mes dy luftërave botërore, si institucione edukativo–arsimore të rëndësishme vërejmë edhe funksionimin e tri medreseve: Medreseja “Medah” e Ataullah Efendiut, Medreseja e reformuar “Gazi Isa Beu” dhe Medreseja e Madhe e Mbretit Aleksandar I.

Në vazhdim do të japim një pasqyrë të shkurtër të këtyre tri medreseve, duke përfshirë themelimin e tyre, qëllimet, planprogramet mësimore, kuadrin edukativo–arsimor, financimin dhe rezultatet e tyre. Më pas do të bëjmë analizimin e të dhënave dhe krahasimin mes tyre.

Paraqitjen e tyre do ta bëjmë sipas datës së themelimit dhe funksionimit. Secilën prej këtyre medreseve do ta paraqesim ndaras, që më pas të bëjmë analizat dhe krahasimet e duhura. Në fillim do të flasim për Medresenë “Medah” të Ataullah Efendiut, më pas për Medresenë e Reformuar të “Gazi Isa Beu” dhe në fund për Medresenë e Madhe të Mbretit Aleksandër I’.

Medreseja “Medah” e Ataullah Efendiut (1923–1946)

Themelimi i kësaj medreseje daton shumë herët, që nga ardhja e osmanëve në qytetin e Shkupit, më saktësisht më 1397, kur prefekti i parë i Shkupit, pasha Jigit Beu, kishte themeluar një xhami dhe një medrese, dhe për mirëmbajtjen e tyre kishte lënë vakëf një sasi të konsiderueshme të pasurisë.⁶¹⁹

Kjo medrese ka vazhduar të funksionojë gjatë tërë periudhës së Perandorisë Osmane deri në Luftën e Parë Ballkanike më 1912. Më 1925, dijetari i shquar Ataullah ef. Kurtishi⁶²⁰ bëri rihapjen e medresesë “Medah Baba”. Kjo medrese vazhdoi së vepruari deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, respektivisht deri në vitin 1946.⁶²¹

Qëllimi i rihapjes së kësaj medreseje ishte përgatitja e kuadrit fetar islam, i cili do të bartë përgjegjësinë e aftësimit dhe ngritjes së vetëdijes fetare të popullatës islame në trojet shqiptare.

Marrë parasysh gjendjen politike, ekonomike dhe fetare të muslimanëve të Shkupit dhe më gjerë në atë kohë, ishte më se e nevojshme hapja e një shkolle të tillë, e cila do të aftësonte kuadro, të cilët do të merreshin me vetëdijesimin e popullatës për t’u ballafaquar me sfidat e asaj kohe. Nga pushteti i atëhershëm përgatiteshin lloj-lloj kurthesh për dëbimin të muslimanëve nga trojet e tyre. Andaj nxënësit e kësaj medreseje përgatiteshin që të duan fenë dhe atdheun e tyre, të sakrifikojnë për to, dhe pastaj të njëjtat bindje t’ia përcjellin popullatës muslimane.

⁶¹⁹ Naser Ramadani, *Zhvillimi i arsimit islam në Maqedoni gjatë shekujve XV-XVII*, Torer, Shkup, 2010, f.71, 104; Мухарем Парипович и Мухамед Мусич, *Историја школа у Скопљу*, стр. 56..

⁶²⁰ Ataullah ef. Kurtishi i lindur më 1874 në fshatin Studeniçan. I shquar për aftësi dhe trimëri. Ishte një ndër themeluesit e partisë “Xhemijet”. Muderris në medresenë Medah. Vdiq më 25.11.1946 në Shkup.

⁶²¹ Taxhedin Bislimi, *Medreseja Medah e Ataullah efendiut dhe nxënësit e saj*, Shkup, 2011, f. 36,39.

Planprogrami mësimor:

Kjo medrese ishte shkollë fetare islame. Andaj pjesa dërmuese e lëndëve në të ishin të karakterit fetar të cilat përfshinin shkenca të ndryshme islame, si: *Kuran, akaid, tefsir, hadith, ulumul hadith, fikh, usulul fikh*, histori islame, filozofi etj. Prej lëndëve, më shumë rëndësi i kushtohej Gjuhës Arabe, ngase llogaritej si lëndë pa të cilën nuk mund të mësohen burimisht shkencat fetare. Në kuadër të gjuhës arabe mësohej morfologjia (sarf), sintaksa (nahv), stilistika (belaga), shkrimi (imla) dhe bukurshkrimi (husni hat). Mësimi kryesisht zhvillohej në gjuhën arabe, andaj edhe literatura e shfrytëzuar për lëndët përkatëse ishte në gjuhën arabe. Tekstet mësimore të shfrytëzuara në këtë medrese, sot mund të llogariten të nivelit të fakulteteve, ngase të gjitha ato libra janë libra bazë në fushat përkatëse. Përveç këtyre lëndëve mësoheshin edhe lëndët shkencore, si matematika, gjeografia dhe etika e debatimit (adabul munadhareti).⁶²²

Mësimi në këtë shkollë nuk kishte afat të caktuar me vite siç është sot. Ai përfundohej nëse nxënësi arrinte të japë provimet në lëndët e para—para dhe tekstet mësimore për ato lëndë. Sa më shumë të mësonte nxënësi, aq më shpejtë mund të përfundonte mësimet. Me përfundimin e planprogramit të paraparë, nxënësi pajisej me ixhazet, diplomë të nënshkruar nga ana e myderrizit, me të cilin kishte mundësi të shërbejë si nëpunës fetar.⁶²³ Ky sistem, deri diku i përngjanë sistemit të Bolonjës sot, që zbatohet në studimet universitare.

Kuadri edukativo—arsimor:

Medreseja “Medah” ndiqte sistemin klasik të shkollave të vjetra islame, si ajo e “Isa Beut”, “Is’hak Beut” dhe shkollat tjera islame jashtë vendit. Kjo nënkupton se planprogrami zhvillohej vetëm nga një mësimdhënës, i cili kishte edhe asistentin e tij. Mësimdhënës në

⁶²² Më gjerësisht rreth lëndëve dhe literaturës shih: Taxhedin Bislimi, Medreseja Medah e Ataulah efendiut dhe nxënësit e saj, Shkup, 2011, f. 40-42.

⁶²³ Po aty, f. 43.

këtë medrese ishte myderrizi Ataullah efendi, ndërsa për asistent zgjidhte ndonjërin nga nxënësit më të aftë të tij nga lënda përkatëse, si Fetah efendiun, Xhemail efendiun dhe Ramadan efendiun.⁶²⁴

Financimi i medresesë

Medreseja “Medah”, për nga statusi juridik ishte medrese private, që nënkupton se ajo financohej nga vetë populli dhe bamirës të ndryshëm. Kjo medrese ishte e vetnja medrese private në territorin që e mbulonte Ulema Mexhlisi i Shkupit⁶²⁵.

Arritjet e medresesë Medah

Medreseja “Medah”, gjatë funksionimit të saj 23 vjeçar (1923–1946), duke e zbatuar sistemin e saj klasik, kishte arritur të aftësojë mbi 80 nxënës dhe t’i pajisë me ixhazete (diploma).

Nxënësit e diplomuar në këtë medrese ishin bartësit e davetit (thirrjes) islam në një pjesë të madhe të trojeve shqiptare. Nxënësit e kësaj medreseje kryesisht ishin nga Shkupi, Kumanova, Presheva, Gostivari, por kishte edhe disa që vinin nga vende të ndryshme të Kosovës.

Këta nxënës, përveç që merreshin me kryerjen e aktiviteteve fetare nëpër xhami dhe mexhlise të ndryshme, ata merreshin edhe me aktivitete të ndryshme shoqërore. Një numër jo i vogël i tyre merreshin edhe me aktivitete politike dhe ushtarake.⁶²⁶ Kështu, Xhemail ef. Xhemaili ishte anëtar i shtabit dhe këshilltar politik i Sulë Hotlës, Ferat ef. Hirda ishte këshilltar dhe përgjegjës për furnizimet ushqi–

⁶²⁴ Po aty, f. 44.

⁶²⁵ Po aty, f. 44–45.

⁶²⁶ Rreth kontributit të hoxhallarëve lexo: Naser Ramadani, Kontributi i ulemave të Kumanovës në ngritjen e çështjes kombëtare përmes shkollës shqipe, 1940–1950, në Simpoziumin shkencor: “Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare”, Shkup, 2012, f. 154–158.

more,⁶²⁷ Haki Sernaxhaj ishte anëtar i Ushtrisë Vullnetare për Mbrotjtjen e Kosovës Lindore. Për shkak të aktiviteteve të tyre politike dhe ushtarake, dhe për shkak të qëndrimit të tyre ndaj pushtetit, shumë prej hoxhallarëve u dënuan me dënime të ndryshme, disa me vdekje, ndërsa disa të tjerë me disa vjet heqje lirie.⁶²⁸

Thënë shkurt, kjo medrese ishte nga populli dhe për popullin. Pushteti i atëhershëm nuk kishte ndikim në të aspak. Andaj, kua-drot e dalë nga kjo medrese ishin të përgatitur mirë që të jenë në anën e popullatës sa herë që rrezikohej interesi i popullatës islame në këto troje. Kjo u pa qartë në qëndrimi i tyre ndaj detyrimit të shqiptarëve për t'i lëshuar trojet e tyre, ndaj medresesë “Aleksandri I”, ndaj uzurpimit të vakëfeve, ndaj mbylljes dhe rrënimit të xhamive etj. Nuk duhet harruar se një numër i këtyre nxënësve hapën shkollat e tyre në vendet nga të cilat vinin, ku më pas, nxënësit e tyre u bënë bartës të arsimit shqip në vende të ndryshme të trojeve shqiptare.⁶²⁹

Medreseja e Reformuar “Gazi Isa Beu” (1936–1941)

Themelimi i kësaj medreseje daton shumë herët, qysh në fillim të Periudhës Osmane.⁶³⁰ Kjo medrese është themeluar nga prefekti i Shkupit, Gazi Isa Beu, i biri i Is'hak Beut, më 1469. Për këtë dëshmon vetë vakufnamja e Isa Beut, në të cilën thuhet: “...dhe të ndërtoj një medrese për njerëzit që duan dituri, e cila përbëhet prej

⁶²⁷ Sevdail Demiri, Sulë Hotla..., Kumanova për flamur NDSH-UÇK, f. 73; Qerim Lita, Shaban efendia, f. 149.

⁶²⁸ Naser Ramadani, Kontributi i ulemave të Kumanovës në ngritjen e çështjes kombëtare përmes shkollës shqipe, 1940-1950, në Simpoziumin shkencor: “Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare”, Shkup, 2012, f. 163-165.

⁶²⁹ Naser Ramadani, Kontributi i ulemave të Kumanovës në ngritjen e çështjes kombëtare përmes shkollës shqipe, 1940-1950, në Simpoziumin shkencor: “Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare”, Shkup, 2012, f. 158-163.

⁶³⁰ Rreth kësaj medreseje më gjerësisht lexo: Naser Ramadani, Zhvillimi i arsimit islam në Maqedoni gjatë shekujve XV-XVI, Topër, Shkup, 2010, f.128-132.

10 dhomave”.⁶³¹ Evlija Çelebiu e ka cekur si një ndër medresetë më të njohura të Shkupit.⁶³² Pas përfundimit të Perandorisë Osmane, respektivisht pas vitit 1912, me krijimin e rrethanave të vështira politiko-shoqërore dhe ekonomike, kjo medrese ndërpreu aktivitetin e saj.

Më 1936, me iniciativë të Ulema Mexhlsit të Bashkësisë Fetare Islame, medreseja “Isa Beut” rihapet përsëri, mirëpo tani me emrin “Medreseja e Reformuar Gazi Isa Beu”. Puna zyrtarisht në të filloi me 2 tetor 1936.

Qëllimi i kësaj shkolle ishte përgatitja e kuadrit për imamë, mësues fetarë, mualimë, imamë, hatibë dhe përgatitja e kandidatëve për fakultete teologjike islame ose shkolla të larta.⁶³³ Po ashtu, qëllimi i kësaj medreseje ishte aftësimi i personelit të nevojshëm për kuadro fetarë dhe fetaro-arsimor në shërbim të Bashkësisë Fetare Islame. Kjo shihet qartë nga njoftimi i lëshuar më 2 shtator 1936 nga ana e Fejzi Haxhiamziq, përfaqësuesit i Ulema Mexhlsit të Bashkësisë Fetare Islame për Shkup, në të cilin thuhet: “Me qëllim të krijimit dhe aftësimit të personelit të nevojshëm për kuadro fetarë dhe fetaro-arsimorë në shërbim të Bashkësisë Fetare Islame, me vendim të nënshkruesit dhe këshillit të tij është themeluar medreseja qendrore tetëvjeçare “Gazi Isa Beu” në Shkup”.⁶³⁴

Planprogrami mësimor

“Medreseja e Reformuar Gazi Isa Beu” ishte shkollë e mesme islame. Pasi qëllimi i saj ishte përgatitja e kuadrove fetarë të profileve të

⁶³¹ Глиша Елезович, Турски споменици -I-, стр. 83.

⁶³² Evlija Çelebi, Putopis, str. 285.

⁶³³ Muhamed Sallkić, Ustavi Islamske Zajednice, el –Kalem, Sarajevë, 1422/2001. f. 187.

⁶³⁴ ДАРМ.1.955.1.1/1-2, Прослава свечаног отварања Гази Исабегове Централне Медресе и Централне Вакуфске Библиотеке у Скоплу, бр. 5267/36, Скопле, 2 септембра 1936 год. Наиб за Исламску Верску Заједницу, Фејзи Хациамзич.

ndryshme, atëherë është e logjikshme që pjesa dërrmuese e lëndëve të jenë të fushës islame, siç janë: Kurani, akaidi, fikhu, tefsiri, hadithi, edukata islame, historia islame, gjuha arabe etj. Krahas lëndëve fetare kishte edhe lëndë shkencore, prandajdhe u quajt “Medreseja e Reformuar”. Kjo shihet qartë nga fjala e Fejzi Haxhiamziqit, ku thuhet: “Planprogrami mësimor i kësaj shkolle, i cili është miratuar nga zotëria, Ministri i Arsimit, përveç arsimimit fetar parasheh edhe arsimim në shkencat natyrore, kështu që, Medreseja nxënësve të vet do t’u ofrojë arsimim bashkëkohor fetar dhe shoqëror”.⁶³⁵

Mësimi në këtë shkollë ishte planifikuar të jetë tetëvjeçar, me dy shkallë dhe nga katër vjet për secilën prej tyre. Kjo vërehet në rregulloren e Ulema Mexhlsit të Bashkësisë Islame, ku në nenin 2 thuhej: “Medreseja qendrore e reformuar “Gazi Isa Beu” në Shkup është autonome, shkollë e mesme teologjike islame me dy shkallë: shkalla e ulët dhe e lartë, në të cilën mësimi zgjat nga katër vjet”.⁶³⁶ Për shkak të luftës së Dytë Botërore që shpërtheu me 1941, kjo Medrese u mbyll dhe nuk arriti të nxjerrë asnjë gjeneratë me shkolim të kryer plotësisht.

Kuadri edukativo–arsimor

Medreseja e Reformuar “Gazi Isa Beu” deri diku kishte një autonomi më të madhe në caktimin e kuadrove edukativo–arsimor. Andaj, kuadri i cili u angazhua në vitin e parë të kësaj shkolle ishin: Hamid Haxhibegiq – jurist i diplomuar në Fakultetin Teologjik, drejtor shkolle, Remzi Rexhep Abdullahu – Fakultetit Teologjik, Hajro Sheqerkaqi – Fakultetin Filozofik, Bedri Abazi – Fakultetin Teologjik në Universitetin e Az’harit, Qamil Ibrahimiri – Fakultetin Teologjik, Fuad Slipçeviq – Fakultetin Filozofik, Nijaz Resuloviq,

⁶³⁵ Po aty.

⁶³⁶ Po aty.

student në Fakultetin Filozofik në Beograd.⁶³⁷ Nga mbienrat e tyre mund të supozohet se tre prej tyre ishin shqiptarë, ndërsa katër të tjerët boshnjakë.

Nga përgatitja profesionale e kuadrit edukativo–arsimor shihet se disa kishin të kryer fakultete teologjike, ndërsa disa të tjerë fakultete filozofike, që mund të supozohet se Ulema Mexhlisi nuk kishte autonomi të plotë në përzgjedhjen e kuadrove, sepse operativa shtetërore me siguri kishte dorë edhe aty.

Financimi në këtë medrese

Pasi Medreseja e Reformuar “Gazi Isa Beu” ishte e themeluar nga ana e Ulema Mexhllisit të Bashkësisë Fetare Islame, atëherë ai merrte përsipër edhe financimin e kësaj medreseje. S’ka dyshim se buri–met kryesore të Bashkësisë Islame kanë qenë vakëfet dhe njetet e grumbulluara nga bamirësit muslimanë, nga fitrat dhe nga zeqati. Nga numri i nxënësve të pranuar vërehet se nga gjithsej 72 nxënës të pranuar në vitin e parë, 45 ishin me financim të Bashkësisë Fetare Islame, ndërsa 27 me vetëfinancim.⁶³⁸ Kjo le të kuptohet se vetëfinancimi nga ana e disa nxënësve ka ndihmuar në buxhetin e kësaj medreseje. Nxënësit në këtë shkollë, krahas arsimimit dhe edukimit, kishin të siguruar edhe fjetjen në internatin e shkollës dhe ushqimin në mensën e saj.

Arritjet e kësaj medreseje

Potencuam më lartë se kjo medrese, për shkak të fillimit të Luftës së Dytë Botërore, nuk arriti të nxjerrë asnjë gjeneratë me shkollim të kryer plotësisht, megjithatë arriti të bëjë aftësimin e një numri të konsiderueshëm të personaliteteve të cilët më vonë do të jenë në ballë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, siç ishin: Azem Marana, Hilmi Shehu, Abdylqerim Saiti, Hilmi Qerimi, Ramadan Agushi,

⁶³⁷ Po aty. 3/1.

⁶³⁸ Po aty. 554-555.

Idriz Idrizi etj., të cilët më vonë e themeluan Organizatën Nacio-
nal-Demokratike Shqiptare (NDSH).⁶³⁹

Medreseja e Madhe “Aleksandri I” (1925–1941)

Iniciativa për themelimin e kësaj medreseje është ngritur në shtator të vitit 1923 nga Hasan Rebac dhe Ahmed Mehmedbashiq, funksionarë të lartë pranë Ministrisë së Fesë të qeverisë mbretërore të SKS. Kjo medrese dekretohet nga ana e Mbretit Aleksandar I më datë 24 prill 1924.⁶⁴⁰ Në shtator të vitit 1925 kjo medrese filloi punën në Shkup. Nga kjo kuptohet se themelues i kësaj medreseje ishte Qeveria e asokohshme e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene (SKS).

Qëllimi i themelimit të kësaj medreseje ishte që nëpërmjet saj të ushtrohet dhe të kontrollohet ndikimi mbi popullsinë shqiptare dhe turke, ngase udhëheqësit fetarë ishin të vetmit të shkolluar deri diku në këtë shoqëri dhe me anë të udhëheqësve fetarë, të cilët do të arsimohen dhe edukohen në këtë shkollë, do të jepet mundësia e depërtimit në brendinë e tyre.⁶⁴¹

Qëllimi i themelimit të kësaj medreseje, ndonëse në shikim të parë ishte fetar, por në realitet aty më së paku mësohej feja, Pjesa dërrmuese e ligjëruesve dhe gjithë edukatorët ishin jomuslimanë, respektivisht serbë. Kjo më mirë shihet në elaboratin e Dragosllav Jovanoviqit, në të cilin thuhet: “...për të ndihmuar që elementët muslimanë, nëpërmjet rrugës së arsimit dhe progresit të futen në rrugën e vërtetë, që të krijohet kleri i ri musliman i edukuar në shkollën dhe frymën e kulturës sonë, nevojave tona shtetërore dhe aspiratave e idealeve tona nacionale, për ta paralizuar aksionin e huaj propagandues në mesin e shqiptarëve e turqve, për ta

⁶³⁹ Qerim Lita, Medresetë e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup gjatë sundimit të mbretërisë së SKS, në Simpozium Shkencor: Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare, f. 119.

⁶⁴⁰ Po aty, f. 109.

⁶⁴¹ Mustafa Memić, Velika medresa i njeni učenci u revolucionarnom pokretu, Skopje, 1984, str. 20.

përsheptuar procesin e asimilimit të këtyre dhe me këtë të mohet në konsolidimin e çështjeve në këto vise, prandaj vendim më i përshtatshëm i zgjidhjes së kësaj problematike u pa themelimi i shkollës së Medresesë së Madhe në Shkup...”.⁶⁴²

Planprogrami mësimor:

Planprogrami mësimor i kësaj medreseje përfshinte më shumë lëndë të karakterit gjuhësor dhe shkencor se sa lëndë të karakterit fetar. Kështu, në këtë medrese mësoheshin gjashtë gjuhë: serbo–kroate, frënge, arabe, gjermane, turke dhe latine. Nga lëndët matematiko–natyrore kishte: matematikë, histori, gjeografi, gjimnastikë, dituri natyre, vizatim, fizikë, kimi, bazat e filozofisë, higjienë, këndim (muzikë) bukurshkrim dhe e drejta civile dhe penale. Ndërsa prej lëndëve fetare mësoheshin këto lëndë: e drejta e sheriatit dhe buri–met e saj, e drejta e trashëgimisë islame, dogmat islame, komentimi i Kuranit, hadithi, histori islame dhe histori e feve.

Për të gjitha lëndët fetare ishin të parapara vetëm 32 orë për javë, ndërsa vetëm për gjuhën serbe 34 orë. Kjo vetvetiu flet për këtë qëllimet e errëta të themelimit të kësaj medreseje.

Kuadri edukativo–arsimor

Kuadri i angazhuar në këtë medrese ishte i asaj natyre që të jetë në gjendje të arsimojnë dhe përgatisin kuadro fetarë të cilët do të zbatojnë politikën shtetërore dhe do të ruajnë dinastinë e Karagjorgje–viçëve. Gjatë 16 viteve të funksionimit të kësaj medreseje kanë punuar 48 profesorë të rregullt dhe 11 honorarë. Prej tyre 24 ishin serbë, 18 boshnjakë, 7 rusë, 3 maqedonas, 3 malazezë, 2 kroatë dhe 2 çifutë.⁶⁴³

⁶⁴² Aj.1.66.Пов.бр.21938, 16 јули 1930 године у Београду, cituar nga Qerim Lita, Medresetë e Bashkësisë..., f. 116

⁶⁴³ Mustafa Memić, Velika medresa i njeni učenci u revolucionarnom pokretu, Skopje, 1984, str. 44.

Financimi i medresesë

Pasi themelues i kësaj medreseje ishte vetë qeveria e SKS, atëherë ajo kishte për sipër edhe financimin e saj. Andaj të gjitha harxhimet për profesorët dhe nxënësit, duke përfshirë këtu qëndrimin në internatin e medresesë i barte vetë qeveria.

Arritjet e kësaj medreseje

Brenda 16 viteve sa ka ekzistuar kjo medrese (1925–1941), gjithsej janë regjistruar 680 nxënës, prej tyre 40% e kanë ndërprerë shkollimin, shumica prej tyre të kombësisë shqiptare. Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar, shkollimin e kanë mbaruar gjithsej 190 nxënës, prej tyre 118 boshnjakë, 62 shqiptarë dhe 10 turq.⁶⁴⁴ Medreseja e Madhe “Aleksandi I”, ishte një instrument ku pushteti i atëhershëm, nëpërmjet saj zbatonte politikën asimiluese të popullsisë joslave. Kjo u vërtetua edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku numri më i madh i nxënësve shqiptarë nga kjo medrese u bënë mbështetës më të mëdhenj të politikës komuniste jugosllave, siç ishte Hivzi Sulejmani dhe suita e tij.⁶⁴⁵

Krahasime dhe analiza

Nëse bëjmë krahasime dhe analiza mes këtyre tri medreseve, do të vërehen dallime të mëdha mes disa prej tyre dhe pika të përbashkëta mes disa të tjera. Medreseja “Medah” ishte shumë e përafërt me medresenë “Gazi Isa Beu”. Në anën tjetër, që të dyja këto, e në veçanti ajo “Medah” ishte shumë larg dhe kishin dallime shumë të mëdha me Medresenë e Madhe “Aleksandrit –I–”.

Në rend të parë themelues i medresesë “Medah” ishte vetë hoxha Ataullah ef. Kurtishi dhe kishte status privat. Medreseja e Reformuar e “Isa Beut” ishte e themeluar nga ana e Ulema Mexhlisit të

⁶⁴⁴ Po aty, f.39.

⁶⁴⁵ Qerim Lita, Medresetë, f. 115.

Bashkësisë Fetare Islame. Ndërsa Medreseja e Madhe “Aleksandrit I” ishte e themeluar nga qeveria e SKS.

Qëllimi i medresesë “Medah” ishte përgatitja e kuadrove për kryerjen e obligimeve fetare, në rend të parë imam, pastaj vaiz dhe mualim. Në anën tjetër, qëllimi i Medresesë së Reformuar “Gazi Isa Beu” ishte përgatitja e kuadrit për nevojat e Bashkësisë Islame si imam, vaiz, mualim, mësues fetar, hatib etj. Ndërsa qëllimi i Medresesë së Madhe “Aleksandri I” ishte krejt ndryshe, ku nëpërmjet përgatitjes së kuadrit fetar të ushtrohet dhe të kontrollohet ndikimi mbi popullsinë shqiptare dhe turke.

Planprogrami i medresesë “Medah” ishte klasik, që përfshinte kryesisht lëndë fetare, por kishte edhe disa lëndë të pakta shkencore. Ai i Medresesë së Reformuar “Isa Beu” kishte më shumë lëndë fetare, por duke përfshirë edhe një numër të konsiderueshëm të lëndëve shkencore. Në anë tjetër, planprogrami i Medresesë së Madhe “Aleksandri I” kryesisht përfshinte lëndë shkencore dhe gjuhësore, ndërsa lëndët fetare më së paku mësoheshin aty.

Sa i përket kuadrit edukativo-arsimor, në medresenë “Medah”, kishte vetëm një mësindhënës dhe asistentin e tij. Në atë të “Isa Beut” disa mësindhënës të diplomuar disa në fakultete teologjike dhe disa të tjerë në fakultete filozofike. Ndërsa në Medresenë “Aleksandrit I” shumica absolute e mësindhënësve ishin serbë, rusë, maqedonas, kroatë dhe çifutë. Mësindhënës të konfesionit islam kishte vetëm disa të nacionalitetit boshnjak. Financimi i medresesë “Medah” ishte në mënyrë private nga bamirës të ndryshëm, ngase edhe statusi i saj juridik ishte privat. Medreseja e Reformuar e “Isa Beut” financohej nga ana e Ulema Mexhllisit, ngase ai ishte themelues. Ndërsa Medreseja “Aleksandrit I” financohej tërësisht nga qeveria e SKS-së.

Arritjet dhe rezultatet e këtyre medreseve ishin të ndryshme. Medreseja “Medah” arriti të nxjerrë një kuadër i cili realisht ishte në

shërbim të popullit. Ata u bënë imamë, vaizë, mualimë etj. Ajo që është më me rëndësi se ata jetonin me brengat e popullit. Kishin qëndrime të prera ndaj disa çështjeve të rëndësishme për popullatën e asaj kohe: qëndrimi ndaj emigrimit të muslimanëve, respektivisht shqiptarëve nga trojet e tyre, qëndrimi ndaj pushtimit të trojeve shqiptare, qëndrimin ndaj pjesëmarrjes në luftë kundër armikut, qëndrimin ndaj arsimimit dhe edukimit të gjeneratave të reja etj.

Medreseja e Reformuar “Gazi Isa Beu”, ndonëse kishte funksionuar shumë pak, vetëm pesë vite, ajo kishte arritur të përgatisë një kuadër i cili më pas do të bëhej bartës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Medreseja e Madhe “Aleksandrit I”, pasi kishte për qëllim që nëpërmjet kuadrit fetar të ushtrohej ndikim dhe kontroll ndaj popullatës muslimane, ajo arriti të nxjerrë një kuadër shumë të dyshimtë. Ata asnjëherë nuk ishin në shërbim të popullit. Asnjëherë nuk kryen shërbime fetare. Shumica e tyre më pas u bënë bartës të ideologjisë komuniste. U angazhuan në organe të ndryshme shtetërore dhe, në vend se të jenë në anën e popullit, ata edhe më shumë ua shtuan vuajtjet atyre.

Nga e gjithë kjo mund të përfundohet se shkollimi dhe edukimi luajnë një rol shumë të madh në formimin e personalitetit të individit. Mirëpo, ky shkollim dhe edukim duhet të ketë qëllimet fisnike dhe humane të cilat përputhen me besimin dhe ideologjinë e popullit, për ndryshe, çdo shkollim që ka qëllime të errëta, që nuk përkasin me besimin e popullit dhe identitetin e tij, dëmi do të jetë shumë më i madh se dobitë. Shembull konkret kemi shkollimin në Medresenë e Madhe “Aleksandrit I”.

Gjatë periudhës komuniste u hapën shumë shkolla nëpër qytete dhe fshatra. Filluan të shkollohen fëmijët, djem dhe vajza. Një numër i tyre vazhdoi studimet edhe në fakultete të ndryshme. Mirëpo, bazuar në atë se ideologjia që predikohej nëpër këto shkolla ishte ideologjia komuniste, vërehet se një numër i madh i të shkolluarve

u ndikuan nga kjo ideologji dhe u bënë komunistë të përbetuar. U krijua një numër i madh komunistësh të cilët kundërshtonin bindjen dhe besimin e popullit të tyre. Edhe sot e kësaj dite kemi një numër të madh të intelektualëve të shkolluar në këto shkolla, që bartin këto bindje.

Mendoj se është koha e unifikimit të besimit dhe shkollimit, respektivisht fesë dhe shkencës. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrijmë të formojmë kuadro të shëndoshë, të cilët do të jenë në shërbim të popullit.

*TAXHEDIN BISLIMI**Bashkësia Fetare Islame – Shkup*

KONTRIBUTI I MEXHLISI ULEMASË SË SHKUPIT NË NGRITJEN E VETËDIJES DHE ARSIMIT TE POPULLATA SHQIPTARE

Ndryshimi dhe kalimi nga sundimi i Perandorisë Osmane nën sundimin e Mbretërisë Serbe Kroate Sllovene (SKS) dhe marrëveshja paqësore e arritur mes të dyja palëve kontraktuese në Stamboll nga 1 deri më 14 mars të vitit 1914⁶⁴⁶, krijoi kushte që Mbretëria Serbe të vendosë sundim absolut mbi popullatën myslimane në përgjithësi, e në veçanti mbi popullatën myslimane shqiptare.

Në janar të vitit 1930 u themelua Bashkësia Fetare Islame sipas Ligjit për Bashkësitë fetare, (i miratuar nga Ministria e Arsimit të Mbretërisë të SKS-së), ndërsa veprimtarinë e saj e zhvillonte sipas Kushtetutës së BFI-së, të miratuar më 9 gusht 1930. Kjo bashkësi fetare, deri më vitin 1936, nuk ishte e konsoliduar si duhej, kurse sistemi strukturor dhe organizativ, thuajse ishte i shkapërderdhur, e kjo vërtetohet nga vetë fakti se shumë myftinj vepronin kokë më vete. Përveç kësaj, shumica e organeve në kuadër të kësaj bashkësie, nuk zgjidheshin përmes votave të lira të myslimanëve, por përmes emërimeve të drejtpërdrejta nga ministri i Drejtësisë. Me këtë kushtetutë, si dhe me politikën me të cilën udhëhiqej BFI-ja në atë kohë, nuk pajtoheshin shumë personalitete myslimane shqiptare, sepse metoda që zbatoheshin ndaj BFI-së, synonte që pushteti i atëhershëm jugosllav, nëpërmjet kësaj bashkësie fetare, respektivisht organeve të saja, t'i mbajë nën kontroll të gjithë myslimanët, sidomos shqiptarët. Pas shumë reagimeve që vinin nga disa krerë më me

⁶⁴⁶ Drzhaven arhiv na Republika Makedonija, Makedonija vo megjunarodnite dogovori, tom 1 (1913-1940), Skopje, 2006, fq 99.

ndikim në vitin 1936, autoritetet e Beogradit lejuan ndërhyrjen dhe ndryshimin e Kushtetutës së BFI-së. Në tetor të këtij viti, në Sarajevë tubohen NAIB-ët dhe këshillat e myftinjve të BFI-së në kuadër të Mbretërisë Jugosllave, të cilët pasi e aprovojnë propozimin e Kushtetutës së re, të njëjtën ia dorëzuan Ministrisë së Drejtësisë dhe më 5 nëntor të vitit 1936, Kushtetuta hyri në fuqi.

Kushtetuta e vitit 1936 dhe zgjedhjet e vitit 1937

Me këto ndryshime kushtetuese u bë edhe bashkimi i të gjitha myftinjve në territorin e Jugosllavisë, ndërsa krahas kryesisë supreme të BFI-së me seli në Beograd, në kuadër të Ulema Mexhllisit të BFI-së, u formuan edhe dy organe, respektivisht njëra me seli në Shkup dhe tjetra në Sarajevë⁶⁴⁷.

Ulema Mexhllisi me seli në Shkup përfshinte territoret e Maqedonisë së sotme, Kosovës, Luginës së Preshevës, Sanxhakun dhe një pjesë të Malit të Zi.

Në vitin 1937, BFI-ja (konform kushtetutës së saj) shpalli zgjedhjet në të gjitha organet e saja. Në këto zgjedhje dolën dy lista zgjedhore. Listës së parë zgjedhore i printe Ferhat bej Draga, pas të cilit qëndronin atdhetarë të shquar shqiptarë, si: Shaban Efendiu, Sherif Voca, Kadri Saliu, Zenel Strazimiri, Hasan Shukriu, Emin Beu, Mulla Idris Gjilani, Remzi Abdullahu etj. Kjo listë, ndryshe quhej edhe **“lista e parisë nacionaliste shqiptare”**. Listës së dytë i printe Fejzi Haxhihamziç, kandidat që u propozua nga mbështetësit e regjimit të Beogradit, shumicën e të cilëve po ky regjim i kishte vendosur nga Beogradi në Shkup, me detyra speciale që të zhvillonin propagandë antishqiptare për turqizmin e tyre⁶⁴⁸.

Paria intelektuale dhe nacionaliste shqiptare (që në fakt ishin udhëheqësit kryesorë të Degës së Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës), i

⁶⁴⁷ Qerim Lita, Shaban Efendija, atdhetar i devotshëm, Kumanovë, 2010, fq. 55.

⁶⁴⁸ Po aty, fq. 57.

kushtoi rëndësi të madhe këtyre zgjedhjeve. Ata në mënyrë të hapur kërkonin nga shqiptarët që të votojnë listën opozitare, të cilës i printe Ferhat bej Draga, duke u premtuar atyre, se nëse do t'i fitonin zgjedhjet, do të angazhohen, fuqimisht në ruajtjen e autonomisë së këtij institucioni fetar. Ata (lista të cilës i printe Ferhat bej Draga) kishin shumë arsye pse këmbëngulnin që të udhëhiqnin me institucionin e Ulema Mexhlisit. Kjo për faktin, se gjithë pasuria e tundshme dhe e patundshme e BFI-së, menaxhohej dhe kontrollohej nga Kuvendi i Vakëfit, ku shumica dërrmuese e besimtarëve ishin myslimanë të përkatësisë kombëtare shqiptare, me ta udhëhiqnin dhe menaxhonin joshqiptarët të emëruar nga Beogradi. Me këtë, ata synonin që të kenë kontroll të plotë mbi myslimanët e këtyre trojeve, si në pikëpamjen ekonomike, po ashtu edhe atë politike dhe arsimore⁶⁴⁹.

Një çështje tjetër me rëndësi jetike, që zgjoi interes të jashtëzakonshëm në zgjedhjet e BFI-së të vitit 1937, ishte se një vit më parë në Shkup, krahas Medresesë së Madhe **“Kral Aleksandri”**, u hap edhe Medreseja e Gazi Isa Beut dhe më 2 tetor të vitit 1936, në mënyrë solemne u bë përvurimi i ndërtesës së re të medresesë, tashmë me emrin **“Medreseja qendrore e reformuar e Isa Beut”**, me plan-program të reformuar dhe të begatshëm.

Për dallim nga Medreseja e Madhe **“Kral Aleksandri”**, e cila financohej dhe mirëmbahej nga buxheti i qeverisë mbretërore dhe me plan-program mësimor të hartuar dhe të imponuar nga Ministria e atëhershme e Arsimit, Medreseja e Gazi Isa Beut ishte autonome dhe plan-programi, financimi, mirëmbajtja dhe mbikëqyrja ishin nën kompetencat dhe angazhimin e organeve të BFI-së.

Rihapja e kësaj medrese të reformuar, hapi mundësi që sadopak të përmirësohet gjendja e vështirë arsimore e popullatës shqiptare. Mirëpo, kjo nuk ndodhi në vitin e parë shkollor, sepse nga 98

⁶⁴⁹ Po aty, fq. 58.

nxënës, të cilët u regjistruan në vitin e parë, më se gjysma e tyre ishin joshqiptarë, shumica e tyre ishin boshnjakë nga Nishi, Novi Pazari, Podgorica, Bello Polja, Priboi etj. Po kështu ishte edhe gjendja e të punësuarve në këtë medrese, ku drejtor ishte Hamid Haxhihamziç, kurse nga gjithsej shtatë mësimsdhënës, të cilët ishin pranuar, vetëm njëri nga ata ishte deklaruar shqiptar, Remzi Abdullah Rexhepi.

Politika e dirigjuar nga Beogradi që zbatohet në organet e BFI-së në Shkup, deri në këto zgjedhje ishte e papranuar nga paria shqiptare, për shkak të diskriminimit që u bëhej atyre. Prandaj, alternativa e vetme ishte që paria shqiptare në mënyrë demokratike t'i merrte në duar të veta institucionet saja.⁶⁵⁰ Që nënkupton, se me BFI-në dhe pronat, duhet të udhëheq popullata shumicë, të mirat e saja, duhet shfrytëzuar në mënyrë proporcionale dhe të ardhurat materiale nga vakëfet e ndryshme të shfrytëzohen edhe për shkollimin e fëmijëve të përkatësisë shqiptare.

Zgjedhjet e organit më të lartë të Kuvendit fetar-arsimor të vakëfit të Shkupit, respektivisht themelimi i Ulema Mexhllisit për viset e Maqedonisë së sotme, të Kosovës, Luginës së Preshevës, Sanxhakut dhe pjesë të Malit të Zi (të quajtura në administratën e asaj kohe **“viset jugore të Serbisë”**), u mbajtën më 19 maj të vitit 1938 në lokalet e Ulema Mexhllisit në Shkup, në prani të Reis-ul Ulemasë të Mbretërisë të Jugosllavisë, Dr. Fehim Spaho të Sarajevës. Për fat të mirë, në këto zgjedhje fitues doli lista nacionaliste shqiptare.

Më 20 maj 1938, anëtarëve të Ulema Mexhllisit të Shkupit u jepen dekretet, në të cilat thuhej:

“Në emër të Lartmadhërisë së tij, Petrit II, sipas mëshirës së Zotit dhe dëshirës së popullit, Mbreti i Jugosllavisë, Mëkëmbësi mbretëror. Në propozim të Ministrit të Drejtësisë, në pajtueshmëri me

⁶⁵⁰Po ary, fq. 59.

Presidentin e Këshillit Ministror dhe në bazë të zgjedhjes, zbatuar sipas paragrafit 3 të ligjit për BFI–në dhe Kushtetutës së BFI–së të Mbretërisë së Jugosllavisë, me datë 19 maj të këtij viti në Shkup, emërohen si anëtarë të Ulema Mexhllisit në Shkup: **Idris Hajrullahu**, ish imam–ofiçar nga Gjilani, **Ataullah ef. Kurtishi**, myderriz nga Shkupi, **Bedri ef. Hamidi**, teolog i diplomuar nga Shkupi, **Sherif ef. Osmani**, gjykatës i sheriatit nga Dibra. Ministri i Drejtësisë le të zbatojë këtë dekret Pavle d.v. R. Stankoviç d.v. I. Petroviç d.v. Beograd 20 maj 1938. Ministri i Drejtësisë Mil. Simonoviç d.v”.

Dr. Mahmud Hysa në lidhje me dhënien e dekreteve rreth emëri–meve të anëtarëve të Ulema Mexhllisit në Shkup, thotë: “Nga kjo shihet se të katër anëtarët që kanë fituar janë shqiptarë, se kanë fituar në bazë të zgjedhjeve të rregullta dhe dekretin për këtë e nënshkruajnë autoritetet më të larta shtetërore. Megjithatë, është për t’u shënuar edhe një dukuri, se me përjashtim të një rasti, emrat e eprorëve të Ulema Mexhllisit nuk serbizohen me prapashtesën sllave –viç, por respektohet forma autoktone shqipe standarde. Kjo jo vetëm me emrat e katër anëtarëve të zgjedhur si anëtarë të UM, por edhe për disa të tjerë”⁶⁵¹.

Në anën tjetër, më 16 maj të vitit 1938, zgjedhjet kishin përfunduar edhe për Ulema Mexhllisin e Sarajevës, kurse më 9 qershor 1938, dy Ulema mexhlliset krahinore, ai i Shkupit dhe i Sarajevës, dhanë betimin para Reis–ul Ulemasë, Dr. Fehim Spahos në Sarajevë.

Me dhënien e betimit si akt solemn dhe ligjor që kishin bërë anëtarët e zgjedhur të dy mexhlliseve, ai i Shkupit dhe i Sarajevës, u formua edhe organi më i lartë i Bashkësisë Islame të Jugosllavisë Versajas që quhej Riaseti i BFI–së.⁶⁵² Anëtarët e riasetit nga Ulema

⁶⁵¹ Mahmud Hysa, SaidNajdeni- Hoxhë Voka, Hafiz Sherif Langu (Studim monografik) Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore të Shqiptarëve – Shkup, Shkup, 2014, fq. 255.

⁶⁵² Muhamed Pirraku, Mulla Idris Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951, Prishtinë, 1995, fq. 22; Mahmud Hysa, Said Najdeni- Hoxhë

Mexhlisi i Shkupit që kishin fituar zgjedhjet ishin: Sherif ef. Osmani – Langu, Ataullah ef. Kurtishi, H. Bedri ef. Hamidi dhe Idris ef. Hajrullahu. Kurse për anëtarë të Ulema Mexhllisit të Sarajevës ishin zgjedhur këta: H. Ef. Aganoviç, Mehmet Ali ef. Qerimoviç, H. Muhamed ef. Panxha dhe H. Ibrahim ef. Rixhanoviç. Këta veprimtarë kulturorë e arsimorë përbënin organin më të lartë të Bashkësisë Islame të Jugosllavisë, përkatësisht Riasetin e BFI-së

Mbledhja konstituive e Ulema Mexhllisit të Shkupit

Pas zgjedhjes të anëtarëve të Ulema Mexhllisit më 21 qershor 1938, mbahet mbledhja e parë e këtij organi. Në këtë mbledhje u formua edhe përbërja e Mexhllisit të Ulemave dhe për kryetar të këtij Mexhlisi u zgjodh H. **Sherif ef. Langu**.

Me konstituivin e këtij organit, vetëm pas tri ditëve, respektivisht më datën 25 qershor 1938, bëhet pranim–dorëzimi mes këtij Mexhlisi dhe udhëheqësisë së mëparshme, përkatësisht udhëheqësit të NAIB–it të BFI-së, Kadri Salihu.

Ajo që ishte shumë e rëndësishme, ishte fakti se me konstituivin e Mexhllisit të ri dhe me aktin e pranim–dorëzimit, përfundimisht në këtë ditë ndërpritet edhe gjendja e jashtëzakonshme, e cila ishte shpallur në bazë të ligjit–kushtetutës së BFI-së në Mbretërinë e Jugosllavisë, më 25 mars 1936. Po në këtë mbledhje, në bazë të kushtetutës së BFI-së, nenit 82 dhe vendimit të kryetarit të Mexhllisit të Ulemave nr. 2500/38, bëhet ndarja e resorëve (detyrat e punës) mes anëtarëve të këtij Mexhlisi. Në këtë mbledhje u vendos që: H. Sherif ef. Langu– Osmani, kryetar i Ulema Mexhllisit; Mulla Idris ef. Hajrullahi – Gjilani, u ngarkua me detyrë të Bash–vaizit (Krye–imam i Ulema Mexhllisit); Ataullah ef. Kurtishi, sekretar për

fetva (sekretar për çështje fetare); dhe Bedri ef. Hamidi, referent fetar–arsimor (përgjegjës për arsim)⁶⁵³.

Inspektimi i gjendjes në terren, konstatimet dhe masat e përmirësimit

Me formimin e Mexhlisi Ulemasë, anëtarët e porsazgjedhur, duke qenë të vetëdijshëm për obligimet që i presin, si dhe përgjegjësitë që kishin marrë mbi vete, vendosën që menjëherë të fillojnë me seriozitetin më të lartë të kryejnë detyrat e tyre, të angazhohen për realizimin e obligimeve që ua kërkon feja dhe aktet normative të BFI–së.

Ky mexhli, në gjysmën e dytë të vitit 1938 dhe gjatë vitit 1939 ka mbajtur 69 mbledhje, ku u shqyrtuan çështje të ndryshme. Ndër të tjerat, vështruan edhe gjendjen e përgjithshme të popullatës myslimane në territorin e këtij mexhlisi, si dhe kërkuar hartimin e një plani operativ sa më të suksesshëm. Për këtë qëllim, me vendim të kryetarit të këtij mexhlisi, H. Sherif ef. Langu, anëtarët e mexhlisit kanë dalë në terren për të parë hallin dhe gjendjen faktike të këtij populli. Kështu që me vendim nr. 22/38 të datës 05.09.1938, H. Bedri ef. Hamidi (përgjegjës fetar–arsimor) dhe Selman ef. Ibrahimini (sekretar i mexhlisit), zyrtarisht udhëtojnë për në Shtip⁶⁵⁴. Vizitat zyrtare me vendim të kryetarit vazhdojnë derisa e mbulojnë të gjithë territorin e këtij Mexhlisi.

Me vendim nr. 2231/39 të datës 7 maj 1939, komisioni i përbërë nga H. Sherif ef. Langu, kryetar, H. Bedri ef. Hamidi, anëtar dhe Selman ef. Ibrahimini, sekretar i UM–së, duhej të vizitojnë tërë territorin e Mexhlisi Ulemasë së Shkupit, për të bërë inspektimin e organeve dhe të institucioneve të BFI–së.

Etapja e parë e inspektimit ishte zhvilluar prej 18 qershorit – 23 korrik të vitit 1939. Ky inspektim ka përfshirë Komisariatet e

⁶⁵³ Izveshtaj o radu ulema –mexhlisa u Skoplju u 1938-1938 godinu, Izdaje Reislul-Uleme IVZ Kraljevine Jugoslavie, Sarajevo, 1941, fq.6.

⁶⁵⁴ Po aty. Fq. 9.

Vakëfeve që nga Beogradi, nëpër Nish, Kosovë, e deri në Shkup. Etapa e dytë e inspektimit ishte zhvilluar nga 25 korriku – 13 gusht të vitit 1939. Inspektimi kishte përfshirë këto komisariate të vakëfit: Koçan, Shtip, Radovish, Strumicë, Vallandovë, Kavadarç, Veles, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Prilep, Manastir, Resnjë, Ohër, Strugë dhe Dibër⁶⁵⁵.

Detyrë të veçantë ka pasur H. Bedri ef. Hamidi (përgjegjës fetar–arsimor), që të hulumtojë gjendjen faktike të institucioneve fetare–arsimore, në mënyrë që ta sjellin rregulloren për medresetë dhe xhamitë. Me mbarimin e inspektimit, ky komision, Mexhllisit të Ulemave të Shkupit i praqet raportin mbi vizitën e bërë në terren.

Raporti i Ulema Mexhllisit të Shkupit

Kryetari i UM–së të Shkupit, H. Sherif ef. Langu, me shkresën nr. 3582/40 të datës 18 mars 1940, i drejtohet Reis–ul Ulemasë të BFI–së të Mbretërisë së Jugosllavisë në Sarajevë dhe e lajmëron se Komisioni e ka kryer inspektimin mbi organet dhe institucionet e BFI–së në rajonin e UM–së të Shkupit dhe për të ka përgatitur raport. Raporti të dhënat i ka të sistemuara: pjesa e përgjithshme, xhamitë, nëpunësitë e xhamive, imamët ushtarakë (imamët të cilët shërbenin si imamë në ushtri), gjyqet dhe gjykatësit e sheriatit, varrezat islame, teqetë, objektet e vakëfit, mejtepet, medresetë, mësimi fetar islam dhe mësuesit fetarë në shkolla, arsini shtetëror (shkollat fillore, të mesme, zeytare dhe fakultetet), komisarati i vakëfeve, mexhlisi i xhematit, imamatet kryesorë dhe imamatet e xhematit, aktivitete tjera të UM–së për ruajtjen dhe kultivimin e jetës fetare dhe moralit, si dhe udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e jetës shoqërore dhe kulturore⁶⁵⁶.

⁶⁵⁵ Mahmud Hysa, Said Najdeni-Hoxhë Voka..., fq. 261. Izveshtaj o radu ulema – mexhlisa u Skoplju u 1938-1938 godinu, fq. 10.

⁶⁵⁶ Izveshtaj o radu ulema – mexhlisa u Skoplju u 1938-1938 godinu, fq. 01-222; Mahmud Hysa, vep.cit., fq. 262.

Raporti paraqet gjendjen faktike të myslimanëve në territorin e UM-së, jep të dhëna konkrete në lidhje me mejtepet, medresetë, xhamitë dhe kuadrin e angazhuar në përgjithësi, ndërsa për territoret ku banonte popullata shqiptare ishte përmbledhur në veçanti. Po ashtu, paraqet diskriminimin fetar dhe indiferencën e pushtetit ndaj popullatës myslimane (shqiptare), qëndrimin armiqësor të ortodoksëve sllavë ndaj komunitetit mysliman. Raporti, në fjalë, tregon edhe aftësitë dhe meritat e anëtarëve të këtij komisioni, e në mënyrë të veçantë tregon për përgatitjen profesionale të referentit fetar-arsimor, H. Bedri ef. Hamidit, i cili në këtë raport shihet si njohës i mirë dhe i thellë i problematikës dhe përpilues i një studimi meritor të një elaborati me peshë të veçantë⁶⁵⁷.

Këtu do të paraqesim vetëm një pjesë të këtij raporti, që ka të bëjë me shkollat shtetërore në Mbretërinë Jugosllave, për të cilat do të duhet të bëjmë përshtatjen nga gjuha serbe në gjuhën shqipe. Të dhënat në raport mbi shkollat shtetërore janë të ndara: në shkolla fillore, të mesme – profesionale dhe në fakultet⁶⁵⁸.

SHKOLLAT SHTETËRORE

a) Shkollat fillore

Për të ilustruar më mirë gjendjen e shkollave fillore në këto hapësira në raport me myslimanët, u sjellim të dhëna të nxjerra nga raporti i inspektimit:

Në paraqitjen e rrethanave të përgjithshme është bërë fjalë për gjendjen e arsimit fetar në mesin e myslimanëve. Këtu duhet konkretizuar shkaqet e gjendjes së vështirë të arsimit, andaj edhe do të fillojmë nga shkollat fillore.

⁶⁵⁷ Mahmud Hysa, vep.cit., fq. 262.

⁶⁵⁸ Izvestaj o radu ulema –mexhlisa u Skoplju u 1938-1938 godinu, fq. 143-176.

Para së gjithash, me keqardhje duhet konstatuar se fëmijët myslimanë edhe më tutje vazhdojnë të vijnë shkollimin vetëm në një numër të vogël të tyre edhe pse shkollimi sipas ligjit është obligues. Kjo gjendje vërehet veçanërisht nëpër fshatra dhe të lë një përshtypje të zymtë, se fëmijët tanë po mbeten të paarsimuar në kohën kur në botë ngritjes arsimore të popullit i kushtohet një vëmendje e madhe. Dy janë arsyet e kësaj gjendje, e para është e shkaktuar nga vetë myslimanët dhe e dyta shkaktohet që vijnë nga jashtë, jashtë tyre (nga jomuslimane T.B).

Arsyet që burojnë nga vetë myslimanët

Sa i përket arsyeve që burojnë nga vetë myslimanët për mos arsimimin e fëmijëve, janë nga më të ndryshmet. Në vazhdim sjellim vetëm dy prej tyre:

Mosbesimi ndaj sistemit: *Muslimanët e këtyre trojeve në përgjithësi, ndaj shkollës ende sillen me një mosbesim të madh. Ky fenomen vërehet veçanërisht nëpër fshatra. Në të shumtën e rasteve, vetë prindërit përdorin edhe forcë fizike, që fëmijët e tyre t'i largojnë nga shkolla, duke mos e ditur se çfarë dëmi i bëjnë dhe çfarë janë pasojat ndaj tyre dhe fëmijëve. Kjo mënyrë e sjelljes ndaj shkollës është pasojë e kultivimit të këtij elementi, në një ambient të rreptë konservator, padituri dhe mos informimi të drejtë për rëndësinë dhe vlerën e vërtetë të shkollës dhe për nevojën e ngritjes arsimore të rinisë. Këtu duhet të theksojmë se edhe shërbyesit fetarë kanë neglizhuar çështjen dhe nuk kanë treguar mirëkuptim dhe përpjekjen e duhur që gjendja arsimore të përmirësohet. Këta shpeshherë kanë qenë edhe barrierë e kësaj çështjeje. Mirëpo, nga koha kur Mexhlisi i Ulemave në Shkup dha urdhër të prerë për të gjithë imamët e xhematit, që të marrin aksion për regjistrimin e fëmijëve të rritur nëpër shkolla dhe të angazhohen me të madhe që këta fëmijë detyrimisht ta vijnë mësimin e rregullt, vërehet një përparim shpresëdhënës se gjendja do të përmirësohet.*

Gjendja e vështirë materiale: Si faktor i dytë i rëndësishëm për mos arsimimin e fëmijëve e që vije nga vetë myslimanët ishte gjendja e rëndë materiale–ekonomike. Kjo çështje e rëndë për nga mprehtësia e saj, veçanërisht shprehet në fshatra, ku fshatari shpesh–herë ishte i detyruar ta largojë fëmijën nga shkollimi, për t’iu gjetur rreth ruajtjes së bagëtisë apo për punë në bujqësi.

Arsyet që burojnë nga jashtë myslimanët

Sa i takon faktorëve nga jashtë e që kanë ndikuar mbi mos vijimin apo vijimin e dobët në shkollat fillore nga fëmijët myslimanë, janë të shumta dhe me këtë rast po përmendim disa prej tyre.

Gjendja e dobët e mësim–besimit Islam. Në rend të parë vlen të theksojmë gjendjen e dobët të mësim–besimit islam në këto shko–lla, gjë që është përmendur edhe më lart, me ç’rast popullata myslimane krijon paragjykimë për shkollën si institucion që jo vetëm se nuk ka asnjë lidhje me fenë, por në mënyrë indirekte është kundër saj. Në anën tjetër, *udhëheqësia e shkollave në shumë vende akoma kanë pikëpamje të gabuara sa i takon çështjes së arsimimit të myslimanëve*. Organet fetare këtë çështje e kanë theksuar në disa vende, duke nënvizuar se edhe aty ku popullata myslimane kishte vullnet për shkollën, shpeshherë pengojë çdo aksion në këtë drejtim. Na kanë dhënë edhe shembuj për vërtetimin e kësaj gjendjeje. Mes tjerash, si dëshmi më e mirë për këtë flet fakti se udhëheqësia e shkollave shumë dobët apo aspak nuk ndërmerre diçka për t’i detyruar fëmijët myslimanë për ta vijuar mësimin. Këtë tolerim, shpeshherë e arsyetojnë se kinse nuk duan ta lëndojnë ndjenjën fetare të masa myslimane, duke pasur parasysh pikëpamjet konservatore të tyre ndaj shkollës. Është më se e qartë, megjithatë, myslimanëve nuk u bëhet shërbim, por një dëm shumë i madh.

Imponimi i kulturës së huaj te nxënësit mysliman. Për mos vijimin e mësimin nëpër shkolla nga fëmijët myslimanë, ndikim me efekte negative kishte edhe tentativa për asimilim fetar e kulturor, përmes

kremtimit dhe manifestimit të festave krishtere nëpër shkolla dhe jashtë tyre, të cilat u imponoheshin edhe nxënësve mysliman. Shpeshherë, fëmijët myslimanë detyroheshin të jenë të pranishëm në këto manifestime, të vijojnë orët e mësim-besimit krishterë apo të shkojnë në kishë për festat e tyre, të heqin kapelat e të marrin pjesë në leximin e lutjeve jomyslimane. Kuptohet, të gjitha këto gjëra shumë keq janë reflektuar dhe kanë krijuar një mosbesim të madh ndaj shkollës të masat myslimane. Kjo dukuri edhe më tepër është theksuar me përdorimin e librave të papërshtatshme, për të cilat është bërë fjalë më herët.

Për të gjitha këto, ne kemi dalë në terren dhe kemi konstatuar se veprimet e tilla sot janë pak më të rralla, si rezultat i kërkesës të Mexhllisit të Ulemave, që ata që kryejnë veprime të tilla, të shpallen fajtorët dhe ndaj tyre të merren masa sanksionuese. Për këtë arsye është e nevojshme që të ndërmerren masa edhe më rigorozë, që veprimet e tilla plotësisht të pengohen, meqë me këto veprime krijohen dëme të dyfishta, pamundësohet arsimimi i popullit dhe krijohet urrejtja ndaj shkollës. Është për të shpresuar se kështu do të kuptohet edhe nga pala tjetër, gjegjësisht, se shkolla në mënyrën më të mirë do t'i shërbejë qëllimit hyjnor, nëse trajtohet si një e mirë e përgjithshme popullore, jashtë kufijve të të gjitha organizatave fetare, të cilave u lejohet të veprojnë në kuadër të feve të tyre jashtë shkollave, e jo përmes shkollave dhe brenda tyre.

Mungesa e objekteve shkollore dhe e kuadrit adekuat arsimor. Si arsye tjetër nga jashtëdhe shumë e rëndësishme është edhe mungesa e objekteve shkollore. *Në hapësirat ku jeton popullata myslimane, numri i shkollave është minimal. Kjo është rezultat i udhëheqjes së keqe të politikës diskriminuese arsimore nga ana e faktorëve kom-petent dhe në anën tjetër edhe rezultat i të moskuptuarit të udhë-heqësisë lokale myslimane. Shkollat nuk janë ngritur proporcionalisht, por edhe sot nuk ngritën në vendet myslimane.* Sa i përket pjesës së dytë, udhëheqësve lokalë, tek ata edhe sikur të kishte vetëdije për nevojën e hapjes të shkollave, nuk do të priteshin re-

zultate më të mira, duke e marrë parasysh faktorin ekonomik të popullatës myslimane, që me njetet e tyre ndërtojnë shkolla. Andaj, është më se e nevojshme, që në ndihmë t'u dalë edhe shteti, meqë siç jemi bindur nga vetë terreni, numri më i madh i vendeve janë pa shkolla dhe për to janë të nevojshme më shumë njetete.

Mendojmë se kësaj çështjeje duhet kushtuar vëmendje të veçantë, sepse analfabetizmi në mesin e myslimanëve është i përhapur në masë më të madhe se sa në të gjitha pjesët tjera të shtetit tonë. U kemi rekomanduar organeve fetare, që të ndërmarrin aksion në vendet e banuara me myslimanë, aty ku nuk ka shkolla, të punohet në ndërtimin dhe riparimin e tyre. Mexhlisi i Ulemave për këtë çështje ka kryer një anketë dhe ka mbledhur të dhëna për këto vende se ku duhet hapur shkolla, andaj duhet angazhuar që kjo çështje të zgjidhet në mënyrën më urgjente. Po ashtu, është vërejtur se në shumë shkolla nuk kanë mësues dhe mbeten të mbyllura me muaj e vite të tëra. Edhe për këtë problem duhet mbledhur informacione dhe të punohet që edhe këto shkolla të kenë mësuesit e vet.

Diskriminimi në baza fetare e kombëtare. Si arsye tjetër shumë e rëndësishme, pse fëmijët myslimanë mbeten pa arsimin, e që është dukuri e shpeshtë, është diskriminimi fetar dhe kombëtar që e bënin udhëheqësit e shkollave. Ky diskriminim vjen në shprehje më së shumti te *udhëheqësit e shkollave, aty ku numri i nxënësve është i kufizuar për t'i pranuar, për arsye të hapësirës. Në këto shkolla, në rend të parë i pranojnë fëmijët e feve tjera e pastaj fëmijët mysliman, nëse për ata ka vende të lira.* Duke marr parasysh se numri i këtyre shkollave është i madh, janë më se të qarta dëmet dhe pasojat te vetë popullata (shqiptare) myslimane. Për këtë duhet pasur kujdes edhe me rastin e regjistrimit të nxënësve dhe të kërkohet që regjistrimi të bëhet proporcionalisht sipas numrit të banorëve. Për këtë duhet dhënë urdhra të nevojshme organeve fetare vendore.

Kuptohet se i tërë faji për këtë gjendje nuk mund t'i lihet popullit për shkak të traditave shekullore dhe të bindjeve të trashëguara për

shkollën, por barra kryesore bie te nëpunësit fetarë dhe gjithsesi te organet dhe qeveritarët, te të cilët nuk guxon të ketë vend për ndjenja dhe veprime të këtilla. Të paktë janë shembujt kur nëpunësit rajonal kanë marrë masa efikase dhe aksione gjithëpërfshirëse, ku me autoritetin e tyre, në çdo vend, nga zyrat e tyre dhe xhamitë iu janë drejtuar popullit për rëndësinë dhe rolin e shkollës në jetën e përditshme.

Megjithatë, përmes nëpunësve fetarë ka qenë e mundur dhe është dashur të arrihet më shumë në këtë drejtim. Ata janë më të thirrur që te myslimanët t'i thyejnë paragjykimet dhe stereotipet dhe të krijojnë pikëpamje të shëndosha për shkollën dhe arsimimin, ashtu siç e trajton edhe vetë Islami, i cili arsimimin e llogaritë si kusht të vërtetë dhe fundamental të ngritjes fetare të individit dhe të popullit në përgjithësi.

Mungesa e kuadrit. Si arsye e rëndësishme dhe e fundit, se pse myslimanët nuk i vijnë shkollat fillore në numër të konsiderueshëm është mungesa e mësuesve myslimanë. Numri i tyre në tërë regjionin është shumë i vogël. Në anën tjetër roli i mësuesit në ditën e sotme është shumë i madh dhe nuk mund të kompensohet me asgjë. Nevoja për kuadër profesional në këto troje, shpeshherë është potencuar për shkak të obligimeve të mëdha, që ata duhet të marrin përsipër me qëllim të vetëdijesimit dhe ngritjes edhe të popullatës myslimane të këtyre trojeve.

Edhe më i dhimbshëm është fakti, se rinia myslimane, edhe nëse kohëve të fundit vërehet një dëshirë më e madhe për t'u shkolluar, shumë rrallë paraqiten në shkollat e mësuesisë, për të cilat shfaqin interesim mjaft të ulët. Për t'u përmirësuar kjo gjendje duhet propozuar Këshillit të Vakëfit në Shkup, që të krijohen numër më i madh i bursave për shkollat e mësuesisë, meqë aty hetohet zbrastira më e madhe dhe nevoja më urgjente.

Gjendja e rëndë e rrethanave arsimore në mesin e myslimanëve, nxiti nevojën e gjetjes së njeteve të shpejta dhe të përshtatshme për t'u përmirësuar. Mexhlisi i Ulemave i kushtoi vëmendje të veçantë kësaj çështjeje dhe ndërmoi masat konkrete. Paraprakisht duhej të mblidheshin të dhëna të sakta për numrin e shkollave dhe numrin e nxënësve myslimanë në tërë regjionin, pastaj të sillen përfundime dhe sugjerime për masat që duhet ndërmarrë në çdo vend të këtij regjioni. Me rëndësi të veçantë është që sa më shumë fëmijë myslimanë të regjistrohen në klasë të parë të shkollës fillore dhe të vijojnë mësimin e rregullt. Në këtë mënyrë, me rritjen e numrit të nxënësve, rritej edhe kërkesa për ndërtimin e më shumë shkollave fillore edhe në këtë regjion. Meqë nëpunësit fetarë nuk ishin në gjendje të plotësojnë mungesën që vërehej në aksionet e dobëta arsimore dhe kulturore në mesin e popullatës myslimane, paraqitet nevoja e plotësimit me mësues në më shumë vende.

Pjesa kryesore e aksionit për përmirësimin e rrethanave arsimore përmes shkollave fillore duhej të zhvillohej përmes imamëve të xhematit; këtë e kanë edhe obligim ligjor, sepse ata mbajnë statistikën e përgjithshme dhe janë më të thirrur për të bërë regjistrimin e fëmijëve në klasë të parë. Mexhlisi i Ulemave në bazë të vendimit nr. 2641 nga 1 qershori 1939, u ka dhënë udhëzime të detajuara të gjithë imamëve për realizimin e këtij procesi. Para së gjithash, është urdhëruar që menjëherë të bëhet regjistrimi i të gjithë fëmijëve nga mosha 7 vjeçare e më lartë në mesin e xhematit të tyre dhe të përfshihen me lista kolektive në shkollë fillore. Për fëmijët, që mbushin shtatë vjet në fillim të vitit shkollor 1939/40 dhe duhet të jenë të regjistruar, është urdhëruar që shkollave t'u dorëzohen lista nga libri amëz i të lindurve për vitin përkatës. Rëndësia e kësaj pune është theksuar dhe u është tërhequr vërejtja edhe komisioneve të vakëfeve dhe mexhliseve të xhematëve, që t'i ndihmojnë imamët në këtë çështje, sepse Mexhlisi i Ulemave dëshironte që asnjë fëmijë i rritur të mos mbetet i paregjistruar, duke shpresuar në mirëkuptimin e nëpunësve fetarë se me këto përpjekje do t'i thyejnë paragjy-

kimet te popullata, të cilët me një tjetër sy e shohin çështjen e shkollimit dhe arsimimit nga shkaqet e përmendura më parë.

Përveç kësaj, u është tërhequr vërejtja edhe organeve vendore dhe për të gjitha pengesat në të cilat do të hasin gjatë kësaj pune, u janë dhënë edhe udhëzime se si t'i tejkalojnë. Është potencuar që në çdo rast kur prindërit pengojnë regjistrimin e fëmijëve të vënë në funksion ndikimin e tyre dhe t'i inkurajojnë. Në raste të caktuara, për prindërit e pandërgjegjshëm, kërkohet nga udhëheqësit e shkollave, që në kohë dhe plotësisht t'i aplikojnë të gjitha rregullat nga Ligji për shkollat popullore. Duke e ditur se një numër i madh i fëmijëve, të cilët i ka regjistruar imami, me leje apo pa leje të prindërve, nuk do vijnë në shkollimin. Mexhlisi i Ulemave e ka urdhëruar imamin që për çdo nxënës të regjistruar për atë vit apo edhe në vitet e mëparshme të bëjë mbikëqyrje, si dhe të marrë të gjitha hapat e nevojshme që fëmija me rregull të fillojë dhe të mbarojë shkollën fillore.

Me paraqitjen e pengesave të shumëfishta, si në vitet e mëhershme, por edhe tash, nga ana e udhëheqësve të shkollave, Mexhlisi i Ulemave i ka paralajmëruar imamët për secilën prej tyre dhe i ka udhëzuar se si të veprojnë. Kështu që, mes tjerash, janë udhëzuar që të kenë vëmendje të veçantë për atë se në shkollat me hapësirë të pamjaftueshme apo edhe personel të pamjaftueshëm, ku regjistrimi kufizohet, të pranohen fëmijë proporcionalisht sipas numrit të banorëve, e jo në rend të parë fëmijët ortodoksë, siç është vepruar shpeshherë deri tani. Po ashtu, janë paralajmëruar të jenë në kontakt të përhershëm me udhëheqësit e shkollave dhe të mbajnë logari se a i aplikojnë të gjitha rregullat ligjore edhe ndaj myslimanëve, si ndaj të tjerëve.

Për të kontrolluar, se si çdo imam do ta kryejë këtë punë, Mexhlisi i Ulemave u ka urdhëruar që në formularët e përgatitur të lajmërojnë se sa fëmijë kanë arritur moshën për shkollë në atë vit dhe se sa janë regjistruar. Po e potencojmë, se pakujdesia e imamëve dhe e

organeve tjera dhe nëpunësve në këtë punë, në përgjithësi ka qenë e madhe, sa që Mexhli i Ulemave është dashur që sipas shkresës nr. 2641/39 t'i nxisë tri herë me radhë dhe prapëseprapë të gjithë nuk kanë dorëzuar raportet për kryerjen e regjistrimeve dhe për suksesin, siç mund të shihet në vijim. Në fund të vitit, me shkresën nr. 8098/39, përsëri janë ftuar dhe udhëzuar imamët që të dorëzojnë raporte dhe të monitorojnë vijimin në shkolla, meqë sukse si ka qenë relativ në xhematët e caktuara.

Pasqyra statistikore e fëmijëve të rritur dhe të regjistruar në klasë I në shkollat fillore gjatë vitit shkollor 1939/40 në territorin e Ulema Mexhlisit të Shkupit⁶⁵⁹

Numri rendor	Komisariati i rrethit i vakëfit dhe arsimit	Numri i përgjithshëm i fëmijëve të rritur në klasë I gjatë vitit shkollor 1939/40.			Numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar gjatë vitit shkollor 1939/40.		
		Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
1	Manastir	232	203	436	91	70	161
2	Gostivar	349	299	648	147	154	301
3	Dibër	120	86	206	61	45	105
4	Kavadar	138	99	237	95	57	152
5	Kërçovë	228	169	397	138	49	187
6	Koçanë	405	310	715	151	106	257
7	Radovish	132	131	263	77	45	122
8	Resnjë	140	108	248	102	68	170

⁶⁵⁹ Në këtë tabelë do të shënojmë vetëm komisariatet e rretheve të vakëfit dhe arsimit të cilat shtrihen në territorin e Maqedonisë së sotme. Në këtë tabelë nuk përmendet rrethi i Kumanovës, sepse, Komisariati i rrethit të vakëfit dhe arsimit të Kumanovës nuk kishte ofruar të dhëna në lidhje me këtë çështje.

9	Shkup	463	331	794	221	118	339
10	Strugë	218	148	366	65	53	118
11	Strumicë	126	70	190	66	33	99
12	Tetovë	782	647	1409	559	108	667

Nga statistika, kuptojmë se edhe 13 komisione të Vakëfeve nuk kanë dorëzuar të dhëna për regionet e tyre dhe për këtë arsye nuk mund të sillen përfundime të sakta për suksesin e këtij aksioni nëpër regione të caktuara. Duke pasur parasysh se ky aksion i organizuar ishte rumbullakuar me shumë vështirësi dhe se organet fetare dhe nëpunësit fetarë, për herë të parë po e realizonin në këto përmasa, aksioni ishte i suksesshëm dhe i një dobie të madhe, meqë këtë vit ishin regjistruar një numër më i madh i nxënësve se sa viteve tjera, se është bërë monitorim mbi nxënësit dhe se popullata është udhëzuar për rëndësinë e shkollës. Në të ardhmen, frytet e këtij angazhimi do të jenë gjithsesi më të mëdha, sepse Mexhlisi i Ulemave do të udhëhiqet në bazë të përvojës së fituar.

Duhet theksuar se Z. Reis-ul Ulema, kësaj çështje i ka kushtuar vëmendje të posaçme. Pas inspektimit të një pjese të këtij regjioni, ai doli me konstatimin e një gjendje të rëndë sa i takon çështjes së arsimit në mesin e myslimanëve dhe i ka rekomanduar Mexhlisit të Ulemave të japin udhëzime dhe urdhëresa organeve rajonale.

Angazhimi për hapjen e shkollave fillore

Mungesa e shkollave fillore në shumë vendbanime myslimane është edhe një nga arsyet e gjendjes së rëndë në arsimimin e të rinjve (shqiptarë) myslimanë. Prandaj edhe Mexhlisi i Ulemave, i mëparshëm, filloi aksionin për hapjen e shkollave fillore, pasi që paraprakisht kishte mbledhur të dhëna për vendet se ku duhet hapur shkolla dhe kishte përgatitur elaborat të detajuar. Ky aksion ishte ndërprerë në kohën e qeverisjes së naibëve. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje, Mexhlisi i Ulemave menjëherë ndërmerr

masa për zgjidhjen e kësaj gjendje dhe i plotësoi me të dhëna të mbledhura më parë. Në bazë të këtyre të dhënave u përfitua një pasqyrë e vendeve në të cilat duhet hapur shkolla fillore.

Lista e vendeve në territorin e Ulema Mexhllisit të Shkupit ku duhet hapur shkolla fillore apo profesionale

Nr. rend.	Komisariati i rrethit të vakëfit dhe arsimit	Rrethi	Komuna	Vendi	Largësia më e afërt e shkollës fillore në km.	Numri i fëmijëve mysliman që duhet të shkoj në shkollë
1	Manastir	Manastirit	Bareshan	Zllakuqan	6	24
2	-	-	Veleshinë	Ostrec	5	64
3	-	-	Dragosh	Kishavë	4	70
4	-	-	Xhavaçkë	Lera	2	22
5	-	-	Ivanjevë	Drvenik	4	60
6	-	-	Strugovë	Obednik	8	60
7	-	Morihov	Baçkë	Germijan	6	11
8	Veles	Velezit	Ivankovaç	Ivankovaç	8	45
9	-	-	Jaboll-çishtë	Jaboll. e Epërm	15	70
10	-	-	Jaboll-çishtë	Jaboll. e Poshtme	15	60
11	-	-	Koçillar	Kuridere	5	20
12	-	-	Rashtan	Jelenov	6	40
13	-	-	Sojekllar	Mamuçllari	5	36
14	Vallan-dovë	Dojranit	Vallan-dovë	Ormanli	8	35
15	-	-	Dojran	Xhumabos	7	50
16	Gostivar	Pollo. i Epërm	Zhel.Rek ë	Xhafa	10	13
17	-	-	-	Padalishtë	6	74
18	-	-	-	Strajan	4	42
19	-	-	Zubov	Branovë	3	61

20	-	-	Poz- haranë	Kalishtë	5	70
21	-	-	Cerovë	Simnicë	3	80
22	-	-	Çaljanë	Koritë	13	80
23	Dibër	Dibrës	Zhupa e Epërme	Breshtani	3	10
24	-	-	-	Elevë	5	23
25	-	-	-	Koxhaxhik	-	14
26	-	-	-	Novak	5	15
27	-	-	Dibrës	Bomovo	10	25
28	-	-	-	Konare	10	46
29	-	-	-	Krivcë	4	29
30	-	-	-	Selokuç	8	75
31	-	-	Kosovrast	Kosovrast	3	85
32	-	-	Osoj	Mogorç	4	40
33	Kavadar	Negot e Vardarit	Bistrenicë	Koresh- nicë	5	37
34	-	-	-	Kosharkë	12	30
35	-	-	-	Çellovec	8	12
36	-	-	Vojs- hanskë	Brusnik	6	11
37	-	-	Disan i Poshtëm	Veshje	6	30
38	-	-	Peshter- nik	Peshternik	6	10
39	Kërçovë	Kërçovës	Midinaç	Baçisht	6	20
40	Koçanë	Koçanës	Blatec	Tresinë	6	14
41	-	-	Vinic	Istibanja	9	11
42	Kuma- novë	Zhegli- govcë	Duma- novcë	Runicë	10	146
43	-	-	Matejçe	Strima	10	49
44	-	-	Orashe	Dllëga	5	30
45	-	-	Pez- hanovcë	Orizare	3	23
46	-	-	-	Sllupcanë	5	188
47	-	-	Tabanocë	Vaksincë	8	163
48	-	-	-	Strazh	5	40
49	Prilep	Poreçit	Aldançes	Aldanç	8	25
50	-	-	Selaç	Belishin	4	20
51	-	-	-	Nerovë	4	25
52	-	Prilepit	Brajllovës	Peshta- levë	6	40
53	-	-	Topol-	Musincë	6	50

			çanë			
54	Rado- vish	Radovis- hit	Poda- reshkë	Hudaverdi	6	20
55	-	-	Rado- vishë	Koxhalijë	7	86
56	-	-	-	Prnajli	8	32
57	-	-	-	Toponicë	5	76
58	Shkup	Shkupit	Brodecit	Brezë	18	32
59	-	-	-	Tanushë	16	24
60	-	-	Bunarx- hikë	Grushinë	10	50
61	-	-	Govër- levë	Jabollcë	6	20
62	-	-	Koliçan i Epërm	Alldincë	18	60
63	-	-	-	Draçevicë	6	69
64	-	-	-	Uji i Kuq	6	20
65	-	-	Gradovc	Vërzhallë	15	66
66	-	-	-	Gumalevë	10	57
67	-	-	-	Dejkovecë	20	36
68	-	-	-	Dobrinë	15	66
69	-	-	-	Paligrad	25	69
70	-	-	Drzhillovë	Ellovë	5	115
71	-	-	-	Mallçishtë	5	13
72	-	-	-	Cerniver	12	37
73	-	-	Kuçkovë	Graçanë	7	40
74	-	-	-	Svillare e Posht.	-	80
75	-	-	Shën Niketë	Blacë	9	100
76	-	-	Çajlanë	Arnaqi	7	30
77	-	-	-	Bukoviç	6	33
78	-	-	-	Seme- nisthtë	7	35
79	-	-	-	Çajlanë	7	40
80	-	-	Shishovë	Kushopek	5	35
81	Strugë	Strugës	Veleshtë	Veleshtë	4	191
82	-	-	-	Dabovjan	3	17
83	-	-	Dello- gozhdë	Dello- gozhdë	4	135
84	-	-	-	Pohum	10	49
85	-	-	Rado- lishtë	Zagraçan	4	18

86	-	-	-	Kalishtë	4	20
87	-	-	-	Frëngovë	4	45
88	Strumicë	Stumicës	Vasilevë	Çanakli	5	35
89	-	-	-	V. Mëhall	5	15
90	-	-	-	Dobrash-nicë	3	35
91	-	-	Murtinë	Svidovicë	4	44
92	-	-	Popçevë	Xhepeli	6	102
93	-	-	Strumicë	Pazvicë	4	10
94	Tetovë	Pollogu i poshtë	Vratnicë	Orashe	5	28
95	-	-	Gruçinë	Laskarc	9	28
96	-	-	-	Merovë	6	25
97	-	-	-	Cerovë	7	20
98	-	-	Pallçishtë i Posht.	Novo Sellë	4	21
99	-	-	Zhelinë	Dobërc	4	35
100	-	-	Sedllarevë	Gurgur-nicë	12	25
101	-	-	-	Sedllarevë	14	35
102	-	-	Sellcë	Brodec	4	21
103	-	-	-	Vejce	7	27
104	-	-	Senakos	Xhuxhe-visht	3	67
105	-	-	Xhepçishtë	Germë	4	25
106	Shtip	Ovcepole	Ovçe Pole	Kovaçevë	5	10
107	-	Shtipit	Dragovë	Popush	5	33
108	-	-	-	Puhçe	5	54
109	-	-	-	Çroshkë	5	26
110	-	-	Karbinc	Kuçilat	5	62
111	-	-	-	Oxhalij	10	15
112	-	-	-	Urak	7	25
113	-	-	M. Cërnilisht	Dobroshan	9	17
114	-	-	Poçivalë	Buçim	5	31
115	-	-	-	Ebeplij	15	15
116	-	-	Kaçivalë	Kalauzlij	22	11
117	-	-	-	Kuçicë	12	30
118	-	-	-	Poçivë	4	28
119	-	-	-	Përnalij	15	12
120	-	-	Xhumajli	Gozeler	5	35
121	-	-	-	Kishinë	7	55
122	-	-	-	Milinë	5	65

Të dhënat e mbledhura, Mexhlisi i Ulemave në bazë të vendimit të tij nr. 4436/38 të 5 prill 1939, ia ka dorëzuar Reis-ul-ulemasë me kërkesë që t'ia përcjell Ministrisë së Arsimit dhe t'i rekomandojë që të hapen shkolla fillore në këto vende. Kësaj kërkesë, ministri i Arsimit i është përgjigjur me letër të 5 korrik 1939, në të cilën shkruante se sipas Rregullores së Ministrisë së Arsimit, vendim për hapjen e shkollave e sjell Bani kompetent, andaj, sipas kësaj me këtë kërkesë duhet drejtuar udhëheqësisë kompetente të Banovinës.

Në lidhje me këtë raport, Mexhlisi i Ulemave ka urdhëruar kontrollimin e vendeve se ku duhet hapur shkolla fillore apo shkolla ambulante për çdo banovinë veç e veç dhe i ka dorëzuar me aktin nr. 5086 më 5 dhjetor të vitit 1939, udhëheqësve (drejtorive) Mbretërore të Banovinave në Shkup, Cetinje dhe Nish, që i përkasin kësaj rrethine. Sipas kësaj, kjo çështje ende nuk është kryer, andaj Mexhlisi i Ulemave edhe më tutje përpiqet që në ato vende të përmendura, për një kohë të shkurtër të hapë shkolla fillore.

Rezultati i aksionit të nisur të Mexhlsit të Ulemave përmes imamëve, sa i përket vijimit të shkollave fillore nga fëmijët myslimanë, ende nuk është i njohur meqë raportet për këtë çështje do të arrijnë gjatë vitit 1940.

Në fund të këtij kapitulli sjellim një tabelë statistikore të shkollave fillore në rrethinën e Mexhlsit të Ulemave në Shkup. Prej aty përveç numrit të shkollave, mësuesve dhe mësuesve fetarë, mund të shihet edhe numri i nxënësve myslimanë dhe të tjerëve në vitin shkollor 1938/39 dhe 1939/40. Këto të dhëna janë mbledhur përmes imamëve me formularë adekuat të përgatitur për këtë çështje, të cilat plotësohen dhe i dorëzohen Mexhlsit të Ulemave për çdo vit shkollor.

Pasqyra statistikore e shkollave fillore në territorin e Ulema Mexh-
lisit të Shkupit⁶⁶⁰

Numri rendor	Komisariati i rrethit i vakëftit dhe arsimit	Viti shkollor	Numri						
			Shkolla	Klasa	Mësuesit e lëndës fetare	Nxënës			
						Myslimanë		Të tjerë	Gjithsej
						Meshkuj	Femra		
1	Manastir	1938/39	49	661	1	51	24	26000	26075
	-	1939/40	55	685	1	51	26	26000	26057
2	Vallan- dovë	1938/39	4	4	4	101	67	?	168
-	-	1939/40	4	7	4	113	76	?	189
3	Veles	1938/39	14	66	5	438	59	63	560
-	-	1939/40	9	42	6	369	32	69	470
4	Gostivar	1938/39	35	88	22	1600	786	774	3160
-	-	1939/40	64	85	25	726	375	250	1351
5	Dibër	1938/3	7	21	11	385	280	514	1179
-	-	1939/40	5	20	10	364	238	366	966
6	Kavadar	1938/39	14	21	6	196	103	1491	1790
-	-	1939/40	14	17	6	148	70	1422	1640
7	Kërçovë	1938/39	16	34	18	924	344	617	1885
-	-	1939/40	16	33	19	874	312	462	1648
8	Koçanë	1938/39	16	50	6	663	578	1583	2824
-	-	1938/39	15	51	4	691	578	1470	2658
9	Kuma- novë	1938/39	13	61	8	716	5	2420	3141
-	-	1939/40	11	22	6	507	46	4180	4728
10	Ohër	1938/39	2	7	2	229	98	?	327
-	-	1939/40	4	19	2	194	97	729	1020
11	Resnjë	1938/39	10	29	3	201	138	891	1230
-	-	1939/40	8	26	3	193	156	918	1267
12	Shkup	1938/39	38	162	16	1675	319	5087	7081
-	-	1939/40	32	152	15	1611	299	4983	6893
13	Strugë	1938/39	12	33	5	477	301	1232	2010

⁶⁶⁰ Në këtë tabelë do të shënojmë vetëm qytetet të cilat shtrihen në territorin e Maqedonisë së sotme, kurse në tabelë janë të shënuar 44 qytete të cilët shtrihen në tërë territorin e Ulema Mexhllisit të Shkupit.

-	-	1939/40	10	26	5	414	279	1071	1723
14	Strumicë	1938/39	16	40	4	146	92	2330	2568
-	-	1939/40	14	37	3	102	60	2251	2413
15	Tetovë	1938/39	34	83	26	2570	258	1350	4178
-	-	1939/40	32	85	25	2641	220	1069	3930
16	Shtip	1938/39	13	33	6	336	241	216	793
-	-	1939/40	23	34	6	314	261	148	449

SHKOLLAT E MESME DHE PROFESIONALE

Nga raporti i inspektimit:

Ndaj shkollave të mesme dhe profesionale, myslimanët e këtij nënqielli sillen edhe më të përmbajtur se sa ndaj shkollave fillore. Një numër shumë i vogël i fëmijëve myslimanë që mbarojnë shkollën fillore vazhdojnë më tutje. Shkaqet kryesore janë: paragjykimet e gabuara për shkollën, varfëria ekonomike e të gjitha shtresave, mungesa e mësuesve parashkollor myslimanë, të cilët do të vepronin në këtë drejtim, pakujdesia dhe pavetëdija e organeve dhe nëpunësve fetarë. Të gjitha këto shkaqe janë shpjeguar në kapitullin paraprak për shkollat fillore. Përveç këtyre, këtu paraqiten edhe dy shkaqe të reja e këto janë **mungesa e konvikteve** dhe **papërshtatshmëria e teksteve shkollor**. Theksojmë, në veçanti se fshatari mysliman në pamundësinë për t'i shkolluar fëmijët e vet, po edhe sikur të donte, nuk do të mundej, meqë në tërë regjionin nuk ka konvikte myslimane, ku do t'i vendosnin fëmijët e tyre. Sa i takon librave, ato ende janë të papërshtatshme. Në shumë shkolla të mesme punohej me libra, njësitë mësimore e të cilave i bënin dëm të dyfishtë myslimanëve përmes ligjërimit të dogmave dhe zakoneve e feve të tjera e që nuk janë në përputhshmëri me islamin. Ndikimi negativ te nxënësit myslimanë i paraqitur me një pamje të shtrembëruar për myslimanët dhe fenë edhe te nxënësit e tjerë krijonin mendim të shtrembëruar për myslimanët dhe për islamin.

Si detyrë dhe punë kryesore në këtë fushë paraqitet nevoja që masat myslimane të orientohen në vlerën e vërtetë dhe të madhe për shkolllat e mesme dhe profesionale, kështu që do të thyhen paragjykimet e rënda. Në këtë drejtim, duhej dhënë udhëzime konkrete të gjitha organeve fetare në regjion dhe t'u bëhet detyrim të marrin aksion më të gjerë në planin arsimor. Iniciativa private, në përgjithësi duhet patjetër, të jetë shumë më e fortë dhe të inkurajohet që të merr mbi vete pjesën më të madhe të detyrimeve në programin arsimor në këtë regjion. E kur të rritet numri i nxënësve nëpër shkolla, më lehtë do të gjenden mësues fetarë dhe do të ketë të drejta të tjera. Shoqatat myslimane do të duhet të zgjerojnë fushëveprimin e vet edhe në këtë plan të përpiqen të ndërtojnë konviktet e tyre, së paku në vendet më të mëdha, meqë për ato ndjehet një nevojë më e madhe. Iniciativës private duhet t'i jepet përkrahje edhe nga Bashkësia Islame, në formë të dhënies së ndihmës për ndërtimin e konvikteve dhe në ndarjen e planifikuar të bursave të vakëfeve atje ku ka nevojë më shumë. Me përpjekje të përbashkët të organeve vendore, inteligjencës fetare dhe qytetarëve, do të krijohet bazë e fortë për arsimim të drejtë dhe të shpejtë të myslimanëve.

Për gjatë kësaj kohe që përfshin ky raport, Mexhlisi i Ulemave është përqendruar të mbledhë të dhëna për numrin e shkollave të mesme, klasave, mësuesve fetarë dhe nxënësve të fesë islame, meqë koha ka qenë shumë e shkurtër për të ndërmarrë masa më të gjera në këtë plan. Në bazë të këtyre të dhënave, vitin e ardhshëm çështja do të shndërrohet në punë dhe do të ndërmerren hapat e nevojshëm për përmirësimin e kësaj gjendjeje, nga ana e Mexhlsit të Ulemave. Duhet theksuar se shumica e shkollave janë qytetare, andaj edhe numri i mësuesve fetarë është më i madh, meqë më herët janë emëruar mësues fetarë vetëm në gjimnaze.

**Pasqyrë statistikore e shkollave të mesme dhe profesionale në terri-
torin e MU-së në Shkup**⁶⁶¹

Numri rendor	Komisariati i rrethit i vakëfit dhe arsimit .	Viti shkollor	Numri						
			Shkolla	Klasa	Mësuesit e lëndës fetare	Nxënës			
						Myslimanë		Të tjerë	Gjithsej
						Meshkuj	Femra		
1	Manastir	1938/39	2	30	1	13	2	1321	1336
-	-	1939/40	2	26	1	13	1	1027	1042
2	Vallan- dovë	1928/39	?	?	?	?	?	?	?
-	-	1939/40	?	?	?	?	?	?	?
3	Veles	1938/39	2	12	1	5	9	?	14
-	-	1939/40	1	?	?	5	12	?	17
4	Gostivar	1938/39	1	3	1	35	?	18	53
-	-	1939/40	3	11	1	31	4	?	35
5	Dibër	1938/39	1	4	2	10	?	52	62
-	-	1939/40	2	4	2	7	?	67	74
6	Kavadar	1938/39	1	4	?	2	1	155	158
-	-	1939/40	1	4	1	4	?	197	201
7	Kërçovë	1938/39	1	4	2	11	?	29	40
-	-	1939/40	1	3	2	27	?	52	79
8	Koçanë	1938/39	2	8	?	3	?	62	65
-	-	1939/40	2	8	?	4	?	132	196
9	Kuma- novë	1938/39	1	13	?	2	1	474	477
-	-	1939/40	1	13	?	3	1	563	567
10	Ohër	1938/39	3	13	2	39	7	616	662
-	-	1939/40	3	16	2	17	19	543	579
11	Prilep	1938/39	1	14	3	6	1	550	557
-	-	1939/40	1	16	?	8	1	617	626
12	Resnjë	1938/39	1	5	?	1	1	88	90
-	-	1939/40	2	8	?	6	1	144	151
13	Shkup	1938/39	14	93	8	390	104	3362	3856

⁶⁶¹ Pasqyra në esencë paraqet 44 vendbanime, respektivisht qytete të cilat shtrihen në të gjithë territorin e UM të Shkupit, por në këtu do të shënojmë vetëm qytetet të cilat shtrihen në territorin e Maqedonisë së sotme.

-	-	1939/40	10	101	4	214	122	1570	1908
14	Strugë	1938/39	2	3	1	10	2	119	131
-	-	1939/40	2	3	1	10	2	119	131
15	Strumicë	1938/39	3	12	?	?	3	434	437
-	-	1939/40	3	12	?	?	3	434	437
16	Tetovë	1938/39	1	11	1	9	?	395	404
-	-	1939/40	1	11	1	9	?	395	404
17	Shtip	1938/39	1	13	1	3	1	?	4
-	-	1939/40	1	8	1	2	1	?	3

FAKULTETET

Në regionin e këtij Mexhlisi të Ulemave është një Universitet dhe atë në Beograd dhe dy fakultete, atë Filozofik në Shkup dhe ai i Drejtësisë në Suboticë. Në Universitetin e Beogradit është numri më i madh i studentëve myslimanë, si nga ky regjion, ashtu edhe nga regjioni i Mexhllisit të Ulemave të Sarajevës. Në vijim do të sjellim numrin e studentëve myslimanë në këtë universitet, të regjistruar në vitin shkollor 1939/40 nga tërë vendi.

Fakulteti	Meshkuj	Femra	Gjithsej
I Drejtësisë	208	6	214
I Mjekësisë	43	15	58
Filozofik	37	12	49
I Bujqësisë – Pylltarisë	38	3	41
Teknik	39	-	39
I Veterinarisë	18	-	18
Gjithsej	383	36	419

Nga ky numër rreth 130 janë nga ky regjion. Imami i Beogradit, i cili i ka mbledhur këto të dhëna, nuk ka mundur t'i gjejë të gjitha, meqë Udhëheqësia e Universitetit me kohë nuk i është përgjigjur për numrin e saktë dhe shpërndarjen e këtyre studentëve nga territori i Mexhllisit të Ulemave të Shkupit, por ka dorëzuar të dhëna për 110 prej tyre; 48 në Fakultetin Juridik, 19 në Fakultetin Filo-

zofik, 18 në Fakultetin e Mjekësisë, 13 në Fakultetin e Bujqësisë dhe Pylltarisë, 5 në Fakultetin Teknik, 2 në Fakultetin e Veterinarisë, 4 në Shkollën e Lartë Ekonomike Komerciale dhe 1 në Akademinë e Arteve.

Numri më i madh i këtyre nxënësve nga ky regjion kanë kryer Medresenë e Madhe në Shkup. Meqë janë me gjendje të dobët materiale, pothuajse të gjithë këta i ndihmon Bashkësia Fetare Islame në Shkup me bursa mujore të përhershme. Gjithsej 23 prej tyre banojnë në Shtëpinë e Gajretit “Osman Xhikiq” në Beograd dhe harxhimet i paguajnë me bursat e tyre. Të tjerët banojnë në banesa private. Andaj, ndjehet një nevojë e madhe për ndërtimin e një konvikti për nxënësit e shkollës së mesme dhe rininë universitare myslimane në Beograd, meqë hapësirat e shtëpisë së përmendur janë të kufizuara për numrin ekzistues të studentëve nga të dy regjionet. Shumica prej tyre janë të detyruar të jetojnë në kushte jo të volitshme higjienike.

Do t’ia vlente që të krijohen mundësi që të gjithë studentët myslimanë në Beograd të jetojnë në një konvikt të përbashkët. Me këtë do të mundësohej përmirësimi i rrethanave jetësore dhe shëndetësore të tyre, do të arrihej një trajtim i njëjtë në edukimin dhe zhvillimin, e me këtë jetë të përbashkët do t’u mundësohej afrimi i intelektualëve nga të dy regjionet, që do të kontribuonte përforcimit të vetëdijes dhe solidaritetit islam. Në Fakultetin Filozofik në Shkup ka 7 studentë myslimanë (5 meshkuj dhe 2 femra), ndërsa në Fakultetin Juridik në Suboticë nga 388 studentë nuk ka asnjë student të fesë islame.

Në bazë të kësaj që përmendëm më parë, mund të konstatojmë se:

Ndjenjat për ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar te populli myslimanë shqiptarë ishin të thella dhe këto ndjenja të rrënjosura në thellësinë e zemrave të tyre, ndikoi në ruajtjen e pavarësisë së tyre fetare dhe kombëtare dhe arritën të mos asimilohen.

Politika e atëhershme, me çdo kusht tentonte të ndikonte edhe në BFI dhe në organet e tij, mirëpo paria myslimane shqiptare ishte e vetëdijshme dhe vigjilente, prandaj ata u përcaktuan që BFI-në në mënyrë demokratike të merrnin në duart e tyre. Për këtë qëllim u angazhuan shumë personalitete të shquara shqiptare të asaj kohe, si: Kadri Saliu, Zenel Strazimiri, Iljaz Agushi, Mulla Idris Hajrullahu (Gjilani), Shaban Efendiu, Hasan Shukriu, Qemal Mehmedi, Abdulla Veliu, Azem Hoxha, Aqif Tetova e shumë të tjerë, të cilëve u printe Ferhat bej Draga⁶⁶². Ky grup i personaliteteve të shquara myslimane shqiptare, në atë periudhë njafat të ndërlikuar, edhe pse ishte formuar në kuadër të BFI-së, do të angazhohet kryekëput në përmirësimin e statusit politik dhe nacional të shqiptarëve nën sundimin e mbretërisë jugosllave⁶⁶³. Edhe përkundër që pushteti serbomadhi u përpoq që me çdo kusht të fitojë lista e Fejzi Haxhihamziçit, falë aktivitetit të parisë shqiptare dhe vendosmërisë së popullsisë shqiptare, në këto zgjedhje fitoi lista shqiptare, të cilës i printe Ferhat bej Draga⁶⁶⁴. Rolin e udhëheqësisë së re të Ulema Mexhllisit në Shkup, më së miri e përshkruan albanofobi, Vasa Çubrulloviç në referatin tij me titull “Problemi i pakicave në Jugosllavinë e Re”, e botuar me 3 nëntor 1944 në Beograd. Në të, ndër të tjerat thotë: ”Kur pas marrëveshjes zgjedhore me Stojadinoviçin, nëpërmjet Mehmet Spahos, Ferhat bej Draga arriti ta zgjerojë autonominë e BFI-së edhe në Serbinë e Vjetër dhe në Maqedoni, me seli në Shkup, separatistët shqiptarë përfituan një armë të fuqishme në duart e tyre. Ata për dy tre vjet, aq shumë e shfrytëzuan, sa që në duart e tyre e morën të gjithë organizatën fetare dhe arsimore të myslimanëve në jug. Nëpërmjet saj, ata u organizuan politikisht dhe kaluan në sulm”⁶⁶⁵.

⁶⁶² Qerim Lita, *Shaban Efendia...*, fq. 59.

⁶⁶³ Po aty, fq. 60.

⁶⁶⁴ Po aty, fq. 63.

⁶⁶⁵ Po aty, fq. 65.

Ulema Mexhlisi në krye me udhëheqësit e saj, dijetarë eminent të shariatit Islam, patriot dhe atdhetarë të dëshmuar, gjithnjë duke u bazuar në parimet fetare Islame dhe argumentet autentike nga Kur'ani Kerimi dhe Sunneti i Pejgamberit a.s., u angazhua për arsimimin dhe edukimin e popullsisë, në veçanti popullit shqiptarë. Shumica e prijesve fetarë ishte për edukimin dhe arsimimin e popullit me dituri të dobishme, mes së cilës do arrinin aspiratat dhe qëllimet e tyre dhe kështu të radhiten në mesin e popujve të përparuar, të qytetëruar, të kulturuar dhe të civilizuar.

Shumica e prijesve fetarë Islam dhe hoxhallarëve, jetuan me modesti në mesin e popullit dhe për popullin. Me bindje dhe kënaqësi mësuan popullin të duan dhe të kultivojnë fenë e tyre dhe atdheun, duke mos i urryer dhe diskriminuar të tjerët, të duan kombin dhe atdheun e tyre, të veprojnë dhe sakrifikojnë për të gjithë këta.

MURTEZAN IDRIZI
ITSHKSH – Shkup

ROLI EDUKATIVO – ARSIMOR DHE KULTUROR I MEDRESEVE NË SHKUP

Roli edukativ dhe arsimor i medreseve, është i lidhur drejtpërdrejt me arsyen e hapjes të tyre. Qëllimi konstruktiv i këtyre shkollave fetare, synonte ruajtjen e vlerave të shoqërisë, të cilës i përkisnin. Megjithatë, nuk mund të përjashtohet as mundësia e rolit të tyre destruktiv në mesin e shoqërisë sonë.

Duke pasur parasysh arsimin dhe edukimin e shoqërisë shqiptare në fillimin e shekullit XX rol të veçantë në këtë drejtim kanë luajtur institucionet fetare. Që do të thotë se edukimi i shoqërisë shqiptare kaloi nëpër disa faza: xhamitë, mejtepet dhe medresetë⁶⁶⁶. Sa i përket fazës së parë, kjo ishte faza ma e hershme e arsimit dhe edukimit të brezave, që daton që nga koha e profetit Muhammed, i cili mesxhidin e shndërroj në institucion edukativo arsimorë. Faza e dytë paraqet shkollat për fillestar, siç quheshin mejtepet, që është një temë në vete. Faza e tretë, ose faza e më vonshme ishte themelimi i medreseve, për të cilën do të flasim në vijim. Kjo fazë e arsimit për pjesëtarët e konfesionit musliman *medreseja*, ndryshe mund të quhet edhe shkolla e studimit islam apo shkalla e lartë e arsimit.

Duhet të përmendim se në fillim kishte dy lloje medresesh: medresetë e zakonshme dhe medresetë për specializim. Sa i përket medresesë së parë, në të studioheshin shkencat islame dhe disiplina tjera të ndryshme⁶⁶⁷, kurse në grupin e dytë të medresesë që ishte

⁶⁶⁶ Naser Ramadani, *Depërtimi osman në Maqedoni dhe zhvillimi i arsimit islam gjatë shekujve XV-XVI*, Mexhlisi Shura, Shkup, 1998. f. 81.

⁶⁶⁷ Mehmed Maksudoglu, *Historia osmane dhe institucionet*, Alsar, Tiranë, 2013, f. 693.

për specializim, në to studioheshin tradita islame, studimet mbi mjekësinë dhe (darul kurra) shkenca për leximin e Kur'anit dhe drejtshqiptimin e shkronjave⁶⁶⁸.

Nevoja e pashmangshme për një shkollë të tillë

Nëse shikojmë në periudhën e hershme të themelimit të medreseve në trojet tona, do të shohim se ato vatra mësimore kishin një rëndësi të veçantë. Fjala bie në kryqëzimin e ideve të ndryshme që depërtuan në fenë Islame. Ashtu që arsyeja për hapjen e shkollave të tilla, për të cilën sunnitët myslimanë i krijuan medresetë, ishte luftimi i ideve të gabuara dhe të shtrembëruara në fe. Qëllimi kryesor i medresesë ishte përhapja e diturisë dhe njëkohësisht unifikimi i mendimit islam⁶⁶⁹.

Pas Luftës së Parë Botërore themelimi i medreseve në trojet tona ishte i një arsyeje dhe tematike krejtësisht tjetër. Nëse shikojmë shqiptarët që ngelën jashtë kufijve të Shqipërisë mes dy luftërave botërore, do të vërejmë se ata nuk gëzonin edhe kushtet më elementare për një zhvillim të nevojshëm ekonomik, shoqëror dhe politik⁶⁷⁰. Thënë shkurt, trojet tona shqiptare pas largimit të osmanlinjve, kishin ngelur në duart e pushtuesve serb, të cilët kishin filluar presionet për konvertimin e shqiptarëve nga feja islame në atë ortodokse⁶⁷¹. Kryepeshkopata e Beogradit me anë të priftërinjve sllavë, u inkuadrua në Programin Nacional Serb, dhe i kishte dhënë vetës për detyrë që popullatën shqiptare ta paraqiste si popullatë të islamizuar, por me prejardhje sllave⁶⁷². Kisha ortodokse sllave në

⁶⁶⁸ Po aty, f. 694.

⁶⁶⁹ Mehmed Maksudoglu, f. 691.

⁶⁷⁰ Musli Bajrami, *Periudha historike e Medresesë së Isa Beut*, Shkup, 2005, f. 63.

⁶⁷¹ Taxhedin Bislimi, "Medreseja Medah" e Ataullah Efendiut dhe nxënësit e saj, Shkup, 2011, f. 35.

⁶⁷² Simpozium ndërkombëtar, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1995, Daut Bislimi, Propaganda e Kishës Ortodokse Sllave për serbizimin e popullatës shqiptare në vitet 1915-1917, f. 455-458.

trojet shqiptare orvatej, që popullin shqiptar ta paraqiste si sllav të shqiptarizuar dhe të islamizuar, ndërsa ortodoksët e viseve jugore të Shqipërisë i paraqiste si grekë shqipfolës⁶⁷³. Në shumicën e rasteve manipulonin duke thënë se: Shqiptarët po shprehin dëshirë të kalojnë në fenë ortodokse.⁶⁷⁴ Nga ana tjetër në Shkup filloi të ndalohej bartja e fesave dhe qelesheve të bardhë (plisave). Qytetarët që kapeshin me plisa keqtrajtoheshin kurse plisat e tyre hidheshin në Vardar⁶⁷⁵. Një pjesë e popullatës myslimane shqiptare evidentoheshin ose regjistrohej si turke. Fëmijët shqiptarë pengoheshin gjatë regjistrimit nëpër shkolla fillore dhe të mesme.

Nga i gjithë ky skenar, synimi përfundimtar i pushtuesit serb ishte pastrimi etnik i viseve të pushtuara dhe kolonizimi i këtyre tokave shqiptare me popullatë serbe⁶⁷⁶. Në të njëjtën kohë Mbretëria Jugosllave filloi përgatitjet e elaborateve të ndryshme, që do të shërbenin si model për shpërnguljen masive të shqiptarëve në Anadoll të Turqisë⁶⁷⁷. Burimet tregojnë se ushtria pushtuese serbe në viset shqiptare persekutoi një numër të madh të prijësve fetarë (hoxhallarë) dhe nëpunësve fetarë islamë⁶⁷⁸.

Pra medresetë përveç që kishin rolin për formimin e personit intelektual fetar islam, ato kishin edhe rolin patriotik kulturor për mbarëvajtjen e popullit⁶⁷⁹. Për t'u ballafaquar me këtë torturë serbe, duhej një kuadër i fuqishëm dhe cilësor, që do të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes shqiptare myslimane. Ashtu që ky kuadër do ta

⁶⁷³ Po aty, f. 455-458.

⁶⁷⁴ Simpozium ndërkombëtar, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1995, Haki Kasumi, Gjendja organizative e Bashkësisë Islame të shqiptarët nën okupimin jugosllav 1912-1914, f. 459-464.

⁶⁷⁵ Musli Bajrami, po aty, f. 66.

⁶⁷⁶ Haki Kasumi, po aty, f. 459-464.

⁶⁷⁷ Musli Bajrami, po aty, f. 64.

⁶⁷⁸ Haki Kasumi, po aty, f. 459-464.

⁶⁷⁹ Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame të shqiptarët gjatë shekullit XX*, AI-ITC, Tiranë, 1997, f. 85.

mbronte popullin shqiptarë nga asimilimi i egër serb⁶⁸⁰. Ky kuadër shqiptarë me ndjenja fetare prodhohej nëpër shkollat që qheshin medrese apo siç përmendëm shkolla të arsimit të lartë. Lloji i këtyre shkollave në Shkup edhe pas Luftës së Parë Botërore ishte i mjaftueshëm, po nuk mund të precizojmë numrin e tyre, sepse ishin shkolla të vogla. Nga ato mund të dallojmë: medresenë e Sulltan Muratit, atë të Ishak Beut (Ishakkije), të Isa Beut, të Kebir Mehmet Çelebiut, të Mustafa Pashës, të Jahja Pashës, të Ismail Agës, medresenë e Arap hoxhës, medresenë e Jelen Kapanit dhe medresenë, e cila nuk llogaritej legjitime nga shteti, medresenë “Medah”⁶⁸¹.

Me siguri këto medrese kanë ekzistuar para vitit 1925—të dhe në mesin e tyre nuk numërohet Medreseja e Madhe. Mes dy luftërave botërore në Shkup kishte disa medrese por tre prej tyre ishin funksionale dhe më efektive. Këto ishin Medreseja Medah, Medreseja e Madhe (E Mbretit Aleksandri I) dhe Medreseja e Isa Beut.

Medreseja Medah

Medreseja Medah sipas vlerësimeve të shumta është rihapur në vitin 1923, me emrin Medreseja e Medah Babës⁶⁸². Medah Baba kishte qenë mësuesi shpirtëror i komandantit osman Jigit Pashës, i cili në historiografinë turke njihet si komandant shumë i suksesshëm⁶⁸³. Rithemelimi i Medresesë Medah bëhet në vitin 1925, nga pishtari i fesë islame, Ataullah ef. Kurtishi⁶⁸⁴. Ataullah Hoxha (1872–1946) u lind në fshatin Studeniçan të Shkupit. Pas mbarimit të shkollës fillore në fshat, vijoi mësimin katërvjeçar në Medresenë Ishakije në Shkup. Pas mbarimit të suksesshëm të kësaj medreseje regjistrohet

⁶⁸⁰ Taxhedin Bislimi, po aty, f. 35.

⁶⁸¹ Po aty, f. 36-8.

⁶⁸² Po aty, f. 36.

⁶⁸³ Лидија Кумбараџи – Беговиќ, Османлиски споменици во Скопје, Исламска Заедница Во РМ, Скопје, 1998, f. 92.

⁶⁸⁴ Mutaib Ademi, Ataullah f. Kurtishi (1874-1946), Hëna e re, Shkup, 1994, Nr 70, f. 30.

në Medresenë Fatih në Stamboll. Në vitin 1909 mori diplomën nga shumë dijetarë të kohës, prej të cilëve mernte dituri. Meqenëse ishte i dalluar në këtë shkollë, mësimdhënësit vendosën ta mbajnë si ligjërues në këtë medrese. Në vitin 1920 në Turqi ndodhën reforma në shtet, ku mendimtarët e kohës torturoheshin, burgoseshin dhe largoheshin nga Turqia. Ataullah efendiu vendosi të lëshojë Turqinë. Pasi kthehet në vendlindje ndër hapat e parë që ndërmori ishte riaktivizimi i Medresesë Medah⁶⁸⁵, që më herët kishte mbajtur emrin Medreseja e Medah Babës. Në vitin 1923 prijësi në fjalë medresenë e emërtoi “Medreseja Medah” dhe e udhëhoqi atë deri në vitin 1937⁶⁸⁶. Si drejtor i kësaj shkolle ishte deri në vitin 1936.

Suksesi i Medresesë Medah, në rend të parë varej nga Ataullah Efendiu, i cili si i ri e donte shkencën dhe dijen. Përvoja e tij si mësimdhënës në medresenë e Muhamed Fatihut në Stamboll pati impakt të madh në zhvillimin e punës së medresesë. Në këtë kontekst duhet kuptuar nevojën e domosdoshme të kohës për arsim sa më të madh të muslimanëve në të gjitha lëmenjtë, por edhe nevoja për ruajtjen e identiteti të shqiptarëve të Shkupit.⁶⁸⁷

Medreseja Medah në atë kohë synonte t’i kundërvihet politikës serbo-sllave e cila përpigjej për shkombëtarizimin e popullatës shqiptare. Kjo strukturë serbo-sllave nëpër fshatra hapte shkollat serbe apo maqedonase duke propaganduar se këto gjuhë janë aq të pasura saqë gjithçka mund shpjegohet, kurse gjuha shqipe është shumë e varfër dhe nuk mundesh të shprehësh mendim të thuktë⁶⁸⁸. Krahas gjithë kësaj politike shkombëtarizuese, shkolla në fjalë vazhdojë aktivitetin e saj shkencor, duke e ruajtur edhe gjuhën

⁶⁸⁵ Simpozium shkencor, Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare, BFI, Shkup, 2013, Muhamed Ali, Roli i Ataullah Efendi Kurtishit në ruajtjen identitetit fetar tek shqiptarët, f. 86-94.

⁶⁸⁶ Mutalib Ademi, Ataullah f. Kurtishi (1874-1946), Hëna e re, Shkup, 1994, Nr 70, f. 30. Ramiz Zekaj, f. 86.

⁶⁸⁷ Taxhedin Bislimi, f. 35.

⁶⁸⁸ Ramiz Zekaj, f. 86.

e popullit por edhe gjuhën e arsimit në këtë shkollë. Në vitin 1938, Turqia dhe Mbretëria Jugosllave bënë një marrëveshje për shkëmbim të popullsive, që nënkuptonte emigrim të myslimanëve në tokat e Anadollit. Përballë kësaj marrëveshje doli vetë Ataullah efendiu me nxënësit e kësaj shkolle, duke u shprehur: “Mos e shitni mallin dhe tokën tuaj, mendoni mirë se si do të dilni para Zotit, mbronit shtëpitë e stërgjyshërve tuaj, punoni tokën tuaj dhe shfrytëzoni bereqetin e saj”. Kjo vatrë e dijes luajti rol permanent në arsimimin e popujve të Ballkanit, në veçanti të shqiptarëve të Maqedonisë⁶⁸⁹.

Medreseja e Madhe apo Medreseja e Mbretit Aleksandër

Pas luftës së Parë Botërore qeveria e Beogradit vërejti mos kënaqësitë e shqiptarëve në fushën e arsimit. Për ta ulur këtë tension në një farë mënyre edhe për ti ndjekur më për së afërmi shqiptarët, qeveria në fjalë vendosi të themelojë një shkollë fetare për myslimanët.

Për domosdoshmërinë e kësaj shkolle, në fjalimin solemn gjatë hapjes së shkollës drejtori, Mehmetbashiçi, sipas dokumenteve arkivore të shpalosura nga studiuesi Qerim Lita, kishte thënë: “Ishte e domosdoshme” kjo shkollë për “eliminimin e injorancës së madhe që i ka kapluar këto treva, posaçërisht popullsinë shqiptare dhe turke⁶⁹⁰. Në vitin 1925 në Shkup, Mbretëria Jugosllave hapi Medresenë e Madhe apo Kral Aleksandri I⁶⁹¹. Kjo shkollë pati statusin e një shkolle të mesme me financim shtetërorë, por kuadri mësimdhënës në tërësi ishte nga kombësia serbe me përjashtim të drejtorit Ahmed Mehmetbashiçi i cili ishte një boshnjak i serbizuar. Në paralelen e parë ku u pranuan 58 nxënës prej tyre vetëm 9 deklaroheshin si shqiptarë. Mos përfshirja e nxënësve shqiptarë me numër

⁶⁸⁹ Muhamed Ali, po aty, f. 86-94.

⁶⁹⁰ Simpozium shkencor, Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare, BFI, Shkup, 2013, Qerim Lita, Medreset e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup gjatë sundimit të Mbretërisë së SKS (Jugosllave) f. 108-119.

⁶⁹¹ Haki Kasumi, f. 459-464.

më të madh në këtë shkollë, erdhi për shkak të politikës serbo–madhe jashtë dhe brenda këtij institucioni⁶⁹².

Nga ana tjetër, këtë politikë shkombëtarizuese nëpërmjet kësaj shkolle fetare e kishin vërejtur atdhetarët si Ferhat Draga⁶⁹³ dhe Ataullah Efendiu. Të cilët në një farë mënyre e paralajmëronin popullatën që mos t'i regjistrojnë fëmijët në atë shkollë fetare siç ishte Medreseja e Madhe. Për propagandën e atdhetarëve tanë shqiptarë ndaj këtij institucioni ishte e informuar qeveria e Beogradit.

Drejtëpërdrejtë drejtori i kësaj shkolle kishte informuar qeverinë e Beogradit se disa elemente shqiptaro – turke nuk kanë qëndrim të mirë ndaj kësaj shkolle. Arsyeja për këtë qëndrim është se nuk dëshironin që rinia shqiptare të edukohet në frymën nacionale serbe, në këtë formë na i interpreton dokumentet arkivore hulumtuesi Qerim Lita. Kjo frymë kombëtare e iniciuar nga atdhedashësit e sipërpërmendur, si Ferhat Draga dhe Ataullah Efendiu, së shpejti depërtoi edhe te nxënësit e kësaj shkolle. Nxënësit shqiptarë të kësaj shkolle ishin të revoltuar ngase të gjithë mësimdhënësit ishin jomyslimanë, me kombësi serbe apo ruse. Duke e analizuar veprimtarinë 16 vjeçare të kësaj shkolle (1925–1941), del se 40% e nxënësve të regjistruar e kanë ndërpre shkollimin. Numri i përgjithshëm i të diplomuarve shqiptarë në këtë shkollë është 62, edhe për gjatë gjashtëmbëdhjetë viteve⁶⁹⁴.

Medreseja e Isa Beut

Një shkollë tjetër e mesme islame në Shkup ishte Medreseja Isa Beut, e themeluar në shekullin XV nga djali i Ishak Beut, Isa Beu.

⁶⁹² Qerim Lita, f. 108-119.

⁶⁹³ Është i njohur aktiviteti i Ferat Dragës në Ulema Mexhlisin e Shkupit, kundër tendencave dhe veprimeve shoviniste serbe. Në mënyrë të veçantë, ai u angazhuan kundër shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet e tyre etnike. Simpozium Ndërkombëtar, Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1995, Haki Kasumi, Gjendja Organizative e Bashkësisë Islame të shqiptarët nën okupimin jugosllav 1912-1914, f. 459-464.

⁶⁹⁴ Qerim Lita, f. 108-119.

Ky person është i njohur për ndërtimin e shumë objekteve fetare si xhami, medrese, mejtep, teqe e shumë objekte tjera me vlerë në kulturën islame⁶⁹⁵.

Me që është ndërtuar në periudhën e hershme Osmane, thuhet se viti i ndërtimit të saj është viti 1440. Zhvillimi i mësimit kohë pas kohe është ndërprerë sidomos në periudhën e njëqindvjeçarit të fundit. Në vitin 1689, kur Pikolomini, komandanti Austro-Hungarez e dogji Shkupin edhe kjo medrese u dogj deri në themel⁶⁹⁶.

Pas luftës së Parë Botërore popullata myslimane shqiptare kishte nevojë për një shkollë e cila do të ulte tensionet e shkaktuara nga shkolat tjera. Thënë shkurt hapja e medresesë Isa Beu në Shkup në një farë mënyre ishte edhe qetësimi i tensioneve që shkaktoj medreseja e madhe. Në sajë të situatës Bashkësia Fetare Islame vendosi që me buxhetin e vet të hap një medrese, për dallim nga Medreseja e Madhe ky institucion do të financohej nga Bashkësia Fetare Islame, dhe nga Ulema Mexhlisi. Dallimi tjetër nga Medreseja e Madhe, ky institucion do të jetë me një plan program që do të ketë autonomi më të gjerë. Për hartimin e këtij plan programi u ngarkuan Ulema Mexhlisi dhe Kuvendi Mearif i Vakëfit në Shkup⁶⁹⁷, këta dy institucione u formuan në vitin 1931 dhe përfshinte 42 njësi administrative⁶⁹⁸. Plan programi i Medresesë Isa Beu ishte i bazuar në planin e Medresesë së Husrev Beut të Sarajevës.

Për dallim nga Medreseja e Madhe, Medreseja e reformuar e Isa Beut stafin e mësimdhënësve apo edukatorëve e kishte myslimanë, në bazë të kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame mësimdhënësit e lëndëve profesionale fetare patjetër të jenë mysliman. Ngjashëm me këtë edhe edukatorët që kujdeseshin për nxënësit edhe ato duhej të ishin muslimanë, që nënkupton një rol më efektiv në prodhimin e

⁶⁹⁵ Лидија Кумбараџи – Беговиќ, f. 48.

⁶⁹⁶ Ramiz Zekaj, f. 87.

⁶⁹⁷ Qerim Lita, f. 108-119.

⁶⁹⁸ Haki Kasumi, f. 459-464.

gjeneratave të reja me një vizion edhe fetar edhe kombëtarë⁶⁹⁹. Rikonstruktimi i kësaj medrese kishte filluar që në vitin 1932, por rihapja dhe fillimi me punë ishte në vitin 1936, edhe atë në bazë të kushtetutës së BFI –së, puna e saj vazhdoj deri në vitin 1941. Në bazë të rregullores së Medresesë së Isa Beut e cila kishte 34 nene, sipas nenit gjashtë gjuha në të cilën duhej mësuar ishte gjuha serbe–kroate⁷⁰⁰. Pushteti serb seriozisht pengonte zhvillimin normal të mësimin në këtë medrese, kështu që mësimdhënësit edukimin e këtyre fëmijëve e bënin nëpër shtëpitë e tyre. Kjo praktikë ndikoi shumë në ruajtjen e besimit, si edhe në mosasimilimin e shqiptarëve. Ngjashëm si kjo kam të dëgjuar se hoxhallarët e asaj kohe edhe fëmijët që mësonin nëpër mejtepe, në disa raste i mësonin nëpër shtëpitë e tyre, por në disa raste edhe në fushë (arë), në kohën e drekës (koha kur hahej ushqimi), ata tuboheshin nën një hije të gjithë së bashku dhe bënin trajnime në gjuhën shqipe për mos ta harruar gjuhën amtare.

Kjo ishte koha kur shteti jugosllavë dëshironte që edhe nëpër këta shkolla fetare të mbijellë frymën sllave⁷⁰¹.

Në prag të Luftës së Dytë Botërore, kjo medrese pushoi së punuari. Edhe pse veprimtaria e saj ishte shumë e shkurtë (pesë vjet, 1936–1941), nxori një numër të konsiderueshëm kuadrosh, të cilët më vonë do të jenë në ballë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare⁷⁰². Të diplomuarit në këtë shkollë ishin të përgatitur dhe të ndërgjegjshëm se duheshin ti shërbejnë popullit⁷⁰³.

Ministri i Arsimit Jugosllavë që atëherë, tentonte që të diplomuarit në këtë medrese, gjithë ato mos t'i vazhdojnë studimet, por vetëm një pjesë prej tyre. Që nga fillimi i luftës së Dytë Botërore e deri në

⁶⁹⁹ Qerim Lita, f. 108-119.

⁷⁰⁰ Ramiz Zekaj,, f. 89. Qerim Lita, f. 108-119.

⁷⁰¹ Ramiz Zekaj, f. 89.

⁷⁰² Qerim Lita, f. 108-119.

⁷⁰³ Mehmed Maksudoglu, f. 691.

vitin 1984, medreseja nuk ishte në funksion. Më 15 tetor 1984 kjo medrese përsëri rifilloi punën e saj, falë dëshirës së flaktë të besimtarëve të devotshëm, të cilët nuk kursyen asgjë nga pasuria e tyre vetëm e vetëm që kjo shkollë të fillojë me punë. Edhe pse lëndët fetare ishin si lëndë profesionale me rëndësi të veçantë, grupi i lëndëve të gjuhës dhe lëndët e kulturës së përgjithshme si Filozofia, Pedagogjia, Psikologjia, Sociologjia, Historia, Gjeografia dhe Biologjia mësoheshin paralelisht me lëndët profesionale⁷⁰⁴.

Duke bërë vlerësimin e arsimit në këto institucione vijmë në përfundim se dobia e përgjithshme nga këta shkolla ishte dija universale. Sidoqoftë deri në njëfarë përmase Medreseja e Madhe dallohej me ideologjinë e anuar ka regjimi sllavistë. Të diplomuarit në këtë shkollë, në të ardhmen përgatiteshin që të jenë pjesë udhëheqësish shtetërore. Ndryshe nga kjo, Medreseja e Isa Beut ishte pjesërisht nën ndikimin e shtetit. Me që ishte nën koordinimin e Ministrisë së Arsimit. Kishte njerëz të cilët punonin në këtë institucion dhe kontrollonin vijueshmërinë e mësimin. Nga ana tjetër Medreseja Medah ishte private, që do të thotë se nuk pranohej nga shteti. Megjithatë nëse shikojmë kuadrin e diplomuar në këtë institucion, do të vërejmë efikasitetin e kësaj shkolle.

Marrë në përgjithësi si në shkollat shtetërore asht edhe në ato private pati patriotë të mirë të cilët, krahas mësimin fetar, fshehurazi ose haptazi e zhvilluan edhe atdhedashurinë te nxënësit e tyre shqiptarë, e kultivuan gjuhën amtare, disa shkruan edhe poezi edhe ilahi në gjuhën shqipe me alfabet arab. Në këtë mënyrë gjithmonë e mbajtën të gjallë vetëdijen për vetveten duke e ruajtur në këtë mënyrë identitetin kombëtar⁷⁰⁵.

⁷⁰⁴ Ramiz Zekaj, f. 91.

⁷⁰⁵ Musli Bajrami, f. 74.

ISLAM ISLAMI & MUHAMED ALI

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup

MEDRESEJA MEDDAH DHE NDIKIMI I SAJ NE SHOQËRINË SHKUPJANE NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Në fund të shekullit XIV, me bashkëngjitjen e territorit të Maqedonisë ndaj shtetit osman, ky vend u shndërrua në një ndër qendrat më të rëndësishme kulturore, fetare dhe civilizuese të Rumelisë. Pas udhëheqjes disa-shekullore, fillimi i shekullit XX dëshmon largimin e osmanlinjve nga këto territore, me çka filloi një periudhë e re përplot sfida për popujt myslimanë të këtyre trojeve, në veçanti për shqiptarët.

Ndonëse presionet fetaro-politike dhe socio-ekonomike të Mbretërisë Jugosllave intensifikoheshin ndaj shqiptarëve në Maqedoni dhe më gjerë, prapëseprapë falë angazhimit të personaliteteve të ndryshme fetaro-politike, si Ataullah Efendi Kurtishi dhe nxënësit e tij, populli shqiptar arriti që t'i përballojë sfidat e kohës post-otomane.

Aktiviteti i imam Ataulla Efendiut rreth pengimit të shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi dhe rezultatet e duhura, sepse pikërisht në kohën kur autoritetet e Beogradit, bënë plane të fshehta për deportimin e dhunshëm të shqiptarëve, ndodhi e kundërta, respektivisht, numri i familjeve që u shpërngulën gjatë viteve 1938–1941 ra në minimum.

Këtu duhet nxjerrë në pah edhe roli konstruktiv i diplomacisë së atëhershme shqiptare e vendosur në Shkup, e cila në momentet më të vështira për çështjen shqiptare, iu doli në ndihmë krerëve shqiptarë.

Roli i Ataullah Efendi Kurtishit⁷⁰⁶ në edukimin fetar të shqiptarëve

Sipas të dhënave historike, pas pjesëmarrjes aktive në Betejën e Kosovës (1389), aktiviteti i ardhshëm i komandantit osman Jigit Pasha dhe mësuesit të tij shpirtëror Meddah Baba, ishte edhe bashkëngjitja e territoreve të Shkupit ndaj Perandorisë Osmane. Më 1391 (ose 1392), ushtria osmane në krye me Jigit Pashën arriti që të hyjë në këtë qytet me çka ky vend u shndërrua në një ndër qytetet më vital të rajonit të Rumelisë. Investimi i parë në këtë fushë ishte ndërtimi i një kullijes⁷⁰⁷ e cila në vete ngërthente xhami, teqe dhe medrese, të cilat për nderë ndaj mësuesit të tij, Jigit Pasha, i emërtoi me emrin e Meddah Babës.⁷⁰⁸

⁷⁰⁶ Ataullah Efendi Kurtishi (1872 – 1946) i njohur edhe si Ata Hoxha, ka lindur në Studeniçan të Shkupit. Pas mbarimit të shkollës fillore në vendlindje, vijoi mësimet katërvjeçare në Medresenë Is'hakije të Shkupit, ku mori mësimë edhe nga Nabi efendi i cili dallohej si dijetar i njohur i asaj periudhe. Vijoi studimet e larta në Stamboll, në Medresenë Fatih. Pas specializimit në fushën e studimeve të hadithit, fikhut, tefsirit dhe ahlakut, më vitin 1909 mori ixhazetnamën (diplomën) nga dijetari i mirënjohur osman Iskilipli Husejin Efendi Nexhmedini. Suksesi i arritur nga ana e Ataullah Efendiut në fushën e studimeve rezultoi me zgjedhjen e tij si muderris (ligjërues) në Medresenë Fatih. Procesi i avancimit të tij shkencor vazhdoi me arritjen e titullit akademik Dersiam, titull ky që konsiderohej grada më e lartë në arsimin e lartë të asaj kohe. Pas vitit 1936 u zgjodh për kryetar të Këshillit të Bashkësisë Islame të Maqedonisë, funksion të cilin e ushtroi deri më 1941. Ndërroi jetë në Shkup, në vitin 1946. *Shih* Kurtiç, Muhsin “Muderris Ataullah Efendi”, *Evladi Fatihan*, Shkup, 2010, I/2, fq. 24, 25; Aliu, Avni et.al., *Myderriz Haki Efendi (1914-1948)*, Lidhja e historianëve të Kosovës Ali Hadri, Prishtinë, 2005, fq. 49; Aruçi, Muhammed, “Üsküp’te Meddah Medresesi”, *Balkanlarda İslam Medeniyeti Sempozyumu (Tebliğler)*, 21-23 Nisan 2000, Sofje, fq. 191; Ademi, Mutalip, et.al, *Ataullah Efendi Hoxha Drita e Diturisë*, pa vend dhe vit botimi, f. 3, 4,5. *Türkiye Ülkücü Gençlik Dergisi*, İstanbul 1971, I/9, fq. 22. Për informata më të detajizuara rreth zgjedhjeve të Mexhlisi Ulemasë në Shkup e Sarajevë (v. 1938) *shih* Piraku, Muhamet, *Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore (1941-1951)*, Dituria Islame, Prishtinë, 1995, fq.22, 23.

⁷⁰⁷ Tërësia e ndërtesave përreth xhamisë.

⁷⁰⁸ Лидија К. Богоевиќ, *Османлиските Споменици во Скопје*, Исламска Заедница на Р.М., Скопје, 1998, , fq. 92; Aliu, et.al., Op.cit., fq. 41; Бекир Садак, “Медресата Меддах во Скопје -I”, *Млада Месечина*, Скопје 2000, XIV/105, fq. 5.

Lista që përmban emrat e disiplinave shkencore dhe librave që janë mësuar në Medresenë e Meddahut:⁷⁰⁹

- SARF: Emsile, Bina, Maksud, zzi, Merah
- NAHV: Avamil, Tuhfe, zhar, Kafije, Molla Xhamii
- ISHT KAK: Shafije
- BELAGAT: Alaka sherhi, Muhtasarul maani
- ARUZ: Aruzi endelus sherhi
- ILMI ADABI MUNAZARA: Kashkopryly, risalesinin, sherhi
- ILMI VAZI: Haxherzade
- MANTIK: Isaguxhi, Mugnit tullab, Tasavvurat, Tasdikat, Shem–sije, Fenari
- FIKIH: Meraki felah, Halebi sagir, Multeka
- USUL FIKIH: Mirat, Sherhu menar
- FERA Z: Siraxhijje
- AKA D/KELAM: Emali sherhi, Akaidi Nesefije, Sherh Taftazani, Devaani
- USUL HAD S⁷¹⁰
- HAD S: Sahih Buhari
- TEFS R: Kadi Bejdavi

⁷⁰⁹ Бекир Садак, “Медресата Меддах во Скопје -2”, *Млада Месечина*, Скопје 2000, XIV/106, fq. 6; Bekir Sadak, *Ūskŭp'te Meddah Medresesi (botim i pjesërishëm)*, pa vend dhe vit botimi, fq. 5-7.

⁷¹⁰ Nuk kemi të dhëna të sakta rreth librave që janë studiuar në lëndën e Usuli Hadithit.

Gjatë sundimit osman Medreseja e Meddahut ka luajtur rol të çantë në arsimimin e popullit të rajonit sidomos të shqiptarëve të Maqedonisë së sotme. Në këtë medrese pos lëndëve fetare janë mësuar edhe lëndët e gjuhës arabe, kaliografisë dhe matematikës. Pas largimit të osmanlinjve, Ataullah Efendi Kurtishi e riaktivizoi Medresenë e Meddahut me çka kjo vatër arsimore – shkencore luajti rol të konsiderueshëm në arsimimin e popujve të Ballkanit, sidomos të shqiptarëve të Maqedonisë dhe jashtë saj deri më 1947, vit ky kur autoritetet komuniste jugosllave i dhanë fund funksioni – mit të saj.⁷¹¹

Emrat e nxënësve të diplomuar të Medresesë Meddah:⁷¹²

Gjenerata e parë e të diplomuarve	Gjenerata e dytë e të diplomuarve	Gjenerata e tretë të diplomuarve (nën udhëheqjen e Fettah Efendiut)
Abdulfettah Efendi Raufi	Hafëz Hasan Efendiu	Hafëz Bekir Efendi Sadak
Hafëz Nexhati Efendiu	Hafëz Abdurrahim Efendiu	Hafëz Sami Efendi Nebi
Selim Efendiu	Hafëz Mustafa Efendi Shemo	Kemal Efendi Aruçi
Hafëz Sadullah Efendiu	Hafëz Hamdi Efendiu	Xhemal Efendiu
Hafëz Shaban Efendiu	Hafëz Kadri Efendiu	Salih Efendiu
Mehmet Efendi Sakipi (Rakipi)	Hasan Efendi Bekiri	Ramadan Efendiu
	Haki Tajip Sarmaxhaj Efendiu	
	Osman Efendiu	
	Idriz Efendiu	
	Husejin Efendiu	
	Ferhat Efendiu	

⁷¹¹ Rreth medresesë së Meddahut në kohën e udhëheqjes së Ataullah Kurtish Efendiut *shih* Ali, Muhamed, “Ataullah Kurtiş Efendi Yönetimindeki Meddah Medresesi”, *Journal Of Balkan Studies*, Bursa 2011, II/3.

⁷¹² Sadak, Op.cit., fq. 11; Aruçi, Op.cit., fq.193, 194; Ademi, et.al, Op.cit., fq. 7, 8;

Autoritetet e medresesë Meddah ishin tepër të kujdesshëm gjatë procesit të seleksionimit të nxënësve për pranim në këtë vatër arsimore dhe prioritezohej pranimi i nxënësve që vinin nga familje me vlera të larta fetare dhe kombëtare.⁷¹³ Nxënësit e kësaj medreseje bashkë me mësuesin e tyre Ataullah efendi Kurtishin qëndruan ballë për ballë kundër shtypjeve të regjimit jugosllav dhe me përkushtimin e tyre të singertë arritën që të ngritin nivelin e edukimit fetar të popujve të Ballkanit, në veçanti të shqiptarëve. Ndonëse, disa prej tyre u vranë, disa u burgosën e të tjerët u ballafaquan me trysni dhe shtypje sistematike të shtetit, megjithatë ata nuk hoqën dorë nga idealet e tyre të kamotshme.

Refleksionet socio-kulturore dhe politike të medresesë Meddah nën udhëheqjen e Ataullah Efendi Kurtishit në shoqërinë shqiptare. Duhet theksuar se pos aktiviteteve akademike, edhe përvoja politike në qendrën perandorake janë dy faktorë kyç që kontribuan në formimin e personalitetit të Ataullah Efendi Kurtishit. Me kthimin e tij nga Stambolli në Shkup, filloi një etapë e re e procesit të transferimit të përvojave akademike dhe politike të këtij personaliteti të bashkatdhetarët e tij. Riaktivizimi i Medresesë Meddah dhe përgatitja e një elite të re fetaro-politike që me dekada të tëra i shërbyen popujve myslimanë, në veçanti shqiptarëve të këtyre trojeve duke u rezistuar të gjitha trysnive politike, ekonomike dhe sociale të shtetit dëshmojnë qartë largpamësinë dhe strategjinë afatgjatë të personalitetit të lartpërmendur.⁷¹⁴

Nga ana tjetër Ataullah Efendi Kurtishi bashkë me nxënësit e tij luftoi ashpër edhe kundër politikave asimiluese të regjimit të Mbretërisë Jugosllave. Kritikë e tij më të ashpra i drejtoi kundër marrëveshjes midis Turqisë dhe Mbretërisë Jugosllave (1938), marrëveshje kjo që stimulonte emigrimin e popujve myslimanë,

⁷¹³ Aliu, et.al., Op.cit., fq . 43,44.

⁷¹⁴ *Shih* Muhamed Ali, “Dersiam Ataullah Kurti Efendi”, *Hilal*, Shkup, 2011, nr. 118, fq.20-21.

mes tyre edhe shqiptarë drejt Anadollisë, gjë që ishte në kundërshtim me interesat afatgjata të shqiptarëve të këtyre trojeve.

Në këto rrethana tragjike për fatin e shqiptarëve në sipërfaqe dolën dy grupime politike shqiptare, të cilat në mënyrë të hapur iu kundërvunë zbatimit të planit famëkeq “Naçertania” të Ilija Garas-haninit, të vitit 1844, i cili parashihte spastrimin e trojeve shqiptare. Grupini politik i udhëhequr nga Ferhat Draga, në të cilin merrnin pjesë paria e atëhershme kombëtare e fetare shqiptare siç ishin: Mulla Idriz Gjilani, Shaban Efendiu, Rexhep ef. Abdullau, Bedri ef. Hamidi, Kadri Saliu, Azem Hoxha, Idriz Cërcëri, Akshi Sulejmani, Mulla Lutfi Ahmeti, Zenel Ibrahim Strazimiri e shumë të tjerë. Ndryshe ky grup njihej si opozita e BFI-së, apo grupi i “Bojali Hanit” në Shkup. Grupimin e dytë e udhëhiqte ulemaja i njohur në hapësirat shqiptare e më gjerë Ataulla ef. Kurtishi.

Grupi që udhëhiqej prej Ataullah Hoxhës, fushatën e tyre kundër shpërnguljes e zhvillonin gjithnjë në botëkuptime fetare, respektivisht, ata apelonin te xhemati i tyre, që të mos i lëshojnë vatrat e tyre, sepse siç theksonin ata: “Ai që e lëshon vatanin është shkja (i pafe)”.

Thënia e tij e njohur lidhur me këtë çështje ishte poashtu: “*Mos e shitni mallin dhe tokën tuaj, mendoni mirë se si do të dilni para Zotit, mbronit shtëpitë e stërgjyshërve tuaj, punoni tokën tuaj dhe shfrytëzoni bërëqetin e saj...*”⁷¹⁵

Roli i Ataullah efendi Kurtishit, në pengimin e shpërnguljes së popullsisë shqiptare ishte shumë i madh, sidomos në viset e Shkupit, Kumanovës e të Preshevës. Ai, gjatë fushatës së tij kundër shpërnguljes, e demaskoi projektin sllav për pastrimin e myslimanëve nga trojet tona etnike, i sqaroi dëmet dhe pasojat e emigrimit, qëllimin e vërtetë të kësaj çmendurie serbe, me qëllim që ti largojë myslimanët e posaçërisht shqiptarët nga këto troje dhe ti instalojë

⁷¹⁵ Aruçi, Op.cit., fq. 196; Aliu, et.al., Op.cit., fq. 52; Ademi, et.al, Op.cit., fq. 9.

diku larg në Anadoll, ku do të shërbejnë si tampon zonë në mes turqve në njërin anë dhe armenëve dhe kurdëve në anën tjetër.⁷¹⁶ Hoxha dhe nxënësit e tij, qëndrimin e mos shpërnguljes, e mbështesnin në dy parime: 1) Ta ruajmë fenë, dhe 2) Ta ruajmë atdhenë.

Strategjia tjetër e Ataullah Efendi Kurtishit – që për arsye të ekuilibre dhe rrethanave të brendshme dhe ndërkombëtare nuk arriti që të implementohet – ishte mendimi për krijimin e një federate ballkanike ku do të merrnin pjesë popujt myslimanë të këtij gadishulli, në veçanti edhe shqiptarët, me çka do t’iu rezistonin torturave dhe padrejtësive sllave.⁷¹⁷ Gjithashtu, ishte kritikues i ashpër i devijimeve morale në shoqërinë shqiptare. Kundërshtonte me të madhe feudalët e asaj kohe që në vend që të harxhonin pasurinë e tyre për të mirat e përgjithshme të shoqërisë, harxhonin nëpër taverna duke mos e pasur parasysh gjendjen e rëndë ekonomike të shqiptarëve. Për të kapërcyer këtë gjendje të rëndë ekonomike, stimulonte aktivitetin tregtar si një vital për avancimin e statusit ekonomik të popullsisë muslimane/shqiptare.⁷¹⁸

Përfundim

Me largimin e osmanlinjë nga Maqedonia (1912) dhe me vendosjen e sistemit të ri politik të Mbretërisë Jugosllave, shqiptarët myslimanë të këtyre trojeve u ballafaquan me sfida të shumta të karakterit fetar, social dhe politik – ekonomik. Megjithatë, në fillim të shekullit XX. popullata muslimane e Maqedonisë dha kontribut të konsiderueshëm në ruajtjen e vlerave fetare dhe kulturore.

⁷¹⁶ Taxhedin Bislimi, *Medreseja e Ataullah Efendiut dhe nxënësit e saj*, Shkup, 2011, fq. 80.

⁷¹⁷ Selim Çoraklı, “Vardar Ovası’nın Hizmet Eri”, *Aksiyon*, İstanbul, 1996, nr. 57, www.aksiyon.com.tr; *Türkiye Ülkücü Gençlik Dergisi*, Op.cit., fq. 23; www.dusuncegundem.com/ 3 Maj 2011.

⁷¹⁸ *Shih Aliu, et.al., Op.cit.; Türkiye Ülkücü Gençlik Dergisi*, Op.cit.

Pikërisht nga këto troje dolën personalitete si Ataullah Efendi Kur-tishi që me përvojën e tyre akademike dhe politike tejkaluan kufijtë e Ballkanit. Medreseja Meddah e cila u riaktivizua nga ana e këtij personaliteti ishte vatër arsimore me vitalitet të lartë që luajti rol të rëndësishëm në avancimin e edukimit fetar të shqiptarëve të Maqedonisë e më gjerë. Nga ana tjetër, nxënësit e kësaj medreseje qëndruan në vijën e parë të luftës për mbrojtjen e identitetit fetar dhe kombëtar të shqiptarëve. Aktivitetet e drejtorit të medresesë Meddah me nxënësit e tij gjatë viteve 1938–1941 rreth pengimit të shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi dha rezultatet e duhura, sepse pikërisht në kohën kur autoritetet e Beogradit, bënë plane të fshehta për deportimin e dhunshëm të shqiptarëve, ndodhi e kundërta, respektivisht, numri i familjeve që u shpërngulën në atë periudhë ra në minimum.

Për në fund, ideja për formimin e një federate ballkanike për t'i bërë ballë pozicionit sllav në Ballkan, refuzimi i politikave emigruese të shqiptarëve nga trojet jugosllave, stimulimi i aktiviteteve ekonomike dhe lufta kundër feudalëve janë disa nga aktivitetet socio – politike të këtij personaliteti që dhanë kontribut të madh në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar të shqiptarëve.

AFET JASHARI

Ministria e Kulturës – Shkup

POROSITË E ATULLAH EF. KURTISHIT (1874–1946), PËR SHQIPTARËT E SHKUPIT

Atullah ef. Kurtishi, i lindur më 1874 në Studeniçan të Shkupit, është figurë e rëndësishme për atë pjesë të historisë, kur trojet tona etnike u ndanë nga Perandoria Osmane dhe mbetën nën okupimin serb, kur jeta për popullin shqiptar dhe mysliman në përgjithësi u bë mjaft vështirë, dhe kur shqiptarët me të madhe u shpërngulën në Turqi.

Jeta e Atullah ef. Kurtishit ka qenë mjaft e rëndë dhe e mundimshme. Dëshira e tij e flaktë për të mësuar dhe për të dhënë kontributin e tij në arsimin fetar, ishte e madhe dhe me plot peripeci. Ai jetoi në Studeniçan në një familje mjaft bujare, që për ta shkolluar të birin sakrifikuan mjaft. Apo, siç thotë populli, ata për të e kanë dhënë edhe dinarin e fundit.

Hapat e parë të diturisë i mori në mejtepin e fshatit, kur prej fillimit shfaqë shenjat e zgjuarsisë, që sipas dëshmimeve të njërit nga nxënësit (talebët) e Atullah ef. Kurtishit, tani më të ndjerit Jusuf Iseni, i njohur si Haxhi Hoxha⁷¹⁹, ka qenë i mprehtë, syçelë, mendjendritur, serioz dhe aktiv. Më pas, shkollimin e kishte vazhduar në Shkup. Si dhjetëvjeçar, në mejtepin e Shkupit ka mësuar te myderrizi kryesor i asaj kohe, hoxhë Nabi efendi Memishi. Nga këtu vazhdon me shkollimin në kryeqendrën e diturisë, në Stamboll. Pas kryerjes me sukses të shkollimit të tij në Shkup, Atullah ef. Kurtishi në një rast kishte thënë: “*Që kur u bëra ta dalloj të djathtën nga e majta, nuk kisha dashuruar dhe nuk kisha mallëngj-*

⁷¹⁹ Deklaratë e Hasan Hyseinit - djali i Jusuf Hyseinit, nxënësi i fundit i Atullah ef. Kurtishi në Mejtepin Medah në Shkup;

yer diçka tjetër, përveç kësaj rruge të lartë. Nuk ka ndodhur diçka që të mund të ma largojë këtë rrugë nga mendja ime. Ky ishte motivi që më nxiti ta vazhdoj këtë rrugë, derisa mora rrugën e mërgimit, kalova nëpër vende të ndryshme për shuarjen e etjes sime. Duke thithur dituri të shumë dijetarëve eminentë në Shkup, Zoti ta mbrojë Shkupin nga dëmet e çrregullimet, atje kam qëndruar dhe mësuar te ajka e profesorëve, profesor Nabi ef. Memishi. Pasi që tek ai mësova lëndën e morfologjisë (sarf) dhe sintaksës (nahv), ku me sukses i kisha kryer këto mësimë me vendosmëri dhe guxim, kalova male, shkëmbinj e rërë, kisha kaluar mbi det derisa arrita në Stamboll⁷²⁰. Këto fjalë Atullah ef. Kurtishi i kishte thënë kur ishte larguar nga Shkupi për të marrë dritën e diturisë në kryeqendrën e Stambollit. Në vitin 1891 regjistrohet në medresenë “Fatih”, e cila ishte nga më të njohurat në atë kohë. Mësoi te profesorët më të njohur të kohës, si: Hafiz Husein Nexhmudin Rodomiri, Abdulfetah ef. Dagistan Bahduri, Hafiz Qamil ef. Istambolli, Thani Haki Bursavi, Haxhi ef. Ismailhaki Manastiri, etj. Pas përfundimit me sukses të shkollimit, mori titullin “myderriz”, i cili ishte njohës i mirë i fikhut e tefsirit të Kuranit, por kishte njohuri edhe për shkencat e tjera shoqërore, si: filozofia, logjika, politika, etj. Në fillim punoi si profesor në medresenë “Fatih” të Stambollit, ku gëzonte autoritet mjaft të madh, jo vetëm në mesin e popullatës në Stamboll, por edhe në mesin e kolegëve dhe dijetarëve të asaj kohe. Njihej si orator i spikatur.

Atullah ef. Kurtishi veçoi në periudhën e fundit të Perandorisë Osmane. Në atë kohë u paraqitën lëvizje të shumta politike, të ndikuara nga ideologjitë e ndryshme vendore dhe nga jashtë. Ky fenomen ndikoi që mjaft popuj brenda Perandorisë Osmane të kërkojnë formimin e shteteve nacionale, siç ishin lëvizjet arabe, armene, shqiptare, etj. Në këtë periudhë ishin në skenë dy koncept-

⁷²⁰ Bazuar në të dhëna sipas disa burimeve dhe botimeve në Turqi, si dhe nga libri i autorit Taxhedin Bislimi: *”Medreseja Medah e Ataullah ef. dhe nxenesit e saj”*, Shkup, 2011;

te për qeverisjen e shtetit: sistemi sekular ose shteti i ndarë nga feja, dhe sistemi shtetëror i bazuar në parimet dhe ligjet e fesë, siç ishte deri në atë kohë Perandoria Osmane. Shumica e dijetarëve, në mesin e tyre edhe Atullah ef. Kurtishi, e mbrojtën konceptin e dytë. Ata planifikonin të themelojnë një parti politike me emrin Partia e Lirisë dhe Koalicionit, me të cilën mendonin se do t'i mbronin qëndrimet dhe idetë e tyre.

Por, qeverisjen dhe sundimin e mori koncepti i parë – shteti i ndarë nga feja. Pasi e morën në dorë pushtetin, ata filluan edhe t'i pastrojnë kundërshtarët e tyre. Në këtë kohë likuiduan edhe mjaft dijetarë eminentë, si Atif Efendi Iskilib etj., të cilët u burgosën dhe u torturuan me dhunë fizike dhe psikologjike, ndërsa shumica e tyre u detyruan të largohen nga Stambolli. Në mesin e tyre ishte edhe Atullah ef. Kurtishi, i cili – sipas disa dëshmitarëve – një kohë të shkurtër ka qëndruar në Greqi, përkatësisht në Trakinë perëndimore. Pastaj, Atullah ef. Kurtishi kthehet në vendlindjen e tij në Shkup, të cilën e gjeti nën sundimin e Mbretërisë serbe, e cila ushtronte dhunë mbi popullatën lokale të Shkupit.

Sipas nipit të Atullah ef. Kurtishit, imam në Xhaminë Ballaban në Çarshinë e Vjetër të Shkupit dhe i cili mban emrin e gjyshit, ai njihej si njeri dinamik dhe aktiv dhe si i tillë njihej edhe në Stamboll. Për gjyshin e tij ai thotë: *“Gjyshi im, Atullah ef. Kurtishi, emrin e të cilit e mbaj unë, ka ndërruar jetë tre vjet para se të lind unë, por gjurmët e tij kanë mbetur në Shkup. Në atë kohë gjyshi im ka ndërmarrë një sërë aktivitete për ta ndryshuar gjendjen e popullatës, por fatkeqësisht, shumë dokumente, fotografi, e materiale të tij, janë shkatërruar gjatë tërmetit në vitin 1963 në Shkup. Atëbotë filloi të mbledhë njerëz rreth vetes për të rezistuar kundër Mbretërisë serbe. Prandaj, në vitin 1919, organet e shtetit serb e burgosin bashkë me disa shokë dhe e dërgojnë në burgun e Krlevës. Pasi u lirua nga burgu, Atullah ef. Kurtishi e vazhdoi sërish rezistencën e tij për liri, për avancimin e popullatës shqiptare në Shkup në të gjitha degët, si arsini, edukimi, mendimi politik, edukimi islam etj.*

Por, ky aktivitet i palodhshëm i pengonte një grupi që kishte marrëdhënie të shkëlqyera me Mbretërinë serbe. Ishte ky grupi i Shevki Ramizit, që kishte ide dhe qëndrime diametralisht të kundërta nga Atullah ef. Kurtishi”⁷²¹.

Pikat kryesore të qëndrimeve të kundërta mes Atullah ef. Kurtishit dhe Shevki Ramizit ishin⁷²²:

Rreth shpërnguljes së myslimanëve dhe shqiptarëve nga trojet e veta etnike, Atullah ef. Kurtishi vazhdimisht kishte apeluar që po-pullata të mos shpërngulet pasi që e kishte kuptuar qëllimin;

Shevkiu apelonte për një shoqëri të quajtur moderne pa vlera fetare dhe morale, ndërsa Atullah ef. Kurtishi apelonte për një shoqëri me vlera fetare;

Atë kohë Shevkiu ishte një ndër pasanikët e Shkupit dhe kishte bankë të veten private, që funksiononte kryesisht me kamatë, ndërsa hoxha i nderuar apelonte për një shoqëri pa kamatë, pasi që edhe Islami e kërkon këtë, etj.

Prandaj, Shevki Beu, në vitin 1938 kishte ngritur padi penale në organet e drejtësisë së Mbretërisë SKS dhe kishte kërkuar që Atullah ef. Kurtishi të përjashtohet nga shteti, me arsyetimin se nuk është shtetas i Mbretërisë SKS. Kjo e detyroi hoxhën të paraqitet në seancë gjyqësore, ku ai do t'i përgënjeshtrojë të gjitha akuzat e Shevki Beut.

Me këtë rast, do të paraqesim edhe një pjesë të seancës gjyqësore, të zhvilluar kundër Atullah ef. Kurtishit⁷²³:

⁷²¹ Deklaratë e Ataullah ef. Kurtishit – nipi i Ataullah Hoxhës, i cili jeton në Shkup dhe është Imam i Xhamisë Ballaban;

⁷²² Taxhedin Bislimi, *Medreseja Medah e Ataullah ef. dhe nxenesit e saj*, Shkup, 2011;

Gjykatësi: *Sa vjeç je?*

Atullah ef. Kurtishi: *64 vjeç.*

Gjykatësi: *A keni certifikatë të lindjes?*

Atullah ef. Kurtishi: *Jo nuk kam certifikatë të lindjes.*

Gjykatësi: *Pse nuk keni?*

Atullah ef. Kurtishi: *Librat amë të evidentimit nuk janë të rregulluara, sepse gjatë luftës ishin të shkatërruara.*

Gjykatësi: *Atëherë, prej nga e dini sigurt se në cilin vit keni lindur?*

Atullah ef. Kurtishi: *E di sepse më kanë treguar, se në luftën ruso-turke, që u zhvillua në Plevle (Bullgari) i kam pasur një vit e gjysmë ose dy vjeç.*

Gjykatësi: *Cilës fe i takoni?*

Atullah ef. Kurtishi: *I takoj fësë muhamedane (islame).*

Gjykatësi: *Çfarë nënshtetësie keni?*

Atullah ef. Kurtishi: *Jam shtetas i Mbretërisë Jugosllave.*

Gjykatësi: *Ku ke lindur?*

Atullah ef. Kurtishi: *Kam lindur në fshatin Studeniçan, Komuna e Draçevës.*

Gjykatësi: *Je i martuar?*

Atullah ef. Kurtishi: *Po (jam i martuar).*

⁷²³ Taxhedin Bislimi, *Medreseja Medah e Ataullah ef. dhe nxenesit e saj*, Shkup, 2011 - (Procesi gjyqësor gjendet në dokumentet e Arkivit të Maqedonisë, dhe është i botuar në librin e mësipërm);

Gjykatësi: *Ke fëmijë?*

Atullah ef. Kurtishi: *Po, i kam tre fëmijë.*

Gjykatësi: *A je i gjykuar?*

Atullah ef. Kurtishi: *Jo, nuk jam i gjykuar.*

Gjykatësi: *A je nën hetime?*

Atullah ef. Kurtishi: *Jo, nuk jam. Kam qenë nën hetime, por jam liruar si i pafajshëm.*

Gjykatësi: *Çfarë profesioni ke?*

Atullah ef. Kurtishi: *Kam qenë hoxhë, kam qenë profesor pranë medresesë private, ndërsa tani jam anëtar i Ulema Mexhlisit.*

Gjykatësi: *Në çfarë gjendje ekonomike je?*

Atullah ef. Kurtishi: *Jam i varfër, në fshat kam vetëm një pjesë të tokës. Tash kam rrogë 5 mijë dinarë në muaj si anëtar i Ulema Mexhlisit.*

Gjykatësi: *A di shkrim dhe lexim?*

Atullah ef. Kurtishi: *Po, di. Di ta flas mjaft mirë gjuhën serbe, di të shkruaj dhe lexoj edhe në alfabetin cirilik, i kam mësuar vet, pra nuk kam mësuar në shkollat serbe; e njoh mirë edhe gjuhën turke dhe arabe.*

Gjykatësi: *Ju keni paraqitur një vërtetim, ku vërtetoni se dini të lexoni shkruani dhe flisni gjuhën serbe.*

Atullah ef. Kurtishi: *Po. Këshillit Shtetëror ia kam paraqitur një vërtetim, të cilin e ka dhënë Riza Xheladinoviçi dhe Mehmed Sadik, që të më shërbejë para Ulema Mexhlisit.*

Gjykatësi: *Këtu kemi siguruar dy profesorë, që do ta provojnë se a di shkrim dhe lexim.*

Atullah ef. Kurtishi: *Mendoj se nuk ka nevojë, ngase vetë gjykatësi mund ta vërej dhe të bindet se a di të lexoj, të shkruaj dhe ta flas gjuhën serbe. Me jep një libër të lexoj. Më thuaj çfarë të shkruaj, unë do të shkruaj, porse asgjë nuk kam kundër që të më provojnë edhe profesorët.*

Gjykatësi: *Shevki Ramizi të ka paditur se ti ke paraqitur vërtetim të rremë se je shtetas i Jugosllavisë, ndërsa ti je shtetas i Turqisë.*

Atullah ef. Kurtishi: *Shtetas i Turqisë kam qenë derisa Shkupi i takonte Turqisë. Unë kam qenë shtetas i Serbisë, ndërsa tash jam shtetas i Jugosllavisë.*

Gjykatësi: *Ku ke qenë në vitin 1913?*

Atullah ef. Kurtishi: *Në vitin 1913 kam qenë në Egjipt, saktësisht në Kajro, kam qenë në shkollim. Në Kajro kam shkuar në vitin 1911.*

Gjykatësi: *Kur je kthyer ne Jugosllavi?*

Atullah ef. Kurtishi: *Në Shkup jam kthyer në vitin 1914. Jam kthyer me pasaportë të Serbisë. Në vitin 1913 kam shkuar në konsullatën ruse dhe atje kam deklaruar se unë jam shtetas i Serbisë, ngase Shkupi ishte në sundimin e Serbisë. Në Kajro në vitin 1913 nuk kishte konsullatë serbe, sepse konsullata ruse përfaqësonte Serbinë. Unë në Athinë, në përfaqësinë e Serbisë kam marrë ndihmë materiale për t'u kthyer në Shkup. Jam i lindur në Studeniçan. Kam dhënë deklaratë para konsullit rus. Unë jam banor i përhershëm i komunës së Draçevës dhe vëllai im më i madh se unë, që ishte nëpunës në kooperativë më ka lajmëruar edhe mua te qeveritarët serbë, ngase në kohën kur ushtria serbe e mori Shkupin unë isha në studime dhe nuk kisha ikur para ushtrisë serbe.*

Gjykatësi: *A keni qenë i internuar në Krlevë?*

Atullah ef. Kurtishi: *Në vitin 1919, unë me më shumë se 50 shokë të tjerë ishim të internuar në Krlevë. I nderuar gjykatës, ajo që unë kam qenë i internuar në Krlevë është argument se unë jam shtetas i këtij shteti. Sikur të kisha qenë shtetas i Turqisë, do të më largonin jashtë kufijve e jo të më dërgonin në Krlevë.*

Gjykatësi: *Në vitin 1919 ku keni qenë?*

Atullah ef. Kurtishi: *Në vjeshtë të vitit 1919 kam marrë pasaportën serbe nga Ranko Trifunoviq kryetar i rrethit (komunës) që të udhëtoj për në Turqi. Në Turqi kam shkuar me pasaportë serbe dhe në vitin 1922 jam kthyer në Studeniçan, ndërsa në vitin 1924 kam ardhur dhe jam vendosur me vendbanim në Shkup, ku Këshilli i komunës më ka pranuar si banor i qytetit.*

Gjykatësi: *Ke edhe diçka për të thënë?*

Atullah ef. Kurtishi: *Po, kam. Shevki Ramizi e di mirë se unë di ta shkruaj, ta lexoj dhe ta flas gjuhën e shtetit dhe se jam shtetas i këtij shteti, por më padit sepse më urren. Ai ka siguruar nga Komuna e Draçevës lloj-lloj vërtetimesh të falsifikuara sipas dëshirës së tij. Njëherë merr vërtetim kinse unë nuk kam qenë banor i kësaj komune e këtë vërtetim e dërgon në Këshillin Shtetëror dhe më padit se me vendim jam caktuar për anëtar të Ulema Mexhlisit. Më pas prej Komunës së Draçevës merr vërtetim tjetër se unë jam anëtar i kësaj komune. Ashtu si i duhen atij, ai edhe nxjerr vërtetime. Unë në vitin 1923 nga ana e Ministrisë së Fesë jam emëruar për myderriz pranë Medresesë. Atëherë Shevki Ramizi nuk më paditi se unë jam shtetas i Turqisë, ndërsa tash më padit.*

Përveç vizionit të tij që shqiptarët t'i shohë ndryshe, Atullah ef. Kurtishi ka qenë edhe mbështetës dhe përkrahës i partisë politike Xhemijeti, e cila atëbotë ishte e vetmja lëvizje politike myslimane në tërë territorin e SKS-së, e në të cilën aderonin edhe një numër

shumë i madh i atdhetarëve shqiptarë. Pastaj, ka qenë edhe kundër ideologjisë majtiste dhe sistemit komunist. Atullah ef. Kurtishi bashkë me nxënësit e tij alarmonte se kjo ideologji ishte kundër dhe në dëm të popujve që ishin të ndryshëm me fe dhe komb. Kontribut të madh, Atullah ef. Kurtishi bashkë me nxënësit e tij, dhanë edhe për organizatën NDSH. Ata bashkëpunuan me organizatat tjera kombëtare, sidomos me organizatën Besa Kombëtare.

Edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, derisa këto vende ishin të pushtuara nga okupatori bullgar, Atullah ef. Kurtishi i vazhdoi qëndrimet e tij. Bullgarët e kishin kuptuar se një nga gjeneratorët e rezistencës të këtyre trojeve është pikërisht ai. Andaj e kishin arrestuar dhe internuar për të vuajtur në burg në Sofje. Atje kishte qëndruar gati një vit. Pas lirimit nga burgu, përsëri është kthyer në Shkup, ku sërish ka vazhduar veprimtarinë e tij.

Atullah ef. Kurtishi ndërroi jetë më 25 nëntor 1946 dhe u varros në varrezat e Gazi Babës në Shkup. Meqë varrezat e Gazi Babës në periudhën komuniste u dislokuan në Butel, tashmë nuk ekziston ndonjë gjurmë që tregon se në këto vende dikur ka pasur varreza të myslimanëve. Në bazë të pohimeve të popullit, varri i Atullah ef. Kurtishi ishte afër tyrbes, që gjendet në majë të kodrinës së Gazi Babës. Në afërsi të kësaj tyrbeje sot është ngritur shtylla metalike, në të cilën janë instaluar antenat dhe repetitorët e radio-televizioneve, ndërsa varri i Atullah ef. Kurtishi gjendej vetëm disa metra në anën veriore të kësaj shtylle⁷²⁴.

Gjurmët e Atullah ef. Kurtishit, sipas nipit të tij⁷²⁵, janë shkatërruar gjatë tërmetit që ka kapluar Shkupin në vitin 1963. Sipas dëshmive tjera të familjarëve të tij, thuhet se qëllimisht janë djegur shumë fotografi, dokumente, shkrime e gjithçka që ka qenë pronë e Atullah ef. Kurtishit,

⁷²⁴ Taxhedin Bislimi, po aty... (Të dhënat e njejta gjenden në formë elektronike në këtë adresë: <http://medreseja-medah.blogspot.mk/>;

⁷²⁵ Deklarata e Atullah ef. Kurtishit, i lindur në vitin 1949, imam në xhaminë Ballaban në Çarshinë e Vjetër në Shkup (nip i Atulla Hoxhës);

me qëllim që ideologjia e tij asnjëherë të mos realizohet në këto troje. Fatkeqësisht, thotë Atullah Kurtishi i riu, ne nuk posedojmë dokumente, ndoshta në arkivat e Stambollit ekzistojnë, ndërsa porosinë e tij vazhdimisht ua përcjellim gjeneratave që vijnë pas neve.

Nga jeta dhe veprimtaria e Atullah ef. Kurtishi kuptojmë se ky personalitet nuk duhet harruar, dhe misioni i tij nuk duhet nëpërkëmbur nga shqiptarët e Shkupit. Nuk duhet harruar as porosinë e tij të madhe se: “Ai që shpërngulet në Turqi, nuk është as fetar e as kombëtar”. Mendoj se Shkupi dhe rrethina duhet të vlerësojnë figurën e tij, që të paktën të çohet deri në fund amaneti se drita, arsimi, edukata dhe politika të kryhen me nder. Sot, pas gjysmë shekullit, përveç Xhamisë së Epërme të Studeniçanit, që e mban emrin e tij si dhe Xhamisë qendrore në Studeniçan, që e mban emrin e medresesë së tij (Medah), të cilën ai e themeloi në Shkup, asnjë institucion tjetër i Shkupit shqiptar nuk ia ka dhënë vendin e merituar.

Prandaj, urojmë që e ardhmja e shqiptarëve të Shkupit të jetë më e ndritur, pasi që ky ka qenë mision dhe kërkesë e përhershme edhe e dijetarëve të mëparshëm, përfshirë edhe Atullah ef. Kurtishin.

Në fund, ja edhe disa porosi të Atullah ef. Kurtishit që janë përcjellë brez pas brezi:

- 1. Mos më daltë shpirti pa e pa flamurin shqiptar duke valëvitur në Kalanë e Shkupit;*
- 2. Kush merr rrugën përmes së cilës e kërkon diturinë, Allahu do t’ia lehtësojë rrugën për xhenet (parajsë);*
- 3. Nuk ka migrim pas çlirimit, por angazhim dhe vendosmëri;*
- 4. Turqia nuk është parajsë, por këto toka shndërrohen në parajsë duke i kultivuar ndjenjat fetare, patriotike, arsimore, edukative, kulturore, tregtare etj. Mos i braktisni këto vende, të cilat paraardhësit tonë i mbrojtën me gjak.*

FJALA PËRMBYLLËSE

Gjatë dy ditëve, më 14 dhe 15 tetor 2015, në Shkup i zhvilloi punimet konferenca shkencore me temë “Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore”.

Konferenca u organizua nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, dhe u mbështet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë.

Aktivitetin e shpalli të hapur ministri i Arsimit dhe Shkencës, z.Abdilaqim Ademi, i cili me këtë rast arsyetoi mbështetjen e dhënë kësaj konference shkencore, me synimin që të dalin në pah edhe të vërteta të reja historike që do ta begatojnë mozaikun historigrafik për Shkupin dhe shqiptarët.

Ndërsa, drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Dr.Skender Asani, tha se kjo është hera e parë që në mënyrë shkencore hulumtohet kjo periudhë e ndjeshme historike, bazuar në të dhënat dokumentare e arkivore, shumica e të cilave publikohen për herë të parë.

Fjalë përshëndetëse patën edhe drejtori i Institutit të Historisë në Tiranë, Akademik Beqir Meta, drejtori i Institutit të Historisë në Prishtinë, Prof.dr. Sabit Syla, dhe drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prof.dr. Hysen Matoshi. Të gjithë këta çmuan lartë idenë dhe nevojën e organizimit të kësaj konference për historio-grafinë shqiptare.

Në konferencë, me punimet e tyre u prezantuan mbi 30 studiues të njohur nga shumë qendra shkencore të vendit dhe jashtë, me fakte

dhe dëshmi të reja për historinë e shqiptarëve të Shkupit dhe rret-hinës në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore.

Këshilli organizues vlerëson se në këtë konferencë u paraqitën tema mjaft me interes për historiografinë shqiptare. Pati tema dhe dilema të cilat për herë të parë u ngritën dhe të cilat meritojnë vëmendje edhe më të madhe.

Fati i shqiptarëve të Shkupit dhe rrethinës gjatë kësaj periudhe ishte mjaft tragjik, i përcjellë me kolonizimin e dhunshëm serb dhe spastrimin etnik. Shqiptarëve iu mohuan të gjitha të drejtat kombëtare, dhe u shtrënguan të shpërngulen nëpër Turqi.

Të vetmet institucione të cilat vazhduan të funksionojnë të gjymtuara dhe nën presionet e dhunshme të pushtetit serb, ishin ato fetare islame, ku shqiptarët dhe myslimanët e tjerë i zhvillonin disa nga aktivitetet e tyre.

Në sesionin e parë u paraqitën këta studiues me këto tema: BEQIR META – “Zhvillimet politiko-ushtarake në Shkup gjatë vitit 1912”; NEBI DERVISHI – “Veprimtaria atdhetare e familjes Draga në Shkup”; MARENGLEN VERLI – “Shkupi në fokusin e një pionieri të studimeve albanologjike – Hamit Kokalari”; DAUT BISLIMI – “Historiografia serbe për shqiptarët dhe Shkupin në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore”; AVZI MUSTAFA – “Arsimi dhe edukimi në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore”; QERIM LITA – “Diplomacia shqiptare në Shkup (1935–1941)”; SHINAZI MEMEDI – “Roli i Bashkësisë Fetare Islame dhe Myftinisë së Shkupit ndërmjet dy luftërave botërore”; ADNAN ISMAILI – “90 vjetori i rrënimin të Xhamisë Burmalit në Shkup”; VIKTOR SOPI – “Veprimtaria atdhetare në Shkup e arqipeshkvit Lazër Mjeda”; NAIM HALIMI – “Reforma agrare dhe kolonizuese në qarkun e Shkupit ndërmjet dy luftërave botërore”; METIN IZETI – “Teqetë e Shkupit midis dy luftërave botërore dhe ndikimi i tyre në ngritjen intelektuale dhe fetare të

popullsisë shqiptare”; NURIDIN AHMETI – “Dëmtimi sistematik i pronave private dhe vakëfeve në Shkup, sipas një shkrese zyrtare të Ferhat Dragës të vitit 1935”, dhe SKENDER ASANI e MEHMET PRISHTINA me temën “Shkupi – qendër e rëndësishme e organizatës politike Xhemieti”.

Kurse, në sesionin e dytë shkencor që u mbajt në ditën e dytë të konferencës në Shkup, u paraqitën këta studiues me këto tema: QEMAL MURATI – “Shqiptarët e Shkupit në dritën e gjuhës dhe toponimisë së tyre në disa botime të proveniencës serbe ndërmjet dy luftërave botërore”; ZEQIRIJA IBRAHIMI – “Zhdukja e kujtesës historike të Shkupit, nëpërmjet planeve urbanistike 1913–2014”; ALBERT RAMAJ – “Gjendja e Arqipeshkvisë së Shkupit dhe veprimtaria e arqipeshkvit Lazër Mjeda mes dy lufrave botërore”; MIXHAIT POLLOZHANI – “Shqiptarët dhe trashëgimia arkeologjike në Shkup, midis dy luftërave botërore”; ISAMEDIN AZIZI & AGRON SALIU – “Lëvizjet demografike të shqiptarëve në Shkup me rrethinë midis dy luftërave botërore”; LIDIJA GJUROVSKA & GABRIELA TOPUZOVSKA – “Shkalla e lindjeve dhe vdekjeve në zonën e Shkupit dhe rrethinës ndërmjet dy luftërave botërore”; NATASHA DIDENKO & ALBERT HANI – “Zhvillimet kulturore në Shkup ndërmjet dy luftërave botërore”; IZAIM MURTEZANI – “Shkupi mes dy luftërave botërore në vargjet e rapsodive popullore”; SKENDER LUTFIU – “Reforma agrare dhe kolonizimi në Ferizaj me rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore”; SEFER TAHIRI – “Interpelanca e deputetëve shqiptarët të Shkupit, ndaj ministrit Davidoviq (1924)”; SEVDAIL DEMIRI – “Çështja shqiptare në shtypin e kohës që botohej në Shkup”; BESNIK EMINI – “Krahasimet e dy librave për Shkupin të autorit Sali Hasim beu”; ARDIAN LIMANI – “Delegacioni shqiptar në Konferencën e Versajës, në mbrojtje të shqiptarëve të krahinës e Shkupit”; NASER RAMADANI – “Funksionimi i medreseve të Shkupit gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore”; TAXHEDIN BISLIMI – “Kontributi i Mexhliis Ulemasë së

Shkupit në ngritjen e vetëdijes dhe arsimit tek popullata (shqiptare)”; MURTEZAN IDRIZI – “Roli edukativo – arsimor dhe kulturor i medreseve në Shkup – (Medreseja Medah, Medreseja e Madhe dhe Medreseja e Isa Beut)”; ISLAM ISLAMI & MUHAMMED ALI – “Medreseja Meddah dhe impaktet e saj në shoqërinë shkupjane ndërmjet dy luftërave botërore”; AFET JASHARI – “Porositë e Ataullah ef. Kurtishit (1874–1946) për shqiptarët e Shkupit”; dhe RINI USEINI – “Aktivitetet e shoqërive dhe zhvillimet kulturore në Shkup e rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore, parë nga këndvështrimi etnografik”.

Këshilli organizues vlerëson se temat dhe kumtesat e paraqitura në këtë konferencë, kishin një nivel të kënaqshëm shkencor, dhe të njëjtit mund të botohen në një edicion të veçantë të revistës “Scupi”.

Ju faleminderit.

Dr. Sevdail Demiri

ITSHKSH, Shkup, 15.10.2015

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

**“Jeta shoqërore e shqiptarëve në shkup dhe rrethinë ndërmjet dy
luftërave botërore”**

SCUPI – 12

*Ky botim u ndihmua nga:
Qendra Kulturore Turke “Junus Emre” në Shkup*



Shtypi: Fokus Print – Shkup

CIP katalogizimi